



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS
PENALE**



DISERTACION

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”**

**“PROCESI I TË PROVUARIT DHE BARRA E PROVËS NË PROCEDIMET
PASURORE DHE GJYKIMET PASURORE TË SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT
TË PRODUKTEVE TË KRIMIT.
ÇËSHTJE TË PRAKTIKËS GJYQSORE DHE STANDARDEVE
NDËRKOMBËTARE ”**

KANDIDAT

Mag. SANDËR SIMONI

UDHËHEQËSE SHKENCORE

Prof. Dr. VASILIKA HYSI

TIRANË, 2021

© E drejta e autorit: Sandër Simoni

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit të UT-së “*Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoraturave*”, miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me Vendimin Nr. 20, datë 13.11.2008.

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenes me çfarëdo lloj mjeti apo forme, pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

PËRMBAJTJA

Vlerësim dhe mirënjohje	vii
Abstrakt.....	viii
Shkurtime.....	x
Parathënie	xi

KREU I

SEKUESTRIMI DHE KONFISKIMI SI INSITUTE TË SË DREJTËS PENALE MATERIALE, PROCEDURALE DHE SI PROCEDIM PASUROR

1.1. Hyrje	1
1.2. Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprimtarisë kriminale si institute të së drejtës penale e asaj procedurale	3
1.3. Sekuestrimi dhe konfiskimi si procedim pasuror.....	11
1.4. Llojet e konfiskimeve si masë parandaluese pasurore	17
1.5. Krimi i organizuar, trafiket si burime të përfitimit të paligjshëm dhe nevoja për konfiskimin e të ardhurave nga kjo veprimtari kriminale.....	24
1.6. Vepra të tjera penale si burime të përfitimeve të paligjshme të pasurisë dhe nevoja për konfiskimin e të ardhurave prej saj.....	30
1.7. Çështje në vëmendje.....	34

KREU II

NORMAT DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË VEPRIMTARISË KRIMINALE

2.1. Hyrje.....	36
-----------------	----

2.2. Normat ndërkombëtare mbi konfiskimin e produkteve të krimit.....	38
2.3. Standardet ndërkombëtare mbi çështjen e konfiskimit të produkteve të krimit dhe barrën e provës.....	44
2.4. Modele të ndryshme ligjore të ligjeve mbi konfiskimet dhe zgjidhjet tipike mbi barrën e provës.....	55
2.5. Roli i institucioneve ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e sekuestimeve dhe konfiskimeve të produkteve të krimit (përfshirë bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellë).....	66
2.6. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe reflektimi i tyre në praktikën e zbatimit të ligjit në nivel kombëtar e ndërkombëtar.....	73
2.7. Çështje në vëmendje dhe perspektiva e tyre.....	88

KREU III

MODELI SHQIPTAR ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE

3.1. Hyrje.....	91
3.2. Sekuestrimi dhe konfiskimi sipas legjislacionit shqiptar.....	92
3.3. Legjislacioni shqiptar për masat parandaluese kundër pasurisë në Shqipëri, sekuestrimi dhe konfiskimi pasuror.....	96
3.3.1. Masat parandaluese pasurore sipas legjislacionit të vitit 2004.....	95
3.3.2. Masat parandaluese pasurore sipas legjislacionit të vitit 2009.....	102
3.3.3. Masat parandaluese pasurore sipas legjislacionit të vitit 2017.....	108
3.3.4. Masat parandaluese pasurore në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike sipas Aktit Normativ 1/20.....	115
3.4. Reflektimi i modeleve të legjislacioneve evropiane në legjislacionin shqiptar.....	122
3.5. Probleme teorike dhe të praktikës gjyqësore mbi standardet ligjore të zbatimit të ligjit për goditjen e pasurisë, provat dhe barra e provës.....	126
3.6. Çështje në vëmendje.....	130

KREU IV

STANDARDI I PROVËS, PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN PASUROR

4.1. Hyrje.....	132
4.2. Procesi i të provuarit, provat dhe standardi i tyre në hetimin dhe gjykimin e masave parandaluese pasurore.....	134
4.3. Standardi provues për masat parandaluese.....	137
4.4. Niveli i dyshimit të bazuar në indicie si standard prove për sekuestrimin e konfiskimit.....	141
4.5. Provat, llojet dhe vlerësimi i tyre në këndvështrim të procedimit penal e atij pasuror.....	149
4.6. Objekti i të provuarit- <i>thema probandum</i> —në procedimin pasuror.....	155
4.7. Hetimi pasuror dhe kërkesa për sekuestrim, të dhënat që shërbejnë si bazë për fillimin e procedimit.....	160
4.8. Kërkesa për konfiskim, kriteret e vlerësimit të kushteve për të vendosur në lidhje me kërkesën për konfiskim pasuror e provat ku mbështetet.....	181
4.9. Çështje ligjore dhe praktike mbi provat.....	191

KREU V

BARRA E PROVËS, KONTRADIKTORITETI DHE MBROJTJA E INTERESAVE TË TË TRETIT GJATË KONFISKIMIT

5.1. Hyrje.....	199
5.2. Barra e provës – <i>onus probandum</i> – si tipar i veçantë i konfiskimit si masë parandaluese pasurore	201
5.3. Kontradiktoriteti në gjykim dhe mundësitë procedurale të ligjit të veçantë dhe atij procedural për prova, në funksion të përmbushjes së barrës së provës	209
5.4. Provat për justifikimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë, mundësitë e paraqitjes së tyre..	212
5.4.1. Të ardhurat e padeklaruara në organet tatimore, huatë, dëshmitë, ekspertimet private dhe konsulenca teknike.....	221

5.5. Mbrojtja e interesave të të tretëve në mirëbesim dhe barra e provës, garancitë për mbrojtjen e pasurisë së ligjshme.....	226
5.5.1 Pozita procedurale e personave të tretë, veçanërisht i kreditorëve dhe bankave, interpretime të ligjit në praktikën gjyqësore.....	230
5.5.2 Përmbledhje e praktikës gjyqësore për sekuestrim e konfiskim pasurive, me fokus mbrojtjen e interesave të Personit të Tretë.....	245
5.6. Vlerësimi i provave gjatë gjykimit të kërkesave për konfiskim pasurie në funksion të barrës së provës, dallimi mes procedurës civile e penale.....	248
5.7. Kriteret e vlerësimit të kushteve për konfiskim, kur gjendet e provuar kërkesa për konfiskim të pasurisë	251
5.8. Çështje të ligjit dhe të praktikës gjyqësore.....	252

KREU VI

KONKLUZIONE, REKOMANDIME, BIBLIOGRAFI, STATISTIKA

6.1 Hyrje.....	261
6.2 Konkluzione.....	263
6.3 Rekomandime.....	290
6.4 Bibliografi.....	307
6.5.Statistika	314

VLERËSIM DHE MIRËNJOHJE

Në fillim të këtij punimi, shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen tim për Departamentin e të Drejtës Penale të Fakultetit të Drejtësisë për ndihmën dhe mbështetjen që më kanë dhënë në realizimin e gjithë këtij procesi.

Një vlerësim dhe mirënjohje të veçantë shpreh për udhëheqësen shkencore të këtij punimi Prof. Dr. Vasilika Hysi, për gjithë gatishmërinë e saj, këshillat e vyera, sygjerimet e rekomandimet, të cilat i kam reflektuar në mënyrë periodike gjatë punimit tim.

ABSTRAKT

Masat parandaluese të sekuestrimit dhe konfiskimit pasuror janë një nga instrumentet më efikase në hetimin e konfiskimit dhe pasurisë së paligjshme, por në të njëjtën kohë dhe një nga institutet më të diskutueshme në raport me respektimin e parimeve të procesit të drejtë gjyqësor dhe së drejtës së pronës, provat, standardin e të provuarit, devijimin e barrës së provës, mbrojtjen e të drejtave të të tretëve. Ky punim trajton këto institute si masa parandaluese nëpërmjet procedimit pasuror *in rem*, natyrën e tij si instrument penal ose civil në drejtim të parandalimit. Punimi përmban analizën e legjislacionit shqiptar të kësaj natyre të viteve 2004, 2009, 2017, si dhe Aktin Normativ të vitit 2020 duke trajtuar origjinën e këtyre ligjeve, evoluimin, zbatimin, çështje të diskutueshme të tyre në praktikën gjyqësore, ndryshimet e fundit, tiparet e veçanta të tyre si devijimin e barrës së provës, fuqia prapavepuese e ligjit, konfiskimi, që shoqëron apo jo dënimin e personit, konfiskimi i zgjeruar, mbrojtja e interesit të të tretëve etj. Punimi ka trajtuar gjithashtu normat ndërkombëtare në ato të OKB, KE, BE, standardet ndërkombëtare për konfiskimin pasuror, institucionet ndërkombëtare e në nivel të BE-së që bashkëpunojnë e monitorojnë konfiskimin si masë parandaluese pasurore, jurisprudencën e GJEDNJ-së, parimet e mbrojtjes që ajo ka zhvilluar, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në qëndrimet e fundit, në lidhje me proporcionalitetin e masave pasurore, mbrojtjen e interesave të palëve të treta, të ardhurat e padeklaruara në organet tatimore, ose konfiskimi pa një vendim dënimi. Vendin kryesor në punim e zë trajtimi i standartit të provës, provave, tiparet e veçanta të të provuarit, niveli i dyshimit i bazuar në indicie si standart prove për sekuestrimin dhe konfiskimin, provat dhe llojet që përdoren në procedimin penal parandalues, objektin e të provuarit etj. Një trajtim të gjerë në këtë punim i është kushtuar barrës së provës, si tipar i konfiskimit si masës parandaluese pasurore duke u ndalur në elementët e procesit të rregullt gjyqësor, mundësitë që ai ofron mbi kontradiktoritetin në gjykim në funksion të përmbushjes së barrës së provës në vërtetimin e ligjshmërisë së pasurisë. Në punim janë trajtuar dhe interpretuar një sërë provash si ekspertimet kontabël, dokumentet zyrtare etj., që përdoren në gjykimin e konfiskimit për justifikimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë apo provat, që përdoren për të justifikuar marrëdhëniet me kreditë, huatë, të ardhurat e padeklaruara etj. Janë dhënë vlerësimet përkatëse për provat dhe dallimet në mes procedurës penale dhe asaj civile, mbrojtja e interesave të të tretëve, pozita procedurale e tyre dhe garancitë për mbrojtjen e garancisë së ligjshme, janë trajtuar në mënyrë të veçantë dhe mbi këto çështje janë ngritur disa hipoteza në punim, të cilat janë vërtetuar gjatë kryerjes së tij. Në fund të punimit janë dhënë konkluzionet dhe rekomadimet përkatëse sipas fushave, si dhe janë janë bashkëngjitur dhe të dhëna statistikore duke plotësuar dhe analizën e politikës penale të ligjit.

FJALËT KYÇ: Sekuestrim, konfiskim, të ardhura nga krimi, produkt i veprimtarisë kriminale, normat ndërkombëtare, standardet ndërkombëtare, jurisprudenca e GJEDNJ, modelet ligjore, konfiskimi pa dënim, proces i të provuarit, provat, barra e provës, mbrojtja e interesit të të tretit.

ABSTRACT

Preventive measures of seizure and confiscation of property is one of the most effective instruments in the investigation and confiscation of illegal property, but at the same time one of the most controversial institutions in relation to respecting the principles of fair trial and property rights, evidence, standard of proof, diversion of the burden of proof, protection of the rights of third parties. This paper treats these institutes as preventive measures through property proceedings *in rem*, its nature as a criminal or civil instrument in terms of prevention. The paper contains the analysis of Albanian legislation of this nature covering 2004, 2009, 2017, as well as the Normative Act of year 2020 addressing the origin of these laws, their evolution, implementation, controversial issues in judicial practice, recent changes, features of their special features such as deviation of the burden of proof, retroactive force of law, confiscation that accompanies or not the punishment of the person, extended confiscation, protection of the interest of third parties, etc. The paper has extensively addressed international norms in those of UN, EC, EU, international standards for property confiscation, international institutions and at EU level that cooperate and monitor confiscation as a preventive measure of property, the jurisprudence of the ECHR, the principles of protection that it has developed, focusing in particular on recent positions regarding the proportionality of property measures, the protection of the interests of third parties, undeclared income to the tax authorities, or confiscation without a sentencing decision. The main place in the paper is occupied by the treatment of the standard of evidence, evidence itself, special features of evidence, level of suspicion based on clues as a standard of evidence for sequestration and confiscation, evidence and types used in preventive criminal proceedings, object of evidence etc. Extensive treatment in this paper is devoted to the burden of proof, as a feature of confiscation as a preventive measure of property focusing on the elements of due process, the opportunities it offers on adversarial proceedings in order to meet the burden of proof in proving the legality of the property. The paper deals with and interprets a series of evidence such as accounting expertise, official documents etc. used in seizure proceedings to justify the lawful origin of property or evidence, used to justify credit relations, loans, undeclared income etc. Relevant assessments have been given for the evidence and differences between criminal and civil proceedings, protection of the interests of third parties, their procedural position and guarantees for the protection of legal guarantees have been treated separately and on these issues some hypotheses have been raised, which have been certified during its execution. At the end of the paper, the relevant conclusions and recommendations are given according to the fields, as well as statistical data are attached, completing the analysis of the criminal policy of the law.

LISTA E SHKURTIMEVE

- KP	Kodi Penal
- KPrP	Kodi Procedurës Penale
- KE	Këshilli Evropës
- UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
- UNTOC	Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar
- CETS 198	Konventa e Këshillit të Europës për Pastrimin, Depiskimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi
- UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
- UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar
- GJ.E.D.NJ.	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- K.E.D.NJ.	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- K.SH.H.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- BE	Bashkimi European
- GJL	Gjykata e Lartë
- GJK	Gjykata Kushtetuese
- GJKR	Gjykata e Krimeve të Rënda
- GJAKR	Gjykata e Apelit për Krime të Rënda
- GJPKKO	Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- KSH	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- KE	Këshilli Evropës
- UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
- UNTOC	Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar
- AAPSK	Agjensia e Administrimit të Paurive të Sekuestruara e të Konfiskuara
- GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
- MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- TFVP	Rekomandimet e Task Forcës për Veprimin Financiar lidhur me Pastrimin e Parave e vitit 2012

PARATHËNIE

Qëllimi kryesor i veprimtarisë kriminale në përgjithësi dhe e krimit të organizuar në veçanti, është sigurimi i përfitimeve materiale, të ardhurave në para, pasurive të luajtshme e të paluajtshme. Lufta ndaj kriminalitetit nuk do të kishte kuptim nëse nuk identifikohen e konfiskohen të ardhurat nga veprimtaria kriminale. Sekuestrimi dhe konfiskimi, si masa parandaluese pasurore, janë dy instrumente procedurale shumë efektive për parandalimin e goditjen e kriminalitetit në përgjithësi dhe atij të organizuar e korrupsionit në veçanti. Këto instrumente ndjekin parimin se kriminaliteti prodhon të ardhura e pasuri dhe kjo pasuri duhet identifikuar e sekuestruar sa më shpejt në mënyrë që të mos “helmojë” ekonominë, si dhe të prishë kohezionin social në shoqëri. Asgjë e krijuar në paligjshmëri e kriminalitet nuk mund të përdoret më tej për të krijuar të ardhura e pasuri të tjera duke dëmtuar parimet e konkurrencës së lirë, ekonomisë së tregut e duke kompromentuar parimet e shtetit të së drejtës.

Legjislacioni ynë përvehtësoi një model ligjor të suksesshëm të zbatuar në vendet e përparuara evropiane, duke parashikuar me ligj të veçantë procedimin pasuror parandalues in rem i njohur në sistemet ligjore bashkëkohore si konfiskimi civil. Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë ishte një risi, pasi solli ndryshim të një sërë parimesh tradicionale të së drejtës e të procedimit penal si veprimi në kohë i ligjit, rrethi i personave ndaj të cilëve vepronte, barra e provës për subjektin e ligjit, pavarësia nga procedimi penal etj.

Natyra e ligjit, zgjerimi i veprimit në kohë të tij, rrethi i gjerë i personave ndaj të cilëve vepronte, devijimi i barrës së provës, rregullat e të provuarit, standardi i provës së kërkuar për të filluar procedimin pasuror e për të vendosur konfiskimin, autonomia nga procedimi penal e nga pozita penale e personit janë disa nga çështjet e diskutueshme të këtij ligji, që sollën diskutime juridike e debate. Ky ligj duke qenë një instrument i zhdërvjellët e efikas procedural, u jep mundësi organeve të procedimit që të sekuestrojnë e të konfiskojnë të ardhura e pasuri duke luftuar kriminalitetin në pikën e tij më të ndjeshme e duke rritur autoritetin e duhur në zbatimin e ligjit. Por, po aq e rëndësishme është mbrojtja dhe garantimi i së drejtës së pasurisë së ligjshme, lirisë së veprimit

ekonomik si e drejtë kushtetuese, mbrojtja e të drejtave ekonomike të personave të tretë, familjarëve, bashkëpunëtorëve në veprimtarinë ekonomike, kreditorëve, huadhënësve etj.

Studimi i këtij ligji dhe interpretimet teorike e gjyqsore mbi të kanë rëndësi të madhe në kushtet e rëndësisë që ka zbatimi i tij. Gjatë punës sime si gjyqtar në gjykatën kompetente ku zbatohet ky ligj përgjatë 17 viteve¹ nga të cilat 15 kam qenë në cilësinë e drejtuesit të gjykatave, e tashmë me eksperiencën si gjyqtar në Gjykatën e Lartë kam patur njëqoft dilema profesionale mbi disa çështje të zbatimit të këtij ligji si shtrirja e veprimit të tij në kohë, autonomia me procedimin penal, kushtet e fillimit të procedimit pasuror e baza e të dhënave e provave mbi të cilën fillohet si dhe kushtet mbi të cilat duhet të bazohet konfiskimi.

Vëmendjen më të madhe ma ka tërhequr procesi i ndërlikuar i të provuarit, natyrat e provave dhe procedura e marrjes e vlerësimit të tyre, barra e provës, niveli i provës gjatë sekuestrimit e konfiskimit. Në këndvështrimin tim si zbatues, por dhe studiues i të drejtës dhe këtij ligji në veçanti, vlerësoj se për zbatimin korrekt të tij, duhet gjetur balanca në mes të fuqisë së veprimit të ligjit e mbrojtjes së të drejtave ligjore, ekonomike, pasurore të shtetasve, subjekte të ligjit, të afërmeve të tyre, bashkëpunëtorëve, të tretëve.

Justifikimi i prejardhjes së ligjshme të pasurisë është një proces i vështirë e të provuarit përkundrejt mundësisë që ka prokuroria për të përdorur të dhënat, indiciet, provat e procesimit penal. Kjo ndikon në pozitën e zotëruesit të pronës. Hulumtimi i të gjitha mundësive, që ligji apo dispozitat e tjera referuese procedurale i japin subjektit të tij, e personave të tretë në mbledhjen e provave dhe në dhënien vlerë të pretendimeve të tyre, është një nga qëllimet e këtij punimi. Çështjet e interpretimit gjyqësor mbi devijimin e barrës së provës për justifikimin e pasurisë së ligjshme tek zotëruesi i pasurisë, niveli më i ulët i kushteve të fillimit të procedimit dhe nevoja e balancimit të një sërë instrumentesh procedurale, mundësitë e mbledhjes e marrjes së provave e

¹ Sipas ligjit nr. 9284 datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese” gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë ishte Gjykata për Krime të Rënda, gjykatë në të cilin unë kam ushtruar detyrën e gjyqtarit nga krijimi i saj në vitin 2004 deri në riorganizimin e saj në dhjetor të vitit 2019, duke mbajtur në të njëjtën kohë dhe funksionin e Kryetarit të Gjykatës. Nga dhjetori i vitit 2019 e deri në mars 2021 kam ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe njëkohësisht funksionin Pozicionin e Kryetarit në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjykata që pasoi Gjykatën e Krimeve të Rënda.

paraqitjes së provave, vlera e vlerësimi i tyre, vështirësitë, zbatimi i parimit të proporcionalitetit në kufizimin e së drejtës së pasurisë e detyrimi për të reflektuar frymën e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut janë çështjet që mua më kanë nxitur të trajtoj këtë temë.

Për këtë është e nevojshme një interpretim korrekt nën frymën e normave, standardeve ndërkombëtaere, jurisprudencës kushtetuese e asaj të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, një praktikë gjyqsore e njëjtë e e qëndrueshme për çështje të zbatimit të tij. Një ligj i plotë me parashikimet e nevojshme e i plotësuar me rregullimet e duhura që të garantojë një procedim pasuror në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor e që ti japë palëve të gjitha mundësitë e mundshme për të referuar në insitutet e duhura procedurale, është i nevojshëm. Me dëshirën për të kontribuar me eksperiencën time gjyqsore e studimore mbi këto çështje vendosa t'i trajtoj këto në punimin tim.

Për këtë qëllim, punimi është strukturuar në kërër të veçantë, sipas pjesëve përkatëse kërkimore, studimore dhe analizuese. Çdo kre është titulluar sipas qëllimit të trajtimit dhe përmbajtjes. Në fillim të çdo kreu, me anë të një hyrje është shpjeguar ajo çfarë do të trajtojë kreu dhe në fund të çdo kreu ka një çështje dedikuar gjetjeve, çështjeve ligjore dhe praktike, si dhe atyre në vëmendje.

Në Kreun e parë “Sekuestrimi dhe konfiskimi si institute të së drejtës materiale procedurale e si procedim pasuror”, është trajtuar sekuestrimi dhe konfiskimi si institute penale dhe si institute të procedimit pasuror parandalues, duke përshkruar natyrën dhe dallimet në mes të tyre. Gjithashtu, në një çështje të veçantë kam trajtuar konfiskimin në veçanti, llojet e konfiskimit civil si masë parandaluese duke u ndalur e analizuar natyrën e çdo lloji konfiskimi civil pasuror si dhe format e tij atij të zakonshëm e të zgjeruar në veçanti sipas traditave ligjore juridike. Në një çështje të veçantë kam trajtuar krimin e organizuar, format kryesore të veprimtarisë së tij dhe trafiket, si burimet kryesore të përfitimeve të paligjshme materiale dhe nevojën ekzistuese për të konfiskuar të adhurat kriminale nga kjo veprimtari, me qëllim luftimin e kësaj forme të kriminalitetit. Gjithashtu, në një çështje tjetër kam trajtuar vepra të tjera penale si burime të përfitimeve të paligjshme të pasurisë dhe nevoja për konfiskimin e të ardhurave prej saj, duke u ndalur në mënyrë

të veçantë tek krimi ekonomik, pastrimi i parave, korrupsioni dhe vepra penale të tjera që gjenerojnë të ardhura kriminale.

Në Kreun e dytë të titulluar “Normat dhe standardet ndërkombëtare mbi konfiskimin e produkteve të veprimtarisë kriminale” është trajtuar në një çështje më vete tërësinë e normave ndërkombëtare në nivelin e OKB, KE, BE, mbi konfiskimin e produkteve të krimit e në një çështje tjetër standardet ndërkombëtare mbi konfiskimin e produkteve të krimit dhe barrën e provës duke u ndalur veçanërisht në ato të Bashkimit Europian. Më tej, janë trajtuar modelet e ndryshme të ligjeve mbi konfiskimet dhe zgjidhjet tipike mbi barrën e provës duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek ligji italian e ai anglez, si dhe ndikimi i tyre mbi ligjin tonë. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar rolit të institucioneve ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të produkteve të krimit, ku jam ndalur në mënyrë të veçantë në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën e ndërsjellë. Në këtë kre është trajtuar si çështje më vete jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut mbi konfiskimin e pasurisë, si masë parandaluese dhe reflektimi i tyre në praktikën e zbatimit të ligjit në nivel kombëtar e ndërkombëtar duke i përmbledhur këto gjetje në një çështje më vete në fund të kreut.

Kreu i tretë është titulluar “Modeli shqiptar me ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese”. Në këtë kre, fillimisht, prezantohet qëllimi i zgjedhjes së kësaj çështje për t’u trajtuar dhe çfarë duhet trajtuar. Më pas, është shqyrtuar sekuestrimi dhe konfiskimi sipas legjislacionit shqiptar, si dhe parandalimi dhe goditja e formave të veçanta nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë. Janë trajtuar në mënyrë kronologjike të tre ligjet për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, nëpërmjet masave parandaluese konkretisht të vitit 2004, 2009 e në mënyrë të veçantë, ndryshimet e e miratuara në vitin 2017, duke u ndalur gjërësisht në tiparet e secilit. Këtu përfshihen parashikime mbi fushën e zbatimit të ligjit, veprimin e tij në kohë, rrethin e personave mbi pasurinë e të cilëve vepron, për procedurën, standardin e të provuarit, barrën e provës etj. Gjithashtu, është trajtuar Akti Normativ me fuqinë e ligjit i vitit 2020 për masat parandaluese dhe karakteristikat ligjore të tij. Në këtë kre janë bërë disa analiza mbi reflektimin e modeleve të legjislacioneve evropiane në legjislacionin shqiptar, nga të cilat është ndikuar si dhe problemet teorike dhe të praktikës gjyqësore mbi standardet

ligjore të zbatimit të ligjit për goditjen e pasurisë dhe barrën e provës. Si çështje e fundit janë trajtuar gjetjet e këtij kreu.

Kreu i katërt është titulluar “Standardi i provës, provat dhe procesi i të provuarit në sekuestrimin dhe konfiskimin pasuror”. Në këtë kre kryesor të punimit, fillimisht, është shpjeguar qëllimi i tij dhe më pas janë trajtuar tiparet e veçanta të të provuarit, standardit të provës e provave në hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore. Në një çështje të veçantë kam trajtuar nivelin e dyshimit, të bazuar në indicie si standard prove për sekuestrimin dhe konfiskimin. Një çështje më vete, e trajtuar gjerësisht, janë provat, llojet dhe vlerësimi i tyre në këndvështrim të procedimit penal e atij pasuror e më tej objekti i të provuarit - *thema probandum* – në procedimin pasuror. Një vend të veçantë në punim zënë hetimi pasuror dhe kërkesa për sekuestrim, të dhënat që shërbejnë, provat që mund të përdoren në mbështetje të kërkesës për konfiskim të pasurisë e më tej kërkesa për konfiskim, kriteret e vlerësimit të kushteve për të vendosur në lidhje me kërkesën për konfiskim pasuror e provat ku mbështetet. Në fund të këtij kreu, në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur si gjetje çështjet ligjore me provat dhe të provuarin në analizë të praktikës gjyqësore.

Kreu i pestë është titulluar “Barra e provës, kontradiktoriteti dhe mbrojtja e interesave të të tretit gjatë konfiskimit”. Në fillim të këtij kreu është shpjeguar qëllimi i synuar me trajtimin e tij e më pas është analizuar barra e provës *onus probandum* si tipar i veçantë i konfiskimit si masë parandaluese pasurore. Në një çështje më vete është trajtuar kontradiktoriteti në gjykim dhe mundësitë procedurale të ligjit të veçantë dhe atij procedural për prova, në funksion të përmbushjes së barrës së provës, ndryshimet sipas procedurës. Një çështje e veçantë trajtuar gjerësisht, janë provat, që mund të përdoren për justifikimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë duke u ndalur tek të ardhurat e padeklaruara në organet tatimore, huatë, thirrja e personave të tretë, ekspertimet private dhe konsulenca teknike. Pjesë e kërimit shkencor është vlerësimi i provave gjatë gjyqimit të kërkesave për konfiskim pasurie në funksion të barrës së provës, dallimet në procedurën penale dhe civile; kriteret e vlerësimit të kushteve për të vendosur në lidhje me kërkesën për konfiskim dhe rastin kur pranohet konfiskimi, mbrojtja e interesave të të tretëve dhe barra e provës së tyre, garancitë për mbrojtjen e pasurisë së ligjshme. Gjetjet e këtij kreu mbi çështje ligjore dhe të praktikës gjyqësore janë trajtuar në mënyrë të veçantë.

*Në fund të punimit në Kreun e gjashtë e të fundit janë përmbledhur **konkluzionet, rekomandimet sipas fushës përkatëse, bibliografia** mbi materialet e shfrytëzuara në këtë punim shkencor, statistikat, me qëllim të një analize të politikës penale.*

*Për realizimin e punimit janë përdorur metoda hulumtuese e analizuese, duke synuar në një shtrirje të gjerë të kërkimit shkencor, analizës, duke ngritur hipoteza me qëllim vërtetimin e tyre duke arritur në gjetje, **konkluzione e rekomandime të caktuara**. Ky punim është trajtuar nëpërmjet përdorimit dhe kombinimit të dy metodave shkencore, të cilat kanë ndihmuar në konstatimin e problematikave, mbledhjen e informacionit, trajtimin e tij, si dhe arritjen dhe paraqitjen e konkluzionit dhe rekomandimeve. Më konkretisht: metoda hulumtuese doktrinale që konsiston në kërkimin ligjor të literaturës së duhur, legjislacioni, raporteve, studimeve, mbledhjen dhe sistemimin e literaturës të përbërë nga libra, udhëzime, dokumente të tilla si artikujt shkencorë, kumtesat e konferencave ndërkombëtare në fushën juridike, si dhe përzgjedhja e praktikës gjyqësore për të ilustruar objektivat dhe problematikën e ngritura në këtë punim. Literatura në gjuhë të huaj, raportet e studimet ndërkombëtare si dhe legjislacioni ndërkombëtar dhe i vendeve të tjera zë vendin kryesor, ndërsa praktika gjyqësore vendase është studiuar e gjitha për shkak të mundësisë që kam patur në njohjen e saj duke punuar në gjykatat kompetente të zbatimit të këtij ligji. Një nga vështirësitë ka qenë pikërisht mungesa e trajtimeve teorike shqiptare mbi këtë fushë studimi.*

Metoda analitike ka shërbyer për të analizuar teoritë dhe interpretimet e ndryshme mbi konfiskimin e masat parandaluese pasurore, analizimin e legjislacionit ndërkombëtar e në veçanti, atë evropian, si dhe legjislacionet e veçanta të shteteve, për të arritur në tiparin e ligjit tonë. Për përgatitjen e punimit, është shfrytëzuar një literaturë e gjerë e huaj, që kryesisht përfshin trajtime teorike, trajtime të instucioneve ndërkombëtare, raporte ndërkombëtare të organizatave ndërkombëtre, jurisprudencën e GJEDNJ, praktikën gjyqësore e kushtetuese të vendeve të tjera europiane, manualët analizuese të ligjeve analoge, literaturën vendase e pothuajse gjithë praktikën gjyqësore vendase e atë kushtetuese mbi çështje të zbatimit të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar.

Në këtë punim kam ngritur disa hipoteza si psh: a mund të themi se masat parandaluese pasurore, konfiskimi pasuror përbëjnë një juridiksion më vete si normë standarde e interpretimit në të drejtën ndërkombëtare, a duhet të kemi një juridiksion më vete të masave parandaluese pasurore me norma rregullatore specifike apo të vijohet me norma referuese, a duhet të ndjekim modelin e konfiskimit pa dënim dhe atë të zgjeruar, a kemi një standard prove të veçantë në procesin e të provuarit në shqyrtimin e masave pasurore, a kemi një standard prove të ndryshëm e parime të veçanta apo duhet të ndjekim parimet referuese në procedurën penale, a duhet të listojmë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese, a ofron ligji të gjitha instrumentete e nevojshme në marrjen e vlerësimit e provave, a kanë të njejtën vlerë indiciet, elementët faktikë, provat rrethanore e ato të marra pa kontradiktoritet, a u jep mundësi palëve për mbrojtje devijimi i barrës së provës, a mbron ligji interesat e të tretëve e sidomos të kreditorëve, a siguron referimi në procedurën penale instrumentet e nevojshme procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror të shtetasve, a e siguron më mirë këtë procedura civile apo duhet një ligj me elementë të plotë rregullatore sui generis dhe për çëshjet e provave e të të provuarit, a janë të nevojshme shtesa të ndryshme ligjore për të konfirmuar standardet ndërkombëtare.

Hipotezat e ngritura mbi çështje të natyrës së ligjit, standardit të provës, barrës së provës, të identifikuar në fillim të punimit, si ato mbi natyrën e ligjit tonë, janë shtjelluar gjerësisht dhe janë vërtetuar në të njëjtën mënyrë si është menduar që në fillim, duke i shoqëruar me gjetje konkrete duke evidentuar një disiplinë të tërë ligjore e procedurale mbi këto kërkime e duke i reflektuar në konkluzione të qarta në fund të çdo kreu dhe në pjesën e konkluzioneve përmbyllëse të punimit si dhe duke rekomanduar nevojat për ndryshime ligjore.

Autori

Nullum commodum capere potest de sua propria iniuria (Askush nuk mund të nxjerrë përfitim nga veprimi i tij kriminal)

“ Follow the money – Ndiq paranë “

Giovanni Falcone

KREU I

SEKUESTRIMI DHE KONFISKIMI SI INSTITUTE TË SË DREJTËS PENALE MATERIALE, PROCEDURALE E TË PROCEDIMIT PASUROR

Përmbajtja: 1.1 Hyrje - 1.2 Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprimtarisë kriminale si institute të së drejtës penale e asaj procedurale. - 1.3 Sekuestrimi dhe konfiskimi si procedim pasuror. - 1.4 Llojet e konfiskimeve si masë parandaluese pasurore. - 1.5 Krimi i organizuar, trafiket si burime të përfitimit të paligjshëm dhe nevoja për konfiskimin e të ardhurave nga kjo veprimtari kriminale. - 1.6 Vepra penale të tjera si burime të përfitimeve të paligjshme të pasurisë dhe nevoja për konfiskimin e të ardhurave prej saj. - 1.7. Çështje në vëmendje.

1.1. Hyrje

Veprimtaria kriminale sjell të ardhura në para, përfitime materiale, pasuri të luajtshme e të paluajtshme, si dhe produkte të tjera, prandaj dhe sekuestrimi e konfiskimi i tyre kanë rëndësi për përmbushjen e qëllimit final të luftës ndaj kriminalitetit. Një aksiomë e vjetër penalo – juridike, që në të vërtetë është një parim civilizues pohon - *Nullum commodum capere potest de sua propria iniuria* – që do të thotë se askush nuk mund të bëjë të vetat të ardhurat, përfitimet apo pasuritë e fituara në një rrugë kriminale. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së përfituar nga veprimtaria kriminale janë instrumente efikase në luftën kundër kriminalitetit e veçanërisht atij të organizuar, trafikeve, krimit ekonomik e korrupsionit. Përfitimi material nga veprimtaria kriminale lë

gjithmonë gjurmë e si e tillë duhet ndjekur. Giovanni Falcone² shprehej se *“Trafiku i drogës nuk lë pothuajse kurrë gjurmë, ndërsa paratë që sjell ky trafik lënë përherë gjurmë si tek shitësi, ashtu dhe tek blerësi”*³.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga veprimtaria kriminale e produkteve që burojnë nga vepra penale janë dy institute të hershme të së drejtës penale materiale e asaj procedurale penale. Legjislacionet penale materiale dhe ato procedurale njohin sekuestrimin si masë sigurimi preventiv dhe konservativ e konfiskimin si dënim plotësues. Vende të ndryshme kanë gjetur zgjidhje të ndryshme legjislative. Disa sisteme ligjore evropiane e më gjerë kanë parashikuar sekuestrimin dhe konfiskimin si institute penale ose civile në kodet respektive materiale penale dhe procedurale, por dhe në ato civile. Vende të tjera, me rregullime të veçanta ligjore, kanë parashikuar sekuestrimin dhe konfiskimin si masa parandalimi pasuror. Në mënyrë të veçantë, pas miratimit të Konventës së Këshillit të Evropës *“Mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”*⁴ konfiskimi i produkteve të veprës penale bëhet instrument i të drejtës penale ose civile si masë parandalimi pasuror, me anë të të cilit mundësohet ndarja e përfitimit financiar ose një sendi material me anë të një veprimi kriminal e të kundërligjshëm, duke vendosur parimin se askush nuk mund të përfitojë nga krimi. Qëllimi i tij, si instrument, është parandalimi dhe ndëshkimi, por dhe mbrojtja e interesave të palës së dëmtuar.

Motivi kryesor i krimit të organizuar është fitimi dhe sigurimi i të ardhurave e përfitimeve pasurore prandaj dhe veprimi efektiv për të parandaluar krimin e organizuar duhet të synojë gjurmimin, ngrirjen, konfiskimin e produkteve të kësaj veprimtarie kriminale. Masa parandaluese e konfiskimit pasuror në procedurën penale ose civile është një nga instrumentet më efikase, por në të njëjtën kohë dhe një nga institutet më të diskutueshme në raport me respektimin e parimeve të procesit të drejtë gjyqësor dhe së drejtës së pronës dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesave të të tretëve e palëve të tjera. Krimi i organizuar dhe trafiket janë veprimtaria kriminale që sjell më shumë të ardhura dhe produkte kriminale, nevoja e të cilave është për t'i futur në kanalet e

² Gjyqtar italian, i vrarë nga Cosa Nostra siçiliane më 23 maj 1993, gjyqtar hetues, që ka drejtuar procedimet kryesore ndaj Cosa Nostra, personalitet me kontribut të jashtëzakonshëm në luftën kundër mafias siçiliane, në krijimin e legjislacionit antimafia dhe atij për bashkëpunëtorët e drejtësisë, si dhe hetimin financiar të organizatave mafioze.

³ Marcelle Padovani, *Cose di Cosa Nostra*, faqe 16, Milano, Rizzoli, 1991

⁴, E ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8646 datë 20.07.2000 *“Për ratifikimin e “Konventës Evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”*

ekonomisë së tregut në formë investimesh, blerjesh e financimesh të aktiviteteve tregtare. Aktivitete të tjera kriminale si ai ekonomik, evazioni fiskal, kontrabanda, falsifikimi i produkteve të konsumit, korrupsioni etj, sjellin dhe ato të ardhura të konsiderueshme duke sjellë, në të njëjtën kohë, humbje të financave publike të shtetit.

Ky kre trajton në mënyrë të hollësishme sekuestrimin dhe konfiskim në procesin penal e atë pasuror duke u ndalur në mënyrë të veçantë në konfiskimin pasuror. Në këtë kre trajtohet një vështrim krahasues mes dy instituteve duke analizuar të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre, në veçanti, përparësitë që kanë sekuestrimi dhe konfiskimi, në kuadër të procedimit pasuror *in rem*.

Në këtë kre, kam hedhur hipotezën e identifikimit të një juridiksioni të veçantë mbi masat e parandalimit pasuror, mbi konfiskimin pasuror në veçanti.

Gjithashtu, janë trajtuar aktivitetet kriminale që sjellin të ardhura e pasuri që janë objekt i konfiskimit, duke patur parasysh se elementët financiarë, që janë përdorur si mjet reagimi ndaj krimit⁵, pasi qëllimi i ushtrimit të aktivitetit kriminal të organizuar e atij ekonomik është sigurimi i përfitimeve e nëse përfitimi nga veprimtaria kriminale nuk evidentohet dhe goditet nuk kemi ndërprerje të paligjshmërisë.

1.2. Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprimtarisë kriminale si institute të së drejtës penale e asaj procedurale.

Sekuestrimi dhe konfiskimi janë të hershëm dhe i përkasin traditës penale materiale e procedurale të të dy sistemeve kryesore të së drejtës atij kontinental të civil law⁶ e atij të common law.⁷ Sekuestrimi është një masë paraprake dhe provizore, ndërsa konfiskimi është një dënim plotësues

⁵ Vasilika Hysi, Penalogjia, botimi i parë, Tiranë 2006, faqe 35.

⁶ E drejta civile, *civil law*, është një sistem juridik me origjinë nga kontinenti i Evropës dhe i miratuar në pjesën më të madhe të botës, brenda kuadrit të së drejtës romake dhe me parime thelbësore të kodifikuara në një sistem të referueshëm, i cili shërben si burim parësor i së drejtës, është grupi i ideve dhe sistemeve juridike që rrjedhin përfundimisht nga Corpus Juris Civilis.

⁷ Sistemi i së drejtës zakonore, *common law*, i cili filloi në Anglinë mesjetare, që bazohet në jurisprudencën e pakodifikuar, precedentin gjyqësor e bërë nga gjyqtarët dhe u jep autoritet precedent vendimeve të mëparshme të gjykatës.

përfundimtar. Sekuestrimi i pasurisë është një masë sigurie që shërben si garanci pasurore kur personi akuzohet për kryerjen e një veprë penale.

Në legjislacionet procedurale, sekuestrimin e gjejmë të parashikuar si masë e përkohshme, ndërsa konfiskimi gjendet në disa sisteme ligjore si pjesë e së drejtës penale e në disa të tjera si pjesë e së drejtës procedurale. Sekuestrimi i pasurisë është një masë e përkohshme që ka për synim të parandalojë humbjen, zhdukjen, fshehjen, tjetërsimin e të ardhurave, pasurisë, produkteve të veprave penale, që mundësisht, më vonë, mund të konfiskohen.

Konfiskimi është humbja përfundimtare ose e përhershme e pasurisë më anë të vendimit të gjykatës. Si koncept, konfiskimi përfshin: përcaktimin subjektiv ndaj të cilit zbatohet, pasurinë që mund të konfiskohet, për kë veprim kriminal të dyshuar apo të provuar se është kryer mund të konfiskohet pasuria, standardin e provës dhe barrën, që duhet të përcaktojë nëse një pasuri justifikohet ligjërisht apo duhet të konfiskohet. Konfiskimi i produkteve të veprës penale është i njohur që në historitë e hershme të shtetit të së drejtës. Në Francë, legjislacioni, që pas rënies së monarkisë, parashikonte konfiskimin e produkteve të krimit, së bashku me dënimin e tij. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës konfiskimi gjeti zbatim në paradigmen e *“luftës kundër drogës”* në fillim të shekullit XX. Italia e zhvilloi më tej juridiksionin e masave parandaluese pasurore e personale në kuadër të legjislacionit të famshëm antimafia duke e imponuar si shembull i efikasitetit të legjislacionit të kësaj natyre.

Në kohërat e sotme, politikat kundër krimit janë orientuar, kryesisht, tek lufta me të gjitha mjetet e korrupsionit, krimit të organizuar, atij ekonomik, që si qëllim kanë gjithmonë përfitime, të ardhura e pasuri nëpërmjet kryerjes së këtyre formave të kriminalitetit. Qëllimi kryesor i përfshirjes së individit në kriminalitet e veçanërisht, atë të organizuar është sigurimi i përfitimeve në të mira materiale e avantazheve personale. Në rastin e krimit të organizuar, këto përfitime sigurojnë bazë për korrupsionin e zyrtarëve publikë, apo për investimin e këtyre të ardhurave në prona e aktivitete të tjera nëpërmjet pastrimit të parave, prandaj dhe konfiskimi i përfitimeve nga vepra penale është masa më e rëndësishme në fushën e parandalimit të kriminalizimit më tej të shoqërisë e vendosjes

së drejtësisë e autoritetit të ligjit. Vlerësimet e institucione si EUROPOL⁸ japin të dhëna se vetëm pak më shumë se një miliard Euro të ardhura arrijnë të konfiskohen në mënyrë të përhershme, ndërkohë që të ardhurat nga krimi variojnë në qindra miliardë Euro.

Konfiskimi ka disa arsye për të cilat zbatohet e ato janë: *së pari* është ajo restorative që lidhet me kthimin e asaj që është përfituar pa të drejtë, *së dyti* parandaluese në kriminalitet pasi duke i hequr pasurinë e përfituar pa të drejtë parandalon mundësinë e përfshirjes më tej në kriminalitet, motivimit për të vijuar më tej në kriminalitet. *Arsyeja e tretë* që ka të bëjë me parandalimin, por është ajo orientuese ndaj pronës, pasi pas konfiskimit prona nuk mund të përdoret më për ndonjë aktivitete kriminal, *arsyeja e katërt* është ajo kompensuese, si masë për ata që u është shkaktuar dëm nga vepra penale.

Ka disa qasje të legjislacioneve ndaj konfiskimit: *qasja e parë* është ajo, që e konsideron konfiskimin e produkteve të veprës penale si sanksion i të drejtës penale. Si i tillë, konfiskimi parashikohet në legjislacionin francez ku trajtohet veçmas nga dënimi me burg apo ai me gjobë dhe paraqitet në dy forma: *i përgjithshëm* kur zbatohet vetëm në rastin e kriminalitetit të rëndë (*trafikimi i narkotikëve, qenieve njerëzore*) dhe kur konfiskohet e gjithë pasuria e të pandehurit (*pavarësisht nëse ka të bëjë me veprën penale konkrete sipas fushës të së drejtës procedurale penale*) dhe i veçantë në rastet kur produktet kanë rrjedhur nga një vepër penale tjetër, e ndryshme nga vepra penale e përshkruar tek konfiskimi i përgjithshëm.

Qasja e dytë e konsideron konfiskimin e produkteve të veprave penale si pasojë juridike e dënimit, që do të thotë se zbatimi i tij është i lidhur me vendimin përfundimtar të gjykatës dhe hyn në fyqi ex lege. Qasja e katërt e konsideron konfiskimin e produkteve të krimit si lloje të veçantë të veprimit shtetëror të karakterit administrativ. Sistemi ligjor italian ka parashikuar herët që në vitet “ 50 – “70, masa të tilla preventive pasurore të konfiskimit. Kusht për zbatimin e masave preventive të konfiskimit është ekzistenca e dyshimit shtesë se përfitimi është krijuar me aktivitete kriminale dhe është në disproporcion me të ardhurat e ligjshme, aktivitetet ekonomike dhe pasurinë e konstatuar. Gjykatat Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në jurisprudencën e saj ka

⁸ Europol, Report 2016 -2017, <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-statistics/crime-areas/economic-crime/money-laundering>

konfirmuar në disa vendime të saj, natyrën administrative të masave të konfiskimit. Qasja e katërt e konsideron konfiskimin e produktit të veprës penale si masë e veçantë e veprës penale përkatësisht si reagim i detyrueshëm i shtetit ndaj veprës penale të veçuar nga sanksioni i veprave penale. Ky konfiskim ka natyrë restauruese dhe synon ta vendosë pronën në gjendjen fillestare para se të kryhej krimi.

Në të drejtën penale dhe procedurale franceze⁹ sekuestrimi i pasurisë gjatë hetimeve ka për qëllim ruajtjen e provave ndërsa konfiskimi si masë reale sigurie e dënim plotësues në rastet kur vërtetohet se pasuria/e ardhura është e dëmshme, është përdorur për kryerjen e një veprë penale ose nuk justifikohet.¹⁰ Kodi i Procedurës Penale Franceze u plotësua me dispozitat e reja me ndryshimet e viteve 2007–2010, duke riformuluar nenet 706 etj. të tij me dispozitat e reja mbi sekuestrimin e duke zgjeruar konceptin për konfiskimin, për t'u dhënë mundësi organeve të hetimit që të kryejnë gjurmimin e të ardhurave nga krimi, në një mënyrë më efikase, si dhe duke mirëregulluar administrimin e përkohshëm të tyre deri në konfiskimin përfundimtar dhe administrimin e tyre.¹¹

Në të drejtën procedurale penale italiane, sekuestrimi është masë sigurimi pasuror, ndërsa në të drejtën penale italiane¹² parashikohet konfiskimi në kuptimin e një mase sigurimi real të aseteve, me qëllim shpronësimit të sendeve, që kanë shërbyer për të kryer veprën penale, janë të destinuara për të kryer veprën penale apo përfaqësojnë produktin e fitimit/ vlerën e veprës penale.¹³ Për sendet, që kanë shërbyer ose ishin të destinuara për kryerjen e krimit, për sendet, që përfaqësojnë produktin ose fitimin, konfiskimi varet nga vlerësimi i gjyqtarit, për sendet e tjera, të përfutuara nga veprimtaria kriminale konfiskimi është i detyrueshëm. Për sendet, që i nënshtrohen konfiskimit të detyrueshëm supozohet rrezikshmëria, ndërsa për sendet që i nënshtrohen konfiskimit fakultativ gjykata duhet të konstatojë lidhjen e drejtpërdrejtë mes tyre dhe faktit kriminal për të vlerësuar rrezikun, që ekziston nga mbajtja e lirë e të njëjtit send.

⁹ Neni 21&131 i Kodit Penal francez dhe neni 56 i Kodit të Procedurës Penale Franceze, Code de Procedure Penale, Edition 2020, 44 edition, Dalloz.

¹⁰ C. Ducouloux – Favard et D.Gerin, “*La confiscation en droit penal français*”, Petites affiches 31 octobre 1982, .

¹¹ E.Camous, “*Les saisies en procedure penale, un regime juridique eparpille*”, Dr. pen. Fev. 2010, nr. 5.

¹² Neni 240 i Kodit Penal Italian, Codice Penale, T. Padovanni, TOMO 1 (articolo 1 – 411)

¹³ Enciklopedia del diritto, estratto, annali VII, Anna Maria Maugeri Confisca (Diritto Penale) Pubblicazione Giuffrè,

Konfiskimi synon parandalimin e kryerjes së krimeve të tjera nëpërmjet shpronësimit të sendeve, të ardhurave nga krimi, të cilat, në çdo rast, janë të lidhura ngushtë me posedimin e tyre, mbajnë gjallë idenë dhe atraktivitetin e krimit. Ndryshe nga masat e sigurisë, konfiskimi nuk merr parasysh rrezikshmërinë shoqërore të autorit të krimit dhe paraqet një urdhërim të parevokueshëm me efekt të menjëhershëm dhe të përhershëm. Në çdo rast, si produkt i krimit kuptohet sendi material që buron nga vetë krimi, si përfitim kriminal ose përfitim ekonomik që rrjedh nga vepra penale.

Konfiskimi penal përbën llojin tipik të konfiksimit, i cili kryqëzon konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe të produkteve të veprës penale me pozitën procedurale penale të personit të akuzuar/të pandehurit nëse ai është shpallur fajtor për akuzën. Sipas një studimi krahasues mbi sistemet ligjore parandaluese pasurore,¹⁴ në Mbretërinë e Bashkuar njihet një lloj sekuestrimi konservativ, që përdoret në funksion të konfiksimit të produkteve të veprës penale dhe ku konfiskimi përbën një detyrim të subjektit për t'i paguar një shumë të caktuar shtetit, detyrim, i cili është caktuar nga gjykata si një lloj përfitimi, që personi ka nxjerrë nga kryerja e veprës penale. Në këtë rast, ky lloj sekuestrimi konservativ garanton përmbushjen e detyrimit ndaj shtetit.

Konfiskimi, në të drejtën italiane, konsiderohet më shumë si një masë reale sigurie. Konfiskimi ka karakter parandalues dhe jo ndëshkues¹⁵, pasi zbatohet parimi i veprimit të ligjit në kohë. Kjo evokoi më vonë nevojën e parashikimit të konfiksimit parandalues si masë civile, e cila nuk e lidh fuqinë e këtij instituti me veprimin në kohë të ligjit. Në legjislacionin penal italian njihen konfiskimi konservativ dhe ai parandalues.¹⁶ Në të drejtën e vendeve europiane, në literaturë dhe në jurisprudencë, është diskutuar shumë për supozimin e rrezikshmërisë shoqërore të personit që ka kryer krimin, për qëllim të konfiksimit. Në një Vendim të Gjykatës së Lartë Italiane, Seksionet e Bashkuara kanë mbajtur qëndrimin se “...*historia e rrezikshmërisë shoqërore të subjektit, nuk lind nga një konsideratë e personalitetit të vetë personit, por më tepër, në lidhje me sendin objekt të konfiksimit, i cili mund të përfaqësojë një shtysë për kryerjen e krimeve të tjera*”¹⁷.

¹⁴ Reversal of the burden of proof in confiscation of the proceeds of crime: a Council of Europe Best Practice Survey, (Best Practice Survey No. 2), PC-S-CO (2000) 8 Rev Council of Europe, European Committee on Crime Problems, Strasbourg 25 May 2000.

Reversal of the burden of proof in confiscation of the proceeds of crime: a Council of Europe Best Practice Survey, (Best Practice Survey No. 2), PC-S-CO (2000) 8 Rev Council of Europe, European Committee on Crime Problems, Strasbourg 25 May 2000.

¹⁶ Nenet 316 dhe 321 të Kodit të Procedurës Penale Italiane.

¹⁷ Casazione Penale, Sez Unite, sentenza nr. 56 374 del 14 dicembre 2018.

Dallimin ndërmjet procesit penal dhe procesit të masave parandaluese dhe zbatimin e garancive të procesit penal në procedimin e masave parandaluese e vë në dukje edhe Gjykata Kushtetuese Italiane, kur shprehet për kushtetueshmërinë e ligjit italian të vitit 1956 për masat parandaluese ndaj pasurive të krimit të organizuar. Gjykata Kushtetuese Italiane,¹⁸ ka mbajtur këtë qëndrim: *“...në sistemin ligjor italian ka një dallim thelbësor ndërmjet dënimeve penale dhe masave parandaluese. Të parat, përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim; të dytat, janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë. Me fjalë të tjera, një dënim penal lidhet me një vepër penale të kryer, ndërsa masat parandaluese synojnë të reduktojnë rrezikun e veprave të ardhshme. Meqenëse sanksionet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo gjithë parimet kushtetuese, që qëndrojnë në themel të sistemit penal, zbatohen ndaj tjetrit. Për shembull, prezumimi i pafajësisë nuk lidhet me masat parandaluese, pasi ato nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose në fajin e personit”*.

Në të drejtën e vendeve kontinentale europiane vizioni tradicional i konfiskimit, i cili tentonte thjesht ta cilësonte atë si masë sigurie të një natyre reale, konfrontohej me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila ishte kundër konceptit tradicional të konfiskimit, të zhvilluar nga të drejtat e vendeve anëtare të Këshillit të Europës. Diskutimi për natyrën nëse është masë sigurie apo dënim real i ka rrënjët në të ashtuquajturën *“koncepti autonomist”* i sanksionit penal i zhvilluar nga GJEDNJ, e cila solli si pasojë rishikimin e një sërë legjislacionesh të vendeve të BE-së. Sipas të ashtuquajturit, *“kriteret Engel”*¹⁹, një sanksion, pavarësisht nga emërtesa, që i ka vendosur legjislatori kombëtar individual, ka një karakter thelbësisht penal kur nga vlerësimi i këtyre kriterëve, në thelb, shfaqet karakteri i fortë i tij. GJEDNJ thotë se këto kritere përfshijnë, në veçanti, cilësimin e bërë nga shtete përkatëse, natyrën kriminale të veprës penale, natyrën ndëshkuese dhe peshën e sanksionit të drejtëpërdrejtë për qëllime parandaluese dhe ndëshkuese, lidhjen me shkeljen penale²⁰. Një pjesë e legjislacioneve perëndimore kanë të parashikuara në Kodet e Procedurës Penale konfiskimin e përkohshëm, një koncept i ngjashëm me sekuestrimin. Diçka të tillë ka përvetësuar legjislacioni procedural penal i

¹⁸ Gjykata Kushtetuese Italiane, me vendimin nr. 27 të vitit 1959 dhe vendimin nr. 23 të vitit 1964

¹⁹ Vendimi i GJEDNJ, Engel dhe të tjerët kundër Holandës, 8 qershor 1976. Ky vendim është mund të gjendet në adresën www.hudoc.echr.coe.int

²⁰ Çështja Punta Peroti kundër Italisë, Vendimi i GJEDNJ 4936/2017.

Kosovës, që në nenin 267 të tij parashikon “*Konfiskimin e përkohshëm*”, i cili është një lloj konfiskimi paraprak penal deri në konfiskimin përfundimtar.²¹

E drejta jonë penale dhe ajo procedurale penale kanë përvetësuar të njëjtat koncepte tradicionale të së drejtës kontinentale vetëm me dallim se sekuestrimin e konsideron masë sigurimi, ndërsa konfiskimin lloj dënimi plotësues. Në Kodin e Procedurës Penale²² janë të parashikuara:

1. Sekuestrimi konservativ, në nenin 270 të KPrP, i cili parashikon se kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme të të pandehurit, të shumave e të sendeve, që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre. Ky lloj sekuestrimi nuk është një masë paraprake, që mund të përdoret për shpronësimin e produktit të veprës penale. Ajo vendoset ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshme të personit të dyshuar, që mund të mos jenë produkt i veprimtarisë penale, por shërbejnë për të garantuar përmbushjen e detyrimit të pagimit të dënimit me gjobë.
2. Sekuestrimi preventiv i parashikuar në nenin 274 të KPrP, sipas të cilit kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi, që lidhet me veprën penale mund të rëndojë, të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesë të prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij, me vendim të arsyetuar. Sekuestrimi mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe të çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP. Ky lloj sekuestrimi është masë sigurimi pasuror dhe ka si qëllim që të ndërpresë vijueshmërinë e pasojës kriminale e ta parandalojë atë si pasojë e zotërimit të lirë të sendit.
3. Sekuestrimi vërtetues/provues në nenin 208, 208/1, 208/a²³ të KPrP, sekuestrimi, që përdoret për qëllim të mjetit të kërkimit të provës, sipas së cilit gjyqtari dhe prokurori

²¹ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, E. Sahiti, R. Murati, Xh. Elshani,

²² Ligji nr. 7905 datë 21.03.1995, i ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 35/2017 datë 30.03.2017 dhe ligjin nr. 147/2020 datë 17.12.2020 dhe atë nr. 41/2021 datë 23.03.2021.

²³ Shtesa e nenit 208/a me ligjin nr. 10054 datë 28.12.2008 njohu si formë të sekuestrimit atë të të dhënave kompjuterike, në rastin e procedimeve për krime të rënda që lidhen me teknologjinë bëhet sekuestrimi i të dhënave kompjuterike si formë e sekuestrimit provues.

disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale, kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Qëllimi i këtij sekuestrimi është sigurimi i provave që do të shërbejnë për sigurimin e fakteve

Konfiskimi penal në legjislacionin tonë është parashikuar vetëm si institut material penal në Kodin Penal në nenet 30, pika 2 dhe 36 të tij. Në nenin 30 të KP²⁴ thuhet se për personat, që kanë kryer krime ose kundravajtje penale bashkë me dënimin kryesor mund t'ju jepen edhe dënime plotësuese, ndër të cilat konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale. Në nenin 36 të Kodit Penal është parashikuar konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale ²⁵ duke u përcaktuar se konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë më marrjen dhe kalimin në favor të shtetit të:

- a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;
- b) të produkteve të veprës penale ku përfshihet çdo lloj pasurie, dokument ose instrument ligjor që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë më pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryereja e veprës penale;
- c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara për kryerjen e veprës penale;
- d) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produktit të veprës penale;
- e) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë vepër penale, edhe kur është dhënë dënimi;
- f) nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht me pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit, i nënshtrohen konfiskimit. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë, në të cilat janë transformuar/shndërruar ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale.

²⁴Neni 30 i Kodit Penal të RSH "Dënime plotësuese"

²⁵Neni 36 i Kodit Penal, "Konfiskimi i mjeteve e të kryerjes së vepër penale dhe produkteve të veprës penale", i ndryshuar me ligjin nr. 9086 datë 19.06.2003.

Konfiskimi penal nuk vepron ndaj personave të tretë, kur pasuritë u përkasin atyre e në këtë mënyrë nuk mund të realizohet gjurmimi i pasurisë kriminale të fshehur në emër të të tretëve, aq më tepër kur pasuritë janë tjetërsuar apo u janë nënshtruar veprimeve simuluese të fshehjes. Gjithashtu, ky konfiskim varet nga procedimi penal nga pozita procedurale e vetë zotëruesit të pronës, duke u varur në këtë mënyrë nga veprimi në kohë i ligjit. Në këtë mënyrë, nuk mund të evidentojë akumulimin afatgjatë të pasurive të përfituara nga aktiviteti kriminal i krimit të organizuar e trafikeve.

1.3 Sekuestrimi dhe konfiskimi si procedim pasuror.

Për shkak të të metave që kishte konfiskimi penal dhe pamundësisë që t'u përgjigjej sfidave të luftës ndaj krimit të organizuar në vitet '80 të shek. XX lindi ideja e procedimit pasuror duke përdorur sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë dhe produkteve të veprës penale në një mënyrë tjetër nga konfiskimi penal. Procedimi pasuror është një procedim që nis ndaj pasurisë së dyshuar se është përfituar si produkt i veprës penale kryesisht në kuadër të krimit të organizuar, trafikeve, por dhe veprave penale të tjera të rënda.

Procedimi civil për sekuestrimin/konfiskimin konsiderohet një procedim gjyqësor *in rem* i cili vepron vetëm ndaj pasurisë (*i shkëputur dhe në mënyrë autonome nga procedimi penal*) përkundrejt procedimit penal kundër personit, i cili është procedim gjyqësor *in personam*.²⁶ Në këtë të fundit, sekuestrimi/konfiskimi janë veprime hetimore dhe rezultat i një vendimi të organit procedues mbi deklarinimin fajtor të personit për një vepër penale. Ky procedim gjyqësor, i cili është një procedim gjyqësor *sui generis*, do të zhvillohet duke marrë në çdo rast për bazë parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut.²⁷

Konfiskimi i produkteve të veprave penale është institut *sui generis*, që përdoret në rast të kryerjes së veprës penale, por me një pjesë të tij, lidhet me rregullat e së drejtës civile (*sekuestrim/ngrirje e pronës, procedurë përmbarimi/ekzekutim*). Prandaj dhe konfiskimi konsiderohet një insitut i

²⁶ Commentario breve al codice antimafia e alle procedure di prevenzione, Balato, Francesco, in Spangher, Giorgio, Marandolo, Antonella (*a cura di*) (Milano, 2019), fq 36

²⁷ Codice antimafia, Digesto delle Discipline penalistiche, ag VIII, Balsamo Antonio, 2018 (Torino, UTET),fq. 73

përzier penal-civil, qëllimi i të cilit është kthimi i situatës në gjendjen përpara kryerjes së veprës penale dhe ndalimi i pasurimit të paligjshëm me veprimtari kriminale.

Procedura e konstatimit të produkteve të veprës penale përfshin konstatimin e objektit dhe përmbajtjes së produkteve të veprës penale, ose ekuivalentit monetar. Në pjesën më të madhe të legjislacioneve kjo procedurë parashikohet si procedim *in rem*, por që zbatohet në kuadër të procedurës penale, kështu që duhet të respektohen parime, që zbatohen në procedurë penale. Kjo procedurë i bashkohet asaj penale, vetë konfiskimi zakonisht në këtë procedurë është i lidhur me dënimin e personit, të cilit i përket pasuria. Ekzistojnë sisteme ligjore, që njohin konfiskimin edhe kur nuk kemi një vendim dënimi. Një procedurë e tillë konfiskimi quhet *konfiskim objektiv* ose i pavarur për shkak se zhvillohet jashtë procesit penal (*qëllimi i të cilit është pikërisht konstatimi i ekzistencës së vepërës penale dhe i fajësisë së autorit*) një mundësi e tillë ekziston, për shembull, në Gjermani. Në të drejtën gjermane, procedura e konfiskimit objektiv, mund të realizohet, në qoftë se ekzistojnë arsye të natyrës reale, të tilla si pamundësia e kapjes për shkak të arratisjes dhe pamundësia e identifikimit të autorit, ose rasti i shpalljes së pafajësisë, si rezultat i së cilës personi lirohet nga dënimi, apo të shtyrjes së ndjekjes penale.

Procedurë e veçantë konsiderohet edhe ajo, në të cilën përfshihet prona e autorit dhe e personave të tjerë, në qoftë se ekziston dyshimi i përfitimeve nga aktivitetet kriminale. Ky lloj konfiskimi quhet *konfiskim i zgjeruar i produkteve të veprës penale*, ku përfshihen jo vetëm asetet nga vepra penale, për të cilën po zhvillohet çështja penale konkrete por çdo produkt tjetër, që supozohet se është nxjerrë nga e njëjta vepër penale ose nga vepra të tjera, që i kanë paraprirë asaj, ose që përkojnë me të.

Kushti themelor për konfiskimin e zgjeruar është: 1. dyshimi ose dënimi për kryerjen e një vepre penale të krimit të organizuar; 2. Rrethanat, që dëshmojnë mundësinë e prejardhjes së pronës tjetër të autorit nga vepra penale të parëcaktuara; 3. pamundësinë e të dyshuarit/të akuzuarit/ të dënuarit, subjektit apo poseduesit të pronës për të justifikuar prejardhjen e ligjshme të pronës. Konfiskimi i zgjeruar i përkufizuar në mënyrë të tillë, zakonisht, konsiderohet si dytësor ndaj konfiskimit të zakonshëm të dhënë. Kur prokurori dyshon për një ose më shumë vepra penale, të kryera nga subjekti, ai mund të pretendojë se produktet kanë ardhur nga këto vepra, ndërkohë që një nga karakteristikat e konfiskimit të zgjeruar është se organet hetimore i përqëndrojnë hetimet te

produktet e veprave penale të papërcaktuara. Vetëm pasi të jenë konsumuar mjetet ligjore dhe provat për konfiskimin e zakonshëm, merret në konsideratë aplikimi i konfiskimit të zgjeruar. Këto modele rregullohen nga legjislacioni procedural penal.

Ndërkohë, ekziston edhe qasja e të drejtës civile për konfiskimin. Sipas këtij modeli “*subjekti*”, në këtë rast, është prona, bazuar në faktin se ka rrjedhur nga aktiviteti kriminal, ndërsa poseduesi ose pronari i saj duhet të arsyetojë nëse prona është krijuar në mënyrë të paligjshme. Ky model nuk bazohet tek faji i autorit të veprës penale, por tek prejardhje e pronës. Ky model tipik është në Mbretërinë e Bashkuar. Atje konfiskimi mbi bazën e të drejtës civile është i ndërruar nga procesi penal dhe është e nevojshme që policia të paraqesë prova të mëtijshme. Kur nuk ka prova të mjaftueshme për të filluar dhe vazhduar procesin penal, nuk ka interes publik për të vijuar me këtë procesin, por ekzistojnë vështirësitë procedurale, që pamundësojnë veprimet e tjera penale (*autori nuk gjendet e nuk paraqitet, ka vdekur*). Megjithatë, duhet të bëhet fjalë për përfitim të konsiderueshëm (*mbi 10 000 GBP*) si dhe për dyshim të arsyeshëm se përfitimi ka ardhur si rezultat i kryerjes së veprës penale ose si shpërblim për veprën në një periudhë prej 12 vitesh nga fillimi i procesit. Kërkesat për dëmshpërblim depozitohen në Gjykatën e Lartë, ndërsa aplikohen standardet e provave sipas të drejtës civile.²⁸

Sekuestrimi, në shumë legjislacione, konsiderohet konfiskimi i përkohshëm dhe masat e sekuestrimit i nënshtrohen rregullave civile.

Konfiskimi parandalues ka disa karakteristika që e dallojnë nga konfiskimi penal, si për shembull:

1. Është masë parandaluese dhe jo dënim shtesë ose plotësues si konfiskimi penal që zhvillohet *in rem* ndaj pasurisë së dyshuar si të përfituar nga veprimtaria kriminale;
2. Nuk mbështetet në pozitën penale të personit ose në dënimin e tij dhe është i pavarur nga procedimi penal;
3. Shtrihet pa kufizim ndaj gjithë pasurisë së personit, ndaj asaj të familjarëve të tij dhe ndaj personave të tretë, që kanë lidhje me personin si subjekt i ligjit;

²⁸ Doracak mbi kthimin efektiv të aseteve në përputhje me standardet evropiane, Regional Anti-Corruption Initiative, The AIRE Centre, 2019, faqe 11.

4. Mbështetet kryesisht në rregullat civile të të provuarit/në raste të veçanta si në ligjin tonë në rregulla të procedurës penale;
5. Ndryshon barra e provës, duke ngarkuar personin, që duhet të justifikojë pasurinë si të ligjshme;
6. Ka fuqi prapavepruese;
7. Lejohet procedimi në mungesë të personit.

Objekt i sekuestrimit dhe konfiskimit pasuror janë “fruter” e aktiviteteve të paligjshme, të dyshuara se janë siguruar drejtpërdrejtë nga veprimtaria kriminale.²⁹ Të ardhurat nga krimi nënkuptohen ato të përcaktuara në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar. Një përkufizim më të gjerë ka dhënë më tej te Konventa e Strasburgut e vitit 1990 duke konsideruar çdo avantazh nga vepra penale. Një Direktivë e vitit 2014 e BE-së, të cilën do ta trajtojmë më poshtë klasifikon si të tilla edhe dokumentet apo instrumentet ligjore që dëshmojnë të drejtën mbi këtë pasuri apo interesin, duke përfshirë dhe investimet, transformimet pasuese të produkteve të drejtpërdrejta nga një person i dyshuar apo i akuzuar si dhe çfarëdo përfitimi të vlefshëm. GJEDNJ, në praktikën e saj³⁰, ka mbajtur qëndrimin se me pasuri nuk duhen kuptuar vetëm mallrat fizike por përfshihen dhe pasuritë e prekshme të patundshme dhe të tundshme, mallrat ndërtesat, tokat, pasuritë e paprekshme (*fondet monetare, aksionet, prona intelektuale, pensionet, të drejtat e sigurimit shoqëror*), pretendimet ligjore (vendimet e gjykatave, borxhet, huatë, kreditë). Po kështu, nisur nga natyra, qëllimi dhe objekti i ndryshëm i hetimit dhe gjykimit, krahasuar me procedimin penal, në gjykimin parandalues nuk gjen zbatim parimi i mos-rëndimit të pozitës së personit (*të dyshuar apo të tretë*).

Kryesisht, rregullimi me ligj të veçantë i sekuestrimit e konfiskimit si masa parandaluese pasurore synon zbatimin e masave të natyrës parandaluese e goditëse, që drejtohen ndaj pasurisë së pajustificuar ligjërisht të një kategorie të posaçme të personave shoqërisht të rrezikshëm, për shkak të pjesëmarrjes në veprimtari kriminale, të njohura edhe për konvencion si fenomene të krimit të organizuar. Masat parandaluese pasurore, në parim, mund t’i gjejmë pasi ka filluar një procedim penal, pas përfundimit të tij, ose edhe pa pasur procedim penal. Zbatimi i tyre është i lidhur me

²⁹ Le misure patrimoniali contro la criminalità organizzata, Cfr. Bolsano A. Contrafato V, Nicastro G, 2008, fq 95

³⁰ GJEDNJ, çështja Bosphorus Airways kundër Irlandës, Vendimi nr. 12137 i datës 30 qershor 2005

ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme, pra të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen nga personi i dyshuar të njëres prej veprave penale të parashikuara në fushën e veprimit të këtyre ligjeve, apo edhe me vërtetimin e fajësisë së tij për kryerjen e këtyre veprave penale. Pra, këto masa zbatohen ndaj pasurisë së një personi të dyshuar, i cili, si rregull, i është nënshtruar ose i nënshtrohet hetimit ose gjykimit për kryerjen e këtyre veprave penale ose ka të dhëna të arsyeshme se pasurinë e ka fituar me veprimtari kriminale. Madje, në këto raste, kur ka të dhëna të bazuara për kryerjen e një veprimtarie kriminale, si krim i organizuar ose trafikim, masat parandaluese pasurore gjejnë zbatim jo vetëm ndaj personit të dyshuar, por edhe ndaj familjarëve, të afërmeve e personave të tjerë të tretë të lidhur me të, sipas kritereve dhe kushteve të caktuara në këtë ligj të posaçëm.

Meqenëse masat parandaluese pasurore janë të lidhura me dyshimin për kryerjen nga personi të një veprë penale, me dyshimin dhe prezumimin për zotërimin dhe prejardhjen e paligjshme të pasurisë si pasojë ose e lidhur me këtë veprimtari kriminale, si dhe me ekzistencën e një procedimi penal, me ecurinë dhe përfundimet e tij, atëherë edhe në procedimin parandalues hetimi dhe gjykimi i çështjes së masave parandaluese pasurore mund të jetë në kompetencë e gjykatës penale. Kjo është përcaktuar në legjislacionin përkatës.³¹ Gjykimi parandalues nuk kushtëzohet nga parimet dhe rregullat e shqyrtimit të kërkesave të palëve gjatë hetimeve paraprake, sepse gjykimi parandalues është një procedim autonom, nuk është pjesë e ushtrimit të ndjekjes penale, pra nuk është as fazë hetimesh paraprake e procedimit penal; procedimi parandalues është i pavarur edhe në raport me procedimin civil e atë administrativ, pasi synon vetëm zbatimin e masave parandaluese pasurore ndaj personave të dyshuar për kryerjen e një kategorie të caktuar veprash penale. Në këtë kuptim, procedimi parandalues mund të shoqërojë procedimin penal, pavarësisht se në cilën fazë ndodhet ky i fundit, apo nëse ka përfunduar.³²

Procedimi parandalues është autonom në raport me procedimin penal (*dhe atë civil*). Procedimi preventiv mund të fillojë, vazhdojë e përfundojë, si gjatë, ashtu edhe pas përfundimit të një procedimi penal. Nga ana tjetër, duke qenë procedime autonome ato nuk janë procedime të tilla,

³¹Ligji 70 / 2017 datë 27.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” është miratuar më 24.07.2017 dhe ka hyrë në fuqi më 22.05.2017.

³²A. Mangione Le misure di prevenzione personali e patrimoniali. La confisca allargata. Aspetti sostanziali e processuali, Milano 2019, fq 110.

që përjashtojnë fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e njëra tjetrës, përse kohë pretendohet a vërtetohet se ka një person të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, ndaj të cilit është duke u zhvilluar ose ka përfunduar një procedim penal. Në procedimin parandalues mjafton të vërtetohet dyshimi i arsyeshëm për qënien si “*person i dyshuar*”, mundësia e zotërimit të pasurive prej tij dhe mos justifikimi i prejardhjes së ligjshme të këtyre pasurive, në raport me veprimtarinë, sjelljen, të ardhurat dhe mënyrën e jetesës, me kohën dhe llojin e veprës që i atribuohet, apo vërtetohet se ka kryer personi i dyshuar. Në gjykimin dhe dhënien e vendimit për vendosjen e masave pasurore, gjykata nuk mund t’i hyjë bazueshmërisë së përfundimeve, që janë arritur në procedimin penal lidhur me ato elemente, që, në fakt, justifikojnë vendosjen e masës preventive pasurore, veçanërisht përse i përket kualifikimit të personit si “*person i dyshuar*”.

Në zbatim të normave materiale e procedurale penale, gjykata, që shqyrton një çështje penale, me dhënien e vendimit të dënimit dhe, kur janë rrethanat, edhe në rast të një vendimi për pushimin e çështjes apo të pafajësisë, mund të urdhëroje konfiskimin e pasurive. Masa e konfiskimit jepet nëse vërtetohet se ka një lidhje shkakësore, logjike e kronologjike, ndërmjet pasurisë që konfiskohet dhe veprës penale të kryer. Ndryshe nga standartet e të provuarit dhe përgjegjësisë në dhënien e një vendimi penal, përfshirë urdhërimin për konfiskimin ose jo të sendeve të sekuestruara, në procedimin parandalues, vendosja e masës pasurore ka në themel të saj mundësinë, dyshimin e arsyeshëm, të mbështetur në të dhëna të mjaftueshme që rezultojnë nga tërësia e provave të marra dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Për shkak e pasojë të kryerjes së një veprimtarie kriminale (*vepre penale*), e cila i atribuohet apo është vërtetuar kundrejt personit të dyshuar, kemi të bëjmë me pasuri të cilat lidhen apo janë produkt i veprimtarisë kriminale, a përbëjnë përdorimin e tyre, të zotëruara direkt apo indirekt nga personi i dyshuar, të cilat formalisht, fiktivisht mund të mbahen edhe nga persona të tjerët fituara në mënyrë të paligjshme, pra që nuk justifikohen ligjërisht dhe që janë në shpërpjestim vlere me veprimtarinë e mundësitë ekonomike, me të ardhurat e deklaruara për qëllime fiskale etj., nga ana e këtyre personave. Pra, në ndryshim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshime të arsyeshme, të mjaftueshme e prezumime, duke iu ngarkuar personit të dyshuar dhe personave të tjere barra e provës për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë.

Në procedimin parandalues nuk ka vend për vërtetimin domosdoshmërisht nga prokurori e gjykata të lidhjes shkakësore, të drejtpërdrejtë, të dukshme e imediate, logjike e kronologjike, ndërmjet pasurisë, prejardhjes së saj dhe veprës penale, për të cilën, së paku, ekziston dyshimi i arsyeshëm si e kryer nga personi i dyshuar.

Këto dy instrumente, por konfiskimi në veçanti, ndërhyjnë në të drejtat themelore të njeriut. Kjo lidhet me natyrën e konfiskimit, nëse ai trajtohet si masë sigurie, sanksion “*sui generis*”, apo masë dënimi.³³ Pra, natyra e sekuestrimit, dhe e konfiskimit në procedimin pasuror gjykimi i tyre ka të përbashkëta me procedimin e gjykimin penal dhe dallime thelbësore që i bëjnë këto institute të veçanta e me rëndësi për studimin e tyre teorik.

1.4. Llojet e konfiskimeve si masë parandaluese pasurore.

Konfiskimet, si masë parandaluese pasurore, janë të llojeve të ndryshme dhe u përkasin sistemeve të ndryshme ligjore, kryesisht të reja. Sistemet ligjore të ndryshme kombëtare riprodhojnë metoda të ndryshme të konfiskimit, të cilat mund të klasifikohen në katër kategori:

- “*Konfiskimi i përgjithshëm i aseteve*” është një lloj konfiskimi, që prek ata individë, të cilët janë shpallur fajtorë në një çështje penale, pavarësisht nga origjina e pasurive kriminale, të cilat duhet të konfiskohen; megjithatë, ky model paraqet probleme të pakapërcyeshme për sa u takon prezumimit të pafajësisë dhe parimit të proporcionalitetit.
- *Konfiskimi i aseteve me destinacion të paligjshëm* është lloji i konfiskimit që prek ato asete, të cilat zotërohen nga persona, që janë pjesë e organizatës kriminale dhe supozohet se përdoren për të financuar veprimtari të paligjshme për qëllime të paligjshme të organizatës;
- Konfiskimi penal “*i zgjeruar*”, i aseteve të dyshuara me origjinë të paligjshme, është modeli më i përhapur në Evropë dhe bazohet në prezumimin e origjinës së paligjshme të aseteve të personave të dënuar për disa lloj veprash penale, tipikisht të lidhura me përfitimin e paligjshëm, si për shembull, korrupsioni ose pjesëmarrja në organizata të llojit

³³ Le confische e sequestri in materia di reati tributari. Për më shumë shih: Gianluca Varraso, Diritto Penale Contemporaneo, viti, fq 25.

mafioz.³⁴ Presumimi i origjinës së paligjshme sipas këtij rregulli i referohet të gjitha asetëve të personit të dënuar, por mbetet subjekt i plotësimi të barrës së provës, ndonëse të reduktuar, nga ana e prokurorit, i cili duhet të provojë mospërputhjen ndërmjet akumulimit të kapitalit të të pandehurit dhe të ardhurave të tij, të deklaruara për qëllimet e tatimeve ose veprimtarisë së tij të ligjshme ekonomike.

- Konfiskimi i zgjatur, lloj konfiskimi i sugjeruar nga Direktiva e Parlamentit Europian të vitit 2014³⁵, i cili përfshin konfiskimin vetëm për një kategori veprash të caktuara, si ato, të cilat lidhen me konceptin “krime të rënda” dhe për të cilat parashikohet një dënim deri në 4 vjet burgim.
- Konfiskimi ndaj personave të tretë, i cili mundëson konfiksimin e të ardhurave ose pasurive të transferuara në emër të personave të tretë nga autorët e veprave penale kriminale të krimit të organizuar, trafikeve ose krime të tjera të rënda e ekonomike.

Në vende të tjera, ka dispozita ligjore, që e kufizojnë prezumimin për asetet e fituara brenda një periudhe kohore specifike, që lidhet me kryerjen e veprës penale, ose që përcaktojnë një kthim të vërtetë të barrës së provës.

- *Konfiskimi i pabazuar në dënim (ose konfiskimi in-rem)*: gjen zbatim pas një procesi gjyqësor për asetet dhe nuk ka nevojë për pasjen e një dënimi si parakusht. Lloji i këtij modeli përfaqësohet nga konfiskimi civil, i cili është shumë i përdorur në vendet e *common law* (MB, SHBA, Australia, Irlanda etj.). Disa sisteme ligjore evropiane përfshirë atë italian, vitet e fundit i janë përshtatur kësaj forme konfiskimi.
- *Konfiskimi, i cili nuk varet nga dënimi penal (in rem)* është një lloj konfiskimi, i cili nuk varet nga procedimi penal ose dënimi i personit, ky lloj konfiskimi është parashikuar në legjislacione të tilla si ai italian ose shqiptar, në të cilat konfiskimi bëhet pavarësisht procedimit penal, por bazuar në dyshimet se personi pasurinë e ka fituar në aktivitete

³⁴ Në sistemin ligjor italian, ky lloj konfiskimi parashikohet nga Neni 12-sexies i dekretit të 8 qershorit 1992, nr. 306, konvertuar në Ligjin e 7 gushtit 1992, no. 356; Codice delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione, a cura di Vincenzo Giglio, consultabile al link: <https://www.filodiritto.com/codici/codice-delle-leggi-antimafia-e-delle-misure-di-prevenzione>

³⁵ Neni 5. Për më shumë shih: Directive 2014/42/EU of the European Parliament and of the Council, of 3 April 2014, “On the freezing and confiscation of instrumentalities and proceeds of crime in the European Union”, doc. The European Parliament and the Council of the European Union. Direktiva është e disponueshme në adresën: <https://eur-lex.europa.eu/legal>. Vizituar për herë të fundit më datë 20.01.2021.

kriminale. Ky lloj konfiskimi njihet në shumicën e vendeve të BE-së si: Hollandë, Çeki, Kroaci, Sllovaki, Hungari, Poloni, Finlandë etj³⁶, por vetëm në rastet kur procedimi penal ndaj subjektit nuk ka filluar për shkak të sëmundjes, parashkrimit të ndjekjes penale, ose të pezullimit të procesit të hetimit të tij në mungesë për shkak se nuk gjendet ose ka ikur.

- *Konfiskimi i bazuar në dënim*, konfiskim, që bazohet në një dënim penal të dhënë ndaj një personi, i cili si rezultat i veprës penale, për të cilën është dënuar, ka akumuluar edhe pasuri. Njihet në disa legjislacione si ai francez, gjerman etj. Në literaturë konsiderohet si ‘*Konfiskimi penal*’ gjen zbatim në procedimet *in personam*. Ai varet nga dënimi dhe vendoset nga një gjykatë penale.
- “*Konfiskimi civil*” gjen zbatim pas procedimit *in rem* që ka lidhje me asetet. Konfiskimi civil nuk ka nevojë për dënimin si kusht i domosdoshëm dhe mund të jepet si nga një gjykatë civile, ashtu edhe nga autoritetet ligjzbatuese.³⁷
- ‘*Konfiskimi civil*’, i cili në Shtetet e Bashkuara përfaqëson një prej instrumenteve më të rëndësishme të ndërhyrjes tek financat e organizatave kriminale, është subjekt i rregullave për provat dhe procedurave që janë të ndryshme prej atyre në çështjet penale. *Actio in rem* është autonom dhe kundër asetëve të njollosura nga krimi, kurse faji i pronarit është i parëndësishëm; konfigurimi special i kësaj mase lejon barrën e provës, nëpërmjet përdorimit të nocioneve të shkakut të mundshëm (*d.m.th., një probabiliteti të drejtë për të menduar se asetet janë blerë me fitime të paligjshme, të mbështetur nga provat, që, megjithëse nuk e arrijnë nivelin e provimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, janë më tepër se sa thjesht dyshim*) si edhe mbizotërimit të provave (*barra tipike e gjyqit civil, i cili privilegjon provën që mbizotëron me një shkallë më të lartë gjase dhe besueshmërie se sa hipoteza e kundërt*).³⁸

Në Shtetet e Bashkuara, me Ligjin për Reformën e Konfiskimit të Aseteve Civile të vitit 2000, u synua që të kufizohej fusha e veprimtimit të konfiskimit civil, duke vendosur mbi prokurorinë barrën

³⁶Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray: Stolen Asset Recovery, A Good practices Guide for Non – Conviction Based Asset Forfeiture, vep.e cituar, fq. 52

³⁷ Stefano Finocchiaro: “La confisca “civile” dei proventi da reato misura di prevenzione e civil forfeiture: verso un modello di non conviction based confiscation Criminal justice Network Progetto Giustizia Penale Lavoro concluso nel mese di luglio 2018, Milano, fq. 73

³⁸ Sandër Simoni, “*Konfiskimi i produkteve të veprës penale si masë parandaluese pasurore*”, Botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, përmbledhje e punimeve të Konferencës Shkencore Kombëtare “*Krimet Financiare, Pastrimi i Parave dhe Siguria Kombëtare*”, shkurt 2021, faqe 416

për të treguar ekzistencën e një “*lidhjeje thelbësore ndërmjet asetit dhe veprës*”. Arsyeja kryesore që preferohen procedimet civile ndaj procedimeve penale është barra më e ulët e provës. Nga ana tjetër, një model i tillë ka disavantazhin e moslejimit të autoriteteve për përdorimin e atyre mjeteve të hetimit, që janë tipike për gjykimin e çështjes penale (*duke iu referuar sidomos mundësisë për të kryer format e përgjimit elektronik: mbi të gjitha, përgjimet telefonike*)³⁹. Modeli i sipërpërmendur është baza e Ligjit për Fitimet nga Krimi i vitit 2002 (POCA)⁴⁰ i cili trajton që të dy urdhrat e konfiskimit kundër personave të dënuar si edhe masat (*rikuperimi civil dhe konfiskimi i kartëmonedhave*), që lejojnë konfiskimin e fitimeve të krimit pa patur nevojën e një dënimi penal.

Kthimi civil është një formë konfiskimi asetesh i pabazuar në dënim, që lejon kthimin në procedim civil para gjykatës së lartë të pronave, të cilat janë fituar nëpërmjet veprimtarive të paligjshme. Padia është kundër vetë pronës (*in rem*) dhe jo kundër individit (*in personam*). Rrjedhimisht, personi, që është zotërues i aseteve, që janë subjekt i urdhrit mund të mos jetë personi i cili ka kryer veprimtaritë e paligjshme. Këto procedime janë procese civile, ku gjen zbatim standardi civil i provës. Nuk është e nevojshme që të provohet kryerja e një vepre penale specifike nga një person i veçantë. Procedura thjeshtohet kur asetet që fitohen direkt nëpërmjet sjelljes së paligjshme apo që synohet të përdoren për të kryer një krim, janë kartëmonedha (*përfshirë çeqet, obligacionet etj*). Konfiskimi i kartëmonedhave është një procedurë e përshpejtuar për konfiskimin pa dënim, që përdoret nga magjistratet për marrjen e parave.

Procedimet parandaluese nuk përfshihen në fushën e veprimit të dispozitave të tjera të legjislacionit material, lidhur specifikisht me procedimet penale dhe përmbajnë garanci, që i tejkalojnë të drejtat e Konventës dhe rregullat e procedurës që janë tipike për pjesën më të madhe të sistemeve ligjore: p.sh, pamundësia për të përdorur deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve si prova thelbësore edhe nëse ato shihen imtësisht nga avokati mbrojtës gjatë gjyqit. Përveç kësaj, prezumimi i pafajësisë,

³⁹Stolen Asset Recovery, A Good practices Guide for non – Conviction Based asset Forfeiture, Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray, Stolen Asset Recovery (STAR) Initiative 2009, The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank, fq.36

⁴⁰The *Proceeds of Crime Act 2002* (c.29) (POCA) is an Act of the Parliament of the United Kingdom which provides for the confiscation or civil recovery of the proceeds from crime and contains the principal money laundering legislation in the UK. Ligjit për Fitimet nga Krimi i vitit 2002 (POCA). Ky akt mund të shihet në adresën: <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2002/29/contents> Faqja është vizituar për herë të fundit më datë 15. 05.2021.

i mishëruar në paragrafin e 2 të nenit 6 të KEDNj-së nuk gjen zbatim për procedimet parandaluese. Modeli, që ka zgjedhur ligjvënësi shqiptar, ashtu sikurse dhe disa vende të së drejtës kontinentale, krahasuar me procedimet civile për konfiskimin, të cilat janë tipike të sistemeve *common-law*, ka avantazhin e rëndësishëm të mundësisë për të përdorur disa instrumente, që janë në dizpozicion të hetimeve në procesin penal.

Ky model karakterizohet, gjithashtu, nga një standard i lartë prove, i cili kërkon një demonstrim rigoroz të origjinës së paligjshme të aseteve (*të cilat rrjedhin prej veprimeve të paligjshme apo të jenë të investuara në ndërmarrje apo pasuri të paluajtshme*) ose të përputhjes ndërmjet aseteve të akumuluar dhe të ardhurave të ligjshme. Në këto procedime, mbledhja e provave bëhet në mënyrë të thellë dhe bazohet në përdorimin e teknologjisë së informacionit, në përdorimin e ndërthurur të analizës së provave plotësuese dhe hetimeve financiare, si dhe në një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteve gjyqsore dhe institucioneve të tjera, si p.sh bankat.⁴¹

Në sistemin juridik të vendeve anglo-saksone, ashtu si dhe në sistemet e së drejtës kontinentale, personi, i cili zotëron pasuritë, që janë objekt i një urdhëri konfiskimi, mund të jetë personi, i cili mund të ketë kryer një veprim të paligjshëm. Një kusht thelbësor për aplikimin e masave parandaluese kundër pasurisë, është që pasuria, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, duhet të posedohet nga personi i dyshuar. Një rregull i tillë mundëson konfiskimin e pasurive në të gjitha rastet e një bashkëpronësie, formë, e cila karakterizon mënyrën e veprimit të organizatave të tipit mafioz. Në këtë mënyrë, bëhet e mundur neutralizimi i efekteve të fshehjes së modeleve moderne të ndërthurjes së interesave ligjore dhe nënligjore të kompanive, të tilla si model i kompanive aksionere në mashtrim, që përfshin kompanitë e krijuara me ligj, por që kanë krijuar një ortakëri me një grup kriminal.⁴²

Konfiskimi parandalues mund të shikohet në këndvështrimin e dënimit. Ai tejkalon logjikën penale; synon të ndajë përgjegjësinë penale individuale, ta lërë atë mënjane, si dhe të neutralizojë

⁴¹The Use of Non-Conviction Based Seizure and Confiscation, funded by the European Union and the Council of Europe, Council of Europe 2020, <https://rm.coe.int/the-use-of-non-conviction-based-seizure-and-confiscation-2020/>

⁴²“La confisca “civile” dei proventi da reato misura di prevenzione e civil forfeiture: verso un modello di non conviction based confiscation Criminal Justice Network - Stefano Finocchiaro - Progetto Giustizia Penale Lavoro concluso nel mese di luglio 2018, Milano.

një formë të posaçme *in-rem*, synon depërtimin kriminal të ekonomisë dhe të institucioneve financiare. Në shumë aspekte, mund të krahasohet me të ashtuquajturën *actions in -rem*, konfiskimin civil dhe instrumenteve të tjerë të vendeve anglo-saksone.⁴³ Konfiskimi i pasurisë nëpërmjet masave parandaluese *in rem* në vende të ndryshme ndjek një rregullim të ndryshëm në raport me procesin e të provuarit dhe barrën e provës. Në shumicën e vendeve ku zbatohet ky lloje konfiskimi është adaptuar devijimi i barrës së provës duke ia ngarkuar atë personit zotërues të pasurisë.

Në disa vende të tjera nuk lejohet përmbysja e barrës së provës, pasi ajo, si parim, bie ndesh me principet kushtetuese, por lejohen prezumimet. Ligjet u japin mundësi autoriteteve gjyqsore që të krijojnë bindjen, duke pasur parasysh vetëm indiciet rreth prejardhjes së paligjshme të aseteve. Prandaj është barrë e procesit të hetimit, që të kundërshtojë indiciet e përfituara, barrë, që duhet të shlyhet në mënyrë serioze, në atë mënyrë që t'i lejojë gjykatësit të bëjnë verifikimet e mundshme e të duhura në lidhje me ekzistencën e elementeve dyshues mbi prejardhjen e ligjshmërisë së pasurisë. Pra, në këtë rast, kemi ulje të nivelit të të provuarit në rastin e kërkesave për konfiskim. Në vendet e Bashkimit Europian⁴⁴ vende të ndryshme ndjekin regjime të ndryshe në lidhje me konfiskimin, procedurën, barrën e provës etj.

Dallimi mes konfiskimit penal dhe konfiskimit që nuk bazohet në një vendim dënimi.

Konfiskimi i zakonshëm që bazohet në dënim është njëri prej elementëve më themelorë të konfiskimit së bashku me konfiskimin bazë të vlerës dhe konfiskimin e mjeteve. Konfiskimi i zakonshëm është konfiskimi i produkteve ose i përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga vepra penale për një person, i cili është dënuar me vendim të formës së prerë. Konfiskimi, pa patur një vendim dënimi është aplikimi i konfiskimit kur ndaj pronarit të pasurisë nuk ka një vendim dënimi pasi nuk gjenden prova për fajësinë, është pushuar çështja, personi nuk gjendet ose është ndarë nga jeta. Kjo është njohur nga një sërë sistemesh ligjore dhe nga e drejta ndërkombëtare, por si

⁴³Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray: Stolen Asset Recovery, A Good practices Guide for Non – Conviction Based asset Forfeiture.

⁴⁴ The Use of Non –Conviction Based Seizure and Confiscation, funded by the European Union and the Council of Europe, Council of Europe 2020, <https://rm.coe.int/the-use-of-non-conviction-based-seizure-and-confiscation-2020/>

standard ndërkombëtar nuk ka një qasje të prerë ndaj këtij lloj konfiskimi pasi është një çështje shumë delikate.

Dallimi mes të dy konfiskimeve është së konfiskimi penal kërkon dhënien e një dënimi penal ndërsa ai që nuk bazohet në një dënim nuk kërkon patjetër të ketë një vendim penal.⁴⁵ Ka një sërë dallimesh procedurale, që bëjnë diferencën mes dy sistemeve. Konfiskimi penal *in personam* shoqëron dënimin penal. Standardet e provës mes të dy llojeve ndryshojnë; disa juridiksione zbatojnë një standard më të ulët të provës gjatë konfiskimit pa dënim.⁴⁶ Rregullat e aplikueshme të provave dhe procedurat, mbi të cilat ato merren, duhet të jenë sa më të specifikuar.

Konventa e Strasburgut e vitit 1990 dhe ajo e Varshavës nuk vënë si parakusht për konfiskim dënimin por përkufizimet e tyre të “*produkteve të krimit*” dhe dispozitat mbi konfiskimin e mjeteve nënkuptojnë që ato përqëndrohen shumë te konfiskimi i bazuar në një vendim dënimi penal. Në kuadër të Bashkimit Europian⁴⁷ po inkurajohet zgjerimi dhe futja e konfiskimit civil. Kjo është shtyrë më tej me Direktivën e 4 të BE-së vitit 2015, por duke theksuar që të përdoret në rrethana të kufizuara vetëm kur ikja e personit të dyshuar apo të akuzuar bën të pamundur ndjekjen penale, me kushtin që personi të ketë mundësi të mbrohet për pronën me një avokat.

Si konfiskimi penal ashtu dhe konfiskimi që nuk bazohet në një dënim ndajnë të njëjtin objektiv: konfiskimin e të ardhurave të përfitura nga veprimtaria kriminale. Motivimi nga i cili nisen është:

- ata që kryejnë veprimtari kriminale nuk duhet të lejohen të përfitojnë nga kjo veprimtari, e të ardhurat nga krimi duhet të konfiskohen në mënyrë që të kompensohen nga dëmet viktimat e veprave penale dhe shteti;
- aktiviteti i paligjshëm duhet të parandalohet. Heqja e përfitimit ekonomik nga krimi dekurajon sjelljen kriminale dhe konfiskimi i aseteve kriminale siguron se ato nuk do të përdoren për qëllime të mëtejshme kriminale.

⁴⁵Impact Study on Civil Forfeiture, project Criminal assets Recovery in Serbia, publisher Council of Europe, 2013

⁴⁶Theodore S, Greenberg, Linda M. Samuel, wingate Grant, Larissa Gray: Stolen Asset Recovery A Good Practices Guide for non-Conviction Based asset Forfeiture, vep.e cituar, fq.67.

⁴⁷ Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillim 20.11.2008, COM (2008) 766 final paragrafi 3.3.1

Parimet e praktikave të mira të G8-ës “Për gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve”⁴⁸ inkurajojnë shtetet që “...të shqyrtojnë mundësinë e shtrirjes në masën, që është në përputhje me parimet themelore të së drejtës së tyre të brendshme të konfiskimit nëpërmjet lejimit të konfiskimit pa dënim”.⁴⁹ Rekomandimi nr. 4 i Task Forcës së Veprimit Financiar 2012, rekomandimet e fundit të përditësuara në 2019⁵⁰ rekomandojnë se “..vendet duhet të konsiderojnë marrjen e masave, që lejojnë të ardhura të tilla ose instrumente, që do të konfiskohen pa kërkuar një dënim penal (jo të bazuar në një dënim penal) ose që kërkojnë, që subjektet të demonstrojnë origjinën e ligjshme të pasurisë, që pretendohet se i nënshtrohet konfiskimit, në masën se një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet e ligjit të tyre të brendshëm..,

Vende të tilla si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar e Irlandës dhe Britanisë së Madhe, Australia, Kanadaja, Italia, Holanda, Austria, Irlanda, Bullgaria, Gjerogjia, Rumania etj., zbatojnë konfiskimin pa dënim.

1.5 Krimi i organizuar, trafiket si burime të përfitimit të paligjshëm dhe nevoja për konfiskimin e të ardhurave nga kjo veprimtari kriminale.

Qëllimi i veprimtarisë kriminale në kuadër të krimit të organizuar ose trafikëve është sigurimi i të ardhurave në para, produkte materiale, pasuri të luajtshme e të paluajtshme, aktivitete tregtare e ekonomike. Trafiket, në përgjithësi, si ai i narkotikëve, njerëzve ose armëve, në kuadër të krimit të organizuar ose jo, sigurojnë shumë të ardhurave në para e të mira materiale. Krimi i organizuar është një kërcënim për sigurinë e brendshme të vendeve dhe në kuadër të BE ⁵¹e më tej, ai siguron fitime të konsiderueshme nga aktivitete të tilla si:

- Trafikimi i narkotikëve

⁴⁸ The G8 Best Practice Principals on Tracing Freezing and Confiscation of assets (2004) paragraph. 26. Ky dokument është i disponueshëm në faqen elektronike, https://www.justice.gov/sites/default/files/ag/legacy/2004/06/03/G8_Best_Practices_on_Tracing.pdf

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Recommendation 4 of the Financial Action Task Forces 2012, FATF Recommendations 2012. Ky dokument është i disponueshëm në faqen elektronike <https://www.fatfgafi.org/publications/fatfrecommendations/documents/internationalstandardscombatingmoneylaunderingandthefinancingofterrorismproliferation-thefatfrecommendations.html>

⁵¹ Raporti SOCTA, 2013, EUROPOL, ky dokument mund të gjendet në adresën <https://www.europol.europa.eu/publications-events/main-reports/eu-serious-and-organised-crime-threat-assessment-socta-2013>

- Trafikimi i qënieve njerëzore
- Kontrabandimi i cigareve, pijeve alkolike, medikamenteve, drurëve, lëndëve djegëse e radiologjike e kimike, veprave të artit e kulturore, të mbetjeve etj.
- Trafikimi i paligjshëm i mbetjeve, asgjësimi dhe shkatërrimi i trashëgimisë mjedisore, peisazhit, asaj trashëgimisë artistike,
- Falsifikimi i mallrave ushqimore, farmaceutike, e prodhimeve të tjera të konsumit
- Pastrimit të parave
- Investimin e të ardhurave në aktivitete ekonomike, tregtare dhe shërbimi

Në rekomandimin nr. (2001)11 të Këshillit të Europës “*Mbi parimet bazë lidhur me luftën kundër krimit të organizuar*”, konkretisht, në raportin shpjegues të tij⁵², jepet përkufizimi i grupit të organizuar. Si krime të organizuara konsiderohen krimet e kryera nga grupe kriminale, të cilat përmbushin disa kritere, disa prej të cilave duhet të ekzistojnë detyrimisht, që janë:

1. Bashkëpunimi i tre ose më shumë personave;
2. Aktiviteti kriminal i tyre për një kohë të gjatë;
3. Kryerja e krimeve me rrezikshmëri të theksuar; bashkëpunimi i tre ose më shumë personave;
4. Aktiviteti kriminal i tyre për një kohë të gjatë;
5. Kryerja e krimeve me rrezikshmëri të theksuar;
6. Ekzistenca e objektivit për përfitime ose pushtet.

Kodi ynë penal në nenin 28 të tij parashikon bashkëpunimin e veçantë kriminal si formë e veçantë e kriminalitetit, ndër të cilat kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatës kriminale.⁵³

- Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, që dallohen nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit,

⁵² Për më shumë për përmbajtjen e rekomandimit dhe raportin shpjegues të tij shih: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804e603c>

⁵³ Neni 28 i KP të Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 78, datë 27.01.1995

qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një ose më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale ose jomateriale.

- Grupi i strukturuar kriminal është forma e veçantë e bashkëpunimit, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një ose më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

Kodi Penal Italian në nenin 416 dhe 416/1 të tij bën një përcaktim të detajuar të organizatave kriminale duke patur parasysh eksperiencën e tyre të hershme në luftën kundër krimit të organizuar. Shprehja “*krim i organizuar*”, për shumë njohës ose studiues të ligjit mund të duket se nuk ka nevojë për ndonjë shpjegim të veçantë, sepse kuptimi i saj, në momentin e parë, perceptohet dhe duket mjaft i qartë. Megjithatë, edhe në kuptimin terminologjik, nuk është e thjeshtë të arrihet në një përkufizim të saktë dhe koherent për këtë dukuri, si në kuadrin e një shteti të vetëm, ashtu edhe në kuadrin ndërkombëtar⁵⁴. Nga ana tjetër, ky përkufizim merr rëndësi të veçantë përse i përket saktësisë ose përpikmërisë nuk është e thjeshtë të arrihet në një përkufizim të saktë dhe koherent për këtë dukuri, si në kuadrin e një shteti të vetëm, ashtu edhe në kuadrin ndërkombëtar.

Në doktrinë ndeshen përkufizime të ndryshme të nocionit “*krim i organizuar*”. Kështu, nga aspekti i trajtimit penalo-juridik të pjesëmarrjes së organizuar të shumë personave në një vepër penale, krimi i organizuar konsiderohet si: “*Kryerja e veprave penale nga ana e organizatës kriminale për të realizuar përfitime ose fuqi (pushtet), me anë të përdorimit të forcës ose me anë të shfrytëzimit të pozicionit të posaçëm në shoqëri, me zvogëlimin e rrezikut nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme ekonomike, politike dhe aktivitete të tjera dhe me një sistem të krijuar më parë të mbrojtjes nga ndjekja e organeve shtetërore të zbatimit të ligjit.*”

Një përkufizim të ngjashëm të “grupit të organizuar kriminal” e jep Protokolli i Palermos⁵⁵, që përcakton: “*Grup kriminal i organizuar*” nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohë të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose vepra penale të rënda, të

⁵⁴54 Zamir Poda: “Krimi i organizuar”, botim i parë, Tiranë, 2005, fq.16

⁵⁵55 Konventa e Kombeve të Bashkuara “*Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar*”, në pikën ‘a’, të nenit 2 të saj, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale". I njëjti instrument ndërkombëtar në nenin 2/c bën përkufizimin e një lloji tjetër të veçantë bashkëpunimi të cilësuar, që paraqet rrezikshmëri më të pakët shoqërore, "grupin e strukturuar kriminal", i cili përcaktohet si: "... një grup që nuk është formuar në mënyrë të rastësishme për kryerjen e menjëhershme të një veprë penale dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësimit në të ose të ketë një strukturë të zhvilluar".

Kjo Konventë jep edhe përkufizimin e "krimit serioz", duke quajtur të tillë: "... atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë." Sipas konventës një krim ka natyrë ndërkombëtare, kur:

- 1-kryhet në më shumë se një Shtet;*
- 2-kryhet në një Shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose kontrollit kryhet në një shtet tjetër;*
- 3-kryhet në një Shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në aktivitete kriminale në më shumë se një Shtet dhe*
- 4-kryhet në një Shtet, por efektet thelbësore i ka në një Shtet tjetër.*

Ky krim quhet i organizuar pasi kriminelët profesionistë gjatë kryerjes së aktiviteteve kriminale i planifikojnë dhe i bashkërendojnë ato në mënyrë të veçantë. Për këtë qëllim, ata mbështeten në shoqëri, shoqata ose persona të tjerë juridikë, grupe të themeluara më parë ose të krijuara rishtazi, të cilat nga pikëpamja formale merren me aktivitete të lejuara dhe të ligjshme dhe shpesh janë të regjistruara rregullisht për aktivitetet që kryejnë. Për të realizuar qëllimet e saj, organizata kriminale, nga ana objektive vepron me veprime aktive të kundërligjshme, duke përdorur forcën, mjetet e tjera të kërcënimit, nënshtrimit dhe heshtjen për shkak të pjesëmarrjes dhe veprimtarisë së saj, për të kryer vepra penale, për të siguruar, në çdo mënyrë, administrimin ose vënien nën kontroll të veprimtarive ekonomike, të koncesioneve, etj.

Sipas të dhënave të marra nga ONODC,⁵⁶ tërësia e veprimeve financiare të grupeve të krimit të organizuar të drogës, sot janë përfshirë në bankat nacionale të vendeve të vogla në depozitim kursimesh, ose duke u investuar në emër të tjerëve në shumicën e rasteve në emër të investitorëve në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të Evropës Lindore. Prej kësaj, nuk bëjnë përjashtim grupet kriminale shqiptare në vend e jashtë vendit, të cilat nëpërmjet trafikimit të narkotikë burimor ose jo, kanë siguruar të ardhura të mëdha dhe i kanë investuar në Shqipëri⁵⁷. Jo gjithmonë operatorët financiarë dhe të kontrollit kanë arritur të identifikojnë burimin e të ardhurave apo të financimit të investimit, blerjes, transaksionit. Kriza ekonomike e viteve të fundit dhe sidomos pandemia e COVID 19, ka bërë që grupet kriminale të identifikojnë mundësi të reja që u ofrohen, duke rrëzuar tashmë barrierat kombëtare. Karakteri i sipërmarrjes shikohet si një nga tiparet më të rëndësishme të organizatave moderne kriminale, në forma veprimi të orientuara fuqishëm drejt plotësimit të kërkesës së tregut për mallra dhe shërbime, shumë bashkëpunues, si dhe luhatjen e aktiviteteve të ligjshme. Ky fenomen është shtrirë vitet e fundit dhe në Shqipëri me investime të grupeve kriminale, që kanë realizuar trafikim të lëndëve narkotike të prodhuara në Shqipëri apo të tranzituara nëpërmjet Shqipërisë⁵⁸.

Dimensioni transnacional i krimit të organizuar është rritur me lehtësinë, me të cilën grupet kriminale përdorin tashmë të gjitha mjetet e transportit, rrugët e infrastrukturës, që ekzistojnë në vendin tonë, vendet e rajonit e të BE-së. Rrugët e Ballkanit mbeten në qendër të trafikut të drogave dhe armëve e për rrjedhojë kthehen mbrapsht në transaksione të pastrimit të parave⁵⁹. Kontrabandimi i cigareve, medikamenteve, mallrave të ndryshme nga rajonet e Kinës dhe Turqia, po ashtu i pijeve alkoolike, si dhe trafikimi i armëve të vogla, kryesisht kalojnë në rrugët e Ballkanit.⁶⁰ Trafiku i heroinës përdor rrugë të ndryshme, por një linjë e saj janë rrugët e Ballkanit

⁵⁶Measuring Organized Crime in the Western Balkans, ky raport gjendet në adresën elektronike <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis>

⁵⁷ Fabian Zhill, Besfort Lamellari: Raporti mbi Krimin e Organizuar, Krimi i Organizuar në Shqipëri, Vlerësimi i Riskut, OSFA, Tiranë, 2015, Raporti është i disponueshëm në: <https://www.osfa.al>

⁵⁸ Prurjet financiare të paligjshme në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Faktorët kryesorë dhe prirjet aktuale, Global Initiative, Against Transnational Organized Crime, Raport i Ekonomisë Politike, Gusht 2020. Fq. 27

⁵⁹ European Parliament study on the deterrence of fraud with EU funds through investigation in the Union of 27 October 2012. Studimi është i disponueshëm në: <https://www.europarl.europa.eu>

⁶⁰Po aty, Këto aktivitete sipas raporteve të Komisionit Europian rezultojnë me humbje tatimore prej 10 miliardë Euro në vit për cigaret e rreth 130 deri në 250 milionë e uro për mallrat e tjera. Raporti është i disponueshëm në: <https://www.europarl.europa.eu>

Perëndimor, ku dhe Shqipëria është destinacion transit për ngarkesa të mëdha lënde të tillë, që vjen kryesisht nga vendet e Amerikës Latine nëpërmjet transportit ujor apo Lindjes së Mesme e Turqisë nëpërmjet transportit rrugor. Në 10-vjeçarin e fundit, ka pasur një tendencë që portet e vendeve të Ballkanit e të Mesdheut, si dhe të Gadishullit Iberik e atyre të Detit të Zi të shërbejnë si porte pritëse dhe magazinim të sasive të mëdha të drogave të forta nga vendet e Amerikës Qendrore dhe Jugore. Raportet ndërkombëtare⁶¹ tregojnë se më shumë se 70 substanca të reja psikoaktive kanë hyrë në tregjet evropiane dhe kanë nevojë për përpunime kimike duke krijuar laboratorë e sjellë nevojë për prekursorë dhe përzierës kimikë të ndryshëm. Kjo nxit organizimin e grupeve kriminale me qëllim krijimin e këtyre laboratorëve e magazinave kryesisht në vendet në kufi me BE siç është Shqipëria.

Krizat dhe luftërat civile në Lindjen e Mesme, Afganistan⁶² kanë nxitur aktivitetin e paligjshme të kontrabandimit ose trafikimit të qenieve njerëzore për rrjedhojë dhe aktivitetet kriminale të falsifikimit të dokumenteve për të lëvizur për jashtë shtetit apo leje hyrjeve e qëndrimeve në vendet e Bashkimit Evropian,⁶³ është nxitur industria e seksit, rritur kërkesa për punë e produkte të lira. Disa vende të BE kanë nxitur iniciativën për zbatimin e Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe shtypjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave. Përdorimi mashtues i internetit lejon krimin e organizuar të zgjerojë trafikimin e paligjshëm të substancave psikoaktive, armëve të zjarrit, materialeve të përdorura për prodhimin e eksplozivëve, kartëmonedhave të falsifikuara, produkteve të falsifikuara dhe produkteve që cenojnë të drejtat intelektuale e pronësore, duke shmangur akcizën dhe taksat e tjera për shitjen e mallrave autentike. Qarkullimi i këtyre mallrave kërkon patjetër mbështetjen dhe veprimin e organizatave kriminale. Asgjësimi i mbetjeve toksike dhe tregtia e mallrave të vjedhura apo të çmuara u shfaqën si formë e re kriminalitetit të organizuar vitet e fundit.

Vështirësitë në marrjen e kredive e marrëdhëniet për bankat për biznesin dhe investitorët i detyrojnë këta të fundit që t'u drejtohen grupeve kriminale, të cilat zotërojnë para të përfituara nga

⁶¹ EU Drug Markets Report. A Strategic Analysis, ky dokument gjendet në:

<https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/>

⁶² Raporti i Raportuesit Special të OKB për të Drejtat e Njeriut e Emigrantëve në BE, 2019. Raporti është i disponueshëm në: <https://www.ohchr.org/en/special-procedures/sr-migrants>

⁶³ ILO 2012 Global Estimate of Forced Labour Regional Factsheet European Union, mund të gjendet në <http://www.ilo.org/ëcm5/groups/public/@europe/@ro-geneva/@ilo-brussels/documents/>

trafikimi i narkotikëve dhe më tej duke i marrë e futur në qarkullim këto para jo të pastra. Kjo krijon varësi të tyre nga krimi i organizuar, por dhe kriminalizon ecurinë e mëtejshme të aktiviteteve ekonomike e investimeve. Nevoja e pastrimit të parave sjell dhe nevojën e përfshirje së tyre në fazat e prokurimit të fondeve publike.⁶⁴Tendencë tjetër e krimit të organizuar është përfshirja në aktivitete më pak produktive, por që , në të njëjtën kohë, mbartin më pak rreziqe.⁶⁵Marrja e përfitimit pasuror paraqet një nga masat kryesore të veprave penale të krimit të organizuar⁶⁶

Shtojca⁶⁷ e Konventës së Këshillit të Evropës “*Për Pastrimin, Depiskimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit* “ ka përcaktuar disa aktivitete kriminale, që në sistemet ligjore të brendshme janë dhe vepra penale përkatëse, të cilat duhet të merren parasysh nga shtetet anëtare për ta shoqëruar hetimin e tyre edhe me hetime pasurore. Si të tilla janë renditur :

- pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal dhe shantazhi,
- terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit,
- trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e emigrimit
- shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve
- trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope
- trafikimi i paligjshëm i armëve
- trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera

1.6 Vepra të tjera penale si burime të përfitimeve të paligjshme të pasurisë dhe nevoja për konfiskimin e të ardhurave prej saj.

Veprimtaria kriminale, që siguron të ardhura jo gjithmonë është në formën e krimit të organizuar. Korrupsioni, krimi ekonomik, evazioni fiskal, shkelja e rregullave në fushën e prokurimeve,

⁶⁴ Përmbledhja e UNODC e rasteve të krimit të organizuar. Mund të gjendet në:
<https://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/digest-of-organized-crime-cases>

⁶⁵ Ismet Elezi, Vasilika Hysi Politika Kriminale, botim 2006, Pegi, fq. 122.

⁶⁶ Vesel Latifi, Ismet Elezi, Vasilika Hysi: Politikat e Luftimit të Kriminalitetit, botim 2012, Insituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publik “Juridica”, faqe 199.

⁶⁷ Përdorimi termave, Shtojcë e Konventës së Këshillit të Europës “*Për Pastrimin, Depiskimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit*”, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën me ligjin nr.9646 dt.27.11.2006, bot. Fletore Zyrtare nr.132, dt.18 Dhjetor 2006

shkelja e barazisë në tendera janë vepra penale, që sigurojnë të ardhura të konsiderueshme. Veprat penale të korrupsionit, krimit ekonomik, evazionit fiskal, përfitimet nga prokurimet e fondeve publike, duke shmangur rregullat e prokurimeve e barazinë në tendera, pastrimit të parasë, falsifikimit të kartëmonedhave, shmangia e akcizës dhe taksave të tjera për shitjen e mallrave autentike, dhënia abuzive e lejeve të ndërtimit, nxjerrja e mineraleve si kromi në kundërshtim me rregullat, duke shmangur taksën minerale, kontrabandimi i medikamenteve, korrupsioni i zyrtarëve publikë⁶⁸ e ai privat, janë të gjitha krime, që kryhen me qëllim grumbullimin e të ardhurave e që sigurojnë përfitime të mëdha për autorët, duke dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme financat publike e politikat sociale në shtetin e së drejtës.

Shtojca⁶⁹ e Konventës së Këshillit të Evropës “*Për Pastrimin, Depiskimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit*” ka përcaktuar disa aktivitetet kriminale që në sistemet ligjore të brendshme janë dhe vepra penale përkatëse, të cilat duhet të merren parasysh nga shtetet anëtare për ta shoqëruar hetimin e tyre edhe me hetime pasurore. Si të tilla janë renditur, krahas natyrës së veprave penale, që kryhen në kuadër të krimit të organizuar edhe: korrupsioni e mitëmarrja, mashtrimi, falsifikimi i monedhës, falsifikimi dhe pirateria e produkteve, krimi mjedisor, vrasja, plagosja e rëndë trupore, rrëmbimi, kufizimi dhe pengmarrja e paligjshme, vjedhja ose plaçkitja, zhvatja, kontrabanda, manipulimi i shitblerjes së letrave me vlerë dhe i tregut.

E gjithë kjo kategori veprash penale siguron të ardhura të konsiderueshme. Procedimet penale zgjasin e mund të mos jenë të efektshme, prandaj ka rëndësi regjistrimi i proceseve parandaluese, në mënyrë që të konfiskohen të ardhurat e pasuritë të vëna nëpërmjet këtyre veprave penale.

Korrupsioni është një fenomen kriminal, i cili siguron të ardhura kriminale e lufta ndaj tij ka rëndësi themelore për të ardhmen e demokracisë në Shqipëri dhe për shtetin e së drejtës. Vlen të përmendim, në këtë rast, reformën e rëndësishme ligjore dhe kushtetuese në lidhje me institucionet

⁶⁸ Sipas Raportit të fundit të Bankës Botërore korrupsioni përbën 5% të PBB botërore (2.6 miliardë dollarë) me mbi 1 miliardë dollarë paguhet si rrushfet çdo vit, ndërsa korrupsioni përbën 10 % të kostos totale të aktivitetit tregtar global dhe 25 % të kostos së kontratave të prokurimit në vendet në zhvillim Për më shumë shih: <https://www.worldbank.org/en/events/>, konsultuar për herë të fundit më 15. 09.2021

⁶⁹ Përdorimi i termave, Shtojcë e Konventës së Këshillit të Evropës “*Për Pastrimin, Depiskimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit*”, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën me ligjin nr.9646 dt.27.11.2006, bot. Fletore Zyrtare nr.132, dt.18 Dhjetor 2006, fq. 5169.

e reja në luftën kundër krimit të organizuar e korrupsionit, e cila duhet të sjellë efektivitet edhe në aspektin e konfiskimit të pasurisë kriminale. Në ndryshimet kushtetuese 2016⁷⁰, ndër të tjera, në nenin 135 të tij, është parashikuar ngritja e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe e Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK).

Gjykata e Posaçme gjykon veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, apo edhe akuzat ndaj ish-funksionarëve të mësipërm. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikacione vetjake sipas ligjit.⁷¹

Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe krimin e Organizuar”⁷² parashikon se kompetenca lëndore e Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, parashikohet nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale e nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135/2 i Kushtetutës⁷³. Ky ligj përcakton juridiksionin penal të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila do të jetë me vendndodhje në Tiranë dhe e ushtron juridiksionin e saj penal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Veprat penale në Kompetencat e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në kompetencën e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e për rrjedhojë dhe të Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK) hyjnë:

⁷⁰Të miratuara nëpërmjet ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, (të ndryshuar).

⁷¹Paragrafi 4 i nenit 135 të Kushtetutës, Pjesa e nëntë, gjykatat. Kushtetuta vë si kusht, që gjyqtarët në detyrë, pra Gjykatat për Krime të Rënda, duhet të japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe të telekomunikimeve vetjake, me qëllim që të kalojnë në Gjykatën e re Antikorrupsion dhe Krimin e Organizuar.

⁷² Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

⁷³ Neni 8, kompetenca lëndore parësore *po aty*.

- Veprat penale më të rëndësishme si ato të korrupsionit, të kryera për shkak të funksionit si: korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike (neni 244 i KP); korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë (neni 244/a i KP); korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë (neni 245 i KP); ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike (neni 245/1 i KP); përfitim i paligjshëm i interesave (neni 257 i KP), shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike (neni 258 i KP), korrupsioni pasiv i personave, që ushtrojnë funksione publike (neni 259 i KP); korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë (neni 259/a i KP); korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260 i KP); korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit (neni 312 i KP); korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë (neni 319 i KP); korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/a i KP); korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj (neni 319/b i KP); korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja (neni 319/c i KP); korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë (neni 319/ç i KP); korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/d i KP); korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj (neni 319/dh i KP); korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja (neni 319/e i KP).
- Veprat penale në kuadër të organizatave kriminale si: forma të veçanta të bashkëpunimit (neni 28 i KP); organizata kriminale (neni 333 i KP); grup i strukturuar kriminal (neni 333/a i KP); kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal (neni 334 i KP).
- Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj.

- Akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.⁷⁴

Në fushën e veprimit të Gjykatës së Posaçme hyjnë edhe kërkesat për masë parandaluese në kuadër të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimi, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, të ndryshuar⁷⁴. Sipas Aktit Normativ Nr. 1 datë 31.01.2020 “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike*” Gjykata e Posaçme e Shkallës së Për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, ishte gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesave të Prokurorisë së Posaçme për masë parandaluese personale dhe pasurore sipas këtij Akti. Për marrjen e masave parandaluese kundër korrupsionit si burim bazë shërben edhe Strategjia Antikorrupsion e KM, sipas së cilës kërkohet bashkëpunim e bashkëveprim i organeve shtetërore me shoqëritë civile, OJQ, gjithë opinionin publik kundër korrupsionit.⁷⁵

1.7 Çështje në vëmendje

Veprimtaria kriminale sjell të ardhura në para, përfitime materiale, pasuri të luajtshme e të paluajtshme, e produkte të tjera, prandaj sekuestrimi e konfiskimi i tyre kanë rëndësi për përmbushjen e qëllimit final të luftës ndaj kriminalitetit. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së përfituar nga veprimtaria kriminale janë instrumente efikase në luftën kundër kriminalitetit e veçanërisht atij të organizuar, trafikëve, krimit ekonomik e korrupsionit. Përfitimi material nga veprimtaria kriminale lë gjithmonë gjurmë e si e tillë duhet ndjekur. Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga veprimtaria kriminale e produkteve që burojnë nga vepra penale janë dy institute të hershme të së drejtës penale materiale e asaj procedurale penale

Legjislacionet penale materiale dhe ato procedurale njohin sekuestrimin si masë sigurimi preventiv dhe konservativ dhe konfiskimin si dënim plotësues. Vende të ndryshme kanë gjetur

⁷⁴ Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “*Për një ndryshim në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”*”.

⁷⁵ Vesel Latifi, Ismet Elezi, Vasilika Hysi: Politikat e luftimit të kriminalitetit, vep. e cituar, fq. 122.

zgjidhje legjislativë të ndryshme. Disa sisteme ligjore evropiane e më gjerë kanë të parashikuar sekuestrimin dhe konfiskimin si institute penale ose civile në kodet respektive, materiale penale dhe procedurale, por dhe ato civile. Vende të tjera, me rregullime të veçanta ligjore, kanë parashikuar sekuestrimin dhe konfiskimin si masa parandalimi pasurore. Kjo qasje është më e dukshme pas miratimit të Konventës së Këshillit të Evropës “*Mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit*”.⁷⁶

Konfiskimi i produkteve të veprës penale është një instrument i së drejtës penale dhe asaj civile me anë të të cilit mundësohet ndarja e përfitimit financiar ose një sendi material me anë të një veprimi kriminal e të kundërligjshëm, duke vendosur parimin se askush nuk mund të përfitojë nga krimi. Qëllimi i tij si instrument është parandalimi dhe ndëshkimi, por dhe mbrojtja e interesave të palës së dëmtuar. Motivi kryesor i krimit të organizuar është fitimi dhe sigurimi i të ardhurave e përfitimeve pasurore prandaj dhe veprimi efektiv për të parandaluar krimin e organizuar duhet të synojë gjurmimin, ngrirjen, konfiskimin e produkteve të kësaj veprimtarie kriminale.

Masa parandaluese e konfiskimit pasuror në procedurën penale ose civile është një nga instrumentet më efikase, por në të njëjtën kohë dhe një nga institutet më të diskutueshme në raport me respektimin e parimeve të procesit të drejtë gjyqësor dhe të drejtës së pronës dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesave të të tretëve e palëve të tjera. Prandaj, një sërë Konventash në nivelin e OKB, KE, BE kanë trajtuar elementë të këtij instituti të rëndësishëm duke e ngritur në nivel të një pjese të së drejtës ndërkombëtare të veçantë. Jurisprudenca e GJDNJ ka evidentuar kufirin e këtyre masave me respektimin e të drejtave të individit, jurisprudentat kushtetuese të vendeve të BE kanë përshtatur e thelluar konceptet mbrojtëse kushtetuese në referim të standardit të GJEDNJ, një sërë aktesh rregullative në kuadër të BE kanë zbërthyer në imtësi konfiskimin pasuror, me synim uniformizimin e zbatimit të tij në hapësirën e përbashkët të së drejtës të zbatuar evropiane.

⁷⁶ Strasburg, 1990, E miratuar me ligjin nr. 8646 datë 20.07.2000 “Për ratifikimin e “Konventës Evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit “

Si përfundim, mund të themi se hipoteza e ngritur në fillim të këtij kreu u vërtetua në kuptimin se tashmë kemi të bëjmë me një juridiksion të veçantë të masave parandaluese pasurore, konfiskimit pasuror që përfshin disa forma të tij me tipare të veçanta nga legjislacioni i tradicional.

Në këtë kuadër, mbetet detyra e sistemit tonë ligjor që t'i përngjasojë këtij juridiksioni të veçantë, parametrave e standardeve të tij, me qëllimin që të gjemë zgjidhjen e duhur në funksion të një procedimi pasuror efikas, i cili mbron interesin publik, por edhe që garanton të drejtat pasurore të shtetasve.

KREU II

NORMAT DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË VEPRIMTARISË KRIMINALE

Përmbajtja. 2.1. Hyrja, 2.2. Normat ndërkombëtare mbi konfiskimin e produkteve të krimit. 2.3 Standardet ndërkombëtare (OKB, KE, BE) mbi çështjen e konfiskimit të produkteve të krimit dhe barrën e provës. 2.4. Modele të ndryshme të ligjeve mbi konfiskimet dhe zgjidhjet tipike mbi barrën e provës. 2.5. Roli i institucioneve ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e sekuestreimeve dhe konfiskimeve të produkteve të krimit (përfshirë bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellë. 2.6. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe reflektimi i tyre në praktikën e zbatimit të ligjit në nivel kombëtar e ndërkombëtar. 2.7. Çështje në vëmendje dhe perspektiva e tyre.

2.1. Hyrje

Legjislacioni shqiptar në këtë fushë është i ri dhe si i tillë është shumë e rëndësishme që t'i përmbahet standardeve ndërkombëtare, në veçanti atij të Bashkimit Evropian e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Normat dhe standardet ndërkombëtarë për çështje të luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, në veçanti të konfiskimit të pasurive kriminale e barrës së provës mbi justifikimin e pasurisë së ligjshme kanë evoluar. Kryesisht,

standardet në nivelin e Bashkimit Evropian me tërësinë rregullative të akteve si Vendimet Kuadër të BE, Direktivat e Komisionit Evropian, Rregulloret, Rekomandimet etj., kanë evoluar në mënyrë dinamike duke iu përgjigjur prirjeve dhe formave të pastrimit të parave.⁷⁷

Direktivat e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit si dhe Raportet shoqëruese të tyre përbëjnë gjetjet më të arrira e të fundit në çështjet e standardizimit të masave parandaluese pasurore, me qëllim harmonizimin e tyre në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, ato përbëjnë një bazë të rëndësishme referuese e të gatshme për legjislacionin shqiptar, në mënyrë të veçantë për masat paraprake pasurore si një nga legjislacionet më delikate dhe për të cilën duhet treguar kujdes i veçantë. Sigurisht, që gjyqtarët janë garantuesit e zbatimit të drejtë të ligjeve nëpërmjet interpretimit e kontrollit gjyqësor, prandaj njohja e normave e standardeve ndërkombëtare është detyrë e tyre.

Legjislacioni për masat parandaluese është i ri e si i tillë ai duhet të jetë një legjislacion modern që të reflektojë risitë e fundit në legjislacionin evropian. E drejta e vendeve evropiane është një e drejtë që zhvillohet përditë, dhe jurisprudenca e GJEDNJ, po ashtu. Siç e kemi trajtuar më lart, konfiskimi pasuror është një masë, e cila prek të drejtën e qenësishme të pasurisë e lirisë së veprimt ekonomike e tregtar e si e tillë, kufizimi i saj duhet të jetë në përputhje me parimet e KEDNJ e standardet ndërkombëtare. Ky institut ka thyer parimet tradicionale tona të së drejtës e zbatimi i tij nuk është i lehtë.

Më sipër është argumentuar se sa e rëndësishme është dhënia e mundësive për të provuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë dhe se sa i vështirë është ngarkimi me barrën e provës së justifikimit të pasurisë së paligjshme.

Edhe në këtë kre, vijojmë me hipotezën e identifikimit të një juridiksioni të veçantë ndërkombëtar mbi masat e parandalimit pasuror, mbi konfiskimin pasuror në veçanti si normë konvencionale, standard ndërkombëtar dhe jurisprudencë ndërkombëtare.

⁷⁷ Shqipëria është vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe si e tillë është e domosdoshme që në çdo proces të rishikimit ose miratimit të legjislacionit, ky i fundit duhet t'i përafrohet atij evropian të *acqui communitaires*.

Për këtë shkak, ka shumë rëndësi njohja e standardeve ndërkombëtare dhe zbatimi i tyre në nivelin kombëtar. Rëndësi të veçantë merr detyrimi që ka shteti ynë, që në përdorimin e këtyre instrumenteve të veçantë të garantohen parimet e procesit gjyqësor të drejtë dhe garancitë procedurale të të hetuarve, familjarëve të tyre, bashkëpunëtorëve, personave të tretë, në mënyrë që si shtet, në një përballje të mundshme me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Shqipëria të gjendet në respektim të frymës së KEDNJ, standardet e zbatimit të së cilës i gjejmë pikërisht në këto norma e në këtë jurisprudencë të GJEDNJ.

2.2. Normat ndërkombëtare mbi konfiskimin e produkteve të krimit.

Normat ndërkombëtare mbi konfiskimin e produkteve të krimit janë në nivel të Konventave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të Këshillit të Evropës, akteve në kuadër të Bashkimit Evropian si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në vijim, trajtohen normat ndërkombëtare bazë, të cilat kanë të bëjnë me konfiskimin e produkteve të krimit.

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar (UNTOC) ⁷⁸

Kjo Konventë është akti ndërkombëtar më i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar, në të njëjtën kohë ka dhënë përkufizimin e konfiskimit. Në nenin 2 të kësaj Konvente janë dhënë përkufizimet e nocionit të të ardhurave nga krimi dhe konfiskimit. Sipas këtyre përkufizimeve “*të ardhura nga krimi*” nënkupton çdo pasuri që rrjedh ose që është fituar, direkt ose indirekt, nëpërmjet kyerjes së një vepre penale. Ndërsa me “*bllokim*” ose “*konfiskim*” nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, shkëmbimit, rregullimit ose zhvendosjes së pasurisë ose marrjen përkohësisht në ruajtje ose kontrollimin e pasurisë në bazë të një urdhri të lëshuar nga gjykata ose

⁷⁸ Ligji nr. 8920 datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “*Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar*”, dhe dy protokolleve shtesë të saj, Fletore Zyrtare nr. 41 korrik 2002.

ndonjë autoritet tjetër kompetent. Më tej, jepet përkufizimi “*Konfiskim*”, që nënkupton privimin e përhershëm nga pronësia me anë të një urdhri gjykatë ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

Sipas kësaj Konvente ⁷⁹ shtetet duhet të adaptojnë, në shkallën më të madhe të mundshme dhe brenda sistemeve të tyre ligjore, masa të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e: (a) të ardhurave nga krimi, që rrjedhin nga veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë ose pasurisë, vlera e së cilës i korrespondon asaj të të ardhurave nga krimi; (b) pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë. Masa të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar identifikimin, zbulimin, bllokimin ose marrjen e çdo sendi, me qëllim konfiskimin e mundshëm. Në qoftë se të ardhurat nga krimi janë transformuar ose konvertuar pjesërisht ose plotësisht në pasuri tjetër, kjo pasuri duhet t'i nënshtrohet masave të përmendura në këtë nen, në vend të të ardhurave nga krimi. Në qoftë se të ardhurat nga krimi janë përzier me pasuri të fituara nga burime të ligjshme, një pasuri e tillë duhet t'i nënshtrohet konfiskimit deri në masën e vlerës së të ardhurave nga krimi që janë përzier. Mjetet monetare ose përfitimet e tjera, që rrjedhin nga të ardhurat nga krimi, nga pasuria, në të cilën janë transformuar të ardhurat nga krimi ose konvertuar ose nga pasuria me të cilën janë bashkuar këto të ardhura, duhet t'i nënshtrohet, gjithashtu, masave të përmendura në këtë nen, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë si të ardhurat nga krimi.

Konventa jep sugjerimin për legjislacionet e brendshme të shteteve që t'u japë pushtetin gjykatave të tij ose autoriteteve të tjera kompetente, që të urdhërojnë bankat që t'u vërë në dispozicion ose t'u marrin dokumentet financiare ose tregtare duke mos refuzuar në emër të sekretit bankar. Gjithashtu, shtetet duhet të vlerësojnë mundësinë, që të kërkojnë, që autori i veprës penale, të demonstrojë origjinën e ligjshme të të ardhurave nga krimi në fjalë ose të pasurisë tjetër që i nënshtrohet konfiskimit, në atë shkallë që kërkesa është në përputhje me parimet e legjislacionit të tyre të brendshëm dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera. Sigurisht që nuk duhet të cenohen të drejtat e shtetasve e dispozitat e saj nuk duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që të cenojnë të drejtat e palëve të treta në mirëbesim. Këto masa kërkojnë të zbatohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm të një shteti palë dhe t'i nënshtrohen këtyre dispozitave.

⁷⁹ Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokollet shtesë të saj,

Konventa⁸⁰ përcakton dhe parimet, mbi të cilat duhet të funksionojë bashkëpunimi ndërkombëtar, në lidhje me konfiskimet, duke përcaktuar se një shtet anëtar që ka marrë një kërkesë nga një shtet tjetër anëtar, i cili ka juridiksion mbi një vepër penale të parashikuar nga kjo Konventë për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të tjera të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 12 të kësaj Konvente, të kryera në territorin e tij, duhet që, në shkallën më të madhe të mundshme: (a) t'ua parashtojë kërkesën autoriteteve kompetente, me qëllim marrjen e një urdhri për konfiskim dhe, në qoftë se jepet një urdhër i tillë, ta zbatojë atë; ose (b) t'u dorëzojë autoriteteve të tij kompetente një urdhër konfiskimi të lëshuar nga një gjykatë në territorin e Shtetit anëtar kërkues, në përputhje me nenin 12 paragrafi 1 të kësaj Konvente, me qëllim që ta zbatojnë atë në masën e kërkuar, për aq sa ka të bëjë me të ardhurat nga krimi, pasuritë, pajisjet ose mjetet e tjera që përmenden në nenin 12 paragrafi 1, që ndodhen në territorin e shtetit anëtar që i është kërkuar konfiskimi. Në zbatim të kërkesës të bërë nga një shtet tjetër anëtar, i cili ka juridiksion mbi një vepër penale, që mbulohet nga kjo Konventë, shteti anëtar që i është kërkuar konfiskimi duhet të marrë masat për të identifikuar, zbuluar dhe bllokuar ose konfiskuar të ardhurat nga krimi, pasuritë, pajisjet ose mjetet e tjera, të përmendura në nenin 12 paragrafi 1 të kësaj Konvente për qëllimet e një konfiskimi të mundshëm, që do të urdhërohet nga shteti palë kërkues ose, në zbatim të një kërkesë në bazë të paragrafit 1 të këtij neni nga Shteti anëtar i kërkuar.

Në lidhje me disponimin e të ardhurave nga krimi ose i pasurisë së konfiskuar⁸¹ Konventa parashikon se të ardhurat e krimit ose pasuria e konfiskuar do të zbatohet në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e tij të brendshme administrative, por duke u dhënë prioritet mundësisë së kthimit tek Shteti Anëtar kërkues të të ardhurave nga krimi ose pasurisë së konfiskuar, në mënyrë që ai të kompensojë viktimat e krimit ose t'ua kthejë këto të ardhura nga krimi, ose pasuri, pronarëve të ligjshëm. Sipas kësaj Konvente⁸², konfiskimi duhet t'u mundësojë shteteve të mbledhin të ardhurat nga krimi, që rrjedhin nga vepra penale, të cilat mbulohen nga kjo Konventë ose të pasurisë, vlera e së cilës i korrespondon asaj të të ardhurave nga krimi, pasurisë,

⁸⁰Neni 13 i Konventës. “Bashkëpunimi ndërkombëtar për konfiskimin”.

⁸¹Neni 14 “Disponimi i pasurisë së konfiskuar”.

⁸²Neni 12 i Protokollit të Palermos “Konfiskimi dhe marrja e sendeve”.

pajisjeve ose mjeteve të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë.

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit”⁸³

Konventa “*Mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit*”⁸⁴ e konsideron “*konfiskimin*” dënim ose masë të urdhëruar nga një gjykatë, pas një procedimi të lidhur me një ose disa vepra penale, dënim ose masë, që përfundon me privimin e përhershëm të pasurisë. Ndërsa me “*pasuri*” nënkupton çdo pasuri të çdo natyre, qoftë trupore ose jotrupore, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose një të drejtë mbi këtë pasuri. Sipas kësaj Konvente, çdo shtet përshtat masat ligjore dhe merr masa të tjera, që rezultojnë të nevojshme për t'i lejuar asaj konfiskimin e instrumenteve, produkteve ose pasurive, vlera e të cilëve u përket këtyre produkteve. Shtetet duhet të parashikojnë masa ligjore dhe masa të tjera të nevojshme për t'u lejuar atyre të identifikojnë pasuritë, që i nënshtrohen konfiskimit dhe të parandalojnë çdo veprim, çdo transfertë ose çdo tjetërsim lidhur me këto pasuri. Legjislacionet duhet të parashikojnë⁸⁵ masa ligjore e të tjera në mënyrë që të përdoren teknika speciale të hetimit që lehtësojnë identifikimin dhe kërkimin e produkteve si dhe grumbullimin e provave që kanë të bëjnë me të e si të tilla sugjerohen:

- Mbikëqyrja e llogarive bankare,
- Vrojtimi
- Telekomunikimet
- Hyrja në sistemet informatike
- Urdhrat për të lëshuar dokumente specifike

Në nenin 6 të saj, Konventa jep kuptimin e veprës penale të pastrimit, duke cilësuar një veprim kur akti është kryer, për kthimin, transferimin e pasurive, me qëllim që të fshihet ose të maskohet

⁸³Ligji nr. 9646 datë 27.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit” Fletore Zyrtare nr. 134 datë 22. 12. 2006

⁸⁴ Strasburg, 1990, E miratuar me ligjin nr. 9646 datë 20.07.2000 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”

⁸⁵Neni 4 “Kompetenca dhe teknika hetimi” i Konventës.

origjina e paligjshme e pasurive të tilla, fshehjen ose maskimin e natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave të lidhura me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produktet. Angazhimi për të bashkëpunuar për përshtatjen e masave ligjore dhe masave të tjera për konfiskimin e pasurive të caktuara, që përbëjnë produkte ose instrumente, si për konfiskimin e produkteve, që përbëjnë detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit, përbën një nga parimet e përgjithshme të masave të bashkëpunimit ndërkombëtar. Si instrumenti tipik i marrëdhënieve ndërkombëtare të bashkëpunimit Konventa, në pjesën më të madhe të saj, rregullon bashkëpunimin ndërkombëtar për çështjet e konfiskimit të produkteve të krimit. Sipas kësaj Konvente⁸⁶, shtetet duhet të bashkëpunojnë për qëllim të hetimit e procedimeve që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve kriminale, në mënyrë që t'u përgjigjen kërkesave:

- Për konfiskimin e pasurive të caktuara që përbëjnë produktet ose instrumentet, si dhe për konfiskimin e produkteve që përbëjnë detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit
- Për ndihmën e ndërsjellë për qëllim të hetimit dhe të masave të përkohshme që kanë për qëllim njërën nga format e konfiskimit.

Parashikohet detyrimi për të urdhëruar masa provizore⁸⁷, në rast se një shtet ka filluar një procedim ose një veprim për konfiskim, shteti tjetër duhet të plotësojë kërkesën për ngrirje ose kapje për të parandaluar çdo veprim, transfertë, apo tjetërsim lidhur me çdo pasuri, që më pas mund të bëhet objekt i një kërkesë konfiskimi. Në ndarjen 4 të Konventës, të titulluar “Konfiskimi”, parashikohet detyrimi për konfiskim dhe ekzekutimin e konfiskimit kur ka kërkesë nga një shtet ose nisjen e një procedimi konfiskimi në bazë të së drejtës së brendshme të çdo shteti. Të njëjtat dispozita zbatohen gjithashtu për konfiskimin lidhur me detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit, nëse pasuritë, mbi të cilat mund të bëhet konfiskimi, ndodhen në territorin e shtetit kërkuar.

⁸⁶Neni 7 “Parimet e përgjithshme dhe masat e bashkëpunimit ndërkombëtar”,

⁸⁷Neni 11 “Detyrimi për të urdhëruar masa provizore”

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Lëndëve Psikotrope⁸⁸

Kjo Konventë e konsideron “konfiskimin”⁸⁹ si një gjobë që nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë me urdhër të gjykatës ose të një autoriteti tjetër kompetent. Me “ngrirje” ose “kapje” nënkuptohet ndalimi i përkohshëm i transferimit, shkëmbimit, sistemimit, ose lëvizjes së pasurisë ose marrjen përkohësisht nën kujdestari, ose nën kontroll të pasurisë, në bazë të një urdhri të lëshuar nga gjykata. Me “fitime” nënkuptohet çdo lloj pasurie që rrjedh ose përfitohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, nga kryerja e një veprimtarie të kundërligjshme e parashikuar në përputhje me nenin 3, ndërsa me “pasuri”, kjo Konventë nënkupton pasuri të çdo lloji, fizike ose jo, të tundshme ose të patundshme, të prekshme apo jo si dhe dokumente ligjore që vërtetojnë të drejtën ndaj tyre. Më tej Konventa parashikon konfiskimin si instrument të saj, për të cilin shtetet duhet të marrin masa për ta mundur e që fitimet që rrjedhin nga veprimtaria e paligjshme e parashikuar në këtë Konventë, dhe e pasurive, vlera e të cilave korrespondon me vlerën e fitimeve.

Një parashikim të rëndësishëm është vënë në Konventë në lidhje me përmbysjen e barrës së provës, ruajtjen e interesave të të tretëve dhe përputhshmërinë formale të parashikimeve të saj me rregullimet e të drejtës së brendshme.⁹⁰ Pra, Konventa e Vjenës është akti i parë ndërkombëtar që parashikoi përmbysjen e barrës së provës ose siç shprehet vetë Konventa përmbysje të vlerësimit të provave, në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera, të deklaruara, që i nënshtrohen konfiskimit. Ky parashikim bëri të mundur më pas një ndryshim zinxhir të ligjeve përkatëse në legjislacionet e vendeve të ndryshme të parashikimit të masave të konfiskimit civil e devijimit të barrës së provës tek personat që zotërojnë pasurinë.

⁸⁸E quajtur ndryshe dhe Konventa e Vjenës 1988, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8722 datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope.”

⁸⁹ Neni i Konventës “Përkufizimet”.

⁹⁰Në paragrafin 7 të nenit 5⁹⁰ thuhet se “Shtetet palë duhet të kenë parasysh se mund të ndodhë një përmbysje e vlerësimit të provave në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera të deklaruara që i nënshtrohen konfiskimit, në atë masë që ky veprim të jetë në përputhje me parimet e ligjit të vendit të vet dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të interpretohen sikur dëmtojnë të drejtat e palëve të treta, që janë në mirëbesim. Gjithsesi, Konventa bën kujdes që të garantojë moscenimin e parimit se masat për të cilat ai bën fjalë, duhet të përkufizohen e të zbatohen në përputhje me ligjet vendase.”

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)⁹¹

Konventa jep të njëjtin përkufizim për “*Të ardhurat nga krimi*”⁹² duke quajtur të gjitha pasuritë që rrjedhin ose janë përfutur direkt ose indirekt, nëpërmjet kryerjes së veprës penale. Me “*ngrirje*” ose “*kapje*” kuptohet ndalimi i përkohshëm i transferimit, konvertimit, disponimit, ose lëvizjes së pasurisë, veçimi i përkohshëm ose kontrolli i pasurisë, mbi bazën e një vendimi të dhënë nga një gjykatë ose organ tjetër kompetent. Me “*konfiskim*” kuptohet humbja e së drejtës kur është e zbatueshme dhe ndarjen e përhershme nga pasuria me anë të një urdhri gjykate ose organi tjetër kompetent. Në nenin 31 të Konventës⁹³ parashikohet domosdoshmëria e marrjes së masave, që mund të jenë të nevojshme për mundësinë e konfiskimit të të ardhurave nga krimi, që rrjedhin nga një veprë penale, ose pasurisë, vlera e së cilës përputhet me atë të të ardhurave të tilla. Konventa, në këtë rast, parashikon se nëse këto fitime nga krimi janë transformuar ose konvertuar, pjesërisht ose plotësisht, në pasuri tjetër, kjo pasuri u nënshtrohet masave të përmendura në këtë nen në vend të fitimeve. Nëse fitimet nga krimi janë ngatërruar me pasuri të fituara nga burime të ligjshme kjo pasuri, pa cënuar kompetencën për ngrirjen ose kapjen, mund të konfiskohet deri në vlerën e vlerësuar të fitimit që është përzier. Të ardhurat ose privilegjet e tjera, që kanë rrjedhur në fitime nga krimi, nga pasuri, me të cilat janë ngatërruar fitimet nga krimi iu nënshtrohen po ashtu masave të përmendura në këtë nen, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë si dhe fitimet nga krimi. Ky përcaktim i Konventës u pasqyrua në legjislacionin tonë penal menjëherë pas nënshkrimit dhe ratifikimit të saj.

- Konventa Penale për Korrupsionin⁹⁴

Kjo Konventë është normë ndërkombëtare në nivelin e atyre të Këshillit të Evropës vend anëtar e të cilës është edhe Shqipëria. Konventa Penale për Korrupsionin⁹⁵ sanksionon që secila palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit kombëtar, sjelljen e referuar në Konventën e Këshillit të Evropës për pastrimin,

⁹¹ Ligji nr. 9492 datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit”.

⁹² Neni 2, “Përdorimi i termave”.

⁹³ Neni 31 “Ngrirja, kapja dhe konfiskimi”.

⁹⁴ Ligj nr. 8778 datë 26.04.2001 “Për ratifikimin e “Konventës Penale për Korrupsionin”.

⁹⁵ Neni 23 i Konventës

kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit, kryesisht për veprat penale të pastrimit të parave të produkteve nga veprat e korrupsionit.

2.3. Standardet ndërkombëtare mbi çështjen e konfiskimit të produkteve të krimit dhe barrën e provës.

Standardet ndërkombëtare mbi çështjet e konfiskimit të produkteve të krimit përbëhen nga normat ndërkombëtare të evokuara në kohë së bashku me instrumentet zbatuese dhe të monitorimit, aktet rregullatore të Bashkimit Europian si Rregulloret, Direktivat, Vendimet Kuadër si dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kuadri referues i Konventave Ndërkombëtare për Konfiskimin e Produkteve të Krimit është i gjerë: nga instrumentet e parë dhe të përgjithshëm të sjellë nga Konventa Evropiane të vitit 1957 (*në fushën e sekuestrimeve të bëra në kohën e arrestimit për qëllime ekstradimi*) dhe të vitit 1959 (*në fushën e ndihmës juridike në fushën penale*) kemi mbërritur dalëngadalë në krijimin e një sistemi gjithnjë e më organik e më kompleks. Tërësia e instrumenteve ligjore, në kuadër të normës ndërkombëtare është zhvilluar veçanërisht në aspektin e bashkëpunimit rajonal në kuadër të Këshillit të Evropës e të Bashkimit Evropian, ashtu dhe në lidhje me fusha specifike, të përcaktuara sipas rëndësisë politike që u jepet atyre nga komuniteti ndërkombëtar (*merren parasysh citimet e Konventës së Vjenës, të vitit 1998 në lidhje me trafikun e lëndëve narkotike, të Konventës së Palermos mbi krimin e organizuar transnacional, të Konventës Penale mbi Korrupsionin, e Këshillit të Evropës në vitin 1999, e Konventës së OSBE-së në vitin 1997 mbi korrupsionin dhe transaksionet tregtare ndërkombëtare*). Në këtë tërësi rregullatore dallohet zhvillimi i së drejtës ndërkombëtare në fushën e hetimeve ekonomike dhe të sekuestrimit të pasurive instrument ose të ardhura të krimit i cili ka ritme shumë më të shpejta në krahasim me çështjen e konfiskimit dhe përdorimit të fundit të pasurive të bllokuara për qëllime sigurie. Vështirësitë qëndrojnë në përkufizimin e standardit provues të kërkuar për qëllime të konfiskimit, i tillë që në burimet ndërkombëtare ftohen shtetet palë që të mbajnë parasysh pragun e provës minimale duke mos pasur peshën tradicionale të akuzës.

Konventa e Vjenës kundër trafikut të lëndëve narkotike dhe psikotrope, ishte Konventa e parë që trajtoi hapur në nivel shumëpalësh çështjen se çfarë ndodh me të ardhurat dhe mjetet e krimit, se çfarë ndodh me pasuritë e sekuestruara. Ajo ofroi një zgjidhje të kujdesshme përmes përcaktimit

të kriterit, (ndonëse nuk sjell një risi juridike), sipas të cilit masat që synojnë konfiskimin “përcaktohen dhe ekzekutohen në përputhje me të drejtën e brendshme të çdo Pale dhe sipas dispozitave të këtij legjislacioni” (neni 5, 7), duke mos cënuar në asnjë rast të drejtat e të tretëve në mirëbesim (neni 5, 8). Dispozita të ngjashme gjenden në nenin 12/7 të Konventës së OKB-së mbi krimin e organizuar transnacional dhe në Konventën e Strasburgut mbi pastrimin e parave të vitit 1990 (edhe në këtë rast, parashikimi tradicional sipas të cilit procedurat e konfiskimit rregullohen nga *lex loci* shoqërohet me ata që e detyron Shtetin e kërkuar të verifikojë faktet, gjë që qëndron në themel të vendimit gjyqësor të shtetit tjetër).

Standardizimi në kuadër të dokumenteve, akteve e institucioneve të Bashkimit Evropian gjatë 20 viteve të fundit ka ecur në një rrugë të qartë me qëllim ri standardizimin e instrumenteve ligjore të veprimit të veçantë të shteteve e atyre të përbashkët si dhe përafrimin e rregullimeve referuese të shteteve të veçanta. Si të tilla, me interes trajtimi për qëllimet e punimit janë aktet si poshtë vijon:

- Plani i Veprimit kundër krimit të organizuar, adoptuar nga Këshilli i Evropës në Amsterdam me datë 16-17 qershor 1997;⁹⁶
- Ndërhyrja e përbashkët të datës 3 dhjetor 1998 mbi pastrimin e parave dhe gjetjen, zbulimin, ngrirjen apo sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi;
- Vendimi Kuadër i Këshillit, datë 26 qershor 2001 në lidhje me po këtë fushë;
- Dispozitat specifike në lidhje me verifikimet e pasurisë në fushën e hetimeve financiare dhe bankare që përmban Protokoli shtesë i Konventës së Bashkimit Evropian për ndihmën gjyqësore në fushën penale të datë 22 maj 2000, adoptuar nga Këshilli Evropës më 16 nëntor 2001;
- Vendimi Kuadër i datës 22 korrik 2003 lidhur me ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave të bllokimit të të mirave dhe të sekuestrimit për efekt prove;
- Rekomandimet e Task Forcës për Veprimin Financiar lidhur me Pastrimin e Parave e vitit 2012 (Rekomandimi TFVP)

⁹⁶Rekomandimin nr. 26, gërma “b”, Këshillit Evropian, në lidhje me fuqizimin e kërimit dhe të sekuestrimit të të mirave të ardhura nga krimi

- Rezoluta e BE-së “Për krimin e organizuar”, miratuar nga Parlamenti Evropian më datë 25 tetor 2011⁹⁷.

Kjo rezolutë⁹⁸, bazuar në *“lidhjen e brendshme ndërmjet krimit të organizuar dhe korrupsionit”* dukshëm vë theksin mbi përdorimin e masave parandaluese kundër pasurisë, duke iu drejtuar Komisionit, që të përpunojë rregullat për një aplikim efikas të instrumenteve të tillë, si: konfiskimi i zgjeruar dhe konfiskimi jo ndëshkues, për lehtësimin e barrës së provës, lidhur me origjinën e pasurive, që zotërojnë personat e dënuar ose personat e akuzuar për veprat penale, të lidhura me krimin e organizuar, si dhe konfiskimi i pasurisë ndaj palëve të treta. Për më tepër, *“i drejtohet Komisionit, që të pranohet dhe të mbështesë nevojën imediate lidhur me legjislacionin Evropian për ri-përdorimin e të ardhurave nga aktiviteti kriminal për qëllime sociale, përfshirë mbrojtjen e dëshmitarëve në procese gjyqësore, në mënyrë që kapitali i organizatave kriminale ose i bashkëpunëtorëve të tyre mund të përfshihet në ciklin e një ekonomie të ligjshme, të pastër, transparente dhe vitale”*.

Këto udhëzime janë shtjelluar më tej nga Rezoluta e Parlamentit Evropian e datës 23 tetor 2013 *“Për krimin e organizuar, korrupsionin dhe pastrimin e parave, dhe në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar përmes goditjes së të ardhurave dhe pasurisë të krijuar nga aktiviteti kriminal”*.⁹⁹ Kjo rezolutë u drejtohet shteteve anëtare, bazuar në legjislacionin vendas, që të prezantojnë modelet e konfiskimit jo ndëshkues, në ato raste ku, bazuar në provat, që disponohen dhe bazuar në një vendim gjyqësor, mund të përcaktohet nëse pasuritë, objekt shqyrtimi, burojnë nga një aktivitet kriminal apo janë përdorur për të kryer një aktivitet kriminal të caktuar. Në këtë kuadër, Rezoluta e vitit 2013 thekson faktin se: *“në përputhje me garancitë kushtetuese të një vendi pa paragjykim ndaj të drejtës së pronës dhe të drejtës për mbrojtje, mund të parashikohen*

⁹⁷ Rezoluta e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Për krimin e organizuar”, 25 tetor 2011. Ky dokument është i disponueshëm në:

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/579318/EPRS_STU\(2016\)579318_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/579318/EPRS_STU(2016)579318_EN.pdf)

⁹⁸ Për më tepër shih <https://eur-lex.europa.eu/legal>

⁹⁹ Rezoluta e Parlamentit Evropian e datës 23 tetor 2013 “Për krimin e organizuar, korrupsionin dhe pastrimin e parave, dhe në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar përmes goditjes së të ardhurave dhe pasurisë së krijuar nga aktiviteti kriminal

<https://www.europarl.europa.eu/news/en/headlines/priorities/crime/20131018IPR22665/cracking-down-on-organised-crime-corruption-and-money-laundering>

dispozita për modelet e parandalimit të konfiskimit, të cilat mund të aplikohen vetëm bazuar në një vendim gjykatë”.

Rezoluta, e miratuar në vitin 2013, i drejtohet Komisionit që të avancojë me një nismë ligjore me qëllim njohjen e përbashkët të urdhrave të sekuestrimit dhe konfiskimit lidhur me masat për mbrojtjen e pasurisë, miratuar nga autoritetet gjyqësore italiane dhe masat ligjore civile të miratuara në vende të ndryshme të BE-së. Rrjedhimisht, rezoluta i drejtohet shteteve anëtare, që në mënyrë të menjëhershme të harmonizojnë masat operationale të nevojshme, në mënyrë që këto dispozita të jenë efektive.

- Direktiva 2005/607KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 tetor 2005 “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave” dhe Raporti i Komisionit Parlamentit Evropian për zbatimin e Direktivës së lartpërmendur¹⁰⁰
- Rregullorja (KE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 tetor 2005 “Mbi kontrollet mbi paratë e gatshme që hyjnë e dalin nga Komuniteti”;
- Vendimi Kuadër i Këshillit të Evropës 2003/568 JHA 22 korrik 2003 për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat dhe raporti i Komisionit për këtë Vendim¹⁰¹;
- Direktiva 2007/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 nëntor 2007 për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, që ndryshon Direktivën 97/7 KE;
- Direktiva 2004/17/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për koordinimin e procedurave të prokurimit për subjektet që ofrojnë energji, ujë, shërbime transporti i bankare”;
- Direktiva e BE 2019/1153 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 20 qershor 2019 “Për vendosjen e rregullave që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale dhe shfuqizimin e Vendimit të Këshillit 2007/642/JHA¹⁰²”;

¹⁰⁰ COM (2012) 0168, European Commission Brussels, 11.4.2012 COM(2012) 168 final Report From The Commission to The European Parliament and The Council, on the application of Directive 2005/60/EC on the prevention of the use of the financial system for the purpose of money laundering and terrorist financing <https://eur-lex.europa.eu/Lex>

¹⁰¹ COM (2007) 0328, Commission of the European Communities, Brussels, 18.6.2007 COM(2007) 328 final Report from the Commission to the Council, based on Article 9 of the Council Framework Decision 2003/568/JHA of 22 July 2003 on combating corruption in the private sector {SEC(2007) 808} <https://eur-lex.europa.eu/Lex>

¹⁰² Directive (EU) 2019/1153 of the European Parliament and of the Council, of 20 June 2019, Laying down rules facilitating the use of financial and other information for the prevention, detection, investigation or prosecution of

- Rregullorja (BE) 2018/1805 “Për njohjen reciproke të Urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimi”;
- Rezoluta e Parlamentit Evropian e 23 tetorit 2013 “Mbi krimin e organizuar, korrupsionin, dhe pastrimin e parave: rekomandime për veprimet dhe iniciativat që duhen ndërmarrë”¹⁰³;
- Direktiva 2005/60/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 tetor 2005 “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave” dhe Raporti i Komisionit Parlamentit Evropian për zbatimin e Direktivës së lartpërmendur¹⁰⁴
- Rregullorja (KE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 15 tetor 2005 “Mbi kontrollet mbi paratë e gatshme që hyjnë e dalin nga Komuniteti”;
- Vendimi Kuadër i Këshillit të Evropës 2003/568 JHA 22korrik 2003 “Për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat dhe raporti i Komisionit për këtë Vendim”¹⁰⁵;
- Direktiva 2007/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 Nëntor 2007 “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”, që ndryshon Direktivën 97/7 KE
- Direktiva 2004/17/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për koordinimin e procedurave të prokurimit për subjektet që ofrojnë energji, ujë, shërbime transporti dhe bankare”.

Dimensioni ekonomik transnacional, që krimi i organizuar është duke marrë, e shtyn sistemin evropian dhe ndërkombëtar në një drejtim të dyfishtë: futjen ose përforcimin e formave të *konfiskimit të zgjeruar*, të ngjashme me masat parandaluese kundër pasurisë dhe tendencën për të përshtatur bashkëpunimin midis shteteve, si dhe me njohjen më të gjerë të masave të vendosura sipas legjislacioneve të ndryshme kombëtare. Në nivel ndërkombëtar, bëhet gjithmonë e më urgjente nevoja për të njohur instrumente të përbashkëta të luftës ndaj grumbullimit të paligjshëm

certain criminal offences, and repealing Council Decision 2000/642/JHA, the European Parliament and the Council of the European Union. Direktiva është e disponueshme në: <https://eur-lex.europa.eu/legal>

¹⁰³ European Parliament Resolution of 23 October 2013 on organized crime, corruption and money laundering: recommendations on actions and initiatives to be taken (final report) (2013/2107(INI), The European Parliament

¹⁰⁴ COM (2012) 0168, European Commission Brussels, 11.4.2012 COM(2012) 168 final Report From The Commission to The European Parliament and The Council, on the application of Directive 2005/60/EC on the prevention of the use of the financial system for the purpose of money laundering and terrorist financing <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0168:FIN:EN:PDF>

¹⁰⁵ COM (2007) 0328, Commission of the European Communities, Brussels, 18.6.2007 COM(2007) 328 final Report from the Commission to the Council, based on Article 9 of the Council Framework Decision 2003/568/JHA of 22 July 2003 on combating corruption in the private sector {SEC(2007) 808} <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2007:0328:FIN:EN:PDF>

të pasurive, edhe për të lejuar zbatimin në shtetet e ndryshme në praninë e një kriminaliteti që, gjithmonë e më shpesh vepron në nivel ndërkombëtar e transnacional. Në këtë vazhde është edhe vendimi i datës 25 Tetor 2011 i Parlamentit Evropian,¹⁰⁶ i cili synon të vlerësojë instrumentin e masave ndaj pasurisë. Nga komisioni Evropian u propozua prezantimi i një direktive kuadër mbi procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit të përfitimeve të krimit, me përpunim të normave që të lejojnë përdorimin efikas të instrumenteve siç janë “konfiskimi në mungesë të dënimit”, me theksimin e barrës së provës mbi origjinën e aseteve, që kanë në posedim personat e dënuar ose të pandehur për vepra penale, të lidhura me krimin e organizuar dhe konfiskimin në rast të regjistrimit të aseteve në emër të të tretëve (pika 8), që duket se ngjason me eksperiencën italiane të masave parandaluese kundër pasurisë.

Komisioni Evropian, më datë 12 mars 2012 paraqiti propozimin për direktivën “Për bllokimin dhe konfiskimin e përfitimeve nga veprat penale në Bashkimin Evropian”, e cila synon të luftojë veprimtaritë e krimit të organizuar, duke i hequr përfitimet në nivel transnacional. Komisioni sugjeroi, midis shumë opsioneve, futjen e një “konfiskimi jo të bazuar në dënim” i njohur si i ligjshëm nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, me garanci të përshtatshme procedurale, në respektim të principit të proporcionalitetit. Për Komisionin, “impakti i këtij opsioni mbi sjelljet kriminale do të ishte domethënëse, sepse konfiskimi, i cili nuk bazohet në dënim (edhe në rrethana të kufizuara) dhe konfiskimi ndaj të tretëve, do të detyronin kriminelët që të vepronin. Një vend të veçantë në standardet e së drejtës së Bashkimit Evropian në lidhje me rregullat uniforme për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit në Bashkimin e Evropian zë Direktiva 2014/42 /BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3 prill 2014 “Për bllokimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit në Bashkimin Evropian”¹⁰⁷

- Direktiva 2014/42 /BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3 prill 2014 “Për bllokimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit në Bashkimin Evropian”.

¹⁰⁶Finalizuar më 12 Mars 2012 me Direktivën “Për bllokimin dhe konfiskimin e përfitimeve nga veprat penale në Bashkimin Evropian”

¹⁰⁷ Directive 2014/42/EU of The European Parliament and of the Council, of 3 April 2014, on the freezing and confiscation of instrumentalities and proceeds of crime in the European Union, doc. The European Parliament and the Council of the European Union

Kjo Direktivë ka shërbyer si standard për gjithë legjislacionet e tjera të vendeve të BE. Synimi i saj ishte përcaktimi i rregullave minimale që do të mund të përafrojnë rregullimet e konfiskimit e të sekuestrimit në shtetet anëtare, duke lehtësuar besimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin efektiv.¹⁰⁸ Së pari, Direktiva dha përkufizime të sakta mbi produktet e krimit, pasurinë, instrumentet, konfiskimin, bllokimin¹⁰⁹ etj.

- Me “*produkt*” kuptohet çdo avantazh ekonomik i nxjerrë nga vepra penale në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë: ky avantazh mund të konsistojë në çdo lloj pasurie dhe përfshin riinvestimin ose transformimet e mëparshme të produkteve direkte dhe çdo përfitim me vlerë.
- Me “*pasuri*” kuptohet çdo pasuri e çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri.
- Me “*instrumente*” kuptohen të gjitha pasuritë e përdorura ose të destinuara për t’u përdorur në çfarëdolloj mënyre, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale.
- Me “*konfiskim*” kuptohet privimi përfundimtar i pasurisë, i urdhëruar nga gjykatat në lidhje me një veprë penale.
- Me “*bllokim*”, kuptohet ndalimi i përkohshëm i transferimit, shkatërrimit, konvertimit, disponimit ose lëvizjes së pasurisë ose realizimi i përkohshëm i izolimit dhe kontrollit të pasurisë.

Nga raportet e Komisionit Evropian¹¹⁰ ishte arritur konkluzioni se sistemet ligjore të vendeve të BE nuk ishin shumë efektive. Konfiskimi pengohej nga ndryshimet në legjislacion në mes të vendeve anëtare të BE-së. Ekzistonte nevoja për të qartësuar konceptin ekzistues të produkteve të krimit, i cili duhet të përfshijë produkte direkte nga veprimtaria kriminale dhe të gjitha përfitimet e tërthorta, duke përfshirë riinvestimin ose transformimin më pas të produkteve të veprës penale. Prandaj, produktet mund të përfshijnë çdo pasuri duke përfshirë atë që është transformuar ose konvertuar, tërësisht ose pjesërisht, në një pasuri tjetër dhe atë që është e përzier me pasurinë e

¹⁰⁸ Përpara dales së kësaj Direktive, korniza ligjore e BE në lidhje me ngrirjen, sekuestrimin e konfiskimin bazohej kryesisht në Vendimet Kuadër dhe Kornizë të Këshillit Europian të viteve 2003, 2005, 2006.

¹⁰⁹ Neni 2, Përkufizime.

¹¹⁰ The Stockholm Programme and the Justice and Home Affairs Council Conclusions on Confiscation and asset Recovery adopted in June 2010.

https://www.eumonitor.eu/9353000/1/j4nvhd1glbmvdzx_j9vvik7m1c3gyxp/vixqtdk9x0xi

blerë nga burime të ligjshme deri në vlerën që vlerësohen produktet e përziera, ose nga pasuria në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet e krimit ose nga pasuria, me të cilën janë përzier produktet e krimit.

Me këtë direktivë zgjerohet kuptimi i pasurisë, duke u përfshirë si e tillë edhe aktet juridike ose dokumentet, që vërtetojnë një titull ose interes për mbi këtë pasuri. Direktiva e konsideron sekuestrimin dhe konfiskimin si koncepte të pavarura dhe se shtetet anëtare i trajtojnë ato në legjislacionet e tyre si sanksione ose masa të llojeve të tjera. Në konceptin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit, pas një vendimi gjykate të formës së prerë, si dhe të pasurisë me vlerë të barasvlershme me instrumentet dhe produktet duhet të zbatohet koncepti i gjerë i veprave penale, që mbulohen nga kjo direktivë¹¹¹ Si parim, kjo Direktivë sugjeron konfiskimin pas dënimit të personit me vendim të formës së prerë. Megjithatë, në sistemet ku lejohet gjykimi në mungesë mund të bëhet konfiskimi edhe kur personi është dënuar në mungesë.¹¹² Shtetet anëtare mund të parashikojnë se konfiskimi mund të mos vendoset në raste të veçanta, që do krijonin probleme për personin e prekur duke e vënë atë në vështirësi për të jetuar.

Kjo direktivë synon që konfiskimi i pasurisë ndaj personit të dënuar të vendoset jo vetëm ndaj pasurisë, e cila lidhet me krimin specifik, por ndaj të gjithë pasurisë, që gjykata i konstaton si produkt të krimeve të tjera, pra konfiskimin e zgjeruar.¹¹³ Konfiskimi i zgjeruar vendoset kur gjykata bindet se pasuria e gjallë është përfutur nga veprimtaria kriminale, kjo nuk nënkupton që duhet vendosur se prona në fjalë është përfutur nga veprimtaria kriminale. Mund të parashikohet se për gjykatën duhet të jetë e mjaftueshme të gjykojë mbi balancën e mundësive ose të prezumojë në mënyrë të arsyeshme, që ka më tepër gjasa që prona në fjalë të jetë përfutur nga veprimtaria kriminale e jo nga veprimtari të tjera. Në këtë kontekst, gjykata duhet të marrë parasysh rrethanat

¹¹¹ Vendimi Kuadër 2001/500/CBD u kërkon shteteve anëtare të lejojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit pas dënimit të formës së prerë dhe të lejojnë konfiskimin e pasurisë vlera e së cilës i korrespondon këtyre instrumenteve dhe produkteve. Vendimi është i disponueshëm në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32005F0212&from=EN>

¹¹² Kjo pasi në një sërë Kodesh të Procedurës Penale gjykimi në mungesë i personit substancialisht nuk konsiderohet vendim i formës së prerë.

¹¹³ Vendimi Kuadër 2005/2012/CBD parashikon tre kategori të ndryshme kërkesash bazë, ndër të cilat shtetet anëtare zgjedhin një prej tyre për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar. Kjo sillte si pasojë koncepte divergjente të konfiskimit të zgjeruar në juridiksione të ndryshme.

specifike të rastit, duke përfshirë faktet dhe provat e disponueshme, mbi bazën e të cilave mund të merret vendimi për konfiskimin e zgjeruar.

Në lidhje me transferimin e pasurisë tek të tretët konfiskimi duhet të jetë i mundur, të paktën kur i treti e ka ditur ose duhej ta dinin qëllimin e transferimit ose kur qëllimi i transaksionit ka qenë simulimi i pronësisë, shmangia e konfiskimit, duke u bazuar në fakte e rrethana konkrete kur ai bëhet falas ose në vlerë të ulët. Rregullat për konfiskimin e pasurisë së të tretit zbatohen edhe për personat juridike, ndërsa në asnjë rast nuk duhet të cenohen të drejtat e palëve të treta me mirëbesim. Direktiva përcakton se duhet të parashikohen zgjidhje ligjore dhe mbrojtje efektive për të garantuar ruajtjen e të drejtave të palëve të treta që pretendojnë se kanë të drejtat reale “*ius in re*” si p.sh. e drejta e uzufuktit.

Kjo direktivë solli standardizim të shumë koncepteve, që u reflektuan në sistemet e brendshme ligjore të shteteve anëtare të BE-së, duke bërë që ta adaptojë këto ndryshime në legjislacionet e tyre¹¹⁴ mbi konfiskimin e barrës së provës:

- Ndryshim në lidhje me “*të ardhurat*” dhe “*instrumentet*” në legjislacionet e Bullgarisë, Çekisë, Estonisë, Greqisë, Francës, Qipros, Finlandës.
- Ndryshim në lidhje me “*konfiskimin e bazuar në dënim*” në legjislacionet e Gjermanisë, Irlandës, Greqisë, Spanjës, Italisë, Letonisë, Austrisë, Polonisë, Portugalisë, Finlandës.
- Ndryshim në lidhje me “*konfiskimin pa bazë dënim*” në legjislacionet e Gjermanisë, Irlandës, Spanjës, Qipros, Letonisë, Maltës, Portugalisë, Finlandës, Suedisë.
- Ndryshim në lidhje me “*konfiskimin e zgjeruar dhe shtrirjen e krimeve për të cilat është zgjeruar konfiskimi*” në legjislacionet e Belgjikës, Çekisë, Estonisë, Irlandës, Greqisë, Spanjës, Italisë, Letonisë, Luksemburgut, Hungarisë, Polonisë, Portugalisë, Suedisë.
- Ndryshim në lidhje me “*konfiskimin nga palët e treta*” në legjislacionet e Estonisë, Irlandës, Greqisë, Qipros, Hungarisë, Polonisë, Portugalisë, Finlandës etj.
- Ndryshim në lidhje me “*masat mbrojtëse*” në ligjet e Spanjës, Francës, Letonisë, Portugalisë.

¹¹⁴ Report from the Commission to the European Parliament and the Council, Asset recovery and confiscation, European Commission, Brussels, 2.6.2020 COM (2020)217 final.

- Ndryshim në lidhje me “*ngrirjen*” në legjislacionet e Austrisë dhe Portugalisë
- Ndryshim në lidhje me “*ekzekutimi efektiv të urdhrave të konfiskimit*” në legjislacionet e Letonisë, Maltës, Austrisë, Portugalisë.
- Ndryshim në lidhje me “*administrimin e pronës së ngrirë e të konfiskuar*” në legjislacionin e Belgjikës, Bullgarisë, Çekisë, Greqisë, Francës, Kroacisë, Qipros, Letonisë, Maltës, Portugalisë, Rumanisë.

Zbatimi i kësaj Direktive është shembulli më i mirë i krijimit të një standardi të njëjtë në gjithë hapësirën ligjore të vendeve të BE-së, një shembull që duhet marrë nga Shqipëria si vend kandidat për në BE. Në zbatim të kësaj Direktive më tej u miratua Rregullorja (BE) 2018/1805 “*Për njohjen reciproke të Urdhrave të Ngrirjes dhe Konfiskimit, një gur themeli për bashkëpunim dhe efikasitet*”¹¹⁵. Kjo rregullore synon, që nëpërmjet konfiskimit të aseteve kriminale, të parandalojë krimin e në veçanti atë të organizuar, të sigurojë fonde shtesë për të investuar për zbatimin e ligjit dhe kompensimin e viktimave. Si bazë ligjore ka veprimet në fushën e njohjes të urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit me origjinë kriminale, sipas nenit 82, paragrafi 1 i TFEU (*Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian*). Bazohet në parimin e subsidiariteteit dhe proporcionalitetit, duke vënë theksin se mënyra më e mirë për të siguruar bashkëpunimin ndërkufitar për ngrirjen dhe kompensimin e aseteve, që rezultojnë nga aktivitetet kriminale është njohja reciproke e ndjekjes penale, të gjitha vendimet gjyqësore në çështjet penale, të marra në një vend të BE-së, normalisht, do të njihen dhe zbatohen menjëherë nga një vend tjetër i BE-së. Si akte të tjera me rëndësi për standardet janë dhe:

- Parimet e praktikave të mira të G8 “Për gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve”¹¹⁶ inkurajojnë shtetet që “...*të shqyrtojnë mundësinë e shtrirjes në masën që është në përputhje me parimet themelore të së drejtës së tyre të brendshme të konfiskimit nëpërmjet lejimit të konfiskimit pa dënim*”.¹¹⁷

¹¹⁵ Rregulloria 2018/1805 hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2020. Rregullorja është e disponueshme në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex:32018R1805>

¹¹⁶ The G8 Best Practice Principales on Tracing Freezing and Confiscation of assets (2004) paragraph. 26 The G8 Best Practice Principales on Tracing Freezing and Confiscation of assets (2004) paragraph. 26. Ky dokument është i disponueshëm në faqen elektronike: https://www.justice.gov/sites/default/files/ag/legacy/2004/06/03/G8_Best_Practices_on_Tracing.pdf

¹¹⁷ The Use of Non-Conviction Based Seizure and Confiscation, funded by the European Union and the Council of Europe, Council of Europe 2020. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/the-use-of-non-conviction-based-seizure-and-confiscation-2020/>

- Rekomandimi 4 i Task Forcës së Veprimit Financiar 2012, Rekomandimet e fundit të përditësuara në 2019¹¹⁸ rekomandon që “..vendet duhet të konsiderojnë marrjen e masave që lejojnë të ardhura të tilla ose instrumente që do të konfiskohen pa kërkuar një dënim penal jo të bazuar në një dënim penal) ose që kërkojnë që subjektet të demonstrojnë origjinën e ligjshme të pasurisë, që pretendohet se i nënshtrohet konfiskimit, në masën se një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet e ligjit të tyre të brendshëm”.

2.4. Modele të ndryshme ligjore të ligjeve mbi konfiskimet dhe zgjidhjet tipike mbi barrën e provës.

Në aspektin krahasimor Ligji Italian Antimafia¹¹⁹ dekret ligji nr. 159 i vitit 2011 i njohur si Kodi Antimafia dhe Masat Parandaluese¹²⁰ është ligji më dinamik, inovativ, nga i cili është marrë si model dhe ligji shqiptar. Studimi i këtij modeli ligjor është me rëndësi si për studiuesit ashtu dhe për gjyqtarët, prokurorët, avokatët pasi ka shërbyer si model dhe për ligjin shqiptar. Shumë çështje të interpretimit të ligjit tonë, ne i bazojmë në interpretimet që i janë bërë ligjit italian. Ligji italian antimafia e ka kaluar testin e ballafaqimit me kontrollin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe përbën një shembull të shkëlqyer të përshtatshmërisë së ligjit në kohë me qëllim balancimin e efektivitetit të procedimit pasuror me mbrojtjen e pasurisë së ligjshme të shtetasve nën frymën e procesit të rregullt ligjor, e kjo kryesisht nga interpretimi gjyqësor e praktika gjyqësore.

Masat parandaluese kundër pasurisë, të cilat janë futur në sistemin ligjor Italian në 1982 me anë të *ligjit Rognoni-La Torre*¹²¹, kanë përcaktuar një përmirësim të dukshëm në luftën kundër dimensionit ekonomik të krimit të organizuar. Forma tradicionale e konfiskimit sipas Kodit Penal

¹¹⁸ Recommendation 4 of the Financial Action Task Forces 2012, FATF Recommendations 2012. Rekomandimi është i disponueshëm në: www.fatf-gafi.org on 15 Octobre 2020.

¹¹⁹ Decreto legislativo 6 settembre 2011, n.159 Codice delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione, nonce nuove disposizione in materiali di documentazione antimafia, a norma degli articoli 1 e 2 della legge 13 agosto 2010, n. 136(G.U 28 settembre 2011, n. 226, testo aggiornato con la legge 17 ottobre 2017, n. 161)

¹²⁰ Dekreti Legjislativ 6 shtator 2011 n. 159, Kodi antimafia dhe masat parandaluese, (Gazeta Zyrtare e 28 shtator 2011 e Republikës së Italisë.

¹²¹ Ligji njihet si ligji Rognoni–La Torre në emër të iniciatorëve dhe hartuesve të tij.

Italian e konsideronte dimensionin ekonomik të krimit, thjesht në perspektivën individuale. Pasja e një dënimi ishte parakusht për konfiskimin e mjeteve të përdoruar për kryerjen e një krimi, për konfiskimin e objekteve të gjeneruara nga vepra, fitimit që rrjedh prej krimit e madje edhe të vlerës së fituar nga autori për kryerjen e një krimi. Duke qenë se kërkohej një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet të mirave që duhej të konfiskoheshin dhe veprës penale, asetet e pastruara dhe fitimet e pastruara nuk mund të konfiskoheshin. Akoma të tej, konfiskimi nuk mund të urdhërohej nëse asetet i përkisnin personave të tjerë veç të pandehurit dhe si rrjedhojë, pronat në pronësi të personave mbulues nuk mund të sulmoheshin.

Rregulli i ri i prezantuar nga *ligji Rognoni-La Torre* lejonte përdorimin e sekuestrimit dhe të konfiskimit si masa parandaluese kundër personave, për të cilët kishte dyshime se ishin pjesë e një organizate kriminale. Zhvillimet pasuese në përvojën gjyqësore italiane mund të përshkruhen si një kalim nga dyshimi tek prova dhe si një zbulim i dimensionit sistematik të krimit. Para ekzistencës së kësaj qasjeje, kishte dyshime lidhur me krimin e organizuar dhe procese gjyqësore që trajtonin çështje të ndara korrupsioni, mashtrimi ose të krimit financiar. Proceset gjyqësore që trajtonin krimin e organizuar nuk e përfshinin aspektet ekonomike dhe administrative dhe shpesh rezultojnë në dhënien e pafajësisë për shkak të mungesës së provave. Pika e kthimit u arrit në vitet tetëdhjetë të shek. XX kur gjyqtarët Rocco Chinnici, Giovanni Falcone dhe Paolo Borsellino, konceptuan një qasje të re të bazuar në përdorimin e hetimit financiar kundër krimit të organizuar. Për herë të parë, mafia, niveli i lartë i korrupsionit në sektorin publik dhe mashtrimi që ndikonte në buxhetin e shtetit dhe të Bashkimit Evropian, u ekzaminuan në mënyrë të përbashkët. Ato u konsideruan si pjesë përbërëse të së tërës dhe jo si fenomene kriminale të izoluar.

Niveli në rritje i sfidës kundër kriminalitetit u shoqërua nga një nivel në rritje i provave të mbledhura, përfshirë përgjimin e komunikimeve nën kontrollin gjyqësor dhe dëshmitë e “*bashkëpunëtorëve të drejtësisë*”, të testuara nga ballafaqimet në gjykatë. Për herë të parë, u mbledh një mozaik i plotë provash në “*gjyqin e madh*”, që pati një domethënie historike dhe u konsideruar nga Giovanni Falcone si prova se “*duke respektuar rregullat e demokracisë mund të arrijmë rezultate të rëndësishme kundër krimit të organizuar*”.¹²² Një tipar i rëndësishëm dhe i

¹²²Antonio Balsamo, referim në seminarin me temë “Konfiskimi nëpërmjet ligjit antimafia”, organizuar në Tiranë, nga PAMECA, 20 nëntor 2017,

vlerësuar i sistemit italian kundër aseteve të paligjshme, konsiston në ndërthurjen e dy aspekteve të efikasitetit dhe garancive në një marrëdhënie të ndërsjellë përforcuese, në përputhje me ide të përcaktuara që datojnë që në ndërtimin fillestar të ‘*ligjit kundër krimit të organizuar*’. Kjo mënyrë u lejon hetuesve krijimin e një sërë provash objektive, të dokumentuara dhe të pakundërshtueshme të cilat është shumë e vështirë të hidhen poshtë dhe që çojnë në konfirmimin e të dhënave që vijnë nga aktiviteti provues tradicional ¹²³.

Në Kodin Antimafia Italian masat parandaluese kundër pasurisë (*sequestro dhe confisca*) paraqesin një lidhje të ngushtë me masat kundër personit duke qënë se mund të jepen vetëm në lidhje me ata persona, të cilëve u zbatohet ose mund ose duhet t’u aplikohet masa personale. Sipas pikëpamjeve mbizotëruese, masat kundër pasurisë, në fakt, nuk bazohen ekskluzivisht në karakterin (*e jashtëligjshëm*) të aseteve të goditura duke qënë se nuk u drejtohen aseteve si pasuri, si pasojë e dyshimit të prejardhjes së paligjshme, por aseteve që futen në disponibilitetin e personave të rrezikshëm për shoqërinë e të tillë janë të dyshuarit për pjesëmarrje në grupe mafioze dhe të dyshuarit për vepra penale të rënda. ¹²⁴

Që një pasuri të mund të sekuestrohet ose konfiskohet, duhet që ndaj titullarit të pasurisë (*me disponibilitet të drejtpërdrejtë ose indirekt*) të zbatohet ose të jetë e zbatueshme masa kundër personit sepse ka krijuar aktivitete të jashtëligjshme që kanë lejuar, pikërisht, vënien e asaj pasurie. Edhe në qoftë se nuk është e mundur të zbatohet masa për ngjarje të ndryshme, është e mjaftueshme të verifikohet që ekzistonin mundësitë për zbatimin e masës kundër personit (*i ashtuquajtur zbatimi i ndarë*). Kjo ndodh kryesisht në rastet e mëposhtme:

- Vdekja gjatë procesit e personit ndaj të cilit duhet të merret kjo masë; që vazhdon ndaj trashëgimtarëve;
- Propozim për marrjen e kësaj mase, bërë pas pesë vitesh nga vdekja e personit (*kjo është parashikuar edhe në ligjin shqiptar*)
- Personi, ndaj të cilit nuk mund të zbatohet masa e ndalimit personal për arsye të ndryshme: nuk është më i rrezikshëm; e ka rezidencën jashtë shtetit, siç parashikohet edhe

¹²³ Stefano Finocchiaro, La confisca e il sequestro di prevenzione, Diritti Penale Contemporaneo.

¹²⁴ Balamo Antonio (2014) Codice antimafia, Digesto delle discipline penali, Agg. VIII, Torino, UTET, fq.34.

nga ligji ynë (*neni 22/2*); sepse kanë rëndësi masa të tjera. Masa e parandalimit është pushuar sepse është shlyer plotësisht.

Në ligjin shqiptar mungojnë masat ndaj personit, por rastet e zbatimit të sekuestrimit dhe konfiskimit, të parashikuar nga nenet 1 dhe 3, pika 1, të ligjit tonë për paranadlimin dhe goditjen e krimit të organizuar, i korrespondojnë kryesisht atyre të sekuestrimit dhe konfiskimit të parandalimit të ligjit Italian (*indicie për kryerjen e disa veprave penale të caktuara*). Normat në fuqi parashikojnë shumë hipoteza të zbatimit të masave të parandalimit kundër personave dhe për të gjitha mund të ndiqet një masë kundër pasurisë. Rastet më të zakonshme janë:

- Persona “*të rrezikshëm të zakonshëm*” që zakonisht merren me trafikë kriminale, pra jetojnë zakonisht edhe pjesërisht, me të ardhura nga aktivitetet kriminale. Mund edhe të mos kenë kryer kurrë vepra penale, por zakonisht kanë precedentë ose dënime për vepra penale “*të zakonshme*” (vjedhje, rrëmbim, mitmarje, pastrim parash, fajde, evazion fiskal, etj.) që janë kompetencë e Prokurorisë së Rrethit;
- *Të dyshuar* për përkatësi në një grup mafioz (*vepër penale e parashikuar në mënyrë të qartë në Kodin Penal italian*); vepër penale që është kompetencë e DDA;
- *Të dyshuar* për vepra penale të rënda, prandaj edhe të përcaktuara si kompetencë e Prokurorive Distriktuale Antimafie (DDA) (midis të cilave shoqatat që merren me trafikimin e substancave të drogërave, me trafikimin e jashtëligjshëm të mbeturinave, si dhe me veprat që lidhen me aktivitete mafioze);¹²⁵
- Persona të rrezikshëm sepse mund të bëjnë ose kanë krijuar “veprime permbyse”, zakonisht janë kompetencë e Prokurorisë së Distriktit.

Në Itali, konfiskimi dhe sekuestrimi ndaj personave sipas shkronjës “a” (*persona të rrezikshëm të zakonshëm jo të lidhur me mafian*) është lejuar duke filluar nga viti 2008. Është menduar, që për “*kriminelin e zakonshëm*” që krijon përfitime të jashtëligjshme, të krijohet një organ që kishte dhënë rezultate pozitive ndaj mafieve. Është deklaruar, që si princip, sekuestrimi dhe konfiskimi parandalues janë të përshtatshëm për të luftuar kriminalitetin që akumulon pasuri të paligjshme,

¹²⁵Sequestri penali, misure di prevenzione e procedure concorsuali. Alalisi dei rapporti alla luce del nuovo codice antimafa, aggiornato al D.Lgs.n.54/2018 sulle incompatibilità e al D.Lgs.n.72/2018 in materia di tutela del lavoro.

edhe nëse nuk është kriminalitet mafioz.¹²⁶ Prandaj, sot, në mënyrë analoge me ligjin shqiptar, sekuestrimi dhe konfiskimi parandalues në Itali zbatohen edhe ndaj personave të rrezikshëm që janë të dyshuar për kryerjen e “veprave penale të zakonshme” si vjedhje, pastrim parash, (që jo domosdoshmërisht është i lidhur me krime mafioze), etj. Qëllimi parandalues i masave të parandalimit, nënkupton që nuk mund të aplikohet masa e parandalimit kundër personit, nëse rrezikshmëria sociale nuk është aktuale: nëse rrezikshmëria nuk është aktuale, nuk ka asgjë për të parandaluar dhe nuk duhet bërë asnjë kontroll specifik. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur ka kaluar një kohë e gjatë nga periudha, në të cilën janë krijuar sjellje të jashtëligjshme. Në ligjin shqiptar, flitet për persona, për të cilët për vepra penale të caktuara “ekziston një dyshim i arsyeshëm, duke u bazuar në indicie”e që mund të zbatohen të njëjtat principe të përpunuara në Itali.¹²⁷ Masat e parandalimit ndaj personit konsistojnë:

- Në mbikqyrjen e veçantë të sigurisë publike, që u lejon autoriteteve të policisë për të bërë kontrolle ndaj personave;
- Në detyrimin për të qëndruar në komunën ku personi ka rezidencën. Largimi përbën një krim të rëndë.
- Në detyrimin për të respektuar shumë detyrime, disa veçanërisht të vështira¹²⁸, shkelja e të cilave përbën krim;
- Në derdhjen e një shume parash shtetit që konfiskohet në rast shkelje të detyrimeve. Mosderdhja e këtyre shumave përbën krim;
- Në disa kushte plotësuese si tërheqja e patentës, apo revokimi i licensave etj; Në përfitim të statusit të të mbikqyrurit të veçantë, që sjell rëndesë dënimi në rastin e kryerjes së disa veprave penale.

¹²⁶Menditto Francesco, Le misure di prevenzione e la confisca allargata (Milano, Giufree) (17 ottobre 2017, nr. 161)

¹²⁷Dekreti Legjislativ 6 shtator 2011 n. 159, Kodi antimafia dhe masat parandaluese

¹²⁸ Të jetosh në mënyrë të ndryshme, duke respektuar ligjet. Të përcaktojë banesën e vet, brenda afatit të pesëmbëdhjetë ditëve nga komunikimi i kësaj mase, në komunën ku banon, i detyruar që të mos e lejojë komunën. Të komunikojë vendin e banimit të zgjedhur në komunën e qëndrimit të detyruar, autoritetit lokal të sigurisë publike, Të mos ikë larg kësaj banese pa paralajmëruar paraprakisht autoritetin që duhet të bëjë mbikqyrjen, Të mos dalë nga kjo banesë para orës 7 dhe të mos kthehet pas orës 20, në periudhën që shkon nga 1 tetori e deri në mars, dhe respektivisht, para orës 6 dhe pas orës 21 në periudhën nga 1 prill e deri në 30 shtator, pa nevojë të provuar, dhe sidoqoftë pa lajmëruar në kohë autoritetin lokal të sigurisë publike, Të mos lidhet zakonisht me persona të dënuar ose të vënë nën masa të sigurisë apo parandalimit. Të fillojë kërkimin e një pune. Të mos ndalojë dhe as të mbajë me vete armë, Të mos marrë pjesë në mbledhje publike.

Sekuestrimi dhe konfiskimi.¹²⁹ Sekuestrimi përbën masën paraprake parandaluese, e ndërmarrë *inaudita altera parte* nga Gjykata, Seksioni i Masave Parandaluese, e përbërë nga tre gjyqtarë, me kërkesë të organit propozues, në bazë të rasteve në mënyrë të paevitueshme më pak të rëndësishme, në profilin material ose provues duke pasur parasysh mungesën e kundërshtimit, në lidhje me ato të nevojshme për konfiskimin e mëvonshëm. Asetet i hiqen atij që i ka në disponim, pronar i propozuar ose formal dhe që administrohen nga një ndihmës administratori gjyqësor, nën drejtimin e gjykatësit të deleguar të emëruar nga Gjykata.

Me konfiskim (kompetencë e të njëjtës gjykatë e përbërë nga tre gjyqtarë) verifikohet ekzistenca e rasteve, në kundërshtim me palët e interesuara dhe në rast pozitiv, merret vendimi për kalimin në pronësi në favor të shtetit. Ka ndryshime me ligjin shqiptar pasi në sistemin ligjor italian nuk lejohet përmbysja e barrës së provës, sepse do të shkelte një princip të Kushtetutës, por lejohen prezumimet. Kompetenca e kërkesës i përket: Prokurorit të Rajonit përkatës në Itali, për personat e dyshuar për vepra penale të lidhura me mafian dhe për krime të rënda (*më sipër shkronja a), b) dhe c)*); Prokurorit të Rrethit për personat e rrezikshëm të “zakonshëm” (*sipër shkronja a)*); Prokurorit Kombëtar Antimafie (*vetëm për masat kundër personit*); Kuestorit, Drejtorit të Drejtorisë Antimafia (*autoritete administrative*).¹³⁰ Ligji italian, si ai shqiptar, parashikon autonominë midis procedurës penale dhe asaj parandaluese, prandaj Prokurori ushtron në mënyrë autonome hetime penale (*duke zbatuar normat e ligjit mbi masat e parandalimit*).

Hetimet penale i japin shumë kompetenca prokurorit (*përgjime me autorizimin e gjykatësit, sekuestime, kontrolle, marrje në pyetje të dëshmitarëve etj.*). Janë të ndryshme kompetencat në procedurën parandaluese: janë të disiplinuar vetëm hetimet dokumentare (*pra në banka, dhomën e tregëtisë, regjistra të pasurisë së paluajtshme ose automjete, tek organizmat tatimore etj.*) dhe sekuestrimi i dokumenteve (*sipas neneve 6 dhe 9 të ligjit shqiptar*). Në fakt, edhe në procedurën parandaluese dëgjohen persona, bëhen verifikime në vend etj., por nuk mund të bëhen hetime “invazive” (*kontrolle në banesa, përgjime etj.*). Praktikisht, ekzistojnë shpesh në Prokurori dy

¹²⁹ Neni 24 i Dekretit Legjislativ 6 shtator 2011 n. 159, Kodi antimafia dhe masat parandaluese

¹³⁰ Decreto legislativo 6 settembre 2011, n.159 Codice delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione, nonche nuove disposizione in materiali di documentazione antimafia, a norma degli articoli 1 e 2 della legge 13 agosto 2010, n. 136(G.U 28 settembre 2011, n. 226, testo aggiornato con la legge 17 ottobre 2017, n. 161)

procedura, njëra penale dhe tjetra parandaluese, prandaj “kalojnë” akte të rëndësishme nga dosja e procedurës penale, në dosjen e procedurës së parandalimit.

Gjykata: kompetenca, “hetimet paraprake”, sekuestrimi. Kompetenca për zbatimin i përket një seksioni ose një trupi gjykues të zakonshëm, i quajtur seksioni për zbatimin e masave parandaluese; një organ i formuar në grup (tre anëtarë) dhe i specializuar. Në çdo gjykatë të zakonshme, me zyrë në provincë, ka gjyqtarë, të cilëve u atribuohet kjo kompetencë dhe që, njëkohësisht ushtrojnë edhe funksione të tjera, përgjithësisht penale (*rreth rasteve që mbeten në territore me ndikim të madh të organizatave kriminale*). Dhënia e kompetencës një trupi gjykues tregon profesionalizmin e veçantë që duhet në këtë sektor. Gjykata ka detyra udhëzuese dhe hetuese, kryesisht për hetimet ndaj pasurisë, duke përdorur edhe policinë gjyqësore. Për rezultatin e hetimeve eventuale, gjykata pa asnjë kundërshtim, mund të marrë vendim për sekuestrim të aseteve (*qoftë ndaj atyre për të cilat kërkesa është bërë, si dhe për ato asete të zbuluara gjatë hetimeve të bëra*), që zbatohet nga policia gjyqësore dhe nga përmbaruesi gjyqësor. Sekuestrimi i gjykatës kundërshtohet me një procedurë vetëm tek e njëjta gjykatë dhe pastaj me një ankim në Gjykatën e Lartë për shkelje të ligjit.

Seanca për konfiskim. Zbatimi i masave kundër personit dhe ajo e konfiskimit bëhet në përfundim të një seance të mbajtur nga e njëjta gjykatë, me pjesëmarrje e nevojshme e prokurorit dhe avokatit të personit nën hetim¹³¹. Në një rast të tillë, zbatohen dispozitat në lidhje me një rit të thjeshtëzuar në procedurën penale, për të zgjidhur çështje të ndryshme nga verifikimi i fajësisë së të pandehurit; thirren në seancë pronarët formalë të aseteve të sekuestruara, që të mund të mbrojnë veten e tyre; nuk është e detyrueshme asistenca e një mbrojtësi. Gjykata ka shumë kompetenca hetuese në seancë, mund të marrë dokumente, të dëgjojë dëshmitarë etj.

Marrëdhëniet dhe ndryshimet mes sekuestrimit/konfiskimit) të parandalimit dhe atij penal. Një nga dallimet është se këto dy lloje sekuestrimi/konfiskimi mund të zbatohen në mënyrë të pavarur procedura penale dhe ajo parandaluese (*siç është parashikuar nga neni 5, pika 1 e ligjit tonë*). Kjo do të thotë se, njëkohësisht, mund të ekzistojnë hetime penale dhe parandaluese të prokurorisë dhe rezultatet mund të kalojnë nga njëri tek tjetri. Pas modifikimit të bërë në ligjin italian në vitin 2011,

¹³¹ Neni 24 i Dekreti Legjislativ 6 shtator 2011 n. 159, Kodi antimafia dhe masat parandaluese

është përmbysur principi i mëparshëm. Sot ka përparësi masa (*sequestro dhe confiscajo përfundimtare*), e cila jepet në procedurën parandaluese, me pezullim (me të drejtë) të asaj penale (*sequestro ose confiscajo përfundimtare*). Zgjedhja e bërë në 2011-ën ka lindur nga eksperiencia, sipas së cilës, administrimi i aseteve në procedurën e parandalimit ishte më eficient, meqënëse drejtohej nga një gjykatës i specializuar; gjykatësi penal, nga ana tjetër, më i impenjuar në verifikimin e përgjegjësisë dhe në masat në çështjen e lirisë personale, ishte më pak i vëmendshëm për administrimin e aseteve “*duke lënë vetëm*” administratorin, duke rrezikuar një administrim jo efikas”.¹³²

Veçoria e gjykatësit të parandalimit në Itali, qëndron edhe në drejtimin e administrimit.¹³³ Në Itali, janë të shpeshta rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit penal sepse ekziston një normë, që është shumë e ngjashme me atë të sekuestrimit dhe konfiskimit parandalues. Në rastin kur procedohen veprat penale më të rënda, midis tyre “*edhe të mafias*” sekuestrohen dhe pastaj konfiskohen të gjitha asetet që janë në disponibilitet të drejtpërdrejtë ose indirekt të të hetuarit/dënuarit, me vlerë të shproporcionuar në lidhje me të ardhurat e deklaruara. Masa mbi sekuestrimin merret nga i njëjti gjykatës kompetent në procesin penal, pa kundërshtim dhe në bazë të kërkesës së prokurorit. Gjykatësi emëron administratorin dhe drejton administrimin. Masa mund të ankimohet tek një gjykatë e përbërë nga tre gjyqtarë me kompetenca të gjera rishikimi, pastaj mund të dërgohet në Gjykatën e Lartë për shkeljet e ligjit. I hetuari, për të patur revokim të masës së sekuestrimit, duhet të justifikojë prejardhjen e ligjshme. Pronarët formalë të aseteve, për të arritur rikthimin e pasurisë, duhet të ofrojnë elemente, që të justifikojnë disponibilitetin real të pasurisë (*pasuri të mjaftueshme për blerjet*). Sekuestrimi ndjek procedurën në fazat e ndryshme, përfshirë debatin publik, dhe në fund të procesit gjykatësi vendos për përgjegjësinë penale dhe në rast dënimi, mbi konfiskimin. Ligji italian parashikon mundësinë e apelimit dhe dërgimit të rastit në Gjykatën e Lartë.

Konfiskimi penal bëhet vetëm në rast dënimi të subjektit, i cili ka në disponibilitet asetet, kur masa e parandalimit, konfiskimi, është dhënë si rezultat i verifikimit direkt apo tërthorazi, të

¹³² Cfr. Balsamo A, Contrafatto V., Nicastro G, Lemisure patrimoniali contro la criminalità organizzata, Giuffrè, Milano 2010.

¹³³ Antonio Balsamo, referim në seminarin me temë “Konfiskimi nëpërmjet ligjit antimafia”, organizuar nga PAMECA, 20 nëntor 2017.

rrezikshmërisë së personit, pavarësisht nga përgjegjësia penale, edhe kur personi merr pafajësi. Pra, nëse për konfiskimin penal duhet një përgjegjësi e vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm¹³⁴, për konfiskimin e parandalimit është i mjaftueshëm verifikimi i kryerjes së atyre fakteve, që mund të konkludojnë rrezikshmërinë e personit edhe vetëm me referencë mundësinë e cilësuar (*indicie*) për kryerje të disa hipotezave kriminale, këtu përfshihet edhe përkatësia në një grup të strukturuar të llojit mafioz. Konfiskimi parandalues lejon të identifikohen pasuritë në disponim të personave, të cilët kanë ndërruar jetë gjatë një procedure, ku në procesin penal me shuarjen e veprës penale vazhdon kthimi i aseteve të sekuestruara dhe deri në pesë vite nga vdekja e personit mund të zbatohej masa e parandalimit. Meqënëse gjykatësi i parandalimit dhe ai penal, nuk ka asnjë kompetencë iniciative në mungesë të një kërkesë ose propozimi për sekuestrim, zgjedhja mbi masën që duhet të përdoret nëse ndodhin rastet e dy organeve, i jepet organit kompetent Prokurorisë, që të kërkojë masën.

Masat kundër pasurisë të ndryshme nga sekuestrimi dhe konfiskimi. Legjislacioni italian parashikon edhe masa të tjera, veçanërisht administrimi i aseteve të lidhura me veprimtari ekonomike. Kur ekzistojnë raste më pak të përcaktueshme, që do të thotë, kur aktiviteti sipërmarrës i personave, që nuk dyshohen për vepra penale, ndihmon në një farë mënyre persona të dyshuar për vepra të rënda, gjykata, me kërkesë të prokurorit ose të autoriteteve të tjera që mund të kërkojnë sekuestrim dhe konfiskim, mund të vendosë kontrollin ose sekuestrimin e ndërmarrjes për një periudhë të caktuar, duke emëruar një administrator. Nëse në përfundim të kësaj periudhe ka pushuar aktiviteti ndihmues, procedura mbyllet me kthimin e ndërmarrjes, në të kundërt merret masa për konfiskim. Pra, në themel, me këtë procedurë kërkohet të “*pastrohen*” ndërmarrje që sidoqoftë pësojnë efektin e mafias.

Interesat e të tretëve, që pretendojnë të drejta mbi asetet e sekuestruara ose të lidhura me këto të fundit¹³⁵. Në zbatimin e ligjit italian kanë lindur shumë çështje në lidhje me kreditorët, për shembull, banka titullare e hipotekës mbi pasurinë e paluajtshme të sekuestruar; kreditori ndaj ndërmarrjes së sekuestruar etj. Ligji atje njeh vetëm kreditë në mirëbesim nëpërmjet një procedure

¹³⁴Neni 533 e në vazhdim, Kodi i Procedurës Penale Italiane.

¹³⁵Neni 28 i Dekretit Legjislativ nr. 159 i vitit 2011, Kodi Antimafia dhe masat parandaluese.

të veçantë e cila është parashikuar kohët e fundit¹³⁶. Thelbi i legjislacionit italian përbëhet nga mundësia për të zbatuar sekuestrimin dhe konfiskimin, në mënyrë të pavarur nga dënimi, në kuadër të një procesi të “*thjeshtuar*” kundër pasurisë si një masë parandaluese. Këto procese Gjykata e Strasburgut i konsideron në mënyrë të përsëritur në përputhje me KEDNJ. Qëllimi i këtyre masave nuk është të ndëshkojë njerëzit duke konfiskuar pasuritë e tyre (*përndryshe, do të ishte një masë penale*). Qëllimi është të godasë pasuritë, që në mënyrë të paligjshme i vihen në dispozicion personave të rrezikshëm, në mënyrë të veçantë sepse ata dyshohen për krime të rënda, rrjedhimisht duke mos u vënë pasuri në dispozicion të tyre, duke parandaluar kryerjen e krimeve të tjera, të cilat mund të shtohen pikërisht nëpërmjet përdorimit të këtyre pasurive. Gjykata italiane e Kasacionit dhe Gjykata e Strasburgut kanë konfirmuar natyrën parandaluese të konfiskimit jondëshkues në Itali.¹³⁷

Legjislacioni i vendeve anglo - sanksone parashikon sistemin e konfiskimit të pasurive nëpërmjet masave, të cilat janë përkufizuar si *action in rem*, të cilat kryhen përmes mekanizmave të provës, janë më shumë civile sesa penale, qofshin këto të lidhura apo jo me hetimin e një vepre penale.¹³⁸ Në Mbretërinë e Bashkuar sekuestrimi civil mjafton të tregojë një shkak të mundshëm, një bazë të mjaftueshme për të konsideruar të mundshme blerjen e një pasurie me fitime të paligjshme, të mbështetur në elementët që nuk arrijnë nivelin e provës *në dukje (prima facie)*, diçka më shumë se një dyshim. Barra e provës zhvendoset tek pala mbrojtëse, e cila duhet të paraqesë elementët për të provuar paligjshmërinë e pasurisë në vepër penale ose që kjo pasuri i përket një pronari që nuk ka lidhje me to. Procedimi nuk diskuton përgjegjësinë e personit dhe gjykimi i konfiskimit të pasurisë bëhet bazuar në një rregull të së drejtës civile të rëndësës së provës, ku mbizotëron pala, e cila mund të mbështesë tezën e saj në një nivel më të lartë pranimi se sa hipoteza të tjera. Gjykata e Lartë e bazon këtë parim në parimin e së drejtës *common law* sipas së cilës rregulli përtej dyshimit

¹³⁶ Decreto legislativo 6 settembre 2011, n.159 Codice delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione, nonce nuove disposizione in material di documentazione antimafia, a norma degli articoli 1 e 2 della legge 13 agosto 2010, n. 136(G.U 28 settembre 2011, n. 226, testo aggiornato con la legge 17 ottobre 2017, n. 161.

¹³⁷ GJEDNJ sesioni. II, 5 janar 2010, Bongiorno e të tjerë kundër Italisë.

¹³⁸ Stolen Asset Recovery, A Good practices Guide for Non-Conviction Based asset Forfeiture, Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray, Stoeln Asset Recovery (STAR) Initiative 2009 The International Bank for Reconstruction and Development/The World Bank

të arsyeshëm zbatohet, në përgjithësi, vetëm për çështje të natyrës penale, që përfshijnë lirinë dhe jetën e personit.¹³⁹

Në Mbretërinë e Bashkuar konfiskimi vjen pas dënimit penal. Sipas ligjit përkatës që parashikon konfiskimin sipas sekuestrimit civil mjafton që akuza të tregojë në fillim një shkak të mundshëm (*që baza e arsyeshme për të konsideruar të mundshme blerjen e një pasurie me fitime të paligjshme, të mbështetur në elementet, që nuk arrijnë nivelin e provës (në dukje) prima facie, përbën diçka më shumë sesa vetëm një të dyshuar*) për të zhvendosur barrën e provës tek pala mbrojtëse, e cila duhet të paraqesë elementet për të provuar paligjshmërinë e pasurisë në një vepër penale, ose që kjo pasuri i përket një personi, që nuk ka lidhje me të.¹⁴⁰ Ky proces bazohet në procedurën civile dhe standardi i provës është ai i “*të dhënës së mundshme*”. Prokurori nuk është i detyruar të vërtetojë se subjekti është autor i ndonjë vepre penale. Procedimi nuk diskuton përgjegjësinë e personit dhe gjykimi i konfiskimit të pasurisë kryhet duke u bazuar në rregullat e së drejtës civile, të rëndësës së provave, ku mbizotëron pala, që mund të mbështesë tezën e saj me nivel më të lartë pranimi sesa hipoteza të tjera. Gjykata e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar e bazon këtë gjykim në parimet e së drejtës amerikane, sipas së cilës, rregulli përtej dyshimit të arsyeshëm zbatohet në përgjithësi vetëm në çështje me natyrë tepër kriminale, që përfshijnë jetën ose lirinë.¹⁴¹

Në Mbretërinë e Bashkuar është adaptuar konfiskimi civil si masë parandaluese. Akti për të Ardhurat nga Krimi është ligj i vitit 2002 dhe parashikon parimet dhe mënyrat sesi veprohet me konfiskimin e pasurisë së përfituar nga kriminaliteti. Ligji parashikon nxjerrjen e urdhërave të konfiskimit kundër individit të dënuar më përpara, rikuperimin civil të të ardhurave nga një veprim që nuk është dënuar, tatimin e fitimeve të krijuara nga krimi, kompetencat e hetimit për të ardhurat e dyshuara nga vepra penale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar e nga agjencitë e zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar kundër pastrimit të parave.¹⁴² Ligji është i ndarë në 12 pjesë, disa prej

¹³⁹L'actio in rem assurgit a modello di “confisca Europea” nel rispetto delle garanzie CEDU “Emendamenti della Commissione LIBE alla proposta di direttiva in materia di congelamento e confisca dei proventi del reato di Anna Maria Maugeri – Diritto penale contemporaneo

¹⁴⁰Proceeds of Crime Act 2002, mund të gjendet në <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2002/29/contents>

¹⁴¹Serious Organised Crime and Police Act 2005, the Serious Crime Act 2007 and the Serious Crime Act 2015, mund të gjendet në <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/9/contents>

¹⁴²Në thelb, përpara zbatimit të Aktit të 2002, një avokat procedues duhej të provonte se paratë ose asetet ishin produkte të krimit dhe gjithashtu, nga cili 'lloj' krimi vinin të ardhurat (*dmth. krimi i drogës ose krimi jo-drogë*).

të cilave zbatohen për të gjithë Mbretërinë e Bashkuar (si p.sh. Pjesa 7 që ka të bëjë me pastrimin e parave). Pjesë të tjera zbatohen vetëm për një juridiksion brenda Mbretërisë së Bashkuar (*kështu që Pjesa 2 lidhet me konfiskimin në Angli dhe Uells, Pjesa 3 lidhet me konfiskimin në Skoci, Pjesa 4 lidhet me konfiskimin në Irlandën e Veriut*).

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës njihet konfiskimi civil¹⁴³ i asetëve kriminale me anë të Aktit të Reformës për Konfiskimin e Pasurisë Civile, 2000.¹⁴⁴ Ky ligj njih procedurën e konfiskimit pasuror *in rem* me një barrë prove të ulët, ajo standarde civile e probabilitetit të faktit për vërtetimin e pasurisë së ligjshme, një procedurë, e cila mund të zbatohet edhe ndaj një personi në mungesë ose që nuk jeton më. Sipas këtij ligji, konfiskimi i pasurisë mund të bëhet vetëm pas dënimit të personit. Kryesisht, urdhrat e konfiskimit synojnë pasurinë e vendosur nga trafiket e narkotikëve, evazioni fiskal, kontrabandimi i mallrave etj.

2.5. Roli i institucioneve ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të produkteve të krimit, përfshirë bashkëpunimin dhe ndihma e ndërsjellë.

Një sërë normash e aktesh parashikojnë përgjegjësinë e institucioneve ndërkombëtare dhe atyre evropiane për zbatimin e këtyre insituteve të rëndësishme. Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të krimit, në kohën e një krimi të organizuar, që nuk njih kufinj, kërkon rol monitorues e mbikqyrës nga institucionet ndërkombëtare dhe veçanërisht, ato evropiane. Institucionet ndërkombëtare janë në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), atyre të Këshillit të Europës (KE) dhe të Bashkimit Europian (BE). Vendet perëndimore, të cilat nuk janë pjesë e Këshillit të Europës ose Bashkimit Europian si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada,

Akti i 2002 hoqi nevojën për të bërë një dallim midis këtyre llojeve si burim i të ardhurave në lidhje me pastrimin e parave të supozuara në MB që filloi pas 24 shkurtit 2003.

¹⁴³ Civil Asset Forfeiture Reform Act, 2000

¹⁴⁴ Stolen Asset Recovery, A Good practices Guide for Non – Conviction Based asset Forfeiture, Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray, Stolen Asset Recovery (STAR) Initiative 2009 The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank

Australia, Zelanda e Re etj. kanë gjetur instrumente bashkëpunimi në kuadër të marrëveshjeve dy palëshe me qëllim bashkëpunimin, ndihmën e ndërsjelltë dhe veprime të tjera të përbashkëta.¹⁴⁵

Në nivel të OKB-së monitorimin e zbatimit të Konventës së OKB kundër Krimit të Organizuar dhe asaj kundër drogave¹⁴⁶ hartohen raporte periodike monitoruese mbi konfiskimin e produkteve të krimit të organizuar dhe atyre që përfitohen nga trafiku i narkotikëve në nivel botëror. Interpol, Banka Botërore dhe UNODC ndihmojnë këtë zyrë në hartimin e raporteve të monitorimit dhe mbledhjen e informacionit. Një numër organizatash dhe projektsh ndërkombëtare janë krijuar me qëllim arritjen e rezultateve konkrete për konfiskimin e të ardhurave nga krimi e ndaj veprave penale të krimit të organizuar, pastrimit të parave e korrupsionit.¹⁴⁷ Si të tilla janë :

- Konventa e Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për Luftimin e Rryshfetit të Zyrtarëve Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit;
- Iniciativa e Përbashkët e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin UNODC/Banka Botërore Rimëkëmbja e Aseteve të Vjedhura;
- Task Forca e Veprimit Financiar (FATF), që është dhe organi kryesor financiar ndërkombëtar, i cili merret me luftën kundër pastrimit të parave dhe kërcënimeve të tjera ndaj integritetit të sistemit financiar;
- Moneyval – organ i Këshillit të Europës që vlerëson standardet e përputhshmërisë me LPP/LFP;
- Grupi EGMONT i Njësisë së Inteligjencës Financiare.

Institucionet evropiane, që monitorojnë e zbatojnë rregullat e direktivave dhe akteve të tjera evropiane për konfiskimet janë: Këshilli Evropian, Komisioni Evropian, Qeveritë e Shteteve Anëtare të BE, EuroJust, Frontex, CEPOL, OLAF, COSI, Banka Evropiane e Investimeve, Këshilli i Evropës, OECD, Interpol etj. Gjithashtu, si institucione monitoruese janë:

1. GRECO (*Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit*) është krijuar në vitin 1999 nga Këshilli i Evropës për të monitoruar pajtueshmërinë e shteteve anëtare me standardet antikorrupsion

¹⁴⁵ Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Rikuperimi dhe konfiskimi i pasurisë, Bruksel, 2.6.2020, COM (2020)217 finale

¹⁴⁶ Résolution adoptée par l'Assemblée générale sans renvoi à une grande commission (A/55/383) 55/25. Convention des Nations Unies contre la criminalité transnationale organisée mund të gjendet në <https://www.unodc.org/pdf/crime/>

¹⁴⁷ J.C:Sharman, The Money Laundry, Regulating Criminal Finance in the Global Economy (Cornell Studies in Political Economy) Cornell university Press, I 1st (October 15, 2011)

të organizatës dhe që monitoron respektimin e parimeve udhëheqëse për luftën kundër korrupsionit¹⁴⁸. Disa nga këto parime janë përqendruar në identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga korrupsioni, parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit në administratën publike, ndër të cilat, në veçanti, *parimi 4* që parashikon të ofrojë masat e duhura për sekuestrimin dhe provimin se të ardhurat janë nga korrupsioni.

2. MONEYVAL (*Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit*) është organ tjetër monitorues i përhershëm i Këshillit të Evropës, të cilit i është besuar detyra e vlerësimit të pajtueshmërisë me standardet kryesore ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Si Instrumente të Bashkimit Evropian janë ato të parashikuara nga Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, duke i dhënë kështu BE-së kompetenca legislative për rregullimin e fushës së konfiskimit pasuror, duke harmonizuar veprimin mes shteteve anëtare të BE.

Në Vendimin Kornizë të vitit 2005¹⁴⁹ parashikohet “konfiskimi i zgjeruar”, njohur ndryshe edhe si konfiskimi i posaçëm, i cili mundëson konfiskimin e pasurisë ku përfshihen jo vetëm asetet nga vepra penale, për të cilën po zhvillohet çështja penale konkrete por çdo produkt tjetër që supozohet se është nxjerrë nga e njëjta vepër penale ose nga vepra të tjera, që i kanë paraprirë asaj, ose që përkojnë me të.

Bashkëpunimi ndërshtetëror dhe ndihma e ndërsjellë. Në nivel ndërkombëtar, bëhet gjithmonë e më urgjente nevoja për të njohur instrumente të përbashkëta të luftës ndaj grumbullimit të paligjshëm të pasurive dhe për të lejuar zbatimin në shtetet e ndryshme, në praninë e një kriminaliteti, i cili, gjithmonë e më shpesh, vepron në nivel ndërkombëtar e transnacional.¹⁵⁰ Në këtë vazhdë, është edhe vendimi i datës 25 Tetor 2011 i Parlamentit Evropian, i cili synon të vlerësojë instrumentin e masave ndaj pasurisë. Nga Komisioni Evropian u propozua prezantimi i një direktive kuadër mbi procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit të përfitimeve të krimit, me përpunim të normave, që të lejojnë përdorimin efikas të instrumenteve, siç janë “konfiskimi në

¹⁴⁸ Parimet udhëheqëse, miratuar në vitin 1997 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës.

¹⁴⁹ Neni 3 I Vendimit Kornizë 2005/202/JHA

¹⁵⁰ L’actio in rem assurgit a modello di “confisca Europea” nel rispetto delle garanzie CEDU “Emendamenti della Commissione LIBE alla proposta di direttiva in materia di congelamento e confisca dei proventi del reato di Anna Maria Maugeri – Diritto penale contemporaneo

muntesë të dënimit”, me theksimin e barrës së provës mbi origjinën e aseteve, që kanë në posedim personat e dënuar ose të pandehur për vepra penale, të lidhura me krimin e organizuar dhe me konfiskimin, në rast të regjistrimit të aseteve në emër të të tretëve (*pika 8*), që duket se ngjason me eksperiencën italiane të masave parandaluese kundër pasurisë.

Komisioni Europian, më datë 12 mars 2012 paraqiti propozimin për direktivën “*në lidhje me bllokimin dhe konfiskimin e përfitimeve nga veprat penale në Bashkimin Europian*”, e cila synon të luftojë veprimtaritë e krimit të organizuar, duke i hequr përfitimet në nivel transnacional. Komisioni sugjeron, midis shumë opsioneve, futjen e një “*konfiskimi jo të bazuar në dënim*” i njohur si i ligjshëm nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, me garanci të përshtatshme procedurale, në respektim të principit të proporcionalitetit. Për Komisionin, “*impakti i këtij opsioni mbi sjelljet kriminale do të ishte domethënëse, sepse konfiskimi, i cili nuk bazohet në dënim (edhe në rrethana të kufizuara) dhe konfiskimi ndaj të tretëve, do të detyronin kriminelët që të ndryshonin praktikën e tyre dhe do të bënin më të vështirë fsheljen e aseteve*”¹⁵¹.

Në lidhje me konfiskimin, vështirësitë e përafrimit dhe të standardizimit janë të tilla, që e bëjnë tejet të vështirë ecjen përpara të së drejtës ndërkombëtare në këtë fushë. Instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar, në raste të veçanta kanë qenë të hershme. Në Marrëveshjen e ndihmës së ndërsjellët në fushën penale mes Shqipërisë e Italisë në vitin 2002,¹⁵² për shembull, perspektivat përmbledheshin në përkufizimin e marrëveshjes (neni 18), sipas të cilit “*në bazë të procedurave gjyqësore të parashikuara nga ligjet e Shtetit të kërkuar, ky i fundit do të ketë të drejtë të urdhërojë konfiskimin në favor të Shtetit kërkuar të pasurive të sekuestruara në zbatim të 2 të këtij neni*”. Shkëmbimi i ratifikimeve të Marrëveshjes u shoqërua nga ai i shënimeve, përmes të cilave dy Shtetet njihnin mundësinë për ta kushtëzuar efikasitetin e dispozitave në lidhje me konfiskimin, me futjen e normave të nevojshme kombëtare zbatuese.

¹⁵¹ Brussels, 12.3.2012 COM(2012) 85 final 2012/0036 (COD) Proposal for a Directive of the European Parliament and the Council on the freezing and confiscation of proceeds of crime in the European Union {SĚD(2012) 31 final} {SĚD(2012) 32 final} <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0085:FIN:EN:PDF>

¹⁵² Marrëveshja e ndihmës së ndërsjellët në fushën penale mes Shqipërisë e Italisë në vitin 2002, neni 18 “*në bazë të procedurave gjyqësore të parashikuara nga ligjet e Shtetit të kërkuar, ky i fundit do të ketë të drejtë të urdhërojë konfiskimin në favor të Shtetit kërkuar të pasurive të sekuestruara në zbatim të pikes 2 të këtij neni.*”

Më 6 qershor 2003, SH.B.A dhe Bashkimi Evropian kanë lidhur një marrëveshje mbi ndihmën e ndërsjellët juridike¹⁵³, e cila dikton parashikime të reja dhe novatore në lidhje me verifikimet bankare dhe me skuadrat hetimore të përbashkëta, por në të nuk thuhet asgjë domethënëse në lidhje me konfiskimin. Ndërkohë, SH.B.A-të kanë ndryshuar thellësisht legjislacionin e tyre të brendshëm dhe, bashkë me të, edhe kuadrin e mundësive të konfiskimit të pasurive, që gjenden aty dhe që jepen nga autoritetet gjyqësore të shteteve të tjera. Duke filluar nga “*Money Laundering Act*” të vitit 1986 u fut, në fakt, mundësia për të sekuestruar dhe konfiskuar fitimet e një krimi lidhur me trafiqet e drogës, të kryera në dëm të një shteti të huaj, përmes një procedimi të posaçëm *in rem*, pra në bazë të vendimeve të një gjykate, të marra në bazë të bindjes për të provuar lidhjen e pasurisë me një vepër krimi, por pavarësisht nga përgjegjësia e mbajtësit dhe nga dënimi i autorit të krimit.

Megjithatë, përtej kësaj mundësie ligjet federale mbi “*civil forfeitures*” nuk ishin të zbatueshme dhe gjendeshin shpesh përballë kërkesës për ndihmë juridike të Shteteve të tjera, për të vendosur një procedurë të së drejtës së brendshme, që ka për qëllim përmbushjen e një letërporosie dhe ku bashkoheshin elementet e faktit që qëndrojnë në themel të vendimit të gjyqtarit të huaj. Një nga qëllimet e standardizimit të normës ndërkombëtare e reflektimit të tyre në legjislacionet e vendeve të ndryshme ka qenë pikërisht ai i dhënies së bazave ligjore të brendshme për bashkëpunimin ndërkombëtar, në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin.¹⁵⁴

Nëse një person akuzohet në një Shtet të huaj për kryerje veprash, që do të justifikonin sekuestrimin dhe konfiskimin në SH.B.A, Ministria e Drejtësisë e SHBA-ve mund të kërkojë përpara gjyqtarit federal apo përpara gjyqtarit të rrethit, në të cilin ndodhet pasuria e dyshuar, një urdhër sekuestrore konservative, që do të ruante disponibilitetin mbi të për 30 ditë,¹⁵⁵ me përjashtim të rastit kur ka shtyrje të mëtejshme të justifikuara nga nevoja për të marrë jashtë vendit provat e përshtatshme për të mbështetur një vendim konfiskimi sipas ligjeve të brendshme.

¹⁵³ Marrëveshja mes SH.B.A dhe Bashkimi Evropian “Mbi ndihmën e ndërsjellët juridike”, 6 qershor 2003, Agreement on mutual legal assistance between the European Union and the United States of America <https://eur-lex.europa.eu/legal>

¹⁵⁴ Civil Asset Forfeitures Reform Act, 106-185-april, 25 2000 mund të gjendet në <https://www.congress.gov>

¹⁵⁵ J.C:Sharman, The Money Laundry, Regulating Criminal Finance in the Global Economy (*Cornell Studies in Political Economy*) Cornell university Press, I 1st (October 15, 2011), faqe 56.

Në lidhje me nocionin e të tretit, në mirëbesim ose të administrimit të pasurive të sekuestruara, në përgjithësi, sistemi i “*civil forfeitures*” paraqet shumë interes për perspektivën e politikës penale të Shteteve të tjera, duke përfaqësuar një model interesant ndëshkues, i cili shkëputet nga garancitë tradicionale të së drejtës penale. Përvoja e marrëdhënieve të bashkëpunimit sheh në fakt të zhvillohen gjithnjë e më shumë jo vetëm shkëmbimi spontan i informacioneve, por edhe adoptimi i instrumenteve të rinj/*extra ordinem*, që priren të racionalizojnë dhe nxisin ato kanale të shkëmbimit të informacioneve, si në rastin e protokolleve të bashkëpunimit të lidhura nga organet e procedimit me autoritetet qendrore të shumë Shteteve extra-evropiane.

Veprimet e mirëfillta të bashkëpunimit janë ato mbi letër-porositë. Në këtë hapësirë bashkëpunimi ne jemi me vendet anëtare të Këshillit të Evropës që nuk janë vende anëtare të Bashkimit Evropian. Bëhet fjalë për një hapësirë bashkëpunimi me pak e ngjeshur se ai i Bashkimit, që tashmë shtrihet drejt parimit të njohjes së ndërsjellët të vendimeve gjyqësore dhe integritetit të strukturave ndëshkuese.

Shteteve jo anëtare të BE kanë aderuar në disa prej Konventave.¹⁵⁶ Konventa të tjera, për nga rëndësia që kanë, ndihmojnë të sjellin një lloj modeli universal për zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare të Konventave. Brenda Bashkimit Evropian, risitë ligjore konceptohen si instrumente plotësues të Konventës mëmë të Këshillit të Evropës (*nga ana tjetër duhet thënë në lidhje me marrëdhëniet mes konventave për ekstradimin lidhur nga Shtetet BE në vitin 1995 dhe në vitin 1997 kundrejt Konventës së Përgjithshme mbi ekstradimin, e Këshillit të Evropës*). Problematika e perspektivave të bashkëpunimit që kanë për qëllim heqjen përfundimtare të disponibilitetit të të mirave që lidhen me krimin, sidoqoftë nuk mund të fshehin rëndësinë e përparimeve të arritura. Momenti kyç qëndron pikërisht në Konventën e Këshillit të Evropës për pastrimin e parave, kërkimin, sekuestrimin, dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Pritshmërive që mbështeten në zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin e parave, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, firmosur në 8 nëntor 1990, në hyrje të së cilës objektivi kryesor i “*priver le delinquant des produits dy crime*” tregohet

¹⁵⁶Rasti i Konventës së Strasburgut mbi pastrimin e parave, në të cilën kanë aderuar, për shembull, Kanadaja dhe Meksika.

si qëllimi dhe njëkohësisht si metoda më moderne dhe efikase e luftës kundër kriminalitetit të organizuar. Kështu për herë të parë vjen përkufizimi i një tërësie rregullash instrumentale për ndërtimin e një sistemi të bashkëpunimit ndërkombëtar që mbështetet në një parim të kërimit të efektivitetit të veprimtarisë së ndëshkimit penal dhe të hapur ndaj anëtarësimit edhe të Shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës.

Rëndësia e Konventës në fjalë shfaqet, sidomos, duke vërejtur risinë e nocionit të “sekuestros” të pranuar nga shtetet kontraktuese, që në dritën e perspektivës së konfiskimit shtrihet në të ardhurat nga krimi dhe nuk kufizohet më me sendet që i përkasin krimi, siç parashikohej nga Konventa Evropiane mbi ndihmën gjyqësore në fushën penale¹⁵⁷, e vitit 1959. Në Konventën e Vjenës¹⁵⁸ shfaqet një sistem bashkëpunimi, i cili nuk kufizohet me kërkimin e mjeteve të krimi, por që shtrihet në të ardhurat e krimeve, që janë kryesisht në gjendje të sjellin fitime dhe procese të një grumbullimi të mëtejshëm parash të paligjshme.

Në vlerësimin tim, një sistem, që mbështetet në idenë se priret drejt detyrimit të dhënies së ndihmës, jo vetëm gjyqësore, por edhe administrative dhe të policisë, e cila nxit shkëmbimin spontan të informacioneve dhe që i jep jetë koordinimit investigues, që mund të bëhet në këtë fushë, është e ardhmja e bashkëpunimit. Pasi vështirësitë në rastin e bashkëpunimit të shteteve, të cilat nuk janë anëtarë të BE-së apo më gjerë siç është edhe Shqipëria na nxjerrin në një përfundim të tillë.

Konventa e Strasburgut¹⁵⁹ përbën ende sot një bazë më të gjerë e të fuqishme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e hetimeve ekonomike, të sekuestrimit dhe konfiskimit. Ajo është bërthama rreth së cilës është organizuar kërkitimi i mëtejshëm i instrumenteve të rinj dhe efikase. Vetëm në kuadrin e Bashkimit Evropian, në vitet pas Planit të Veprimit kundër krimi të

¹⁵⁷Konventa Evropiane mbi ndihmën gjyqësore në fushën penale, e vitit 1959 (neni 3, I C. E.A.G.) përshkruan letërporsinë si të drejtpërdrejtë, përveçse në njoftime, në “kryerjen e akteve përgatitore” dhe në “përcjelljen e provës së krimi”

¹⁵⁸ E quajtur ndryshe dhe Konventa e Vjenës 1988, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8722 datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope.”

¹⁵⁹, E miratuar me ligjin nr. 9646 datë 20.07.2000 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimi”

organizuar, adoptuar nga Këshilli i Evropës në Amsterdam më 16-17 qershor 1997, u vijua gjatë viteve të fundit me miratimin e:

- Ndërhyrjes së përbashkët të datës 3 dhjetor 1998 mbi pastrimin e parave dhe gjetjen, zbulimin, ngrirjen apo sekuestrimin e konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi,
- Vendimit Kuadër të Këshillit të datës 26 qershor 2001 në lidhje me po këtë fushë,
- Konventës mbi ndihmën gjyqësore në fushën penale të 29 majit 2000
- dispozitave specifike në lidhje me verifikimet e pasurisë në fushën e hetimeve financiare dhe bankare, që përmban Protokolli shtesë i Konventës së Bashkimit Evropian për ndihmën gjyqësore në fushën penale të datës 22 maj 2000 adoptuar nga Këshilli Evropës më 16 nëntor 2001,
- Vendimi Kuadër i datës 22 korrik 2003 lidhur me ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave të bllokimit të të mirave dhe të sekuestrimit për efekt prove.

Përgjithësisht, Konventa shprehet me kujdes mbi shtrirjen e kompetencave të Bashkimit, por jo në rastin e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme. Bashkimi Evropian duhet të luajë një rol të veçantë për çështjet si bashkëpunimi gjyqësor dhe ai i policisë, mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit, mbrojtjen e kufijve, emigracionin dhe politikën e strehimit.¹⁶⁰ Mungesa e këtyre akteve do e bënte të vështirë zbatimin efektiv të parimit të njohjes së ndërsjellët të vendimeve dhe dekreteve gjyqësore si themel i bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale, por edhe në perspektivat e nevojshme të përafrimit të normativave substanciale dhe procedurale. Zbatimi i parimit të njohjes së ndërsjellët të vendimeve gjyqësore nuk mund të zhvillohet vetëm në drejtimin e përkufizimit të normave procedurale të nevojshme, për të siguruar zbatimin në territorin e një shteti anëtar të vendimeve gjyqësore, të marra nga autoritete të një tjetër shteti anëtar.¹⁶¹

Një perspektivë e integritetit të legjislacionit është thelbësore për funksionimin e një sistemi të bashkëpunimit, që mbështetet në parimin e njohjes së ndërsjellët, meqë vetëm zgjerimi i grupit të rregullave të së drejtës substanciale dhe procedurale të përbashkëta bën të mundur përdorimin e

¹⁶⁰ Report from the Commission to the European Parliament and the Council, Asset recovery and confiscation, European Commission, Brussels, 2.6.2020 COM (2020)217 final. www.eu.org

¹⁶¹ Po aty, fq.

besimit konkret drejt sistemeve të tjera juridike, që qëndrojnë në bazë të parimit të njohjes së ndërsjellët të vendimeve gjyqësore.¹⁶² Një vështirësi që ka Shqipëria lidhet me procesin e njohjes së vendimeve penale të huaja me vendet e Këshillit të Europës, me të cilat nuk kemi marrëveshje dypalëshe.

2.6. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe reflektimi i tyre në praktikën e zbatimit të ligjit në nivel kombëtar e ndërkombëtar. *(Masat parandaluese kundër pasurive vis-à-vis të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut)*

Konfiskimi pasuror është një institut i së drejtës ndërkombëtare, i cili lindi pas miratimit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, jurisprudenca dhe praktika e GJEDNJ nuk kanë shmangur trajtimin e ankesave ndaj çështjeve të zbatimit të konfiskimit si mjet parandalues pasuror.

GJEDNJ, thekson se procedimet *in rem*, që nuk lidhen me gjetjen apo ndëshkimin e autorit, nuk mbulohen nga paragrafi 3 i Nenit 6 të KEDNJ, që ka të bëjë me të drejtat e personave të akuzuar për një veprë penale, por vetëm nga paragrafi i parë i këtij neni, e drejta për një proces të rregullt ligjor.¹⁶³ Prandaj, tashmë, modelet e konfiskimit pasuruar në vendet anëtare të BE-së ndjekin parimet e procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 1 të Protokollit shtesë nr. 1 të Konventës¹⁶⁴ çdo person fizik e juridik ka të drejtën e gëzimit të lirë të pasurisë. Neni 1 Protokollit 1i imponon shtetit detyrimin negativ ashtu dhe atë pozitiv për të mbrojtur posedimin e pasurisë. Megjithatë, GJEDNJ e njeh të drejtën e shtetit për ta konfiskuar pasurinë e individëve apo të personave juridikë brenda kushteve të caktuara e të parashikuara në nenin 1 të Protokollit nr. 1. Në mënyrë specifike, çdo ndërhyrje duhet të jetë në pajtueshmëri me interesin publik.

¹⁶²Impact Study on Civil Forfeiture, project Criminal assets Recovery in Serbia, publisher Council of Europe, 2013,

¹⁶³Çështja Brems, Vendimi i GJEDNJ 2005. <https://hudoc.echr.coe.int/>

¹⁶⁴“Personi fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ata i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

Për të hyrë në fushën e veprimit të Konventës e nën mbrojtjen e saj, individit duhet ta posedojë pronën në kuptimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1. Është me rëndësi që ky pretendim të bazohet në të drejtën e brendshme dhe është detyrim i parashtruesit të ankesës të vërtetojë natyrën e saktë të së drejtës së tij në të drejtën e brendshme. Në çështjen Novikov kundër Rusisë¹⁶⁵ GJEDNJ ka vënë re se “...kërkuesi kishte pretendime mbi karburantin e sekuestruar nga policia ruse si objekt krimi, sepse ai ishte përfutur i një marrëveshje transferimi lidhur me karburantin, e cila ishte e zbatueshme sipas ligjit rus. Për t’u pranuar si posedim çdo e drejtë/prendim mbi pronën në të ardhmen duhet të jetë pjesë e fushës së veprimit të pretendimit të ligjshëm ose të pritshmërisë legjitime. Pritshmëria legjitime është e zbatueshme sipas së drejtës së brendshme dhe konsiderohet si një pasuri për qëllime të nenit 1 të Protokollit nr. 1”.

Këtë qëndrim ka mbajtur GJEDNJ, në çështjen Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë,¹⁶⁶ rasti ku një personi i ishte konfiskuar gjithë pasuria si i dënues për tradhti, kur shprehet se “...e drejta e brendshme parashikonte pronësi të përbashkët mbi pasuritë e fituar nga bashkëshortët në martesë, prandaj bashkëshortja kishte pritshmëri legjitime ndaj një pjesë të pasurisë familjare që ishte e barabartë me atë të bashkëshortit të vet.”

Ndërhyrja në gëzimin e pasurisë e mbrojtur nga neni 1 i Protokollit shtesë nr. 1 të Konventës lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në paragrafin 2,¹⁶⁷ duke iu caktuar shteteve të drejtën për të miratuar “ligjet e mëvonshme për të vendosur përdorimin e të drejtës së pronës, duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm”, i cili përfshin nevojën për të parandaluar “përdorimin e paligjshëm dhe të rrezikshëm të mallrave, të cilave u është treguar origjina e paligjshme”. Ndërhyrja konsiderohet proporcionale me qëllimin e ligjshëm të ndjekur, të përfaqësuar nga një politikë penale parandaluese, për zbatimin e së cilës ligjvënësia duhet të jepte hapësirë të gjerë manovrimi duke iu referuar ekzistencës së një problemi të interesit publik dhe përzgjedhjes së mekanizmave të zbatimit.¹⁶⁸

¹⁶⁵ GJEDNJ, Novikov kundër Rusisë, nr. Vendimi 13067 datë 11 korrik 2013 <https://hudoc.echr.coe>

¹⁶⁶ GJEDNJ, Denisova § Moiseyeva kundër Rusisë, Vendimi i datës 4 tetor 2012 i GJEDNJ, <https://hudoc.echr.coe>

¹⁶⁷ Protokoll shtesë i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, neni 1 paragrafi 2 parashikon: “Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

¹⁶⁸ Vendimi Arcuri kundër Italisë, Vendimi 5 qershor 2001, no. 20176/87, GJEDNJ, <https://rm.coe.int>

GJEDNJ përjashton shkelje të nenit 4 të Protokollit shtesë nr. 7 të Konventës në lidhje me shkeljen e parimit *ne bis in idem*, sepse masat parandaluese nuk nënkuptojnë një gjykim në lidhje me fajësinë penale, ndërsa synojnë të parandalojnë kryerjen e veprave dhe veprimtarive penale. Në vitin 2015, GJEDNJ konfirmoi edhe respektimin e Konventës për masa të tjera parandaluese kundër pasurisë të përcaktuara dhe të vendosura në shtete të tjera (*edhe pse të cilësuar si action in rem*) duke rikujtuar të njëjtat parime dhe arsyetim të përdorur në vendimet e dhëna ashtu si masat parandaluese në Itali.¹⁶⁹

Rëndësi të veçantë paraqesin masat parandaluese të konfiskimit, konfiskimi i zgjeruar, rregullat e ripërdorimit të pasurive të konfiskuara për qëllime sociale, veprimet e ndërmarra nga agjencitë investiguese.¹⁷⁰ Rezultatet me masat parandaluese në vendet e BE-së, janë arritur përmes sistemit gjyqësor dhe disponimit të një sërë provash, të cilat, për pjesën më të madhe, kanë marrë vlerësime pozitive nga GJEDNJ bazuar në faktin e mirëqenë që konfiskimi parandalues vlerësohet nga shtetet, të cilat detyrohen të rregullojnë përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm, në mënyrë të veçantë në kuadër të politikave penale, që synojnë të luftojnë fenomenin e krimit të organizuar.

GJEDNJ-ja në çështjen Denisova § Moiseyeva¹⁷¹ (4 tetor 2012) është shprehur se: “*kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nenit 1 të Protokollit nr. 1 është se çdo ndërhyrje nga autoriteti publik në gëzimin e pasurisë duhet të jetë “e ligjshme”: paragrafi i dytë pranon se Shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë përdorimin e pronës duke zbatuar “ligje”. Çështja, nëse një ekuilibër i drejtë ka qenë i vendosur midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit, bëhet e rëndësishme kur ndërhyrja në fjalë përmbush kërkesat e ligjshmërisë dhe nuk është arbitrare”*.¹⁷²

¹⁶⁹ GJEDNJ, 12 maj 2015, Gogidze dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë, që vlerëson legjislacionin kombëtar të ngjashëm me atë që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me “*individët e dyshuar seriozisht për korrupsion*”

¹⁷⁰ Rezoluta e Parlamentit Europian e datës 23 tetor 2013 për krimin e organizuar, korrupsionin dhe pastrimin e parave, dhe në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar përmes goditjes së të ardhurave dhe pasurisë së krijuar nga aktiviteti kriminal”.

¹⁷¹ Çështja Denisova § Moiseyeva kundër Rusisë, Vendimi i datës 4 tetor 2012 i GJEDNJ. idem

¹⁷² Baklanov kundër Rusisë, nr. 68443/01, § 39, 9 qershor 2005 dhe Frizen kundër Rusisë, nr. 58254/00/mars 2005.

GJEDNJ, thekson se procedimet *in rem*, që nuk lidhen me gjetjen ose ndëshkimin e autorit, nuk mbulohet nga paragrafi 3 i Nenit 6 të KEDNJ, i cili ka të bëjë me të drejtat e personave të akuzuar për një vepër penale, por vetëm nga paragrafi i parë i këtij neni, e drejta për një proces të rregullt ligjor.¹⁷³ Sekuestrimet janë konsideruar vendime jo përfundimtare, për të cilat Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), lidhur me zbatimin e nenit 6 të Konventës, për vendimet e ndërmjetme është shprehur: “*Procedurat paraprake, të tilla si ato që kanë të bëjnë me vendosjen e një mase të ndërmjetme, normalisht nuk konsiderohen të jenë vendimtare për të drejtat dhe detyrimet civile dhe, si pasojë, normalisht nuk bien nën mbrojtjen e nenit 6 të Konventës*”¹⁷⁴ Ajo e ka zbatuar nenin 6 të Konventës për vendimet e ndërmjetme vetëm në raste përjashtimore, kur natyra e vendimit të ndërmjetëm e kërkon këtë përjashtim¹⁷⁵

GJEDNJ e ka konsideruar konfiskimin jondëshkues në Itali si një masë të karakterizuar nga natyra parandaluese dhe funksioni dhe jo si masë penale, prandaj është në përputhje të plotë me parashikimin e protokollit të lartpërmendur.¹⁷⁶ Nëse do të kishte natyrë kriminale, duhet të kërkohej zbatimi i parimeve tipike të sistemit penal. Parimet, të cilat janë në kundërshtim me sistemin e masës parandaluese, janë ato të parashikuara nga neni 7 i KEDNJ. GJEDNJ konsideron se masa parandaluese ka funksion gjerësisht të ndryshëm nga masa penale. Në çështjen Balsamo kundër San Marino, GJEDNJ është shprehur se “*masa e konfiskimit ishte një masë parandaluese dhe jo ndëshkuese, një masë parandaluese e pavarur nga procedimi penal*.”¹⁷⁷

Sipas gjykatës, ndërsa kjo e fundit synon të ndëshkojë shkeljen e legjislacionit penal dhe varet nga siguria e kryerjes së veprës penale dhe përgjegjësia kriminale e të pandehurit, masa parandaluese synon të pengojë kryerjen e krimeve të mëtejshme nga individët që konsiderohen “*të rrezikshëm*”

¹⁷³ Çështja Brems, Vendimi i GJEDNJ 2005. idem

¹⁷⁴ Shih vendimin Wiot kundër Francës, vendim i datës 15 mars 2001; APIS a.s. kundër Sllovakisë, vendim i datës 13 janar 2002; Libert kundër Belgjikës, vendim i datës 8 korrik 2004.

¹⁷⁵ Shih Markass Car Hire Ltd kundër Qipros, vendim i datës 23 Tetor 2001, Micallef kundër Maltës, vendim i datës 15 tetor 2009 idem

¹⁷⁶ Vendimi Raimonondo v. Italisë, vendimi i GJEDNJ-së i 22 shkurt 199, <https://hudoc.echr.coe.int>

¹⁷⁷ GHEDNJ, Vendimi Balsamo kundër San Marino, nr. 20319/17, zhvilluar me datën 8 tetor 2019, GJEDNJ, <https://hudoc.echr.coe>

para ligjit.¹⁷⁸ Konfiskimi, në kuadër të ligjit antimafia i përket atyre masave (*jo pashmangshmërisht* ¹⁷⁹*me natyrë kriminale*), të nevojshme për të mbrojtur si duhet interesin publik. Nuk mund të asimilohet në një masë penale, sipas tre kritereve të shtjelluara në KEDNJ. Për të cilësuar një masë penale për qëllim të Konventës duhen parë: cilësimi formal në të drejtën e brendshme, natyra e sanksionit, rëndesa (masa) e sanksionit.¹⁸⁰

Qëllimi legjitim: Në çështjen Reila dhe të tjerët kundër Italisë¹⁸¹ prona e parashtruesit ishte konfiskuar si e fituar nga të ardhurat kriminale në krim të organizuar. GJEDNJ u shpreh se përderisa masa e konfiskimit kishte shkelur pa dyshim të drejtat e parashtruesve të ankesës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, qëllimi legjitim i luftimit të organizatës kriminale të llojit mafioz në Itali ishte aq i rëndësishëm sa që ndërhyrja në Konventë nuk ishte në shpërpjesëtim me qëllimin. Prandaj nuk kishte shkelje të Konventës dhe kërkesa ishte qartazi e pabazë.

Ndërhyrja proporcionale. Në çështjen AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar, ¹⁸²GJEDNJ mban qëndrimin se “Shteti gëzon liri të gjerë vlerësimi në lidhje me zgjedhjen e mjeteve për zbatimin dhe vërtetimin nëse pasojat e zbatimit janë të arsyeshme për interesin e përgjithshëm, për qëllim të arritjes së objektivit të ligjit në fjalë.

Pajtueshmëria e konfiskimit pasuror si masë parandalues, me Konventën e të Drejtave të Njeriut.

Protokolli shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ¹⁸³, parashikon se “*Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush*

¹⁷⁸ Vendimi Marandina vs. Italisë, nr. 12386/86, Vendim i Komisionit i 15 prillit 1991, GJEDNJ, <https://hudoc.echr.coe> GJEDNJ, Vendimi Raimondo kundër Italisë, 22 shkurt 1994, GJEDNJ, Raimondo kundër Italisë, GJEDNJ 15 qershor 1999, Vendimi Prisco kundër Italisë. 15 qershor 1999, GJEDNJ, <https://hudoc.echr.coe>

¹⁷⁹ Protokoll shtesë i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, neni 1 paragrafi 2 parashikon: “Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

¹⁸⁰ Case of Engel and Others v. The Netherlands, application no. 5100/71, 23 shtetor 1976, <https://hudoc.echr.coe.int/>

¹⁸¹ GJEDNJ, Vendimi Reila dhe të tjerët kundër Italisë, 2019 <https://hudoc.echr.coe>

¹⁸² GJEDNJ, AGOSI kundër Mbretërisë së bashkuar, Vendim i datës 24 tetor 1986, <https://hudoc.echr.coe>

¹⁸³ Neni 1 “Mbrojtja e Pronës, Protokoll 1 shtesë i Konventës së të Drejtave të Njeriut, i amenduar me Protokollin 11 në Paris, 20.03.1952, Titujt e neneve të shtuar dhe teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155), që prej hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998

nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

GJEDNJ e konsideron konfiskimin e pasurisë si një formë të kontrollit të pronës duke theksuar se kjo formë kontrolli e ndërhyrje duhet të jetë e përcaktuar në një ligj, që ndjek një qëllim legjitim dhe të jetë proporcionale.¹⁸⁴ GJEDNJ e konsideron konfiskimin në Itali si një masë të karakterizuar nga natyra parandaluese dhe funksioni si masë penale, prandaj ligji Italian është konsideruar në përputhje me parashikimin e protokollit nr. 1 të KEDNJ. Nëse do të konsiderohej se kishte natyrë penale, duhet të kërkohet zbatimi i parimeve tipike të sistemit penal, të cilat nuk janë të njëjta me sistemin e masave parandaluese e veçanërisht neni 7 i KEDNJ.

Në një Vendim Gjykata e Kasacionit në Itali¹⁸⁵ shprehet se “... në rastin e vërtetimit që një pasuri nuk i përket personit të supozuar gjyqtari nuk duhet të bazohet vetëm tek rrethanat rastësore apo faktet që përbëjnë prova rrethanore, por duhet të bazohet në fakte të forta, të sakta e të qëndrueshme që të mund të mbështesin e të tejkalojnë supozimin mbi përkimin e dukshëm e të tejkaluar midis pronësisë dhe disponueshmërisë efektive të pronës. Kjo, duke pasur si udhërrëfyes të barrës së provës lidhur me rigorozitetin e provueshmërisë së disponimit direkt të pronës së prejardhur nga aktiviteti kriminal e në pronësi efektive të një tjetri. Disponueshmëria duhet të vërtetohet thelbësisht, në kontrast me pronësinë e dukshme të të tretëve, ajo duhet të vërtetohet nga investigimet rigoroze, intensive dhe të thella dhe jo nga konotacionet e rastit apo rezultatet e përcipta”.

Në lidhje me këtë çështje është interesante një gjykim i kryer nga Gjykata Federale Penale Zvicerane¹⁸⁶. Në këtë gjykim, Gjykata rrëzoi kërkesën e paraqitur nga një person i dyshuar që i përkiste “Ndrangheta-s” dhe i dënau në Itali për përfshirje në trafikim droge dhe dhënie parash

¹⁸⁴ Raimondo v. Itali App. Nr. 12954/87 (GJEDNJ 22 shkurt 1994) , Reila kundër Italisë App. Nr. 52439/99 (GJEDNJ 4 shtator 2001, Sun kundër Rusisë, Nr. 31004/02 (GJEDNJ 5 shkurt 2009)

¹⁸⁵ Vendimi nr. 46857/2009 i Gjykatës së Kasacionit në Itali mbi aplikimin e ankuesit Angelo Fiorisi.

¹⁸⁶ Vendimi i datës 21 Janar 2011 nga Gjykata Federale Penale Zviceriane, Divizioni i dytë.

me fajde, kundër vendimit të autoriteteve kompetente zvicerane për të pranuar kërkesën për asistencë juridike, të paraqitur nga prokurori italian në kuadrin e procedurave të parandalimit. Kërkesa për asistencë ishte drejtuar me marrjen e informacionit dhe dokumentacionit, me qëllim konfiskimin e llogarive bankare të vendosura në territorin zviceran. Mbështetja në premisën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, mund të arrihet vetëm në kuadrin e procedimeve penale. Gjykata Zvicerane u ballafaqua me çështjen lidhur me natyrën ligjore të procedurave italiane të sekuestrimit dhe konfiskimit, me supozimin e natyrës interpretuese jo-detyruese të cilësimit ligjor që përdor legjislacioni kombëtar.

Nga ky këndvështrim, Gjykata Zvicerane ka pranuar se mund të ofrohet asistencë gjyqësore ndërkombëtare për procedura, të cilat, megjithëse, jo-zyrtarisht penale, kanë për qëllim hapjen e procedimeve penale ose të lidhura ndryshe me një çështje penale. Mbi bazën e këtyre argumenteve, Gjykata Zvicerane pranoi natyrën thelbësisht penale të procedimeve, në lidhje me sekuestrimin dhe veçanërisht konfiskimin. Kështu, ajo hodhi poshtë ankesën kundër zbatimit të asistencës gjyqësore ndërkombëtare.

Arsyetimi i gjykatës citoi jurisprudencën e GJEDNJ, e cila konstatoi se konfiskimi parandalues, përbën ndërhyrje në të drejtën e një personi për të gëzuar paqësisht pasuritë e tij, por është e përcaktuar me ligj dhe në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur, duke i shërbyer interesit të përgjithshëm më anë të parandalimit të përdorimit të paligjshëm në një formë, që është e rrezikshme për shoqërinë, të pasurive, origjina e ligjshme e të cilave nuk është e përcaktuar. Në këtë këndvështrim, GJEDNJ, theksoi se masa parandaluese pasurore është pjesë e një politike të parandalimit të krimit, ajo gjykoi se për zbatimin e një politike të tillë, organi ligjvënës duhet të ketë një hapësirë të gjerë vlerësimi, si në lidhje me ekzistencën e një problemi që prek interesin publik, i cili kërkon masa të kontrollit dhe mënyrën e duhur për zbatimin e këtyre masave. GJEDNJ, më tej, vërejti se në Itali problemi i krimit të organizuar ka arritur një nivel shumë shqetësues. Fitimet kolosale, që organizatat kriminale nxjerrin nga aktivitetet e tyre të paligjshme u japin atyre një shkallë pushteti, që vë në rrezik shtetin e së drejtë brenda Shtetit. Mjetet e përdorura për të luftuar këtë pushtet ekonomik, veçanërisht masa parandaluese e konfiskimit, mund të shfaqet si e domosdoshme për vazhdimin me sukses të betejës kundër organizatave në fjalë.

Përveç kësaj, GJEDNJ njohu përputhshmërinë e procedurës së konfiskimit në lidhje me parimet e procesit të rregullt dhe të drejtën e mbrojtjes (*neni 6 KEDNJ*). GJEDNJ vuri në dukje se procedurat për zbatimin e masave parandaluese pasurore kryhen në prani të dy palëve para tre gjykatave të njëpasnjëshme, Gjykatës së Rrethit, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Kasacionit. Në veçanti, të pandehurit, duke udhëzuar avokatin e tyre, janë në gjendje të ngrenë kundërshtime dhe të paraqesin prova, që ata i konsiderojnë të domosdoshme për të mbrojtur interesat e tyre, gjë që tregon se respektohen të drejtat e mbrojtjes.¹⁸⁷ Për më tepër, GJEDNJ vërejtë se gjykatave italiane nuk u lejohet të bazojnë vendimet e tyre thjesht mbi dyshime. Ata duhet të përcaktojnë dhe vlerësojnë në mënyrë objektive faktet e paraqitura nga palët dhe nuk ka asgjë që sugjeron se ato vlerësojnë arbitrarisht provat e paraqitura para tyre. Sipas Gjykatës Zvicerane, aspektet procedurale të konfiskimit të sipërpërmendura, të miratuara pas përfundimit të një procesi thelbësisht gjyqësor, të mbështetura në garanci të ngjashme me ato të gjykitimit penal, përbëjnë elemente konkludues të një natyre penale të kësaj mase dhe të procedimeve përkatëse.¹⁸⁸ Siç duket, në themel të këtij vlerësimi të bërë nga autoriteti gjyqësor i huaj, ka qenë aftësia e gjyqësorit italian për të ndërtuar një "ligj në veprim" në përputhje me standardet ndërkombëtare të "gjykitimit të drejtë".¹⁸⁹ Një zhvillim i tillë është shoqëruar me një sistem veçanërisht të efektshëm të kontrollit të përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, si kundër-masë ndaj ndërveprimit kompleks midis Mafias dhe ekonomisë në Italinë Veriore, si dhe në Jug.

GJEDNJ, për masën e sekuestrimit të Aktit Italian të vitit 1965, është shprehur se kjo masë nuk ka për qëllim që të privojë kërkuesin nga prona e tij, por vetëm e ndalon atë që ta përdorë; sekuestrimi është qartazi një masë që ka për qëllim të sigurojë se pasuria, e cila duket se është fryt i veprimtarive të paligjshme të kryera në dëm të komunitetit, të mund të konfiskohet më tej, nëse është e nevojshme; masa si e tillë është e justifikueshme nga interesi i përgjithshëm dhe, duke pasur parasysh fuqinë e rrezikshme ekonomike të një organizate si Mafia, nuk mund të thuhet se marrja e saj në këtë fazë të procedimit është disproporcionale me qëllimin që synohet të arrihet (*Shih çështjen Raimonondo v. Italisë, vendimi i GJEDNJ-së i 22 shkurt 1994, para.27*). Për

¹⁸⁷ Vendimi Raimonondo v. Italisë, vendimi i GJEDNJ-së më 22 shkurt 199, <https://hudoc.echr.coe.int>

¹⁸⁸ Balsamo and Luparello, referim 2013. idem

¹⁸⁹ Antonio Balsamo, "Konfiskimi nëpërmjet ligjit antimafia", referimi në seminarin me temë "Konfiskimi i pasurisë si masë parandaluese pasurore" organizuar nga PAMECA, Tiranë 20 nëntor 2017

konfiskimin, në këtë çështje GJEDNJ-ja ka pranuar se konfiskimi përbën një privim të pronës. Sipas saj, konfiskimi ka synuar të ndjekë një qëllim, që ishte në interesin e përgjithshëm, pra kërkonte të siguronte se përdorimi i pronës në fjalë nuk do të sillte fitime për kërkuesin ose organizatën kriminale, anëtar i së cilës ai dyshohej se ishte, në dëm të komunitetit. GJEDNJ-ja i njeh një hapësirë të gjerë vlerësimi shtetit italian. Ajo shprehet, ndër të tjera, se konfiskimi, i cili është hartuar për të bllokuar lëvizjen e kapitaleve të dyshimta, është një armë efektive dhe e nevojshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe Mafies. Prandaj duket proporcionale me qëllimin që synon të arrihet.¹⁹⁰

Në çështjen *Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 24 tetor 1986, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, shprehet se paragrafi 2 i nenit 1 Protokollit 1 i KEDNJ-së i njeh të drejtën shteteve të miratojnë ato ligje që i konsiderojnë të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Por duhet të ekzistojë një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet masës së marrë dhe qëllimit që synohet të arrihet; me fjalë të tjera, duhet të shqyrtohet nëse ka një balancë të drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe interesave të individit ose individëve në fjalë. Në përcaktimin e kësaj baraspeshe, GJEDNJ-ja thkeson që shteti gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi si për zgjedhjen e mjeteve, ashtu edhe në përcaktimin e pasojave të masës, të cilat justifikohen nga interesi i përgjithshëm për qëllim të arritjes së qëllimit të ligjit në fjalë .

Në çështjen *Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë* i 5 korrik 2001, GJEDNJ-ja vendosi se edhe pse masa në fjalë sillte privimin e pronës, kjo përbente një kontroll të përdorimit të pronës në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili u jep të drejtën shteteve që të miratojnë ligje që i konsiderojnë të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Ajo ka theksuar edhe se masa e kundërshtuar bën pjesë në një politikë për parandalimin e krimit. GJEDNJ-ja shprehet se konfiskimi në këtë rast ka synuar të parandalonte përdorimin e paligjshëm, në një mënyrë të rrezikshme për shoqërinë, të zotërimeve, origjina e ligjshme e të cilave nuk është vërtetuar. Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje, sipas saj, i shërben interesit publik dhe është në përputhje me qëllimin legjitim që synon të arrijë.

¹⁹⁰Vendimi *Raimonondo v. Italisë*, vendimi i GJEDNJ-së i 22 shkurt 1994, [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:\[%22001-57870%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001-57870%22]})

Mbrojtja e personave të tretë ka gjetur trajtim në jurisprudencën e GJEDNJ. Në një sërë vendimesh të GJEDNJ¹⁹¹ gjykata ka mbajtur qëndrimin se vlerësimi i pretendimeve për cenim të nenit 1 të Protokollit, do të bëhet nisur nga fakti se sa palët e treta kanë pasur mundësi për të paraqitur pretendimet e tyre në gjykatat vendase. Gjithashtu, edhe për elementët e sjelljes ose të fajit të personave të tretë, GJEDNJ ka marrë parasysh nëse këta elementë janë shqyrtuar nga gjykatat vendase.

Në çështjen *Varvara kundër Italisë*¹⁹², GJEDNJ konkludoi se masat e marra në këtë rast kundër subjektit përfaqësonin një masë penalizuese dhe ndëshkuese në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7 të KEDNJ. Në çështjen *Paraponiaris kundër. Greqisë*, GJEDNJ i kishte gjetur veprimet e organeve në shkelje të parashikimeve të nenit 6/2 të KEDNJ. Në lidhje me procedurat e konfiskimit GJEDNJ e ka vënë theksin tek mundësitë që legjislacionet u japin palëve, subjekteve personave të tretë për t'u mbrojtur ligjërisht ndaj veprimeve autoritare e për të paraqitur pretendimet e tyre mbi pronën. Në çështjen *Gogitidze dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*¹⁹³ GJEDNJ ka mbajtur këtë qëndrim “...kur një konfiskim është bërë pavarësisht dënimit penal por si rezultat i konfiskimit civil të ndarë, përbën kontroll të përdorimit të pasurisë në kuptim të parashikimeve të paragrafit 2 të nenit 1 të Protokollit I” Për sa i përket çështjes së konfiskimit pa dënim, GJEDNJ është përpjekur që të bëjë dallimin mes të pasurisë së përfutur nga aktiviteti kriminal i grupeve mafioze e të organizuara me përfitimin nga veprimtari të tjera kriminale.

Në rastet kur është pretenduar shkelja e nenit 6 të KEDNJ, e drejta për një proces të rregullt, GJEDNJ ka shqyrtuar nëse procedura e konfiskimit është bërë në bazë të një procedure të pajtueshme me nenin 6 (1) të KEDNJ. Në çështjen *Philips kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁹⁴

GJEDNJ shprehet se: “Mundësia, që i është dhënë të parashtruesit të ankesës për të kundërshtuar supozimin se pasuria ishte fituar përmes mjeteve legjitime, përbënte mbrojtje të mjaftueshme të të drejtave të tij. Për më tepër e drejta e brendshme konstatohet se është proporcionale, për atë kohë

¹⁹¹ Vendimi Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë, datë 1 prill 2010, GJEDNJ <https://hudoc.echr.coe.int/>

¹⁹² Varvara kundër Italisë, çështja nr. 17475/09, datë 29.10.2013, GJEDNJ <https://hudoc.echr.coe.int/>

¹⁹³ Çështja nr. 36862/05 datë 12.05.2015 <https://hudoc.echr.coe.int/>

¹⁹⁴ GJEDNJ, Philips kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendim i datës 5 korrik 2001. <https://hudoc.echr.coe>

sa ajo kishte arritur ekuilibër të drejtë mes të të drejtave të parashtruesit të ankesës dhe qëllimit legjitim publik”.

Konfiskimi pa dënim dhe përputhshmëria e tij me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Një nga hipotezat, që kam ngritur në këtë punim shkencor është nëse konfiskimi i dhënë në mungesë të dënimit penal është në përputhje me nenin 7 të KEDNJ-së. Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konfiskimi nëpërmjet masave parandaluese në sistemin ligjor italian u konsiderua një kufizim i të drejtës së pronësisë. GJEDNJ e ka konsideruar legjitime të drejtën e shtetit, në përputhje me kërkesat e nenit 1 të Protokollit e për rrjedhojë nuk i nënshtrohet parimeve të procesit penal. Masa, në këtë rast, thotë GJEDNJ, synon parandalimin e si rrjedhojë ka një legjitimitet konvencional. Në rastet që kanë të bëjnë me parandalimin, GJEDNJ ka trajtuar dhe raste të tjera të konfiskimit në vlerë, pavarësisht rrezikshmërisë së personit dhe në mungesë të dënimit penal, duke e quajtur, në këto raste, konvencionale nevojën e parandalimit.¹⁹⁵

Në një çështje tjetër¹⁹⁶, GJEDNJ konstatoi se konfiskimi i një pasurie me origjinë të paligjshme të disa zyrtarëve publikë i dhënë në mungesë të një dënimi penal ishte në përputhje me Konventën. Në këtë rast, GJEDNJ vuri në dukje se kishim të bënim me një konfiskim civil, në të cilin përdorimi evident i provave me një nivel më të ulët provues është proporcional me qëllimin e parandalimit të kriminalitetit, që është synimi i kuadrit ligjor rregullator vendas e ndërkombëtar dhe se masa nuk është e karakterit penal, por civil që synon rregullimin dhe kufizimin e së drejtës pronësore. Sikurse është trajtuar më lart, një natyrë e ngjashme njihet në konfiskimin, i cili nuk bazohet në dënim, i parashikuar në ligjin amerikan, i quajtur si konfiskimi civil.

Një rast interesant në jurisprudencën e GJEDNJ është çështja *Geerings kundër Hollandës*. Aplikanti¹⁹⁷ ishte i dënuar në Hollandë për veprat penale të vjedhjes në kuadër të organizatës

¹⁹⁵ Case *Geerings v. Hollande*, application no. 30810/03, Judgment dated 01 June 2007, European Court of Human Rights, Strasbourg, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ebe4>

¹⁹⁶ *Gogitidze dhe të tjerë v. Gjeorgjisë*, GJEDNJ 2015

¹⁹⁷ Aplikim nr. 308/10 i datës 1 mars 2007 për Çështjen *Geerings kundër Hollandës*. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ebe4>

kriminale. Për disa nga veprat penale të akuzuara ai mori pafajësi në gjykatë pasi nuk provohej se i kishte kryer, megjithatë, prokurori kërkoi konfiskimin e pronave, të fituara nga kjo veprimtari pasi sipas tij “...pavarësisht pafajësisë, ka tregues të mjaftueshëm që veprimet ishin kryer prej tij”. Gjykata rajonale e refuzoi urdhrin e konfiskimit, ndërsa Gjykata e Apelit e pranoi. Edhe Gjykata Supreme e la në fuqi Vendimin e Apelit duke arsyetuar se “...veprat penale të aktit të njoftimit të akuzës, pavarësisht vendimit të pafajësisë janë akoma bazë për konfiskimin e kjo për Gjykatën është e pajtueshme me nenin 6 (2) të Konventës.” GJEDNJ pranoi ankesën e G. duke e gjetur vendimin në shkelje të nenit 6(2) duke theksuar “...se ndërsa prezumimi i pafajësisë nuk zbatohet për procedurën e konfiskimit, dhënia e konfiskimit për pasuri të dyshuara, që janë vënë me një vepër penale, për të cilën është marrë pafajësi, përbën tejkalim të arsyeve, mbi të cilat mund të jepet konfiskimi, pasi në këtë rast dyshimet për kryerje të veprës kanë rënë. “ Gjykata, në këtë rast, bën një dallim mes marrjes së masës së konfiskimit, kur nuk justifikohet mjaftueshëm pasuria, duke cituar vendimet *Philips kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Van Offeren kundër Hollandës* dhe rastit konkret kur masa e konfiskimit lidhet me një vepër penale, për të cilën është marrë pafajësi. Nëse përtej dyshimit të arsyeshëm nuk konstatohet se personi e ka kryer veprën penale dhe se nuk del i vërtetuar ndonjë fakt për paligjshmëri ose përfitim të padrejtë atëherë një masë e tillë jepet vetëm mbi prezumin të fajit, gjë që për gjykatën nuk është e pajtueshme me nenin 6&2 i KEDNJ.¹⁹⁸

GJEDNJ me Vendimin e *Varvara kundër Italisë*, i 29 tetorit 2013,¹⁹⁹konstatoi se aplikimi i konfiskimit urban, në rastet e shfajësimit për shuarjen e krimit përbën shkelje të parimit të ligjshmërisë, të parashikuar nga neni 7 i KEDNJ.²⁰⁰Gjykata, në këtë rast, trajtoi interpretimin e cilësimit “penal” të konfiskimit urban, i parashikuar në legjislacionin italian²⁰¹. GJEDNJ arsyetonte se KEDNJ nuk kufizohet në kërkimin e nevojës për një bazë ligjore për krimet dhe ndëshkimet, por gjithashtu, nënkupton paligjshmërinë e zbatimit të sanksioneve penale për veprimet e kryera nga të tjerët (në rastin e mëparshëm të ligjit tashmë të konstatuar në konflikt e pafajësia e refuzuar

¹⁹⁸Ky qëndrim është mbajtur edhe në çështjen *Salabiaku kundër Francës*, 7 tetorit 1988, seria a nr. 141 fa 15-16

¹⁹⁹ Vendimi *Varvara c. Itali*, ric. n. 17475/09 & 69, 29 tetor 2013, GJEDNJ, seksioni i dytë, i dërguar.

²⁰⁰ Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, i cili në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas së drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte në zbatim në momentin kur është kryer vepra penale. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

²⁰¹ Art.44 të dekretit legjislativ nr. 380/2001 (Ligji i Konsoliduar mbi Ndërtimin),

në nenin 6, 2, KEDNJ) ose, në çdo rast, që nuk bazohet në një gjykim fajësues (*consignéedans un verdict de culpabili té un verdict de culpabilité*).²⁰²Zbatimi i konfiskimit urban, në mungesë të një dënimi, rezulton, pra, i papajtueshëm me këtë të fundit dhe përfshin shkelje të dispozitës në fjalë. Të njëjtin arsyetim GJEDNJ e ka dhënë edhe në Vendimin *Sud Fondi e të tjerë kundër Italisë*²⁰³ ku ka arritur në konkluzionin se “*zbatimi i konfiskimit pavarësisht vendimit për të liruar kërkuessit nuk kishte bazë ligjore, ishte arbitrar dhe cenonte nenin 7 të Konventës*”.

Ky standard i jurisprudencës së GJEDNJ në interpretim të Konventës dhe konkretisht, nenit 7 të saj, duke rishikuar pjesën e ligjit shqiptar, i cili parashikon autonominë e procedimit pasuror nga ai penal, duke nënkuptuar apriori zbatimin e konfiskimit pasuror pa dënim në çdo rast. Tashmë, ka ardhur koha që ligji ynë të parashikojë rastet kur konfiskimi mund të bëhet edhe pa vendim dënim dhe kur vendimi, që deklaron të pafajshëm të pandehurin ndikon në procedimin pasuror, nëse është rasti të paktën në lidhje me përgjegjësinë penale juridike të personave fizikë.

Në çështjen *Econostri, Punta Perotti kundër Italisë*²⁰⁴, GJEDNJ gjeti shkelje nga ana e shtetit italian në pamundësinë për të riparuar dëmin e shkaktuar nga konfiskimi pa të drejtë dhe u shpreh me kërkesën për kompensim të paraqitur nga kompanitë e ndërtimit. Ky vendim është në vijim që qëndrimin që GJEDNJ ka mbajtur në çështjen *Sud Fondi dhe të tjerët kundër Italisë, të datës 20 janar 2009*, me të cilën Italia u ndëshkua për shkelje të neneve 7 (*i cili nje parimin e ligjshmërisë në çështjet penale*) dhe 1 Prot. 1(*i cili krijon të drejtën e pronës në vend*) GJEDNJ në lidhje me konfiskimin e “Ecomostri” të Punta Perotti.

Në vlerësimin tim, ky qëndrim i GJEDNJ është i rëndësishëm dhe duket i përshtatshëm për të kuptuar pikat kryesore para se të analizojmë disa çështje mbi të cilat GJEDNJ u siguroi të drejtë të barabartë palëve të dëmtuara, për shkak të shkeljes së pranuar të të drejtave të tyre themelore. Me vendimin e marrë në janar 2009, gjyqtarët e Strasburgut pohuan natyrën “*penale*” të konfiskimit urban, duke argumentuar se zbatimi i tij, në rastin konkret, ishte në kundërshtim me nenin 7 të KEDNJ. Gjykata Evropiane, pasi deklaroi ankesën të pranueshme, i ftoi kompanitë

²⁰²<https://www.echr.coe.int>

²⁰³ Sud Fondi srl and Others v. Italy - 75909/01 Judgment 20.1.2009 [Section IIç]

²⁰⁴ Shënim për Gjykatën EDU, sec. II, dërguar. 10 maj 2012, ric. n. 75909/01, Sud Fondi dhe të tjerët c. Itali

ankuese dhe qeverinë e paditur për të gjetur një marrëveshje, dhe pamundësia për të arritur një kompromis e bëri të pashmangshëm një vendim të ri. Me aktvendimin e 10 majit 2012²⁰⁵, GJEDNJ shprehet se gjetja për një shkelje të Konventës ose të Protokolleve të saj rezulton për shtetin e gjetur në shkelje si një detyrim ligjor për ta korrigjuar, duke rivendosur sa më shumë që të jetë e mundur gjendjen e mëparshme ekzistuese. Në lidhje me këtë, nëse është e vërtetë, nga njëra anë, se KEDNJ pranon se shtetet kontraktuese kanë lirinë për të zgjedhur mjetet e respektimit të një gjykimi të Gjykatës që krijon një shkelje konvencionale, nga ana tjetër, kur ligji kombëtar nuk lejon ose lejon vetëm kompensim të pjesshëm për pasojat e shkeljes, Gjykata mund t'i japë palës së dëmtuar të drejtë, sipas nenit 41 të KEDNJ, të drejtë. Sa i përket sasisë së dëmit, Gjykata theksoi, në radhë të parë, natyrën radikale të konfiskimit të tokës së aplikantëve si në pajtim me nenin 7 të KEDNJ. Zhdëmtimi, që duhet të njihet, duhet të pasqyrojë, në këtë rast, idenë e një anulimi total të pasojave të masës.

Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se kthimi i tokës tek ankuesit përbënte vetëm një kompensim të pjesshëm, në lidhje me shkeljen e Shtetit italian të të drejtave të tyre, duke theksuar se ndërtesat e ndërtuara atje ndërkohë janë shkatërruar pa u njohur si masë dëmshpërblimi. Shpenzimet e bëra nga kompanitë për ndërtimin e ndërtesave duhet të jenë një komponent thelbësor i *restitutio in integrum* ku aplikantët kanë të drejtë. *Së dyti*, Gjykata vëren se jo të gjitha tokat i janë kthyer aplikantëve deri më sot dhe se në veçanti ato që i nënshtrohen dy planeve specifike të zhvillimit të tokës janë transferuar në qytetin e Barit, e cila ende nuk e ka kthyer atë. Për sa i përket këtyre tokave, Gjykata konsideron se duhet të kompensojë dëmin që rrjedh nga mungesa absolute e këtyre tokave nga shoqëritë e përsëritura, të llogaritur nga momenti i konfiskimit. Një kompensim i ngjashëm duhej të bëhej pasi, pronat e të cilave janë kthyer zyrtarisht në kompanitë e përsëritura, të cilat megjithatë nuk janë në gjendje t'i përdorin ato pasi ato janë shndërruar në një park publik.²⁰⁶

Në çështjen *Caste of Balsamo kundër San Marino*, GJEDNJ²⁰⁷ mban qëndrimin se: “...në rastin kur nuk ka dyshim që ankuesit janë liruar nga akuzat në lidhje me pastrimin e parave bie dhe dyshimi bie dhe baza ku mbështetet urdhri për konfiskim pasuror pasi masa në këtë rast nuk

²⁰⁵ Po aty

²⁰⁶ Vendim i GJEDNJ, sec. II, dërguar. 10 maj 2012, ric. n. 75909/01, Sud Fondi dhe të tjerët c. Itali

²⁰⁷ Vendimi *Caste of Balsamo kundër San Marino*, aplikimi nr. 20319/17 dhe 21414/17, GJEDNJ, 8 tetor 2019.

bazohet në një konstatim gjyqësor që ankuesit kishin përfituar nga veprat penale për të cilat ato ishin liruar. ... në rastin që konfiskimi nuk bazohej në një vendim dënimi penal, e as nuk ishte rezultat i procedurave të veçanta “civile”, çështja do të shqyrtohet si një çështje e kontrollit të përdorimit të pronës brenda kuptimit të paragrafit 2 të nenit 1 të Protokollit 1. “

Siç e kam trajtuar dhe më sipër, si del dhe nga vendimet e GJEDNJ si standard ndërkombëtar, nuk ekziston një qasje e prerë ndaj konfiskimit pa dënim pasi është një çështje shumë delikate. Konventa e Strasburgut 1990 dhe ajo e Varshavës nuk vënë si parakusht për konfiskim dënimin por përkufizimet e tyre të “produkteve të krimit” dhe dispozitat mbi konfiskimin e mjeteve nënkuptojnë se ato përqendrohen shumë te konfiskimi i bazuar në një vendim dënimi penal. Në kuadër të Bashkimit Evropian²⁰⁸ po inkurajohet zgjerimi dhe futja e konfiskimit civil. Kjo është shtyrë më tej me Direktivën e vitit 20154 të BE-së, por duke theksuar që të përdoret në rrethana të kufizuara, vetëm kur ikja e personit të dyshuar apo të akuzuar bën të pamundur ndjekjen penale me kushtin që personi të ketë mundësi të mbrohet për pronën me një avokat.

2.7. Çështje në vëmendje dhe perspektiva e tyre.

Normat ndërkombëtare, standardet ndërkombëtare dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut na përcaktojnë kufijtë ligjorë të rregullimit të sekuestrimit, konfiskimit, barrës së provës e gjithashtu orientimin tonë në interpretimin gjyqësor të ligjit. Duke parë gjithë kuadrin rregullator ndërkombëtar, standardet ndërkombëtare tashmë të konfirmuara, jurisprudencën e GJEDNJ, ne duhet të reflektojmë nëse ligji ynë, që rregullon masat parandaluese është në përputhje me këto standarde.

Duke analizuar jurisprudencën e GJEDNJ dhe aktet komunitare, duhet të bëjmë kujdes me legjislacionin shqiptar për të përputhur me këto standarde mbrojtjen e interesave pasurore të subjekteve të ligjit, saktësimin e procedurave të konfiskimit, përputhshmërinë me proporcionalitetin e veprës të konfiskimit pa dënim e atij të zgjeruar si dhe mbrojtjen e interesave

²⁰⁸ Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillim 20.11.2008, COM (2008) 766 final paragrafi 3.3.1

të palëve të treta, kreditorëve, huadhënësve. Prandaj dhe njohja e saj për juristët, avokatët, gjyqtarët e prokurorët shqiptarë është e rëndësishme.

Fuqia juridike e vendimeve të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik, është pranuar në jurisprudencën tonë kushtetuese e cila në vendimin Nr. 20, datë 01.06.2011²⁰⁹ ndër të tjera ka theksuar se: *“Gjykata, e shih me vend të theksoje se, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë ekskluzive. Kjo kompetencë është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti. Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime, të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre”*.

Në kuptim të këtij Vendimi gjyqtarët shqiptarë e më specifikisht ata që zbatojnë ligjin mbi konfiskimin janë vetë interpretues të këtij ligji, por në radhë të parë, zbatues të normës ndërkombëtare që si mekanizëm garantues ka pikërisht jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Prandaj, është me rëndësi njohja e normave ndërkombëtare, standardeve ndërkombëtare e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nëse rendisim në analizë jurisprudencën e GJEDNJ, mund të krijojmë një indeks të qëndrimeve të saj, të cilat duhet t'i kemi në vëmendje në praktikën e përditshme nën frymën e interpretimit pajtues të ligjit tonë për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar me nenet 1, 6, 7, 8 të KEDNJ. Si të tilla si gjetje të kësaj analize mund të rendisim qëndrimet e GJEDNJ-së :

1. E drejta e pronësisë apo e posedimit mbrohet nga neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ.
2. E drejta e pronës gjatë procesit të konfiskimit mbrohet nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, neni 6 i KEDNJ

²⁰⁹ Në vendimin Nr. 5, datë 2 Shkurt 2001 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera thuhet se: *“Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale”*.

3. Ndërhyrjet me masat e parandalimit pasuror sekuestrim, konfiskim duhet të jenë në proporcionalitet dhe legjislacioni duhet të përcaktojë një prag vlerësimi të qartë të asaj që konsiderohet pasuri e paligjshme e të mundësisë të justifikimit të pasurisë së ligjshme.
4. Në zbatimin e masës së konfiskimit legjislacioni duhet të jetë në proporcion të drejtë e të balancuar të interesit të përgjithshëm publik me nevojën për konfiskim dhe asaj të mbrojtjes të së drejtës së pronësisë, si dhe asaj për proces të rregullt ligjor.
5. Në rastet e krimit të organizuar, mafioz, shtetet duhet të parashikojnë mekanizma ligjore të balancimit të të drejtave në raport me rëndësinë e kriminalitetit,
6. Sekuestrimi i pasurisë së përfituar në mënyrë të padrejtë nga nëpunësi civil i shtetit në kuadër të masave kundër korrupsionit nuk përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.
7. Prezumi se pasuria ishte fituar në mënyrë të paligjshme nuk përbën shkelje të nenit 6 nëse shtetasve u jepen mjete për t'u mbrojtur e provuar të kundërtën.
8. Kalimi i barrës së provës tek individit nuk përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ nëse parashikohet shprehimisht nga legjislacioni vendas.
9. Që të jemi para respektimit të KEDNJ në aplikimin e një masë pasurore, ajo duhet të jetë e parashikuar në ligjin e brendshëm e të zbatohet në mënyrë proporcionale.
10. Në ekuilibrin e drejtë të masës duhet të jetë në vëmendje: sjellja e pronarit, niveli i fajit, qëllimet dhe objektivat e ligjit
11. Lënia pa pronë e blerësit *bona fides*, apo mosdhënia e mundësisë së kompensimit , përbën ndërhyrje joproporcionale dhe shkelje.
12. Jo çdo masë konfiskimi pasurie ndaj pasurisë në pronësi të një personi, që është shfajësuar nga akuzat është në përputhje me Konventën nenin 7, në veçanti për personat juridikë.
13. Marrja e masës së konfiskimit të pasurisë shumë kohë pas marrjes së një vendimi shfajësimi nga akuzat penale, nuk është në përputhje me nenin 6 të KEDNJ.

Jurisprudenca e GJEDNJ na orienton se ligji shqiptar duhet të ndjekë standardin ndërkombëtar të respektimit të së drejtës së pronësisë duke riparë rregullimet për aksesin në gjykim në të gjitha fazat, kontradiktoritetin, mbrojtjen efikase të palëve të treta si dhe konfiskimin në rast të mospasjes së një dënimi penal.

Si përfundim, mund të themi se hipoteza e ngritur në fillim të këtij kreu u vërtetua në kuptimin se tashmë kemi të bëjmë me një juridiksion të veçantë të masave parandaluese pasurore, konfiskimit pasuror, që përfshin normat konvencionale ndërkombëtare, standardet ndërkombëtare të interpretimit të tyre, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ, juridiksion, i cili duhet të na orientojë në një sistem ligjor rregullator sa më të përshtatshëm për masat e konfiskimit pasuror.

KREU III

PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE NË SHQIPËRI

Përmbajtja. 3.1. Hyrje, 3.2. Sekuestrimi dhe konfiskimi sipas legjislacionit shqiptar. 3.3. Legjislacioni shqiptar për masat parandaluese kundër pasurisë në Shqipëri, sekuestrimi dhe konfiskimi pasuror, 3.3.1. Masat parandaluese pasurore sipas legjislacionit të vitit 2004, 3.3.2. Masat parandaluese pasurore sipas legjislacionit të vitit 2009, 3.3.2. Masat parandaluese pasurore sipas legjislacionit të vitit 2017, ndryshimi i natyrës së ligjit. 3.3.3 Masat parandaluese pasurore dhe personale, në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike sipas Akti Normativ nr. 1 datë 31.01.2020. 3.4. Reflektimi i modeleve të legjislacioneve evropiane në legjislacionin shqiptar. 3.5.Probleme teorike dhe në praktikën gjyqësor mbi standardet ligjore të zbatimit të ligjit për goditjen e pasurisë, provat dhe barrën e provës. 3.6.Çështje në vëmendje.

3.1.Hyrje

Legjislacioni shqiptar parashikon të dy llojet e konfiskimeve si atë në kuadër të procesit penale edhe atë parandalues pasuror ose civil. Në këtë kre trajtohet modeli ligjor shqiptar për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese, institutit i konfiskimit si dënim penal, i parashikuar në legjislacionin penal shqiptar dhe si masa sigurimi, të parashikuar në legjislacionin procedural penal, duke trajtuar dallimet me konfiskimin civil të parashikuar me ligj të veçantë. Më tej, në këtë kre trajtohen në vështrim krahasimor dhe perspektiv të gjitha ndryshimet në ligjet tona në tre periudha deri tek i fundit.

Ligji, që parashikoi për herë të parë në Shqipëri sekuestrimin parandalues dhe konfiskimin është ligji “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*” i vitit 2004. Origjina, tiparet e tij, procesi i zbatimit të ligjit dhe diskutimet në jurisprudencë e në praktikën gjyqësore mbi standardet ligjore e kushtetuese të tij si dhe barrën e provës kanë qenë të diskutueshme deri në nënshkrimin e këtij ligji ndaj kontrollit kushtetues dhe praktikës gjyqësore të unifikuar. Ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” konturuan natyrën e masës parandaluese, të gjykimit parandalues pasuror dhe të konfiskimit. Ligji nr. 70/2017 “*Për një ndryshim në ligjin 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, i dha një natyrë tjetër ligjit dhe solli ndryshime thelbësore te kanë brendi të tij.*

Akti Normativ nr. 1 datë 31.01.2020 “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike*” kishte një tipar tjetër të diskutueshëm legjislativ, por parashikonte masa parandaluese pasurore të së njëjtës natyrë, për më tepër masa parandaluese pasurore. Në modelet e ligjeve të miratuara janë reflektuar modelet e legjislacioneve evropiane, por zbatimi i tyre është shoqëruar me diskutime ligjore e praktike mbi standardet ligjore, provat, barrën e provës etj., të cilat kanë interes njohjeje në këndvështrimin teorik dhe praktik dhe si të tillë, ato trajtohen në këtë kre.

Vështrimi krahasues mbi tri ligjet e zbatuara në kohë të ndryshme na jep mundësinë të bëjmë krahasimet në mes të tyre për të arritur në një përfundim se cila procedurë e hetimit, e gjykimit dhe masave parandaluese balancon më drejt interesin publik të procedimit pasuror për një hetim

pasuror të efektshëm me mbrojtjen e të drejtave dhe garancive mbi pronën për subjekte të ligjit apo palët e treta. Në këtë kre të punimit ngrihet hipoteza nëse ka ardhur koha që Shqipëria të ketë tashmë ligj të ri apo të përvijëzojmë një juridiksion të ri të masave të parandalimit pasuror brenda sistemit tonë ligjor.

3.2. Sekuestrimi dhe konfiskimi sipas legjislacionit shqiptar

E drejta penale dhe procedurale penale shqiptare kanë përvetësuar të njëjtat koncepte tradicionale të së drejtës kontinentale, me dallimin se sekuestrimi parashikohet si masë sigurimi, ndërsa konfiskimi si dënim plotësues. Sekuestrimi dhe konfiskimi, si masa parandaluese pasurore parashikohen me ligj të veçantë²¹⁰ duke i rregulluar si institute jashtë kuadrit të procedimit penal dhe si një procedim më vete, që quhet procedim pasuror *in rem*.

Kodi i Procedurës Penale²¹¹ parashikon sekuestrimin konservativ (neni 270), sekuestrimin preventiv (neni 274) Sekuestrimi zbatohet “kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme të të pandehurit, të shumave e të sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet ku ligji lejon sekuestrimin e tyre”. Ky lloj sekuestrimi nuk është një masë paraprake, e cila mund të përdoret për shpronësimin e produktit të veprës penale. Ajo vendoset ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshme të personit të dyshuar, që mund të mos jenë produkt i veprimtarisë penale, por shërbejnë për të garantuar përmbushjen e detyrimit të pagimit të dënimit me gjobë.

Sekuestrimi preventiv zbatohet kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi, i cili lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Në kushte të tilla, me kërkesë të prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. Sekuestrimi mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe të çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP. Ky lloj sekuestrimi

²¹⁰Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

²¹¹Ligji nr. 7905 datë 21.03.1995, i ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 35/2017 datë 30.03.2017 dhe ligjin nr. 147/2020 datë 17.12.2020 dhe atë nr. 41/2221 datë 23.03.2021.

është masë sigurimi pasuror dhe ka si qëllim që të ndërpresë vijueshmërinë e pasojës kriminale e ta parandalojë atë si pasojë e zotërimit të lirë të sendit. *Sekuestrimi vërtetues* (neni 208, paragrafi 1 i KPrP), përdoret për qëllim të mjetit të kërkimit të provës, sipas së cilit gjyqtari dhe prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Qëllimi i këtij sekuestrimi është sigurimi i provave që do të shërbejnë për sigurimin e fakteve. Të njëjtin qëllim ka edhe sekuestrimi provues, i përmendur në nenin 208/a të KPrP për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike.

Konfiskimi penal në legjislacionin shqiptar është parashikuar vetëm si institut material penal në Kodin Penal, të ndryshuar në nenet 30 pika 2 dhe 36 të tij. Sipas nenit 30 të KP²¹² për personat që kanë kryer krime apo kundërvajtje penale bashkë me dënimin kryesor mund të jepen dhe dënime plotësuese, ndër të cilat konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.

Në nenin 36 të Kodit Penal është parashikuar konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale²¹³ duke u përcaktuar se konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë më marrjen dhe kalimin në favor të shtetit të:

- g) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale
- h) të produkteve të veprës penale ku përfshihet çdo lloj pasurie, dokument ose instrument ligjor që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë më pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale
- i) të shpërblimeve, të dhënë ose të premtuara për kryerjen e veprës penale
- j) të çdo pasurie tjetër vlera e së cilës i korrespondon asaj të produktit të veprës penale
- k) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë vepër penale, edhe kur është dhënë dënimi
- l) nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësuar me pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

²¹²Neni 30 i Kodit Penal të RSH.

²¹³Neni 36 i Kodit Penal, i ndryshuar me ligjin nr. 9086 datë 19.06.2003.

Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose janë pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale.

Konfiskimi penal nuk vepron ndaj personave të tretë kur pasuritë u përkasin atyre dhe në këtë mënyrë nuk mund të realizohet gjurmimi i pasurisë kriminale të fshehur në emër të të tretëve, aq më tepër kur pasuritë janë tjetërsuar ose u janë nënshtuar veprimeve simuluese të fshehjes. Gjithashtu, ky konfiskim varet nga procedimi penal, nga pozita procedurale e vetë zotëruesit të pronës, duke u varur në këtë mënyrë nga veprimi në kohë të ligjit. Në këtë mënyrë, nuk mund të evidentohet akumulimi afatgjatë i pasurive të përfituara nga aktiviteti kriminal i krimit të organizuar e trafikëve.

3.3. Legjislacioni shqiptar për masat parandaluese kundër pasurisë në Shqipëri, sekuestrimi dhe konfiskimi pasuror.

Legjislacioni shqiptar përvetësoi modelin e procedimit pasuror, autonom me procedimin penal, i cili ngarkon me barrën e provës zotëruesin e pasurisë, një formë e konfiskimit civil, që ka ndjekur rregullat civile e penale. Ky model ligjor ka pasur rrugëtimin e tij nga viti 2004²¹⁴ me ligjin e parë e në vijim duke u ndryshuar disa herë në përshtatje me normat e standardet ndërkombëtare, jurisprudencën e GJEDNJ, përvojën ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore vendase.

3.3.1. Masat parandaluese pasurore sipas legjislacionit të vitit 2004.

Konfiskimi, si masë parandaluese në Shqipëri u parashikua për herë të parë me ligjin “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, (ligji-këtej e tutje) i miratuar në vitin 2004²¹⁵, i cili u ndryshua në mënyrë

²¹⁴Ligji nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

²¹⁵Ligji nr. 9284 datë 30.09.2004 “Për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese.

thelbësore në vitin 2009²¹⁶ dhe më tej në vitin 2017²¹⁷, së bashku me paketën e ndryshimeve në kuadër të reformës në drejtësi. Me interes studimi dhe për zhvillimin historik të mendimit juridik shqiptar në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar është trajtimi i origjinës dhe tipareve të ligjit, zbatimi i tij në praktikë, problematikat e hasura, diskutimet juridike mbi çështjet e kushtetutshmërisë dhe barrën e provës.

Ligji nr. 9284, datë 30.09.2004, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*” parashikonte masa konkrete për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive. Ligji i vitit 2004 synoi realizimin e goditjes efektive të fenomeneve të krimit të organizuar, terrorizmit, trafikëve të paligjshme. Ky ligj dhe zbatimi i tij në vite, përbën një histori më vete të veprimit të tij²¹⁸, një risi për nga pikëpamja e natyrës ligjore e zbatimit të tij, një proces dinamik për nga mënyra e diskutimit të përputhshmërisë së tij me sistemin ligjor shqiptar që ka kaluar në një periudhë të shkurtër të gjitha fazat e zakonshme, me të cilat ballafaqohen ligjet e një natyre të tillë, që kanë impakt në të drejtat e shtetasve. Qëllimi i tij është jo vetëm të parandalojë dhe të ndëshkojë, por dhe të mbrojë interesat e palës së dëmtuar. Detyrimi i shtetit për të konfiskuar të ardhurat e paligjshme nga krimi i organizuar dhe trafikët vjen si rezultat i përmbushjes së detyrimeve, të cilat rrjedhin nga normat ndërkombëtare.

Hartimi i kornizës ligjore dhe krijimi i institucioneve për konfiskimin e produkteve të krimit u parashikua si një kusht i Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit dhe, si rrjedhim, Shqipëria duhej të ndiqte këtë standard. Pas nënshkrimit të Konventës së OKB për Krimin e Organizuar²¹⁹, të Konventës Evropiane “ Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të

²¹⁶ Ligji nr. 10 192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese”.

²¹⁷ Ligji nr. 70/2017 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese”.

²¹⁸ Raporti i Konferencës së organizuar nga Komisioni Europian , Misioni EURALIUS dhe Gjykata e Krimeve të Rënda “*Praktikat më të mira të drejtësisë penale - Aktiviteti i Gjykatës së Krimeve të Rënda kontribut solid në luftën kundër krimit të organizuar*”, mbajtur nga Sandër Simoni, 13 korrik 2012. [www.gjkr.gov.al](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/ligji_per_Gjykatën_e_Krimeve_te_renda-1.pdf)
https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/ligji_per_Gjykatën_e_Krimeve_te_renda-1.pdf

²¹⁹ Ligji nr. 8920 datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar “ dhe dy protokolleve shtesë të saj, , Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare, Tiranë 2006, botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, faqe 481

krimit”²²⁰ disa ndryshimeve në legjislacionin penal material e procedural, ndryshimeve në legjislacionin procedural penal²²¹, dhe miratimit të ligjit organik për fillimin e funksionimit të gjykatave të krimeve të rënda²²², adaptimi masave parandaluese pasurore si instrument ligjor dhe i së drejtës tonë përbënte një hap të rëndësishëm drejt efikasitetit të veprimit të ligjit shqiptar për konfiskimin e produkteve të veprës penale.

Ligji ishte një risi për sistemin ligjor penal shqiptar dhe për botëkuptimin rreth këtij sistemi. Qëllimi i këtij ligji ishte parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive. Fillimisht, si natyrë, konfiskimi i përkiste atij të natyrës civile, ndërsa hetimi e gjykimi i kërkesave mbi to, përveç parashikimit të veçantë mbështetëj në norma të procedimit penal, civil dhe administrativ. Procedimi pasuror ishte autonom ndaj procedimit penal dhe barra e provës për justifikimin e origjinës së ligjshme të pasurisë i përkiste personit të dyshuar që pasurinë e ka përfutur me veprimtari kriminale. Sipas ligjit, ai zbatohej edhe për pasuritë e paligjshme të personave të dyshuar, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.²²³

Për hartimin e ligjit ka shërbyer ligji italian, por situata ligjore dhe kushtetuese mes dy vendeve ishte e ndryshme. Italia, për të gjitha kodet e saj parashikon që të shoqërohen me ligje aplikuese, të cilat shpjegojnë dhe zhvillojnë më tej dispozita edhe institute të kodeve, duke i plotësuar ato në aspekte të caktuara, duke i bërë normat e ligjit të barasvlershme me ato të kodeve. Në këto kushte, ligjet plotësuese, lejohen të venë rregulla të reja ose ta detajuar në raport me kodet, por pa u konsideruar ato kontradiktore me kodin për shkak të diferencës së hierarkisë së normës juridike.²²⁴

²²⁰ Ligji nr. 8646 datë 20.07.2000 “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare, Tiranë 2006, botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, faqe256

²²¹ Ligji nr. 9276 datë 16.09.2004 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale në RSH”

²²² Ligji nr. 9110 datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, www.qpz.gov.al

²²³ Paragrafi 3 i nenit 3 të ligjit nr. 9284 datë 30.09.2005 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

²²⁴ Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “*Ligji Penal dhe Zbatimi i tij*”, Botime Albanian University, Tiranë 2014, fq. 23, referat Sandër Simoni

Qëllimi i këtij ligji ishte parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë të personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale. Në kuptim të ligjit, me masa parandaluese kuptohet çdo masë me karakter pasuror, e vendosur nga gjykata në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre²²⁵. Synimi i ligjit ishte parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova për vepra penale të përfshira në fushën e veprimit të ligjit.²²⁶

Karakteristika e fushëveprimit të këtij ligji është dhe ajo se ky ligj e zgjeron sferën e subjekteve duke vepruar dhe ndaj personave të tjerë si:

- a) bashkëshortit;
- b) fëmijëve;
- c) personave gjini ose krushqi e afërt me personin e dyshuar (të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërët, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrit, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka);
- ç) personave fizike ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme të pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.²²⁷

Praktika e procedimeve dhe gjykimeve të kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim në bazë të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar solli diskutime mbi disa çështje kryesore të zbatimit të këtij ligji.²²⁸ Sipas këtij ligji dhe më posaçërisht, në kuptimin e zbatimit e dispozitave

²²⁵ Shih Relacionin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. <https://www.parlament.al/dokumentacioni/projektligje/>, ora 13:22, datë 20.03.2017.

²²⁶ Veprat penale ku përfshihen a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe kryerjen e krimeve prej tyre;

b) pjesëmarrje në organizata terroriste ose në bandë armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe kryerjen e krimeve prej tyre;

c) kryerjen e krimeve të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme, kreu VII i Kodit Penal;

ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283/a e 284/a të Kodit Penal.

²²⁷ Paragrafi 2 i nenit 3 “Fusha e zbatimit të ligjit i ligjit.”

²²⁸ Kuptimi i nenit 4, pika 3 dhe nenit 28, pika 1 të Ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

të mësipërme, një nga çështjet e diskutueshme ishte se cila do të ishte gjykata kompetente për hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive: gjykata penale për krime të rënda, duke hetuar e gjykuar çështjen sipas rregullave të procedurës civile, apo gjykata civile.

Në lidhje me këto çështje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në një qëndrim unifikues²²⁹, mbajtën qëndrimin se pavarësisht nga formulimi dhe gjuha e përdorur, në përmbajtje pika 3 e nenit 4 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, përbën një normë me karakter rregullues të përgjithshëm që duhet kuptuar e interpretuar jo në mënyrë literale, por sipas qëllimit dhe vullnetit të ligjvënës, duke marrë parasysh edhe përmbajtjen në tërësi të dispozitave të këtij ligji. Sipas Vendimit të sipërcituar, ky ligj lidhet me zbatimin e një regjimi juridik të posaçëm për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, që burojnë apo lidhen me disa nga fenomenet më të rënda kriminale, me një lloj procedimi të posaçëm të natyrës parandaluese dhe goditëse ndaj këtyre fenomeneve, *ndonëse nuk është procedim penal, me anë të të cilit caktohen rregulla për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, për hetimin dhe gjykimin e veprave penale etj., në çdo rast, procedimi parandalues është i lidhur me ekzistencën dhe përfundimet e atij penal.*²³⁰Sipas këtij interpretimi të bërë nga Kolegjet Bashkuara të Gjykatës së Lartë, masat parandaluese pasurore, të parashikuara nga ky ligj, në parim, mund të gjejnë zbatim pasi ka filluar një procedim penal, ashtu edhe pas përfundimit të tij. Zbatimi i tyre është i lidhur me ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme, pra të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen nga personi i dyshuar të njëres prej veprave penale të treguara në nenin 3 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, apo edhe me vërtetimin e fajësisë së tij për kryerjen e këtyre veprave penale. Pra, këto masa zbatohen ndaj pasurisë së një personi të dyshuar, i cili, si rregull, i është nënshtruar apo i nënshtrohet hetimit a gjykitimit për kryerjen e këtyre veprave penale.

Meqenëse masat parandaluese pasurore janë të lidhura me dyshimin për kryerjen nga personi të një vepr penale²³¹, me dyshimin dhe prezumimin për zotërimin e prejardhjen e paligjshme të pasurisë për shkak e në lidhje me këtë veprimtari kriminale, si dhe me ekzistencën e një procedimi

²²⁹Vendimin Unifikues nr. 1 datë 25.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. www.gjykataelarte.gov.al

²³⁰Ky qëndrim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë solli dhe nevojën e ndryshimit të ligjit për të saktësuar në mënyrë të shprehur e për të sanksionuar pavarësinë nga procedimit penal, si një formë e konfiskimit pa dënim.

²³¹Neni 3, pika 1 e ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë. “

penal, me ecurinë dhe përfundimet e tij, atëherë edhe në procedimin parandalues hetimi dhe gjykimi i çështjes së masave parandaluese pasurore janë kompetencë të gjykatës penale. Për sa kohë në ligj nuk parashikohet ndryshe, atëherë për gjykimin e këtyre masave do të ishte kompetente gjykata, e cila, sipas K.Pr.Penale (neni 75/a), kishte në kompetencë gjykimin e krimeve të rënda, si dhe të atyre veprave penale (neni 3, pika 1 e Ligjit),²³² për të cilat gjejnë zbatim masat parandaluese.

Procedimi parandalues sipas ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, ishte autonom në raport me procedimin penal (dhe me atë civil). Procedimi preventiv mund të fillojë, vazhdojë e përfundojë, si gjatë edhe pas përfundimit të një procedimi penal. Nga ana tjetër, duke qenë procedime autonome, ato nuk janë procedime të tilla, të cilat përjashtojnë fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e njëra-tjetrës, për sa kohë pretendohet a vërtetohet se ka një person të dyshuar në kuptim të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 për kryerjen e një veprë penale, ndaj të cilit është duke u zhvilluar ose ka përfunduar një procedim penal. Autonomia e procedimit penal dhe atij parandalues, rezulton edhe nga përmbajtja e dispozitës së nenit 27 të ligjit²³³.

Ligji parashikonte rregulla të posaçme mbi kompetencat dhe procedurën, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedimin parandalues, ndërmjet të cilave evidentohet përcaktimi i barrës së provës së personave të dyshuar dhe personave të tjerë lidhur me justifikimin e origjinës së ligjshme të pasurisë së tyre.²³⁴ Ndryshe nga standardet e të provuarit dhe përgjegjësisë në dhënien e një vendimi penal, përfshirë urdhërimin për konfiskimin ose jo të sendeve të sekuestruara, në procedimin parandalues, sipas ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, vendosja e masës pasurore ka në themel të saj mundësinë, dyshimin e arsyeshëm, të mbështetur në të dhëna të mjaftueshme që rezultojnë nga tërësia e provave të marra dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

²³² Neni 3, Rrethi i personave të dyshuar, Ligji nr. 9284 datë 30.02.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

²³³ Neni 27, Marrëdhëniet me procedimin penal.

²³⁴ Për efekte të gjykit parandalues, nëse prokurori arrin të vërtetojë se ndaj një personi ka një procedim penal, masa sigurimi, apo një vendim dënimi për njërin nga veprat penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, atëherë kjo përbën provë me vlerë të plotë për të vërtetuar para gjykatës “dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova” për kryerjen e këtyre veprave penale, pra subjekti i procedimit penal ka edhe cilësitë e “personit të dyshuar” (nenet 1, 2, 3 të ligjit).

Ligji²³⁵ ka parashikuar prezumimin që, për shkak e pasojë të kryerjes së një veprimtarie kriminale (vepre penale) e cila i atribuohet ose është vërtetuar kundrejt personit të dyshuar, kemi të bëjmë me pasuri të cilat lidhen apo janë produkt i veprimtarisë kriminale, a përbëjnë përdorimin e tyre, të zotëruara direkt apo indirekt nga personi i dyshuar, të cilat formalisht, fiktivisht mund të mbahen edhe nga persona të tjerë (neni 3, pika 2 dhe neni 8), të fituara në mënyrë të paligjshme, pra që nuk justifikohen ligjërisht dhe që janë në shpërpjesëtim vlere me veprimtarinë e mundësitë ekonomike, me të ardhurat e deklaruara për qëllime fiskale etj., nga ana e këtyre personave. Pra, në ndryshim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshime të arsyeshme, prova të mjaftueshme e prezumime, duke iu ngarkuar personit të dyshuar dhe personave të tjerë, barra e provës për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Në procedimin parandalues nuk ka vend për vërtetimin domosdoshmërisht nga prokurori e gjykata të lidhjes shkakësorë, të drejtpërdrejtë, të dukshme e imediate, logjike e kronologjike, ndërmjet pasurisë, prejardhjes së saj dhe veprës penale, për të cilën, së paku, ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer nga personi i dyshuar.²³⁶

Ligji u aplikua në këtë kuptim deri në vitin 2007 nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 1, datë 25.01.2007, kanë gjykuar çështjen nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor të vendimit nr. 37, datë 10.07.2006, të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, Tiranë, e cila linte në fuqi vendimin nr. 39, datë 12.06.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, Tiranë, mbi sekuestrimin e pasurisë në mbështetje të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, unifikuan praktikën gjyqësore në lidhje me gjykatën kompetente për hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive, si dhe mbi gjykimin e çështjes²³⁷, interpretimin e kohës së vendosjes së konfiskimit²³⁸, të barrës së provës dhe të interpretimit të termave të vendosura mbi pezullimin dhe sekuestrimin²³⁹ Ajo çfarë paraqet interes për t’u cituar është ajo pjesë e Vendimit Unifikues të sipërcituar, që vlerësonte se, masat parandaluese pasurore, të parashikuara nga ky ligj, në parim,

²³⁵ Ligji nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”,

²³⁶ Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1 datë 25.01.2007.

²³⁷ Sqarimin dhe interpretimin e kuptimit të nenit 4 pika 3 dhe nenit 28 pika 1, të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004

²³⁸ Interpretimi i kohës së vendosjes së konfiskimit në zbatim të nenit 9 apo 7 të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004;

²³⁹ Interpretimi i termave të përdorur mbi pezullimin dhe sekuestrimit në nenet 9 e 10 të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004.

mund të gjejnë zbatim pasi ka filluar një procedim penal, ashtu edhe pas përfundimit të tij e se zbatimi i tyre është i lidhur me ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme, pra të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen nga personi i dyshuar të njëres prej veprave penale të treguara në nenin 3 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, apo edhe me vërtetimin e fajësisë së tij për kryerjen e këtyre veprave penale.

Nga përmbajtja e Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u konstatua se pengonte zbatimin dhe efektivitetin e ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004, pasi ndalon sekuestrimin dhe konfiskimin e të gjitha asetëve, fondeve apo pasurive të tjera, të blera ose të fituara nga personat e dënuar përpara se ndaj tij të hapej çështja penale. Kjo nuk përkonte me parimet, mbi të cilat ishte bazuar procedimi pasuror, pengohej lufta efektive kundër grupeve të krimit të organizuar, pasi masat e sekuestrimit dhe konfiskimit përbëjnë një aspekt themelor dhe vendimtar në këtë drejtim. Për sa më lart, në referim të dispozitave të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004, të unifikimit të praktikës ligjore lidhur me zbatimin e tyre të dhënë nga Gjykata e Lartë, u pa e nevojshme ndryshimi i ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”, për shkak të ndërhyrjes nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr. 1, datë 25/01/2007.

Sikurse u theksua më lart, u konstatua²⁴⁰ se ligji “*Për Parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”, por edhe vendimi unifikues nr. 1, datë 25.01.2007, kufizonte në mënyrë të konsideruar zbatimin dhe efektivitetin e ligjit, ndalonte sekuestrimin dhe konfiskimin e të gjithë asetëve, fondeve apo pasurive të tjera të blera apo të fituara nga personat e dënuar, përpara se ndaj tyre të hapej një çështje penale duke u penguar lufta kundër krimit të organizuar, prandaj dhe duhej ndërhyrë në përmbajtje të ligjit, duke saktësuar me këtë rast dhe disa çështje të rregullimit të kompetencës dhe procedurës.

3.3.2. Masat parandaluese kundër pasurisë sipas legjislacionit shqiptar të vitit 2009²⁴¹

²⁴⁰Nëpërmjet Progres Raportit të BE-së të vitit 2008, të eksperteve të misionit vëzhgues të vendeve anëtare të BE-së, mbi dialogun për liberalizimin e vizave.

²⁴¹Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ishte një ligj thuajse tërësisht i ri. Ai shfuqizoi ligjin e viti 2004 dhe ripërcaktoi procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, subjekte të këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikim dhe korrupsion apo krime të tjera²⁴². Në një vështrim të parë, vërehet se legjislatori përcaktoi një objekt më të gjerë, gjithë përfshirës, i cili nuk përfshinte vetëm parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, por edhe trafikimin e korrupsionit.

Në këtë ligj, u riformuluan dispozitave e neneve, që kishin të bënin me veprimi në kohë të ligjit, gjykatën kompetente, autonominë nga procedimi, të cilat ishin objekt unifikimi nga Gjykata e Lartë, si dhe u bënë shtesa e ndryshime, që synonin të zgjidhnin disa problemeve të evidentuara në praktikë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të tij. U ndryshuan rregullat me qëllim ndarjen e saktë të procesit civil të sekuestrimit/konfiskimit të pasurive të paligjshme nga procesi penal, duke vënë theksin se procedura zhvillohet kundër pasurisë dhe jo kundër personit. Për këtë qëllim u miratua një shtesë që në titull të ligjit, ku theksohet se me këtë ligj, goditja dhe parandalimi i krimit të organizimit realizohet nëpërmjet zbatimit të masave parandaluese kundër pasurisë. Masat parandaluese u përmbledhën në një koncept të vetëm për të lehtësuar kuptimin e tyre dhe përfshinë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë. Personi i dyshuar u la si përkufizim për të evidentuar faktin se personi i dyshuar nuk konsiderohet vetëm shtetasi, ndaj të cilit ka filluar, vazhdon apo ka përfunduar një procedim penal.

Ligji i vitit 2009,²⁴³ përcaktoi kriteret e caktimit të masës parandaluese (neni 2/3). Në ndryshim nga ligji i vitit 2004, ky ligj saktëson se masat parandaluese zbatohen ndaj pasurisë së personit të dyshuar (*in rem*) dhe jo ndaj personit (*in personam*). Kjo ndarje synon të lehtësojë kuptimin dhe zbatimin e ligjit në praktikë, *nëpërmjet përdorimit të procedurës civile për goditjen e këtyre pasurive*. Procedura civile, e drejtuar kundër pasurisë, ka avantazhin e barrës së provës që kalon tek personi, i cili zotëron këto pasuri dhe *niveli i të provuarit është dukshëm më i ulët se sa në procedurën penale*. Kjo zgjidhje pranohet në doktrinën bashkëkohore, *ku procedimi civil për*

²⁴² Shih neni 1 të ligjit nr. 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

²⁴³ Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

sequestrimin/konfiskimin është një procedim gjyqësor in rem, i cili vepron ndaj pasurisë (i shkëputur dhe në mënyrë autonome nga procedimi penal) përkundrejt procedimit penal kundër personit, i cili është procedim gjyqësor in personam. Në këtë të fundit, sequestrimi/konfiskimi janë veprime hetimore dhe rezultat i një vendimi të organit procedues mbi deklarinin fajtor të personit për një vepër penale. Ky procedim gjyqësor, i cili është një procedim gjyqësor sui generis, do të zhvillohet duke marrë në çdo rast për bazë parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut.

Rrethi i veprave penale, ndaj të cilave zbatohen masat parandaluese të pasurisë u zgjerua, lidhur me fushën e zbatimit të ligjit, u hoq kushti, që kërkohej për zbatimin e ligjit, “*të bazuarit në prova*” (për t’a përputhur me qëllimin e zbatimit të ligjit ndaj pasurisë dhe jo ndaj personit); u shtua parashikimi në lidhje me zbatimin e ligjit në kohë, duke parashikuar se ligji zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të ligjit, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtarinë kriminale në kohën e vënies së pasurisë. Në këtë mënyrë u zgjidh ngërçi i krijuar nga vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë në vitin 2007.²⁴⁴

Ligji vepron edhe për pasuritë e personave të dyshuar, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht kohës së përfshirjes së personit në veprimtari të paligjshme me kusht që kjo pasuri të jetë e implikuar nga veprimtari kriminale.²⁴⁵ Ligji përcakton procedurat verifikuese ndaj pasurisë dhe zgjeron fushën e veprimtarisë së ligjit, duke e shtrirë edhe tek trashëgimtarët e zotëruesit të pasurive të paligjshme nën një afat të caktuar²⁴⁶. Kjo dispozitë jep konceptin e personave të lidhur mes tyre, duke përfshirë në të edhe të afërmit. Në këtë mënyrë, kjo dispozitë shërben për të kuptuar më lehtë dispozitat e tjera të veçanta, që lidhen me rrethin e këtyre personave. Pas nenit 6 u shtua neni 6/1 “*Gjykimi*”. Në këtë nen të ri përcaktohen qartë dhe në përputhje me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, se kompetente për gjykimin e këtyre çështjeve ishte Gjykata për Krime të Rënda.

²⁴⁴ Për më shumë shih nenin 3 të titulluar “Fusha e zbatimit të ligjit”.

²⁴⁵ Paragrafi 4 i nenit 3 të ligjit “Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatëpërfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

²⁴⁶ Neni 3/1 i ligjit. “Fusha e zbatimit “që përcakton veprat penale në fushën e zbatimit të ligjit duke i saktësuar ata.

Në përputhje me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë u përcaktua edhe përbërja e trupit gjykues, i cili do të shqyrtojë këto çështje dhe konkretisht gjykata e shkallës së parë për krime të rënda do të gjykonte me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar (*gjykatë monokratike*) dhe në gjykatën e apelit për krime të rënda me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë (*gjykatë kolegjiale*). Në paragrafin e tretë është përcaktuar se këto gjykime do të bëhen sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të pajtueshme me natyrën e këtij procedimi gjyqësor. Barra e provës, e cila është një ndër elementët thelbësorë të këtij procedimi bie mbi personin, pasuria e të cilit i nënshtrohet këtij procedimi, për të vërtetuar origjinën e ligjshme të pasurive që ka fituar.²⁴⁷ Kur ekziston një rrezik real dhe konkret për humbjen, përvetësimin ose tjetërsimin e fondeve, të pasurive dhe të drejtave të tjera, për të cilat parashikohet zbatimi i masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji, prokurori, mund t'i kërkojë gjykatës të vendosë paraprakisht sekuestron e tyre, edhe përpara caktimit të datës së seancës gjyqësore.

Gjykata, me kërkesë të prokurorit, duke parashtruar arsyet përkatëse, vendos sekuestron e pasurive, për të cilat ka të dhëna se mund të jenë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të personit, ndaj të cilit zhvillohen hetimet sipas këtij ligji, kur vlera e tyre rezulton të jetë në përmasa që nuk u përgjigjet të ardhurave të deklaruara ose veprimtarisë ekonomike të zhvilluar prej tij, në bazë të të dhënave të mjaftueshme, ka shkaqe të bazuara për të menduar se këto sende janë produkt i veprimtarive të paligjshme ose përbëjnë investim të tyre. Prokurori mund t'i kërkojë gjykatës ta detyrojë personin, ndaj të cilit zhvillohen hetimet, ose ata që kanë titullin e pronarit apo zotërojnë çfarëdo titulli, fonde ose pasuri të çdo lloji, me vlerë që nuk përputhet me të ardhurat ose aftësitë e tyre ekonomike, që të justifikojnë ligjshmërinë e prejardhjes së tyre.

Kërkesa për konfiskimin e pasurisë dhe barra e provës. Masa e konfiskimit vendoset me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa. Konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe në raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit. Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi. Gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Me kërkesë të prokurorit gjykata

²⁴⁷ Neni 21 paragrafi 3 “Barra e provës për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurisë së të cilit kërkohet konfiskimi “

mund të vazhdojë gjykimin edhe në raste kur personi nuk ka banim të njohur brenda vendit, është larguar jashtë vendit ose, me gjithë kërkimet e bëra, nuk gjendet. Në këtë rast gjykata vendos mosgjethjen e personit, duke i caktuar atij një avokat. Avokati mund të caktohet kryesisht nga gjykata ose të zgjidhet nga të afërmit e personit. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, gjykata, kryesisht, me vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata, ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme.²⁴⁸

Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;
- b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe
- c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.²⁴⁹

Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur:

- a) procedimi penal i filluar ndaj personit pushohet nga organi procedues për shkak:
 - i) të pamjaftueshmërisë së provave;
 - ii) të vdekjes së personit;
 - iii) se personi nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;
- b) personi deklarohet i pafajshëm penalisht për shkak:
 - i) të pamjaftueshmërisë së provave;
 - ii) se vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet;
- a) personi është proceduar për një vepër penale, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është

²⁴⁸ Neni 21 i ligjit nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të rënda nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë “

²⁴⁹ Neni 24 “Pranimi i kërkesës për konfiskim “

jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji.

Me ligjin nr.24/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe “Për një ndryshim në ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, u përfshinë dhe veprat penale të kaluara në kompetencën e GJKR dhe nene të tjera të veprave penale kundër korrupsionit, si nenet 164/a, 244, 244/a, 245, 260, 312, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal. Për rrjedhojë ndryshoi emërtesa e ligjit, duke përfshirë edhe korrupsionin përveç krimit të organizuar e trafikeve²⁵⁰.

Kontrolli i kushtetueshmërisë së ligjit.

Ligji, ka qenë objekt i vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, e vënë në lëvizje me kërkesë të Komitetit Shqiptar i Helsinkit me objekt për kontroll kushtetutshmërinë me argumentin se cenonte të drejtën e pronësisë e të drejtat e individit mbi pronën. Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 4/2011²⁵¹ mori në shqyrtim kushtetutshmërinë e masave parandaluese, të parashikuara në ligj, duke arsyetuar se *ato cenojnë të drejtën e pronës, por kufizimet, nën parimin e proporcionalitetit, bëhen për një interes publik dhe janë në përpjesëtim me gjendjen që ka diktuar marrjen e këtyre masave, duke arritur në përfundimin se ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 është në përputhje me kërkesat e neneve 17, 35, 41 dhe 42 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 8 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit shtesë të KEDNJ-së*²⁵².

²⁵⁰Ligji nr.24/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe “Për një ndryshim në ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, së bashku me relacionet shoqëruese të tyre, ku në nenin 3 të tij u përfshinë dhe veprat penale të kaluara në kompetencën e GJKR²⁵⁰ dhe nene të tjera të veprave penale kundër korrupsionit, si nenet 164/a, 244, 244/a, 245, 260, 312, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal. Në këtë mënyrë, ndryshoi dhe emërtesa e këtij ligji, duke përfshirë përveç krimit të organizuar e trafikeve edhe korrupsionin

²⁵¹Vendimin nr. 4/2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH mbi padinë me kërkesë Komiteti Shqiptar i Helsinkit

²⁵²Neni 2 “Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.”

Në shqyrtim të pretendimeve për antikushtetutshmërinë e ligjit, Gjykata kushtetuese mbi pretendimin se shprehja “*dyschim i arsyeshëm bazuar në indicie*”, parashikuar në nenin 3 paragrafi 1 i ligjit nuk është në përputhje me standardin “*dyschim i arsyeshëm*”, parashikuar në nenin 27 paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe në nenit 5 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe në nenin 228 paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata arrin në përfundimin se ligji nuk shkel nenin 27, paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe pretendimi i kërkuesit është i pabazuar. Për pretendimin se ligji objekt shqyrtimi cenon të drejtën e pronës, të sanksionuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1, Protokollin 1 i KEDNJ-së, arriti në përfundimin se kufizimi i të drejtës së pronës, i garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1, Protokollin 1 i KEDNJ-së, nga ligji objekt shqyrtimi, nuk bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës.

Për pretendimet se ligji objekt shqyrtimi shkel disa elemente të procesit të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, gjykata arrin në përfundimin se nuk është i bazuar si pretendim. Për pretendimin se cenohet e drejta e ruajtjes së jetës private, garantuar nga nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së, Gjykata u shpreh se kjo e drejtë kushtetuese nuk cenohet me këtë ligj.

3.3.3. Masat parandaluese sipas ligjit të vitit 2017. Ndryshimi i natyrës së ligjit.

Ndryshimet e fundit me Ligjin nr. 70/2017 “Për një ndryshim në ligjin 10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*, erdhën si rezultat i ndryshimeve në tërësinë e paketës ligjore të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi, dhe si nevojë e përshtatjes së ligjit me natyrën e tij penale. Çështjet e praktikës gjyqësore dhe interpretimet e ndryshme nga gjykatat në lidhje me institutet e këtij ligji, në mënyrë të veçanti, lidhur me rrethin e personave ndaj të cilëve zbatohet ligji dhe pozita procedurale e tyre, veprimet procedurale të cilat duhet të kryente dhe kishte mundësi të zbatonte prokuroria gjatë fazës së hetimit pasuror dhe nëse referimi në rregullat e procedurës civile nënkuptonte disponibilitet të plotë të prokurorisë mbi kërkesën për konfiskim²⁵³

²⁵³Vendimin nr. 1 datë 16.01.2014 të Gjykatës së Shkallës së Për për Krime të Rënda dhe vendimin nr. 8 datë 02.04.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda sipas së cilëve heqja dorë e prokurorit nga gjykimi i kërkesë nuk çon detyrimisht gjykatën në vendimmarrjen për pushimin e saj sipas nenit 201/1 të KPrC, pasi prokurori nuk

e ngjashme me atë të disponimit të padisë, çështjet e të provuarit, të standardit të provës, kuptimi i indicies që mbështesin dyshimin për përfitimin e pasurisë kriminale etj.

Çështjet e sipërcituara kanë qenë të debatueshme gjatë zbatimit të ligjit në kohë. Sigurisht, fakti që procedimi pasuror, një procedurë e bazuar në rregullat e procedimit civil, mbështetej, kryesisht, mbi aktet e përfutuara nga procedimi penal si dhe institutet e procedimit civil zbatoheshin nga një gjykatë penale ishte një disavantazh në zbatimin e këtij ligji apo fakti që fusha e veprimit të këtij ligji përfshinte dhe pasurinë e vënë më kryerjen e veprave penale të cilat nuk ishin në kompetencës e gjykatës kompetente asaj të krimeve të rënda. Këto çështje sollën dhe nevojën e rishikimit të tij.

Me Ligjin i ri nr. 70 / 2017 datë 27.04.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*”,²⁵⁴ është synuar harmonizimi i përmbajtjes së ligjit me praktikën më të mirë të zbatimit të tij në këto vite si dhe zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme si pika të dobëta të tij sipas modeleve ligjore të përparuara dhe normave ndërkombëtare të fundit, siç janë direktivat e Komisionit Evropian.

Ndryshimi i rregullave procedurale në zbatim të këtij ligji sjell diskutimin mbi raportin e efektivitetit të procedimit pasuror me garancitë për mbrojtjen e pasurive të ligjshme të subjekteve të ligjit. Disa pyetje kërkojnë përgjigje. A kemi tashmë një procedim pasuror më efektiv e më pak instrumente në dorën e subjekteve të tij për t’u mbrojtur apo kemi avancim të garancive e mundësive për të justifikuar pasurinë e ligjshme? Çështja e natyrës së ligjit shqiptar është një çështje që ka interes shkencor për tu trajtuar nga pikëpamja teorike. Ndryshimet e fundit në ligj janë ndryshime thelbësore dhe si të tilla ka nevojë t’i jepet përgjigje pyetjes se cila është natyra e ligjit shqiptar pas këtyre ndryshimeve, cilës traditë ligjore i përket dhe nëse ligji ynë tashmë është tërësisht i natyrës penale pavarësisht se rregullon institutin e konfiskimit pasuror civil ?

gëzon tagër disponimi padie, meqenësë pasuria nuk është dhe interesi publik duhet të prevalojë në këtë rast, dhe vendimin nr. 224 datë 09.12.2014 të Gjykatës së Lartë që i prish këto dy vendime.

²⁵⁴ Ligji 70/2017 datë 27.04.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* është miratuar në Parlament me datën 24.07.2017 dhe ka hyrë në fuqi me datën 22.05.2017.

Për një pjesë të këtyre arsyeve dhe me qëllim që ligji t'i përafrohej më shumë modelit të suksesshëm të ligjit italian, është vlerësuar se ky ligj duhej të ndryshohej në vijim të ndryshimeve, që përfshinë legjislacionin shqiptar në kuadër të reformës në drejtësi prandaj u pa e nevojshme ndërhyrja në këtë fushë të posaçme, duke sjellë nevojën e një ligji të ri, i cili do të ishte gjithëpërfshirës dhe me një fushë zbatimi më të gjerë. Ligji i ri nr. 70/ 2017 datë 27.04.2017 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*” i ndryshuar tashmë ka hyrë në fuqi dhe është në zbatim. Ky ligj me ndryshimet përkatëse ka synuar harmonizimin dhe me legjislacionin procedural penal, i cili ishte ndryshuar, si dhe ta sjellin atë në përputhje me të gjithë paketën ligjore në kuadër të Reformës në Sistemin e Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Për ndryshimet që ka pësuar ky ligj, legjislatori është mbështetur në rregullimet e ligjit italian duke i dhënë atij një natyrë penale.²⁵⁵

Qëllimi i rishikimit ishte nevoja për qartësimin e aplikimit e tij në procesin penal dhe procesin civil, saktësimin e natyrës së çështjeve që ai trajton, të pozitës së prokurorit në këto çështje dhe të fuqisë së vendimit gjyqësor të formës së prerë në raport me përfundimet eventuale të gjykatës që trajton një çështje penale të lidhur me këtë ligj. Që në titull ligji ka ndryshuar duke reflektuar rrethin e veprave penale për të cilat zbatohet masat parandaluese kundër pasurisë si: krimi i organizuar, trafikimi, korrupsioni dhe krimeve të tjera. Rrethi i personave, ndaj të cilëve zbatohet ligji është kufizuar te personat e afërm, si: bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesit. Pasuria e regjistruar në emër të tyre prezumohet se është regjistruar në mënyrë të rreme dhe se gëzimi i përket personit të dyshuar. Pra, nga njëra anë është kufizuar numri i personave të afërm, por nga ana tjetër është shtuar një tjetër prezumim ligjor, i cili bën më të qëndrueshme barrën e provës që bie mbi të dyshuarin dhe personat e afërm, por gjithmonë kur ka të dhëna të dobishme të siguruar në mënyrë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për origjinën e sendeve.

²⁵⁵Decreto legislativo 6 settembre 2011, n.159 Codice delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione, nonce nuove disposizione in material di documentazione antimafia, a norma degli articoli 1 e 2 della legge 13 agosto 2010,

Ligji 2017 ka përcaktuar si standard të provës atë të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për regjistrimin e rremë, i cili duhet të jetë i mbështetur në prova dhe jo në indicie, por “*të dhëna të dobishme të siguruara në rrugë të ligjshme*”, gjë që nënkupton se ekziston një garanci më tepër. Ndërkohë, për personat e tjerë fizikë ose juridikë, të dhënat e nevojshme nxirren nga marrëdhëniet midis palëve, si dhe të dhëna të tjera të dobishme të siguruara në mënyrë të ligjshme. Ligji zbatohet edhe për pasuri të vëna para hyrjes në fuqi të ligjit dhe kërkohet vetëm ekzistenca e indicieve për pjesëmarrje në veprimtari kriminale dhe se pasuria të jetë vënë gjatë kësaj veprimtaria. Dy momente janë të rëndësishme: *së pari*, mjafton të ketë të dhëna indiciare dhe jo dënim penal për pjesëmarrje në veprimtari kriminale; *së dyti*, bëhet fjalë për çdo lloj pasurie të paligjshme, jo vetëm atë të vënë nga veprimtaria kriminale që buron nga veprat penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit. Një ndryshim të rëndësishëm përbën parashikimi se verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas këtij ligji, do të rregullohet nga dispozitat procedurale të këtij ligji dhe ato të Kodit të Procedurës Penale dhe se të dhënat që rrjedhin nga procedimi penal përdoren edhe në procedimin pasuror, sipas procedurës së këtij ligji²⁵⁶. Ky ndryshim është i pritur dhe i shkon përshtat detyrës hetimore të prokurorit dhe sjell procedimin pasuror në ambientin të cilit i përket. Prokurori nga verifikimet kalon në kryerjen e veprimeve hetimore, duke përfshirë edhe marrjen në pyetje të personave që kanë dijeni për faktet objekt të këtij ligji, si edhe kryerjen e ekspertimeve të nevojshme.

Përsa i përket juridiksionit, risia e ligjit është se shqyrtimi i masave parandaluese nuk është më ekskluzive e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar, por i kalon edhe Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, për veprat penale në kompetencën lëndore të tyre. Ligji parashikoi rregullimin përkatës për periudhën tranzitore deri në krijimin e Gjykatave të Posaçme e Prokurorisë së Posaçme.²⁵⁷ Me krijimin e tyre, më datë 19 dhjetor 2019, kërkesat për konfiskim të pasurive të dyshuara se janë vënë me veprimtari kriminale, që nuk ishte në kompetencën e GJKKO, u transferuan në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale, të kryer në bazë të nenit 75/a të KPrP.

²⁵⁶ Neni 5, pika 2 e ligjit nr. 70/2017 datë 27.04.2017 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*”

²⁵⁷ Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroria e Posaçme filluan veprimtarinë më datë 19 dhjetor 2019.

Roli aktiv i gjykatës rritet dhe gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, mund të urdhërojë hetimin e nevojshëm²⁵⁸, duke bërë që veprimtaria hetimore të shtrihet te gjykata. Ligji kur parashikon kërkesën e prokurorit drejtuar gjykatës për zbatimin e sekuestrimit ose konfiskim kërkon që kjo kërkesë të jetë e arsyetuar, duke mos përdorur më termin “*e motivuar*”²⁵⁹. Në mënyrë të shprehur parashikohet se gjykimi i kërkesës për sekuestrimin e pasurisë bëhet në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve, në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori, duke marrë në konsideratë barazinë e palëve. Detyrimin për caktimin e seancës për konfiskimin e pasurisë²⁶⁰, brenda pesë ditëve nga mbarimi i afatit të vendimit të sekuestros e ka kryesisht gjykata dhe jo më, me kërkesë të prokurorit, pasi kërkohet njoftimi i prokurorit, personave të parashikuara nga pika 1 dhe 2 e nenit 3, si edhe mbrojtësin e zgjedhur²⁶¹.

Ligji parashikoi mundësinë e thirrjes gjatë fazës së konfiskimit të personave të tretë e ne veçanti mundësisë së mbrojtjes së pasurisë nga ana e personit të tretë në mirëbesim, si dhe i sanksioneve për të tretët në keqbesim.²⁶² Në lidhje me pasuritë, të cilat me anë të veprimeve juridike janë transferuar tek të tretët kur janë në *male fides*, parashikohet sekuestrimin apo konfiskimin mbi pasuri të barasvlershme, sigurisht duke mbrojtur *mirëbesimin e personave të tretë*, duke parashikuar se gjykata vendos sekuestrimin apo konfiskimin e pasurive, të cilat i kanë kaluar personave të tretë dhe vetëm kur këta të fundit janë me keqbesim e duke parashikuar detyrimin e gjykatës që gjatë konfiskimit t’i thërrasë ata në proces.²⁶³ Nenet 13 dhe 14²⁶⁴ të ligjit riformulohen plotësisht, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë interesit publik dhe duke e konsideruar *fazën e ekzekutimit të masës parandaluese si pjesë të procesit të rregullt ligjor*, si dhe duke gjetur zbatim edhe në rastin kur gjykata refuzon kërkesën për konfiskim, pasi shtohet neni 24/a²⁶⁵. Në nenin 5 pika 2, ligji parashikon se verifikimi, hetimi dhe gjykimi i masave parandaluese rregullohet nga procedura e këtij ligji dhe ajo e Kodit të Procedurës Penale, për fazën e ekzekutimit, ligji i referohet

²⁵⁸ Neni 10 i ligjit nr. 70/2017.

²⁵⁹ Neni 11 i ligjit nr. 70/2017.

²⁶⁰ Kur seanca e posaçme sipas pikës 4 të këtij neni nuk caktohet, gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, konstaton shuarjen e masës së sekuestrimit. Shuarja e masës së sekuestrimit nuk pengon paraqitjen dhe pranimin e një kërkesë të re për konfiskimin e pasurisë”,

²⁶¹ Neni 12 i ligjit nr. 70/2017.

²⁶² Shtesa në nenet 12/a dhe 12/b të ligjit.

²⁶³ Neni 22 i ligjit.

²⁶⁴ Nenet 14 dhe 15 i ligjit nr. 70/2017.

²⁶⁵ Neni 26 i ligjit nr. 70/2017.

Kodit të Procedurës Civile dhe si autoritete të cilat merren me këtë fazë janë policia gjyqësore dhe administratori i pasurisë, duke përjashtuar përmbaruesin gjyqësor, për me tepër ligji i referohet Kodit të Procedurës Civile.

Detyrimi i barrës së provës, shtrihet jo vetëm ndaj personave subjekte të drejtpërdrejta të ligjit por edhe ndaj personave familjarë e të afërm. Në rastin e personave, të cilët mbajnë në mënyrë fiktive pasuritë e subjekteve, këta të fundit *kanë barrën e provës për të treguar se të dhënat e grumbulluara nga prokuroria janë të pamjaftueshme*, pra mbi to nuk bie detyrimi për të provuar ligjshmërinë e pasurive të tyre dhe faktin që ato nuk i përkasin personit të dyshuar, por duke u mjaftuar me të provuarin se të dhënat e grumbulluara nga prokuroria janë të pamjaftueshme, duke shkuar në kah të kundërt me parimin *in dubio pro reo*.

Autonomia e procedimit pasuror në raport të procedimit penal, sanksionohet në nenin 24, pika 3 e ligjit nr. 10192/2009 duke sanksionuar të drejtën e gjykatës për të disponuar me konfiskimin e pasurisë në rastin kur akuza apo procedimi penal ndaj personit të dyshuar është pushuar apo është shpallur i pafajshëm, në çdo prej rasteve kur merret vendim pafajësie apo pushohet çështja penale, me përjashtim të rastit kur fakti nuk ekziston, nuk parashikohet nga ligji si vepër penale apo del se i pandehuri nuk ka kryer veprën penale. Kur vendimi i konfiskimit priset nga një gjykatë më e lartë, me vendim të formës së prerë t'i kthehet prona e tij, duke ruajtjen e të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim sipas Kodit Civil²⁶⁶.

Ndryshimi i rregullave procedurale në zbatim të këtij ligji sjellin diskutimin për raportin e efektivitetit të procedimit pasuror me garancitë për mbrojtjen e pasurive të ligjshme të subjekteve të ligjit. Ligji referon në rregullat e procedurës penale tashmë një mundësi për të përdorur institutet e procedurës penale në mbledhjen e provave, një mundësi që ligji i vjetër nuk e lejonte pasi për zbatimin e normave plotësuese procedurale përcaktoheshin ato civile. Kjo ndihmon organin procedues pasuror prokurorinë që në verifikimin, hetimin dhe kryerjen e veprimeve procedurale t'u referohet normave të zbatueshme nga ana e tyre në procedimin penal, çka ndihmon në përdorimin e provave të procedimit penal e rrit ndjeshëm efikasitetin e rezultateve të procedimit pasuror. Një nga hipotezat që është ngritur në këtë punim është ajo nëse referimi në rregullat e

²⁶⁶ Neni 31 i ligjit nr. 70/2017.

procedurës penale, kufizon mundësinë e përmbushjes së barrës së provës për subjektin e ligjit, personave të tretë, për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë, përfundimin, në të cilin kam arritur do ta shtjelloj në kapitujt vijues mbi provat dhe barrën e provës.

Ligji zbatohet edhe për pasuri të vëna para hyrjes në fuqi të ligjit dhe kërkohet vetëm ekzistenca e indicjeve për pjesëmarrje në veprimtari kriminale dhe se pasuria të jetë vëne gjatë kësaj veprimtarie. Edhe ky ligj bazohet në *konfiskimin pa dënim*, që do të thotë se nuk është e nevojshme dënimi i personit për të vendosur konfiskimin e pasurisë së tij, *por vetëm indicie se ka kryer veprat penale në fushën e veprimit të këtij ligji*.

Objekti i të vepruarit të ligjit tashmë është zgjeruar duke përfshirë brenda fushës së veprimit të tij dhe veprat penale të tjera, nga ato të cilat kishte ligji i vjetër.²⁶⁷ Në fushën e veprimit të tij janë shtuar veprat penale të korrupsionit në tërësi si dhe gjithë veprat penale që janë tashmë në kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sipas ndryshimeve në nenin nr. 75/a të KPrP²⁶⁸ të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “*Për disa ndryshime në KP*”. Çfarë mbetet më e rëndësishme në këtë ndryshim është përfshirja e veprave penale në fushën e korrupsionit dhe të theksuarit se, në këtë rast, fillon procedimi pasuror *kur ka indicie për përfitim pasuror të paligjshëm*.²⁶⁹ Zgjerimi i veprave penale të tjera në fushën e veprimit të këtij ligji, njëkohësisht, me mundësinë që ky ligj të përdoret dhe nga juridiksioni i zakonshëm i prokurorive dhe gjykatave, rrit mundësitë e këtyre organeve për të bërë të mundur hetimin pasuror për vepra penale, të cilat nuk janë më në kompetencën e prokurorisë dhe gjykatës së posaçme, por

²⁶⁷ Sipas ndryshimit në pikën 1 të ligjit, Objekti është shtuar shprehja “...dhe krime të tjera”

²⁶⁸ Neni 75/a “Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.”.

²⁶⁹ Shkronja d) paragrafi i parë i nenit 3, të ligjit, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017

në të njëjtën kohë lë dyshime për efikasitet në procedurat e hetimit pasuror, një procedurë, e cila kërkon një specializim dhe një kujdes të posaçëm gjatë aplikimit.²⁷⁰

Në vlerësimin tonë, ngushtimi i rrethit të personave ndaj të cilëve vepron ligji antimafia është një nga hapat pozitive të ndërmarrë. Tashmë dispozitat e ligjit zbatohen ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1 të nenit 3 të tij,²⁷¹ në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga persona të afërm e konkretisht bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, të paralindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi, për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë i pasurisë.²⁷² Disa çështje të natyrës së ligjit mbeten për t'u diskutuar nëse ka parashikime të mjaftueshme, a duhet të jetë një ligj i natyrës penale e të referojë në rregullat e procedurës penale, a mbron të tretët dhe si duhet të kuptohet autonomia ndaj procedimit penal kur merret një vendim pafajësie.

3.3.4. Masat parandaluese pasurore në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike sipas Aktit Normativ nr. 1/20.

Me Aktin Normativ nr. 1 datë, 31.01.2020²⁷³ “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike*” u miratuan disa masa me karakter të përkohshëm, në kuadër të forcimit të luftës ndaj organizatave, grupeve të strukturuar kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe individëve të përfshirë në krime të rënda. Ai synonte një ndërhyrje emergjente dhe me karakter të përkohshëm në kushtet e nevojës së forcimit dhe ashpërsimit të luftës kundër krimit të organizuar, organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, apo individëve të përfshirë në krime të rënda me synim konsolidimin e sigurisë në vend. Arritja e këtij qëllimi synohej të arrihej duke vendosur disa masa parandaluese me karakter pasuror dhe ekonomik. Kjo për shkak se zbatimi i ligjit për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar nuk kishte qenë shumë efektiv,

²⁷⁰ Sandër Simoni, “*Konfiskimi i produkteve të veprës penale si masë parandaluese pasurore*”, Botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, përmbledhje e punimeve të Konferencës Shkencore Kombëtare “*Krimet Financiare, Pastrimi i Parave dhe Siguria Kombëtare*”, shkurt 2021, faqe 416

²⁷¹ Neni 3, Fusha e zbatimit, e ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

²⁷² Neni 3, paragrafi 2, shkronja a), e ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

²⁷³ Aktin Normativ nr. 1 datë 31.01.2020 “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike*”

nuk kishte rezultate të dukshme e pak procedime pasurore ishin regjistruar. Nëpërmjet këtij Akti normativ synohej që të kishte më zhdërvjelltësi në vendosjen e masave parandaluese pasurore por dhe atyre personale të personave, të cilët kishin kryer një vepër penale në ato të përcaktuara.

Sipas Aktit Normativ të miratuar në bazë të nenit 101 të Kushtetutës nga Këshilli i Ministrave.²⁷⁴ subjekt i tij janë personat, të cilët janë të dënuar apo janë nën hetim për veprat penale të parashikuara nga neni 5 i tij, ndër të cilat dhe veprat penale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Duket qartë se ky Akt Normativ ka synuar të parashikojë me këtë formë legjislative masat e sigurimit personal, përveç atyre pasurore duke marrë si model pikërisht pjesën e parë të Kodit Antimafia Italian, *dekretligjit 159 të majit 2011*²⁷⁵. Ndryshe nga ligji për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar Akti Normativ parashikon si fushë të veprimt të tij një numër më të madh të veprave penale ku futen ato të krimit të organizuar dhe krimeve të tjera të rënda penale, neni 5 i tij.²⁷⁶

Gjithashtu, si të tillë ishin personat, që *deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ ishin persona nën hetim, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë*, me përjashtim të personave, për të cilët ka vendim të pushimit të akuzës apo të çështjes penale, për pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata kriminale, banda e armatosur dhe grupi i strukturuar kriminal, pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata terroriste e të krimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal dhe kryerjen e një sërë krimesh të tjera të rënda.

Si subjekt i këtij ligji ishin dhe personat fizikë dhe juridikë, shtetas shqiptarë apo të huaj, si dhe persona pa shtetësi, për të cilët ka filluar procedura e shpalljes apo për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara në elemente të faktit për përfshirje në çdo formë të terrorizmit dhe të financimit të tij,

²⁷⁴Ky akt normativ është miratuar me datën 31.01.2020, duke u botuar në Fletoren Zyrtare e hyrë menjëherë në fuqi. Sipas nenit 101 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme.

²⁷⁵Dekreti Legjislativ 6 shtator 2011 n. 159, (Itali) Kodi antimafia dhe masat parandaluese.

²⁷⁶Sipas nenit 5, "Subjekti", pika 1 dhe 2, Subjekte të këtij akti normativ, janë personat, që deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ janë dënuar me vendim penal të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të personave, për të cilët ka vendim pafajësie dhe ata për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 109, 109/b, 110/a, 114, 117, 128/b, 134, paragrafi i tretë, 136, 138/a, 139, 140, 141, 151, 152, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284 dhe 284/a, të Kodit Penal;

të kryera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi, për masat kundër financimit të terrorizmit. “Konfiskim” sipas këtij Akti, është kalimi në favor të shtetit, heqja e së drejtës së pronësisë me urdhër të autoritetit kompetent në kushtet e privimit të plotë apo të pjesshëm dhe pa kompensim të pasurisë që buron drejtpërdrejt apo tërthorazi nga krimi. “Element i faktit” është tërësia e të dhënave apo njohurive që sigurohen nga policia në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj në zbatim të legjislacionit përkatës dhe që vlerësohet se mund të përbëjnë faktin, ngjarjen apo rrethanë të faktit.

Masat parandaluese me karakter pasuror do të zbatohen *për subjektet e përmendura në nenin 5, ndaj pasurive të personave të parashikuar në nenin 5, të këtij akti normativ, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga personat e afërm (bashkëshortët, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëjetuesit për periudhën e 5 viteve të fundit), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta* si dhe ndaj personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e parashikuar në nenin 5, si subjekte të këtij akti normativ, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

Për personat subjekt të këtij ligji, në rast se nga verifikimet paraprake të cilat çojnë në *dysshimin e arsyeshëm bazuar në elemente të faktit* rezulton se posedojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, *pasuri, të drejta ose veprimtari ekonomike, tërësisht ose pjesërisht të pajustificuara në raport me nivelin e të ardhurave ose fitimeve që rrjedhin nga veprimtaritë e ligjshme të deklaruara sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, struktura përkatëse e policisë (Operacioni Forca e Ligjit)* kërkon paraqitjen nga ana e subjekteve, *brenda 48 orëve të deklarimit në formën e një vetëdeklarimi.*

Masa parandaluese me karakter pasuror është masë parandaluese, e cila jepet me vendim të Gjykatës, nisur nga dyshimi i arsyeshëm bazuar në elementë të faktit, rezulton se posedojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë pasuri të drejta ose veprimtari ekonomike tërësisht ose pjesërisht të pajustificuara në raport me nivelin e të ardhurave ose fitimeve. Masat parandaluese me karakter pasuror do të zbatohen: a)për subjektet e përmendura në nenin 5 b)ndaj pasurive të

personave të parashikuar në nenin 5, të këtij akti normativ, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:²⁷⁷

- i. personat e afërm (bashkëshortët, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëjetuesit për periudhën e 5 viteve të fundit), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta;
- ii. personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e parashikuar në nenin 5, si subjekte të këtij akti normativ, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

Ndërsa masa parandaluese pasurore e konfiskimit për pasuritë që administrohen, posedohen ose janë në pronësi të subjekteve sipas parashikimit të nenit 16, të këtij akti normativ, vendoset me kërkesë të prokurorit, i cili i paraqet gjykatës në mënyrë të argumentuar arsyet ku bazohet kërkesa.²⁷⁸ Kur mbi pasurinë është vendosur masa e sekuestros, ka dyshime të arsyeshme, bazuar në elemente të faktit, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale, të parashikuara në nenin 5 të këtij akti normativ e nuk mund të provohet përpara gjykatës origjina e ligjshme e burimit të krijimit të pasurisë apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që janë shpërpjesëtimore dhe nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre.

Me kërkesë të prokurorit gjykata mund të vazhdojë gjykimin edhe në raste kur personi nuk ka banim të njohur brenda vendit, është larguar jashtë vendit ose me të gjitha kërkimet e bëra nuk gjendet. Në këtë rast, gjykata vendos mosgjjetjen e personit, duke i caktuar atij një avokat. Avokati mund të caktohet kryesisht nga gjykata ose të zgjidhet nga të afërmit e personit. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë u përkasin personave të tretë, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata, ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme. Kur vërtetohet se disa pasuri i janë transferuar apo janë

²⁷⁷ Sipas Kreut II, "Masat parandaluese me karakter pasuror".

²⁷⁸ Neni 24 i Aktit Normativ.

regjistruar në emër të të tretëve, me veprime juridike fiktive ose të simuluara, gjykata konstaton pavlefshmërinë e këtyre veprimeve juridike. Për këtë qëllim, kur nuk provohet e kundërta, prezumohen fiktive ose të simuluar.

Për sa i përket gjykatës kompetente ky Akt e ka një përcaktim të qartë të vullnetit legjislativ tashmë ²⁷⁹ në lidhje me përcaktimin e Gjykatës së Posaçme si e tillë. Në nenin 9 të këtij akti të titulluar “*Gjykata dhe Prokuroria kompetente në kuptim të këtij akti normativ*” është parashikuar “*Kërkesa për marrjen e masave parandaluese dhe kundërshtimi i masave të marra sipas përcaktimeve të këtij akti normative shqyrtohen në shkallë të parë nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi*”.

Që nga hyrja në fuqi e këtij akti nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u miratuan një sërë kërkesash për sekuestrim të pasurive sipas neneve 15 e vijues të tij dhe po vijon shqyrtim i një numri të madh kërkesash për konfiskim pasurie sipas nenit 23 e vijues të këtij akti. Në aspektin rregullator ligjor tashmë ky Akt Normativ tashmë i kthyer në ligj ka të përcaktuar elementët e zbatueshmërisë së tij, efekt i cili ka vijuar për një periudhë 1-vjeçare nga kjo gjykatë dhe normat rregullatore të tij mbi masat parandaluese pasurore, në këtë rast, si procedime *in rem* janë të ngjashme me ato të parashikuara nga ligji tjetër ai nr.10192 “*Për parandalimin dhe goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, ndryshuar me ligjin nr. 70/2017. Akti normativ në nenin 9²⁸⁰ të tij ka përcaktuar se kërkesa për marrjen e masave parandaluese sipas përcaktimit të këtij akti normativ shqyrtohet në shkallë të parë nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Masat parandaluese me karakter pasuror dhe ekonomik të parashikuara në këtë *akt normativ* nuk vendosen ndaj pasurisë që para hyrjes në fuqi të këtij akti është në proces të shqyrtimit gjyqësor ose për të cilën është disponuar me vendim gjykate në zbatim të legjislacionit penal, ligjit për

²⁷⁹Me ligjin nr.18/2020 nga ana e Kuvendit është miratuar akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 1 datë 31.01.2020 i Këshillit të Ministrave.

²⁸⁰Neni 9 i Aktit Normativ nr. 1 datë 31.01.2020 “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike*.”

parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë si dhe legjislacionit për financimin e terrorizmit. Masat parandaluese zbatohen ndaj subjekteve që janë personat që janë dënuar apo janë nën procedim për vepra penale të krimit të organizuar apo vepra penale të rënda, ndërsa ato parandaluese pasurore përveç këtyre subjekteve zbatohen edhe ndaj personave familjarë e të afërm të tyre.

Masat parandaluese të karakterit pasuror të parashikuara janë:

1. Sekuestrimi i pasurisë me vendim të gjykatës
2. Sekuestrimi i pasurisë nga policia në rastet e emergjencës
3. Konfiskimi i pasurisë

Ky Akt Normativ është në zbatim prej më shumë se dy viteve nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.²⁸¹ Një numër kërkesash relativisht të larta për sekuestrim ishin miratuar e tashmë janë në fazën e konfiskimit. Disa çështje që lidhen me tiparin legjislativ të zgjedhur, përkohshmërinë, nevojën, mbivendosjen me veprimin e ligjit antimafia, sanksionit penal të procesit e natyrës civile të normës referuese, kompetenca e dhënë Policisë së Shtetit me sekuestrimin, si dhe fakti nëse parimet e rëndësishme si barra e provës, prezumimi i pafajësisë, barra kufizuese e provueshmërisë, barazia e palëve në proces, kanë shoqëruar këtë periudhë të zbatimit të tij.²⁸²

Një ide për ndryshimin e kompetencës ekskluzive për Gjykatën e Posaçme është diskutuar, me qëllim që kompetenca e Gjykatës së Posaçme të jetë vetëm për kërkesat për konfiskimin e pasurive

²⁸¹ Akti normative nr. 1 datë 31.01.2020 i Këshillit të Ministrave “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, i miratuar me ligjin nr. 18/2020, parashikonte afatin 1-vjeçar të kohëzgjatjes së tij. Me Aktin tjetër Normativ nr. 35 datë 16.12.2020 “Për një shtesë në Aktin normative nr. 1 datë 31.01.2020 i Këshillit të Ministrave “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, u parashikua që “Kërkesat për marrjen e masave parandaluese të depozituara nga Drejtori i Përgjithshëm i policisë së shtetit deri më datën 31.12.2020, vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykata dhe prokuroria kompetente, të përcaktuara në nenin 9 sipas kompetencës, rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë akt normative “

²⁸² Sandër Simoni, “Konfiskimi i produkteve të veprës penale si masë parandaluese pasurore“ Botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, përmbledhje e punimeve të Konferencës Shkencore Kombëtare “Krimet Financiare, Pastrimi i Parave dhe Siguria Kombëtare “, shkurt 2021, faqe 416

të subjekteve të dyshuar se këtë pasuri e kanë vënë me vepra penale në kompetencën e Gjykatës së Posaçme siç janë ato të krimit të organizuar e korrupsionit. Tendencia legjislative për parashikimin e masave parandaluese të reja mund të zbusë efektivitetin e zbatimit të ligjit kryesor atë për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar e duke sjellë ngadalësimin e zbatimit të tij. Ka pasur diskutime për aspektin kushtetues nëse koncepti i nevojës imediate justifikon nga pikëpamja kushtetuese masa të tilla të miratuara me *Akt Normativ*, ndërkohë që ekziston një ligj i ngjashëm në fuqi, e nëse përkohshmëria e *Aktit Normativ* cenon parimin e sigurisë juridike.

Objekti i Aktit Normativ, sa i takon masave me karakter pasuror, është i njëjtë me ligjin antimafia, po kështu, qëllimi i aktit normativ konsiston në forcimin dhe ashpërsimin e luftës kundër krimit të organizuar, me synimin për konsolidimin e sigurisë në vend, ndërsa qëllimi i ligjit antimafia është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar etj., përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.

Akti Normativ kishte parashikuar një periudhë zgjatje një-vjeçare, por për shkak të numrit të madh të kërkesave për konfiskim, për të cilat ishte marrë vendim sekuestrimi, efektet e zbatimit të tij u zgjatën deri në përfundimin e shqyrtimit të tyre. Për rrjedhojë ky akt është në zbatim e sipër.

Disa çështje ligjore të Aktit Normativ nr. 1 datë 31.01.2020, duhet të rishihen për këtë periudhë të mbetur të zbatimit të tij. p.sh :

- Kompetenca e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shqyrtimin edhe të kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim për pasuritë e fituara nga veprimtari kriminale, që nuk është në kompetencën e këtyre Gjykatave. Sipas vlerësimit tonë, kompetenca e Gjykatës së Posaçme duhet të jetë vetëm për kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim të pasurive të dyshuar si të përfituara nga kryerja e veprave penale në kompetencën e kësaj gjykate sipas nenit 75/ a të KPrP.²⁸³

²⁸³ Kërkesa për marrjen e masave parandaluese dhe kundërshtimi i masave të marra sipas përcaktimeve të këtij akti shqyrtohen në shkallë të parë nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sipas përcaktimeve të legjislcionit në fuqi.

- Sa i takon kompetencës lëndore për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e masave parandaluese me karakter pasuror, kjo kompetencë do të përcaktohet sipas neneve 148/dh dhe 135 të Kushtetutës, neni 75/a të KPP dhe nenit 7 të ligjit antimafia me nr. 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, apo, sipas nenit 9 të Aktit normativ nr. 1, datë 30.1.2020;
- Në kushtet kur akti normativ dhe ligji antimafia kanë të njëjtin objekt rregullimi, sa i takon masave parandaluese me karakter pasuror dhe ligji antimafia që është në fuqi, cilat dispozita do të zbatojë gjykata, nëse nuk çmon se dispozitat e aktit normativ vijnë në kundërshtim me Kushtetutën;
- Sa i takon veprës penale, që e kualifikon një person si subjekt të masave parandaluese me karakter pasuror, kur për veprën penale kryesore ka pasur në vijim një procedim penal për pastrim të produkteve të saj, e tillë do të konsiderohet vepra penale kryesore për të cilën personi është dënuar, apo vepra penale e prejardhur, ajo e pastrimit të produkteve të saj, parashikuar nga neni 287 i KP;
- Kur i dyshuari për pastrim të produkteve të veprës penale është i njëjti person që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet, në kuptim të nenit 287(4) ²⁸⁴c, të KP, a konsiderohet shterues hetimi për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, edhe sa i takon hetimit pasuror, nisur nga vetë natyra specifike e veprës penale të prejardhur në këtë rast;
- Në këtë hipotezë të fundit, cili është efekti apo si ndikon vendimi i pushimit të çështjes/akuzës tek procedimi parandalues me karakter pasuror, sekuestrimi/konfiskimi.
- Sa i takon fushës së zbatimit, parashikohet se masat parandaluese me karakter pasuror, të parashikuara në këtë akt nuk vendosen për pasuritë, të cilat para hyrjes në fuqi të tij janë në proces shqyrtimi gjyqësor ose për të cilin ekziston një vendim gjykate, në zbatim të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar. Kjo mbivendosje rezulton qartë nga parashikimi, sipas të cilit veç sekuestrimit apo konfiskimit në kuadër të vendimit penal të sekuestrimit apo konfiskimit sipas aktit normativ, pezullohen edhe për shkak të sekuestrimit apo konfiskimit në bazë të ligjit antimafia, procedim i cili është i njëjtës natyrë me atë të aktit normativ.

²⁸⁴ Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, neni 287 i Kodit Penal të RSH.

3.4. Reflektimi i modeleve të legjislacioneve evropiane në legjislacionin shqiptar

Modelet e legjislacioneve evropiane dhe në mënyrë të veçantë aktet juridike evropiane kanë ndikuar në modelin e ligjit shqiptar, në përshtatjen e tij duke synuar më shumë drejtë një ligji që jep instrumentet e duhura të efikasitetit me qëllim përmbushjen e qëllimit të tij. Çështja e *natyrës së ligjit shqiptar* tashmë është një çështje që duhet diskutuar nga pikëpamja teorike. Kjo është një nga hipotezat që janë hedhur në fillim të punimit e që do ta shtjellojmë më poshtë.

Ligji para ndryshimeve të vitit 2017²⁸⁵ ishte një përzierje e dy modeleve të ligjeve: atij anglez për konfiskimet pasurore, që është një ligj që ndjek modelin e konfiskimit civil dhe të zgjeruar²⁸⁶ dhe atij Italian Antimafia,²⁸⁷ që është një ligj i tiparit penal. Harmonizimi i dy modeleve atij anglo-sakson dhe italian në legjislacionin tonë nuk u pa si efektiv e natyral nga ana e vëzhguesve të huaj e misioneve ndërkombëtare të huaja në Shqipëri, që ofronin asistencë juridike²⁸⁸. Dallimet rridhnin nga legjislacione të ndryshme bazuar në të ashtuquajturën *action in rem* dhe si pasojë në zbatimin e dispozitave të procedurës civile, që nuk përputhet me përvojën e dobishme të legjislacionit italian bazuar në qasje të ndryshme - zbatim i rregullave të procedurës penale.

Ndryshimet në këtë ligj janë ndryshime thelbësore e pas këtyre ndryshimeve lind pyetja *se cila është natyra e ligjit tonë tashmë, cilës traditë ligjore i përket e nga cili model është ndikuar më shumë, nëse është një ligj i karakterit penal apo atij civil*. Për t'i dhënë një përgjigje kësaj pyetje së pari duhet të hedhim këndvështrimin mbi natyrën e konfiskimit si masë parandaluese, llojeve të konfiskimit apo natyrës së tij penale apo civile duke u ndalur veçanërisht në legjislacionin italian. Kjo për arsyen se ligji shqiptar nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar , trafikut dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, është qartësisht i bazuar në përvojën italiane.

²⁸⁵ Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen ekrimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese e kundër pasurisë”

²⁸⁶ Ligji anglez për të ardhurat kriminale, 2002 (POCA) <https://www.legislation.gov.uk/>

²⁸⁷ Dekreti Legjislativ 6 shtatorit 2011, nr. 159 “Kodi i Ligjit të Mafias dhe masat parandaluese, si dhe rregulla të reja për dokumentacionin e mafies” Gazeta Zyrtare 28 shtatorit 2011.

²⁸⁸ Shih mendimin e misionit PAMECA, Mision i Komisionit Europian që mbështete policinë dhe prokurorinë, Nëntor 2016

Fillimisht, zbatimi praktik i ligjit varej nga procedimi penal, zbatoheshin rregullat e procedurës civile tipare këto që e bënin atë të ngjashëm me modelin e ligjeve anglo-saksone të konfiskimit civil. Por ligji zbatohet nga gjykata penale e një gjykatë e veçantë siç ishte ajo e krimeve të rënda. Kjo zgjidhje pranohet në doktrinën bashkëkohore, *ku procedimi civil për sekuestrimin/konfiskimin është një procedim gjyqësor in rem i cili vepron ndaj pasurisë* (i shkëputur dhe në mënyrë autonome nga procedimi penal) përkundërt procedimit penal kundër personit i cili është procedim gjyqësor *in personam*. Në këtë të fundit, sekuestrimi/konfiskimi janë veprime hetimore dhe rezultat i një vendimi të organit procedues mbi deklarinimin fajtor të personit për një vepër penale. Ky procedim gjyqësor, i cili është një procedim gjyqësor *sui generis*, do të zhvillohet duke marrë në çdo rast për bazë parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut. Tashmë ligji i ri ka ndërruar tipar *dhe bazohet tërësisht në eksperiencën e ligjit italian*. Kjo pasi ndryshimet janë thelbësore. Vlerësoj se edhe fakti që ky ligj zbatohet nga një prokurori si ajo e veçantë e krimeve të rënda dhe nga një gjykatë e profilat penal²⁸⁹ ishte e disfavorshme në zbatim, pasi nuk ishte e lehtë nga ana e gjyqtarëve të krimeve të rënda që të zbatonin dispozita procedurale civile, ndërkohe që procedura civile ofronte më shumë mundësi për të përmbushur barrën e provës nga ana e subjekteve. Në këtë aspekt kishte disa kundërshti normative në ligj me këtë ndërthurje të dispozitave kryesisht ato që kanë të bëjnë me së pari me vepra penale, të cilat nuk ishin në kompetencën e kësaj gjykate.

Ligji ishte konfuz në lidhje me karakteristikat e personit subjekt të ligjit dhe hetimin vijues të pasurive, që do të trajtohen siç ndodh në legjislacionin italian ose hetimin e drejtpërdrejtë të pasurive, që do të trajtohen tipike për legjislacionin anglo-sakson. Ligji shqiptar nuk kishte një dallim të qartë²⁹⁰ ndërmjet prezumimeve subjektive për personat subjekt të ligjit dhe rrjedhimisht pasurive në pronësi të tyre në ndonjë mënyrë, prezumime objektive-kërkesë për pasuritë e sekuestruara, për posedimin e drejtpërdrejt ose jo të pasurive nga individit subjekt i ligjit apo origjina e paligjshme të pasurive.

²⁸⁹ Duke qenë se modeli referues, ai italian parashikon kompetencën e seksioneve të caktuara të gjykatës, ndërsa në atë të Mbretërisë së Bashkuar konfiskimi vendoset nga Gjykata e Lartë, mund të themi se përsa i përket kompetencës zgjedhja, që ka bërë legjislatori shqiptar është një zgjidhje e veçantë dhe tipike.

²⁹⁰ Dallimi i qartë është tipik për legjislacionin italian

Parimi i proporcionalitetit në kufizimin e të drejtës së pronës sipas jurisprudencës së GJEDNJ duhej të riformulohej në ligj e të gjente shprehimisht përcaktim. Ligji ndjek prezumimin se personat, që kanë regjistruar në mënyrë të rreme pasuritë në emrin e tyre, nëse nuk provohet e kundërta ato pasuri u përkasin personave subjekt të ligjit. Prezumimi i ngritur me ligj ishte në përputhje me legjislacionin italian dhe merr parasysh përputhshmërinë me parimet e KEDNJ nga GJEDNJ²⁹¹ Mbetet akoma prezumimi i zotërimit të pasurive nga të dyshuarit e veprës penale, por pa barrën mbi subjektet e tjerë persona të afërm të tyre për të provuar se ata janë pronarë të vërtetë të pasurive të sekuestruara.

Në Mbretërinë e Bashkuar konfiskimi vjen pas dënimit penal. ²⁹²Sipas ligjit përkatës, që parashikon konfiskimin sipas sekuestrimit civil mjafton që akuza të tregojë në fillim një shkak të mundshëm (*që baza e arsyeshme për të konsideruar të mundshme blerjen e një pasurie me fitime të paligjshme, të mbështetur në elementët që nuk arrijnë nivelin e provës (në dukje) prima facie, përbën diçka më shumë sesa vetëm një të dyshuar*) për të zhvendosur barrën e provës tek pala mbrojtëse, e cila duhet të paraqesë elementet për të provuar paligjshmërinë e pasurisë në veprën penale, ose që kjo pasuri i përket një personi, që nuk ka lidhje me të.

Procedimi nuk diskuton përgjegjësinë e personit dhe gjykimi i konfiskimit të pasurisë bëhet bazuar në rregullat e së drejtës civile, të rëndësës së provave, ku mbizotëron pala që mund të mbështesë tezën e saj me nivel më të lartë pranimi sesa hipoteza të tjera. Jurisprudenca e bazon këtë gjykim në parimet e së drejtës amerikane, sipas së cilës, rregulli përtej dyshimit të arsyeshëm zbatohet, në përgjithësi, vetëm në çështje me natyrë tepër kriminale që përfshijnë jetën ose lirinë. ²⁹³

Thelbi i legjislacionit italian përbëhet nga mundësia për të zbatuar sekuestrimin dhe konfiskimin në mënyrë të pavarur nga dënimi në kuadër të një procesi të “*thjeshtuar*” kundrejt pasurisë si një masë parandaluese. Këto procese GJEDNJ i konsideron në mënyrë të përsëritur në përputhje me KEDNJ. Qëllimi i këtyre masave nuk është të ndëshkojë njerëzit duke konfiskuar pasuritë e tyre (*përndryshe do të ishte një masë penale*). Qëllimi është të godasë pasuritë në mënyrë të paligjshme,

²⁹¹ GJEDNJ, Vendimi i 5 qershorit 2010, Biongiorna kundër Italisë. <https://hudoc.echr.coe>

²⁹² Proceeds of Crime Assets. (POCA)

²⁹³ Stolen Asset Recovery, A Good practices Guide for Non – Conviction Based asset Forfeiture, Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray, Stolen Asset Recovery (STAR) Initiative 2009 The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank

të cilat i vihen në dispozicion personave të rrezikshëm. Në mënyrë të veçantë sepse ata dyshohen për krime të rënda; rrjedhimisht duke mos u vënë pasuri në dispozicion të tyre, duke parandaluar kryerjen e krimeve të tjera, të cilat mund të shtohen pikërisht nëpërmjet përdorimit të këtyre pasurive. Gjykata italiane e Kasacionit dhe GJEDNJ kanë konfirmuar gjithmonë natyrën parandaluese të konfiskimit jondëshkues në Itali. Kjo frymë është reflektuar në ligjin tonë tashmë edhe në praktikë nuk ka më hezitime për të zbatuar një masë konfiskimi pa pasur një dënim penal. Ligji ynë mban qëndrimin e ndërmjetëm në mes të një konfiskimi civil *in rem*, me rregulla të procedurës penale e që nuk është i varur nga procedimi penal.

Një çështje me interes kërkimi është analiza dhe dhënia e përgjigjes pyetjes nëse *natyra e ligjit shqiptar për parandalimin mes pasurisë përshtatet me atë penal?*

Institutet referuese në ligj apo terminologjia e përdorur si *akuza, hetimi, provat* dhe kuadri ku funksionojnë ato si: i dyshuar për veprën penale janë koncepte të së drejtës penale. Marrëdhënia me procedimin penal, pavarësisht se është jo e ndërruar, por në thelb të procedimit pasuror janë aktet e procedimit penal. Kjo në rastin kur procedimi pasuror regjistrohet në të njëjtën kohë me procedimin penal, kur të dy procedimet nisin njëkohësisht apo kur procedimi pasuror fillon menjëherë pas atij penal. Parimi i autonomisë së procedimit pasuror nga ai penal nënkupton se aktet e tij mund të transferohen në atë pasuror. Në mes të dokumenteve, që mund të sigurohen sipas nenit 9 të ligjit²⁹⁴ janë ato që lidhen me hetimin penal, siç janë urdhrat e zbatimit të masave të sigurimit, transkriptet e përgjimeve të bisedave telefonike, raportet e sekuestrimit dhe kontrollit, deklaratimet e dëshmitarëve, vendimet etj. Kjo lidhet edhe me elementet e vendimit të gjykatës, ku thuhet shprehimisht se zbatohen dispozitat përkatëse të KPrP.

Si përfundim, mund të themi se ligji ynë është një model dualist në mes të modelit të veçantë kontinental italian të një ligji penal për masat parandaluese e që bazohet në parimet e konfiskimit civil të modelit anglosakson.

3.5. Probleme teorike dhe të praktikës gjyqësore mbi standardet ligjore të zbatimit të ligjit për goditjen e pasurisë, provat dhe barrën e provës.

²⁹⁴ Me autorizim të lëshuar nga prokurori ose gjykata, oficerët e policisë gjyqësore mund të vendosin sekuestrimin e dokumenteve të shqyrtuara, sipas rregullave të parashikuara në nenet 208, 209, 210 dhe 211 të KPrP.

Çështjet të diskutueshme ka pasur në këto vite në praktikën gjyqësore në zbatimin e këtij ligji. Një nga problemet e ligjit ishte se ai nuk kishte dispozita të mjaftueshme rregullatore e në mungesë të tij referonte në të dyja procedurat penale e civile, herë vetëm në atë civile e tani vetëm në atë penale. Ndërthurja e dy proceduarave krijonte keqkuptim në lidhje me zbatimin e instituteve referuese. Pasiguria në zbatimin e autonomisë së procedimit penal i bënte prokurorët të hezitonin regjistrimin e procedimit pasuror pa pasur një procedim penal. Nga ana tjetër, ishte e vështirë krijimi i një fashikulli më vite me akte ose prova vetëm për hetimin pasuror. Mungesa e oficerëve të policisë të specializuar në hetimin e krimit ekonomik dhe fakti se Prokuroria e Krimeve të Rënda ishte e zënë me shumë procedime në kuadër të krimit të organizuar e bënin më pak efektiv hetimin pasuror në zbatim të ligjit. Fakti se disa vepra penale nuk ishin në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda si: shfrytëzimi i prostitucionit, (neni 114/a i KP), mbajtja e lëndëve narkotike²⁹⁵ (neni 287 i KP). Fakti se këto vepra penale vazhdonin e hetoheshin nga Prokuroritë e rretheve e të gjykoreshin nga gjykatat e rretheve sillte probleme në hetimin pasuror dhe marrjen e provave gjatë gjykimit të tyre. Gjithashtu, varësia e procedimit pasuror nga ai penal në këtë rast është më e zbehtë.

Nga gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë ka pasur vlerësime të ndryshme në lidhje me këto çështje: së pari në lidhje me autonominë në procesin penal, sa ndikon rezultati i procesit penal mbi gjykimin e kërkesave për konfiskim²⁹⁶, së dyti, nëse mund të vendoset sekuestrimi pasuror ndaj një pasurie, kur për të është vendosur sekuestrim preventiv si masë sigurimi penale; cilat rregulla procedurale do të zbatohen ato civile apo penale dhe a mundet një gjykatë e profilin penal t'u referohet rregullave të procedurës civile dhe deri në çfarë mase²⁹⁷. Së treti, cilat janë veprimet hetimore dhe provat që parashikon vetë ligji, dhe nëse mundet prokuroria ose gjykata gjatë hetimit pasuror të përdorë institutet procedurale të kërkimit të provës si p.sh., përgjimin. Së katërti, cilat prova të procedimit penal mund të përdorim dhe a mundet pala/subjekti të sjellë prova të tjera nga ato që parashikojnë procedurat respektive. Së pesti, çfarë mund të quhet vënie e pasurisë gjatë

²⁹⁵ Në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda ishin edhe “*Trafikimi i personave*”, neni 110/ a iKP dhe “*Trafikimi i lëndëve narkotike*”, neni 383/a i KP

²⁹⁶ Në rastin paraqitjes së kërkesave për konfiskim edhe pasi gjykata e tjera kanë shpallur pafajësi për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale për personin ndaj të cilit tek kërkohet konfiskimi.

²⁹⁷ Neni 7 paragrafi 4 i ligjit.

përfshirjes së dyshuar në një veprimtari kriminale. *Së gjashti*, çfarë duhet të kuptojmë me shprehjen “*dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicie*”, kush do të shërbejë si indicie, dhe sa të tilla nevojiten. *Së shtati*, roli i gjykatës gjatë zgjatjes së sekuestros dhe a mundet prokurori të urdhërojë heqjen e sekuestros, kur ajo është vendosur me vendim gjykate. *Së teti*, çfarë mund të shërbejë si provë për të justifikuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë gjatë shqyrtimit të kërkesës për konfiskim. *Së nënti*, në përgjithësi, të gjitha çështjet e tjera që lidhen me të provuarit gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave. Kjo pasi në mes të gjykatave të faktit e asaj të Lartë ka pasur qëndrime të ndryshme në lidhje me standardin e provës, provat, që mund të merren e përdoren dhe dispozitat procedurale referuese.²⁹⁸

Gjatë zbatimit të ligjeve në vite dolën në pah disa kundërshti normative, që kishin të bënin me identifikimin e qartë të fushës së veprimit të ligjit, marrëdhënien e subjekteve të ligjit dhe pasurive objekt i sekuestrimit dhe konfiskimit si pasojë, karakteristikat e personit subjekt të ligjit dhe hetimin vijues të pasurive, ose hetimin e drejtpërdrejtë të pasurive, në mënyrë të veçantë në lidhje me prezumimet ligjore të situatave apo të fakteve objekt hetimi, se cilat mund të konsideroheshin si të tilla.

Për të ilustruar një nga problematikat e konstatuara në praktikë, po trajtojmë dy procedime pasurore, kërkesa për konfiskim në të cilat gjykatat bënë interpretime të ndryshme të ligjit në lidhje me autonominë nga procedimi penal, dhe një tjetër në lidhje me mundësinë apo kompetencën funksionale të prokurorit për të hequr dorë nga kërkesa për konfiskim kur gjykata ka vlerësim tjetër për të:

1. Me Vendimin nr. 25 datë 10.12.2014²⁹⁹ të Gjykatës së Shkallë së Parë për Krime të Rënda, u pranua kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda për konfiskimin e pasurive të shtetasve A.Sh., S.Sh. e personave të tretë C.M. dhe F.Z., konkretisht, i disa llogarive bankare me vlerë 5 000 000 lekë. Këta persona dyshoheshin për veprën penale të “*Pastrimit të parave*”, neni 287 i KP, ndërsa në shtetin grek ishin në hetim për veprën penale të “*Shfrytëzimit të prostitucionit*”. Vendimi u dha

²⁹⁸ Bëhet fjalë për ato raste kur Gjykata e Lartë ka pranuar efektin shues të masave të sekuestrimit e nuk ka pranuar konfiskimin për shkak të daljes së vendimit penal të pafajësisë ose kur janë pranuar si prova, të cilat justifikojnë kane pranuar çdo provë që justifikon pasuritë si kontrata noteriale formale pa u thelluar në burimin e te ardhurave.

²⁹⁹ Vendimi nr. 10, datë 12.02.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda mbi kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda për konfiskimin e pasurisë së shtetasve A. Sh, S. Sh, personave të tretë C. M.

në bazë të dispozitave të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, tek të cilat referonte ligji. Gjykata e Apelit me Vendimin nr. 6 datë 27.01.2012 lë në fuqi Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Ndërkohë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte dërguar për gjykim çështja penale ndaj të pandehurve S.SH, A.SH për veprën penale të “Pastrimit të parave”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 821 datë 23.05.2012 ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurve A.Sh.; S.Sh.; C.M.; F.Z. Mbi bazën e këtij Vendimi pafajësie, të pandehurit dhe personat e tretë i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim vendimi sipas nenit 450 të KPrP.

Kolegji Penal me vendimin nr. 00-2013-1548 datë 6.03.2013 ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim dhe prishjen e vendimit penal nr. 14 datë 14.12.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krime të Rënda si dhe të Vendimit nr. 6 datë 27.01.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe dërgimin për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë me tjetër trup gjykues. Gjykata e Lartë e konsideron Vendimin e pafajësisë ndaj subjekteve të ligjit si një rrethanë e re, që në kuptim të nenit 450 të KPrP përbën shkak për rishikim, duke zbatuar në këtë mënyrë një institut të së drejtës procedurale penale, ndërkohë që ligji referonte në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Në rigjykim, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, prokurori kërkoi pushimin e gjykimit për konfiskim pasurie bazuar në Vendimin e Gjykatës së Lartë. Gjykata nuk e pranoi kërkesën për pushim me argumentimin se së pari, prokurori nuk mund të ketë disponim padie, pasi në këtë rast është interesi publik i konfiskimit; së dyti, vendimi penal, që i shpall të pafajshëm të pandehurit nuk ka ndikim mbi kërkesën për konfiskim e nuk sjell asnjë njohje të faktit se pasuria është fituar në mënyrë të ligjshme duke cituar se barrën e provës për këtë e kishin kërkuesit, barrë të cilën nuk e kanë përmbushur. Për rrjedhojë, Gjykata nuk e ndryshoi vendimin duke lënë në fuqi konfiskimin e pasurisë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit me të njëjtën argumentim. Gjykata e Lartë me Vendimin nr. 10 datë 12.02.2015³⁰⁰ vlerëson se prokurori ka të drejtën për të disponuar objektin e kërkimit duke pranuar, në këtë rast, që të zbatohen rregullat e procedurës civile, e gjykatat kanë gabuar se nuk e kanë pushuar gjykimin e kërkesës mbi kërkimin e tij, ndërkohë që vendimin e pafajësisë së Gjykatës së Tiranës e cilëson se rrëzon faktet indiciare se pasuria është vënë me veprimtari kriminale. Ndërkohë, nuk analizon faktin se subjektet ishin në masë sigurie në shtetin

³⁰⁰ Vendimi nr. 00- 2015- 1989 datë 24.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

grek për kryerjen e veprave penale të “*Shfrytëzimit të prostitucionit*” në kuadër të organizatës kriminale sipas neneve 187, 351 të KP grek.

Një rast tjetër nga praktika gjyqësore shqiptare ka lidhje me procedimin pasuror ndaj subjektit A.J, ndaj të cilit ishte vendosur sekuestrimi i pasurisë ndaj 16 apartamenteve. Prokurori paraqet kërkesën për gjykim dhe gjatë shqyrtimit të saj, ai heq dorë nga kërkesa për konfiskim duke kërkuar pushimin e saj. Në Vendimin nr. 1 datë 16.01.2014 të Gjykatës së Shkallës së Për Krime të Rënda dhe vendimin nr. 8 datë 02.04.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda mbahet qëndrimi që heqja dorë e prokurorit nga gjykimi i kërkesës për konfiskim nuk sjell domosdoshmëri dhe detyrimisht gjykatën në vendimmarrjen për pushimin e saj sipas nenit 201/1 të KPrC, pasi prokurori nuk gëzon tagër disponimi padie, meqenëse pasuria nuk është dhe interesi publik duhet të prevalojë në këtë rast. Gjykata e Lartë me vendimin nr. 224 datë 09.12.2014 i prish të dy këto vendime me arsyetimin se është prokurori i cili e disponon kërkimin sipas nenit 201/1 të KPrP, 202 dhe si e tillë ai mund të heqë dorë nga kërkesa edhe gjatë konfiskimit.³⁰¹ Ky rast praktik sjell në vëmendje kuptimin se Gjykata të ndryshme i japin zbatimit të rregullave procedurale, varësisë së vendimit të konfiskimit nga ai i dënimit dhe rolit të prokurorit në disponimin e kërkesës së konfiskimit.

3.6. Çështje në vëmendje

Çështjet e praktikës gjyqësore dhe interpretimet e ndryshme nga gjykatat në lidhje me institutet e këtij ligji e në, mënyrë të veçantë, ato që lidhen me rrethin dhe pozitën procedurale të personave ndaj të cilëve zbatohet ligji, veprimet procedurale, të cilat duhet të kryente dhe kishte mundësi të zbatonte prokuroria gjatë fazës së hetimit pasuror dhe nëse referimi në rregullat e procedurës civile nënkuptonte disponibilitet të plotë të prokurorisë mbi kërkesën për konfiskim³⁰² e ngjashme me atë të disponimit të padisë, çështjet e të provuarit, të standardit të provës, kuptimi i indicies që

³⁰¹ Vendimin nr. 224 datë 09.12.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

³⁰² Shih vendimin nr. 1 datë 16.01.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimin nr. 8 datë 02.04.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda sipas së cilëve heqja dorë e prokurorit nga gjykimi i kërkesës nuk çon detyrimisht gjykatën në vendimmarrjen për pushimin e saj sipas nenit 201/1 të KPrC, pasi prokurori nuk gëzon tagër disponimi padie meqenëse pasuria nuk është dhe interesi publik duhet të prevalojë në këtë rast. Shih dhe vendimin nr. 224 datë 09.12.2014 të Gjykatës së Lartë që i prish këto dy vendime.

mbështesin dyshimin për përfitimin e pasurisë kriminale etj., kanë qenë çështjet e debatueshme të zbatimit të këtij ligji në kohë.

Sigurisht, fakti se procedimi pasuror një procedurë e bazuar në rregullat e procedimit civil, mbështetet, kryesisht, mbi aktet e përfuara nga procedimi penal si dhe institutet e procedimit civil zbatoheshin nga një gjykatë penale, ishte një disavantazh në zbatimin e këtij ligji apo fakti se fusha e veprimit të këtij ligji përfshinte dhe pasurinë e vënë me kryerjen e veprave penale, të cilat nuk ishin në kompetencën e gjykatës kompetente, pra asaj të krimeve të rënda. Këto çështje sollën dhe nevojën e rishikimit. Tashmë, mund të themi se kemi një ligj tipik, i cili bazohet në traditën kontinentale të konfiskimit si masë parandaluese e që ka pranuar standardin më të ulët të provës e devijimin e barrës së provës.

Ligji i ri për parandalimin dhe goditjen e krimeve të rënda, korrupsionit e trafikëve nëpërmjet masave parandaluese është një ligj i mirë e efikas i natyrës penale që trajton një institut konfiskimi *in rem* e respekton parimet e një procedimi që u jep mundësi subjekteve të mbrojnë të drejtat e tyre pasurore. Bazuar në analizën e bërë sa më sipër, mund të thuhet se Shqipëria ka një ligj tipik shqiptar, i cili është i natyrës penale, por që bazohet në parimet e konfiskimit civil e të zgjeruar pa dënim, që ka të përcaktuar një standard të caktuar të provës atë të dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në indicie e që i ngarkon barrën e provës subjektit, gjithnjë duke mbrojtur interesat e të tretëve e duke respektuar kontradiktoritetin në gjykim e parimet e procesit gjyqësor të drejtë. Gjithashtu, kjo analizë nxjerr në dritë disa kontradikta të natyrës së ligjit tonë me atë të sistemeve dhe vendeve të tjera .

Analiza e bërë në këtë kapitull të legjislacionit tonë ndër vite, krahasuar me juridiksionin ndërkombëtar të masave parandaluese dhe ligjet homologe të vendeve të BE e më tej, na jep si konkluzion vërtetimin e hipotezës së ngritur në fillim të këtij kreu se tashmë, pas kaq viteve të zbatimit të këtij legjislacioni duhet ta rishikojmë atë duke rirregulluar ligjin në fuqi ose duke përvijëzuar një juridiksion të ri të masave parandaluese brenda sistemit tonë ligjor. Kjo duke pasur në vëmendje se:

- Sistemet ligjore, të cilat nuk e lidhin konfiskimin me dënimin apo pozitën e personit në procedimin penal janë procedime civile, jo domosdoshmërisht penale por administrative në kuptimin e një lloji të veçantë të angazhimit shtetëror.
- Konfiskimi i zgjuar i adaptuar nga Shqipëria është karakteristikë për konfiskimin e lidhur me një vendim dënim apo fajësie për një vepër të rëndë apo krim të organizuar
- Konfiskimi pa dënim, konfiskimi objektiv apo autonom është i natyrës së konfiskimit civil që rregullohet me rregullat e procedurës civile.
- Barra e provës është karakteristikë për procedimin civil
- Procedura penale e lidh detyrimisht konfiskimin me pozitën penale të personit, subjekt të ligjit.

KREU IV

STANDARDI I PROVËS, PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN PASUROR

Përmbajtja 4.1 Hyrje, 4.2 Procesi i të provuarit, provat dhe standardi i tyre në hetimin dhe gjykimin e masave parandaluese pasurore. 4.3. Standardi provues për masat parandaluese. 4.4. Niveli i dyshimit i bazuar në indicie si standard prove për sekuestrimin dhe konfiskimin. 4.5. Provat, llojet dhe vlerësimi i tyre në këndvështrim të procedimit penal e atij pasuror. 4. 6. Objekti i të provuarit -thema probandum—në procedimin pasuror. 4.7. Hetimi pasuror dhe kërkesa për sekuestrim, të dhënat, që shërbejnë si bazë për fillimin e procedimit pasuror 4.7. Kërkesa për konfiskim, kriteret e vlerësimit të kushteve për të vendosur në lidhje me kërkesën për konfiskim pasuror e provat, ku mbështetet. 4.8. Çështje ligjore dhe praktike mbi provat.

4.1. Hyrje

Sekuestrimi dhe konfiskimi si procedura parandaluese pasurore kanë karakteristikat e tyre të veçanta për sa i përket rregullave të të provuarit, standardit të provës, provave që përdoren e mënyrës si merren, barrës së provës etj. Sigurisht, proceset bazohen në parimet e procesit të drejtë gjyqësor dhe kontradiktoritetit. Mbi të gjitha, ato janë procese që bazohen në prova e teoritë e të provuarit sipas parimeve përkatëse të procedurës që zbatohet. Jo të gjitha parimet e provave të

procesit penal a civil vlejné edhe për procedimin pasuror, pasi në procedimin pasuror, niveli i provave dhe i të provuarit është më i ulët. Megjithatë, të vlerësuarit e provave bëhet sipas disa parimeve të caktuara të cilat gjenden në normat ndërkombëtare dhe rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

Ligji ka disa rregulla për mënyrën se si bëhen verifikimet, hetimet e merren të dhënat e provat sipas parashikimeve të ligjit. Devijimi i barrës së provës për justifikimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë dikton disa nga këto parime për shkak se një subjekt i ligjit nuk ka mundësitë që ka një organ procedues i hetimit apo gjykimit. Megjithatë, parimet e lirisë së provës apo të vlerësimit të lirë të tyre janë parimet që vënë në pozitë të barabartë subjektin e ligjit për t'u mbrojtur gjatë hetimit apo gjykimit të kërkesave. Procesi i të provuarit ka dallime sipas procedurës së zbatimit; procedura civile ka më shumë mundësi procedurale që palët dhe personat e tretë të jenë aktivë në proces, nisur dhe nga fakti se barra e provës për palët private është tipar i procesit gjyqësor civil. Ndërsa, në procedurën penale rregullat mbi provat janë më të kufizuara e lejohet vetëm paraqitja e provave të njohura sipas parashikimeve të Kodit.

Standardi i provës ka ndryshuar sipas procedurës së zbatimit deri në ndryshimet e vitit 2017³⁰³, e kërkon interpretim rigoroz, në mënyrë që të garantojë procesin, në thelb të të cilit është prova. Niveli i dyshimit të bazuar në indicie ndryshon nga ai i bazuar në provë, pasi prova me indicien nuk kanë vlerë të barabartë. Hetimi pasuror nuk siguron në çdo fazë kontradiktoritetin, ndërsa ai i gjykimit të kërkesës për konfiskim duhet domosdoshmërisht të sigurojë debatin mbi provën, kontradiktoritetin, barazinë e armëve për shtetin dhe subjektin.

Barra e provës për justifikimin e pasurisë së paligjshme i përket personit subjekt i ligjit, por kjo nuk shmang detyrimin e prokurorit, i cili, në kërkesën për sekuestrim e konfiskim, të sjellë prova për të vërtetuar kushtet dhe kriteret për këto masa. Provat, mbi të cilat mbështetet hetimi pasuror dhe më pas konfiskimi janë të llojeve të ndryshme, në varësi të procedurës së zbatimit. Ligji ka përcaktuar disa rregulla për standardin e provës, procedurën, verifikimet, hetimet e kompetencat e gjykatës, të tjerat referohen në Kodin e Procedurës Penale. Këta janë çështjet që vlerësojmë se kanë interes teorik dhe praktik për t'u trajtuar në këtë kre të rëndësishëm të punimit.

³⁰³ Ligji nr. 70/2017 datë 27.04.2017 i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 22 maj 2017.

Në këtë kre të rëndësishëm të punimit, kam ngritur disa hipoteza për diskutim si më poshtë:

- A kemi një standard prove të veçantë në procesin e të provuarit në shqyrtimin e masave pasurore, një standard prove të ndryshëm e parime të veçanta apo duhet të ndjekim parimet referuese në procedurën penale.
- A duhet të listojmë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e veçantë me ligj.
- A ofron ligji të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen dhe vlerësimin e provave, a kanë të njëjtën vlerë indiciet, elementet faktikë, provat rrethore dhe ato të marra pa kontradiktoritet.
- A lejon procedura penale një sistem provash të mjaftueshëm për hetimin e gjykimin pasuror, a e siguron më mirë këtë procedura civile apo duhet një ligj me elemente të plotë rregullatorë *sui generis* dhe për çështjet e provave dhe të të provuarit,
- A janë të nevojshme shtesa e ndryshime ligjore për të konfirmuar standardet ndërkombëtare.

Këto hipoteza jam munduar t'i shtjelloj në analizë ligjore dhe praktike, duke arritur në një përfundim në fund të kreut.

4.2 Procesi i të provuarit, standardi i provave dhe provat në hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore.

Procedimi pasuror nëpërmjet sekuestrimit e në veçanti, konfiskimit të pasurisë duke qenë një proces tjetër nga ai penal, e në të njëjtën kohë dhe i natyrës penale, përbën një disiplinë të dyfishtë të procesit të të provuarit, objektit të të provuarit, provave dhe barrës së provës. Ligji³⁰⁴ nuk përcakton rregullat e procesit të të provuarit dhe provat mbi të cilat bëhet hetimi pasuror e ku mbështetet kërkesa për konfiskim. Ai referon në procedurat përkatëse në fillim në atë civile e

³⁰⁴Ligj nr. 10 192 datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë ", i ndryshuar me ligjin nr. 24/2014 datë 20.03.2014 dhe atë nr. 70/2017 datë 27.04.2017.

tashmë në atë penale.³⁰⁵Për pasojë, në interpretimin e parimeve të të provuarit e të llojeve të provave, i referohemi natyrës dhe parimeve, mbi të cilat funksionojnë masat parandaluese pasurore si një procedim pasuror *in rem*, që ka për qëllim parandalimin nëpërmjet sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë dhe që kryhet nëpërmjet verifikimit të prejardhjes së ligjshme të saj e kalimit të barrës së provës tek zotëruesi i saj.

Nuk ka një juridiksion të veçantë brenda legjislacionit shqiptar të masave parandaluese. Nëse është e nevojshme krijimi apo jo i një juridiksioni të tillë dhe brenda sistemit ligjor shqiptar, kjo është hedhur si hipotezë në këtë punim, mendim i cili do të shtjellohet në vijim. Por paraprakisht, ne duhet të identifikojmë disiplinën e rregullimeve mbi provat dhe të provuarin, që parashikon ligji, dhe ato të procedurës penale apo civile tek të cilat ne duhet të referohemi. Tashmë ligji është në kompetencën e gjykatave të zakonshme e atyre të veçanta, nuk është më fushë ekskluzive kompetencë vetëm e një gjykate penale të posaçme siç ishte përpara ndryshimeve të vitit 2017. Ai tashmë zbatohet edhe nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe ato të veçanta sipas fushës së kompetencës së tyre³⁰⁶, por rëndësia që ka marrë zbatimin e ligjit me zgjerimin e fushës së veprimit edhe për vepra të tjera të korrupsionit e krimit ekonomik, patjetër që do të përvijëzojë shpejt edhe në praktikën shqiptare *një juridiksion të veçantë të tij të ngjashëm me atë në vendet e tjera, të marra si model*.

Në vlerësimin tonë, duhet të jetë jurisprudenca nëpërmjet konsolidimit të interpretimit në nivel kushtetues e konvencional dhe praktika gjyqësore për çështjet e interpretimit gjyqësor të ligjit³⁰⁷ që të trajtojnë e përcaktojnë parimet e zbatimit të së drejtës së provës në procedurën e parandalimit duke bërë dallimin me ato të procesit penal.

³⁰⁵ Neni 5 i ligjit të mësipërm verifikimi, hetimi dhe gjykimi sipas këtij ligji, mbështetet në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregullat në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj.

³⁰⁶ Kërkesa për marrjen e masave parandaluese shqyrtohet në shkallë të parë nga gjykatat e retheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

³⁰⁷ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së lartë në Vendimin Unifikues nr. 1 datë 25.01.2007 shprehen se : "...përveç rregullimeve të parashikuara shprehimisht në këtë ligj, hetimi dhe gjykimi parandalues mbështetet sipas referimeve konkrete, apo sipas rastit, edhe në norma të procedimit administrative, civil dhe penal që lidhen apo i shërbejnë zhvillimit të procesit të rregullt ligjor në procedimin parandalues, ndonëse ky është një gjykim i veçantë, thelbësor dhe që nëpërmjet njohjes e zbatimit të këtyre dispozitave të garantohet zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor".

Konfiskimi vjen si pasojë e një procesi gjyqësor, tipari thelbësor i të cilit është kontradiktoriteti në të cilin formohet prova dhe realizohet barazia e armëve; bazohet në aspektin konvencional e atë kushtetues. Ishte Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Lëndëve Psikotrope³⁰⁸ që trajtoi përmbyjsjen e barrës së provës, ruajtjen e interesave të të tretëve dhe përputhshmërinë formale të parashikimeve të saj me rregullimet e së drejtës së brendshme. Në paragrafin 7 të nenit 5³⁰⁹ të Konventës thuhet se *“Shtetet palë duhet të kenë parasysh se mund të ndodhë një përmbyjsje e vlerësimit të provave, në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera të deklaruara, që i nënshtrohen konfiskimit, në atë masë që ky veprim të jetë në përputhje me parimet e ligjit të vendit të vet dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të interpretohen sikur dëmtojnë të drejtat e palëve të treta që janë në mirëbesim. Gjithsesi, Konventa bën kujdes të garantojë moscenimin e parimit se masat për të cilat ai bën fjalë, duhet të përkufizohen e të zbatohen në përputhje me ligjet vendase.*

Konventa e Këshillit të Evropës për Konfiskimin e Produkteve të Krimit³¹⁰ parashikon se shtetet duhet të përshtatin masat ligjore dhe të marrin masa të tjera, që rezultojnë të nevojshme për të lejuar të identifikojnë dhe të kërkojnë pasuritë, që i nënshtrohen konfiskimit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 17 të saj, parashikon se kufizimet e të drejtave dhe lirive mund të vendosen vetëm me një ligj për një interes publik, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, por që nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara nga Konventa Evropiane të drejtave të Njeriut. Ndërsa në nenin 41 dhe 42 të Kushtetutës, krahas garantimit të së drejtës së pronës, parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë e ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Procedimi pasuror ka karakteristikat e tij, të cilat i kemi trajtuar më sipër si: autonomia me procedimin penal dhe standardi i provës më i ulët se ai i procedimit penal, devijimi i barrës së provës dhe objekti i veçantë i të provuarit që lidhet kryesisht me pasurinë e të ardhurat. Për

³⁰⁸ E quajtur ndryshe dhe Konventa e Vjenës 1988, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8722 datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope.”

³⁰⁹ Neni 5 Konfiskimi.

³¹⁰ Konventa për Pastrimin, Depiskimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit, neni 3, Masat hetimore dhe masat e përkohshme.

rrjedhojë, edhe procesi i të provuarit ka rregullat e veta të veçanta që përcaktohen në këtë ligj në disa përcaktime të veçanta të tij, që duhet të trajtohen teorikisht duke interpretuar dispozitat e veçanta të ligjit, të cilat përcaktojnë rregulla procedurale apo të vlerësimit të provës.

Se sa e rëndësishme është prova si dhe mundësia që i jepet palës për ta paraqitur atë, mjafton të sjellim në vëmendje se sa kompleks është procesi i konfiskimit të pasurisë, kur bëhet fjalë për pasuri të mëdha, aktivitetet ekonomike, ku janë përfshirë familjarë, të tretë, bashkëpunëtorë, banka, huadhënës, kompani siguracionesh e investimesh, kërkohen ekspertime financiare, kontabël të vlerësimit të pasurive etj.

Duhet theksuar se përsa i përket provave, procesit të të provuarit, parimeve mbi të cilat ato bazohen kemi parashikimet e ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit e korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese, rregullimet veçanta të ligjit, të cilat bazohen në parimet e procedimit pasuror si standardi i provës e barra e provës. Ndërkohë, si norma plotësuese procedurale kemi ato të legjislacionit procedural penal. Por, a mjaftojnë vetëm këto në një procedim ku ndërthuren koncepte të pronësisë, posedimit, e çdo instituti tjetër të së drejtës civile, familjare, trashëgimisë, tregtare, financiare, administrative etj. Një hipotezë të tillë kam hedhur në këtë studim e do të mundohem ta shtjelloj më poshtë.

4.3 Standardi i provës për masat parandaluese pasurore

Standardi i provës në procedimin parandalues është më i ulët se në procedimin penal. Ndryshe nga standardet e të provuarit dhe përgjegjësisë në dhënien e një vendimi penal, përfshirë urdhërimin për konfiskimin ose jo të sendeve të sekuestruara, në procedimin parandalues, sipas ligjit shqiptar, vendosja e masës pasurore ka në themel të saj dyshimin e arsyeshëm, të mbështetur në të dhëna të mjaftueshme, që rezultojnë nga tërësia e provave të marra dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Pra, në ndryshim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshime të arsyeshme, të dhëna të mjaftueshme e prezumime, duke iu ngarkuar personit të dyshuar dhe personave të tjerë barra e provës për të vërtetuar ligjshmërinë për justifikimin e origjinës së pasurisë.

Sistemet ligjore ndryshojnë shkallën e provës, që kërkohet për të mbështetur një vendim konfiskimi. Mundësitë variojnë nga provat, ku mbështetet shkaku i mundshëm ose baza e arsyeshme deri tek një dyshim i thjeshtë apo indiciet që të jenë të mjaftueshëm për bindjen e gjyqtarit, ashtu sikurse ka sisteme ligjore që kërkojnë një provë përtej dyshimit të arsyeshëm që është një standard i njëjtë me atë që kërkon procedimi penal.³¹¹ Standardet e provës sipas radhës, nga më i ulëti tek ai më i larti renditen:

- dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicie
- një bazë e arsyeshme të dhënash
- standardi i epërsisë së provës
- prova përtej dyshimit të arsyeshëm

Disa sisteme ligjore lejojnë një standard të ulët në fazën fillestare të lejimit të sekuestrimit të provës ose konfiskimit paraprak të barabartë me atë që lejohet për lëshimin e urdhrave ose vendimeve të kontrollit, sekuestrimit në të drejtën penale etj., ndërsa për konfiskimin kërkohet një standard më i lartë i provës. Në procedimin parandalues nuk ka vend për vërtetimin domosdoshmërisht nga prokurori e gjykata të lidhjes shkakësore, të drejtpërdrejtë, të dukshme e të menjëhershme, logjike e kronologjike, ndërmjet pasurisë, prejardhjes së saj dhe veprës penale, për të cilën së paku ekziston dyshimi i arsyeshëm si e kryer nga personi i dyshuar. Standardi i provave rrethanore nuk është i njëjtë për secilin element të të provuarit. Ligji ka parashikuar vlerësime të ndryshme në lidhje me fakte juridike të ndryshme, ndërsa një standard uniform provues përcaktohet për sekuestrimin dhe konfiskimin.

Standardet e provës, që ka përcaktuar ligji shqiptar janë si më poshtë:

- *dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova* për pjesëmarrjen në veprimtari kriminale që përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit.³¹² Pra, pjesëmarrja në kriminalitet të organizuar ose veprat penale të tjera në fushën e zbatimit të ligjit duhet të provohet bazuar standardit më të ulët të provës, që mbështetet tek dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie.

³¹¹ Stolen Asset Recovery A Good Practices Guide for non-Conviction Based asset Forfeiture, Theodore C. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray, The World Bank, Washington D.C.

³¹² Neni 3 “Fusha e zbatimit” Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

- në rastin e regjistrimit të rremë të pasurisë në emër të të afërmeve ligji ka zgjedhur *prezumimin* se është një nivel më i ulët provues, ndërsa e kundërta duhet të provohet, gjë që kuptohet me prova me nivel provues.³¹³
- *të dhëna të mjaftueshme* se pasuritë ose veprimtaritë e subjekteve të ligjit zotërohen pjesërisht ose plotësisht.³¹⁴ Pra, në këtë rast, kërkohen “*të dhëna të mjaftueshme*”, kjo në kuptimin se titulli i pronësisë ose i posedimit mund të vërtetohet saktë, për shkak të regjistrimit të pasurisë.
- *të dhëna të dobishme*, të siguruar në mënyrë të ligjshme, që krijojnë dyshim të arsyeshëm në rastin e zbatimit të prezumimit të regjistrimit të rremë.³¹⁵
- *të dhëna të mjaftueshme* se pasuritë zotërohen nga subjektet e ligjit nxirren nga marrëdhënia mes tyre me të afërmit, por dhe nga të dhëna të dobishme të siguruar në mënyrë të ligjshme, që krijojnë dyshim të arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.³¹⁶
- *indicie të rëndësishme* për përfshirjen në veprimtari kriminale në rastin e veprimit të ligjit në kohë për pasuritë e vënë përpara hyrjes në fuqi të tij.³¹⁷

Ndërkohë, siç kemi trajtuar më lart zbatohet në tërësi si procedim pasuror për pasuritë që zotërohen plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi të cilët ekziston “*një dyshimi i arsyeshëm*”, i bazuar në prova se janë fituar me kryerjen e veprave penale në fushën e zbatimit të ligjit.

- Sekuestrimi vendoset, kur ekziston *dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie*, që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri.

³¹³ Shkronja a) paragrafi 2 nenit 2 “Fusha e zbatimit” “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të përmendura në pikën 1, të këtij neni në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga personat e afërm për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë përveçse provohet e kundërta

³¹⁴ Shkronja b) paragrafi 2 i nenit 3 “Fusha e zbatimit” Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

³¹⁵ Paragrafi 3 i nenit 2 të Ligjit “Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurisë në emër të personave të afërm zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruar në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e pasurisë”

³¹⁶ Pika 4 i nenit 2.

³¹⁷ Paragrafi 6 nenit 2 parashikon se: Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale në kohën e vënies së pasurisë.

- Konfiskimi i pasurisë vendoset, *kur ka dyshime të bazuara në indicie* për pjesëmarrje në veprimtari kriminale.

Pra, gjatë objektit të të provuarit e vërtetimit të fakteve iu referohemi standardit të parashikuar shprehimisht për secilën situatë dhe jo një standardi të njësuar për të gjithë rastet. Duke marrë si shembull proporcionalitetin e të ardhurave që si element faktik mund të dalë i vërtetuar duke vlerësuar punën ose aktivitetin që ushtron personi, të ardhurat e tij nga ky aktivitet, jetesën, lidhjet me persona të botës së krimit, pamundësinë e personit për të vërtetuar të ardhurat këto në tërësi krijojnë provën e plotë të paligjshmërisë efektive të akumulimit të pasurisë.³¹⁸ Parimi i proporcionalitetit në kufizimin e të drejtës së pronës sipas jurisprudencës së GJEDNJ, ndjek prezumimin që personat kanë regjistruar në mënyrë të rreme pasuritë në emrin e tyre, nëse nuk provohet e kundërta, nuk mund t'i mbajnë ato pasuri.

Prezumimi i ngritur me ligjin tonë është në përputhje me ligjet e tjera analoge e merr parasysh përputhshmërinë me parimet e KEDNJ nga GJEDNJ.³¹⁹ Mbetet akoma prezumimi i zotërimit të pasurive nga të dyshuarit e veprës penale, por pa barrën mbi subjektet e tjerë, persona të afërm të tyre, për të provuar se ata janë pronarë të vërtetë të pasurive të sekuestruara. Çdo sistem ligjor parashikon prezumime të faktit dhe të ligjit. Konventa nuk bën kundërshtime në parim *mutandis mutandis*. GJEDNJ³²⁰ shprehet se e drejta e kërkuesve për respektimin e pasurisë së tyre, megjithatë, nënkupton ekzistencën e garancive ligjore të efektshme dhe nuk do të thotë se nuk mund të kufizohet. Prova kërkohet nëse personat e afërm, familjarët e përmendur në nenin 3 pika 2 shkronja a)³²¹ tregojnë se:

- ata kanë paratë ose të ardhurat e mjaftueshme për të blerë pasuri ose për të patur veprimtari sipërmarrëse.
- ata i kanë përdorur paratë për të blerë pikërisht atë pasuri
- kjo tregohet në mënyrë rigoroze

³¹⁸Cfr. A.Balsamo, Codice Antimafi, Dig. disk. Pen, VIII, Torino, 2014

³¹⁹ GJEDNJ, Vendimi i 5 qershorit 2010, Biongiorna kundër Italisë.

³²⁰ GJEDNJ, Vendimi Salabiaku kundër Francës, 7 tetor 1988

³²¹ Persona të afërm, bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrra, vjehrra etj.

Shprehja “*të dhëna të mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik zotërohen pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë indirekte, nga personat që kanë konsumuar veprat penale të krimit të organizuar e të tjera*”, është vënë për të shmangur keqinterpretimin, pasiguritë dhe për qartësi duke përcaktuar elementet dhe karakteristikat që lejojnë gjykatat ta konsiderojnë zotërimin indirekt në emër të autorëve të dyshuar.

Këto të dhëna të mjaftueshme nxirren:

- nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1 të ligjit tonë, duke iu referuar një marrëdhënieje të veçantë me të dyshuarin e veprës, për shembull, marrëdhënia e punës, varësia profesionale ose lidhja e gjakut dhe familjare, të cilat janë përfshirë në nenin 3 pika 2 shkronja a) ku bëjnë pjesë të afërmit.
- nga fakti se personi fizik ose juridik ka pasuri ose të ardhura që nuk përputhen dukshëm me nivelin e të ardhurave, fitimeve ose veprimtarive të ligjshme të deklaruar dhe nuk justifikohen prej tyre.
- mungesa e mjeteve financiare të palës së tretë për të blerë pasuritë, që përbën në veçanti një element të rëndësishëm të pronësisë fiktive, i shtohet marrëdhënies së veçantë ndërmjet të dyshuarit dhe personit që zotëron pasuritë e nga rrethana të tjera të dobishme

Për shembull; përmbajtja e një përgjimi telefonik ose fatura të energjisë elektrike në emër të një personi mund të provojnë pronësinë fiktive të një personi mbi pasurinë, duke mos pasur ndoshta lidhje me mjete ekonomike apo marrëdhënie të dukshme me të dyshuarin e veprës.

4.4 Niveli i dyshimit të bazuar në indicie si standard i provës për sekuestrimin dhe konfiskimin.

Në procedimin parandalues, sipas ligjit shqiptar, për vendosjen e masës së sekuestrimit apo konfiskimit pasuror kërkohet një standard prove i ulët, konkretisht dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie. Fillimisht, me miratimin e ligjit ky nivel u kontestua me argumentin se binte ndesh me tiparet e përgjithshme të procedimit penal që kërkonte dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova si niveli më i ulët i të provuarit në rastin e hetimeve paraprake. Gjykata Kushtetuese e RSH në lidhje me kërkimin se shprehja “*dyshim i arsyeshëm bazuar në indicie*” parashikuar nga neni 3

paragrafi 1 i ligjit,³²² nuk është në përputhje me standardin “*dyshim i arsyeshëm*” parashikuar nga neni 27/2 i Kushtetutës dhe neni 5 /i KEDNJ ka mbajtur qëndrimin se ky standard zbatohet për masat parandaluese pasurore, ndaj garancia e cituar kushtetuese nuk ka lidhje me objektin e ligjit dhe për këtë arsye kjo shprehje si standard provues nuk shkel *nenin 27/2 germa c)* të Kushtetutës.³²³

Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ³²⁴në lidhje me procesin e të provuarit dhe standardin e provës që kërkohet në gjykimin parandalues mbante qëndrimin se: “...*në procedimin parandalues njafton të vërtetohet dysimi i arsyeshëm për qenien si person i dyshuar, mundësia e zotërimit të pronës dhe nuk është i njëjti standardin si për procedimin penal*”

Për përfshirjen në veprimtari kriminale kërkohen *dysime të arsyeshme të bazuara në indicie* në lidhje me këtë fakt. Të njëjtin nivel prove ligji pranon për regjistrimin e procedimit penal, sekuestrimin dhe konfiskimin³²⁵. Kjo pasi si procedim pasuror për pasuritë që zotërohen plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi të cilët ekziston një dysimi i arsyeshëm i bazuar në prova se janë fituar me kryerjen e veprave penale në fushën e zbatimit të ligjit. Sekuestrimi vendoset kur ekziston dysimi i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri. Konfiskimi i pasurisë vendoset kur ka dysime të bazuara në indicie për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, por ndërkohë kërkohet në mënyrë kumulative që të rezultojë nga posedimi i pasurisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi dhe nuk provohet prejardhje e ligjshme e pasurisë.

Nga renditja e mësipërme rezulton se standardi i ulët i provës “ *i dysimit të arsyeshëm të bazuar në indicie*” kërkohet për identifikimin e subjektit për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, pasurisë që rezulton në emër të tij, për vendosjen e sekuestrimit e konfiskimit. Ndërsa për vendosjen e

³²² Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

³²³ Vendimi nr. 4 datë 2.02.2011 i Gjykatës Kushtetuese e të RSH. Mund të gjendet në www.gjk.gov.al

³²⁴ Vendimi nr. 1 datë 25.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë më kërkues Prokuroria e Krimeve të Rënda ndaj subjektit Xh. T. Mund të gjendet në www.gjykataelartë.gov.al

³²⁵ Neni 3, neni 11 dhe neni 24 i ligjit nr. 10 192 datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

konfiskimit kërkohen edhe plotësimi i dy kushteve e tjera kumulative³²⁶ që janë: vërtetimi se pasuria është drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave (ligji përdor termin “*rezulton*”), ndërsa për prejardhjen e ligjshme të pasurisë përdoret termi “*nuk provohet*” dhe “*nuk arrijnë të përligjin nivelin e të ardhurave*”³²⁷

Edhe në ligjin italian antimafia³²⁸, janë përdorur termat “*në bazë të elementëve të fakteve*” dhe “*prova*” kur bëhet fjalë për diferencën në mes të asaj që kërkohet për të provuar përfshirjen në kriminalitete e standardin e jetesës të pajustificuar dhe nga ana tjetër. Pra, jo për çdo element të të provuarit kërkohet i njëjti nivel i provës. Termi ose standardi i të provuarit të “*dëshimeve të bazuara në elementë të faktit*”, i parashikon edhe *Akti Normativ nr. 1 datë 31.01.2020* “³²⁹ Duket qartë që ky Akt Normativ ka marrë si model pikërisht Kodin Antimafia Italian, dekretligjin 159 të majit 2011 në të cilin përdoret ky standard prove.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,³³⁰ duke shqyrtuar një kërkesë për antikushtetutshmëri të ligjit, mbi pretendimin se shprehja “*dëshim i arsyeshëm bazuar në indicie*”, parashikuar në nenin 3 paragrafi 1 i ligjit nuk është në përputhje me standardin “*dëshim i arsyeshëm*”, parashikuar në nenin 27 paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe në nenit 5 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe në nenin 228 paragrafi 1 të KPP-së,³³¹ ka mbajtur qëndrimin se “*neni 27 paragrafi 2 i Kushtetutës mbi kriterin e dëshimit të arsyeshëm lidhet me garancitë kushtetuese për privimin e lirisë. Ndërsa ligji objekt shqyrtimi, në nenin 1 për objektin e ligjit, parashikon se “Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin*

³²⁶ Përveçse atij të përcaktuar nga shkronja a) e nenit 24 të ligjit, në lidhje pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale sipas parashikimit të nenit 3 pika 1 të ligjit.

³²⁷ Shkronja b) dhe c) paragrafi 1 i nenit 24 të ligjit “Pranimi i kërkesës për konfiskim”

³²⁸ Neni 1, Dekreti Legjislativ 6 shtator 2011, nr. 159 “Kodi i ligjit të Antimafias, masat parandaluese, si dhe rregullat të reja për dokumentacionin”

³²⁹ Aktin Normativ nr. 1 datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike, miratuar me datën 31.01.2020, duke u botuar në Fletoren Zyrtare e hyrë menjëherë në fuqi.

³³⁰ Vendimi nr. 4, datë 23.02.2011, Kërkues Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kërkesa me objekt “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ të ligjit nr. 10192”.

³³¹ Neni 27, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se “*Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme, kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj*”. Ndërsa neni 228, paragrafi 1 i KPP-së parashikon se “*askush nuk mund t’i nënshtrohet masave të sigurimit personal, nëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm bazuar në prova*.”

e organizuar dhe trafikim”. Neni 4 i ligjit saktëson se masë parandaluese është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarisë ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre. Ndaj garancia e cituar kushtetuese nuk ka lidhje me objektin e ligjit dhe, për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se ligji nuk shkel nenin 27, paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe pretendimi i kërkuar është i pabazuar”.

Ky qëndrim është në vijim të qëndrimeve të mbajtura nga GJEDNJ³³² në lidhje me konfiskimin si masë parandaluese për pasurinë dhe jo ndëshkuese dhe si e tillë është në përputhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ³³³. Ishte Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Lëndëve Psikotrope,³³⁴ e cila njohu mundësinë që shtetet në legjislacionin e brendshëm të parashikonin përmbysje të vlerësimit të provave në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera të deklaruara që i nënshtrohen konfiskimit. Nëse i referoheni interpretimit në të drejtën italiane për “faktin”, me elementë faktike nënkuptojmë elemente që kanë të bëjnë me fakte ose që përbëjnë fakte, pra elemente që mund të konsiderohen konkrete, objektive dhe të verifikueshme. Termi “*de facto*” (nga latinishtja *de facto*)³³⁵ tregon diçka që korrespondon qartë me të vërtetën, me realitetin dhe që vërtetohet dhe demonstron pikërisht nga faktet; për shembull. Edhe në fakt, dhe në fakt, ato kanë kuptime të arritshme, por përdoren për qëllime të ndryshme.

Një nga interpretimet e mundshme të “elementeve të faktit” është ai i elementeve (të vërtetave) të cilat rrjedhin thjesht nga faktet dhe për këtë arsye vërtetohen automatikisht. Nëse i referohemi

³³² GJEDNJ Marandino kundër Italisë, 15 prill 1991, Raimondo kundër Italisë, 22 shkurt 1994, Prisco kundër Italisë 15 qershor 1999, Reila kundër Italisë 5 janar 2000 etj.

³³³ “Cdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona etj, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara me ligj e nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çënojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligjë që ata i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin epërgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera.

³³⁴ E quajtur ndryshe dhe Konventa e Vjenës 1988, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8722 datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope.”

³³⁵ Fjalorin i Madh i gjuhës italiane. Il Grande dizionario della lingua italiana. il 9 maggio 2019. <https://www.gdli.it/>

kuptimit të shprehjes indicie - nga latinishtja “*inde*” dhe “*direre*” – *pohimi, ekzistenca e një fakti të panjohur që rrjedh nga një fakt i njohur*.

Ligji ynë procedural penal nuk flet për prova të drejtpërdrejta ose të tërthorta, por flet vetëm për termat “*provë*”, “*indicie*”.³³⁶ Provat e tërthorta ose indiciet përbëjnë material provues pasi vërtetohet se kanë lidhje me ngjarjen që është objekt hetimi, shpeshherë ato përbëjnë prova të vetme të procesit gjyqsor dhe kanë karakter të kushtëzuar. Neni 152 K.Pr.Penale parashikon se “*Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveç se kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën*”. Pra, njehsimi i vlerës provuese të provës direkte me atë indirekte do të mund të bëhet vetëm nëse ato janë pa të meta dhe nëse nuk ka dyshim për përputhje mes tyre. Me “*dyshim të arsyeshëm*” kuptohet një bazë reale dhe ekzistente të dhënash fillestare, e cila nuk është ende në nivelin e provës. Ndërsa, që një e dhënë të vlerësohet si provë duhet që ajo të jetë “*përtej dyshimit të arsyeshëm*”.

Ky kuptim i provës spikat si debat në kontekstin e së drejtës zakonore anglo-saksone³³⁷, i karakterizuar për më tepër nga vlerësime e bëra nga juritë popullore. Me fjalë të tjera, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, si rregull juridik i vendimit, me të cilin duhet të zgjidhet problemi i provave të pamjaftueshme dhe kontradiktore, përfaqëson kufirin e lirisë së bindjes së gjyqtarit, të përgatitur nga sistemi juridik për të parandaluar se rezultati i gjykimit t’i lihet vlerësimeve diskrecionale, subjektive që kufizohen me arbitraritetin. Megjithatë, dyshimi i arsyeshëm nuk është thjesht dyshimi gjithmonë i mundshëm ose dyshimi imagjinar, por është dyshimi që, pas të gjitha vlerësimeve dhe konsideratave të provave, ndikon në mendimin profesional të gjyqtarëve në një gjendje të tillë, që ata nuk mund të pohojnë një bindje të palëkundur, afër sigurisë morale (*të kuptohet si siguri praktike*), mbi vlefshmërinë e akuzës. Rregulli i gjykimit dhe vlerësimit të sanksionuar nga neni 8/a³³⁸ dhe 380³³⁹, 383³⁴⁰ të Kodit

³³⁶ Nenet 149,152 I KPrP. “Kuptimi i provës”, “Objekti i provës”

³³⁷ Çështja Commonwealth kundër Weber, vendosur nga Gjykata e Lartë e Massachusetts në 1850, ose dënimi i famshëm i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në re Winship, i vitit 1970, Reference Manual on Scientific Evidence, For Use With Federal Practice and Procedure, Federal Judicial Center, West Publishing Company

³³⁸ Faktet në një procedurën penale provohen me çdo provë, me kushte që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

³³⁹ Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera vec atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqsor.

³⁴⁰ Provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta.

tonë të Procedurës Penale, duhet të koordinohet me rregullat e vlerësimit të dhëna në nenin 152 të KPrP³⁴¹ ku sanksionohen parimet e vlerësimit të lirë të provave.

Që të argumentohet në mënyrë të saktë pohimi i parimit të *“përtej dyshimit të arsyeshëm”*, duhet që indiciet në kuptim të nenit 152 të KPrP të përmbushin të tre elementët kumulativë: rëndësinë, saktësinë dhe përputhshmërinë. Vlerësimi i tyre sigurisht kalon në procesin e bindjes së brendshme të gjyqtarit profesionist, i cili nëpërmjet përvojës profesionale e maksimave të saj bën vlerësimin nëpërmjet logjikës dhe argumenteve duke vlerësuar elementin faktik /indicien si provë që vërteton një fakt. Në thelb të këtij vlerësimi është parimi se në mungesë të qoftë edhe njëres prej këtyre elementëve, provat nuk mund të ngrihen në shkallën e provës së përshtatshme për të themeluar përgjegjësinë penale. Për më tepër, procesi i vlerësimit të indicies ndahet në dy momente të dallueshme: i pari synon të konstatojë shkallën më të madhe ose më të vogël të ashpërsisë dhe saktësisë së secilit prej tyre, i konsideruar i veçuar, i dyti konsiston në një ekzaminim të gjithanshëm dhe unitar që synon të eliminojë paqartësitë relative mbi to.

Për sa i përket vlerësimit të provave rrethanore, gjyqtari nuk mund të kufizohet në një vlerësim të vetëm dhe të fragmentuar të indicieve, as të vazhdojë thjesht me një përmbledhje të këtyre të fundit, por duhet para së gjithash të vlerësojë elementet e vetme rrethanore për të verifikuar sigurinë e tyre në kuptimin që ato duhet të jenë fakte realisht ekzistuese dhe jo vetëm të mundshme ose të supozuara. Indiciet duhet të vlerësohen nisur nga vlera e tyre e brendshme demonstruese dhe më pas të vazhdohet me një vlerësim të tërësishëm të elementeve të caktuara, për të konstatuar nëse paqartësia relative e secilës prej tyre, e konsideruar veçmas, mund të zgjidhet në një vizion unitar, duke lejuar që fakti e fajësia e të të akuzuarit të provohen *“përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”* pra me një shkallë të lartë besueshmërie racionale, që ekziston. Sipas Siracosanno³⁴² indiciet quhen *“provë logjike”*, e cila është e aftë

³⁴¹Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata pas shqyrtimit të provave në tërësi, cmon vërtetësinë dhe uqinë provues e të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetër.

³⁴²D. Siracosano, *Diritti Processuale Penale*, nuova edizione, 2004, Giuffrè editore, Vol. primo. La prova diretta e gli indizi.

që nëpërmjet arsytimit e vlerësimit të saj të krijojë bindjen e ekzistencës së faktit.³⁴³ Indiciet e pavërtetuara e të pa konfirmuara mbasin abstrakte e joracionale. Nëse ato mbeten alternative apo hipotezë e formuluar në mënyrë abstrakte, ato nuk kanë asnjë konfirmim konkret në gjetjet procedurale dhe janë të jashtme për rendin natyror të gjërave dhe racionalitetin normal njerëzor.³⁴⁴ Pra vlerësimi nuk duhet të jetë fragmentar, por një vlerësim i përgjithshëm e sistematik i kuadrit provues.

Një çështje me rëndësi është dallimi mes “*dyshimit*” me “*indicien*”. “Dyshimi” është një nocion që lëkundet mes dy kuptimeve, atij të dukurisë subjektive, hamendje, pra hipotezave të paprovuara, ose më saktë në kërkim të provave dhe kuptimit të të dhënës dyshuese, ekuivokë, të dobët. Megjithatë, sipas *Larguier dhe Conte* ky koncept nënkupton elementë të aftë për të mbështetur hipoteza të ndryshme dhe alternative, madje dhe të kundërta, në shpjegimet e fakteve që testohen.³⁴⁵ Në të kundërt sikurse i përkufizon Vincent Mermoz në punimin e tij për indiciet në procedurën penale, “*indiciet*” janë provat e arritura përmes një arsytimi konkludues i cili duke u nisur nga një fakt i njohur (*indicies*) shpie në një fakt të panjohur (*fakt p.sh. për të vërtetuar se personi ka qenë prezent në vendngjarje*) në bazë të zbatimit të rregullave shkencorë, logjikë ose maksimave të përvojës.³⁴⁶

Edhe në trajtimet e teorisë së provës në të drejtën italiane mbahet qëndrimi sipas të cilit “*elementët e faktit*”³⁴⁷ janë fakte të panjohura për t’u vërtetuar në bazë të rregullave shkencore e përvojës racionale të bindjes së gjyqtarit, ndërsa “*dyshimi*” një hamendësim, qëndrim subjektiv, fenomen i hipotezës me prova që duhen kërkuar, ose me të dhëna të dobëta e të paqarta të tilla si për të mbështetur hipoteza të dallueshme, alternative, madje dhe të kundërta me shpjegimin e fakteve që testohen.³⁴⁸ Praktika gjyqësore italiane gjithashtu sanksionin se “*indiciet*” janë fakte të caktuara

³⁴³ D. Siracosano, *Diritti Processuale Penale*, nuova edizione, 2004, Giuffrè editore, Vol. primo. La prova diretta e gli indizi.

³⁴⁴ Corte di Cassazione, Seksioni 1, nr. 44324, datë 18/04/2013, Stasi, Rv. 258321; Seksioni 1, nr 26455 datë 26.03.2013, Knox, Rv 255677).

³⁴⁵ Larguier et Conte, “*Procédure pénale*”, Dalloz, Collection “*Mementos*” 24 Edition 2016

³⁴⁶ Vincent Mermoz *Les indices en procédure pénale*, Université Paris Saclay, 2019

³⁴⁷ Termi elementëve të faktit në Kodin e Procedurës Italine e Kodin Antimafia është i njëjtë me kuptimin që ka termi indicie në Kodin tonë të Procedurës Penale dhe ligjin tonë për parandalimin e kriminalitetit. Ky përcaktim bëhet nga neni 192 i KPrP italiane.

³⁴⁸ Paolo Ferrua, Fabio M. Grifantini, Giulio Illuminati, Renzo Orlandi *La prova nel dibattimento penale*, quarta edizione, G. Giappichelli editore, Torino, 2007.

nga të cilat, me konkluzion logjik të bazuar në rregullat e vlerësimit të përvojës profesionale të konsoliduara dhe të besueshme, arrijnë në demonstrimin e një fakti të pasigurtë për të vërtetuar sipas skemës së të ashtuquajturit “*silogjizëm gjyqësor*”³⁴⁹.

Këto parime të vlerësimit të indicies i ka adaptuar dhe e drejta dhe teoria shqiptare e provave. Në nenin 152 i Kodit të Procedurës Penale sanksionohet që nga indiciet nuk mund të nxirret ekzistenca e një fakti përveçse kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën. Të dhënat për qëllime provuese ndryshojnë nga hamendjet e thjeshta, sepse ato përbëhen nga fakte të caktuara ontologjikisht të cilat, të lidhura me njëra-tjetrën, janë të ndjeshme ndaj një interpretimi shumë specifik, ato duhet të korrespondojnë me të dhënat e caktuara faktike dhe, për këtë arsye, nuk përbëhen nga hamendjet e thjeshta, duhet të jenë të rëndësishme që të kenë një vlerë shprehëse të një fakti që ka të bëjë me atë që kërkohet të provohet. Kur thuhet të jenë të sakta do të thotë që janë të afta për të shprehur një probabilitet të lartë për prejardhjen e faktit, për prejardhje nga fakti i njohur i së panjohurës. Ato duhet të jenë të sakta që të kenë një rekuizitë të tillë, që në mungesë të njëres së dhënë nuk ngrihet në shkallën e provës së përshtatshme për vendosjen e përgjegjësisë penale. Për më tepër, procesi i vlerësimit të tyre ndahet në dy momente të dallueshme: *i pari*, synon të konstatojë shkallën më të madhe ose më të vogël të ashpërsisë dhe saktësisë së secilit prej tyre, i konsideruar i veçuar, *i dyti* konsiston në një ekzaminim tërësor dhe të vetëm që synon të shpërbëjë paqartësi relative.

Në një Vendim të Gjykatës Kushtetuese Italiane³⁵⁰, janë deklaruar si në kundërshtim me Kushtetutën disa nene të Kodit Italian Antimafia për masën e parandalimit personal të mbikëqyrjes së posaçme për personat që duke u bazuar në *elementë të faktit* del që janë përfshirë në veprat penale të trafikimeve. Për këtë shfuqizim të këtyre neneve Gjykata Kushtetuese Italiane përdor si argument Vendimin e GJEDNJ (*Dhoma e Madhe*) vendimi *Tommaso kundër Italisë*³⁵¹ në lidhje

³⁴⁹ Corte di Cassazione, SS. UU 6682 del 4/2/1992 Musumeci

³⁵⁰ Vendimi nr. 24/2019 i Gjykatës Kushtetuese Italine mbi bazën e kërkesës së disa gjykatave Gjykata e Padovës, Gjykata e Apelit të Napolit dhe Gjykata e Udines për të shfuqizuar si në kundërshtim me Kushtetutën të Art. 117, paragrafi i parë në lidhje me nenin. 2 Prot Shto. n. 4 i KEDNJ dhe neni. 25, paragrafi i tretë, i Kushtetutës.

³⁵¹ Vendimi i datës 23 shkurt 2017, i GJEDNJ, Tommaso kundër Italisë citon “Gjykata njih “*statusin kushtetues*” të masave të sipërpërmendura në vijat e ekzistencës së një baze të përshtatshme ligjore, të proporcionalitetit të nevojshëm në lidhje me objektivat legjitime të parandalimit dhe i rezervës së juridiksionit ose një procedim i cili, megjithëse nuk i nënshtrohet standardeve të garancisë së gjykitimit penal, megjithatë është i përshtatshëm për garantimin e të drejtës së mbrojtjes. Nisur nga sa më sipër, në lidhje me profilet e papërcaktueshmërisë së bazës

me proporcionalitetin e masave parandaluese, të cilat nuk i nënshtrohen garancive të procesit penal, por duhet të ruajnë përshtatshmërinë e garancitë e mbrojtjes, duke arsyetuar se ulja e nivelit të provës bazuar në elementët e faktit nuk është e përshtatshme për masat e sigurimit personal siç është ajo që parashikon neni përkatës në Kodin Italian Amtimafia.³⁵²

4.5 Provat, llojet dhe vlerësimi i tyre, në këndvështrim të procedimit penal e atij pasuror.

Në kuptimin e provës, ne i referohemi provës në të drejtën procedurale penale, teorisë mbi të por gjithashtu natyrës së gjykimit parandalues pasuror. Standardi i provës dhe devijimi i barrës së provës, i referohet natyrës së konfiskimit të cilën GJEDNJ e konsideron si masë parandaluese dhe jo penale, që ka një funksion të ndryshëm nga procesi *in personam* e që merret me qëllim interesin publik.³⁵³ Procesi parandalues është një proces që i nënshtrohet parimeve të procesit të rregullt gjyqësor e parimeve themelore të procesit penal dhe të cilësuar si të tilla nga ndërhyrja e gjykatës mbi palët, shqyrtimi i një kërkesë të qartë e një objekti të qartë gjykimi në përputhje me parimin e ligjshmërisë, parimet e ligjshmërisë dhe natyrës së detyrueshme të masës që do merret, kontradiktoritetit në gjykim, sigurimit të mbrojtjes, gjykimit në të gjitha shkallët, mundësi për prova, e drejta e ankimit dhe ajo e rishikimit në rast të një vendimi të padrejtë.³⁵⁴

Ligji “Për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar ka përcaktuar se për verifikimin, hetimin dhe gjykimin mbështetet në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohet

ligjore të masave parandaluese për të cilat ai kishte shprehur tashmë dyshime të forta në të kaluarën (fjalë nr. Kasacion si nga ana përmbajtësore (me referencë të veçantë për mbiemrin "kriminal", ndaj ndajfoljes "zakonisht", termave "fakte", "të ardhura" dhe "trafikim kriminal") dhe procedural (që synojnë të specifikojnë konsistencën e "elementeve faktike", veçanërisht në lidhje me çdo vendim që ka ndodhur ndërkohë në gjykatë) në dispozitat e kontestuara, verpimet nga subjekti, të cilat realisht kanë sjellë fitime për të, të cilat nga ana e tyre përbëjnë - ose kanë përbërë në një periudhë të caktuar-të vetmen e tij. të ardhurat ose të paktën një komponent i rëndësishëm dhe për këtë arsye e deklarën pyetjen e ngritur pjesërisht të pabazuar këtu pasi përfituesit e mundshëm të masave parandaluese janë në gjendje të parashikojnë në mënyrë të arsyeshme zbatimin e vetë masës.

³⁵² Art. 1, le. a), Dekreti Legjislativ 159/2011 (me referenca përkatëse në nenin 4, paragrafi 1, germa c) dhe 16, Dekreti Legjislativ 159/2011).

³⁵³ Qëndrim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Vendimet Marandino kundër Italisë, 15 prill 1991, Raimondo kundër Italisë, 15 qershor 1999, Prisco kundër Italisë, 15 qershor. <https://hudoc.echr.coe>

³⁵⁴ La prova nel procedimento di prevenzione: identità, alterità o somiglianza con il processo penale, di Giovanni Francolini, SP Sistema Penale, 10/2020.

nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, dhe gjithashtu, bazohet në standardin penal të *dyshimit të arsyeshëm*. Kjo i jep ligjit natyrën penale të tij. Prandaj, nuk ka një disiplinë të veçantë të provave, teorisë së të provuarit në hetimin e gjykimin parandalues, por për këtë i referohemi tashmë asaj të procedurës penale.

Është me vend në këtë rast të trajtojmë disa koncepte të teorisë së provave në të drejtën procedurale penale, të cilat i përdorim më tej në *interpretimin e të provuarit, standardit të provës e barrës së provës* në sekuestrimin dhe konfiskimin gjatë procedimit pasuror *in rem*. Vërtetimi i fakteve juridike, qoftë në procedimin penal, qoftë në atë pasuror parandalues bëhet nëpërmjet provave. Dallimi është se tek niveli i provës që kërkohet. Nocioni “*provë*” nënkupton një të dhënë që përmban saktësinë e një fakti. Me fjalë të tjera, prova është burim njohurish për faktet që vërtetohen në procedurën penale. Ndërsa procesi i të provuarit, është ai proces, i cili në analizë e përdorim të provave, siguron verifikimin apo njohjen e një fakti. Kodi i Procedurës Penale jep përkufizimin për provën³⁵⁵: “*Provat janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij*”.

Fjala “*provë*” rrjedh nga latinishtja, dhe është rrënja e fjalës “*aprovatio*”, që do të thotë aprovim ose miratim.³⁵⁶ Kur flitet për provat, është e nevojshme të bëhet dallimi mes termit “*provë*”³⁵⁷, e termave të tjerë, që përdoren në procedurën penale si për shembull: “*procedura e të provuarit*”, “*marrja e provave*”, *fakti*”, “*mjeti i provës*”. Sipas fjalorit procesi i të provuarit³⁵⁸ nënkupton veprimet procedurale në tërësi si: marrjen, shqyrtimin, verifikimin, vlerësimin. “*Fakti*” është ekzistenca objektivo-reale e një sendi a dukurie, procesi, cilësie, fragment i realitetit objektiv që janë objekt i të provuarit.³⁵⁹ Marrja e provave është faza e shqyrtimit e marrjes provave në procesin gjyqësor. Ndërsa “*mjeti i provës*” është instrumenti me të cilin sigurohet prova. Nga formulimi i

³⁵⁵ Neni 149 i KPrP i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 ne paragrafin 2 të tij “*Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata, mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cënon lirinë e vullnetit të personit.*”

³⁵⁶ Fjalori latinisht-shqip, botim 2004, Akademia e Shkencave.

³⁵⁷ Oxford Dictionary of Law “*Prova është ajo që synon të provojë qënien ose mosqënien e një fakti*”

³⁵⁸ Black’s Law Dictionary “*Të provuarit është të pranuarit, apo të refuzuarit e një fakti të pretenduar nëpërmjet provave*”

³⁵⁹ Sandër Simoni, Leksione të lëndës *Procedurë Penale*, temat “*Provat. Mjetet e provës*”, Shkolla e Magjistraturës, 2005 e në vijim.

nenit 149 të K.Pr.Penale, del e qartë se prova sipas legjislacionit shqiptar, përbën fazën esenciale të të provuarit dhe vetë kuptimi i saj është i lidhur me veprën penale. Kjo del nga përkufizimi i saj si “...njoftim mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale”. Në K.Pr.Penale italiane³⁶⁰ nuk ka një përkufizim të provës. Dispozitat e përgjithshme të tij hapen me “objektin e provës”. Ndërsa literatura juridike e përkufizon provën si “një mjet procedural i nevojshëm për të vërtetuar ekzistencën e një fakti relativ”. Po kështu, në K.Pr.Penale franceze³⁶¹ nuk ka një përkufizim të provës, por kuptimi i saj del nga formulimi i dispozitave mbi parimet e procesit gjyqësor penal, ndërkohë që teoria e së drejtës procedurale penale trajton parimet e të drejtës mbi provat nga palët dhe atë të vlerësimit të lirë të tyre.³⁶²

Kodi i Procedurës Penale i yni ka një përkufizim të qartë mbi provat në nenin 149 i K.Pr.Penale ku shprehet se ato duhet “...të merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e përcaktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhurave prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, shkallën e përgjegjësisë së tij”. Ky është kriter formal i provës, rrjedhojë e kriterit të përgjithshëm të së drejtës, e të drejtës penale në veçanti. Për të pasur cilësinë e provës, njoftimet mbi faktin, burimet e njohjes, të dhënat duhet të merren në njërin prej burimeve të parashikuara në K.Pr.P dhe në përputhje me rregullat e caktuara po në këtë Kod sipas parimit parimi i legalitetit të provës ose siç njihet ndryshe “*jura novit curia*”.³⁶³ Gjithashtu, provat duhet të shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e saj, fajësinë ose pafajësinë dhe shkallën e përgjegjësisë. Kjo lidhet me kuptimin e provës si njoftim ose e dhënë mbi faktin dhe rrethanat që lidhen me veprën penale. Në rast se prova nuk sjell vërtetimin e faktit dhe për më tepër të një fakti, që lidhet me veprën penale, ajo nuk mund të ketë vlerën e provës.³⁶⁴

Klasifikimi i provave është një çështje që ka nevojë të lëvrohet në këtë pjesë të punimit. Kriteri i klasifikimit qëndron në raportin e provës ndaj faktit. Në bazë të këtij kriteri, provat ndahen në direkte dhe indirekte. Provë direkte ose e drejtpërdrejtë është ajo e cila provon ekzistencën ose

³⁶⁰ Codice de Procedura Penale, Edizione Simone 2005

³⁶¹ Code de Procedure Penale, con loi du 15 juin 2000, 44 edition, edition 2016, Dalloz, redigee avec le concours de Jean Pradel, Professeur a la Faculte de droit et de sciences sociales de Poitiers, Francis Casorla.

³⁶² Code de Procedure Penale, 44 edition, 2004, Procedurë Penale, Corinne Renault –Brahinsky, 6 edition

³⁶³ Coredro F. Procedura Penale, VIII ed, Giufree, Milano, 2006. fq

³⁶⁴ Sandër SIMONI, Leksione të së drejtës procedurale penale, Provat dhe vlerësimi i tyre, Shkolla e Magjistraturës

mosekzistencën e faktit në mënyrë direkte. Si të tilla, janë thëniet e dëshmitarit që ka qenë në vendngjarje, deklarinimet e të pandehurit etj. *Provë indirekte* ose e tërthortë janë rrethana fakti të vërtetuara jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ato flasin për ekzistencën e një fakti që vërtetohet në bazë të vërtetimit të disa fakteve të tjera. Sikurse është trajtuar më lart, provat indirekte quhen *indicie* (*indicie* – nga latinishtja “*inde*” dhe “*direre*” – *pohimi, ekzistenca e një fakti të panjohur, që rrjedh nga një fakt i njohur*).³⁶⁵

Në ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në nenin 7 të ndryshuar³⁶⁶ është përdorur termi “fakt penal” në vend të shprehjes “Vepër penale” që ekzistonte më përpara në rastin sanksionimit të parimit të *ne bis in idem*, ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtin fakt³⁶⁷. Formulimi i dispozitës së re tashmë është : “*Askush nuk mund të gjykohej rishtas për të të njëjtin fakt penal, për të cilin është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente*”³⁶⁸.

Ligji procedural shqiptar nuk flet për prova të drejtpërdrejta ose të tërthorta, por flet vetëm për terma *provë, indicie*.³⁶⁹ Provat e tërthorta ose *indiciet* përbëjnë material provues pasi vërtetohet se kanë lidhje me ngjarjen që është objekt hetimi, shpeshherë ato përbëjnë prova të vetme të procesit gjyqësor dhe kanë karakter të kushtëzuar. Neni 152 K.Pr.Penale parashikon se: “*Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveç se kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën*”. Pra, njësimi i vlerës provuese të provës direkte me atë indirekte do të mund të bëhet vetëm nëse ato janë pa të meta dhe nëse nuk ka dyshim për përputhje mes tyre. Nga zbërthimi i përmbajtjes së nenit të mësipërm kuptohet se për të pasur indiciet vlerë provuese kërkohet pluraliteti i tyre, të qënurit të rëndësishme, të sakta e të përputhshme mes tyre. Provat direkte karakterizohen nga fakti se japin argumentin drejtpërdrejt, por dhe provat indirekte kanë një përparësi që është objektiviteti i tyre si në rastin e atyre materiale (*sendet në gjurmët e veprës penale*).

³⁶⁵Termi “*indicie*” është përdorur në nenin 152 të K.Pr.Penale .

³⁶⁶ Ligji nr. 35/2017 datë 30.03.2017 “Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale të RSH”

³⁶⁷ Titull ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017. Titulli i mëparshëm: “Ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtin vepër”.

³⁶⁸ Nen ndryshuar me ligjin 35/2017, datë 30.03.2017, neni 4. Teksti i mëparshëm ishte: “Askush nuk mund të gjykohej rishtas për të njëjtin vepër penale, për të cilën është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente”.

³⁶⁹ Nenet 149, 152 të Kodit të Procedurës Penale.

Në procedurën penale shqiptare zbatohet teoria e vlerësimit të lirë të provave. Ky parim siç do të shpjegohet më poshtë, do të thotë se *asnjë provë s' do të ketë vlerë të paracaktuar, prandaj duhet shqyrtuar me kujdes*. Për ta kuptuar nëse një provë është direkte apo indirekte duhet të shihet se çfarë lidhje ka kjo provë me faktin kryesor. Nisur nga kjo mund të ndodhë që të njëjtat prova mund të jenë direkte në një çështje, dhe në një tjetër të jenë indirekte. Kështu për shembull, thëniet e një dëshmitari se ka dëgjuar të pandehurin të kanosë të dëmtuarin, është provë direkte në rast se kemi kanosje, por në qoftë se do kishim si pasojë vrasjen atëherë kjo do të ishte provë indirekte.³⁷⁰

Prova indirekte është një shkallë besueshmërie dhe bazë për dyshim dhe nëse merret si e vetme ajo nuk ka vlerë prove, nëse ekzistojnë disa të tilla që të çojnë në një konkluzion logjik për saktësinë e faktit që është objekt pohimi ato kanë vlerë pohuese, ka disa prova si dëshmia, akti i ekspertimit, provat materiale, të cilat janë prova herë direkte dhe herë indirekte.

Provat e plota dhe jo të plota. Ky klasifikim varet nga roli që ka secila prove mbi të vërtetën ose të pavërtetën e faktit. Prova quhet e plotë kur provon tërësisht faktin kurse provë jo e plotë e vërteton jo tërësisht faktin.

Prova origjinale dhe të prejardhura. Kriteri i kësaj ndarje është burimi i të dhënave me të cilat vërtetohet fakti. Është provë origjinale dëshmia e dëshmitarit okular, kur atë që dëshmon ai e ka perceptuar me shqisat e veta, ndërsa prova e prejardhur konsiderohet ajo provë e marrë tërthorazi dhe jo nga një burim i drejtpërdrejtë siç është dëshmitari indirekt, një dokument³⁷¹ etj.

Ndarje tjetër është ajo mes provave materiale dhe personale. Klasifikohen në natyrën e burimit të provës. Prova personale janë njohuri të drejtpërdrejta ose të tërthorta të individit, ndërsa materiale janë sendet etj. Zakonisht si prova paraqiten thëniet e dëshmitarit, aktet e ekspertimit, shkresat, provat materiale, deklaratimet e të pandehurit, ballafaqimet, njohjet, eksperimenti. Ligji procedural penal nuk përjashton lloje të tjera provash, mjafton që ato të plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 149 të K.Pr.Penale. Palët mund të paraqesin prova të reja të njohura ndryshme si “*beneficium novorum*” nga ato të kërkuara fillimisht apo të njohura nga ligji. Por kur kërkohet një provë që nuk

³⁷⁰ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda. Procedura Penale, komentar, botim 2003

³⁷¹ Michele- Laure Rassat Manuel de procedure penale, , 1 edition 2003, plotëso shtëpinë botuese.

rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë atë në se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetin e personit.³⁷²

Marrja dhe çmuarja e provave. Vlera si provë merret në shqyrtimin gjyqësor, atëherë kur ajo që ofrohet si e tillë nga palët shqyrtohet, verifikohet dhe në fund pranohet si e tillë. Në gjykim, provat merren me kërkesën e palëve, që në fillim të procesit gjyqësor.³⁷³ Gjykata vlerëson kërkesat, duke u shprehur për pranimin e marrjes së tyre e duke përjashtuar provat që janë të ndaluara me ligj e ato që janë të panevojshme për procesin e të provuarit. Disponimet për marrjen e provës mund të revokohen në fazat e mëtejshme të shqyrtimit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në nenin 356 të KPrP. Provat që janë mbledhura nga palët në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren, kjo në përputhje me përmbushjen e parimit të respektimit të normave procedurale (neni 2 i KPrP). Papërdorshmëria ngrihet mbi bazën e kërkesave të palëve, por dhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procesit. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre.³⁷⁴ Ky është momenti i vlerësimit të provave një nga një, në mënyrë analitike, në raport me njëra-tjetrën. Çmuarja e vlerësimi, bëhet mbi bazën e asaj çka rezulton gjatë marrjes e shqyrtimit të tyre gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. Procesi i çmuarjes e vlerësimit të provave është një proces perceptimi e mbrujtjeje e mendimit profesional të gjyqtarit mbi gjithçka që rezulton nga procesi.

Vlerësimi i provave sipas sistemit procedural shqiptar bazohet në teorinë e vlerësimin të lirë të tyre. Sipas parimeve të njohura në nenin 152 të KPrP. Parimet bazë, mbi të cilat zhvillohet ky proces janë se, *së pari*, çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar; *së dyti*, gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Këto dy parime përbëjnë të ashtuquajturin vlerësim të lirë të provave që do të thotë se procesi i çmuarjes së provave i trajton provat në mënyrë të barabartë duke mos i dhënë asnjërës vlerë të paracaktuar. Gjithashtu, ky proces i çmuarjes kryhet në bazë të bindjes së brendshme të gjyqtarit pasi ka shqyrtuar provat në tërësi. Ndërsa ligji procedural ka dhënë dhe përkufizime të vlerës së një të të dhënë të caktuar si ai për indiciet (neni 152 i KPrP). Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveçse

³⁷² Paragrafi 2 i nenit 149, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 datë 30.03.2017 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë"

³⁷³ Neni 152 pag. 1, i Kodit të Procedurës Penale.

³⁷⁴ Neni 152, pag. 1, i Kodit të Procedurës Penale.

kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën³⁷⁵. Kjo do të thotë se indiciet që të mund të vlejnjë për të vërtetuar ekzistencën e një fakti duhet të plotësojnë tre kushte:

1. të jenë të rëndësishme, që do të thotë të jenë të vlefshme në ofrimin e një të dhëne faktike, të japin një fakt që ka rëndësi për objektin e të provuarit.
2. të jenë të sakta, që do të thotë të mos jenë evazive e të tilla, që nuk ofrojnë diçka që duket e qartë.
3. në përputhje me njëra tjetrën që do të thotë që të merren parasysh duhet që indiciet të jenë jo në kundërshtim me njëra tjetrën.

Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtin vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim të lidhur, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.³⁷⁶ Edhe ky përcaktim është në përputhje me parimin se provat nuk kanë një vlerë të paracaktuar, por vlerësohen në raport e unitet me njëra tjetrën. Sigurisht, që ky është momenti më i rëndësishëm në procesin penal, momenti tek i cili varet së tepërmi gjetja e të vërtetës dhe dhënia e drejtësisë.³⁷⁷ Kodi i procedurës penale³⁷⁸ ka parashikuar llojet e provave kryesore që shërbejnë për vërtetimin e fakteve në procesin e të provuarit në procedimin penal duke renditur si të tilla: *dëshminë, pyetjen e të pandehurit, ballafaqimin, njohjen, eksperimentin, ekspertimin* të cilat janë të njëjtat, që mund të përdoren për procedimin pasuror.

4.6 Objekti i të provuarit – *thema probandum*

Në rastin e procesit të të provuarit është e rëndësishme të dallohen në dy elementet kryesorë: së pari, Objektin e të provuarit - *Thema probandi*³⁷⁹; së dyti, provat, mbi të cilat bazohet procedura e parandalimit, llojet dhe vlerësimi i tyre. Objekti i të provuarit janë faktet juridike, që qëndrojnë në themel të pretendime të palëve apo personave të tjerë në gjykim parandalues (*facta probatur, iura deducuntur*). Me objekt të të provuarit kuptojmë tërësinë e fakteve, konstatimi i të cilëve është i

³⁷⁵ Neni 152 pag. 2, i Kodit të Procedurës Penale.

³⁷⁶ Neni 152 pag. III i KPrP.

³⁷⁷ Paolo Ferrua, Fabio M. Grifantini, Giulio Illuminati, Renzo Orlandi, La prova nel dibattimento penale, G. Giappicheli editore Torino, Quarta Edizione, 2007 quarta edizione, i editore, Torino. Faqe 33

³⁷⁸ Provat, Titulli IV, Kreu I, II, III, Kodi i Procedurës Penale, Ligji nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH” i ndryshuar.

³⁷⁹ *Thema probandum*- nga latinishtja objekti i të provuarit, tema e të provuarit.

nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Dispozitat penale dhe ato procedurale që aplikohen nuk janë objekt provimi sepse për to ekziston parimi latin “*iuria novit curia*”. Objekt i të provuarit janë faktet juridike të rëndësishme, të cilat varen nga një vendim gjyqësor, i bazuar te indiciet. Dispozitat nuk përcaktojnë se cilat janë fazat e rëndësishme, në kuptimin e ngushtë, që duhen vërtetuar gjatë këtij procesi. Sigurisht, se me natyrën e procesit gjyqësor që kemi ne, kjo varet nga palët në proces, por gjithsesi përveç tyre, është gjyqtari që ka kompetence që në mënyrë “*ex officio*”, të përzgjedhë vetë faktet që duhen dhe provat që duhen marrë, pra përcaktimi i objektit të të provuarit nuk është një veprim formal dhe mekanik. Aq më tepër, me procedimin pasuror, ku kemi dhe rregullat e përcaktuara me ligj të veçantë për kompetenca të gjykatës në marrjen e provave ose detyrimin për thirrjen e personave të tretë, kur del se pasuritë u përkasin atyre.

Në procedimin parandalues sipas ligjit shqiptar *objekt i të provuarit* janë:

- faktet për pjesëmarrjen në veprimtari kriminale në fushën e zbatimit të ligjit ³⁸⁰, pra pjesëmarrja në kriminalitet të organizuar apo veprat penale të tjera në fushën e zbatimit të ligjit;
- faktet në lidhje me regjistrimin e rremë të pasurisë në emër të të afërmeve ligji dhe prezumimet se është kryer një veprim/transaksion i tillë³⁸¹;
- faktet se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen pjesërisht ose plotësisht³⁸² dhe vërtetimi i saktë i titullit të pronësisë për shkak të regjistrimit të pasurisë;
- fakte, që pretendohen për vërtetimin e prezumimit të regjistrimit të rremë; ³⁸³
- fakte mbi paligjshmërinë e origjinës së pasurisë e disproporcionalitetin në të ardhura e shpenzime jetese; ³⁸⁴

³⁸⁰ Paragrafi 1, neni 3 “Fusha e zbatimit”

³⁸¹ Shkronja a) paragrafi 2 neni 2 “Fusha e zbatimit” “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të përmendura në pikën 1, të këtij neni në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga personat e afërm, për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta.

³⁸² Shkronja b) paragrafi 2 I neni 3 “Fusha e zbatimit” Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

³⁸³ Paragrafi 3 i neni 2 të Ligjit “Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurisë, në emër të personave të afërm zbatohet kur ka të dhëna të dobishme të siguruar në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e pasurisë”

³⁸⁴ Pika 4 i neni 2

- fakte për përfshirjen në veprimtari kriminale në rastin e veprimit të ligjit në kohë për pasuritë e vënë përpara hyrjes në fuqi të tij.³⁸⁵

Ligji nuk parashikon kritere të tjera për përcaktimin e *objektit të të provuarit*, prandaj dhe referenca bëhet në teorinë e së drejtës së procedurës penale në lidhje me objektin e provës dhe të të provuarit. Neni 150 i K.Pr.Penale parashikon përkufizimin e objektit të provës, sipas të cilit: “*Janë objekt prove faktet, që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale*”. Me vendimin gjyqësor, gjykata vendos nëse është kryer vepra penale, në cilat rrethana është kryer, nga kush është kryer, cilësimin juridik, provat mbi të cilat bazohet ky cilësim referuar rrethanave të faktit që dalin të provuara, ato që dalin të paprovuara, dënimin, disponimin mbi provat materiale dhe shpenzimet procedurale.³⁸⁶ Pra, objekti i të provuarit janë të gjitha elementët që vendosen në themel të vendimit gjyqësor. Përcaktimi ligjor ose i përafërt i objektit të të provuarit është i pamundur, sepse çdo vepër penale ka karakteristikat e veta.

Rrethanat kryesore, që përbëjnë objektin e të provuarit janë: koha, vendi, mënyra e kryerjes së veprës penale, fajësia e të pandehurit në kryerjen e kësaj vepre, qëllimi, motivet, pasojat, dëmi, shkaqet dhe kushtet e kryerjes së veprës penale, rrethanat lehtësuese ose rënduese. Faktet relative që dalin nga e drejta penale materiale, në rend të parë përfshijnë të gjitha cilësitë, në të cilat manifestohen elementet e përgjithshme (*objektive dhe subjektive*) të veprës penale, të cilat janë të njëjtat për të gjitha veprat penale, por dhe për veprën penale e cila është objekt gjykimi. Këto fakte mund të jenë fakte të jashtme dhe fakte të brendshme (*psikologjike*). Disa fakte duhet të vërtetohen në çdo vepër penale si: veprimi i inkriminuar, koha, vendi i veprimit, mjeti, pasojat etj., fakte të cilat çmohen si fakte të jashtme. Verifikimi i fakteve të jashtme bëhet me analizë dhe shqyrtim të drejtpërdrejtë. Objekti i të provuarit sikurse do të trajtohet gjatë shqyrtimit në tërësi të natyrës së provave, llojeve të tyre dhe mënyrës së marrjes e të vlerësimit, nuk është një koncept statik. Sistemi procedural shqiptar është ndërtuar si i tillë, që thelbi i të provuarit është procesi gjyqësor. Është pikërisht zhvillimi i tij, i cili përcakton kufijtë dhe hapësirën e shtrirjes së objektit të të provuarit.³⁸⁷

³⁸⁵ Paragrafi 6 e nenit 2 “Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale në kohën e vënies së pasurisë.

³⁸⁶ Neni 380 i KPrP.

³⁸⁷ Sandër Simoni, Leksione në Shkollën e Magjistraturës, 2005 – 2010, “Provat dhe mjetet e provës”

Regjistrimi i procedimit penal dhe aktet e paraqitura nga Prokuroria në kërkesën për marrjen e masës parandaluese të sekuestrimit të pasurive, duhet të mos dështojnë në formimin e indicieve, aq më pak, të atyre “*të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën*”, në kuptim të barrës së provës. Nocioni i provës, i cili jepet neni 149 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe nocioni i indicieve, si mjet procedural provueshmërie, për të treguar ekzistencën e një fakti vetëm kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën. Dallimi midis provës dhe indicies qëndron në atë se: nëse e para vërtetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të faktit.

Lidhur me verifikimin e pranisë së elementit të dyshimeve, *fumus boni iuris*, d.m.th., të pranisë së probabilitetit të kryerjes së veprës penale, duhet bërë verifikimi i të gjitha rrethanave të faktit.

Verifikimi i faktit penal të atribuar ndaj personit subjekt i procedimit pasuror, në standardin provues të “*dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në indicie*”, si një nga kushtet e domosdoshme për aplikimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros parandaluese, sipas ligjit të posaçëm, duhet të karakterizohet, përta i përket aspektit të provueshmërisë, nivelit të përmbajtjes së “*indicieve*”, mbështetëse të dyshimit të arsyeshëm, prej tipareve të rëndësisë, saktësisë, përputhshmërisë, përta kohë që ky nivel vlerësimi i fuqisë provuese të indicieve, sipas paragrafit të dytë të nenit 152 të KPrP, gjen zbatim në momentin procedural të vlerësimit të tyre në gjykim, në funksion të verifikimit të ekzistencës së faktit penal (*sipas akuzës së paraqitur prej prokurorit*) mbi bazën e provave, sipas standardit provues universal–*përtej cdo dyshimi të arsyeshëm*–dhe vetëm në këtë rast, për të arritur nivelin e provës, tejkaluere të “*dyshimit të arsyeshëm*” lidhur me objektin e gjyimit–fajësinë, verifikimin e akuzës.

Karakter i ngushtësisht indiciar i zbatimit prej legjislatorit të procedimit pasuror parandalues, fazës së aplikimit të masës së sekuestros, konsiderohet edhe përcaktimi i paragrafit 6 të nenit 3 të ligjit tonë për paradalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, që parashikon kushtin, për “*aplikimin e këtij ligji edhe mbi pasuritë e (personave) të vëna para hyrjes në fuqi të tij*”, e identifikuar, në “*indicie të rëndësishme*” për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale në kohën e vënies së pasurisë.

Përdorimi i këtij termi, prej legjislatorit, ndërkohë që, në paragrafin e parë të nenit 3 të ligjit, ka përdorur termin “*indicie*”, nënkupton, detyrimin e ligjzbatuesit, për të shmangur çdo lloj interpretimi zgjerues, lidhur me karakterin ngushtësisht indiciar të këtij procedimi. Kjo duke e konceptuar dhe zhvilluar mbi bazën e një standardi provues, të verifikimit të kushteve për caktimin e masës së sekuestros parandaluese, në rastet e aplikimit të saj “*mbi pasuritë e personave mbi të cilët rëndon një dyshim i arsyeshëm për pjesëmarrje në veprimtari kriminale*”³⁸⁸, të identifikuar në “*indicie*” të mjaftueshme. Ndërsa, në rastet e aplikimit të saj “*mbi pasuritë e personave, mbi të cilët rëndon një dyshim i arsyeshëm për pjesëmarrje në veprimtari kriminale*”, të vëna këto pasuri përpara hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm, të identifikuar në “*indicie të rëndësishme*”, është kërkuar një standard tjetër provueshmërie më i madh se në rastin e parë, por jo si ai standardi provues në gjykimin e themelit të çështjes mbi bazën e provave, sikurse konsiderohet pluraliteti i “*indicieve*,” të verifikuara në kushtet e “*rëndësisë*”, “*saktësisë*” dhe të “*përputhshmërisë*”.

Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1 datë 25.01.2007³⁸⁹ arriti të unifikojë praktikën gjyqsore për çështje të zbatimit të masave parandaluese duke interpretuar vlerën provuese që ka provat që marrën prej një procedimi penal apo vendimi për masë sigurimi personale, duke mbajtur qëndrimin se : “*Për efekte të gjykimit parandalues, nëse prokurori arrin të vërtetojë se ndaj një personi ka një procedim penal, masa sigurimi, apo një vendim dënimi për njërin nga veprat penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, atëherë kjo përbën provë me vlerë të plotë për të vërtetuar para gjykatës “dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova” për kryerjen e këtyre veprave penale, pra subjekti i procedimit penal ka edhe cilësitë e “personit të dyshuar” (nenet 1, 2, 3 të ligjit)*

Në procedimin parandalues, objekt i të provuarit janë faktet mbi dyshimin e arsyeshëm për qenien “*person i dyshuar*”, mundësia e zotërimit të pasurive prej tij dhe mos justifikimi i prejardhjes së ligjshme të këtyre pasurive, në raport me veprimtarinë, sjelljen, të ardhurat dhe mënyrën e jetesës, me kohën dhe llojin e veprës, që i atribuohet, apo vërtetohet se ka kryer personi i dyshuar. Në

³⁸⁸ Pasuritë, që janë vënë pas hyrjes në fuqi të ligjit.

³⁸⁹ Me kërkesë Prokuroria për Krime të Rënda kundër shtetasit Xh.T. me objekt “*Sekuestrimi i pasurive*”.www.gjykataelarte.gov.al

objektin e hetimit dhe gjykimit parandalues është vërtetimi i “*dyslimit të arsyeshëm*” për pjesëmarrje, kryerje të veprave penale, të përcaktuara në nenin 3 të ligjit, por jo edhe vërtetimi i lidhjes shkakësore të veprimeve të tij me pasojat e ardhura për efekt të përgjegjësisë penale të tij. Gjykata, kur shqyrton një kërkesë për sekuestrim ose konfiskim, për qëllime të vendosjes së masës parandaluese pasurore, duhet të shqyrtojë dhe vlerësojë në mënyrë autonome të gjitha faktet, rrethanat, indiciet etj., për të nxjerrë përfundimet e saj mbi elementët, që mbështesin në ligj e në fakt vendosjen e masës parandaluese pasurore. Nga ana tjetër, në kuptim të ligjit shqiptar, në ndryshim nga procedimi penal, prezumohet se pasuritë e personit të dyshuar kanë një lidhje me pjesëmarrjen, kryerjen e veprave penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji.

Për zbatimin e drejtë të ligjit, mbështetur në hetimet e kryera, edhe prokurori ka detyrime për të parashtruar kërtime të motivuara dhe prova mbështetëse përpara gjykatës, lidhur me identifikimin e pasurive të personit të dyshuar e të personave të tjerë, të tregojë nga ana e tij se ka bazë për dyshime të arsyeshme dhe në këtë mënyrë të dhëna, prova të mjaftueshme për efekte të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, gjë që motivon ekzistencën e prezumimit, i cili buron nga ligji dhe si rezultat, kërkesën për zbatimin e masave pasurore të sekuestrimit, pezullimit të përkohshëm dhe konfiskimit, duke i kërkuar gjykatës t’i kalojë në këtë mënyrë edhe barrën e provës personave të dyshuar dhe personave të tjerë. Gjykata duhet të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të mbështetur në prova dhe në ligj, në përputhje me objektin e të provuarit—*thema probandum*.

Në një Vendim të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda³⁹⁰ arsyetohet se: “...objekt i të provuarit është barrë për të paditurin K.N. marrëveshja e “*dhurimit*” të pretenduar, bërë nga nipi i tij N.N dhe e shumës me të cilën i padituri e ka blerë mjetin”.

4.7 Hetimi pasuror dhe kërkesa për sekuestrim, të dhënat që shërbejnë si bazë për fillimin e tij dhe provat që mund të përdoren në të provuarit e kërkesës për konfiskim.

³⁹⁰Vendimi nr. 14 datë 06.02.2017 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, www.gjkata.gov.al

Hetimi pasuror ka karakteristikat e veta se është një hetim mbi pronën e pasurinë. Parimi i autonomisë, tashmë, është marrë parasysh si një parametër, që rregullon raportin ndërmjet procedurës parandaluese dhe procedurës penale. Por procedimet pasurore, kryesisht, mbështeten në aktet e procedimit penal kur ka të tillë, e sigurisht këto të fundit janë baza e fillimit të regjistrimit të procedimit pasuror. Megjithatë, mund të thuhet se ka *disa rregullime në ligjin përkatës të mundësisë që ka prokuroria për të mbledhur të dhëna, akte, për të bërë verifikime të nevojshme, me qëllim mbledhjen e të dhënave, indicieve apo provave ku ajo mbështet kërkesën për sekuestrim e konfiskim*. Rregullat e ligjit prevalojnë mbi ato të procedurës penale, që është procedura referuese, që do të thotë se përsa gjejmë parashikime në ligj iu referohemi atyre, kur nuk ka iu referohemi rregullave penale të KPrP.

Duke analizuar parashikimet e veçanta të ligjit dhe ato referuese në Kodin e Procedurës Penale për provat dhe vlerësimin e tyre, mund të krijojmë një *indeks* të mënyrës së kryerjes së verifikimeve, hetimeve e marrjes së provave, që mund të përdoren në kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë.

- fashikulli i procedimit penal nëse kemi një procedim penal të filluar para ose pas regjistrimit të procedimit pasuror ose vetëm akte të veçanta të procedimit penal;
- vendimi gjyqësor i dënimit, nëse kemi një proces gjyqësor ndaj subjektit, i cili ka përfunduar me një vendim fajësie apo pushimi të çështjes në ngarkim të subjektit;
- procesverbalet e sekuestrimit, kontrollit, këqyrjes, arrestimit në flagrancë.
- procesverbalet e sekuestrimit e të marrjes së dokumenteve të pronësisë, këqyrjes së regjistrave të pasurisë, titujve të pronësisë, akteve të gjendjes civile;
- aktet e ekspertimit kontabël, financiar e të vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
- provat materiale;
- dokumentet dhe regjistrimet teknike;
- procesverbale ose thënie të dëshmitarëve.

Veprimet hetimore të prokurorisë, të kryera vetë ose nëpërmjet policisë gjyqsore bëhen në lidhje me:

- Verifikimet e pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme (merren të dhëna në regjistrat e pasurive apo të titujve të pronësisë p.sh. verifikimet e pronave bëhen në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Agjensisë së Kadastrës.³⁹¹
- Prokuroria duhet të kryejë hetime mbi mjetet financiare, ku futen të gjitha instrumentet me të cilat një person operon në sistemin finaciar si: *transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* etj. Këto verifikime dhe informacione merren nga bankat e institucionet e tjera financiare, si të tilla ata lënë gjithmonë gjurmë.
- Hetime mbi veprimtarinë ekonomike, tregtare dhe profesionale dhe burimi i ardhurave të tyre, ku përfshihen verifikimet mbi llojin e aktivitetit tregtar ose profesional, i regjistruar ose jo në Qendër Kombëtare të Regjistrat Tregtar,³⁹² në emër të subjektit, në ortakëri me të tjerë apo aksioner, kapitali themeltar, burimi, pagesat e tatimeve, bilancet, shpërndarjen e të ardhurave, shpenzimet, llogaritë rrjedhëse e transfertat, investimet.
- Verifikime të veçanta bëhen për subjektet që janë zotërues të lejeve për transport, shërbime, shfrytëzim mineral, pyjor, peshkim, e në veçanti atyre të ndërtimit, autorizimeve, koncensioneve, licensave e çdo të drejtë tjetër për të ushtruar aktivitet ekonomik.
- Verifikohen kontributet nëse janë përfituar, financime, kreditime të çdo lloji, të dhëna të përfituara nga shteti, entitete a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare.
- Verifikohet e hetohet nëse këto pasuri, veprimtari, të drejta pasurore janë të ligjshme apo jo.
- U dërgohen shkresa zyra të administratës, bashkive, gjendjes civile, të regjistrimit të pasurive e të kadastrës, të tatimeveve, licensave, të shërbimeve periodike e të furnizimit me ujë, energji, sigurimeve shoqërore, bankave, shoqërive kursim kredi e atyre të investimeve duke u kërkuar kopje të dokumentacionit të veprimeve të subjektit apo të afërmëve të tij.
- Bëhen hetime për mënyrën e jetesës së personit, shpenzimet e përditshme etj.

³⁹¹ Parashikimi i nenit 6 të ligjit për kryrjen e veprimeve hetimore sipas objektit të hetimeve.

³⁹² Paragrafi 2 i nenit 6 “Objekti i hetimeve”.

- Kur konstatohet se duhen kryer hetime apo bërë verifikime për të dhëna jashtë vendit atëherë dërgohet letërporosi për jashtë vendit sipas objektit të hetimit apo verifikimit të nevojshëm.³⁹³

Prokuroria dhe policia gjyqësore të dhënat duhet t'i kërkojë pranë zyrave e institucione përkatëse prandaj dhe nevojiten njohuri specifike mbi titujt e pronësisë:

1. Të dhënat për pasuritë e paluajtshme kërkojnë pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ose Agjensisë Shtetërore të Kadastrës ndërsa për pasuritë e luajtshme si automejtet pranë zyrave të Drejtorive të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
2. Për llogaritë bankare, trasferrat, pagesat, hetimet shtrihen në banka.
3. Për pasuritë e shoqërive tregtare në regjistrin e shoqërive tregtare apo pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKB).
4. Për kuotat dhe aksionet verifikohen dhe hetohen publikimet në regjistrin e shoqërisë tregtare dhe shënimet në regjistrat kontabël të shoqërive.³⁹⁴

Si çdo person tjetër, titullar i së drejtave reale e atyre të pronësisë subjekti mund të marrë vetë të dhëna, akte, prova shkresore e ti paraqesë në gjykatë. Ata kërkojnë dhe merren ;

- *Titujt e pronësisë së pasurive të luajtshme e të paluajtshme* merren në regjistrat e pasurive apo të titujve të pronësisë p.sh. Agjensia e Kadastrës³⁹⁵ sipas legjislacionit për tokën, kthimin e pronës për përfitimin e titujve të pasurisë së paluajtshme sipas legjislacionit për tokën bujqësore,³⁹⁶ pyjet, kullotat dhe kthimin e pronës truall.³⁹⁷ E në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Rrugor. Për automjehet.

³⁹³Konventa e Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale “ dhe protokolli i saj shtesë, i miratuar me ligjin nr. 9498 datë 10.06.1999, i ndryshuar me ligjin nr. 9539 datë 22.05.2006, si dhe Protokolli i dytë shtesë i Konventës i ratifikuar me ligjin nr. 8499 datë 10.06.1999.

³⁹⁴Në nenin 14 të ligjit përcaktohet pikërisht që ekzekutimi i masës së sekuestros duhet të bëhet pranë këtyre institucioneve dhe në këtë mënyrë.

³⁹⁵Parashikimi i nenit 6 të ligjit për kryerjen e veprimeve hetimore sipas objektit të hetimeve.

³⁹⁶ Ligjin nr. 20/2020 për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë,

³⁹⁷Ligji Nr. 7501, datë 19.7.1991“Për tokën” (Fletore zyrtare 5, viti 1991, faqe 246) Ndryshuar me: Ligj, Nr.7715, datë 02.06.1993 Nr 9 Faqe 141 viti 1993 Ligj, Nr.7763, datë 25.10.1993 Nr 12 Faqe 796 viti 1993 Ligj, Nr.7855, datë 29.07.1994 Nr 10 Faqe 484 viti 1994 Ligj, Nr.8752, datë 26.03.2001 Nr 14 Faqe 400 viti 2001 Ligj, Nr.9244, datë 17.06.2004 Nr 49 Faqe 3375 viti 2004 dhe ligji Nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin e kompensimit e pronës “ (Ndryshuar me ligjin nr.9388, datë 4.5.2005, Ndryshuar me ligjin nr.47/2015 datë 7.5.2015)

- Të dhëna e akte mbi *transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* etj. mund të merren nga bankat e institucionet e tjera financiare, si të tilla ata lënë gjithmonë gjurmë
- Të dhënat dhe provat për *pagesën e tatimeve* sipas legjislacionit fiskal, ku përfshihen të dhëna e akte për zbatimin e procedurave tatimore e pagesën e tatimeve sipas ligjit tatimor³⁹⁸
- *pagesën e tatimeve mbi të ardhurat si biznes* apo ato që rrjedhin nga vlerësimi i pasurisë së paluajtshme apo transaksioneve mbi të³⁹⁹
- *pagesën e tatimeve mbi vlerën e shtuar* sipas legjislacionit mbi vlerën e shtuar⁴⁰⁰
- *pagesën e taksave kombëtare* sipas legjislacionit për taksat kombëtare⁴⁰¹
- *pagesën e taksave lokale* sipas ligjit për taksat lokale⁴⁰²
- *pagesat e detyrimeve doganore* sipas legjislacionit doganor⁴⁰³
- përmbushjen e detyrimit për deklarimin e pasurisë për subjektet si funksionarë publikë, gjyqtarë e prokurorë, që detyrohen të bëjnë *deklarim periodik vjetor për pasurinë dhe konfliktin e interesit e ligjit për deklarimin e pasurisë*.⁴⁰⁴

Sic vërehet qartë verifikimi ose hetimi i të drejtave reale është një rregullim më vete e veprimeve që do të kryejë Prokuroria dhe policia gjyqësore, për të cilën ligji ka përcaktim të qartë e të veçantë e në këtë rast të dhëna kërkohen në mënyrë të drejtpërdrejtë duke zbatuar ligjin. Këto verifikime e veprime hetimore mund të kryhen deri sa është pa përfunduar konfiskimi i pasurisë.⁴⁰⁵ Marrja dijeni nga prokuroria apo policia gjyqësore për pasuritë, që duhen verifikuar bëhet me iniciativë proaktive ose njoftim nga të tretët. Zakonisht, procedimi pasuror fillohet për çdo procedim penal në mënyrë të veçantë për veprën penale, që sjellin të ardhura kriminale si trafiket, krimi i

³⁹⁸ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues

³⁹⁹ Sipas ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligji nr. 9723 datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar dhe ligji nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”

⁴⁰⁰ Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”

⁴⁰¹ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar

⁴⁰² Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar

⁴⁰³ Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 32 datë 2.04.2015

⁴⁰⁴ Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

⁴⁰⁵ Paragrafi 3 i nenit 6 të ligjit nr. 10 192.

organizuar, korrupsioni e krimi ekonomik.⁴⁰⁶ Të dhëna mblidhen nga policia gjyqësore dhe se duhen gjetur në to elementët thelbësorë të faktit, mbi të cilat duhet mbështetur hetimi pasuror, i dërgohet informacioni prokurorisë.⁴⁰⁷

Nga interpretimi i neneve 6 dhe 9 të ligjit për parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandalese, del se Prokurorit i janë përcaktuar veprimtaritë hetimore, që ai duhet të kryejë dhe nuk mund të bëjë veprime evazive procedurale penale të tjera. Në zbatimin e ligjit është menduar se mund të përdoren në procedurën e parandalimit të gjitha dokumentet e përfuara, dhe ndër këto janë dokumente të krijuara në procesin penal si: vendime për caktimin e zbatimit e masave të sigurimit, procesverbale për përgjime, për sekuestime dhe kontrolle, deklarata të dëshmitarëve dhe marrje në pyetje, vendime, etj. Në mungesë të një dispozite të shprehur që ta përjashtojë mundësinë e marrjes së këtyre rezultateve, mund të konsiderohet e lejuar. Në këtë përfundim mund të arrihet nga parimi i autonomisë së procedurës penale dhe asaj të parandalimit, që tregon se si mund të ekzistojnë njëkohësisht hetime penale dhe parandalimi pasuror. Një ndalesë e mundshme për përdorim rezultateve të procedimit penal duhet të gjejë një parashikim të qartë, sidomos në një procedurë, si ajo e sekuestimit dhe konfiskimit, që duhet të jetë më “e shpejtë” sepse goditet prona private dhe jo liria personale, princip i pakundërshtueshëm i shprehur nga GJEDNJ dhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë dhe ato të vendeve të tjera. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të ligjit sa më sipër, mund të themi se në procedimin pasuror, gjatë hetimit prokurori mund të marrë:

1. akte prova nga fashikulli i procesimit penal;
2. mund të kryejë veprime hetimore në bazë të rregullave të Kodit të Procedurës Penale për mjetet e kërkimit të provës;
3. mund të kryejë verifikime dhe hetime të nevojshme si ato të parashikuara në ligj e të trajtuara sa më sipër.

Provat materiale, dokumentet: Në procedimin pasuror mund të përdoren si prova për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm për veprimtarinë kriminale të subjektit ose për origjinën e paligjshme të pasurisë si prova materiale ashtu dhe dokumente të tilla si: *procesverbalet e marrjes së provave*,

⁴⁰⁶Neni 8 “Veprimet paraprake”, paragrafi i parë.

⁴⁰⁷Paragrafi 2 i nenit 8 “Veprimet paraprake”

fotografite, filmime, dokumente bankare, të pasurisë, procesverbale të tjera etj. Ligji nuk përcakton llojin e tyre, por u referohemi rregullave të marrjes dhe parimit të vlerësimit në legjislacionin procedural penal. Provat materiale në legjislacionin shqiptar procedural janë të rregulluara në nenet 187 deri 190 i Kodit të Procedurës Penale.

Kur flitet për provat materiale, është e nevojshme që shkurtimisht të trajtohet se cilat janë provat materiale në përgjithësi. Në rastin e kërkimit dhe gjetjes së të vërtetës, theksi vihet te provat materiale, të cilat vlerësohen si mjet efikas provues. Rëndësia e provave materiale, si lloj i posaçëm i provave, ka rëndësi në procedimin pasuror pasi prona, pasuria, e ardhura dhe burimi saj duhet të jetë objekt këqyrjeje e marrjeje. Legjislacioni procedural penal, në shumë vende flet për *“objektet që mund të shërbejnë si provë në procedurën penale”*. Ligji nuk përcakton llojet e objekteve dhe nuk i jep trajtim të posaçëm ndonjë *“objekti që mund të shërbejë si provë në procedurën penale”*. Në teoritë e së drejtës së procedurës penale ka autorë, të cilët duke shkruar për provat materiale i ndajnë ato në *prova materiale në kuptimin e gjerë* dhe në *kuptimin e ngushtë*.⁴⁰⁸ *Prova materiale në kuptimin e gjerë* konsiderohet çdo objekt (*send fizik*) që mund të shërbejë si provë në procedurën penale. Në këtë nocion përfshihen shkresat dhe regjistrimet teknike të ndryshme objektet-sendet fizike si për shembull arma, me të cilën është kryer vepra penale etj. E përbashkëta e këtyre *“provave”* është se janë objekte fizike. Kjo ndarje mbështetet në ndarjen e provave në *prova personale dhe materiale*.⁴⁰⁹

Prova materiale në kuptimin e ngushtë, sipas tyre, konsiderohen objektet që në vetvete përmbajnë shenja grafike, figurative ose artistike, të destinuara ose të përcaktuara për të shprehur ose ruajtur ndonjë provë. Ka një ndarje tjetër në kategorinë e provave materiale që i quan *“prova reale”*, ndërsa dokumentet i konsideron nënloj të provave reale. Disa autorë⁴¹⁰ nuk bëjnë dallim ndërmjet dokumenteve dhe regjistrimeve teknike por ato i trajtojnë së bashku duke u mbështetur në faktin se edhe njëra edhe tjetra kanë një element të përbashkët dhe ky është shënimi paraprak i ndonjë

⁴⁰⁸ Michele- Laure Rassat Manuel de Procedure Penale, Presses universitaires de France, 2002

⁴⁰⁹ Sandër Simoni, Leksione mbi provat, Shkolla e Magjistraturës. 2005 – 2015,

⁴¹⁰ Paolo Ferrua, Fabio M. Grifantini, Giulio Illuminati, Renzo Orlandi, La prova nel dibattimento penale, G. Giappicheli editore Torino, Quarta Edizione, 2007 quarta edizioe, i editore, Torino. Faqe 254

fakti (*me shkrim, me aparat fotografimi, filmim, magnetofon etj.*) që më vonë mund të shërbejë si provë për vërtetimin e fakteve në procedurën penale.

Provë materiale konsiderohet çdo objekt i rëndësishëm për vërtetimin e fakteve të rëndësishme për zgjidhjen e një çështje penale. Këto prova janë të shumta dhe të llojeve të ndryshme. Ato mund të grupohen në: mjetet për kryerjen e veprës penale (*automjetet për kryerjen e kontrabandës, për falsifikimin material etj.*; sendet e prodhuara të veprës penale (*p.sh paraqja ose shkresa e falsifikuar*); sendet e fituara me vepër penale, të cilat mund të jenë objekt i veprës penale (*sendet e vjedhura*) ose sendet e fituara si shpërblim për veprën e kryer (*paratë e marra si korrupsion*); sendet, në të cilat gjenden gjurmët e veprës penale apo gjurmët e autorit dhe viktimës. Në Kodin e Procedurës Penale Shqiptare ⁴¹¹, me nocionin “*provë materiale*” kupton “*sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmët e saj ose janë objekt i veprimeve të të pandehurit, sendet që përbëjnë objektin e përfitimit nga vepra penale, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për largimin e rrethanave të çështjes*”.

Prandaj sipas nenit 208 paragrafi 1 i KPrP të RSH “*Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve*”. Të provuarit me ndihmën e provave materiale, kur kemi të bëjmë me objekte, sipas nevojës, mund të kombinohen me dëshminë e dëshmitarit dhe nëpërmjet procesit të njohjes. Objektet-sendet fizike, që kanë ndonjë lidhje me çështjen penale, lidhje, e cila mund të argumentohet me provat që paraqiten në proces, mund të shërbejnë si burim njoftimi për vërtetimin e fakteve në procedurën penale. Ato e shprehin këtë veti provuese atëherë kur me rastin e paraqitjes së tyre organi procedurës bën këqyrjen e tyre. Objektet fizike, që kanë lidhje me çështjen penale paraqesin veti provuese dhe kur këqyrja e tyre bëhet nëpërmjet procesit të ekspertimit. Në të vërtetë, përsa u përket objekteve dhe fenomeneve, për njohjen e të cilave kërkohet dijeni ose mjeshhtëri e posaçme profesionale, kur rruga për fitimin e njohurisë për vërtetimin e fakteve në procesin penal (*njohurisë që figuron në objektin e caktuar*) realizohet nëpërmjet ekspertimit.⁴¹²

⁴¹¹Neni 187 i Kodit të Procedurës Penale.

⁴¹²Neni 178 i Kodit të Procedurës Penale.

Vlen të theksohet se objekte të tilla, si dhe vetë procesi i ekspertimit konsiderohet mjet provues, ndërsa përmbajtja e këtij mjeti provues, të shprehur nëpërmjet mendimit të ekspertit, konsiderohet provë. Objektet fizike mund të jenë bartës të provave atëherë kur prova është fiksuar në to, si bie fjala, dokumentet në të cilat janë bërë shënime me shkrim, vizatime ose skica, që përmbajnë fakte që vërtetohen në procedurën penale ose incizimet e fituara në regjistrim teknik të fakteve të bëra me ndihmën e instrumenteve optike, akustike ose të kombinuara optiko-akustike. Vetë dokumenti (*p.sh., letra që përmban tekstin e inkriminuar, faturat, shënimet kontabël, bilanci, deklaratën e shënuar etj.*) si dhe regjistrimet teknike (*letra e fotografisë, shiriti, filmi etj.*) konsiderohen mjete të provës, ndërsa përmbajtja e shkresës apo përmbajtja e incizimit është provë, e cila shërben për vërtetimin e fakteve në procedurë penale.⁴¹³

Dokumentet. Procedimi pasuror nënkupton veprime verifikimi e hetime mbi dokumente, shkresa, si publike dhe private, të cilat mund të jenë *akte zyrtare, bilance financiare, fatura, shënime private të veprimeve të biznesit, dokumente bankare etj.*⁴¹⁴ Prandaj për to, iu referohemi kuptimeve në legjislacionin civil e për rregullat e marrjes e vlerësimit, atij procedural penal. Nocioni *dokument* si provë në procedurë penale, kupton shënimet me shkrim që përmbajnë fakte (*të dhëna për faktet*)⁴¹⁵ që vërtetohen në procesin e të provuarit si dhe deklarata dhe përpilime me shkrim, në të cilat figurojnë faktet e tilla, e veç kësaj edhe vizatimet dhe skicat nga të cilat faktet e tilla mund të vërtetohen. Me *dokument* kuptojmë një send të përshtatshëm ose të destinuar për të dëshmuar një fakt përkatës për marrëdhënien juridike. Në kuptimin e ngushtë dokument është çdo send, në të cilin në një formë të shkruar, është vënë deklarata e ndonjë personi për një fakt të rëndësishëm juridik. Me dokument në kuptim të inkriminimit përveç dokumenteve formale të shkruar, që përdoren në komunikimin juridik duhet kuptuar edhe dokumente të tjera, me të cilat mund të dëshmohen fakte të caktuara. Të tilla janë dokumentet, si vetëdeklarimet në kuptimin e “*dokumentit*” si formë e shprehjes së vullnetit dhe kusht për plotësimin e kushteve për të kandiduar në institucionet e rivlerësimit. I referohemi kuptimit të dokumentit në dispozitat ligjore të ndryshme, të cilat nuk bëjnë dallimin në falsitetin e dokumenteve sipas llojit zyrtar dhe privat.

⁴¹³ Sandër Simoni, Leksionet mbi provat, Shkolla e Magjistraturës, 2005-2010.

⁴¹⁴ Në rastin e subjekteve të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar, një dokument i rëndësishëm ku bazohet hetimi pasuror janë deklaratat periodike të pasurisë.

⁴¹⁵ Nenet 191 vijues të KPrP.

Neni 246 i K.Pr.Civile kur parashtron dispozitat që përshkruajnë provat, në Kreun VIII, i referohet termit “*Shkresa*”.⁴¹⁶ Ndërkohë, neni 256 i po këtij Kodi bën përcaktim të aktit zyrtar: “*Aktet zyrtare, që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi, i cili ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve, që janë bërë përpara tyre për faktet, që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar*. Neni 259 i K.Pr.Civile përcakton: “*Shkresa e thjeshtë, e nënshkruar nga personi, që e ka lëshuar, përbën provë të plotë se deklarimet, që përmban, janë të atij që e ka nënshkruar, në rast se personi, kundër të cilit paraqitet shkresa, pranon se është nënshkruar prej tij*.” Neni 262 i K.Pr.civile përcakton: “*Shkresa private përbën provë në favor të përpiluesit vetëm në qoftë se atë e paraqet pala kundërshtare ose në qoftë se bëhet fjalë për librat, që përmenden në nenin 260*”. Neni 270 i K.Pr.Civile përcakton se “*Çdo shkresë mund të goditet për falsitet. Shkresat private mund të goditen për falsitet edhe kur nga krahasimi me të tjerat vërtetohet se janë origjinale*”.

Nga analiza e përmbajtjes së dispozitave të Kodit të Procedurës Civile shihet qartë se “*Dokument*” është çdo shkresë, çdo objekt material, në të cilin është fiksuar me shenja të shkruara mendimi i njeriut, pra në kuptimin e gjerë është çdo paraqitje materiale e shfaqjes së mendimit. Mjeti më i zakonshëm i paraqitjes materiale të shfaqjes së mendimit është shkresa, pra në kuptimin me të ngushtë dokumenti është një akt i shkruar, d.m.th., shkresë. Dokumenti përbën mjet provues pavarësisht nga faktet përse është përpiluar. Dokumentet ose aktet e shkruara kanë disa tipare: a) kanë një përmbajtje të kuptueshme lidhur me një fakt, rrethanë apo ngjarje; b) kanë shenjat e shkrimit nëpërmjet të cilave është shprehur mendimi dhe c) objekti, mbi të cilin janë fiksuar shenjat e shkrimit, që shprehin mendimin për faktin, rrethanën apo ngjarjen.

Nga pikëpamja e vendit ose e personit, nga të cilët rrjedhin dokumentet dallohen në dy lloje: akte/dokumente zyrtare dhe akte private. Aktet zyrtare dallohen në akte që nxirren nga organet shtetërore (*organe të pushtetit dhe të administratë shtetërore*) dhe në akte që nxirren nga nëpunësit

⁴¹⁶Sipas Këtij kodi: “*Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvushtje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen*”.

e shtetit ose personat publikë që ushtrojnë veprimtari publike. Në të parat hyjnë aktet zyrtare, që përmbajnë një urdhër, një vendim ose çdo masë tjetër të marrë prej tyre ose që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve. Në të dytat hyjnë aktet, që dalin nga nëpunësi shtetëror ose personi, që ushtron veprimtari publike, brenda kompetencës së tyre. Aktet private janë ato që rrjedhin nga personat privatë dhe nga pikëpamja e formës ato dallohen në akte të cilësuar dhe në akte të thjeshta (*ose shkresa e thjeshtë*).⁴¹⁷ Shkresa e thjeshtë ose private është çdo akt i shkruar, që bëhet pa ndërhyrjen e ndonjë personi zyrtar dhe që përmban nënshkrimin e personit, kjo shkresë kur është nënshkruar rregullisht d.m.th., nga personi që e ka lëshuar jep besim të plotë si akti zyrtar se deklaratimet e përmbajtura në këtë shkresë janë të atij që e ka nënshkruar. Pra, vlera provuese e shkresës së thjeshtë varet vetëm nga nënshkrimi i personit në emrin e të cilit është përpiluar. Në kuadër të dokumenteve bëjnë pjesë shënimet e shkruara në shkresa të ndryshme si p.sh. certifikata, vendime e shkresa të tjera të organeve shtetërore; certifikata, dëftesa dhe shkrime të tjera të institucioneve që kryejnë *autorizime publike, libra afariste, vërtetime, shkresa, llogari, raporte etj. nga llogaria rrjedhëse; deklarime dhe komunikime me shkrim e letra te tjera private të qytetarëve etj.*

Të gjitha dokumentet që hartohen bëhen me qëllim që dikush më vonë mund t'i përdorë të dhënat për faktet që figurojnë në to. Për të quajtur një dokument si *provë* në procedurën penale nuk është e thënë që ai të përpilohet enkas për nevoja procedurale siç është rasti p.sh., me procesverbalin mbi thëniet e dëshmitarit, me vendimet gjyqësore etj. Kryesore është që në dokument të figurojnë të dhëna për faktet që vërtetohen në procedurën penale. Me sa shihet, nocioni "*dokument*" përfshin shkresa të ndryshme që i referohen ndonjë fakti që vërtetohet në procedurën penale. Në këtë drejtim, nuk është me rëndësi a është dokument publik apo privat. Neni 190 i K.Pr. P parashikon se "*Lejohet marrja e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjeti tjetër*" Pra, ligji procedural shqiptar ka bërë këtë zgjidhje duke përcaktuar lejueshmërinë e marrjes së një dokumenti, pavarësisht se kush e ka krijuar atë, mjafton që ai të përfaqësojë një fakt të rëndësishëm. Në teori të ndryshme të procedurës penale është i përhapur mendimi se dokumentet janë vetëm "*formë me shkrim, në të cilën paraqiten prova të tjera*".⁴¹⁸

⁴¹⁷ Sandër Simoni, Leksionet mbi provat, Shkolla e Magjistraturës, 2005-2010

⁴¹⁸ Michele-Laure Rassat, Manuel de procedure penale, Press Universitaire de France, 2002, pg. 101

Sipas këtij këndvështrimi, dokumentet janë lloj i posaçëm i provave vetëm për nga forma e tyre, kurse për nga përmbajtja ato paraqesin lloj tjetër të provës, sikurse është, p.sh., deklarinimet e të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit ose mendimi i ekspertit. Nëse i analizojmë me vëmendje dispozitat ligjore, në përgjithësi, konkretisht dispozita që kanë të bëjnë me aktet, procesverbalet, leximin e deklarinimeve në seancë dhe marrjen e procesverbaleve të procedimeve të tjera etj.,⁴¹⁹ nenet 121, 116, 362, 368, 369 të K.Pr.P si dhe neni 193 i tij, në veçanti, që i referohet marrjes së procesverbaleve të procedimeve të tjera, mund të vërehet se ekziston dallimi mes tyre. Nga dispozitat ligjore të sipërpërmendura shihet qartë se procesverbalet e hartuara gjatë hetimeve me deklarinimet e të pandehurit, dëshmitarit ose ekspertit, megjithëse në vetvete përmbajnë deklarata të këtyre personave, ato nuk bën të identifikohen me deklarinimet e personave në fjalë në vlerë, pasi gjykata në shqyrtim kryesor nuk mjaftohet me leximin e procesverbaleve por sistemi ynë procedural ka pranuar se provë do të merret, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Gjykata, pra duhet që në mënyrë verbale t'i dëgjojë në seancë ato. Nuk ka dyshim se dallimi themelor ndërmjet dokumentit (*procesverbalit*) dhe dëshmisë verbale të personit qëndron në atë se dokumenti është shkronjë e vdekur në letër, të cilën në kuptimin logjik mund ta pranojmë ose jo, ndërsa te prova, që ka të bëjë me dëshmi të drejtpërdrejtë të personit ekziston mundësia e bërjes së pyetjeve plotësuese për sqarim më të mirë të çështjes.

Dallimi tjetër thelbësor është se dokumenti (*procesverbalit*) nuk përmban deklarinimin e deklaruesit fjalë për fjalë, por atë që hartuesi e ka çmuar të rëndësishme në atë moment. Në këtë kuptim, në K.Pr.P⁴²⁰ është parashikuar vetëm mënyra e marrjes së procesverbaleve nga procedime të tjera si p.sh., ato që kanë të bëjnë me sigurimin e provës ose dhe ato të administruara. Procesverbalit i provës, në një gjykim civil të përfunduar me vendim të formës së prerë, marrja e dokumentacionit që nuk mund të përsëritet, vendimet e formës së prerë për faktet e vëna në themel të tyre mund të merren si prova.

Bazuar në subjektin që i harton dokumentet, aktet mund të jenë *publike dhe private*. Para se një dokument të pranohet si provë në procedurë penale, organi procedurës duhet të vërtetojë nëse ai

⁴¹⁹ Nenet 112, 116, 193, 362, 368 dhe 369 të Kodit të Procedurës Penale.

⁴²⁰ Neni 193 i KPrP

ka cilësinë e provës. Kështu, duhet të verifikohet kush është subjekti hartues i dokumentit; prej nga ai i di faktet e shkruara në dokument; kush, përveç autorit, ka marrë pjesë me rastin e hartimit të dokumentit dhe ku e kur është hartuar dokumenti. Shpeshherë, këto të dhëna janë shënuar në dokument, prandaj më tutje vërtetohet autenticiteti i dokumentit dhe ndryshimet eventuale të tij. Dokumenti zyrtar, zakonisht, i përmban të dhënat e sipërpërmendura. Duhet të mbahet parasysh se dokumenti ka edhe kriterin e formës së shkruar *subscritum suvatum*. Sa i përket autenticitetit të tij në procedurë penale nuk vlen prezumimi, sikurse faktet (*të dhënat për faktet*) e shënuara në dokument janë të sakta. Në nenet 194, 195 K.Pr.P jepet përdorshmëria e dokumenteve anonime dhe rastet kur mund të investohet gjykata kur konstaton një dokument fals. Dokumentet *ex lege* nuk kanë fuqi me të madhe se ato private. Prandaj, *vlera provuese e dokumenteve çmohet nga gjykata*, duke i vlerësuar ato në raport me provat e tjera.⁴²¹

Ekspertimi kontabël/financiar/auditues dhe ai vlerësimit të pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme. Një lloj tjetër prove, e parashikuar në K.Pr.P. në nenet 178-186 të tij është ekspertimi. Ekspertimi është një nga provat më të përdorshme në hetimin e gjykimin e çështjeve penale, por ky lloj ekspertimi i veçantë është i domosdoshëm gjatë procedurës së konfiskimit pasuror. Gjatë hetimit parandalues pasuror është e nevojshme kryerja e ekspertimit kontabël/financiar/ auditues apo e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, pasi është e nevojshme që në rastin e hetimit pasuror të bëhet vlerësimi i vlerës së pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, të përcaktohen vlera e pasurisë, e të ardhurave, shpenzimeve, vlera të aktivitetit ekonomik, bilanceve kontabël etj. Ky lloj ekspertimi kërkon njohje të veçanta për rrjedhojë është i domosdoshëm nga gjykata, por në mënyrë të veçantë nga pala për të vërtetuar fakte, që lidhen me origjinën e ligjshme të pronës. Për mënyrën e marrjes së këtyre provave apo e vlerësimit të tyre u referohemi rregullave procedurale penale e civile. Domosdoshmëria që të provohen saktë dhe plotësisht faktet e nevojshme juridike, e veçanërisht të atyre, që gjyqtari nuk ka njohuri të mjaftueshme profesionale, ka shtruar nevojën për zbatimin e ekspertimit si një veprimtari e posaçme që ushtrohet nga eksperti, me të cilin sigurohet mendimi i tij si provë.

Ekspertimi nënkupton kryerjen e një veprimi të caktuar nga eksperti për vërtetimin e vlerësimit të një fakti apo zbulimin e tij për të cilën kërkohet një njohuri i posaçme profesionale. Ekspertimi si

⁴²¹Sandër Simoni, Leksionet mbi provat, Shkolla e Magjistraturës, 2005-2010

veprim nënkupton dhe aktivitetin e organit të procedurës nëpërmjet vendimit të kryerjes, caktimit të ekspertimit, emërimit, e vlerësimit të mendimit të tij. Objektin e ekspertimit e përbëjnë faktet që kanë të bëjnë me sqarimin dhe zgjidhjen e çështjes financiare/kontabël konkrete, si dhe faktet që kanë të bëjnë me çështje të tjera, që janë në lidhje me veprën penale, e që kontribuojnë në marrjen e vendimit gjyqësor lidhur apo me masa të caktuara. K.Pr.P⁴²² ka bërë një përcaktim të objektit të ekspertimit, dhe kufijve të lejueshmërisë, duke përcaktuar se ky veprim procedural lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, inxhinierike, financiare, kontabël.

Eksperti është një profesionist në fushat jo juridike, mund të jetë financier/kontabilist/auditues/inxhinier topograf etj., të cilin organi procedural e thërret për të dhënë një mendim, lidhur me vërtetimin e një fakti juridik të caktuar, për vërtetimin e të cilave kërkohet një njohuri e posaçme. Dikur, eksperti quhej “*grykatës shkencor*”, ndërsa sot njihet si subjekt procedural. Rregullat e caktimit të ekspertit i parashikon K.Pr.P⁴²³ “*caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave, që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në fushën përkatëse*”.⁴²⁴

Ligji shqiptar i ka dhënë një disponibilitet të gjerë organit procedues, e rëndësishme është që eksperti të njihet nga ky organ, dhe emërimin si ekspert ia jep vendimi i organit procedural. Eksperti është person fizik i aftë profesionalisht dhe proceduralisht, i cili e ndihmon organin e procedurës, në zbulimin të fakteve kontestuese për mjeshtëri profesionale. Veprimtaria dhe roli i ekspertit është e papajtueshëm me veprimtarinë dhe rolin si të organit të procedurës, ashtu edhe të subjekteve të tjera procedurale. Specifika e veprimtarisë së ekspertit ndikon që ai të jetë një pjesëmarrës i pavarur procedural, i cili ofron ndihmë profesionale.

Si i tillë, ai thirret nga subjekti gjatë procedurës së konfiskimit, por caktohet nga gjykata. Eksperti caktohet në bazë të nenit 179 të KPrP, dhe neneve 224/d, 225 e vijues të K.Pr.Civile dhe 178,179 dhe 184 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim kryerjen në gjykim të ekspertimit vlerësues të

⁴²² Neni i 178 i Kodit të Procedurës Penale.

⁴²³ Neni i 179 i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar në vitin 2002

⁴²⁴ Ekspertët kontabël/financiar/auditues e të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme, si rregull, zgjidhen prej regjistrimit të ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë si dhe pranë regjistrimit të kontabilistivë të autorizuar.

pasurive të paluajtshme dhe kontabël/audit ligjor të pasurive objekt konfiskimi e të të ardhurave, mbi të cilat janë krijuar ato, duke iu referuar listës së ekspertëve të regjistruar në regjistrin e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë për të kryer ekspertimet pranë gjykatave respektive.⁴²⁵

Akti i ekspertimit është një provë shkencore e cila, ndonëse pse mbart në vetvete shumë avantazhe, për gjykatën do të mbetet një provë, si gjithë llojet e tjera të provave, që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykata e çmon atë. Çmuarja e provës, pra dhe e asaj me ekspert, bëhet duke nxjerrë vlerën e saj provuese në koherencë me provat e tjera të procesit gjyqësor. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatat, të cilat nuk janë aspak të detyruara që të pranojnë a priori këto mendime, përveçse kur i bindin. Fakti se eksperti ofron mendime të specializuara për gjykatën në një fushë jojuridike, bën që mendimi i ekspertit të tërheqë vëmendje më të madhe në momentin e çmuarjes së tij nga ana e gjykatës dhe kjo e fundit duhet që të argumentojnë me hollësi mendimin e kundërt. Nëse nuk pranohet mendimi i ekspertit duhet që të paraqiten argumente bindëse, por kjo nuk do të thotë se gjykatat duhet të pajtohen gjithmonë me konkluzionet e ekspertëve. Pra, gjykatat, përfundimet e nxjerra nga ekspertët, i shqyrtojnë në kontekstin e të gjitha rrethanave të tjera të çështjes.⁴²⁶

Në nenin 178 të Kodit të Procedurës Penale nën titullin “Objekti i ekspertimit” parashikohet shprehimisht se: “*1. Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore.*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite konkludohet se veçoria kryesore e mendimit të ekspertëve si provë është karakteri i tij shkencor. Vërtetimi i një fakti apo konstatimi i qenies ose jo të një rrethane që ka rëndësi për çështjen bëhet me ndihmën e specialistëve, të cilët realizojnë këqyrjen apo analizën e një objekti ose fenomeni mbi bazën e njohurive të posaçme, që ato zotërojnë në fusha të ndryshme të shkencës, teknikës ose kulturës. Mendimi i ekspertëve, që kalon kufijtë e një mendimi shkencor dhe merret me trajtimin e problemeve të së drejtës materiale apo procedurale, të formës së fajësisë apo të motiveve etj., nuk ka asnjë vlerë provuese dhe nuk mund të merren parasysh nga organi procedues prokuroria dhe gjykata.

⁴²⁵ Ekspertët kontabël/financiar/auditues ligjor e ato të vlerësimit të pasurive të paluajtshme e të luajtshme/ të vlerësimit të dëmit janë ekspertë, të cilët regjistrohen pranë regjistrin të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa ekspertët kontabël të autorizuar/audit ligjor janë të regjistruar pranë Insitutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

⁴²⁶ Vendimi Nr. 45, datë 23.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

Në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale thuhet shprehimisht se: *“1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar.”*. Mbështetur në këtë dispozitë sikurse u theksua më lart si të gjitha provat e tjera edhe mendimi i ekspertëve në procesin penal i nënshtrohet shqyrtimit dhe çmuarjes së tij nga prokuroria në fazën e hetimit paraprak dhe nga gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, në bazë të po atyre parimeve që kanë fuqi për të gjitha llojet e provave. Natyrisht, veçoritë që ka kjo provë sidomos kur fusha e dijes që ka shërbyer si bazë për zgjidhjen e çështjes, është e panjohur për gjykatën, e bëjnë të vështirë, por jo të pamundur punën për verifikimin e drejtësisë së përfundimeve që ka arritur eksperti. Veç kësaj edhe vetë ekspertimi është një proces i veçantë njohje, që drejtohet në zgjidhjen e çështjeve që përbëjnë objektin e ekspertimit, e që kryhet në bazë të një sërë veprimesh e operacionesh, të cilat diktohen nga natyra e problemit që zgjidhet. Vlerësimi i mendimit të ekspertit përfshin, pikërisht edhe verifikimin e rregullsisë së këtyre operacioneve e veprimeve, të cilat e kanë çuar ekspertin në nxjerrjen e përfundimeve të tij. Në vetvete, mendimi i ekspertit është zbatimi i një teze të caktuar shkencore në një rast konkret, prandaj për gjykatën nuk ka rëndësi vetëm mendimi i ekspertit por ka rëndësi tërë procesi i punës së tij, kanë rëndësi metodat e përdorura dhe mënyra si i ka zbatuar ai këto teza shkencore.

Është e rëndësishme që ekspertimi të kryhet në përputhje me normat procedurale, pasi në këtë mënyrë krijohet garanci e plotë, që konkluzioni i arritur të jetë i drejtë. Në nenin 184 të K.Pr.Penale nën titullin “Veprimet e ekspertit” parashikohet shprehimisht se: *“1. Për t’iu përgjigjur kërkesave të ekspertimit, eksperti mund të autorizohet nga organi procedurës që të shohë aktet, dokumentet dhe gjithçka që përfshihet në fashikullin e prokurorit ose të gjykatës. 2. Eksperti mund të autorizohet të marrë pjesë edhe në pyetjen e palëve dhe marrjen e provave. 3. Kur eksperti kërkon të dhëna nga i pandehuri, i dëmtuari ose nga persona të tjerë, këto të dhëna përdoren vetëm për qëllimet e ekspertimit. 4. Kur për nevojat e ekspertimit është i domosdoshëm shkatërrimi ose ndryshimi i thelbit të sendit, kur është e mundur, ekspertët detyrohen të ruajnë atë pjesë të tij, si dhe të dokumentojnë pjesën e përdorur për ekspertim, duke vënë në dijeni organin procedues dhe palët.”*, ndërsa përcaktohet dhe mënyra e dhënies së mendimit të ekspertit.⁴²⁷

⁴²⁷ Neni 185 të K.Pr.Penale nën titullin “Akti i ekspertimit” thuhet shprehimisht se: *“1. Mendimi i ekspertit jepet me shkrim. 2. Kur ekspertët e caktuar janë më shumë se një dhe kanë mendime të ndryshme, secili parashtron me akt të*

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se një nga të drejtat e ekspertëve është të njihet me të gjitha materialet e çështjes për të dhënë një mendim të saktë. Mendimi i ekspertit duhet të jepet me shkrim dhe në të duhet të paraqiten qartë dhe me hollësitë e nevojshme materialet që ka pasur në dispozicioni ekspertit, metodat e përdorura dhe të dhënat e konstatuara gjatë këqyrjes dhe analizës së objektit të ekspertimit, tezat teknike dhe shkencore, që ka shfrytëzuar ekspertit për këtë punë, si dhe përgjigjet për të gjitha detyrat e shtruara për zgjidhje nga ana e organit procedues.

Akti i ekspertimit është pasqyrimi përfundimtar i ekspertimit. Metodika e hartimit të aktit të ekspertimit bazohet në katër elementë bazë të cilat përbëjnë strukturën e çdo akti ekspertimi, që përmban: pjesën përshkruese të pasurisë objektet ekspertimit ose të të ardhurave sipas detyrës së gjykatës e objektit të aktit të ekspertimit, rrethanat e çështjes, pjesën e ekzaminimit ekspertues dhe konkluzionit. Ligji procedural shqiptar nuk përcakton llojet e ekspertimeve. Këtë e bën praktika në rastin e ekspertimeve në zbatim të ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* të ndryshuar⁴²⁸, është e nevojshme kryerja e ekspertimit kontabël apo i vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Kodi i Procedurës Penale parashikon ekspertimin kompleks⁴²⁹ për rastet kur kërkimet dhe vlerësimet paraqiten të vështira. Duhet theksuar këtu se pjesa përfundimtare e aktit të ekspertimit duhet të jetë rrjedhojë logjike e pjesës përshkruese arsyetuese të këtij akti. Në rast se ekspertët nuk tregojnë se ku janë mbështetur për të dhënë këtë ose atë mendim apo nuk tregojnë procesin dhe metodat e punës të përdorura, mendimi i dhënë prej tyre nuk mund të pranohet, pasi nuk është e mundur të bëhet verifikimi dhe çmuarja e mendimit të tyre, por do të detyrohej ta pranonte mendimin e ekspertit si një fakt të vërtetuar, të padyshimtë dhe të sigurt, në kundërshtim me nenin 152 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *“Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar”*. Në rastin e ekspertimeve kontabël/financiar/auditues konkluzioni është përgjigja ndaj detyrës së gjykatës e kërkesave të

veçantë mendimin e tij. 3. Kur faktet janë komplekse dhe ekspertit nuk mund të japë përgjigje menjëherë, organi procedues i jep atij një afat jo më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë. Kur ka nevojë për verifikime veçanërisht komplekse ky afat mund të zgjatet edhe më shumë se një herë për periudha jo më të gjata se tridhjetë ditë, por pa kaluar afatin maksimal prej gjashtë muajsh.”

⁴²⁸ Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.04.2017.

⁴²⁹ Neni 179 pag. 3 i Kodit të Procedurës Penale.

palëve nëse ekzistojnë mjetet financiare të nevojshme e të ligjshme për justifikimin e pasurisë. Pjesa e konkluzionit mund të jetë në mënyrë kategorike ose të mundshme. Edhe konkluzionet e mundshme janë me natyrë pozitive ose negative. Kjo mënyrë formulimi është një nga problemet e ndërlikuara të hasura në praktikë

Gjykata e Posaçme e Shkallës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka mbajtur një qëndrim të qartë për karakteristikat dhe elementët, që duhet të ketë një akt ekspertimi kontabël dhe ai i vlerësimit të pasurisë së paluajtshme për t'u quajtur i vlefshëm si provë. Në një vendim të gjyqtarit të seancës paraprake mbi bazën e kërkesë së dërgimit të çështjes për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 të KP⁴³⁰, Gjykata shprehet se: “... në aktin e ekspertimit kontabël i dt. 21.02.2021 (i hartuar nga ekspertja kontabël L. M), i administruar në fashikullin e prokurorisë, nga ana e ekspertes jepet, ndër të tjera edhe mendim juridik (shiko faqen 6 të aktit të ekspertimit, ku ndër të tjera përcaktohet: “... Theksojmë se për shkak të mashtrimit të qëllimshëm, që subjekti ka bërë në deklaratimet vjetore duke lidhur kontrata dhurimi dhe huapërdorje me të motrën, puna jonë bëhet akoma më e vështirë, përfundimisht ...”.

Gjykata thekson se akti i ekspertimit është një provë shkencore, e cila, ndonëse pse mbart në vetvete shumë avantazhe, për gjykatën do të mbetet një provë si gjithë llojet e tjera të provave, që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykata e çmon atë. Çmuarja e provës, pra dhe e asaj me ekspert, bëhet duke nxjerrë vlerën e saj provuese në koherencë me provat e tjera të procesit gjyqësor. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatat, të cilat nuk janë aspak të detyruara që të pranojnë a priori këto mendime, përveçse kur i bindin. Fakti se eksperti ofron mendime të specializuara për gjykatën në një fushë jojuridike, bën që mendimi i ekspertit të tërheqë vëmendje më të madhe në momentin e çmuarjes së tij nga ana e gjykatës dhe se kjo e fundit duhet që të argumentojnë me hollësi mendimin e kundërt. Nëse nuk pranohet mendimi i ekspertit duhet që të paraqiten argumente bindëse, por kjo

⁴³⁰ Vendimi nr. 72 datë 16.09.2021 i gjyqtarit të seancës paraprake të GJPKKO mbi kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 137/1 të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndaj të pandehurit F. L (ish gjyqtar i GJL), i akuzuar për veprën penale të Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, e parashikuar nga neni 257/a/2 i K.Penal.

nuk do të thotë se gjykatat duhet të pajtohen gjithmonë me konkluzionet e ekspertëve. Pra, gjykatat, përfundimet e nxjerra nga ekspertët, i shqyrtojnë në kontekstin e të gjitha rrethanave të tjera të çështjes.⁴³¹ Veçoria kryesore e mendimit të ekspertëve si provë është karakteri i tij shkencor. Vërtetimi i një fakti apo konstatimi i qenies ose jo të një rrethane që ka rëndësi për çështjen bëhet me ndihmën e specialistëve, që realizojnë këqyrjen apo analizën e një objekti ose fenomeni mbi bazën e njohurive të posaçme, që ata kanë në fusha të ndryshme të shkencës, teknikës ose kulturës. Mendimi i ekspertëve, që kalon kufijtë e një mendimi shkencor dhe merret me trajtimin e problemeve të së drejtës materiale apo procedurale, të formës së fajësisë apo të motiveve etj., nuk ka asnjë vlerë provuese dhe nuk mund të merren parasysh nga organi procedues prokuroria dhe gjykata. Gjykata çmon se është e rëndësishme që ekspertimi të kryhet në përputhje me normat procedurale, pasi në këtë mënyrë krijohet garanci e plotë se konkluzioni i arritur të jetë i drejtë. Mendimi i ekspertit duhet të jepet me shkrim dhe në të duhet të paraqiten qartë dhe me hollësinë e nevojshme materialet, që ka pasur në dispozicion eksperti, metodat e përdorura dhe të dhënat e konstatuara gjatë këqyrjes dhe analizës së objektit të ekspertimit, tezat teknike dhe shkencore, që ka shfrytëzuar eksperti për këtë punë, si dhe përgjigjet për të gjitha detyrat e shtruara për zgjidhje nga ana e organit procedues. Duhet theksuar këtu se pjesa përfundimtare e aktit të ekspertimit duhet të jetë rrjedhojë logjike e pjesës përshkruese arsyetuese të këtij akti. Në rast se ekspertët nuk tregojnë se ku janë mbështetur për të dhënë këtë ose atë mendim apo nuk tregojnë procesin dhe metodat e punës të përdorura, mendimi i dhënë prej tyre nuk mund të pranohet, pasi nuk është e mundur të bëhet verifikimi dhe çnuarja e mendimit të tyre, por do të detyrohej ta pranonte mendimin e ekspertit si një fakt të vërtetuar, të padyshtimtë dhe të sigurt, në kundërshtim me nenin 152 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: “Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar”. Gjykata konstaton se ekspertja kontabël, në rastin konkret, ka dalë jashtë misionit të saj, pasi ndër të tjera merret edhe me zgjidhjen e çështjes në themel sikurse është ajo e përcaktimit të faktit nëse i pandehuri F. L. ka bërë apo jo deklaram të rremë në deklaratat e tij të pasurisë në lidhje me kontratat e dhurimit dhe huapërdorjes me të motrën”.⁴³²

⁴³¹ Vendimi Nr. 45, datë 23.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

⁴³² Mbi bazën e këtij argumentimi mbi aktin ekspertimit kontabël, gjyqatri i seancës paraprahe i Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur kthimin e akteve për ripërsëritjen e aktit të ekspertimit dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore në Prokurorinë e Posaçme.

Vlerësime të tjera mbi provat. Mënyra sesi gjykata merr një provë të karakterit procedural penal apo dhe prova të tjera në një gjykim konfiskimi pasurie gjatë procedimit pasuror, sigurisht që varet nga përcaktimet e veçanta në ligjin për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar. Është me vend të përmendet se rregullimi në legjislacionin shqiptar mbi kompetencat e gjykatës për të kryer veprime procedurale sipas nenit 10/1 të Ligjit⁴³³ është një zgjedhje e veçantë, të cilën nuk e kemi gjetur në legjislacionet e tjera. Në legjislacionet e tjera, p.sh., atë italian nuk ekziston një kompetencë e tillë, mbase se në modelin italian referohen rregullat procedurale civile. Me interes në fushën teorike dhe praktike është interpretimi i kuptimit të kësaj dispozite, edhe pse është e vështirë që një gjykatës të mund të “përmbyshë” këto kompetenca në mënyrë “invazive” (*kontrolle në banesa, përgjime*). Referenca për “*kërkesën e palëve*” tregon kompetenca të zgjeruara të gjykatës në procedurë pas sekuestrimit për të verifikuar argumentimet e të interesuarit dhe të Prokurorisë. Të dhënat, informacionet, rezultatet e verifikimeve, provat si: provat materiale, dokumentet, procesverbalet, ekspertimet mblidhen nga prokuroria gjatë fazës së hetimit pasuror përpara ose gjatë periudhës kur është vendosur sekuestro. Në vlerësimin tonë, kjo gjë nuk i përgjigjet pozicionit të Gjykatës, por synon efektivitetin e procedimit pasuror në tërësi si një procedim i veçantë e si e tillë ky rregullim duhet të rishikohet.

Ligji trajton pasuritë e personave, që *prima facie* nuk i përgjigjen situatës ekonomike të personit⁴³⁴ dhe kanë një vlerë proporcionale me të ardhurat legjitime të deklaruara dhe blerja e pasurisë, e cila nuk është e justifikuar, sikurse përcaktohet në nenin 11, pjesa e parë dhe nenin 24/1 të Ligjit.⁴³⁵ Kjo është formë e konfiskimit të zgjeruar, që ngjason me modelin e vendeve, të cilat përfshijnë të gjithë pasurinë me origjinë të paligjshme që mund të mos jenë me vlerë proporcionale krahasuar me të ardhurat e deklaruara për qëllime tatimore ose veprimtari ekonomike, që mund të rezultojnë në deklarata të manipuluar financiare, që nuk përputhen më të ardhurat aktuale. Sipas praktikës

⁴³³ Paragrafi i i nënit 10 “Kompetencat e gjykatës” “Gjykata me kërkesë të prokurorit, të palëve ose kryesisht urdhëron hetimet e nevojshme për të zgjidhur çështjen dhe mund të miratojë masat e përcaktuara me ligje të veçanta”.

⁴³⁴ Neni 2 “...përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustifikuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale”.

⁴³⁵ Gjykata vendos sekuestrimin e pasurisë kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhur shpërpjestimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtaria të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përlligjen prej tyre. Rezulton se pasuria është drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjeshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1 të këtij ligji. (*të afërmit*).

gjyqësore, prova kërkohet nëse personat e përmendur në nenin 3 pika 2 shkronja “a” të Ligjit⁴³⁶ tregojnë se ata kanë paratë ose të ardhurat e mjaftueshme për të blerë pasuri ose për të pasur veprimtari sipërmarrëse apo i kanë përdorur paratë për të blerë pikërisht atë pasuri.

Shprehja “*të dhëna të mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik zotërohen pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë indirekte, nga personat, që kanë konsumuar veprat penale të krimit të organizuar e të tjera*”, rezulton se është vënë për të shmangur keqinterpretimin, pasiguritë dhe për qartësi duke përcaktuar elementët dhe karakteristikat, të cilat lejojnë gjykatat që ta konsiderojnë zotërimin indirekt në emër të autorëve të dyshuar.

Këto të dhëna të mjaftueshme nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e afërm, duke iu referuar një marrëdhënie të veçantë me të dyshuarin e veprës, për shembull marrëdhënia e punës, varësia profesionale ose lidhja e gjakut (familjare), të cilat janë përfshirë në nenin 3 pika 2 shkronja a), ku bëjnë pjesë të afërmit.

E dhëna e mjaftueshme nxirret nga fakti që personi fizik ose juridik ka pasuri ose të ardhura që as nuk përputhen dukshëm me nivelin e të ardhurave, fitimeve ose veprimtarive të ligjshme të deklaruara as nuk justifikohen prej tyre. Një vlerësim tjetër se nga nxirret e dhëna e mjaftueshme është dhe mungesa e mjeteve financiare të palës së tretë për të blerë pasuritë, që përbën në veçanti një element të rëndësishëm të pronësisë fiktive, i shtohet marrëdhënies së veçantë ndërmjet të dyshuarit dhe personit, që zotëron pasuritë. Vlerësohen dhe nga rrethana të tjera të dobishme. *Për shembull*; përmbajtja e një përgjimi telefonik mund të provojë pronësinë fiktive të një personi, i cili nuk ka mjetet ekonomike dhe marrëdhënie të dukshme me të dyshuarin e veprës apo pagesa të kuotës së shërbimit administrative të rojës apo të pagesës së energjisë, ujit etj., për një periudhë të gjatë sjell indicien se subjekti është pronar i banesës.

Çdo sistem ligjor parashikon prezumime të faktit dhe të ligjit. Në këtë aspekt, në objektin e hetimit dhe gjykimit parandalues është vërtetimi i “*dysimit të arsyeshëm*” për pjesëmarrje⁴³⁷, por jo edhe

⁴³⁶ Persona të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrit, vjehrra etj.).

⁴³⁷ Ligji nr. 70/ 2017 datë 27.04.2017 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”

vërtetimi i lidhjes shkakësore të veprimeve të tij me pasojat e ardhura për efekt të përgjegjësisë penale të tij. Ndërsa, procedimi penal është i lidhur me një fakt të caktuar, që përbën, apo i atribuon personit kryerjen e një vepre penale, procedimi parandalues është i lidhur me vlerësimin e rrethanave, rrezikshmërisë së një personi të dyshuar, që shfaqet edhe në veprimtari, sjellje e qëndrime, të cilat jo domosdoshmërisht janë të lidhura me përgjegjësinë penale, domethënë përbëjnë vepër penale. Prandaj gjykata, e cila shqyrton një kërkesë për konfiskim pasurie për qëllime të vendosjes së masës parandaluese pasurore, duhet të shqyrtojë dhe vlerësojë, në mënyrë autonome, të gjitha faktet, rrethanat, indicjet etj., për të nxjerrë përfundimet e saj mbi elementet, që mbështeten në ligj dhe në fakt vendosjen e masës preventive pasurore.

Prandaj, mund të konkludojmë se prova në procedimin parandalues pasuror, ajo mbi të cilat mund të konfiskohet një pronë është një koncept i dyfishtë, që ndjek regjimin e një vlerësimi të veçantë të një standardi të ulët e që plotësohet sipas parimeve të vlerësimit në procedurën penale.

4.8 Kërkesa për konfiskim, kriteret e vlerësimit të kushteve për të vendosur për konfiskim pasuror dhe provat ku mbështeten.

Kërkesa për konfiskim është finalizimi i një sërë veprimesh verifikimi e hetimi pasuror të prokurorisë, që përmbledh relacionin e informacionet e policisë gjyqësore, rezultatet e verifikimeve të prokurorit, të gjitha të dhënat e provat e marra si rezultat e këtyre verifikimeve si dhe të gjitha të dhënat e provat, që kanë paraqitur subjekti dhe të tretët gjatë fazës së zbatimit të vendimit të sekuestrimit.

Verifikimi duhet të bëhet duke u bazuar në fakte konkretisht të vërtetuar (*jo mbi dyshime, spekulime apo hamendje*):

- të tilla mund të jenë raportet e autoriteteve të policisë, precedentët penale të personit, ndaj të cilit propozohet masa, provat e marra në procesin penal, edhe nëse në proces janë konsideruar të pamjaftueshme për përgjegjësi penale.

- Me një vlerë treguese të sigurtë: mund të përdoren të dhëna për personin/subjekt i ligjit ose atyre, që dyshohen për pjesëmarrje në një grup kriminal, që shfaqin mungesë e një pune të qëndrueshme, në lidhje me nivelin e jetesës, pasurimi i papritur etj.

Janë të përdorshme, të gjitha veprimet e procesit penal, që eventualisht janë kryer, që mund të jenë rivlerësuar nga gjykata sipas rregullave të tij provuese.

Në veçanti:

- 1) për subjektet (*që merren me trafikë kriminale pra, që jetojnë zakonisht, ose pjesërisht, me të ardhura nga aktivitete kriminale*) të gjitha elementet dhe faktet e vërtetuara do të përdoren për të verifikuar përfshirjen në këtë veprimtari në kohën e vënies së pasurisë.
- 2) Për persona të dyshuar për përkatësi në grupe të strukturuar kriminale, pra për kryerjen e veprave penale të rënda), duhet të verifikohet *indicia* për kryerjen e veprës penale (*përkatësi në krim të organizuar apo krim tjetër i rëndë*). Nëse në një proces penal duhet prova, në atë të parandalimit mjaftojnë rrethanat e faktit, objektivisht të vlerësuara dhe të kontrolluara, që të çojnë në një gjykim të provueshëm, në mënyrë të arsyeshme pra, të cilësimit të mundësisë së kryerjes së veprës penale.

Disponibiliteti i asetëve. Disponibiliteti ndodh kur, përtej regjistrimit formal të pasurisë në emër të një personi të tretë, i ndryshëm nga personi i propozuar për masat, ky i fundit të jetë vërtetë *dominus* që të mund të përcaktojë destinacionin ose përdorimin.⁴³⁸ Prandaj do të kishim:

- a) Disponibilitetin e drejtpërdrejtë, kur personi nën hetim është titullari formal i pasurisë (pronari);
- b) Disponibiliteti indirekt, kur personi ndaj të cilit procedohet, ndonëse nuk është titullari formal i pasurisë, mund të vendosë në çfarëdo mënyre destinacionin ose përdorimin, duke ushtruar fuqinë e tij për llogari të personave të tretë.

Në rast kur asetet regjistrohen formalisht në emër të të tretëve, ekziston detyrimi që të shpjegojë arsyet e kalimit fiktiv (*të një të drejte*) mbi bazën e hetimeve faktike, që nënkuptohen nga kushtet

⁴³⁸Neni 26 i ligjit përcakton elementët e detyrueshëm të vendimit të gjykatës, ndër të tjera kjo dispozitë përmban detyrimin procedural sipas të cilit: “*Vendimi i gjykatës për marrjen e masës parandaluese përmban: e) parashtrimin e Përmbledhur të faktit dhe shkakun ligjor të masës parandaluese*”.

e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë dhe mund të përbëjnë provë indirekte të disponibilitetit të personit nën hetim.

Kjo provë, mund të kuptohet nga elementë të ndryshëm, një ndër të cilët është vlera joreale e pronës në disproporcion me të ardhurat e deklaruar ose aktiviteti ekonomik, i kryer nga personat që iu drejtohet, ose mungesa e lidhjes në mes të këtij aktiviteti dhe një tjetri, përpara disponibilitetit ekonomik. Në rastin e bashkëshortit, fëmijëve dhe bashkëjetuesve kërkohet një barrë më e ulët pasi ekziston *presumimi i përkatësisë së personit ndaj të cilit është propozuar masa*)⁴³⁹. Kur kemi transferim falas ose me pagesë të ulët të pasurisë tek të afërmit pak para marrjes së masës kjo hetohet si rast i keqbesimit në marrjen në pronësi.

Prejardhja e jashtëligjshme. Për të vërtetuar prejardhjen jo të ligjshme të pasurisë, nuk duhet prova e prejardhjes jo të kundraligjshme të pasurisë, por vetëm *mjaftueshmëria e indicieve*, që konkludohet kryesisht nga pabarazia ndërmjet vlerës së asetit dhe hyrjeve të deklaruar ose të veprimtarisë, që ka kryer personi ndaj të cilit merren masa (*procedohet*). Në një rast të tillë, mjafton të rezultojë se pasuria është frut i një aktiviteti të paligjshëm për të ndërmarrë një masë që heq rritjet ose ripërdorimin e shumave të të njëjtës pasuri.⁴⁴⁰ Me fjalë të tjera, paratë e përftuara nga pasuria origjinale, që vjen nga një aktivitet i jashtëligjshëm, përfshijnë dhe bëjnë të jashtëligjshëm ripërdorimin e këtyre parave pra, të pasurive të vëna me këto para. Në këtë zhvillim do të përfshihen të gjitha ripërdorimet e parave të mëpasshme, që derivojnë nga operacione financiare, të cilat janë të lidhura me pasurinë e përftuar në mënyrë të jashtëligjshme (*në origjinë*). Asetet me prejardhje nga veprimtari të jashtëligjshme (*ose ripërdorimi i saj*) goditen pa qenë e nevojshme të ndahen nëse këto aktivitete janë të llojit mafioz ose jo, pra nuk duhet një lidhje shkakësore midis sjelljes së prezumuar si e jashtëligjshme dhe përfitimit të jashtëligjshëm. Demonstrimi i prejardhjes së jashtëligjshme të aseteve të konfiskuar, cilado qoftë (*për shembull, evazioni fiskal*) është i mjaftueshëm për t'i goditur ato.

⁴³⁹ Në rastet kur hetimi pasurir fokusohet në verifikimin e regjistrimit të rremë të pasurisë ose simulimit të transaksionit bankar apo të kalimit të pasurisë së paluajtshme.

⁴⁴⁰ Në rastet kur pasuria transferohet disa herë në disa transaksione të kalimit të saj.

Kundërshtimet e palëve duhet të verifikohen në lidhje me pronësinë mbi pasurinë, qoftë edhe në lidhje jodirekte me pasurisë. Kjo është barrë prove e akuzës. Përballë provës së ofruar nga organi propozues dhe që i duket e përshtatshme Gjykatës, në fazën e sekuestrimit, të tretët që kanë pasurinë të regjistruar në emër të tyre (*pronarë formalë*) të thirrur në gjykim, mund të sjellin elemente, që kanë synim të ndikojnë në krijimin e një alibie, duke ushtruar mundësinë për t'u mbrojtur, nëpërmjet futjes në procedurë të elementëve të besueshëm dhe koherentë. Të tillë mund të jenë dokumentet në lidhje me ekzistencën e të ardhurave, të përdorura në mënyrë të përshtatshme për blerjen e asetit.

Mjaftueshmëria e indicieve për prejardhjen e jashtëligjshme të aseteve është një test i vazhdueshëm në çështjet e hetimit pasuror dhe gjykimin e kërkesave për konfiskim. Hipoteza e përmbysjes së barrës së provës, nuk ndodh shpesh sepse gjyqtari, në bazë të elementeve të përfutur gjatë procedurës, duhet të arrijë bindjen, duke pasur parasysh vetëm indiciet rreth prejardhjes së paligjshme të aseteve. Prandaj, është barrë e personit nën hetim të kundërshtojë indiciet e përfutura; barrë, e cila duhet shlyer në mënyrë serioze, në atë mënyrë që t'i lejojë gjyqtarit të bëjë verifikimet e duhura në lidhje me ekzistencën e elementëve dyshues mbi prejardhjen e ligjshme të pasurisë.

Përcaktimi i sendit, ndaj të cilit merret masa parandaluese, duhet të jetë, në çdo rast, nominal duke iu referuar rëndësisë dhe pasojës që ai ka në interesat pasurore. Prokurori, në çdo rast ka detyrë të identifikojë pasuritë, të cilat janë rezultat i veprimtarisë kriminale, të parashikuar nga neni 3 i ligjit, me qëllim që interesi publik, i cili determinon në vendosjen e kufizimit të pronës të jetë në proporcion me masën që merret duke u vendosur vetëm mbi ato pasuri, të cilat e kanë burimin nga aktiviteti i paligjshëm. Në referim të nenit 3, pika 1, germa "a" dhe pika 2 germa "a", të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandalese⁴⁴¹, pasuria objekt sekuestrimi plotëson kriteret e parashikuara nga ky nen. Një nga detyrimet që ka prokurori është

⁴⁴¹ Në nenin 3 pika 1 germa "d" parashikohet zbatimi i ligjit për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje, për kryerjen, prej tyre, të veprës penale të "prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive në emër të personit të afërm i përmendur në shkronjën "a", të pikës 2 të këtij neni,⁴⁴¹ zbatohet prej gjykatës, pasi vlerësohet se ka të dhëna të dobishme, të siguruar në rrugë të ligjshme si p.sh. infomacione nga zyrat e regjistrimit të pasurisë apo institucione të tjera apo nga provat si akti i ekspertimit, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së krijimit të pasurive, të cilat rezultojnë të regjistruara në emër të personit të afërm, i cili rezulton se ka qenë në pamundësi ekonomike për të krijuar pasuritë me të ardhura të ligjshme.

verifikimi nëse pasuritë janë të krijuara në periudhën kur dyshohet se subjekti ka qenë i përfshirë në veprimtari kriminale pra, është e nevojshme të përcaktohet koha e krijimit të pasurisë kriminale.

Në referim të nenit 11 pika 4 të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, për vendosjen e masës se sekuestros, është e domosdoshme *ekzistenca e kriterëve që lidhen me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicie*, të cilat tregojnë se personat mund të jenë të përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotërimin e pasurive dhe të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe ekzistenca e të paktën e njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Në lidhje me *indiciet*, d.m.th. prania e elementit të ashtuquajtur *fumus boni iuris*, rezulton se për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë, është e nevojshme hetimi dhe marrja e të dhënave dëshmuese rreth kryerjes së një fakti, që përbën vepër penale të parashikuar si e tillë në nenin 3 të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar ⁴⁴²Nga aktet dhe provat që merren, gjykata duhet të verifikojë nëse u arrit që të realizohej barra e provës “*onus probandi*”, që ligji i ngarkon akuzës. Për të provuar dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në indicie se personi nën hetim është përfshirë në veprimtarinë e kundërligjshme duhet të ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

Investimet gjatë kohës kur personi ka qenë i përfshirë në veprimtari kriminale, blerja e pasurive, krijimi i llogarive bankare, të cilat nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, përbën një të dhënë, në nivelin provues të indicieve, e cila përkrah situatës tjetër të dyshimit se ai është përfshirë në veprimtarinë e kundërligjshme formon një indicie, jep një njohje të re, e cila krijon dyshimin e

⁴⁴² Fusha e zbatimit, neni 3 I ligjit nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.04.2017

arsyeshëm, të bazuar në këto indicie, për dyshimin e kryerjes nga ai të një krimi tjetër p.sh siç është pastrimi i parave, mosdeklarimi, evazioni fiskal etj.⁴⁴³

Vendimi nr. 00-2017-227 (48), datë 29.03.2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përcakton se: *“Prokurori si subjekti procedural nismëtar në procedimin pasuror parandalues ka detyrimin ligjor që, në momentin e paraqitjes së kërkesës për konfiskim (kjo vlen edhe për sekuestrimin), të argumentojë, se ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në indicie se pasuria, është e krijuar si rezultat i pjesëmarrjes në organizatat kriminale dhe nuk justifikohen ligjërisht në raport me burimet e ligjshme të të ardhurave dhe kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme. Prokurorit, në çdo rast, i del si detyrë që të paraqesë përpara gjykatës indicie të mjaftueshme për të provuar dyshimin se pasuria, për të cilën kërkohet masa parandaluese, është krijuar nga një aktivitet kriminal nga ato, që parashikon shprehimisht fusha e zbatimit të ligjit”*.⁴⁴⁴

Vendimi nr. 00-2014- 1953 (224), datë 9.12.2014, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, arsyetohet se: *“Vërtetimi i disproporcionit midis aftësisë së nivelit të të ardhurave dhe vlerës së pasurisë që i përket personit mund të vlerësohet si tregues i aftësive për të fituar pasuri vetëm kur shoqërohet nga indicie të tjera, që e konfirmojnë dhe të lënë të besosh se pasuria është fryt i veprimtarisë së paligjshme, ndërsa kur ai nuk shoqërohet nga indicie të tjera, nuk mund të konsiderohet në vetvete si përcaktues i një dyshimi të arsyeshëm”*.⁴⁴⁵

Kriteret e vlerësimit të kushteve në mbështetje të kërkesës për konfiskim

Kërkesa për konfiskim pasuror kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të tre kushteve⁴⁴⁶ që lidhen sigurisht me të provuarit nga ana prokurorisë në kontradiktoritet të:

⁴⁴³Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, parashikon, në nenin 5/2, të tij se: *“Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit”*.

⁴⁴⁴Vendimin Nr. 00-2017-227 (48), datë 29.03.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

⁴⁴⁵Vendimin Nr. 00-2014- 1953 (224), datë 9.12.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë,

⁴⁴⁶Neni 24 i ligjit nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë “ ndryshuar me ligjin nr. 70/2017 datë 27.04.2017

- Pjesëmarrjes së personit në veprimtari kriminale, në veprat penale që përcakton ligji. Kjo duhet provuar në nivelin e dyshimeve të arsyeshme të bazuara në indicie. Nëse ka një nivel të provuari në nivelin e provës, përtej dyshimit të arsyeshëm është një nivel më i pranueshëm, që justifikon në mënyrë më legjitime kërkesën dhe vështirëson barrën e provës për personin.
- Rezulton e provuar se pasuria është drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave, që kanë kryer vepra penale në fushën e veprimit të ligjit duke e lidhur këtë me faktin rezultativ se çfarë nënkupton një nivel prove i lartë.
- Nuk është përmbushur barra e provës, për të provuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë nga ana e subjektit, i cili nuk arrin të përligjë zotërimin e pasurisë ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara.

Konfiskimi i pasurisë mund të bëhet edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit pushohet ose ai deklarohej i pafajshëm, me përjashtim të rastit kur fakti nuk ekziston, nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale. Në rastin kur rezulton se personi i dyshuar zotëron një numër pasurish, masa parandaluese pasurore nuk vendoset vetvetiu mbi të gjitha pasuritë e tij, por çmohet dhe vendoset vetëm për ato që, nga gjykimi, rezulton se nuk u justifikohet origjina, prejardhja e ligjshme. Kjo për shkak se nuk mund të përjashtohet mundësia, që një person i dyshuar sipas këtij ligji, të disponojë edhe pasuri të fituara në mënyrë të ligjshme.⁴⁴⁷

Gjithashtu, për gjykatën nuk mund të jetë i mjaftueshëm thjesht përfundimi se ekziston mospërputhje ndërmjet të ardhurave të personit të dyshuar dhe pasurive të fituara prej tij, për të çmuar se të gjitha pasuritë duhet të sekuestrohen dhe konfiskohen. Krahas kësaj, gjykata duhet të individualizojë, sipas rrethanave, në mënyrë të mjaftueshme, për efekte vetëm të procedimit parandalues edhe ekzistencën e një lidhje shkakësore të caktuar ndërmjet veprimtarisë kriminale të personit të dyshuar⁴⁴⁸ dhe përfitimit të pajustificuar ligjërisht të pasurisë prej tij. Në gjithë këto vlerësime ka rëndësi analizimi i të gjitha fakteve që lidhen me origjinën e pasurisë dhe të ardhurave e në veçanti akti i ekspertimit kontabël ose i vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Në këtë kuptim,

⁴⁴⁷ Neni 12/a parashikon dhe situatën kur vendoset sekuestrimi në rast se konstatohet se po bëhet një transferim.

⁴⁴⁸ Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë

pavarësisht nga parashikimet e ligjit, këto masa nuk mund të zbatohen nëse nga procedimi parandalues dhe gjykimi i kërkesës së prokurorit për vendosjen e tyre rezulton se, pasuria është fituar (*në mënyrë të justifikuar ligjërisht ose jo*), është vendosur në çdo mënyrë në zotërim të personit të dyshuar përpara kryerjes së veprës penale që i atribuohet apo për të cilin ai është dënuar (neni 3, pika 1 e ligjit).

Modeli i konfiskimit pasuror, që është zgjedhur nga ligjvënësi shqiptar, nuk e lidh mundësinë e vendosjes së saj si masë me ndonjë vendim penal të formës së prerë ndaj subjektit. Shqipëria bën pjesë në atë grup shtetesh që, në legjislacionin parandalues, njohin *konfiskimin e dhënë në mungesë të vendimit të dënimit*. Konfiskimi mund të vendoset edhe mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme, të bazuar në indicie për pjesëmarrje në veprimtari kriminale.⁴⁴⁹ Në praktikën shqiptare të zbatimit të konfiskimit si masë parandaluese pasurore kjo paraqet rast të rrallë, pasi zakonisht procedimet pasurore janë regjistruar duke pasur dënime për subjektet, ndaj të cilëve është vendosur sekuestrimi i pasurisë. Në praktikë është konstatuar se gjykata nuk bëjnë një dallim të qartë të konceptit të autonomisë së procedimit pasuror ndaj atij penal dhe se tashmë legjislacioni shqiptar njeh konfiskimin pa dënim.

Në një Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda⁴⁵⁰ arsyetohet se “*Gjatë procesit gjyqësor, pas paraqitjes së pretendimeve nga ana e kërkuarit, si dhe prapësimeve dhe pretendimeve nga ana e palës së paditur, kjo e fundit nuk arriti të justifikojë origjinën e ligjshme të llogarive të sekuestruara. Sipas provave të shqyrtuara dokumenteve bankare, llogarive bankare, ekstrakteve të këtyre llogarive, dokumenteve të marra nga dosja e procedimit penal dhe akteve të ekspertimeve kontabël, rezulton se llogaritë e sekuestruara janë pjesë e të ardhurave të pajustificuara të shtetasit K. I., nëpërmjet shoqërisë ALTD. Nga analiza e provave shkresore dhe të dhënave të pasqyruara në aktin e ekspertimit, rezulton se pasuritë objekt konfiskimi, nuk provohet se kanë prejardhje të ligjshme, pala e paditur nuk justifikon zotërimin e pasurive dhe të të ardhurave dhe se nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre. Në kushtet, që fitimi nga aktiviteti apo*

⁴⁴⁹ Neni 24/1 shkronja a) e ligjit nr. 70 / 2017 datë 27.04.2017 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pausurisë”.*

⁴⁵⁰ Vendimi nr. 14, datë 27.04.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

*veprimtaritë e ligjshme është zero, të ardhurat e krijuara janë të kundërligjshme, për shkak të dyshimit se nëpërmjet veprimtarisë është kryer vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal. Pra, ato dyshohet se kanë ardhura nga veprimtaria kriminale e pastrimit të produkteve të veprës penale”.*⁴⁵¹

Referuar veprimit prapaveprues në kohë të ligjit për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, pas ndryshimeve të vitit 2017, *kërkohen indicie të rëndësishme për përfshirjen në veprimtari kriminale të subjektit në kohën e vënies së pasurisë*. Ky është një standard më i lartë i provueshmërisë, pasi në vlerësimin tonë, në kuptim të provës, indiciet e rëndësishme, kur janë më shumë dhe përputhen me provat e tjera, barazohen në vlerë me provat e parashikuara nga ligji procedural. Në këtë aspekt, ndryshimet e ligjit përbëjnë një hap pozitiv. Në marrëdhëniet me procedimin penal ky ligj tashmë bazohet në procedurën penale, duke u mbështetur në rregullimet procedurale penale dhe duke lejuar mundësinë, që të përdoren të dhënat e marra gjatë procesit penal. Sigurisht, ky ndryshim ka pasur si qëllim rritjen e efektivitetit të procedimit pasuror dhe mundësinë e përdorimit të instituteve procedurale si mjete më të mira për të mbledhur të dhëna.

Të bazuarit në procedurën civile ishte një proces tërësisht i njëanshëm nga ana e prokurorisë, megjithëse ka diskutime në mes të juristëve dhe kryesisht avokatëve, se procedura civile ofronte shumë mundësi mbrojtjeje në favor të barrës së të provuarit. Procedimi penal ofron mundësi dhe garanci ligjore për procesin e rregullt ligjor, duke i dhënë mundësi personit, pasuria e të cilit është në procedim pasuror, për t’u vënë në dijeni si rezultat i veprimeve hetimore të pyetet dhe t’i merren deklarime, mbi bazën e të cilave ai mund të japë shpjegimet e nevojshme që në fazën e hetimit pasuror.

Formimi në kontradiktoritet i provës. Provat gjatë procesit penal formohen në kontradiktoritet gjatë debatit mes të palëve në gjykim. I njëjti parim vlen për procedurën e parandalimit pasuror dhe ndryshimin në mënyrën si zbatohet ajo në sekuestrim dhe konfiskim. Sekuestrimi është masë paraprake, zhvillohet në dhomë këshillimi nga gjyqtari dhe nuk ka kontradiktoritet. Ndërsa, gjatë shqyrtimi të kërkesës së konfiskimit zbatohen parimet e kontradiktoritetit dhe formimit të provës gjatë debatit gjyqësor. Gjyqtari në rastin e vlerësimit të deklarimeve/dëshmive të bashkakuzuarit

⁴⁵¹Vendimi nr. 14, datë 27.04.2016 i Gjatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, www.gjkr.gov.al

mund ta bazojë bindjen e vet mbi deklarata jo të besueshme *ictu oculi* ose të mohuara nga elemente të kundërt, ose mbi rrëfimin se kush ka arsye për të dyshuar se në dhënien e një deklarimi *contro alios* mund të jetë ndikuar nga arsye personale.

Kjo ka rëndësi në rastin e hetimit pasuror të pasurive të personave, subjekt të ligjit ose të lidhur me to, të cilët janë në proces gjyqësor penal/apo janë dënuar për vepra penale, në kuadër të krimit të organizuar në Shqipëri apo në vende të tjera. Në këtë rast, kompetente për hetimin pasuror është Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e cila ka një strukturë të specializuar për hetimin e krimit të organizuar, por dhe atij ekonomik,⁴⁵² si dhe ka aftësinë të operojë më shpejt me autoritetet e huaja për marrjen e informacioneve nëpërmjet letërporosive. Kjo Prokurori ka mundësi më të mëdha strukturore e infrastrukturore për shfrytëzimin e kapaciteteve të shumta që i jep procedimi penale i këtyre veprave penale për kryerjen e hetimeve të specializuara dhe për mbledhjen në kohë të të dhënave për procedimin parandalues. Prandaj ka mundësi për veprime hetimore më të shpejta e të specializuara. Kjo edhe për veprat penale të korrupsionit apo ato të kryera në detyrë nga funksionarët publik sipas kompetencës së nenit 75/a të KPrP.⁴⁵³

Gjatë konfiskimit, provat e paraqitura nga prokuroria i nënshtrohen shqyrtimit dhe zbatohen parimet e kontradiktoritet të vlerësimit të tyre, sikurse i kemi trajtuar më sipër. Prokuroria ka barrën e provës për pjesën e kërkimit dhe objektin e konfiskimit, siç shprehet dhe Gjykata e Lartë me

⁴⁵²Ligji nr. 95 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, sipas së cilit pranë Prokurorisë së Posaçme funksionon Byroja kombëtare e hetimit si dhe ka një sektor të veçantë për krimin ekonomik e atë financiar në përbërje të të cilit ka ekspertë financiarë.

⁴⁵³Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”): Veprat penale në kuadër të organizatave kriminale si neni 28 i Kodit Penal: Forma të veçanta të bashkëpunimit, neni 333 i Kodit Penal: Organizata Kriminale, neni 333/a i Kodit Penal: Grup i strukturuar kriminal, neni 334 i Kodit Penal: Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal. Veprat penale si atë të korrupsionit e të kryera për shkak të funksionit si neni 244 i Kodit Penal: Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 244/a i Kodit Penal: Korrupsioni aktiv i nënpunësve të huaj publikë, neni 245 i Kodit Penal: Korrupsioni aktiv i funksionerëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, neni 245/1 i Kodit Penal: Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, neni 257 i Kodit Penal: Përfitim i paligjshëm i interesave, neni 258 i Kodit Penal: Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, neni 259 i Kodit Penal: Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259/a i Kodit Penal: Korrupsioni pasiv i nënpunësve të huaj publikë, neni 260 i Kodit Penal: Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, neni 312 i Kodit Penal: Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit, neni 319 i Kodit Penal: Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, neni 319/a i Kodit Penal

Vendimin Unifikues nr. 1 datë, 25.01.2007. *“Por, për zbatimin e drejtë të ligjit, mbështetur në hetimet e kryera, edhe prokurori ka detyrime për të parashtruar kërtime të motivuara dhe prova mbështetëse përpara gjykatës, lidhur me identifikimin e pasurive të personit të dyshuar e të personave të tjerë, të tregojë nga ana e tij se ka bazë për dyshime të arsyeshme dhe, në këtë mënyrë të dhëna, prova të mjaftueshme për efekte të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, gjë që motivon ekzistencën e prezumimit që buron nga ligji nr.9284, datë 30.09.2004 dhe, si rezultat, kërkesën për zbatimin e masave pasurore të sekuestrimit, pezullimit të përkohshëm dhe konfiskimit, duke i kërkuar gjykatës t’i kalojë në këtë mënyrë edhe barrën e provës personave të dyshuar dhe personave të tjerë (neni 8, neni 13). Nga ana e saj, gjykata duhet të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të mbështetur në prova dhe në ligj”.*

Me Vendimin nr. 48 datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, është rrëzuar kërkesa e ankuesit ndaj vendimin të sekuestros duke u dhënë argumenti se sekuestro është një masë paraprake dhe ndaj saj ka mjete të tjera ankimi me vendimin përfundimtar. Gjyqtarët në pakicë në këtë Vendim arsyetojnë se: *“Jurisprudenca e brendshme, tregon se urdhrat e konfiskimit nuk mund të shtrihen te personat e tjerë të cilët janë pronarë së bashku me të dënuarit” dhe kërkon nga gjykatat të respektojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të anëtarëve të familjes së të dënuarit që tojejnë me të”. Vetëm në qoftë se konstatohet në procese civile të mëvonshme, pavarësisht nga konstatimet e bëra në procesin penal, se pasuria është fituar si produkt i krimit, por është regjistruar në emrat e personave të tjerë me synimin për ta fshehur atë nga konfiskimi, ankimi refuzohet. Në dritën e konsideratave të mësipërme, Gjykata konstaton se ankuesi “ka mbajtur një barrë individuale të tepërt”, e cila do të mund të ishte legjitime vetëm nëse ata do të kishin pasur mundësinë të sfidonin në mënyrë efektive masën e konfiskimit të vendosur në procesin penal në të cilin ata nuk ishin palë; megjithatë, kjo mundësi u është mohuar atyre në procesin civil të mëvonshëm dhe për këtë arsye “balanca e drejtë, që duhet të arrihet në mes të mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe kërkesave të interesit të përgjithshëm”, është cenuar (krahasoni Hentrich kundër Francës, vendimi i datës 22 shtator 1994, Seria A nr. 296 A, § 49)”.⁴⁵⁴*

⁴⁵⁴ Vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. www.gjk.gov.al

Gjatë përdorimit të procedurës civile, para ndryshimeve të vitit 2017, në ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, palët, subjektet paraqiteshin vetëm përpara Gjykatës, duke sjellë prova shkresore, të cilat nuk ishin në formën e duhur ligjore, gjë që i bënte formale dhe këto mundësi procedurale që ofronte kjo lloj procedure. Mbledhja e provave nga ana e prokurorisë bazuar në procedurën penale nënkupton hetimet e specializuara dhe të thelluara e në formën e duhur procedurale.

Referimi në procedurën penale e bën një ligj me natyrë penale pasi referon në zbatimin e të gjitha institutet procedurale penale, duke përcaktuar se cilat prova mund të paraqiten. Në aspektin e efektivitetit është një përmirësim, por pozita e subjektit dhe palëve të treta është më e kufizuar në drejtëm të mbrojtjes të të drejtës së pronësisë apo e mundësive procedurale të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë dhe të pozitës së personave të tretë.

4.9 Çështje ligjore dhe praktike mbi provat.

Zbatimi i ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, në raport me procesin e rëndësishëm të të provuarit dhe provat ku mbështetet sekuestrimi dhe konfiskimi pasuror kanë nxjerrë në pah disa çështje ligjore dhe praktike me interes për t'u trajtuar.

Së pari, mund të thuhet se në ligjin shqiptar mungojnë përcaktimet për sa i përket të llojit të të dhënës, dyshimit, bazës së mjaftueshëm dhe kriterëve, nga të cilat gjykatat duhet të nisen për vlerësimin e tyre. Si rregull, ligji duhej të kishte përcaktime të posaçme dhe vetëm në mungesë të tyre, të referohej tek dispozitat e tjera procedurale. Në mungesë të tyre, i referohemi rregullimeve procedurale penale, të cilat, gjithsesi, i japin avantazh prokurorisë për të mbështetur një kërkesë për konfiskim mbi të dhënat dhe provat e marra në kuadër të procedimit penal, por jo për një hetim pasuror të specializuar, proaktiv e të fokusuar vetëm në hetime pasurore. Nëse ligji do të parashikonte përcaktime përkatëse në lidhje me procedurën se si veprohet gjatë hetimit pasuror, atëherë do të kishte një normativë të posaçme dedikuar hetimit dhe gjykimit pasuror. Ligji referon në rregullat e procedurës penale dhe ky ka qenë qëllimi që hetimi të ishte efektiv, duke përdorur mjetet e kërkimit të provës, si përgjimet, sekuestrimet, këqyrjet kontrollet apo provat që janë marrë

gjatë procedimit penal. Në këtë kontekst, vlen të evidentojmë qëndrimin e GJEDNJ në çështjen Matanovic kundër Kroacisë, ku Gjykata shprehet se: “*Mungesa e një procedure efektive për të përcaktuar zbulimin e provave të mbledhura përmesurvejimit të fshehtë përbën shkelje të të drejtave të mbrojtura nga neni 6 i KEDNJ*”. Në interpretim të këtij Vendimi, lind diskutimi: a duhet ligji të përcaktojë qartë mënyrën e marrjes së provës së fshehtë, që lidhet me kufizimin e të drejtës private, nisur nga fakti se, tashmë, jemi në procedim pasuror e jo penal? Apo duhet të referojë tek dispozitat konkrete procedurale penale. A përbën shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor përdorimi i të dhëna që vijnë nga procedimi penal si përgjimet në një procedurë tjetër në kuadër të procedimit pasuror. Mjetet e kërkimit të provës të cilat çënojnë lirinë personale dhe privatësinë nuk mund të përdoren pavarësisht parashikimeve të nenit 10 të ligjit, pasi si të tilla ato në procedurën penale përdoren vetëm në rastin e procedimit penal ndaj personit kur mund të kufizohen të drejtat personale të privatësisë.

Në praktikën e zbatimit të ligjit tonë⁴⁵⁵, konstatohet se elementët e përcaktuar ligjorë të detyrimit për t’u provuar në standardin përkatës, si ato të pjesëmarrjes në veprimtari kriminale, posedimit të pasurisë apo regjistrimit të rremë e fiktiv, origjinës jo të ligjshme të pasurisë apo asaj të pajustificuar ligjërisht, nivelit të provueshmërisë për secilin fakt, nuk gjejnë argumentim për çdo rast të veçantë por trajtohen të gjitha njësoj. Një çështje ligjore, që rezulton nga praktika e gjyqësore, është ajo e vlerës së vendimeve të pafajësisë për vepra penale të prejardhura nga veprimtaria kriminale për të cilën ekziston dyshimi i arsyeshëm për përfshirje në veprimtari kriminale. Në praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimi penal, i cili ka shpallur të pafajshëm të pandehurin për veprën penale të “*Pastrimit të produkteve të krimit*” (neni 287 i KP), është konsideruar si “*provë e re*”, që duhet të sjellë detyrimisht rishikimin e vendimit të konfiskimit të pasurisë së përfituar nga një veprimtari tjetër kriminale dhe që në mënyrë derivative është dyshuar se është pastruar si produkt i krimit me disa investime të tjera.⁴⁵⁶ Në këtë vendim të Gjykatës së Lartë⁴⁵⁷ thuhet se: “*Nga të dhënat e mësipërme, përderisa të gjykuarit për akuzat në ngarkim të tyre janë deklaruar të pafajshëm me anë të një vendimi penal të formës së prerë, si*

⁴⁵⁵ Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.04.2017

⁴⁵⁶ Nr.00-2013-1548 i Vendimi (83) i datës 06.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mbi kërkesën e A.Sh., S.Sh. për rishikim vendimi të konfiskimit.

⁴⁵⁷ Vendimi nr. 1967 datë 23.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

dhe kur vetë ligji “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ligji mbi të cilën janë bazuar vendimet e gjykatave për konfiskimin e pasurive të të gjykuarve, nuk parashikon si rast përjashtimor konfiskimin e pasurive edhe kur personi shpallet i pafajshëm për shkak se fakti i pretenduar nga prokurori si fakt kriminal nuk përbën veprë penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se kërkesa e paraqitur nga të gjykuarit, nëpërmjet avokatit të tyre mbrojtës, duhet pranuar dhe të vendoset rishikimi i vendimeve penale të dhëna në ngarkim të tyre”.

Nga ky Vendim del se Gjykata e Lartë nuk ka interpretuar në mënyrë korrekte parimin e autonomisë së procedimit penal nga ai parandalues pasuruar, gjithashtu ka keqinterpretuar nivelin e kërkuar të provës në procedimin pasuror, duke vlerësuar provat e indiciet, që ekzistonin për pjesëmarrje të kërkuësve në veprimtari kriminale në shtetin grek,⁴⁵⁸ ndërsa vepra penale e “Pastrimit të parave” ishte regjistruar në Shqipëri e për të cilën kërkuësit kishin marrë pafajësi si veprën që derivonte nga ajo për të cilën ishin nën hetim në shtetin grek. Ndërkohë që gjykata e faktit⁴⁵⁹ e ka konfiskuar të ardhurat llogari bankare të kërkuësve duke argumentuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm se të pandehurit kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të qenieve njerëzore”, “Shfrytëzimit të prostitucionit”, “Krijimi të pjesëmarrjes në organizata kriminale”, sipas neneve 114, 114/b, 333, 333/a të KP. Për rrjedhojë, përmbushet kërkesa e neni 3/a germa a, c, d e ligjit nr. 10 192, duke konfirmuar konfiskimin e pasurisë së A.Sh. e S.Sh. edhe pas marrjes së vendimit të pafajësisë së tyre për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të krimit,” neni 297 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda duke lënë në fuqi këtë Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë arsyeton⁴⁶⁰ se “ekziston dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova se ata e kanë kryer veprën për të cilën po gjykohen në shtetin grek, ndaj tyre është në zbatim masa e sigurimit “arrest në burg”. Në këtë Vendim, Gjykata e Apelit shprehet se: “..gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Civile, Prokurori nuk mund të gëzojë tagrat e disponimit

⁴⁵⁸ Në këtë rast kërkuësit A.Sh. e S.Sh. po hetoheshin në shtetin grek për veprën penale të “Krijimit të organizatës kriminale”, “Trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim ushtrimin e prostitucionit” dhe “Pastrimit të parave” sipas neneve 187, 351, 323/a të Kodit Penal Grek.

⁴⁵⁹ Vendimi nr. 25 datë 10.12.2014 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁴⁶⁰ Vendimi nr. 10, datë 12.02.2015 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

mbi padinë, pasi në këtë rast pasuria e kërkuar për konfiskim nuk është pasuri e tij, e se interesi publik duhet të prevalojë në këtë rast". Në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë⁴⁶¹ gabon më tej kur arsyeton se "...ligji nuk ka parashikuar si rast përjashtimor konfiskimin e pasurive edhe kur personi shpallet i pafajshëm, për shkak se fakti i pretenduar nga prokurori si fakt kriminal përbën vepër penale", duke mos interpretuar drejt parimin e autonomisë së procedimit pasuror e duke mos pasur një koncept të qartë mbi standardin e provës për vërtetimin e pjesëmarrjes së personit në aktivitet kriminal.

Provat për të vërtetuar simulimin e regjistrimit të rremë të pasurisë

Procedimet pasurore të filluara ndaj subjekteve të rivlerësimit sipas ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve⁴⁶² (i ashtuquajtur i procesi i vetting) sollën një vlerësim të ri të fakteve që mund të përdoren në hetimin e pasurisë së simuluar. Me Vendimin nr. 8 datë 20.04.2021 të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është vendosur sekuestrimi i një pasurie apartament në emër të shtetasit L.D., e dyshuar në emër të B.D. Ndaj B.D. ishte regjistruar procedim pasuror, ndërkohë që ishte nën procedim penal për veprën penale të "Refuzimit për deklarim, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrim për deklarim", pasi B.D., funksionar publik i mbartur me detyrimin për deklarim, nuk ka deklaruar një apartament, që sipas Prokurorisë së Posaçme rezulton në emër të vëllait të tij, por përdorej nga subjekti, i cili kishte nënshkruar kontratat e furnizimit me energji elektrike me OSSHE, të furnizimit me ujë, paguante rregullisht detyrimet periodike dhe pagesat shënoheshin në librezat me emrin e tij. Si prova për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm, Prokuroria solli deklaratimet e mirëmbajtësit të kompleksit, kontrata të energjisë elektrike e të furnizimit me ujë, librezat përkatëse.⁴⁶³ Gjykata, në Vendimin e sekuestrimit, arrin në konkluzionin se: "Këto indicie janë të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm se kjo pasuri zotërohet efektivisht nga shtetasi B.D., pavarësisht regjistrimit formal në emër të të vëllait, me qëllim fshehjen, prezumimi

⁴⁶¹ Vendimi nr. 112, datë 24.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁴⁶² Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH"

⁴⁶³ Këto ishin konstatime të Vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili me Vendimin nr. 12, datë 17.12.2018 ka vendosur shkarkimin e subjektit nga detyra e gjyqtarit.

i regjistrimit të rremë në emër të personit në emër të të afërmit, shtetasit L.D. sipas shkronjës a, pika 2 i ligjit, zbatohet në këtë rast, pasi ka të dhëna të dobishme, të siguruara në mënyrë të ligjshme për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë. “Gjykata, në këtë rast citon edhe rezultatet e hetimit pasuror në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe ekspertimin kontabël të kryer po në kuadër të këtij procesi.”⁴⁶⁴

Kundrejt pretendimit në ankim se pagesa e energjisë elektrike nuk mund të shërbejë si fakt për të vërtetuar se kjo pasuri i përket subjektit ose frekuentimi disa herë i apartamentit në plazh gjatë kohës së pushimeve, Gjykata e Apelit të Posaçëm⁴⁶⁵ argumenton se sjellja e B.D. si pronar i sendit të sekuestruar, që nga krijimi duke lidhur kontratën për furnizimin me energji elektrike të këtij apartamenti si dhe pagesa e tarifës së administrimit për bashkëpronësinë e detyrueshme, kombinuar me përdorimin dhe gëzimin e sendit të paluajtshëm qetësisht dhe vazhdimisht duke përkuar dhe më të dhëna të tjera, si deklarime të administratorit të kompleksit, bën të zbatueshëm prezumimin e regjistrimit të rremë të kësaj pasurie në emrin e L.D.

Në një Vendim të Gjykatës së Lartë⁴⁶⁶ konstatohet se u tërhiqet vëmendje gjykatave të faktit në lidhje me faktin se vendimet e tyre bazohen *në hipotezën se në shumicën e rasteve, personat që e vënë pasurinë si rrjedhojë e një aktiviteti kriminal të kundërligjshëm, në mënyrë fiktive e kalojnë në emër të personave të afërm apo të besuar.*

Në një Vendim të Gjykatës së Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁴⁶⁷ arsyetohet se *“Të dhënat dhe provat e paraqitura nga prokuroria, që ka barrën e provës në gjykimin parandalues/preventiv për të vërtetuar se personi nën hetim pasuror përmbush kushtet dhe kriteret për t’u cilësuar si “person i dyshuar”, ndaj të cilit mund të zbatohet masa e parandalimit pasuror, në vlerësimin e kësaj gjykate justifikojnë ekzistencën e dyshimit që në këtë rast është “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova” për përfshirjen e Sh. në akt korruptiv”*

⁴⁶⁴ Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”

⁴⁶⁵ Vendimi nr. 132 datë 1.06.2021 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

⁴⁶⁶ Vendimi nr. 11 datë 22.01.2014 i Gjykatës së Lartë. www.gjykataelarte.gov.al

⁴⁶⁷ Vendimi nr. 230 datë 24.12.2020 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në lidhje me procesin e marrjes së provës në një Vendim të Gjykatës së Lartë⁴⁶⁸ argumentohet se: *“Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se vendimi i gjykatës së faktit, duke u mbështetur thjesht në një përshkrim narrativ të rrethanave të çështjes, pa marrë në shqyrtim provat dhe pa bërë analizë e tyre të marra në unitet, ka arritur në përfundimin e gabuar për sa i përket pranimit të kërkesës së prokurorit dhe lejitimit të sekuestrimit të shumës prej 30000 Euro”*.

Në lidhje me përcaktimin e objektit të të provuarit dhe detyrimet e prokurorit në një Vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁴⁶⁹ arsyetohet: *“Përcaktimi i sendeve, ndaj të cilëve merret masa parandaluese, duhet të jetë për çdo rast nominal, duke iu referuar rëndësisë dhe pasojës e indicjeve që ekzistojnë. Prokurori, në çdo rast ka për detyrë të identifikojë pasuritë, të cilat pretendohen se janë produkt i veprimtarisë kriminale të parashikuara nga neni 3 i ligjit. Prokurori në çdo rast i del detyrë që të paraqesë përpara gjykatës indicie të mjaftueshme për të provuar dyshimin se pasuria, për të cilën kërkohet masa parandaluese është krijuar nga një aktivitet kriminal nga ata që parashikon shprehimisht fusha e zbatuar e ligjit”*.

Në lidhje me arsyetimin e mjaftueshëm mbi “dyshimin e arsyeshëm” në një Vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁴⁷⁰ arsyetohet se: *“Gjykata e Shkallës së Parë, në kundërshtim me sa kanë pretenduar në ankim të paditurit dhe personat e tretë, i ka bërë një vlerësim të saktë dhe korrekt “provës bazë” të përdorur nga pala ankimese për të justifikuar ligjshmërinë e pasurive zotëruese, aktin e ekspertimit kontabël dhe shtesës së tij, duke e vlerësuar atë pa fuqi provuese dhe duke analizuar me hollësi mendimin e saj të kundërt me ekspertin”*.

Në një Vendim tjetër të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁴⁷¹ mbi analizën e provave arsyeton se: *“Gjykata e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke përsëritur shqyrtimin gjyqësor dhe duke urdhëruar dhe akt ekspertimi shtesë dhe pavarësisht pretendimeve, që lidhen me vlerësimin dhe marrjen e provave, nuk përbëjnë shkak të parashikuar nga neni 432 i KPrP, është evidentuar mungesa e një prej kushteve të parashikuar në nenin 24 të ligjit, të cilat janë kumulative e mungesës, qoftë e njërit prej tyre, shkakton paligjshmëri të konfiskimit”*.

⁴⁶⁸ Vendimi nr. 41 datë 16.03.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al

⁴⁶⁹ Vendimi nr. 112 datë 24.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al

⁴⁷⁰ Vendimi nr. 224, datë 09.12.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al

⁴⁷¹ Vendimi nr. 61, datë 29.02.2012 Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al

Në lidhje me pranimin si prova të shkresave të thjeshta pa vlerë provues në një Vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁴⁷² arsyetohet se “Gjykata e Apelit ,në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 259 të KPrC ka vlerësuar si prova në favor të palës së paditur disa shkresa private, të cilat sipas dispozitave ligjore të mësipërme nuk mundet, që në rastin konkret, të përbëjnë provë në favor të palës së paditur. Kontrata e huasë dhe deklaratat e personave, që i kanë dhënë nuk janë në formën e duhur ligjore noteriale, por në formën e shkresave të thjeshta private të rregulluara sipas nenit 258 të KPrC. Gjykata e Apelit ndryshe nga shkalla parë kontrata e huasë me shtetasit A.G. e G.H. dhe deklaratat e shtetasit A.H. i ka quajtur dokumente, që janë në kushtet e parashikimit ligjor të nenit 259 të KPrC dhe me pasojë provueshmërie duke u marrë në konsideratë për justifikimin e pasurisë së paligjshme” Ky rast praktik nxjerr në pah diferencën në trajtimin e provave në rastin kur zbatohet procedura civile sipas parashikimeve të ligjit të vitit 2009 dhe mungesa e një referimi të qartë në llojin e provës që përdoret në proceset parandaluese pasurore dhe vlera provuese e tyre.

Në përfundim të këtij kreu arrijmë në vërtetimin e hipotezave të ngritura në fillim të tij se:

- kemi një standard prove të veçantë në procesin e të provuarit në shqyrtimin e masave pasurore, një standard prove të ndryshëm e parime të veçanta, prandaj dhe në zbatimin e masave duhet të ndjekim kriteret e përcaktuara në ligj për provat, duke i plotësuar më pas ato me parimet e provave në procedurën penale.
- Ligji duhet të ketë rregullime të tjera, më të gjera për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e provave, të listohen provat, të cilat përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e veçantë me ligj, duke u dhënë këtë mundësi palëve e duke çliruar gjykatën nga detyrimi për të kryer veprime kryesisht hetimore.
- ligji duhet të parashikojë, në mënyrë të veçantë, të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen dhe vlerësimin e provave, të përcaktojë disa kriterë vlerësues të indicieve, elementët faktikë, provat rrethore e ato të marra pa kontradiktoritet.
- procedura penale nuk është e mjaftueshme për hetimin dhe gjykimin pasuror
- procedura civile jep më shumë mundësi e instrumente procedurale për gjykimin pasuror.

⁴⁷² Vendimi nr. 134, datë 15.02.2018 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. www.gjykataelarte.gov.al

- një ligj me të gjitha elementet e veçantë rregullatorë *sui generis* dhe për çështjet e provave e të të provuarit.

KREU V

BARRA E PROVËS, KONTRADIKTORITETI DHE MBROJTJA E INTERESAVE TË TË TRETIT NË MIRËBESIM GJATË KONFISKIMIT

Përmbajtja 5.1. Hyrje 5.2. Barra e provës - onus probandum - si tipar i veçantë i konfiskimit si masë parandaluese pasurore 5.3. Kontradiktoriteti në gjykim dhe mundësitë procedurale në funksion të përmbushjes së barrës së provës, 5.4. Provat për justifikimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë, mundësitë e marrjes e paraqitjes së tyre 5.4.1. Të ardhurat e padeklaruara në organet tatimore, huatë, dëshmitë, ekspertimet private dhe konsulenca teknike 5.5. Mbrojtja e interesave të të tretëve në mirëbesim dhe barra e provës, garancitë për mbrojtjen e pasurisë së ligjshme. 5.5.1 Pozita procedurale e personave të tretë, veçanërisht e kreditorëve dhe bankave, interpretime të ligjit në praktikën gjyqësore 5.5.2 Gjetje të praktikës gjyqësore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, me fokus mbrojtjen e interesave të personit të tretë. 5.6. Vlerësimi i provave gjatë gjykimit të kërkesave për konfiskim pasurie në funksion të barrës së provës, dallimi mes procedurës civile e penale 5.6.1. Kriteret e vlerësimit të kushteve për konfiskim, kur gjendet e provuar kërkesa për konfiskim të pasurisë 5.7. Çështje të ligjit dhe të praktikës gjyqësore.

5.1. Hyrje

Devijimi i barrës së provës, në lidhje me justifikimin e origjinës së ligjshme të të ardhurave dhe pasurisë nga shteti tek subjekti, pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet, është një nga tiparet e veçanta të konfiskimit si masë parandaluese pasurore. Që të përmbushet ky detyrim për barrën e provës (*onus probandum*) kërkohet zbatimi i një procedure kontradiktore gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim, në kushtet e barazisë së armëve mes prokurorisë, që kërkon konfiskimin dhe subjektit, që duhet të justifikojë pasurinë e ligjshme të tij. Instrumente procedurale për këtë ndryshojnë sipas procedurës, barra e provës për palën është një element tipik i së drejtës procedurale civile, ndërsa në rastin e procedurës së konfiskimit sipas ligjit shqiptar zbatohet procedura penale. Megjithatë, procedura penale shqiptare është e bazuar në parimet e një sistemi akuzator, që garanton barazinë e palëve, të drejtën e mbrojtjes, kontradiktoritetin.

E rëndësishme është që në këtë hapësirë personi/i afërmi/bashkëpunëtori pasuria ,e të cilit kërkohet të konfiskohet të ketë mundësinë të përdorë instrumente ligjorë të ligjit dhe të legjislacionit procedural për të paraqitur prova, kërkuar këqyrjen e ekspertimeve, thirrjen e dëshmitarëve, marrjen e provave, akteve shkresore në institucione bankare e të regjistrimit të pasurisë, në mënyrë që të vërtetojë e të provojë të ardhurat e ligjshme. Në procesin e të vërtetuarit të fakteve mbi pasurinë e ligjshme e të prejardhjes së ligjshme të pasurisë mund të paraqiten prova nga ato që parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Në praktikën gjyqësore çështjet e diskutueshme janë mënyra se sesi do të trajtohen kërkesat për marrjen si provë të ekspertimeve kontabël, të kryera nga subjektet jashtë procedimit pasuror, konsulentët teknikë e financiarë, thirrja e personave të tretë, kontratat noteriale mbi huatë ose detyrimet kur ato nuk kanë gjurmë në kanalet bankare etj.; nga cilat kritere duhet të niset gjykata për të vlerësuar vlerën provuese të tyre.

Një çështje delikate e zbatimit të ligjit është mbrojtja e interesit pasuror të të tretëve në raport me detyrimin për përmbushjen e barrës së provës, garancitë që ofron ligji për mbrojtjen e kreditorëve, huadhënësve apo familjarëve e të afërmeve, të cilët kanë kontribuar në krijimin e pasurisë, që kërkohet të konfiskohet. Këto çështje trajton ky kre i rëndësishëm i punimit tim.

Në këtë kre, janë ngritur disa hipoteza si më poshtë:

- A u jep mundësi ligji shqiptar dhe referimi në rregullat e procedurës penale palëve për mbrojtje, për shkak të devijimit të barrës së provës,
- A mbron ligji interesat e të tretëve e sidomos të kreditorëve,
- A siguron referimi në procedurën penale instrumentet e nevojshme procedurale për mbrojtjen e interesit pasurore të shtetasve,
- A e siguron më mirë këtë procedura civile apo duhet një ligj me elemente të plotë rregullatorë *sui generis* dhe për çështjet e provave dhe të të provuarit,
- A janë të nevojshme shtesa e ndryshime ligjore për të konfirmuar standardet ndërkombëtare.

5.2. Barra e provës (*onus probandum*) - si tipar i veçantë i konfiskimit si masë parandaluese pasurore.

Procedimi pasuror *in rem* në Shqipëri adaptoi tiparin e konfiskimit civil, atë të devijimit të barrës së provës për justifikimin e origjinës së ligjshme të pasurisë tek personi, pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet. Ky është një tipar i veçantë i ligjit tonë, që nuk korrespondon me parimet e procesit penal, por që ngjason më tepër, në këtë rast, me atë procedural civil. Ishte Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Lëndëve Psikotrope,⁴⁷³ që sugjeroi përmbyshjen e barrës së provës, ruajtjen e interesave të të tretëve dhe përputhshmërinë formale të parashikimeve të saj me rregullimet e së drejtës së brendshme⁴⁷⁴, duke sugjeruar një përmbyshje të vlerësimit të provave në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera të deklaruara që i nënshtrohen konfiskimit. Edhe legjislatori ynë si ai i shumë vendeve të tjera, plotësoi këtë sugjerim nëpërmjet parashikimit të masave të konfiskimit civil e devijimit të barrës së provës tek personat që zotërojnë pasurinë.

Jo të gjitha sistemet e kanë pranuar përmbyshjen e barrës së provës p.sh., në ligjin italian nuk është pranuar përmbyshja e barrës së provës pasi ajo ndalohej nga Kushtetuta Italiane. Sistemet anglo-saksone dhe shumica e vendeve të sistemit kontinental kanë sanksionuar devijimin e barrës së provës duke ia ngarkuar atë personit, pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet. Mbështetja legjitime ndaj prezumimeve për të identifikuar origjinën e paligjshme të pasurisë bën edhe jurisprudenca e GJEDNJ⁴⁷⁵, dhe parashikohet shprehimisht nga legjislacioni i Bashkimit Evropian⁴⁷⁶ në idenë që mund të ketë një përmbyshje të vërtetë të barrës së provës mbi ligjshmërinë e prejardhjes së sendit dhe nëse përmbyshja ekziston, kjo nuk do t'i shpëtojë kontrollit kushtetues.

⁴⁷³ E quajtur ndryshe dhe Konventa e Vjenës 1988, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8722 datë 26.12.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope."

⁴⁷⁴ Në paragrafin 7 të nenit 5⁴⁷⁴ thuhet se "Shtetet palë duhet të kenë parasysh se mund të ndodhë një përmbyshje e vlerësimit të provave në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera të deklaruara që i nënshtrohen konfiskimit, në atë masë që ky veprim të jetë në përputhje me parimet e ligjit të vendit të vet dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të interpretohen sikur dëmtojnë të drejtat e palëve të treta që janë në mirëbesim. Gjithsesi, Konventa bën kujdes të garantojë moscenimin e parimit se masat, për të cilat ai bën fjalë, duhet të përkufizohen e të zbatohen në përputhje me ligjet vendase".

⁴⁷⁵ Vendimi Cacucci dhe Sabatelli kundër Italisë, 17 qershor 2014

⁴⁷⁶ Direktiva e Parlamentit Evropian nr. 2014/42 e BE, e miratuar më 25 shkurt 2015

Në qëndrimet e deritanishme të GJEDNJ nuk ka pasur kundërshtim lidhur me barrën e provës në konfiskimin civil.⁴⁷⁷ Në rastet kur ndonjë instancë gjyqësore e ndonjë shteti evropian ka vënë në diskutim devijimin e barrës së provës kjo nuk ka shkuar për diskutim deri në GJEDNJ.⁴⁷⁸ Vlen për tu përmendur iniciativa ligjor e vitit 2014 e disa ligjvënësve amerikanë⁴⁷⁹ për të rritur barrën e provës në rastin e konfiskimit të aseteve, duke detyruar autoritetet të mbledhin prova sipas standardit të provës së qartë, bindëse para se të kërkojnë konfiskimin e një pasurie, duke i lënë pronarit të saj vetëm barrën për ta justifikuar atë.

Devijimi i barrës së provës si përcaktim kushtetues u njoh në Kushtetutën tonë në ndryshimet e saj në lidhje me reformën në drejtësi të vitit 2016⁴⁸⁰ tek aneksi për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Sh., në kuadër të reformës në drejtësi me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve, që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36, 37, dispozitat që lidhen *me barrën e provës*, nenet 128, 131, nënparagrafi f, 135, 138, 140, 145 paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi b), 149, paragrafi 1, nënparagrafi b), kufizohen pjesërisht sipas nenit 17 të Kushtetutës.

Devijimi i barrës së provës për justifikimin e pasurisë së ligjshme nga akuza tek subjekti e dallon procedimin pasuror nga ai penal. Në procedimin penal është prokurori, i cili ka barrën e provës për të provuar *“tej dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova”*, faktet në lidhje me fajësinë e të pandehurit. Në të drejtën penale barra e provës derivon nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Kush pretendon një akuzë duhet ta provojë atë, parimi *actori incubit probatio*. Rregulli mbi barrën e provës rrjedh nga parimi latin *onus probandi incumbit ei dicit*, nga detyrimi që rëndon mbi gjyqtarin në të gjitha sistemet moderne procedurale për të kërkuar në çdo rast shkakun e kërkimit,

⁴⁷⁷ Reversal of the burden of proof in confiscation of the proceeds of crime: a Council of Europe Best Practice Survey, (Best Practice Survey No. 2), PC-S-CO (2000) 8 Rev Council of Europe, European Committee of Crime Problems, Strasbourg 25 May 2000.

⁴⁷⁸ Gjykata e Lartë Belge, Vendimi i 18 shkurtit 1998, Proces & Bewijs 1998, dhe Gjykata e Apelit të Benjafield në Angli në Vendimin e 21 dhjetorit 2000, vunë në diskutim përputhshmërinë e përmbysjes së barrës së provës në rastin e konfiskimeve me frymën e nenit 6 të KEDNJ.

⁴⁷⁹ Amendamenti i Pestë i Aktit të Rivendosjes së Integritetit i vitit 2014, projektligji i Senatit i quajtur Akti Fair (*The Fifth Amendment Integrity Restoration Act of 2014*)

⁴⁸⁰ Ligji nr. 76/2016 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8417 “Kushtetuta e RSH” Aneksi “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve” neni A, Kufizimi i të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta

në pamundësi për të shmangur detyrimin për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Si rregull, barra e provës u takon atyre që kërkojnë të zbatojnë ligjin në favor të tyre.⁴⁸¹

Barra e provës është tipike për procesin procedural civil sipas parimit se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj. Kjo përcakton parimin e barrës së provës (*onus probandum*), që karakterizon dialektikën e procesit gjyqësor civil, pasi kush pretendon një fakt të caktuar, logjikisht ka ardhur në dijeni të këtij fakti ndaj dhe e pretendon e për rrjedhojë ka mundësi të tregojë provat, të cilat e provojnë këtë fakt. Nëpërmjet barrës së provës bëhet e mundur që të përcaktohet se cila nga palët ndërgjyqëse duhet të marrë masa për paraqitjen e provave gjatë gjykimit, nëse dëshiron të vërtetohen pretendimet e saj të ngritura para gjykatës. Në të drejtën procedurale civile barra e provës për faktet formuese ose krijuese të marrëdhënies juridike apo së drejtës i përket paditësit. Faktet penguese, ndryshuese apo shteruese duhet të provohen nga i padituri.⁴⁸² Një tipar të tillë ka barra e provës për personin që duhet të justifikojë pasurinë e ligjshme të tij. Duke u konsideruar konfiskimi civil pasuror jo si një masë dënimi, por një masë pasurore është pranuar përmbysja e barrës së provës për tek pronari/poseduesi i pasurisë, që kërkohet të konfiskohet, në kuptimin se është pikërisht ai që di faktet mbi prejardhjen, origjinën, të ardhurat e faktet, që justifikojnë ligjshmërinë e vënies së pronës.

Sipas ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese, është parashikuar përmbysja e barrës së provës për justifikimin e pasurisë së ligjshme tek subjekti i ligjit. Barra e provës për këtë sipas ligjit tonë u ngarkohet:

1. Personave, të cilët zotërojnë pasuritë nën sekuestrim ose jo, plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të cilët dyshohen për kryerje të veprave penale në fushën e zbatimit të ligjit⁴⁸³, *kanë barrën për të provuar se veprimtaritë e pasuritë e sekuestruara, të zotëruara pjesërisht ose plotësisht prej tyre janë fituar nga burime të ligjshme.*⁴⁸⁴

⁴⁸¹ Micheli, GA, The burden of Proof, rest. Padua, 1966.

⁴⁸² Flutura Tafaj, Asim Vokshi: Procedurë Civile, Pjesa I, Botimi II, Fakulteti i Drejtësisë i UT, 2018, fq. 527

⁴⁸³ Neni 3 paragrafi 1 i ligjit “Fusha e zbatimit” përcakton personat për pasurinë e të cilëve vepron ligji.

⁴⁸⁴ Nën nenin 21/3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

2. Personat e afërm (*bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi*), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, kanë barrën për të provuar që pasuritë, për të cilat kërkohet konfiskimi, zotërohen me titull pronësie vetëm prej tyre, janë fituar nga burime të ligjshme dhe nuk janë në pronësi të tërthortë të personave të përmendur në nenin 3, pika, 1 të ligjit.⁴⁸⁵
3. Personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e subjektet e ligjit ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre, kanë barrën e provës për të treguar se të dhënat e siguruara gjatë procedimit pasuror janë të pamjaftueshme për të vërtetuar se veprimtaritë e pasuritë e tyre ;
 - a. Zotërohen tërësisht ose pjesërisht , në mënyrë të tërthortë , nga ana e personave subjekte të ligjit.
 - b. Janë përdorur, kanë lehtësuar ose kanë ndikuar, në një formë të caktuar, në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga ana e personave subjekt të ligjit⁴⁸⁶

Pozicionit të të dyshuarit për përfitim të kundërligjshëm të pasurisë nga pozicioni i palëve të treta dallon në këtë procedim. Edhe mes personave që lidhen me subjektin të afërm dhe subjekteve të tjera fizike ose juridike, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se zotërojnë pasuri në emër të të dyshuarit ka ndryshime⁴⁸⁷ Barra e provës, që i përket prokurorit dhe barrës së provës që i përket personit, pasuria e të cilit konfiskohet është e ndryshme; prokurorit i përket detyrimi për të provuar se pasuria është në emër të personit, se personi dyshohet për veprimtari kriminale ose se pasurinë e ka regjistruar në emër të të tjerëve. Adaptimi i përmbysjes së barrës së provës, si parim i procedimit pasuror, nuk do të thotë se prokurori ka rol pasiv në procedurën e të provuarit të kushteve të konfiskimit, përkundrazi, ai ka detyrimin dhe barrën e provës, të vërtetojë se personi

⁴⁸⁵ Neni 21 paragrafi 4 i ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit , korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

⁴⁸⁶ Paragrafi 5 i nenit 21 të ligjit nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit , korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

⁴⁸⁷ Ndryshimet me ligjin nr. 70/2017 në nenin 21 të ndryshuar, qartëson ndryshimin e barrës së provës në lidhje me pasuritë e personave të përmendur në nenein 3/1 (të dyshuar për vepra penale) nga ata që përcaktohen në nenin 3/2 (pronar fiktiv) siç përshkruhet në shkronja “a” dhe “b”.

është i përfshirë në veprimtari kriminale dhe se ai zotëron një pasuri të caktuar ose personat e tij afërm.

Konfiskimi vendoset nëse plotësohen tre kushtet kumulative të përcaktuara nga neni 24 i ligjit⁴⁸⁸

- Ka dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie për pjesëmarrje të personit në veprimtari kriminale
- Rezulton se pasuria është drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave
- Nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme apo personat subjekte të këtij ligji, nuk arrijnë të përligjin zotërimin e pasurive ose të ardhurave të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre.

Dy kushtet e para duhet të vërtetohen në seancën e konfiskimit mbi bazën e detyrimit që ka prokurori për të sjellë fakte e prova, pra barra e provës i përket prokurorit. Ndërsa të provuarit e prejardhjes së ligjshme të të ardhurave e pasurisë është barrë prove për subjektin e ligjit, personin pasuria e të cilit kërkohet të sekuestrohet. Prokurori duhet të tregojë në gjykatë arsyet ku bazohet kërkesa për konfiskim⁴⁸⁹; se subjekti, zotërues i pasurisë është i përfshirë në veprimtari kriminale dhe që pasuritë ndahen në pronësi të tij. Nëse prokurori arrin të vërtetojë se ndaj një personi ka një procedim penal, masa sigurimi, apo një vendim dënimi për njërën nga veprat penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 të ligjit, atëherë kjo përbën provë me vlerë të plotë për të vërtetuar para gjykatës “*dysheimin e arsyeshëm të bazuar në prova*” për kryerjen e këtyre veprave penale, pra subjekti i procedimit penal ka edhe cilësitë e “*personit të dyshuar*”.

Prokurori ka barrën e provës për të vërtetuar në gjykatë se një person në hetim ose i dënuar përmbush kushtet për t’u cilësuar si “*person i dyshuar*” për kryerjen e veprave penale të parashikuara në fushën e veprimit të ligjit. Prokurori ka detyrime për të parashtruar kërkime të motivuara dhe prova mbështetëse përpara gjykatës, lidhur me identifikimin e pasurive të personit

⁴⁸⁸ Neni 24, Pranimi i kërkesës për konfiskim

⁴⁸⁹ Neni 21 i ligjit “Konfiskimi i pasurisë vendoset me kërkesë të prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa”

të dyshuar e të personave të tjerë, të tregojë nga ana e tij se ka bazë për dyshime të arsyeshme dhe, në këtë mënyrë të dhëna, prova të mjaftueshme për efekte të gjykitimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, gjë që motivon ekzistencën e prezumimit që buron nga ligji dhe si rezultat, kërkesën për zbatimin e masave pasurore të sekuestrimit, pezullimit të përkohshëm dhe konfiskimit, duke i kërkuar gjykatës t'i kalojë në këtë mënyrë edhe barrën e provës personave të dyshuar dhe personave të tjerë (neni 8, neni 13). Nga ana e saj, gjykata duhet të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të mbështetur në prova dhe në ligj.

Në procedimin parandalues mjafton të vërtetohet dyshimi i arsyeshëm për qenien si “*person i dyshuar*”, mundësia e zotërimit të pasurive prej tij dhe mos justifikimi i prejardhjes së ligjshme të këtyre pasurive, në raport me veprimtarinë, sjelljen, të ardhurat dhe mënyrën e jetesës, me kohën dhe llojin e veprës që i atribuohet, apo vërtetohet se ka kryer personi i dyshuar. Në gjykimin dhe dhënien e vendimit për vendosjen e masave pasurore, gjykata nuk mund t'i hyjë bazueshmërisë së përfundimeve, të nxjerra gjatë në procedimin penal lidhur me ato elemente, të cilat, në fakt justifikojnë vendosjen e masës preventive pasurore, veçanërisht përsa i përket kualifikimit të personit si “*person i dyshuar*”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendimin unifikues nr.1, datë 25.01.2007,⁴⁹⁰ mbajtën qëndrimin se: “...*personi i dyshuar (neni 3, pika 1) dhe personat e tjerë (neni 3, pika 2 dhe neni 8) kanë barrën e provës për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurisë së tyre, për të provuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale a investim të tyre dhe, vetëm për “personat e tjerë” të provojnë se, jo vetëm nga pikëpamja formale, por edhe në fakt, nuk jemi përpara zotërimit në çdo mënyrë të këtyre pasurive prej personit të dyshuar*”. Barra qëndron mbi kërkuesin që të provojë origjinën e ligjshme të pasurisë në mënyrë rigoroze pa pasur mundësinë të pretendojë se pasuria vjen nga të ardhurat, të cilat nuk janë deklaruar të paverifikueshme.⁴⁹¹ Për personat e përmendur në nenin 3/2 shkronja “a”⁴⁹² parashikohet se ekziston prezumimi ligjor i zotërimit në emër të kërkuesit duke vënë ndaj tyre barrën e provës për

⁴⁹⁰Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1 datë, 25.01.2007 mbi kërkesën e Prokurorisë së Krimve të Rënda për konfiskimin e pasurisë së shtetasit Xh. T.

⁴⁹¹Neni 24 i ligjit prashikon kriteret mbi të cilat vendoset konfiskimi duke përfshirë edhe këtë si çështje.

⁴⁹²Personat e afërm për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta.

të provuar të kundërtën, pra që ata kanë të ardhura të mjaftueshme për të blerë pasuri të caktuara. Barra e provës për të provuar origjinën e ligjshme të pasurisë së sekuestruar në zotërimin të drejtpërdrejtë ose indirekt prej tyre u përket të afërmeve të subjektit siç shprehet në paragrafin 3 të nenit 21 të ligjit i ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë⁴⁹³

Lidhur me diskutimin nëse është e pranueshme të ngarkosh me barrë prove një person tjetër jashtë procedimit pasuror, i referohemi natyrës së konfiskimit si masës pasurore e jo personale, pasi vetëm përgjegjësia personale është e lidhur ngushtësisht me pozicionin procedural të personit. Në këtë rast, ligji sanksion parimin e prezumimit të regjistrimit fiktiv apo të rremë të pronës dhe mjaftohet me ngarkimin e barrës së provës pronarit ligjor. Ligji trajton pasuritë e atyre personave që *prima facie* nuk i përgjigjen situatës ekonomike të personit⁴⁹⁴ dhe kanë një vlerë proporcionale me të ardhurat legjitime të deklaruar dhe blerja e pasurisë nuk është e justifikuar ashtu siç përcaktohet në nenin 11, pjesa e parë dhe nenin 24/1 të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë⁴⁹⁵

Kjo është formë e konfiskimit të zgjeruar që ngjason me modelin e vendeve, të cilat përfshijnë të gjithë pasurinë me origjinë të paligjshme, që mund të mos jenë më vlerë proporcionale krahasuar me të ardhurat e deklaruar për qëllime tatimore ose veprimtari ekonomike, që mund të rezultojnë në deklarata të manipuluar financiare dhe që nuk përputhen më të ardhurat aktuale. Gjyqtarët, në interpretimin e këtij kriteri, kërkojnë medoemos justifikimin e dokumentuar të të ardhurave të ligjshme dhe përdorimin e tyre për të blerë një pasuri të caktuar. Paratë, gjithmonë, lënë gjurmë, sidomos shumat e mëdha, prandaj, kushdo që i ka përdorur mund të justifikojë zotërimin dhe përdorimin konkret të tyre.

⁴⁹³ Personat e përmendur në nenin 3, pika 1 të këtij ligji (*të afërmit*), kanë barrën për të provuar se pasuritë, për të cilat kërkohet konfiskimi, zotërohen me titull pronësie vetëm prej tyre dhe janë fituar në mënyrë të ligjshme.

⁴⁹⁴ Neni 2 "*përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale*".

⁴⁹⁵ Gjykata vendos sekuestrimin e pasurisë kur ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicie, që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura shpërpjestimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtaria e ligjshme, e deklaruar dhe që nuk përlligjen prej tyre. Rezulton se pasuria është drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjeshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1 të këtij ligji. (*të afërmit*).

Origjina e ligjshme nuk mund të provohet pa paraqitur dokumente të rëndësishme ose vetëm në prani të elementëve të tjera “*të momentit*” të bazuara në faktin që shumica e ekonomisë shqiptare është informale. Personat e afërm të subjektit të ligjit kanë barrën e provës për të provuar që pasuritë e sekuestruara janë pronë e tyre ekskluzive dhe nuk janë në pronësi të subjektit të ligjit, pra persona e të dënuar apo të dyshuar për kryerje të një vepre penale.⁴⁹⁶ Ndërsa personat fizikë ose juridikë, që kanë lidhje biznesi ose bashkëpronësie me subjektet e ligjit kanë barrën e provës për të treguar që elementet e nxjerrë gjatë procedimit nuk janë të dhëna të mjaftueshme që veprimtaria ose pasuritë e tyre janë poseduar pjesërisht ose tërësisht, në mënyrë indirekte ose janë përdorur në kryerjen e veprimtarive të paligjshme nga subjektet e ligjit.⁴⁹⁷ Në disa raste të gjykimit të kërkesës për konfiskim nga ana e gjykatave janë konsideruar të justifikuar pasuritë e blera edhe në mungesë të dokumenteve ose në prani të elementëve të tjerë “*kontradiktorë*” ose kanë deklaruar se paratë e përdorura për të blerë pasurinë kanë rrjedhur nga evazioni fiskal.

Përsa i përket ndarjes së barrës së provës ndërmjet palëve të procedurës parandaluese në lidhje me origjinën e paligjshme të pasurive, që i nënshtrohen propozimit pasuror, praktika gjyqësore italiane në një Vendim të Seksioneve të Bashkuara⁴⁹⁸ kanë theksuar se: “*barra e provës, në lidhje me disproporcionin i takon palës publike ndërmjet pasurive dhe kapaciteteve të të ardhurave si dhe origjinës së paligjshme, të vërtetohet edhe mbi bazë të prezumimeve, ndërkohë që kërkuessit i njihet e drejta për të ofruar prova të kundërta*”

Në mënyrë që të bëhet një konfiskim, mjafton të kemi disproporcion midis disponueshmërisë dhe të ardhurave të raportuara nga propozimi ose të dhëna të përshtatshme për të lejuar që në mënyrë të arsyeshme të konkludohet se pasuritë, për të cilat kërkohet konfiskimi, përbëjnë ripërdorimin e të ardhurave të veprimtarive të paligjshme dhe që propozuesi nuk ishte në gjendje ta provonte origjinën legjitime të parave të përdorura për blerjen e këtyre aseteve. Supozimi i origjinës së paligjshme të aseteve duhet të jetë gjithmonë i dalë nga një proces provues, i cili përdor prezumime të besuara të elementeve rrethanorë, me kusht që të karakterizohet nga elementët nevojshëm të rëndësishëm, saktësisë dhe përputhshmërisë. Për përmbushjen e barrës së provës, të vendosur për

⁴⁹⁶ Këtë detyrim e përcakton paragrafi 4 i nenit 21 “Konfiskimi i pasurisë”.

⁴⁹⁷ Paragrafi 5 i nenit 21 “Kërkesa për konfiskimin e pasurisë dhe barra e provës”

⁴⁹⁸ Cass, S.U., 26 giugno 2014 – 2 febbraio 2015, nr. 4880) Spinelli e altro, Rv. 262604

personin e prekur, mjafton vetëm pretendimi i fakteve, situatë ose ngjarje, aty ku janë të verifikueshme, janë të mjaftueshme të përshtatshme, në mënyrë të arsyeshme dhe të besueshme për të treguar origjinën e ligjshme të aktivitetit.⁴⁹⁹

5.3. Kontradiktoriteti në gjykimin e konfiskimit dhe mundësitë procedurale në funksion të përmbushjes së barrës së provës.

Konfiskimi si fazë finale e procedimit pasuror ka në themel të tij kontradiktoritetin si element thelbësor të procesit të drejtë gjyqësor. Detyrimi për përmbushjen e barrës së provës mund të realizohet vetëm në një procedurë kontradiktore. Sikurse është theksuar, në procedurën e konfiskimit parandalues përdoret procedura penale, ndërkohë që përmbysja e barrës së provës korrespondon me natyrën e procesit gjyqësor civil. Prandaj është e rëndësishme që në kushtet e zbatimit të ligjit të qëmtojmë në të gjitha mundësitë që ai jep për përmbushjen e elementit kontradiktor gjatë marrjes dhe debatit mbi provat, ndërkohë që ato mund të paraqiten në një standard më të ulët sesa ai që kërkohet për provat në procedurat respektive. Në ligj⁵⁰⁰ sanksionohet qartë se konfiskimi i pasurisë vendoset me kërkesë të prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa. Gjykata vendos pas kryerjes së hetimit gjyqësor, pasi dëgjon diskutimin dhe parashtrimet përfundimtare të palëve. Hetimi gjyqësor realizohet pikërisht në debat e kontradiktoritet, në këtë fazë merren provat e dëgjohen pretendimet e palëve mbi to.

Përmbushja e detyrimit për barrën e provës mund të bëhet vetëm në kushtet e dhënies së mundësisë për subjektin, i cili në kontradiktoritet të paraqesë provat e tij. Ligji e rregullon këtë në dispozitën që parashikon hetimin gjyqësor nga gjykata.⁵⁰¹ Hetimi gjyqësor referohet në rregullat e procedurës penale⁵⁰². Kjo nënkupton të drejtën e mbrojtjes, fazën e verifikimit të fuqisë provuese të fakteve e provave të paraqitura nga palët, debatin mbi to, mundësinë për të marrë prova të reja për të thirrur dëshmitarë. Personi/subjekt i ligjit për të provuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë duhet të ketë

⁴⁹⁹ A.M. Maugeri, *Le moderne sanzioni patrimoniali tra funzionalità e garantismo*, Milano, 2001, 122 ss.; AA. VV., *La giustizia patrimoniale penale*, Torino, 2011; F. Mendo, *Le confische nella prevenzione e nel contrasto alla criminalità "da profitto" (mafie, corruzione, evasione fiscale)*, in questa Rivista, 2 febbraio 2015.

⁵⁰⁰ Neni 21 paragrafi 1 i ligjit nr. 10 129 i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017

⁵⁰¹ "Neni 21 "Kërkesa për konfiskim dhe barra e provës" parashikon se "Gjykata vendos pas kryerjes së hetimit gjyqësor dhe pasi dëgjon diskutimin përfundimtar të palëve".

⁵⁰² Neni 22 "Procedura gjyqsore e konfiskimit" parashikon se: "Gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale".

kohën e nevojshme për t'u njohur me kërkesën, me provat e faktet, mbi të cilat bazohet kërkesa për konfiskim.

Neni 21 i ligjit, i cili rregullon kërkesën për konfiskim dhe barrën e provës, pësoi ndryshime të rëndësishme në ndryshimet e vitit 2017, pasi sipas parashikimeve të pika 1 të këtij neni kërkohej disponim nga gjykata mbi kërkesën për konfiskim vetëm pas kryerjes së hetimit gjyqësor dhe dëgjimit të diskutimeve përfundimtare të prokurorit dhe palëve. Nga leximi i një formulimi të tillë konstatohet se për gjykatën është i detyrueshëm, jo vetëm njoftimi i palëve, por prezenca e detyrueshme e tyre, që do të thotë se gjykata nuk mund të disponojë me vendim në prezencë të prokurorit dhe në mungesë të palëve të tjera, të cilat nuk kanë paraqitur diskutimet përfundimtare.

Kontradiktoriteti nuk sigurohet gjatë fazës së sekuestrimit, pasi kjo është një fazë, e cila zhvillohet për shkak të ngutshmërisë e rrezikut të tjetërsimit ose transferimit të pronës dhe duke qenë një fazë e ndërmjetme nuk siguron kontradiktoritetin. Në lidhje me procedimin parandalues pasuror, *inter procedurale* e sekuestros parandaluese pasurore është rezultat i veprimit të dy akteve normuese, konkretisht: i ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë nr.10192 datë 3.12.2009 i ndryshuar me ligjin 70/2017 dhe Kodit të Procedurës Penale. Ligji (neni 12, pika 1 e tij) parashikon se “*Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata në dhomën e këshillimit brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori*”. Kjo dispozitë përcakton qartë se sekuestrimi vendoset në mungesë të kontradiktoritetit në dhomë këshillimi, në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori. Gjykata procedon *de plano*, pra në mungesë të kontradiktoritetit pra, pa thirrur e dëgjuar palët. Të drejtat e palëve përmbushen me atë çfarë sanksionon neni 27 i ligjit për mundësinë e ankimimit ndaj vendimit të sekuestrimit.⁵⁰³

Në një vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁵⁰⁴ arsyetohet se: “*Procedura e masës së sekuestrimit parandalues të pasurisë zhvillohet në dhomë këshillimi vetëm mbi bazën e dokumenteve dhe akteve të paraqitura, pa praninë e palëve dhe pa u*

⁵⁰³ Kundër Vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë, zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit, revokimit apo të shuarjes së masës së sekuestrimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

⁵⁰⁴ Vendimi nr. 132, datë 01.06.2021 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

dëgjuar, për këto shkaqe, shkaku i ankimit në lidhje me aspektin procedural të marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë në dhomë këshillimi pa u dëgjuar palët, nuk ka bazë ligjore dhe si e tillë rrëzohet”.

Gjykata e Lartë, në një Vendim të saj të vitit 2021,⁵⁰⁵ mbi rekursin se provat, që janë përdorur për sekuestrim, nuk i janë nënshtruar kontradiktoritetit, arsyeton se: *“Kolegji konsideron, në të njëjtat kushte, sikurse sa më sipër, minimalisht në kushtet e papërshtatshmërisë, pretendimin, e parashtruar në shkaqet e rekursit, e identifikuar në pavlefshmërinë e vendimit (të Gjykatës), që ka caktuar masën e sekuestros për shkak të mbështetjes–bazueshmërisë–së tij, në kundërshtim me parashikimin e nenit 380 të K.Pr.Penale, në “prova që nuk janë marrë dhe shqyrtuar në shqyrtimin gjyqësor, në prezencë të kontradiktoritetit të palëve”, përsa kohë që, qartazi, ky parim themelor i procesit të drejtë, të proklamuar në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 6 të saj dhe të implementuar-mutatis mutandis-në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, gjen zbatim vetëm në proces, në “selinë” natyrale të formimit fiziologjik të provës pra, në kuadrin e gjykimit në themel të akuzës së kontestuar nga Prokurori të pandehurit, “para një Gjykate të pavarur, të paanshme, të caktuar me ligj” dhe jo në procedim(et) e implementuara gjatë fazës paragjykimore, (para Gjyqtarit) të hetimeve paraprake, kryesisht, të atyre incidentale, të aktivizuara, në funksion të problematikës së kësaj faze, të caktimit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe ndalues si dhe të masave të sigurimit me karakter pasuror, ndër të cilat përfshihet edhe masa e sekuestros parandaluese, objekt i rekursit, ku gjykohet mbi bazën e “burimeve të provave”, të marra nga prokurori, në një kohë që, në rastin konkret, të aktivimit të procedimit pasuror dhe të aplikimit (për momentin) të masës së sekuestros parandaluese, ndaj subjektit, (pasurisë së tij) mbi bazën e “indicieve”, (përcaktimi i paragrafit të dytë të nenit 3 të ligjit të posaçëm, nr.10192, dt.03.12.2009), të thjeshta, të mjaftueshme, pra në nivelin e një standarti minimal provueshmërie, të justifikueshëm me momentin (fazën) e aplikimit të saj si dhe me emergjencën”.*

Në mënyrë që të përmbushet detyrimi për barrën e provës, subjekteve të ligjit duhet t’u jepet mundësia që në kontradiktoritet të kundërshtojnë provat e paraqitura nga akuza, por dhe të kenë të gjitha mjetet ligjore e procedurale për të paraqitur prova, që të mund të justifikojnë se të ardhurat

⁵⁰⁵Vendimin nr. 00-2021, datë 7.10.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

e tyre janë vënë në rrugë ligjore e që pasuria e tyre është e ligjshme. Ligji nuk jep shumë zgjidhje për provat që mund të përdoren por kjo del nga interpretimi i rregullimeve të veçanta⁵⁰⁶, gjë që nënkupton se gjatë fazës së gjyqimit të konfiskimit personi/subjekt i ligjit apo të afërm e persona të tretë të thirrur ndaj tij mund të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që u jep Kodi i Procedurës Penale për të debatuar e kundërshtuar faktet dhe provat, mbi të cilat mbështetet kërkesa për të paraqitur prova, shkresore, për të kërkuar kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël, për të thirrur dëshmitarë, persona të tretë etj.

5.4. Provat për justifikimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë, mundësitë e marrjes dhe paraqitjes së tyre.

Justifikimi i pasurisë së ligjshme si barrë provuese për subjektet e ligjit/të afërmit/bashkëpunëtorët dhe personat e tretë kërkon që ata të paraqesin fakte/prova të pakundërshtueshme, të cilat sigurohen në mënyra të ndryshme në rrugë zyrtare e në formën e kërkuar nga ligji. Provat mund të kërkojnë në elementet e përcaktuar të ligjit e në institutet e provave, që parashikon Kodi i Procedurës Penale. Duke analizuar parashikimet e veçanta të ligjit dhe ato referuese në Kodin e Procedurës Penale për provat dhe vlerësimin e tyre, mund të krijohet një *indeks* i provave, që mund të paraqesë subjekti i ligjit në funksion të përmbushjes së barrës së provës dhe të justifikimit të pasurisë së ligjshme të tij.

Si çdo person tjetër, titullari i së drejtave reale e atyre të pronësisë. subjekti mund të marrë vetë të dhëna, akte, prova shkresore e t'i paraqesë në gjykatë. Të tilla mund të jenë:

- Titujt e pronësisë së pasurive të luajtshme e të paluajtshme, që merren në regjistrat e pasurive ose të titujve të pronësisë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ⁵⁰⁷ sipas legjislacionit për tokën dhe për kthimin e pronës për përfitimin e titujve të pasurisë së paluajtshme, sipas legjislacionit për tokën bujqësore, pyjet, kullotat dhe kthimin e pronës

⁵⁰⁶ Si ato të referuara në nenet 21 e 24 të tij të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë nr.10192, datë 3.12.2009 i ndryshuar me ligjin 70/2017.

⁵⁰⁷ Parashikimi i nenit 6 të ligjit për kryerjen e veprimeve hetimore sipas objektit të hetimeve.

truall.⁵⁰⁸, ndërsa në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Rrugor për automjetet në pronësi a përdorim.

- Të dhëna, akte mbi *transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* etj. mund të merren nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, si të tilla ata lënë gjithmonë gjurmë.
- Të dhënat e provat për pagesën e tatimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me legjislacionin fiskal ku përfshihen:
 - o të dhëna e akte për zbatimin e procedurave tatimore dhe pagesën e tatimeve sipas ligjit tatimor;⁵⁰⁹
 - o pagesën e tatimeve mbi të ardhurat si biznes ose ato që rrjedhin nga vlerësimi i pasurisë së paluajtshme ose transaksioneve mbi të;⁵¹⁰
 - o pagesën e tatimeve mbi vlerën e shtuar sipas legjislacionit mbi vlerën e shtuar;⁵¹¹
 - o pagesën e taksave kombëtare sipas legjislacionit për taksat kombëtare;⁵¹²
 - o pagesën e taksave vendore sipas ligjit për taksat vendore;⁵¹³
 - o pagesat e detyrimeve doganore sipas legjislacionit doganor;⁵¹⁴
- Përmbushjen e detyrimit për deklarimin e pasurisë për subjektet si funksionarë publikë, gjyqtarë e prokurorë, që detyrohen të bëjnë deklarim periodik vjetor për pasurinë dhe konfliktin e interesit sipas legjislacionit në fuqi.⁵¹⁵

⁵⁰⁸ Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” (Fletore zyrtare 5, viti 1991, faqe 246) Ndryshuar me: Ligj, Nr.7715, datë 02.06.1993 Nr 9 Faqe 141 viti 1993 Ligj, Nr.7763, datë 25.10.1993 Nr 12 Faqe 796 viti 1993 Ligj, Nr.7855, datë 29.07.1994 Nr 10 Faqe 484 viti 1994 Ligj, Nr.8752, datë 26.03.2001 Nr 14 Faqe 400 viti 2001 Ligj, Nr.9244, datë 17.06.2004 Nr 49 Faqe 3375 viti 2004 dhe ligji Nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin e kompensimin e pronës” (Ndryshuar me ligjin nr.9388, datë 4.5.2005) (Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006) (Ndryshuar me ligjin nr.9684, datë 6.2.2007) (Ndryshuar me ligjin nr.9898, datë 10.4.2008) (Ndryshuar me ligjin nr.10 095, datë 12.3.2009) (Ndryshuar me ligjin nr.10207, datë 23.12.2009) (Ndryshuar me ligjin nr.10 186, datë 5.11.2009) (Ndryshuar me ligjin nr.10308, datë 22.7.2010) (Ndryshuar me ligjin nr.55/2012, datë 10.5.2012) (Ndryshuar me ligjin nr.49/2014, datë 8.5.2014) (Ndryshuar me ligjin nr.47/2015 datë 7.5.2015)

⁵⁰⁹ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 112/2020 “Për rregjistrin e pronarëve përfitues”.

⁵¹⁰ Sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar dhe ligji nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

⁵¹¹ Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”

⁵¹² Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar

⁵¹³ Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar

⁵¹⁴ Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar me ligjin nr. 32 datë 2.04.2015

⁵¹⁵ Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

- Të dhënat mbi veprimtarinë ekonomike, tregtare dhe profesionale dhe burimi i të ardhurave të tyre, ku përfshihen verifikimet mbi llojin e aktivitetit tregtar ose profesional, i regjistruar ose jo në Qendër Kombëtare të Regjistrimit Tregtar,⁵¹⁶ në emër të subjektit, në ortakëri me të tjerë ose aksioner, kapitali themeltar, burimi, pagesat e tatimeve, bilancet, shpërndarjen e të ardhurave, shpenzimet, llogaritë rrjedhëse e transfertat, investimet.
- Të dhënat se subjektet janë zotërues të lejeve për transport, shërbime, shfrytëzim mineral, pyjor, peshkim, e në veçanti atyre të ndërtimit, autorizimeve, konçensioneve, liçensave dhe çdo të drejtë tjetër për të ushtruar aktivitet ekonomik.
- Kontributet që subjekti ka përfituar, financime, kreditime të çdo lloji, të dhëna të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare.

Këto të dhëna kërkohen pranë zyrave të administratës, bashkive, gjendjes civile, të regjistrimit të pasurive e të kadastrës, të tatimeve, liçensave, të shërbimeve periodike e të furnizimit me ujë, energji, sigurimeve shoqërore, bankave, shoqërive kursim kredi e atyre të investimeve duke u kërkuar kopje të dokumentacionit të veprimeve të subjektit apo të afërmëve të tij. Në mënyrë të veçantë, të dhënat e aktet mbi titujt e pronësisë kërkohen dhe merren:

- Të dhënat për pasuritë e paluajtshme kërkohen pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ose Agjensisë Shtetërore të Kadastrës ndërsa për pasuritë e luajtshme si automjetet pranë zyrave të Drejtorive të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Për llogaritë bankare, transfertat, pagesat hetimet shtrihen në banka;
- Për pasuritë e shoqërive tregtare në regjistrin e shoqërive tregëtare apo pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKB);
- Për kuotat dhe aksionet verifikohen dhe hetohen publikimet në regjistrin e shoqërisë tregtare dhe shënimet në regjistrat kontabël të shoqërive.⁵¹⁷

Subjekti i ligjit ose personat e lidhur me të mund të përdorin institutet e procedurës penale e të kërkojnë kryerjen e akteve të ekspertimit, të këqyrjes, e marrjes së provave apo lloje të provave, që nuk parashikohen nga Kodi i Procedurës Penale, por lejohet prej tij në kuptim të nenit 149 siç

⁵¹⁶ Paragrafi 2 i nenit 6 “Objekti i hetimeve “

⁵¹⁷ Në nenin 14 të ligjit përcaktohet pikërisht që sekuestros duhet të bëhet pranë këtyre institucioneve dhe në këtë mënyrë.

është marrja e konsulentit privat teknik. Instrumentet procedurale të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale bëhen të mundur duke ia kërkuar gjykatës si garant i respektimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit në gjykim. Mbi bazën e kërkesës së subjektit të ligjit, gjykata vendos kryerjen e ekspertimit kontabël financiar ose atij të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme duke respektuar rregullat procedurale, të parashikuara në nenet 178-186 të KPrP.

Në një rast se subjekti, të cilit i ishin konfiskuar disa llogari bankare nga gjykata e krimeve të rënda ishte gjendje nën masë sigurimi për shkak të procedimit penal, ushtron rekurs në Gjykatën e Lartë⁵¹⁸ me pretendimin se: *“Gjykatat i kanë mohuar të drejtën e paraqitjes së provave dhe konkluzioneve përfundimtare, duke nënvlehtësuar mundësinë që rekursuesi të paraqesë prova të mbledhura gjatë gjykimit të konfiskimit, që nëse do të ishin vënë në dispozicion të ekspertëve do të sillnin një rezultat tjetër të aktit të ekspertimit financiar, e se kërkuesi duke qenë në masë sigurimi “arrest në burg” nuk ka arritur të mbledhë në kohë provat e duhura se ekspertët i janë referuar vetëm prova të vëna në dispozicion nga prokuroria dhe ata nuk kishin njohuri në fushën e transaksioneve bankare ndërkombëtare”*. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me Vendimin nr. 294, datë 4.5.2021, nuk i ka marrë parasysh këto pretendime nuk arsyetuar se *“...kërkuetit i është garantuar e drejta e mbrojtjes, parimi i kontradiktoritetit dhe barazia e armëve në gjykim, pasi mbrojtja e tij ka pasur mundësi të njihet dhe të debatojnë provat e paraqitura, fakti që gjykata e shkallës së parë nuk ka riçelur hetimin gjyqësor nuk përbën shkelje të barazisë së armëve për sa kohë vendimi i ndërmjetëm është i arsyetuar. Ndërsa largimi nga seanca e konkluzioneve përfundimtare të kërkuetit është bërë me dëshirën e tij”*.

Ekspertimi kontabël/financiar/auditues dhe ai vlerësimit të pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme. Është lloji e provës më i përdorshëm për përmbushjen e barrës së provës për subjektet që u jep mundësi subjekteve për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme, në përputhje me legjislacionin e tatim-taksave e përlogaritur ato sipas metodave të sakta matematikore e ligjore. As ligji e as Kodi nuk parashikojnë një lloj ekspertimi të tillë të veçantë përveçse rregullimit të ekspertimit në përgjithësi si një nga llojet e provave. Parashikohet në nenet 178-186 të Kodit të Procedurës

⁵¹⁸ Vendimi nr. 294 datë 4.5.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al

Penale.⁵¹⁹ Ekspertimi është një nga provat më të përdorshme në hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale, por ky lloj ekspertimi i veçantë është i domosdoshëm gjatë procedurës së konfiskimit pasuror. Ky lloj ekspertimi kërkon njohje të veçanta e për rrjedhojë është i domosdoshëm nga gjykata, por në mënyrë të veçantë nga pala, për të vërtetuar fakte, që lidhen me origjinën e ligjshme të pronës.

Domosdoshmëria që të provohen saktë dhe plotësisht faktet e nevojshme juridike, e veçanërisht të atyre që gjyqtari nuk ka njohuri të mjaftueshme profesionale, ka shtruar nevojën për zbatimin e ekspertimit si një veprimtari e posaçme, që ushtrohet nga eksperti, me të cilin sigurohet mendimi i tij si prove. Ekspertimi nënkupton kryerjen e një veprimi të caktuar nga eksperti për vërtetimin e vlerësimit të një fakti apo zbulimin e tij, për të cilën kërkohet një njohuri e posaçme profesionale.⁵²⁰ Ekspertimi si veprim nënkupton dhe aktivitetin e organit procedues nëpërmjet vendimit të kryerjes, caktimit të ekspertimit, emërimit, e vlerësimit të vendimit të tij. Objektin e ekspertimit e përbëjnë faktet që kanë të bëjnë me sqarimin dhe zgjidhjen e çështjes financiare/kontabël konkrete, si dhe faktet, që kanë të bëjnë me çështje të tjera, të lidhura me veprën penale, dhe që kontribuojnë në marrjen e vendimit gjyqësor, lidhur apo me masa të caktuara. K.Pr.P.⁵²¹ ka bërë një përcaktim të objektit të ekspertimit, dhe kufijve të lejueshmërisë, duke përcaktuar se ky veprim procedural lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore. Po në këtë përkufizim kodi shqiptar për rastet e ekspertimit të anës objektive të çështjes, bën kujdes në ruajtjen e jetës private të subjektit, përveç shpenzimet dhe të ardhurat e jetesës së përditshme kur përcakton se nuk lejohen ekspertimet për të përcaktuar profesionalizmin.⁵²²

Eksperti është një profesionist në fushat jojuridike. Ai mund të jetë *financier/kontabilist/auditues/inxhinier topograf etj.* të cilin organi procedues e thërret për të dhënë një mendim, lidhur me vërtetimin e një fakti juridik të caktuar, për vërtetimin e të cilave kërkohet një njohuri e posaçme. Më parë, ai njihet si “*gjykatës shkencor*”, ndërsa sot njihet si subjekt

⁵¹⁹ Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore.

⁵²⁰ Procedura Penale, Komentar, H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Botim Tiranë 2003.

⁵²¹ Neni 178 i KPrP

⁵²² Pag. 2 i nenit 178 të Kodit të Procedurës Penale.

procedural. Rregullat e caktimit të ekspertit i parashikon K.Pr.P ⁵²³; ku në nenin 179 të tij thuhet se “*caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në fushën përkatëse*”. ⁵²⁴ Regjistri gjendet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Ligji shqiptar i ka dhënë një disponibilitet të gjerë organit procedues, dhe është e rëndësishme që eksperti të njihet nga ky organ dhe emërimin si ekspert ia jep vendimi i organit procedues. Eksperti është person fizik, i aftë profesionalisht dhe proceduralisht, i cili i ndihmon organit procedues në zbulimin e fakteve kundërshtuese në fushën profesionale të tij. Veprimtaria dhe roli i ekspertit është i papajtuashëm me veprimtarinë dhe rolin si të organit procedues dhe të subjekteve të tjera procedurale. Prandaj, specifika e veprimtarisë së ekspertit ndikon që ai të jetë një pjesëmarrës i pavarur procedural, që ofron ndihmë profesionale. Si i tillë, ai kërkohet nga subjekti gjatë procedurës së konfiskimit, por caktohet nga gjykata. Eksperti caktohet në bazë të ligjit dhe neneve 224/d, 225 e vijues të K.Pr.Civile dhe 178,179 dhe 184 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim kryerjen në gjykim të ekspertimit vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe kontabël/audit ligjor të pasurive, objekt konfiskimi i të ardhurave, mbi të cilat janë krijuar ato duke iu referuar listës së ekspertëve të regjistruar në regjistrin e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë për të kryer ekspertimet pranë gjykatave respektive.

Akti i ekspertimit është pasqyrimi përfundimtar i ekspertimit të kryer. Metodika e hartimit të aktit të ekspertimit bazohet në katër elementë bazë, të cilat përbëjnë strukturën e çdo akti ekspertimi, konkretisht: a) pjesa përshkruese e pasurisë objekt ekspertimi ose e të ardhurave sipas detyrës së gjykatës e objektit të aktit të ekspertimit; b) rrethanat e çështjes; c) pjesa e ekzaminimit ekspertues dhe d) konkluzioni. Në rastin e *ekspertimeve kontabël/financiar/auditues* konkluzioni është përgjigja ndaj detyrës së gjykatës dhe e kërkesave të palëve, nëse ekzistojnë mjetet financiare të nevojshme e të ligjshme për justifikimin e pasurisë. Pjesa e konkluzionit mund të jetë në mënyrë kategorike ose të mundshme. Konkluzionet e mundshme janë me natyrë pozitive ose negative. Formulimi i konkluzioneve të mundshme është një nga problemet e ndërlikuara të hasura në

⁵²³ Neni 179 i Kodit të Procedurës Penale i ndryshuar në vitin 2002

⁵²⁴ Ekspertët kontabël/financiar/auditues të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme si rregull zgjidhen pranë regjistrin të ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë si dhe pranë regjistrin të kontabilistëve të autorizuar.

praktikë. Ka raste kur konkluzionet paraqesin rezultatet me shkallë afërsie probabiliteti, kur konkluzioni duhet formuar kategorik dhe kur ka mundësi gjykohe rast pas rasti e për këtë ndikojnë një sërë faktorësh si p.sh. teknika e të shkruarit, niveli i kualifikimit etj., p.sh kur eksperti kontabël shprehet në aktin e ekspertimit për qëllime keqdashëse të pronarit/subjektit në fshehjen e burimit të pasurisë apo jep mendim për regjistrim fiktiv të pronësisë.

Ligji procedural penal shqiptar nuk përcakton llojet e ekspertimeve, por praktika dikton llojet e tyre në rastin e ekspertimeve në zbatim të ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, të ndryshuar*”⁵²⁵. Kodi i procedurës penale parashikon ekspertimin kompleks⁵²⁶, për rastet kur kërkimet dhe vlerësimet paraqiten të vështira. Ky është rasti kur mund të kërkohet kryerja e një ekspertimi të kombinuar kontabël/ financiar/auditues e vlerësues të pasurisë së paluajtshme. Neni 363 i Kodit të Procedurës Penale⁵²⁷ mundëson pyetjen e ekspertëve në seancë gjyqësore. Marrja e mendimit dhe pyetjet e ekspertit i japin mundësinë subjektit të sqarojë situatën e të ardhurave e të pronës së tij. Meqenëse aktet e ekspertimit kontabël/financiar, të auditit ligjor e vlerësimit si të paluajtshme janë akte që hartohen mbi një objekt ekspertimi delikat, të vlerësimit të pretendimeve mbi ligjshmërinë e të ardhurave, origjinën e pronës, pagesën e taksave dhe tatimeve, pyetja e ekspertit në seancë gjyqësore të konfiskimit në kontradiktoritet dhe me debat mbi rezultatet e aktit të ekspertimit ka rëndësi për krijimin e bindjes tek gjyqtari.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka mbajtur një qëndrim të qartë për karakteristikat dhe elementet që duhet të ketë një akt ekspertimi kontabël dhe i vlerësimit të pasurisë së paluajtshme për tu quajtur i vlefshëm si provë. Në një vendim të gjyqtarit të seancës paraprake mbi bazën e kërkesës së dërgimit të çështjes për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 të KP⁵²⁸, Gjykata shprehet se: *Gjykata vlerëson se në aktin e*

⁵²⁵ Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë “ i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.04.2017.

⁵²⁶ Neni 179 pag. 3 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵²⁷ Për pyetjen e ekspertëve respektohen dispozitat mbi pyetjen e dëshmitarëve, për aq sa janë të zbatueshme. Eksperti ka të drejtë të konsultohet me dokumentet, shënimet dhe botimet që mund të merren edhe kryesisht.

⁵²⁸ Vendimi nr. 72 datë 16.09.2021 i gjyqtarit të seancës paraprake të GJPKKO mbi kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 137/1 të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ndaj të pandehurit F. L. (ish gjyqtar i GJL), i akuzuar për veprën penale të *Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi,*

ekspertimit kontabël i dt. 21.02.2021 (i hartuar nga ekspertja kontabël L. M.), i administruar në fashikullin e prokurorisë, nga ana e ekspertës jepet ndër të tjera edhe mendim juridik (shiko faqen 6 të aktit të ekspertimit, ku ndër të tjera përcaktohet: "... Theksojmë se për shkak të mashtrimit të qëllimshëm që subjekti ka bërë në deklaratimet vjetore duke lidhur kontrata dhurimi dhe huapërdorje me të motrën, puna jonë bëhet akoma më e vështirë, përfundimisht ... akti i ekspertimit është një provë shkencore që, ndonëse mbart në vetvete shumë avantazhe, për gjykatën do të mbetet një provë si gjithë llojet e tjera të provave, që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykata e çmon atë. Çmuarja e provës, pra dhe e asaj me ekspert, bëhet duke nxjerrë vlerën e saj provuese në koherencë me provat e tjera të procesit gjyqësor. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatat, të cilat nuk janë aspak të detyruara të pranojnë a priori këto mendime, përveçse kur i bindin. Fakti se eksperti ofron mendime të specializuara për gjykatën në një fushë jojuridike, bën që mendimi i ekspertit të tërheqë vëmendje më të madhe në momentin e çmuarjes së tij nga ana e gjykatës dhe se kjo e fundit duhet të argumentojnë me hollësi mendimin e kundërt. Nëse nuk pranohet mendimi i ekspertit duhet të paraqiten argumente bindëse, por kjo nuk do të thotë se gjykatat duhet të pajtohen gjithmonë me konkluzionet e ekspertëve. Pra, gjykatat, përfundimet e nxjerra nga ekspertët, i shqyrtojnë në kontekstin e të gjitha rrethanave të tjera të çështjes. Gjykata konstaton se ekspertja kontabël në rastin konkret ka dalë jashtë misionit të saj, pasi ndër të tjera merret edhe me zgjidhjen e çështjes në themel sikurse është ajo e përcaktimit të faktit nëse i pandehuri F. L. ka bërë apo jo deklaram të rremë në deklaratat e tij të pasurisë në lidhje me kontratat e dhurimit dhe huapërdorjes me të motrën".⁵²⁹

Në nenin 178 të K.Pr.Penalë nën titullin "Objekti i ekspertimit" parashikohet shprehimisht se: "1. Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve, që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore.". Nga përmbajtja e kësaj dispozite konkludohet se veçoria kryesore e mendimit të ekspertëve si provë është karakteri i tij shkencor. Vërtetimi i një fakti apo konstatimi i qenies ose jo të një rrethane, që ka rëndësi për çështjen bëhet me ndihmën e specialistëve, që realizojnë këqyrjen apo analizën e një objekti ose

fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", e parashikuar nga neni 257/a/2 i K. Penal.

⁵²⁹ Vendimi Nr. 45, datë 23.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese. www.gjk.gov.al

fenomeni mbi bazën e njohurive që posaçme, që ato kanë në fusha të ndryshme të shkencës, teknikës ose kulturës. Mendimi i ekspertëve që kalon kufijtë e një mendimi shkencor dhe merret me trajtimin e problemeve të së drejtës materiale apo procedurale, të formës së fajësisë apo të motiveve etj., nuk ka asnjë vlerë provuese dhe nuk mund të merren parasysh nga organi procedues prokuroria dhe gjykata. Në nenin 152 të K.Pr.Penale thuhet shprehimisht se: “1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar”. Mbështetur në këtë dispozitë sikurse u theksua më lart si të gjitha provat e tjera edhe mendimi i ekspertëve në procesin penal i nënshtrohet shqyrtimit dhe çmuarjes së tij nga prokuroria në fazën e hetimit paraprak dhe nga gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, në bazë të po atyre parimeve, që kanë fuqi për të gjitha llojet e provave. Natyrisht, veçoritë që ka kjo provë, sidomos kur fusha e dijes, që ka shërbyer si bazë për zgjidhjen e çështjes, është e panjohur për gjykatën, e bëjnë të vështirë, por jo të pamundur punën për verifikimin e drejtësisë së përfundimeve që ka arritur eksperti. Veç kësaj edhe vetë ekspertimi është një proces i veçantë njohjeje, që drejtohet në zgjidhjen e çështjeve që përbëjnë objektin e ekspertimit, e që kryhet në bazë të një sërë veprimesh e operacionesh, të cilat diktohen nga natyra e problemit që zgjidhet. Vlerësimi i mendimit të ekspertit përfshin, pikërisht edhe verifikimin e rregullsisë së këtyre operacioneve e veprimeve, të cilat e kanë çuar ekspertin në nxjerrjen e këtyre apo atyre përfundimeve. Në vetvete, mendimi i ekspertit është zbatimi i një teze të caktuar shkencore në një rast konkret, prandaj për gjykatën nuk ka rëndësi vetëm mendimi i ekspertit, por ka rëndësi tërë procesi i punës së tij, kanë rëndësi metodat e përdorura dhe mënyra si i ka zbatuar ai këto teza shkencore.

Është e rëndësishme që ekspertimi të kryhet në përputhje me normat procedurale pasi në këtë mënyrë krijohet garanci e plotë që konkluzioni i arritur të jetë i drejtë. Mendimi i ekspertit duhet të jepet me shkrim dhe në të duhet të paraqiten qartë dhe me hollësi të nevojshme, materialet që ka pasur në dispozicion eksperti, metodat e përdorura dhe të dhënat e konstatuara gjatë këqyrjes dhe analizës së objektit të ekspertimit, tezat teknike dhe shkencore, që ka shfrytëzuar eksperti për këtë punë si dhe përgjigjet për të gjitha detyrat e shtruara për zgjidhje nga ana e organit procedues. Duhet theksuar këtu se pjesa përfundimtare e aktit të ekspertimit duhet të jetë rrjedhojë logjike e pjesës përshkruese arsyetuese të këtij akti. Në rast se ekspertët nuk tregojnë se ku janë mbështetur për të dhënë këtë ose atë mendim apo nuk tregojnë procesin dhe metodat e punës të përdorura, mendimi i dhënë prej tyre nuk mund të pranohet, pasi nuk është e mundur të bëhet verifikimi dhe

çmuarja e mendimit të tyre, por do të detyrohej ta pranonte mendimin e ekspertit si një fakt të vërtetuar, të padyshimtë dhe të sigurt, në kundërshtim me nenin 152 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: “Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar”,

5.4.1. Të ardhurat e padeklaruara në organet tatimore, huatë, dëshmitë, ekspertimet private dhe konsulenca teknike

Ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar⁵³⁰, në nenin 24 të tij, parashikon se personi nuk mund të përligjë pasurinë, duke deklaruar si burim të saj të ardhurat ose riinvestime, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve.⁵³¹ Në kushtet e ekonomisë informale, që ka mbizotëruar gjatë viteve të shkuara dhe të ardhurave të sjella në Shqipëri, jashtë sistemit bankar, si pasojë e emigrimit të parregullt, rezulton se një pjesë e pasurive të vëna dhe të ardhurave të depozituara në sistemin bankar rezultojnë të padeklaruara në organet tatimore dhe jo në përputhje me sistemin fiskal.

Të ardhurat, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve janë ato të ardhura, për të cilat nuk janë zbatuar detyrimet për pagesat e tatimit sipas: ligjit tatimor mbi të ardhurat e tatueshme⁵³¹; pagesën e tatimeve mbi të ardhurat si biznes apo ato që rrjedhin nga vlerësimi i pasurisë së paluajtshme apo transaksioneve mbi të,⁵³² pagesën e tatimeve mbi vlerën e shtuar sipas legjislacionit mbi vlerën e shtuar;⁵³³ pagesën e taksave kombëtare sipas legjislacionit për taksat kombëtare;⁵³⁴ pagesën e taksave vendore sipas ligjit për taksat vendore;⁵³⁵ dhe pagesat e detyrimeve doganore sipas legjislacionit doganor.⁵³⁶

⁵³⁰ Neni 24 “Pranimi i kërkesës për konfiskim”, paragrafi 2 “Në çdo rast, personi nuk mund të përligjë pasurinë, duke deklaruar si burim të saj të ardhurave ose riinvestime, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

⁵³¹ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligji nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligji nr. 112/2020 “Për rregjistrin e pronarëve përfitues”.

⁵³² Sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar dhe ligji nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

⁵³³ Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”.

⁵³⁴ Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar.

⁵³⁵ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

⁵³⁶ Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 2.04.2015.

E ardhura⁵³⁷ tatohet në mënyrë që të jetë një e ardhur nga sistemi ligjor. Të ardhurat përkufizohen si “shuma algjebrike e vlerës së tregut e të drejtave të ushtruara gjatë konsumit dhe ndryshimit në vlerë të shumës së të drejtave të pasurisë ndërmjet fillimit dhe fundit të periudhës në fjalë”. Megjithatë, sistemet tatimore të shumicës së vendeve largohen nga ky përkufizim i gjerë (*i cili përndryshe do të përfshinte në bazën tatimore p.sh. shtimet e përealizuara*). Në praktikë, të ardhurat përkufizohen përgjithësisht në bazë të posteve specifike, që duhen përfshirë në bazën tatimore (*si p.sh. të ardhurat nga punësimi, fitimet nga biznesi, të ardhurat nga qiraja, etj.*) në vend të përcaktimit të të ardhurave sipas një formule të përgjithshme. Ky është veçanërisht rasti për vendet që zbatojnë sistemin tatimor tabelar, si edhe për sistemet e tatimit mbi të ardhurat globale.

Sipas sistemeve tatimore tradicionale, ku përfshihet dhe sistemi shqiptar, të ardhurat mund të përfshijnë arkëtimet e parave ose ekuivalentin e tyre, por mund, gjithashtu, të përfshijnë shumat që gjykohen ose parashikohen që do të merren. Shumë vende bëjnë dallim ndërmjet të ardhurave (*ndonjëherë të quajtura në këtë kontekst si “të ardhura të zakonshme”*) dhe shtimeve të kapitalit, ku këto të fundit janë subjekt i rregullave të ndryshme të llogaritjes, shkallëve tatimore, ose në disa raste edhe përjashtohen nga tatimet.⁵³⁸ Që të konsiderohet si e ardhur duhet të jetë e tatueshme mbi bazën e sistemit të tatimit direkt mbi të ardhurat. Megjithëse, termi përgjithësisht zbatohet për një tatim mbi individët (*ku ai mund të përcaktohet si tatim mbi të ardhurat personale ose tatim mbi të ardhurat individuale*), ai gjithashtu përdoret në disa vende për një tatim mbi personat juridikë, si p.sh. shoqëritë. Përgjithësisht, tatimi zbatohet në bazë vjetore, d.m.th. mbi të ardhurat e fituara gjatë ose lidhur me një vit fiskal të caktuar.

Mund të dallohen dy sisteme kryesore të tatimit mbi të ardhurat: një sistem tatimor global dhe një sistem tatimor tabelar mbi të ardhurat. Megjithatë, edhe në sistemet e tatimit global, në pikëpamjen e përkufizimeve të ndryshme teorike të të ardhurave, shumica e vendeve i specifikojnë postet që përbëjnë të ardhura për qëllime tatimore. Shkallët e tatimit mbi të ardhurat mund të zbatohen me shkallë progresive ku shkalla e tatimit rritet me rritjen e të ardhurave ose me shkallë fikse. Mundet

⁵³⁷ Fjalori tatimor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

⁵³⁸ Bibliografi: R. Haig, “Koncepti i të ardhurave—aspektet ekonomike dhe ligjore” në Haig (red.), *Tatimi mbi të Ardhurat Federale*, 1921; H. Simons, “Tatimi mbi të ardhurat personale”, 1938; K. Holmes, “Koncepti i të ardhurave—një analizë shumëdisiplinore.

gjithashtu të vendoset një mbipagesë. Shumica e vendeve vendosin tatim mbi të ardhurat për totalin e të ardhurave në shkallë botërore të rezidentëve dhe për të ardhurat nga burime brenda vendit në rastin e jorezidentëve. Disa vende, megjithatë, e kufizojnë tatimin mbi të ardhurat me burim të brendshëm, si për rezidentët ashtu edhe për jorezidentët sipas parimit të territorit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁵³⁹ nuk e ka lënë në diskrecionin e organeve ligjzbatuese përcaktimin e të ardhurave “*të tatueshme*”, por ia ka njohur vetëm ligjit. Për këtë arsye, pjesa e shkëputur e fjalisë “*të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen*” mund të gjejë zbatim vetëm brenda një norme pozitive ligjore, jo akti nënligjor dhe as diskrecional të organeve publike. Pra, sipas parimit të ligjshmërisë personi mund të justifikojë origjinën e ligjshme të të ardhurave vetëm nëse janë paguar taksat e tatimet mbi të. Taksat e tatimet përcaktohen nga legjislacioni tatimor dhe ai për procedurat tatimore⁵⁴⁰. Subjekti mundet që të justifikojë blerjen e mallrave, që duken joproporcionale me të ardhurat e deklaruar për qëllime tatimore nëpërmjet të ardhurës të natyrës legjitime. Të ardhurat nga veprimtaria e ligjshme ekonomike duhet të konsiderohen të ligjshme edhe nëse ata nuk janë deklaruar për qëllime tatimore për shkak të raportit të ligjit dhe ndryshimit mes të ardhurave dhe aktivitetit ekonomik. Në rastet kur aktiviteti ekonomik është i ligjshëm dhe nëpërmjet balanceve kontabël vërtetohen hyrje dalje të mallrave të ligjshme diskutohet nëse kjo mund të konsiderohet si një e ardhur e ligjshme. Një e ardhur nga evazioni fiskal e riinvestuar konsiderohet evazion sistematik e si rregull, ajo nuk duhet konsideruar burim ligjshëm i të ardhurës⁵⁴¹. Në praktikë, ka lindur diskutimi i të ardhurave të pretenduara në periudhën kur subjekti i ligjit nuk ka qenë subjekt i ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër

⁵³⁹Neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj

⁵⁴⁰Ligji nr. 8438 datë 28.12.2019 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligji nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligji nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues

⁵⁴¹Sipas ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar dhe ligji nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme “

⁵⁴⁰ Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH.”.

⁵⁴¹ Kjo është karakteristike në rastet e procedimeve pasurore të pasurisë e të ardhurave të subjekteve të dyshuar ose të dënuar për vepra penale në kuadër të krimit të organizuar, kur procedimi penal i tyre shoqëron dhe akuzat për pastrim të produkteve të krimit.

pasurisë nr.10192, datë 3.12.2009 i ndryshuar me ligjin 70/2017, apo nuk kishte detyrim për të deklaruar të ardhura personale.

Në praktikën gjyqësore është diskutuar rasti i zbatimit të përcaktimit të nenit 24/2 të ligjit për të ardhurat e realizuara para ndryshimeve të vitit 2017 të ligjit. Në një vendim të Gjykatës së Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁵⁴² arsyetohet se : *“Përcaktimi në nenin 24/2 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017 neni 1 ku thuhet se ‘Në çdo rast personi nuk mund të përligjë pasurinë duke deklaruar si burim të saj të ardhura ose investime që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve’ në këtë rast nuk vjen në kundërshtim me këtë qëndrim të mësipërm, pasi jo vetëm që ky përcaktim nuk ka qenë në ligjin e mëparshëm, por edhe nëse ky do të ishte ligji i zbatueshëm edhe në gjykimin e kësaj çështjeje, ky përcaktim i mësipërm bën fjalë vetëm për sa është shprehur: ‘mospagimi i taksave dhe tatimeve’ dhe jo i çdo lloji shkeljeje tjetër të legjislacionit tatimor ose tregtar, që është e ndëshkueshme administrativisht”.*

Huatë. Në kushtet e mungesës së kredithënies, shumë biznese e individë kanë përdorur huatë për aktivitetet ekonomike dhe tregtare apo për blerjen e pasurive të paluajtshme. Huatë dhe kontratat noteriale mbi to mund të përdoren si alibi për të justifikuar pasuri jo të ligjshme ose blerje të pasurive të pajustificuara. Huaja njihet si veprim juridik nga Kodi Civil⁵⁴³ e përdoret në ekonominë informale shqiptare. Të ardhurat nga huaja barazohen mbi të ardhurat e përfituara nga interesi i huasë, në rastin kur huaja është dhënë me interes nga institucionet financiare të licencuara, dhe në shumën e interesit të maturuar. Kur huaja është pa interes, nuk krijohen të ardhura dhe për rrjedhojë nuk aplikohet tatim. Nga marrëveshja e huasë pa interes, lind detyrimi i huamarrësit për kthimin e huasë, por jo një e ardhur në kuptim të ligjit *“Mbi tatimin mbi të ardhurat”*, dhe as detyrim i individit/huamarrësit, subjekt rivlerësimi në këtë proces për të paguar tatim. Në rast konfirmimi të marrëdhënies së huasë, personi tjetër i lidhur detyrohet të justifikojë burimin e krijimit të pasurisë së dhënë hua.

⁵⁴²Vendimi nr. 5, datë 16.03.2018 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda

⁵⁴³ Neni 1050 i KC të RSH parashikon: *“Me kontratën e huasë njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t’i kthejë huadhënësit atë të holla, ose atë sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afati, me kërkesën e huadhënësit”.*

Ligji nuk bën dallim për sa i përket detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të personave të lidhur ose të personave të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse këta të fundit i konfirmojnë këto marrëdhënie. Në kuptim të ligjit, huaja pa interes paraqitet si një marrëdhënie kontraktore, detyrimi monetar, sipas së cilës: i) huadhënësi i jep në pronësi huamarrësit një shumë të hollash; dhe ii) huamarrësi është i detyruar për t'i kthyer huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit. Kodi Civil, në pjesën e posaçme, për kontratën e huasë nuk përcakton detyrim për formalizimin e kontratës. Nga ana tjetër, dispozitat urdhëruese ligjore për detyrimet monetare formalizojnë fazën e ekzekutimit të detyrimeve të ndërsjella sipas huasë, vendin, datën dhe dëftesën e pagesës.

Në kuptim të Kodit Civil, kontrata e huasë është një kontratë tipike, joformale, që në rastin konkret në thelb ka ekzekutimin e detyrimeve monetare, ekzekutimi i të cilave, në mungesë të një përcaktimi të ndryshëm kontraktor, formalizohet me një shkresë, që i lëshohet dikujt për të vërtetuar se i është marrë diçka/para ose për të vërtetuar se ai ka paguar a ka dhënë diçka/para (dëftesë). Në këto kushte, kontrata e huasë është kontratë joformale, por formale janë veprimet përfundimtare të përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Huatë kanë fuqi provuese, vetëm nëse ato janë në formën e kontratës së shkruar sipas kërkesave dhe të Kodit të Procedurës Civile, sipas aspektit procedural të formës së shkresës.⁵⁴⁴ Në vlerësimin e kontratave të huasë si provë shkresore kemi parasysh praktikën gjyqësore mbi ekzistencën e aktit noterial si titull ekzekutiv, i cili përmban në vetvete një veprim juridik me detyrim të njëanshëm dhe abstrakt për pagesën e një shume të caktuar.⁵⁴⁵ Fuqi provuese e shkresave (*nervus probationis*) është më tepër një koncept i së drejtës civile e procedurale civile por në procedurën penale të shqyrtimit të kërkesave të konfiskimit, huatë paraqiten si prova dokumente me fuqi provuese, në rast se vërtetohet transaksioni bankar i parasë së dhënë hua.

⁵⁴⁴ Në aspektin procedural, neni 246 i Kodit të Procedurës Civile përcakton: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishje ose shitesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”.

⁵⁴⁵ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 980 datë 29.09.2000.

Në një rast se pala e tretë ushtronte rekurs ndaj Vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda⁵⁴⁶ pretendohet se nuk janë marrë parasysh dhe vlerësuar thëniet e dëshmitarëve, që dëshmojnë në seancë për dhënien hua të një sasive të konsideruar, të dhënë subjektit M.F., të cilët kanë konfirmuar prova shkresore siç janë huatë.

Thirrja e dëshmitarëve dhe personave të tretë mund të jetë një nga provat ku subjekti mbështetet për të vërtetuar një fakt. Thirrja e dëshmitarit mund të bëhet sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale ku thëniet e dëshmitarit janë një nga provat kryesore për vërtetimin e fakteve.⁵⁴⁷ Thëniet e dëshmitarit i nënshtrohen vlerësimit si provë sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Si të tillë, mund të jenë persona të afërm, bashkëpunëtorë ose ortakë, huadhënës etj. Një çështje e diskutueshme është nëse në një rast të tillë vlejnë parimet civile të pamundësisë së provës me dëshmitarë për të kundërshtuar provën me shkresë. Sipas parimeve të të vlerësuarit në të drejtën procedurale civile reflektuar në nenin 231 të Kodit të Procedurës Civile prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë (*ad substantum*) ose provimin (*ad probationem*) e një veprimi juridik kërkon shkresë.

Thirrja e personit të tretë është parashikuar në ligj (neni 22 të ligjit) kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, kryesisht, gjykata, me vendim të arsyetuar, i thërret në gjykim. Kodi i procedurës penale nuk parashikon personin e tretë si subjekt, ndërsa Kodi i Procedurës Civile në nenin 192 të tij⁵⁴⁸ parashikon thirrjen e personit të tretë. Personi i tretë ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të nevojshme brenda afatit që i caktohet nga gjykata. Në këtë rast, provat dhe të dhënat e paraqitura nga person i tretë i nënshtrohen debatit dhe vlerësimit në seancën gjyqësore të konfiskimit.

5.5. Mbrojtja e interesave të të tretëve në mirëbesim dhe barra e provës, garancitë për mbrojtjen e pasurisë së ligjshme.

⁵⁴⁶ Vendimi nr. 143, datë 9.11.2018 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

⁵⁴⁷ Nenet 360 - 363 të Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁴⁸ Neni 192 i KPrC, i ndryshuar me ligjin nr. 38/2017 “Secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen, prej të cilit mund të kërkojë një garanci ose shpërblim., që lidhet me përfundimin e çështjes”

Ligji mbron interesat e të tretëve, të cilët gjenden të lidhur me subjektin, por që janë në mirëbesim, duke parashikuar edhe pasoja. Në rastet kur është vendosur një sekuestrim ose konfiskim e kur pas vënies në dijeni për hetimet, personi, kundër të cilit kërkohet të vendoset masa, e tjetëron, shpërndan, transferon, shpërdoron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë, me qëllim për të shmangur ekzekutimin e masës së sekuestrimit ose konfiskimit të saj dhe kur vërtetohet se personi i tretë është në keqbesim pasuria sekuestrohet ose konfiskohet.⁵⁴⁹ Sipas nenit 22 të ligjit,⁵⁵⁰ kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, kryesisht, gjykata, me vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata, ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme. Prokurori kryen çdo hetim të nevojshëm për verifikimin e këtyre pretendimeve.

Kur vërtetohet se pasuria është transferuar ose regjistruar në emër të të tretëve, me veprime fiktive ose të simuluar, gjykata konstaton pavlefshmërinë e tyre. Për këtë qëllim, përderisa nuk provohet e kundërta, prezumohen fiktive ose të simuluar edhe transferimet edhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull barrësor, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese kundër personave të afërm si dhe transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull falas apo dukshëm nën vlerën e tregut, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese.⁵⁵¹ Ligji shqiptar nuk e thekson shumë mbrojtjen e interesave të të tretit në mirëbesim, por kjo gjendet si një koncept konvencional, si një parim, i cili zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Lëndëve Psikotrope⁵⁵² kur flet për *“masat, që rezultojnë të nevojshme për të lejuar konfiskimin e të ardhurave nga krimet e vërtetuara, ose i aseteve, vlera e të cilave korrespondon me atë të të ardhurave të tilla, të cilat duhet të paragjykojnë si e drejta e palëve të treta në mirëbesim”*. Konventa e Këshillit të Evropës *“Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve*

⁵⁴⁹ Neni 12/a i shtuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.04.2017 “Sekuestrimi ose konfiskimi i pasurisë së barazvlefshme”

⁵⁵⁰ Neni 22 “Procedurat gjyqësore e konfiskimit”, paragrafi 3, 4 dhe 5.

⁵⁵¹ Paragrafi 5 shkronjat a) dhe b) të nenit 22 “Procedura gjyqësore e konfiskimit”.

⁵⁵² E quajtur ndryshe dhe Konventa e Vjenës 1988, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8722, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në *“Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope”*”.

të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit”⁵⁵³ në nenin 21 të saj parashikon se: “Në shqyrtimin e kërkesave për bashkëpunim, pala e kërkuar pranon ndonjë vendim lidhur me të drejtat e pretenduara nga palët e treta. Njohja mund të refuzohet nëse palët e treta nuk kishin mundësitë e mjaftueshme për të mbrojtur të drejtat e dikujt”. Direktiva 2014/42 /BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3 prill 2014 “Për bllokimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit në Bashkimin Evropian” në artikullin 6 parashikon se: “Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të qenë në gjendje të vazhdojnë me konfiskimin e të ardhurave nga krimi ose pasuri të tjera të një vlere, që korrespondon me të ardhurat e përmendura, që janë transferuar, drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekt, nga një i dyshuar ose i pandehur ndaj palëve të treta, ose që janë blerë nga palët e treta nga një i dyshuar ose i pandehur, të paktën nëse ato palë të treta e dinin se transferimi kishte për qëllim shmangien e konfiskimit, në bazë të fakteve dhe rrethanave konkrete, duke përfshirë edhe faktin se transferimi ose blerja është bërë pa pagesë ose kundërdrejt pagesës së një shume dukshëm më e ulët se vlera e tregut”.

Pavarësisht se fryma e Direktivës u reflektua në ligjin “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar”, me ndryshimet e vitit 2017 (nenit 12/a e ligjit), por jo kaq në mënyrë përshkruese, mund të vihen në pah disa tregues të kriterëve, që mund të ndiqen për të vlerësuar nëse personi i tretë është në mirëbesim ose në keqbesim. Të tillë janë: dijenia se transferimi kishte si qëllim shmangien e konfiskimit; transferimi ose blerja është bërë pa pagesë ose kundërdrejt pagesës së një shume dukshëm më e ulët se vlera e tregut.

Një çështje me interes të analizohet janë kriteret, mbi bazën e të cilave, mund të përcaktohet nëse i tretë është në mirëbesim dhe të provuarit e të qenurit në keqbesim ose në mirëbesim. Çështja më delikate në rastin e zbatimit të ligjit shqiptar është ajo e raportit të kreditorëve me pasurinë, e cila është vënë nën sekuestro e kërkohet të konfiskohet. Për shembull, banka titullare e hipotekës mbi pasurinë e paluajtshme të sekuestruar; kreditori ndaj ndërmarrjes së sekuestruar etj. Marrëdhëniet kreditore janë marrëdhënie tregtare/financiare, që rregullohen nga Kodi Civil. Parimisht, një

⁵⁵³ Ligji nr. 9646 datë 27.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit”, Fletore Zyrtare nr. 134, datë 22. 12. 2006.

marrëdhënie e tillë është në mirëbesim. Prandaj duhen mbrojtur interesat e kreditorëve kundrejt konfiskimit të pasurisë nën kreditim.

Një vlerësim tjetër, duhet të kemi në rastin kur institucionet e kreditimit, si bankat, përfshihen në një marrëdhënie kreditimi me një person, shoqëri, tregtare, person fizik, i cili është i përfshirë në një aktivitet kriminal në kuadër të krimit të organizuar.⁵⁵⁴ Parimisht, një marrëdhënie kreditimi në rastet kur kredidhënës janë institucionet bankare duhet të jetë një marrëdhënie mirëbesimi. Në praktikën gjyqësore nuk ka kritere të vlerësimit të mirëbesimit të të tretit, prandaj referimi bëhet te kriteret e përcaktuara në të drejtën civile. Gjithsesi, mirëbesimi është një rrethanë, që duhet të provohet e të vërtetohet si rezultat i rregullave të një marrëdhënie tregtare, ekonomike, biznesi, kreditimi.

Karakteristika në marrëdhënien e të tretit me subjektin, apo me procedimin e parandalues si dhe mbrojtjen e atij që është në mirëbesim janë:

- pala e tretë (*bartës i së drejtës reale të garancisë*) gjen mbrojtje para gjyqtarit në fazën e parë të sekuestrimit e në atë të ekzekutimit të sekuestrimit
- mbrojtja e së drejtës reale i mbijeton konfiksimit në rastet kur marrëdhëniet është në mirëbesim, sipas rregullave të kodit civil, të cilat rregullojnë kredinë, hipotekën pengun, kaparin dhe të drejtën e natyrshme mbi to *ius distrahendi*, disiplina e masve parandaluese patrimoniale, kolektarerali, kredidhëniet në mirëbesim;
- i treti ka barrën e vërtetimit të fakteve të pretendimit të bërë ndaj pasurisë së konfiskuar duke përfshirë mirëbesimin e lartpërmendur;
- mirëbesimin duhet ta provojë i treti në kuptimin që ky ka përmbushur detyrimet për marrjen e informacionit për subjektin, me të cilin ka hyrë në marrëdhënie biznesi si i treti;
- pronari i së drejtës reale të garancisë mund të kërkojë të drejtën e tij para gjykatës, që ka vendosur sekuestron ose konfiskimin;
- të drejtat e të tretëve dhe mirëbesimi duhet të vlerësohen në mënyrë të kujdesshme.

⁵⁵⁴ Personat që akuzohen/dyshohen/ ose janë dënuar për një nga veprat penale të parashikuara në kompetencën e përcaktuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH” “Veprat penale në kuadër të organizatave kriminale si neni 28 i Kodit Penal: Forma të veçanta të bashkëpunimit, neni 333 i Kodit Penal: Organizata kriminale, neni 333/a i Kodit Penal: Grup i strukturuar kriminal, neni 334 i Kodit Penal: Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 4, datë 27.01.2021, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës së kërkuarve Y. N. (alias Xh. P.) dhe M. N. , me objekt: “Revokimin e Vendimit nr.16, datë 01.08.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me Vendimin nr.145, datë 27.08.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kryesisht, për sekuestrimin e pasurive të shtetasve Y.N. “duke arsyetuar se: “Në lidhje me pasuritë e fituara (investuara) me kredi bankare (pretendim i kërkuarve dhe i bankave në proces), gjykata vlerëson se nuk justifikohen si pasuri të fituara me të ardhura të ligjshme. Ata janë blerë (investuar) me kredi të marra nga autoriteti financiar, por kështu e shlyerjes së tyre nuk provohen të vijnë nga një aktivitet i tillë. Është detyrim i kërkuarit (subjektit) të provojë burimin e ligjshëm të kësteve që shlyejnë këto kredi. Përpos sa më lart, kjo gjykatë vlerëson se hetimi pasuror duhet parë i lidhur me origjinën e tyre, duke mos u marrë të shkëputura nga njëra-tjetra. Barra e provës së subjektit Y.N. dhe bashkëshortes së tij, shtetas M.N., për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tyre, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkt i veprave penale ose investim i tyre, do të jetë objekt i shqyrtimit të kësaj çështjeje në themel, në konformitet të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 (të ndryshuar) dhe Kodit të Procedurës Penale. Analiza e detajuar ekonomiko-financiare, nuk është objekt shqyrtimi i këtij gjykimi”.*

5.5.1 Pozita procedurale e personave të tretë, veçanërisht i kreditorëve dhe bankave, interpretime të ligjit në praktikën gjyqësore

Në interpretimin e ligjit, në tërësinë e praktikës gjyqësore të Gjykatave, një çështje e diskutueshme ka qenë ajo se kush hyn në kategorinë e personave të tretë e nëse konsiderohen si të tillë blerësit në mirëbesim, huadhënësit dhe bankat si kreditorë të tyre, në veçanti.⁵⁵⁵ *Po cila është pozita e bankave dhe kreditorëve si persona të tretë dhe a garanton ligji mbrojtje për to gjatë konfiskimit të pasurisë që bankat kanë kredituar?* Qëndrimi më i zakonshëm është ai sipas 22, pika 3 të Ligjit 10192, datë 03.12.2009, ku personat e tretë mund të thirren kryesisht nga gjykata ose prokuroria, kur ata tërheqin interesa pronësie dhe kur nuk mund të ngatërrohen me personat e tretë, të parashikuar në KPC. Kjo rrjedh prej argumentimit se të drejtat janë mbi pasuritë e të cilëve bien

⁵⁵⁵Vendimi nr. 74, datë 112/03/2021 Gjykatës së Apelit kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

efektet e këtij ligji, e që për nuk mund të ngatërrohen me “*personin e tretë*” në marrëdhëniet civile, janë “a) *personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi)*, për të cilët presumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta; b) *personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre*”.⁵⁵⁶

Po ashtu, të tillë janë edhe personat që pretendojnë se janë pronarë të pronës në fjalë, ose që pretendojnë se kanë të drejta të tjera pronësore (*‘të drejta reale’, ‘ius in re’*), siç është e drejta e uzufuktit sipas pikës (33) Direktiva 42/2014/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 3 Prillit 2014, mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Evropian.⁵⁵⁷ Kështu, nëse për ata që pretendojnë se janë pronarë të pronës në fjalë (*e drejtë reale*) sipas ligjit shqiptar përfshihen: a) *personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi)*, për të cilët presumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta; b) *personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre*⁵⁵⁸, për ata ‘që pretendojnë se kanë të drejta të tjera pronëse duhet të kuptohen ata që kanë ‘ius in re’. Dhe në kuptim të asaj se tani shprehja ‘ius in re’ përdoret për të përshkruar të drejtën e shoqëruar me nëdorësinë/posedimin.

Shprehja “*Jus ad rem*”, përdoret për të përshkruar një të drejtë pa pasur nëdorësinë/posedimin. Ndërsa “*ius in re*”, përdoret në kuptim pak më të gjerë, e para tregon një të drejtë të paplotë, ose jo të plotë për një send. E dyta është një e drejtë e plotë dhe e përsosur (*pa të meta, pa gabime, pa boshllëqe, pa mungesa*) e një sendi, ‘ius in re’ nënkupton pasjen në nëdorësi të sendit. Nga sa,

⁵⁵⁶ Gërma 'a' dhe 'b', neni 3, ligji 10192/2009 i ndryshuar.

⁵⁵⁷ Direktiva 42/2014/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 3 Prillit 2014, mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Evropian³.

⁵⁵⁸ Gërma 'a' dhe 'b', pika 2, neni 3, ligji 10192/2009 i ndryshuar

rrjedhimisht në *'ius in re'* përfshihet jo vetëm uzufrukti, i sugjeruar si shembull nga paragrafi 33, Direktiva 42/2014/EU Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3.4.2014, mbi sekuestrimin dhe mbi instrumentet e produkteve të krimit në Bashkimin Evropian, por edhe qiraja, huapërdorja, apo enfiteoza, të drejta këto, të cilat nënkuptojnë nëdorësinë e sendit. Për këtë ekziston qëndrimi⁵⁵⁹ se në gjykimin e konfiskimit sipas ligjit 10192/2009 i ndryshuar, personat për t'u thirrur në gjykim janë edhe ata që gëzojnë njëren prej këtyre të drejtave, mbi sendet që kërkohet të konfiskohen.

Edhe në rastin pozitiv të ndryshimit të pronësisë mbi sendet objekt i këtij gjykimi, këta persona kanë të drejtë të ruajnë sipas rastit uzufruktin, qiranë, huapërdorjen, apo enfiteozën, gjë që në interesin e tyre. Lidhur kjo me idenë se marrëdhënia e kredisë rregullohet sipas normave mbi huanë, të parashikuara në legjislacionin material civil⁵⁶⁰ dhe me dhënien e shumës së të hollave, pronësia mbi këto të holla humb dhe fitohet nga huamarrësi. Kjo do të thotë, sipas qëndrimit të disa gjykatave, se mbi shumat e dhëna hua nga kredi-dhënës si banka, pronësia e tyre ka humbur, prandaj dhe ato nuk i përkasin më kësaj të fundit.

E drejta e 'Hipotekës', ajo është një e drejtë, e cila nuk nënkupton edhe nëdorësinë, pra një e drejtë *'jus ad rem'*, pa pasur nëdorësinë/posedimin mbi sendet e hipotekuara. Si e tillë, ajo nuk është e drejtë *'ius in re'*, për të cilën, në mënyrë të shprehur, referon paragrafi 33, Direktiva 42/2014/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3.4.2014, mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Evropian, se pala/personi i tretë duhet të dëgjohet e kështu të thirret në gjykim.⁵⁶¹ Interesi për t'u mbrojtur ka vetëm palët e treta që pretendojnë se janë pronarë të pronës në fjalë (*'drejtë reale'*) (*'real rights'*) ose 'që pretendojnë se kanë të drejta të tjera pronësore' (*'or who claim that they have other property rights'*) (*'ius in re'*), asnjërin prej të cilave nuk ka banka që jep kredinë.

Në ligjin tonë nuk del shumë i qartë vullneti i ligjvënësit për rrethin e personave që thirren ose ndërhyjnë si persona të tretë në procedurën e konfiskimit, duke përfshirë personat e përcaktuar në

⁵⁵⁹ Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me vendimin nr. 51, datë 28.03.2022.

⁵⁶⁰ Neni 1050 Kodi Civil.

⁵⁶¹ Qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 51, datë 28.03.2022 duke cituar Vendim nr. 9/2010 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Vendimi n.4/2011 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Çështja Marini kundër Shqipërisë, pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

gërmat “a” dhe “b” të nenit 3/2 të ligjit parandalues. Në praktikë, ka patur raste të interpretimit të gabuar në përmbajtjen e paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 22 të Ligjit parandalues, duke krijuar dallime artificiale për të drejtat e reale të pronësisë, që personat e tretë mund të mbrojnë në një procedurë konfiskimi. Si referim, mund të sjellim një rast⁵⁶² të praktikës gjyqësore, sipas të cilit, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se personat e tretë, pretendimet e tyre mund t’i parashtrojnë në fazën e konfiskimit. Ndonëse ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është nxjerrë përpara Direktivës nr. 4/2012 në BE, në lidhje me rrethin e personave që duhet të legjitimohen në mbrojtje të interesave të tyre në procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të subjektit të dyshuar, ka përdorur mjetin term “*persona të prekur*”, ku përfshihen edhe personat e tretë, që lejohet të ndërhyjnë sipas parashikimit të nenit 22/3 të ligjit parandalues.

Edhe pas ndryshimeve me ligjin 70/2017, në ligjin parandalues, përsëri praktika gjyqësore e Gjykatave të Posaçme, ka qenë në të njëjtën linjë, duke konsoliduar qëndrimin, sipas së cilit, kërkesat e palëve në fazën e sekuestrimit kufizohen brenda rrethit të personave të parashikuar nga paragrafët “a” dhe “b” të nenit 3/2 të ligjit parandalues, ndërsa në fazën e konfiskimit, sipas përmbajtjes së nenit 22/3, janë lejuar të ndërhyjnë në proces personat e tretë, që janë prekur nga procedura e sekuestrimit të pasurive. Garancitë procedurale, e drejta e pronësisë, e drejta për një proces të rregullt ligjor për personat e tretë, në raport me personat e lidhur, janë një element i rëndësishëm i këtij ligji, i rregulluar në mënyrë të veçantë në ndryshimet e bëra me ligjin nr. 70/2017, datë 27.04.2017, por që duhen interpretuar në mënyrë koherente, në përputhje me normat e standardet ndërkombëtare siç u argumentua dhe më sipër.

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në kuadër të procesit të rregullt ligjor, ofron një sërë garancish për subjektin i cili i nënshtrohet masave parandaluese kundër pasurisë dhe personave të tretë, duke parashikuar që shtetet palë gjatë procesit të konfiskimit të pasurisë nuk duhet të cenojnë të drejtat e palëve të treta në mirëbesim. (*neni 12, pika 8 e Konventës së Palermos*). Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Lëndëve Psikotrope kur flet për “*masat që rezultojnë të nevojshme për të lejuar konfiskimin e të ardhurave nga krimet e vërtetuara ose i aseteve vlera e të cilëve korrespondon me atë të të ardhurave të tilla, të cilat duhet të paragjykojnë si e drejta e palëve të treta në mirëbesim*”.

⁵⁶² Vendimi i Gjykatës së Apelit të Posaçëm nr.49, datë 15.05.2018

Konventa e Këshillit të Evropës “*Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe për Financimin e Terrorizmit*” parashikon në nenin 21 se “*Në shqyrtimin e kërkesave për bashkëpunim, pala e kërkuar pranon ndonjë vendim lidhur me të drejtat e pretenduara nga palët e treta. Njohja mund të refuzohet nëse palët e treta nuk kishin mundësitë e mjaftueshme për të mbrojtur të drejtat e dikujt*”.

Direktiva 2014/42/BE “*Për sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të veprës penale në Bashkimin Evropian*” si një akt rekomandues për standardin e së drejtës evropiane, parashikon që meqenëse masat parandaluese, prekin të drejtat e personave, jo vetëm atyre të dyshuar apo të akuzuar, por dhe të palëve të treta të cilat nuk janë në procedim penal, është i nevojshëm përcaktimi i një mbrojtje specifike dhe i mjeteve juridike të përshtatshme në mënyrë që të garantohet ruajtja e të drejtave themelore në zbatim të direktivës si e drejta për tu dëgjuar e palëve të treta të cilat pretendojnë se janë pronarë të pasurive mbi të cilat shtrihen masat ose që gëzojnë të drejta reale mbi to.

Jurisprudenca e GJEDNJ thekson se procedimet *in rem*, që nuk lidhen me gjetjen apo ndëshkimin e autorit, nuk mbulohen nga paragrafi 3 i Nenit 6 të KEDNJ që ka të bëjë me të drejtat e personave të akuzuar për një vepër penale, por vetëm nga paragrafi i parë i këtij neni, e drejta për një proces të rregullt ligjor, prandaj tashmë modelet e konfiskimit pasurur në vendet anëtare të BE ndjekin parimet e procesit të rregullt ligjor. GJEDNJ e ka interpretuar nenin 1 të Protokollit shtesë nr. 1 të Konvetës në kuptimin që çdo person fizik e juridik ka të drejtën e gëzimit të lirë të pasurisë.⁵⁶³ Mbrojtja e personave të tretë ka gjetur trajtim në jurisprudencën e GJEDNJ. Në një sërë vendimesh të GJEDNJ (*Vendimi Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë, datë 1 prill 2010, GJEDNJ*) gjykata ka mbajtur qëndrimin se vlerësimi i pretendimeve për cenim të nenit 1 të Protokollit, do të bëhet nisur nga fakti se sa palët e treta kanë patur mundësi për të paraqitur pretendimet e tyre në gjykatat vendase, duke vënë theksin tek elementët e sjelljes e faktit.

⁵⁶³ GJEDNJ Çështja Brems, Vendimi i GJEDNJ 2005, Vendimi Caste of Balsamo kundër San Marino, aplikimi nr. 20319/17 dhe 21414/17, GJEDNJ, 8 tetor 2019.

Ndryshimet e ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, me ligjin nr. 70/ 2017, datë 27.04.2017, një nga synimet që ka pasur për mbrojtjen e personit të tretë në mirëbesim dhe parashikimet për sanksionet ndaj personave të tretë në keqbesim. Kështu citojmë përmbajtjen e nenit 12/a, të shtuar me ligjin 70/2017 në ligjin parandalues, sipas të cilit ligjvënësi rregulloi veprimin e masave parandaluese mbi pasuritë e personit të tretë kur është në keqbesim. Kjo dispozitë parashikon se: 1. *Sekuestrimi ose konfiskimi vendoset mbi mjete monetare ose mbi çdo pasuri tjetër në zotërim të personave të përmendur në nenin 3, të këtij ligji, kur, pas marrjes në dijeni për hetimet në ngarkim të tij, personi, kundër të cilit kërkohet të vendoset masa tjetërsion, shpërndan, transferon, shpërdoron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë, me qëllimin për të shmangur ekzekutimin e masës së sekuestrimit ose konfiskimit të saj.*

Neni 22 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 70/ 2017, datë 27.04.2017, në paragrafin 3 parashikon se “*Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, gjykata, edhe kryesisht me vendim të motivuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme. Prokurori kryen çdo hetim të nevojshëm për verifikimin e këtyre pretendimeve*”.

Ky nen në një interpretim *strictu sensu*, mund të kuptohet se të drejtën për të ndërhyrë në proces ia ka njohur personave të tretë që rezultojnë se u përkasin pasuritë, pa përcaktuar më tej se kush janë këta persona. Sigurisht që koncepti i pronësisë, apo se kujt i përket pasuria është një koncept i së drejtës civile, së pari, dhe pastaj një gjendje fakti, që lidhet me procedimin penal. Paragrafi i 5 i këtij neni parashikon rastin kur pasuria është regjistruar në mënyrë fiktive tek i treti, kjo në vijim të parashikimit në përmbajtjen e nenit 12/a të ligjit. Nga gjithë kjo analizë ligjore, konkludojmë se ligji ka qëllim të mbrojë të tretin me mirëbesim.

Disa nga praktikat gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Apelit, prej të cilave veçojmë arsyetimin e vendimit nr. 49, datë 15.05.2018 kur arsyeton se: “*Sa i përket të drejtës materiale të personave*

të tretë, për të kërkuar nga gjykata mbrojtjen e interesave të tyre, kolegji çmon se pretendimet e tyre mund të lidhen vetëm me fazën e dytë të këtij gjykimi, që është faza e konfiskimit sipas rregullimeve të parashikuara në nenin 27 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, dhe se pretendimet e tyre nuk mund të zgjidhen sipas rregullave të parashikuara nga KPP". Në një rast një bankë pretendon se vendimi nr. 51 datë 28/03/2022, i Gjykatës së Posaçme të Apelit, që refuzon legjitimitimin e saj si person i tretë, vjen në kundërshtim edhe me praktikën dhe jurisprudencën e mëparshme të Gjykatave përfshirë edhe vendimin nr.74, datë 11/03/2021 të cituar në pjesën hyrëse për faktin se për këtë vendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nuk ka shmangur, mundësinë e legjitimitetit të bankave të nivelit të dytë në fazën e konfiskimit.

Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. 74, datë 11/03/2021, ka shqyrtuar kërkesën për revokimin e sekuestros, në mënyrë të qartë është shprehur në favor të së drejtës së shoqërisë "R. Bank" sh.a., për t'u thirrur dhe për të ndërhyrë në fazën e procedurës gjyqësore të konfiskimit. Disa prej shtesave dhe ndryshimeve të bëra në ligjin parandalues me ligjin 70/2017, kanë ruajtur qasjen e mëparshme për konceptin e personave të tretë sipas neneve 189 e vijues të KPC.⁵⁶⁴ Bëhet fjalë për përmbajtjen e nenit 12/a, të shtuar me ligjin 70/2017 në ligjin parandalues, sipas të cilit ligjvënësi rregulloi veprimin e masave parandaluese mbi pasuritë e personit të tretë kur është në keqbesim.⁵⁶⁵

Meqenëse edhe ndryshimet me ligjin 70/2017 nuk e kanë ndryshuar përmbajtjen e paragrafëve "3" dhe "4" të nenit 22, të ligjit 10 192, shoqëritë bankare në praktikë kanë pretenduar se nuk ka asnjë arsye që të privohet nga të drejtat e saj për të ndërhyrë në procesin e konfiskimit të pasurive të të dyshuarve, në kushtet kur, sipas të drejtave reale të *hipotekës* dhe *barrave siguruese*, disa prej pasurive të sekuestruara, i përkasin plotësisht ose pjesërisht kësaj Pale. Diskutimi mbi rrethin e personave, që përfshihen në përmbajtjen e nenit 22, të ligjit 10 192, datë 03/12/2009, nga njëra anë

⁵⁶⁴ Si në përmbajtjen e ligjit 9284, datë 30/09/2004 ashtu edhe në ligjin nr. 10 192 datë 03/12/2009 para ndryshimeve të vitit 2017.

⁵⁶⁵ *Sekuestrimi ose konfiskimi vendoset mbi mjete monetare ose mbi çdo pasuri tjetër në zotërim të personave të përmendur në nenin 3, të këtij ligji, kur, pas marrjes në dijeni për hetimet në ngarkim të tij, personi, kundër të cilit kërkohet të vendoset masa tjetërsion, shpërndan, transferon, shpërdoron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë, me qëllimin për të shmangur ekzekutimin e masës së sekuestrimit ose konfiskimit të saj.*

pranon “*edhe personat që pretendojnë se kanë të drejta të tjera pronësore*”⁵⁶⁶sepse edhe në rastin pozitiv të ndryshimit të pronësisë mbi sendet objekt të këtij gjykimi këta persona kanë të drejtë të ruajnë sipas rastit uzufruktin, qiranë, huapërdorjen apo enfiteozën, çka është edhe interesi i tyre për t’u dëgjuar. Përrjashtimi nga e drejta e pjesëmarrjes në këtë procedurë konfiskimi, personat, që kanë të drejtë në hipotekë apo në barrë siguruese mbi pasuritë e sekuestruara, sikurse është edhe rasti i bankave është një praktikë e gabuar.

Të drejtat reale të Hipotekës dhe Barrëve Siguruese, ndonëse nuk nënkuptojnë nënpronësinë apo posedimin e sendeve përkatëse, pas regjistrimit të tyre në regjistrat përkatëse, krijojnë për përfituesin e këtyre të drejtave, raporte të drejtpërdrejta me sendet, duke pasur madje akses në të drejtën më thelbësore të pronarit të drejtën e disponimit. Në një rast, Gjykatat kanë mbajtur qëndrimin se hipoteka/barra ndjek fatin e sendit pra dhe në rastin se këto sende të hipotekuara/barrësuar do të ndërronin pronar ato do të transferoheshin te pronari i ri, së bashku me detyrimin sipas hipotekës/barrës dhe kështu të drejtat reale të janë të mbrojtura nga regjimi juridiko civil. Por është e pamohueshme që kjo çështje do të gjente një zgjidhje me të plotë dhe të drejtpërdrejtë nëse nga gjykata do të pranohej në gjykim për të dhënë sqarime lidhur me këto pasuri të barrësuar.

Për të ilustruar se si këto çështje komplekse mund të dëmtojnë interesat e një pale të tretë me të drejta reale mbi një pasuri, të cilat mund të evitoheshin nëse kjo palë do të thirrej në gjykim, po marrim për simetri të këtij argumenti rastin e një shoqërie *leasing* që mund të ketë nënshkruar me shoqërinë/subjektin e vënë në sekuestro disa kontrata qiraje financimi (*leasing*) për blerjen e disa mjeteve. Shoqëria ka nënshkruar disa kontrata për blerjen e disa mjeteve. *Këto mjete sipas kontratës mbeten në pronësi të bankës deri në momentin e shlyerjes së kështit të fundit. Pra momentalisht këto pasuri janë në pronësi të bankës dhe pavarësisht kësaj, gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të tyre, Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara kërkon që të pezullohet ekzekutimi mbi këto pasuri pasi sipas saj këto pasuri janë të sekuestruara dhe asnjë detyrim nuk mund të ekzekutohej ndaj tyre.* Në nocionin e “pasurisë” që mbron Konventa dhe paragrafi i parë i nenit ‘1’ të Protokollit të saj.

⁵⁶⁶ Të drejta reale “*ius in re*”, siç është e drejta e uzufruktit por edhe qiraja, huapërdorja apo enfiteoza.

Sipas “Udhërrëfyesit praktik për pranueshmërinë e Ankimeve” në GJEDNJ⁵⁶⁷, rezultojnë se: “Nocioni i ‘pasurisë’ ka një rëndësi autonome.... dhe është i pavarur në raport me cilësimet formale të së drejtës së brendshme: *disa të drejta dhe interesa të tjera, që përbëjnë aktivet mund të konsiderohen gjithashtu si ‘të drejta pronësie’ dhe si ‘pasuri’, sipas kuptimit të kësaj dispozite*”. Për nocionin “pasuri” GJEDNJ e ka trajtuar edhe për Personat e Tretë (*bonafide*) në procedura të ndryshme konfiskimi të pasurive, sikurse ka ndodhur në një çështje,⁵⁶⁸ kur shprehet: “53. Gjykata përmend se termi ‘pasuri’ tek neni 1 i Protokollit 1 ka kuptim autonom që, sigurisht, nuk kufizohet në pronësinë e të mirave materiale: *disa të drejta dhe fitime të tjera, që përbëjnë asete, gjithashtu, mund të konsiderohen, për qëllime të kësaj dispozite, si të drejta të pronësisë dhe, kështu, si pasuri. është e parëndësishme nëse e drejta e ‘Gasus’-it ndaj beton-përzierës duhet konsideruar si e drejtë pronësie apo si e drejtë e siguruar nga objekti i veprimtarisë. Në çdo rast, konfiskimi dhe shitja e beton-përzierës kanë përbërë kufizim të së drejtës së shoqërisë palë kërkuese për të gëzuar qetësisht një ‘pasuri’ në kuptimin e nenit 1 të Protokollit* .

Duke shpjeguar kuptimin autonom të nocionit “pasuri”, GJEDNJ ka përfshirë mbrojtjen e Personave të Tretë për të drejtat e siguruarat përmes kontratës, që kanë pasur me personat, pasuritë e të cilave kanë qenë në proces konfiskimi. Madje, GJEDNJ ka shkuar më tej kur ka trajtuar konceptin “*Të ardhurat e pritshme në të ardhmen*” të cilat merren në mbrojtje nga Protokollit 1 i KEDNJ. Në dokumentin e cituar më sipër,⁵⁶⁹ rezultojnë se jurisprudenca e Gjykatës ka përcaktuar se: “Nocioni “i pasurisë” mund të përfshijë si “pasuri aktuale”, ashtu edhe vlerat trashëgimore, si dhe detyrimet në bazë të të cilave kërkuesi mund të pretendojë të paktën një “shpresë të ligjshme” që të gëzojë me të vërtetë të drejtën e pronësisë.”⁵⁷⁰ “Të ardhurat e pritshme në të ardhmen” “konsiderohen si “pasuri”, kur ekziston kundrejt tyre një detyrim që sanksionohet nga drejtësia.”⁵⁷¹

⁵⁶⁷ Udhërrëfyesit praktik për pranueshmërinë” së Ankimeve në GJEDNJ, shih www.echr.coe.int

⁵⁶⁸ GJEDNJ, çështje “Gasus Dosier- und Fördertechnik GmbH kundër Holandës” (23/02/1995), www.echr.coe.int

⁵⁶⁹ Po aty

⁵⁷⁰ GJEDNJ, J.A.Pye Oxford Ltd etj kundër Mbretërisë së Bashkuar (DHM) &61) www.echr.coe.int

⁵⁷¹ GJEDNJ, Lan Edgar Liverpool Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar, parag. Anheuser Busch Inc. kundër Portugalisë (DHM) pgr 41). www.echr.coe.int

Sipas studiuesit të të drejtës private italiane Dr.Francesco Galgano ⁵⁷²në interpretimin e nocionit të të drejtës reale të hipotekës shprehet se: *"Jurisprudencia italiane nisur edhe nga shtrirja progresive e të drejtave të kreditit u ka njohur atyre një mbrojtje absolute [...] të drejtat e kredisë/hipotekës janë bërë kështu, të drejta pasurore të mbrojtura ndaj kujt do"*. Legjislacioni francez (i cili ka ndryshuar me qëllimin për t'ju përafruar direktivës së sipërcituar) mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve kriminale ka zhvendosur limitet e parimeve të përgjithshme të drejtës penale, jo vetëm përmes institucionalizimit të një sistemi të zgjeruar të zhvendosjes së barrës së të parë të KEDNJ dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së. Procedura e konfiskimit, karakterizohet si faza përfundimtare e hetimit të objektit të çështjes, dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme që Gjykata të jetë e qartë në lidhje me subjektet dhe objektet që duhet të marrin pjesë dhe sendet që duhet të konfiskohen.

Sipas nenit 21 të Ligjit ⁵⁷³, barrën e provës në lidhje me pasuritë e sekuestruara e kanë personat që preken nga sekuestrimi i këtyre pasurive. Gjykatat, në vendimarrjen e tyre e kanë kufizuar rrethin e personave të cilët mund të ngrenë pretendime si personat e afërt, por ndërkohë ligji nuk kufizon gjykatën që në bazë të një dyshimit të arsyeshëm të sekuestrojë çdo pronë ku personi i dyshuar mund të ketë fshehur apo transferuar pasurinë. Ky ligj përjashton personat me keqbesim. *Cili është roli që kanë Bankat në lidhje me pasuritë e personave të dyshuar të cilat janë sekuestruar, por ndërkohë burim për blerjen e tyre janë kreditë e marra pranë Bankave, apo këto prona janë zhvilluar nga marrja e kredive ?* Qëllimi i ligjvënësit në lidhje me aplikimin e këtij ligji, është fakti i parandalimit të disponimit të pasurive të personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore të disponojnë pasuri të palegjitimuara. Por, ndërkohë këto prona janë blerë apo zhvilluar jo me të ardhurat e personave të dyshuar, por me kreditë e marra pranë bankave ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat, vlerësoj se interesi i bankës në rastin konkret është e qartë pjesëmarrja e bankës do të reflektonte dhe një vendimarrje sa më objektive duke sqaruar pozicionin e personit që i konfiskohet prona, por dhe subjekteve të tjera që kanë interesa të ligjshme dhe janë në marrëdhënie mirëbesimi.

⁵⁷² Dr. Francesco Galgano, E drejta private, pjesa e parë, Shtëpia botuese Luarasi, 2003, faqe 151

⁵⁷³ Ligji nr. 10 192, datë 03.12.2009 (i ndryshuar)

Ndryshimet ligjore, që i janë bërë ligjit, ku tani për procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit gjykatat duhet t'i referohen Kodit të Procedurës Penale, është rrjedhojë e ndarjes së juridiksionit penal me atë civil, ku gjykatat e juridiksionit penal veprimtarinë e tyre e bazojnë mbi legjislacionin penal, kur dy institute parashikohen njëkohësisht në të dyja juridiksionet. Por, gjykatat në procedurën e sekuestrimit/konfiskimit kanë të drejtë që të vlerësojnë ndryshe nga sa mund të mendojë dhe organi i akuzës, dhe ky proces kalon në një fazë hetimi gjyqësor. Nëse ligji i jep të drejtë personave të afërm të paraqesin pretendimet e tyre dhe barrën e provës para gjykatës, qëllimi ka qënë që kush preket nga kjo vendimarrje t'i jepet mundësia e përballjes me barrën e provës.

Nga kjo mundësi dhe në kuadër të dhënies së drejtësisë nuk ka pse të përjashtohet vetëm banka, por çdo person që preket nga kjo vendimarrje dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me pronat e sekuestruara. GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore në lidhje me Ligjin Italian Antimafia, që për nga qëllimi dhe mënyra se si procedohet është i ngjashëm me Ligjin nr. 10 192, datë 03.12.2009 (i ndryshuar), arsyeton se, fakti që nga shtetet kufizohen disa parime në kuadër të interesit publik, nuk do të thotë se gjykatat nuk duhet të jenë të vemëndshme që në vendimarrjen e tyre të zbatojnë parimin e propocionalitetit, dhe dëgjimit të palëve të cenuara.

Ky balancim i interesit publik duhet të jetë objekt i vlerësimit të gjykatave pas një hetimi të drejtë, gjithpërfshirës dhe i bazuar në prova. Gjykatat në disa raste praktike gjyqësore, argumentojnë faktin se, banka nuk është pronare apo poseduese e pronave, për këtë arsye nuk mund të jenë pjesëmarrëse në gjykimin e sekuestrim / konfiskim të tyre. Nëse banka ka dhënë kredi për këto prona, subjekti pa shlyer detyrimet e kredisë nuk mund ta tjetërsojë atë, pasi është vetëm banka ajo që në rast mospërbushje do të bëhet automatikisht pronë e saj. Heqja e disponimit të këtyre pronave personave të dyshuar për krime dhe korrupsion, është qëllimi i ligjit për të penguar vazhdimin e veprimtarisë së tyre, por gjykata nuk duhet të jetë indiferente ndaj personave që ligjërisht kanë të drejta mbi këto prona dhe faktit se atyre ju refuzohet e drejta për të parashtruar pretendimet e tyre nuk ndihmon në një vendimarrje të drejtë, të bazuar në parimet Kushtetuese, për zhvillimin e veprimtarisë së lirë, të drejtës për akses në gjykatë, të drejtën e pronës dhe parime të tjera të rëndësishme në të cilat bazohet shteti ligjor.

Me vendimin nr. 36 të vitit 2017 Gjykata Kushtetuese⁵⁷⁴ ka arsyetuar në lidhje me rëndësinë që ka marrëveshja bankare për dhënien e kredisë duke justifikuar lëshimin e urdhër ekzekutimit dhe duke justifikuar kufizimin e parashikuara nga neni 17 të Kushtetutës, konkretisht, gjykata arsyeton se: *“Për Gjykatën Kushtetuese paraqet rëndësi të veçantë çështja nëse dispozita ligjore, objekt kontrolli, mbështetet ose jo në kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për të justifikuar në pikëpamje të Kushtetutës, preken e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është e domosdoshme të përmbushen disa kushte siç janë ato që kufizimi të realizohet me ligj, të jetë bërë për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, si dhe të mos cenojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore. Sistemi bankar zë vend të rëndësishëm në strukturat ekonomike të një vendi. Ai është një ndër aktorët kryesorë të ekonomisë së tregut, stabiliteti i të cilit është i lidhur drejtpërdrejt me stabilitetin makroekonomik të vendit. Në një sistem të tillë, bankat funksionojnë si ndërmjetës financiar duke mbledhur dhe grumbulluar mjetet e lira financiare të publikut, në formën e depozitave, për t'i përdorur këto fonde për të ushqyer sistemin e kreditimit. Dhënia e garancive ligjore për kthimin e sigurt të kredive bankare i shërben konsolidimit të sistemit bankar, si dhe ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e depozitave financiare të qytetarëve apo subjekteve të tjerë. Nisur nga ky rol dhe nga atributet që i janë veshur këtij sistemi, parashikimi në ligj i lëshimit të urdhrit ekzekutiv, sipas kërkesës së subjektit bankar, me qëllim shlyerjen e shpejtë të kredisë pas skadimit të afateve kontraktore, ka pasur për qëllim të sigurojë ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet interesit publik nga njëra anë, që synon qëndrueshmërinë e sistemit bankar dhe garantimin e kursimeve të depozituesve, si dhe respektimit të të drejtave të individit për një mbrojtje të plotë ligjore, nga ana tjetër. Duke sanksionuar me ligj aktet e dhënies së kredisë bankare në cilësinë e titullit ekzekutiv, i kërkueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë nga huadhënësi, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ligjvënësi ka ndjekur një qëllim të përligjur dhe të justifikuar, në këndvështrimin e konceptit kushtetues “interes publik”.*

Nevoja për qartësim të konceptit të pronës në vendimet e gjykatave. Veprimtaria e Bankave rregullohet nga një kuadër i gjerë ligjor, dhe veprimtaria e saj, bazohet në të ardhura të depozituara nga publiku i gjerë. Nëse në një formë ligji penal ndëshkon veprimtarinë kriminale, përveç Bankës si institucion privat, kjo vendimarrje ndikon dhe intersa të subjekteve të tjera. Çdo subjekt që ka

⁵⁷⁴ Vendimin nr. 36 të vitit 2017 i Gjykata Kushtetuese, www.gjk.gov.al

interesa të drejtpërdrejta mbi këto pasuri duhet të sqarojë pozicionin e tij, si në mirëbesim apo keqbesim. Për rastin e këtij të fundit, ligji i ka dhënë përgjigje kur automatikisht sendet sekuestrohen, por nuk i jepet përgjigje për subjektet, që kanë qenë në mirëbesim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në praktikën e tij,⁵⁷⁵ pas ndryshimeve ka mbajtur qëndrimin se, “ *personi i tretë nuk ka të drejtë të paraqesë ankim ndaj vendimit të sekuestrimit* “, por në përmbajtje të tij ky vendim argumenton se pala konkretisht Banka T. ka patur mundësinë për të paraqitur pretendimet e saj. Në një rast tjetër, gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrim se subjekti Bankë nuk ka të drejtë për të marrë pjesë si person i tretë, dhe as i është dhënë mundësia të paraqesë pretendimet. Gjykata arsyeton se: “*Në rastin në gjykim, pasuritë janë të regjistruara vetëm në emër të kredimarrësve. Kërkesja, as nuk mund të thirret dhe as nuk mund të lejohet të ndërhyjnë si palë e tretë, në procesin e konfiskimit që po zhvillohet, pasi nuk rezulton se i përket ndonjë prej pasurive objekt gjykimi*”.

Gjykata e Posaçme e Apelit, në vendimin nr.74, datë 11/03/2021, kur ka shqyrtuar, këtë proces pasuror, ankimin për vendimin e gjykatës së shkallës së parë, që kishte shqyrtuar kërkesën për revokimin e pasurive të subjektit të ligjit parandalues Y. N. dhe familjarëve të tij, ka arsyetuar si vijon: “*Neni 12/b i ligjit parandalues përdor termin palë, në paraqitjen e kërkesës për revokimin e sekuestrimit të pasurisë. Duke analizuar në tërësi dispozitat që rregullojnë këtë moment procedural, që lidhet me fazën e sekuestrimit të pasurisë dhe/apo hetimin pasuror, kolegji vlerëson të gabuar vendimmarrjen e gjykatës së posaçme të shkallës së parë, e cila duke referuar në procedurën gjyqësore të gjykimit në themel të këtij procedimi pasuror/ konfiskimi i pasurisë, ka thirrur në gjykim apo ka legjitimuar si palë, disa institucione bankare/banka të nivelit të dytë, me të cilat subjekti i ligjit parandalues ka një marrëdhënie kontraktore. Gjatë fazës së hetimit pasuror ligji përcakton si palë, personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2 të tij, konkretisht: subjekti i ligjit si dhe personat e afërm (sipas shkronjës ‘a’ të pikës ‘2’) dhe personat fizikë apo juridikë, që zotërojnë pasuri apo veprimtari, por për të cilat ka të dhëna se zotërohen plotësisht apo pjesërisht nga subjekti i ligjit parandalues. Bankat e nivelit të dytë janë në cilësinë e kreditorëve në raport me subjektin e ligjit parandalues, element ky që nuk i legjitimon ato si palë në këtë fazë të procedimit pasuror. Secila nga pasuritë, mbi të cilat është vendosur masa e sekuestrimit të pasurisë, figurojnë të regjistruara në pronësi*

⁵⁷⁵ Vendimi nr.00-2021-438, dt.22.06.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

të subjektit të ligjit parandalues dhe personave të afërm të tij (bashkëshortja apo fëmijët). Ky kolegji çmon se haptazi bankat, në cilësinë e kredidhënësve ndaj subjektit të ligjit parandalues, nuk legjitimohen të parashitrojnë pretendime për revokimin e sekuestrimit të vënë në bazë të këtij ligji. Sekuestrimi i pasurisë është një masë parandaluese paraprake, që vendoset për të garantuar vënien në zbatim të konfiskimit, në rast se provohet ekzistenca e kritereve të parashikuara në nenin 24 të këtij ligji....”.

Ky argumentim i Gjykatës së Apelit të Posaçëm, referon me momentin procedural të sekuestrimit, ku për shkak të rëndësisë që ka ndërprerja e veprimtarisë së personit të dyshuar, gjykata vetëm konstaton pronat, që janë në emër të personit të dyshuar dhe të afërmeve të tij, por është faza e konfiskimit ajo që përcjell një hetim më të thellë të objekteve, që kalojnë në favor të shtetit dhe subjekteve konkrete duke iu dhënë dhe këtyre të fundit mundësinë në mënyrë përfundimtare të japin pretendimet në lidhje me objektin e konfiskimit.

Gjykata Kushtetuese⁵⁷⁶, pasi evidenton dallimet mes fazës së sekuestrimit dhe asaj të konfiskimit të pasurive, arsyeton se: “Neni 22 sqaron me hollësi procedurën e konfiskimit. Pra, është më se e qartë se para gjykatës zhvillohet një proces gjyqësor, ku palët shprehin argumentet e tyre dhe kanë mundësi të debatojnë, për të ndikuar vendimmarrjen gjyqësore. Gjykata çmon se këtë vendimmarrje gjykatat e zakonshme nuk mund ta arrijnë pa kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin dhe duke lejuar një debat të plotë gjyqësor.”

Ndërsa Gjykata e Apelit për Krime të Rënda⁵⁷⁷, në arsyetimin dhe duke shtjelluar dallimin mes dy fazave të procedimit pasuror, nuk ka marrë në konsideratë të drejtat materiale të personave të tretë, të ngritura në fazën e sekuestrimit të pasurive, por ka shtjelluar procedurën që duhet të aplikohet, për të drejtat pasurore të këtyre personave, në fazën e konfiskimit, kur arsyetohet se: “Ky kolegji, fillimisht vlerëson të pohojë se pretendimet e mësipërme nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë fillestare e paraprake të procedimit pasuror parandalues. Këto pretendime si rregull i përkasin fazës së konfiskimit të pasurive (neni 21 e vijues i ligjit parandalues), ku barra e provës për të provuar ligjshmërinë e krijimit të këtyre pasurive monetare i takon jo vetëm shtetasit L. S.,

⁵⁷⁶ Në vendimin nr 4/2011 për kushtetutshmërinë e ligjit parandalues.

⁵⁷⁷ Vendimt Nr. 49, datë 15.05.2018 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

që ipso lege dyshohet se nuk i ka fituar ligjërisht, por edhe personave të tretë, me të cilët shtetasi i dyshuar S., pretendon se i ka realizuar kontratat e sipërmarrjes, për disa pasuri të paluajtshme. Gjatë gjykimit të konfiskimit personat e tretë, sipërcituar duhet të konstituohen si palë (person i tretë), në zbatim të nenit 22/3 të ligjit parandalues pasuror, mbi kërkesën e tij. Kjo Gjykatë Apeli rithekson, në përgjigje të pretendimeve të artikuluar në ankim dhe që lidhen me procesin e konfiskimit të pasurisë, se çdo pretendim mbi të drejtën e personit për të vërtetuar se këto pasuri i ka fituar në mënyrë të ligjshme, mund të realizohen në fazën e gjykimit në themel të kësaj kërkeje “Për konfiskimin e pasurisë”, në respektim të nenit 21, pika 3, e ligjit të sipërcituar....”.

Në një Vendim të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë⁵⁷⁸ për legjitimimin e personave të tretë, arsyetohet se : *Në gjykimin me objekt konfiskimin e pasurisë, kjo Gjykatë në përputhje me parashikimet e nenit 22/3 të ligjit parandalues, për shkak se disa prej pasurive objekt konfiskimi ishin në emër të personave të tjerë, thirri si persona të tretë për të ndërhyrë në këtë gjykim, pasi tërheqin interesa: Shoqërinë “B-KO” SHPK, me administrator shtetasin Bashkim Balili, Shoqërinë “DAED” sh.p.k., me administrator shtetasin D.N. dhe shtetasit G.A. A.A, L. e G.C., E.M, E.L., B.R., dhe L.K.. Këta të fundit u thirrën si Persona të Tretë në gjykimin e konfiskimit sepse kishin financuar në ndërtimin e apartamenteve të të dyshuarit K. Balili, me kontrata sipërmarrje”. Ndërsa në përfundim të procesit të konfiskimit, sipas dispozitivit të këtij vendimi del se për të gjitha pasuritë e financuara nga personat e tretë, ishte vendosur “Revokimin e sekuestros së vendosur me vendimin Nr.28, datë 21.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe kthimin pronarëve të tyre për pasuritë e mëposhtme.”⁵⁷⁹*

Banka duhet të mbrojë interesat e saj pasurore mbi një pjesë të pasurive objekt konfiskimi, dhe që janë të veshura me të drejta pronësore, që përfshihen në përmbajtjen e nenit 22/3 të ligjit parandalues. Këto të drejta mbrohen edhe nga nenet 17/2 dhe 42 të Kushtetutës si dhe KEDNJ dhe janë në përputhje me aktet e tjera ndërkombëtare sikurse është Direktiva nr. 42/2014 të BE,

⁵⁷⁸ Në vendimin nr.18 e datë 21/09/2020 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

⁵⁷⁹ Ky vendim i gjykatës së faktit ka marrë formë të prerë sepse Kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, me vendimin nr. 33 vendimi, datë 09/02/2021 ka vendosur “Mospranimin e ankimit të paraqitur nga ankuesit B. B.dhe shoqëria “Balili & Co” sh.p.k., nëpërmjet mbrojtësit, ndaj vendimit nr. 18, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Për bllokimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Evropian”. Ky argument gjen mbështetje edhe në nocionin e “pasurive” që mbron Konventa dhe Paragrafi i parë i nenit “1” të Protokollit të saj. GJEDNJ shpjeguar në kuptimin autonom të nocionit “pasuri”, ka përfshirë mbrojtjen e Personave të Tretë për të të drejtat e siguruar përmes kontratës, që kanë pasur me personat, pasuritë e të cilëve kanë qenë në proces konfiskimi.⁵⁸⁰

Në lidhje me të drejtën e ankimit ndaj vendimit për konfiskimin referuar nenit 27/2, të Ligjit 10192, datë 03.12.2009, personi i tretë ndodhet në një pozicion procedural të papërcaktuar qartë nga Gjykatat, prandaj dhe duhet të aplikohen parashikimet e përgjithshme për të drejtën e ankimit, si dhe nga përmbajtja e nenit 4/2 të Kushtetutës që përcakton se: *Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*. Ndërsa, sipas përmbajtjes së nenit 43 të Kushtetutës parashikohet se, *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.”* Kjo është një çështje, për të cilën duhet rregullim dhe ndërhyrje në ligjin tonë për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar.

5.5.2 Përmbledhje e praktikës gjyqësore për sekuestrim e konfiskim pasurive, me fokus mbrojtjen e interesave të Personit të Tretë.

- Qëndrimi se provat e paraqitura nga palët e treta kanë ndikim në rezultatin e konfiskimit.⁵⁸¹ Lidhur me ankimin e personave të tretë, në këtë gjykim kolegji i Gjykatës së Apelit, arsyeton se në aspektin procedural palët e treta legjitimohen në ankimin e paraqitur prej tyre dhe marrjen pjesë në gjykimin në Apel, në mbështetje të nenit 276/1 të K.Pr.Penale, në të cilin thuhet: *“Kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros, cilido që ka interes mund të bëjë ankim”*. Baza ligjore e mësipërme pranohet nga Gjykata e Apelit edhe për shkak të parashikimeve në nenin 5/2 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 të ndryshuar, në të cilin thuhet se: *“Verifikimi, hetimi dhe gjykimi sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga*

⁵⁸⁰ Çështja “Gasus Dossier- und Fördertechnik GmbH kundër Holandës” (23/02/1995);

⁵⁸¹ Gjykata e Apelit, Vendim nr Nr. 49 datë 15.05.2018

rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj". Në mbështetje të dy dispozitave të mësipërme, nga njëra anë si dhe provave të paraqitura nga palët e treta në këtë gjykim, Gjykata e Apelit, arrin në përfundimin se ankuesit me cilësinë e personave të tretë legjitimohen plotësisht në ankimin e paraqitur prej tyre dhe për rrjedhojë pjesëmarrjen e tyre në gjykimin në apel. Gjykata çmon së të gjithë personat e tretë, paraqitën si provë para gjykatës kontratat respektive të sipërmarrjes të lidhura midis tyre dhe shtetasit L.S., në periudhën kohore 2002-2005, kohë në të cilën ka përfunduar objekti.

Gjithashtu, ata paraqitën para gjykatës dokumente, të cilat vërtetojnë kontratat për energjinë elektrike dhe ujin me entet përkatëse. Faktet e mësipërme e bindin gjykatën se personat e tretë kanë interesa të ligjshme për të paraqitur ankim kundër sekuestros së vendosur ndaj objekteve që posedohen prej tyre në mirëbesim në bazë të veprimeve juridike të ligjshme (kontratat respektive të sipërmarrjes të lidhura siç thamë më lart), veprime të cilat kanë patur dhe kanë për qëllim kalimin e pronësisë nga shtetasi L.S. tek palët e treta në këtë gjykim. Ky përfundim arrihet në parashikimet e nenit 22/3 të ligjit të mësipërm, në të cilën thuhet: *"Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces"*. Kjo dispozitë parashikon rregullat e këtij gjykimi të posaçëm, që i përkasin fazës së konfiskimit, për pasuri, kur më parë është vendosur ndaj tyre sekuestrimi, duke parashikuar ndërhyrjen dhe pjesëmarrjen e personave të tretë, në këtë gjykim. Sa më sipër duke u rikthyer në parashikimet e nenit 5/2, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, kolegji arrin në përfundimin se pretendimet e personave të tretë në këtë gjykim, mund të zgjidhen në mënyrë përfundimtare në gjykimin për konfiskimin e pasurisë së sekuestruar ndaj shtetasit L.S. *Pavarësisht përfundimit të arritur si më sipër lidhur me kërkimin e bërë nga personat e tretë në ankimet e tyre, kolegji çmon të theksojë dhe një herë se të gjithë personat e tretë pjesëmarrës në këtë gjykim krijuan bindjen për gjykatën se janë posedues të ligjshëm të objekteve mbi të cilat është vendosur sekuestro dhe si të tillë duhet të vazhdojnë t'i posedojnë ato qetësisht, deri në shqyrtimin përfundimtar të çështjes dhe mundësimin e kalimit të pronësisë mbi objektet e poseduara në favor të tyre.*

Në një rast tjetër⁵⁸², pas konfiskimit, në bazë të provave të sjella nga palët, Prokuroria ka hequr dore nga Konfiskimi dhe është pushuar gjykimi, për disa pasuri, për shkak se justifikoheshin si të blerë edhe me kredi bankare. *“Në këto kushte e gjithë pasuria objekt i kërkesës për gjykim, përfshihet në pasuritë që duhet t’u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin parandalues duke pasur personat zotërues të saj, të paditurit, barrën e provës të justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit 21/3 të ligjit parandalues. Pasuritë objekt konfiskimi janë si më poshtë vijon: Gjatë gjykimit, palët ndërgjyqëse, si pala paditëse Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, edhe ana e paditur paraqitën prova të cilat u shqyrtuan dhe u analizuan nga gjykata. Në përfundim të gjykimit, pala paditëse, Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, e cila disponon padinë, duke çmuar se me provat e paraqitura nga ana e paditur, justifikohet burimi i ligjshëm i blerjes së dy pasurive hoqi dorë nga gjykimi i padisë për këto pasuri, duke kërkuar pushimin e gjykimit, dhe kthimin e këtyre pasurive palës së paditur, duke revokuar kështu dhe vendimin nr.25 datë 23.11.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë “Për sekuestrimin e pasurive”.*

Në një rast gjykimi⁵⁸³, mbahet qëndrimi në praktikën gjyqësore se nuk është e nevojshme për konfiskim mospërputhja mes të ardhurave dhe vlerës së shpenzuar për pasurinë, por duhet të provohet shpërpjesëtimi i plotë e të justifikohen të ardhurat. *-duke u nisur nga parashikimi i nenit 24/1 germa "b" e ligjit nr. 10192/2009, i cili parashikon se konfiskimi vendoset kur, krahas ekzistencës së kushteve të tjera të përmendura në gerrat "a" dhe "c", pasuritë... ” nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme...”, pra nuk kërkohet barazimi i vlerës së pasurive me të ardhurat e ligjshme, por mospërputhja e dukshme mes tyre, që nënkupton se mospërputhja të jetë e një shkalle të atillë të lartë sa të krijojë bindjen e plotë se pasuria objektivisht nuk mund të jetë krijuar me të ardhura të ligjshme, por me të ardhura nga veprimtaritë kriminale për të cilat ekzistojnë indiciet që kërkon neni 3/1 i ligjit; -duke vlerësuar se disponimi i një banese me sipërfaqe mesatare, ku banon vetë pala e paditur D. K. (e moshës 64 vjeç) nuk tregon në vetvete mospërputhje të dukshme mes të ardhurave dhe pasurive dhe as një nivel të pajustificuar ekonomik në kuptim të vetë qëllimit të ligjit nr.10192/2009, të shprehur në*

⁵⁸² Nr. Vendimit 106, dt 13.09.2017 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

⁵⁸³ Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Vendimi nr 12, datë 23/12/2016

nenin 2 te tij, sipas të cilit “Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminal”; çmon se plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 24/1 i ligjit nr. 10192/2009 për konfiskimin e pasurive të blera nga e paditura D. K. me kontratën e shitjes nr.33 rep., nr.27/3 kol., dt.17.01.2012, me përjashtim të banesës njëkatëshe me sipërfaqe ndërtimi 98 m² ku e paditura Drane Kola jeton aktualisht dhe truallit funksional të saj me sipërfaqe 200 m².

Në një rast të praktikës gjyqësore diskutohet koha e krijimit të pasurisë, dhurimi i pasurisë dhe përjashtimi i saj nga konfiskimi, e si provohet kjo⁵⁸⁴, gjykatat arsyetojnë se: “ Gjykata, referuar historisë së mënyrës së fitimit të pronësisë, të pasurive objekt konfiskimi, nga pronarët e parë, që nuk janë as subjekte të Ligjit Nr.10192/2009 dhe rrjedhimisht as palë në këtë proces, konstaton se mënyra e fitimit është e ligjshme, e fituar nëpërmjet vendimeve të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, pa lidhje, as të prezumuar, me veprimtarinë kriminale të trafikimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike, për të cilat ka indicie se ka kryer i padituri Fatmir Kajolli. Jo vetëm pala paditëse nuk provoi simulimin e shitjes, nëpërmjet dhurimit nga të paditurit e këtij gjykimi, por edhe gjykata në fazën e hetimit gjyqësor, nuk konstatoi asnjë element të simulimit në marrëdhënien juridike të kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, me kontratë dhurimi, nga dhuruesi tek përfituesi. Gjykata konstaton se shumica e pasurive, që kërkohet të konfiskohen rrjedhin nga marrëdhënia juridike e dhurimit, të formalizuara në kontratë, menjëherë pas fitimit të saj me vendimin e Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave. Duke konkluduar në ligjshmërinë e origjinës dhe të ligjshmërisë së mënyrës së fitimit të pasurive, objekt konfiskimi, (fituar me kontratë dhurimi) kjo gjykatë, çmon se të paditurit nuk detyrohen të provojnë, me prova të tjera, se kanë pasur mundësi pagimi, për fitimin e tyre. Në këtë gjykim, nuk u provua, as në nivelin e indicieve nga pala paditëse, ose me provat e shqyrtuara në këtë gjykim, që këto veprime juridike (dhurimi) të jenë kryer në dukje për të mbuluar një shitblerje të këtyre pasurive. Pretendimet e ngritura nga pala paditëse, (koha e shkurtër e kryerjes se transaksioneve, numri i madh i kontratave të dhurimit dhe vlerat e supozuara prej paditëses), nuk janë argumente ligjore dhe mbeten në kuadër të pretendimeve, të pambështetura në prova të tjera të këtij gjykimi.

⁵⁸⁴ Vendim datë 03/05/2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, mbi pasuritë e shtetasit F. K.

5.6. Vlerësimi i provave gjatë konfiskimit në funksion të barrës së provës, dallimet në procedurën penale dhe civile.

Vlerësimi i provave të paraqitura nga subjekti, të afërmit, persona të tretë në funksion të barrës së provës duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme bazuar në rregullat e ligjit, në përputhje me objektin e të provuarit të përcaktuar në ligj si dhe në përputhje me parimet e vlerësimit të procedurës penale, të cituara sa më sipër në këtë punim. Rregullimet e ligjit dhe përcaktimet e tij për kriteret kanë përparësi dhe do të zbatohen të parat sipas parimit *lex specialis derogat legi generali*.⁵⁸⁵ Rregullimet e përcaktimit të ligjit, në këtë rast, nuk janë të shumta ndryshe nga ligjet e tjera analoge. Megjithatë, në përmbajtje të ligjit, gjenden disa kriterë të vlerësimit të barrës së provës nga subjekti dhe personat e tretë.

Ligji nuk kufizon mundësinë për të paraqitur prova. Kjo nënkuptohet nga përmbajtja e ligjit kur përcakton vetëm se barra e provës për të provuar se veprimtaritë dhe pasuritë e sekuestruara të zotëruara pjesërisht ose plotësisht prej tyre janë fituar në burime të ligjshme u përket subjekteve të ligjit. Gjithashtu, të afërmit dhe bashkëpunëtorëve u përket barra për të provuar se pasuritë, për të cilat kërkohet konfiskimi, zotërohen me titull pronësie vetëm prej tyre dhe janë fituar në mënyrë të ligjshme e nuk janë në pronësi të tërthortë të personave subjekte të ligjit. Siç shtjelluam më sipër në këtë punim llojet e provave mund të jenë të ndryshme për shkak të natyrës së procedimit pasuror e kryesisht janë prova, që lidhen me të ardhura, prona, vlerësime kontabël e të pasurisë së paluajtshme. Personi i tretë, kur thirret mund të kërkojë marrjen e të dhënave të duhura për pasuritë e kaluara atij, transaksionet, blerjen, kredinë etj.

⁵⁸⁵Emri vjen nga deklarata e plotë e doktrinës, një maksimum ligjor në latinisht: *Lex specialis derogat legi generali*. *Lex specialis*, në teorinë dhe praktikën ligjore, është doktrinë e ndërlidhur me interpretimin e ligjeve dhe mund të zbatohet në kontekstin e së drejtës vendore dhe ndërkombëtare. Doktrina pohon se nëse dy ligje trajtojnë të njëjtën situatë faktike, një ligj që rregullon një çështje specifike (*lex specialis*) mbizotëron një ligj që rregullon vetëm çështjet e përgjithshme (*lex generalis*). Situata zakonisht, lind në lidhje me interpretimin e legjislacionit të mëparshëm, kur legjislacioni më i përgjithshëm është miratuar më vonë. Megjithatë, atëherë mund të zbatohet edhe doktrina e quajtur "lex posterior derogat legi priori" (ligji më i ri mbizotëron ligjin më të vjetër). Mund të supozohet se ligjvënësit kanë planifikuar të anashkalojnë legjislacionin e mëparshëm. Ekziston gjithashtu një pikëpamje se konfliktet e normave duhet të shmangen përmes një interpretimi sistematik. Ky parim vlen edhe për ndërtimin e një trupe të ligjeve apo të një ligji të vetëm që përmban edhe dispozita specifike edhe të përgjithshme

Kodi i procedurës penale⁵⁸⁶ ka parashikuar llojet e provave kryesore që shërbejnë për vërtetimin e fakteve në procesin e të provuarit në procedimin penal duke renditur si të tilla : *dëshminë, ballafaqimin, provat materiale, ekspertimin* të cilat janë të njëtat që mund të përdoren për procedimin pasuror. Si mjete të kërimit të provës janë parashikuar *sekestrimi, kqyrja, kontrolli dhe përgjimet*. Sipas nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveçse kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën⁵⁸⁷. Kjo do të thotë se indiciet që të mund të vlejë për të vërtetuar ekzistencën e një fakti duhet të plotësojnë kushtin e rëndësisë, të saktësisë, e të përputhshmërisë.

Edhe në kodin e procedurës civile⁵⁸⁸ është parashikuar parimi i çmuarjes dhe vlerësimit të lirë të provave sanksionuar në nenet 29, paragrafi 2 dhe 309⁵⁸⁹ paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile.⁵⁹⁰ Kodi i Procedurës Civile duket sikur pranon teorinë e çmuarjes së lirë të provave, por në fakt pranon teorinë e provave ligjore⁵⁹¹, për shembull, në nenin 253 të tij përcaktohet shprehimisht se aktet zyrtare si një nga llojet e shkresave përbëjnë provë të plotë dhe se lejohen të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet falsiteti, pra akti zyrtar paraqitet me fuqi të plotë provuese dhe gjykata nuk mund të ndryshojë këtë urdhërim ligjor.

Ndërsa në të drejtë procedurale penale mbizotëron parimi i vlerësimit të lirë të provave, për shembull, në procedurën penale thëniet e dëshmitarit janë provë me vlerë të barabartë provuese si ato shkresore dhe shkencore, që janë aktet e ekspertimit. E drejta procedurale civile ka përparësi përse i përket llojeve të larmishme të provës dhe të barrës së provës për palët në procedurën civile

⁵⁸⁶ Provat, Titulli IV, Kren I, II, III, Kodi i Procedurës Penale, Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 “*Kodi i Procedurës Penale i RSH*”, i ndryshuar.

⁵⁸⁷ Neni 152 pag. 2 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁸⁸ Deri përpar ndryshimeve të ligjit Ligji nr. 10 192 datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave paranatdhuese kundër pasurisë*” me ligjin nr. 70/2017 datë 27.04.2017, gjatë shqyrtimit të kërkesave për sekestrim dhe konfiskim zbatohet procedura civile dhe rregullat e procedurës civile.

⁵⁸⁹ Gjykata çmon provat e marra gjatë shqyrtimit të çështjes sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre

⁵⁹⁰ Gjykata çmon provat që ndohen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre të rrethanave të çështjes

⁵⁹¹ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi Procedurë Civile, pjesa I, botimi II, botim 2018.

si një traditë e së drejtës procedurale civile. Edhe ligji italian⁵⁹² dhe ai anglez ⁵⁹³ bazohen në procedurën civile e në institutet e saj.

5.7 Kriteret e vlerësimit të kushteve për të vendosur në lidhje me kërkesën për konfiskim, kur gjendet e provuar kërkesa për konfiskim pasurie.

Pranimi i kërkesës për konfiskim kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të tre kushteve⁵⁹⁴ që lidhen sigurisht me të provuarit nga ana prokurorisë në kontradiktoritet të:

- Pjesëmarrjes së personit në veprimtari kriminale në ato vepra penale që përcakton ligji, kjo duke u provuar në nivelin e dyshimeve të arsyeshme të bazuara në indicie. Nëse kemi një nivel të provuari në nivelin e provës përtej dyshimit të arsyeshëm se është një nivel më i pranueshëm që justifikon në mënyrë më legjitime kërkesën dhe vështirëson barrën e provës për personin.
- Rezulton e provuar se pasuria është drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave që kanë kryer vepra penale në fushën e veprimit të ligjit duke e lidhur këtë me faktin rezultativ, që do të thotë një nivel i lartë prove.
- Nuk është përmbushur nga ana e subjektit të ligjit ose e të tretit barra e provës për të provuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë nga ana e subjektit, i cili nuk arrin të përligjë zotërimin e pasurisë ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara.

Në çdo rast personi nuk mund të përligjë pasurinë duke deklaruar si burim të saj të ardhura ose riinvestime, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve. Në rastet kur nuk përmbushet barra

⁵⁹² Decreto legislativo 6 settembre 2011, n. 159 “Codice delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione, nonche muove disposizione in materia di documentazione antimafia, a norma degli articoli 1 e 2 della legge 13 agosto 2010 nr. 136 (G.U 28 settembre 2011, n. 226) , testo aggiornato con la legge 17 ottobre 2017 nr. 161

⁵⁹³ Proceeds of Crime Act 2002

⁵⁹⁴ Neni 24 i ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundra pasurisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.04.2017.

e provës për vërtetimin e origjinës së ligjshme të pasurisë, gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskim të pasurisë edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit/subjektit të ligjit, pushohet ose ai deklarohet i pafajshëm, me përjashtim të rasteve të pushimit ose të pafajësisë deklarohet se: a) faji nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet si vepër penale; c) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale.

Kriteri i përmbushjes së tre kushteve kumulative është një garanci për konfiskimin pasuror pasi ndërthur detyrimin e prokurorisë për vërtetuar pjesëmarrjen e subjektit në veprimtari kriminale dhe zotërimin nga ana e tij të pasurisë me barrën e provës së subjektit për të vërtetuar origjinën e ligjshme të saj, duke ndërthurur me të gjitha mundësitë ligjore të instrumenteve procedurale të të provuarit sipas standardit të kërkuar në ligj. Të provuarit e prejardhjes së ligjshme të pasurisë nga subjekti i ligjit apo përligjja e zotërimit të pasurisë e të ardhurës përpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve, të realizuara nga burime të deklaruara, është një proces rigoroze e empirik, i cili i nënshtrohet një vlerësimi të thellë dhe të gjithanshëm juridik, ekonomik, financiar e logjik. Prejardhja e ligjshmërisë së pronës apo përligjja e zotërimit të pasurisë e të ardhurës në përpjesëtim me nivelin e të ardhurave duhet bërë në përputhje me parimet e vlerësimit të provës të shtjelluara më lart në një proces gjyqësor që i jep mundësinë subjektit të ligjit dhe të tretëve të paraqesin e të marrin, të mbledhin çdo të dhënë e provë në funksion të saj.

Në një Vendim të Gjykatës së Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁵⁹⁵ arsyetohet se: *“Subjektit të ligjit i bie barra e provës për të provuar vetëm me mjete e burime të ligjshme pasurinë e zotëruar prej tij, vlerat materiale, që janë gjetur në banesën e tij, që se justifikimi i pasurisë nuk mund të realizohet me të ardhurat e pretenduara si pasojë e një ekonomie informale apo me të ardhura, për të cilat nuk dokumentohet origjina e tyre apo mënyra sesi në rastin konkret këto vlera monetare janë vënë në zotërim të subjektit. Edhe në rast se personat e tretë do të dokumenton faktin se kanë të ardhura, ato duhet të provojnë mënyrën se si i kanë lënë ata apo arsyen në banesën e Sh. M. Pretendime të tilla si arsye sigurie apo blerje pasurie të padokumentuara nuk mund të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurës. Në rrethanat e mësipërme pamundësia e justifikimit të origjinës së ligjshme të parave objekt konfiskimi që efektivisht zotërohen nga subjekti, pasuri të cilat dukshëm janë shpërpjesëtimore dhe nuk i*

⁵⁹⁵Vendimi nr. 230, datë 24.12.2020 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

përgjigjen nivelit të të ardhuraeve e fitimeve nga veprimtaria e subjektit të deklaruar nga ai subjekt i deklarimit të pasurisë”.

5.8. Çështje të ligjit dhe të praktikës gjyqësore.

Çështja e përmbushjes së detyrimit të barrës së provës për justifikimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë në praktikën hetimore pasurore dhe atë të gjykimit pasuror hasen shpesh. Kjo vjen si rezultat edhe i mos përcaktimeve të qarta në ligjin përkatës, por edhe në keqinterpretimin e elementëve e parashikimeve të veçanta të ligjit sipas natyrës së tij. Në praktikën gjyqësore konstatohet se nuk del qartë kontradiktoriteti në shqyrtimin e kërkesave për konfiskim dhe mundësia që subjektet të përdorin institutet e ligjit apo të KPrP për justifikimin e pasurisë së paligjshme; nuk rezulton që subjekteve t’u jepet mundësia për të marrë, kërkuar dhe paraqitur prova nga ana e tyre përveç kundërshtimit të atyre të prokurorisë; nuk del që nga ana e subjekteve janë paraqitur prova të llojeve të ndryshme nga ata që parashikon legjislacioni procedural; nuk ka një dallim të qartë të elementeve të ndryshëm të të provuarit të barrës së provës në lidhje me detyrimin e personave të tretë kur ata jana në keqbesim apo në mirëbesim.

Për sa i përket barrës së provës për personave të tretë dhe në rastin kur i treti vepron në keqbesim në një Vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁵⁹⁶ arsyetohet se fakti që persona të tretë kanë bërë deklarime për shuma monetare, që kanë lënë për ruajtje në banesës e Sh. M. nuk ka vlerë provuese për ato vlera të hollash, pasi ajo nuk vërtetohet në asnjë provë tjetër që u përket personave të tretë.

Për sa i përket vlerës së dokumenteve zyrtare deklarata e deklarimit periodik të pasurisë dhe dyshimit se subjekti ka kryer veprën penale të “*Deklarimit të rremë*”, lidhjen e procedimit pasuror me procesin e ankimimit në GJEDNJ për shkak të shkarkimit si pasojë e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve,⁵⁹⁷ në një Vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁵⁹⁸ arsyetohet se “*gjendemi para dyshimit të arsyeshëm se lidhur me*

⁵⁹⁶ Vendimi nr. 230, datë 24.12.2020 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

⁵⁹⁷ Ligji nr 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁵⁹⁸ Vendimi nr. 128, datë 26.05.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

burimin e krijimit të pasurisë, subjekti deklaruës F. L., ka kryer deklarin të rremë si në deklaratën periodike pasurore, ashtu dhe atë në kuadër të rivlerësimit kalimtar, fakt ky i ndëshkueshëm nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, dispozitë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10 192 “...lidhur me pretendimin se procesi i rivlerësimit kalimtar është në vijim, për shkak të ankimimit në GJEDNJ e si pasojë nuk mund të niset procedim penal apo pasuror, ky kolegji arsyeton se procedimi penal e pasuror janë të pavarur nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që kryhet në zbatim të Kushtetutës. Sistemi i rivlerësimit kalimtar është proces me karakter administrativ dhe ka karakter të përkohshëm me efekt të natyrës disiplinore, ndërsa procedimi penale dhe ai pasuror mbi bazën e rregullimeve të tjera procedurale dhe ligjore”.

Në lidhje me pretendimet e personave të tretë në mirëbesim në një Vendim Gjykata e Apelit të Posacëm për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar⁵⁹⁹ arsyeton se “Pasuria i kalon në administrim administratorit edhe në rastet kur të drejtat mbi të mund ti kenë kaluar personave të tretë, të gjendur në mirëbesim sikurse janë edhe qiramarrësit .”

Në praktikë gjyqësore, vlerësimi i provave është i varur në mënyrë të pashmangshme nga legjislati referues i taksa tatimeve, të ardhurave personale, rregullave mbi aktivitetin tregtar etj. Në një rast të shqyrtimit të një kërkesë për konfiskim të pasurive të një subjekti i cili ishte i dënuar në shtetin holandez për një vepër penale në fushën e veprimit të ligjit, Gjykata e Apelit për krime të rënda arsyeton si më poshtë në lidhje me vlerësimin e provave që u sollën nga subjekti dhe personat e tretë për vlerën provuese të provave të sjella nga këta për justifikimin e pasurisë së ligjshme:

Në lidhje me pranimin si prova të shkresave të thjeshta pa vlerë provuese në një Vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁶⁰⁰ arsyetohet se : “Gjykata e Apelit në interpretim të gabuar të nenit 259 të KPrC, e në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 262 të KPrC, ka pranuar si prova me vlerë të plotë provuese shkresat e thjeshta, kontratën e huasë , të cilat në mënyrën se si janë paraqitur në procesin gjyqësor nuk mund të përbëjnë provë në favor të shtetasit D.Gj., si të vetmet prova shkresore me anë të të cilave shtetasi D.Gj. ka justifikuar burimin e ligjshëm të pasurive të tij “

⁵⁹⁹ Vendimi nr. 128, datë 26.05.2021 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

⁶⁰⁰ Vendimi nr. 134, datë 15.02.2018 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Në lidhje me përfshirjen në aktin e ekspertimit të pasurive të regjistruara për shkak të amnistisë fiskale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një vendim të tij⁶⁰¹ arsyeton se “...duhet pasur parasysh edhe pretendimi tjetër i tyre me ligjin nr. 10418 datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”. Është e vërtetë se sipas nenit 13 të këtij ligji, dispozitat e tij nuk zbatohen për kapitalin, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji nr. 10192. Por duhet kuptuar se moszbatimi përfshin vetëm faljen, sepse nxjerrja e ligjit në fjalë (qëllimi i ligjit në nenin 2 të tij) legjitimon pretendimet e kërkuesve se të ardhurat e tyre në bizneset që kanë zhvilluar kanë qenë më të larta se sa janë deklaruar, në kushtet e fshirjes së të ardhurave, mosdeklarimit të plotë dhe të saktë së të gjitha fitimeve dhe mospagimin e plotë të taksave dhe tatimeve, që ata sikur dhe shumë biznese të tjera në Shqipëri, kanë zbatuar nga viti 1991–2010. Kjo rrethanë duhet mbajtur parasysh gjatë ekspertimit, që duhet të urdhërojë gjykata për veprimtarinë e bar kafesë, shitjes së gomave dhe hotel–restorantit”.

Çështja delikate në praktikë është ajo e mbrojtjes së interesave të të tretëve, kryesisht kreditorëve dhe të tretëve në marrëdhënie biznesi me subjekte të ligjit. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në një rast⁶⁰² ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së kërkuesave Y. N. (alias Xh. P.) dhe M. N. , me objekt: “Revokimin e Vendimit nr.16, datë 01.08.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me Vendimin nr.145, datë 27.08.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kryesisht, për sekuestrimin e pasurive të shtetasve Y.N. “ me arsyetimin se “Në lidhje me pasuritë e fituara (investuara) me kredi bankare (pretendim i kërkuesve dhe i bankave në proces), gjykata vlerëson se nuk justifikohen si pasuri të fituara me të ardhura të ligjshme. Ata janë blerë (investuar) me kredi të marra nga autoriteti financiar, por kështu e shlyerjes së tyre nuk provohen të vijnë nga një aktivitet i tillë. Është detyrim i kërkuesit (subjektit) të provojë burimin e ligjshëm të kësteve që shlyejnë këto kredi. Përpos sa më lart, kjo gjykatë vlerëson se hetimi pasuror duhet parë i lidhur me origjinën e tyre, duke mos u marrë të shpëputura nga njëra-tjetra. Barra e provës së subjektit Y.N. dhe bashkëshortes së tij, shtetas

⁶⁰¹Vendimi nr. 179, datë 27.06.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

⁶⁰²Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 4, datë 27.01.2021.

M.N., për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tyre, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkt i veprave penale ose investim i tyre, do të jetë objekt i shqyrtimit të kësaj çështjeje në themel, në përputhje me ligjin nr.10192, datë 03.12.2009 (të ndryshuar) dhe Kodit të Procedurës Penale. Analiza e detajuar ekonomiko financiare, nuk është objekt shqyrtimi i këtij gjykimi.”

Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁶⁰³ mbi bazën anikimi të kreditorëve ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të paraqitur në datë 03/02/2021 nga Banka e Tiranës sh.a., si dhe ankimin e paraqitur në datë 01.02.2021 nga shtetasit Y.N. M. N, ndaj vendimit nr. 4, datë 27.01.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke arsyetuar se: “Në zbatim të nenit 12/b të ligjit parandalues, secila nga palët pjesëmarrëse në këtë procedim pasuror, në rastin konkret: prokuroria e posaçme dhe subjekti i ligjit parandalues apo/dhe personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 e 2 të këtij ligji, kanë të drejtën të vënë në lëvizje gjykatën, për të kërkuar revokimin e sekuestrimit të pasurisë. Kolegji i gjykatës së posaçme të apelit vlerëson se dispozitat e ligjit parandalues kanë përparësi në raport me dispozitat e K.P.Penale, që vetë ligji i përcakton si rregulla që plotësojnë rregullat procedurale të ligjit parandalues (neni 5, pika “2” cituar më lart). Në interpretim të këtij kolegji, në lidhje me “urdhrin/vendimin” që disponon për rrëzimin e kërkesës së subjektit të ligjit parandalues për revokimin e sekuestrimit të pasurisë, ligjvënësi nuk ka parashikuar të drejtën e ankimit. Një konkluzion i tillë mbështetet pikërisht tek natyra e kësaj vendimmarrje, që ka si synim verifikimin dhe kontrollin mbi faktin nëse vijnë të ekzistojnë kushtet dhe kriteret, mbi bazën e të cilave është caktuar masa parandaluese, lidhur ngushtë edhe me kohëzgjatjen e arsyeshme të masave parandaluese, në rastin konkret. Në këto kushte, bazuar në arsyet e sipërcituara dhe në zbatim të germës “b”, pika 1, të nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se “ankimi nuk pranohet kur vendimi është i paankimueshëm”, ky kolegji vlerësoi se apeli i paraqitur nuk duhet të shqyrtohet, duke vendosur “mospranimin e ankimit” të depozituar nga mbrojtësi i kërkuar Y.N. dhe M.N.Në lidhje me ankimin e paraqitur nga Banka Tirana sh.a., ky kolegji i gjykatës së posaçme të apelit, vlerësoi se duhet evidentuar se neni 12/b i ligjit parandalues përdor termin palë, në paraqitjen e kërkesë për revokimin e sekuestrimit të pasurisë. Duke analizuar në tërësi dispozitat që rregullojnë këtë moment procedural, që lidhet me fazën e sekuestrimit të pasurisë dhe/apo hetimin

⁶⁰³Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 74, datë 11.03.2021

pasuror, kolegj vlerëson të gabuar vendimmarrjen e gjykatës së posaçme të shkallës së parë, e cila duke referuar në procedurën gjyqësore të gjyqimit në themel të këtij procedimi pasuror/konfiskimi i pasurisë, ka thirrur në gjykim apo ka legitimuar si palë, disa institucione bankare/banka të nivelit të dytë, me të cilat subjekti i ligjit parandalues ka një marrëdhënie kontraktore. Gjatë fazës së hetimit pasuror ligji përcakton si palë, personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2 të tij, konkretisht: subjekti i ligjit si dhe personat e afërm (sipas shkronjës 'a' të pikës '2') dhe personat fizikë apo juridikë, që zotërojnë pasuri apo veprimtari, por për të cilat ka të dhëna se zotërohen plotësisht apo pjesërisht nga subjekti i ligjit parandalues. Bankat e nivelit të dytë janë në cilësinë e kreditorëve në raport me subjektin e ligjit parandalues, element ky që nuk i legitimon ato si palë në këtë fazë të procedimit pasuror. Secila nga pasuritë mbi të cilat është vendosur masa e sekuestrimit të pasurisë, figurojnë të regjistruara në pronësi të subjektit të ligjit parandalues dhe personave të afërm të tij (bashkëshortja apo fëmijët)...bankat, në cilësinë e kreditorëve ndaj subjektit të ligjit parandalues, nuk legjitimohen të parashirojnë pretendime për revokimin e sekuestrimit të vënë në bazë të këtij ligji. Sekuestrimi i pasurisë është një masë parandaluese paraprake, që vendoset për të garantuar vënien në zbatim të konfiskimit, në rast se provohet ekzistenca e kritereve të parashikuara në nenin 24 të këtij ligji. Në vijim të analizës të dispozitave të K.P.Penale, ky kolegj vlerëson se edhe në interpretim të nenit 212 të K.P.Penale, (parë kjo dispozitë edhe lidhur me shkaqet e ankimit të parashtruara nga Banka e Tiranës sh.a.), ky subjekt nuk legjitimohet të bëjë ankim ndaj vendimit nr. 4, datë 27/01/2021 të gjykatës së posaçme të shkallës së parë. ”

Kundër vendimit nr. 74, datë 11.03.2021, të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka paraqitur rekurs, , personi i tretë Tirana Bank sh.a. me të cilin kërkon: *Prishjen e vendimit nr.74, datë 11.03.2021,të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe kthimin e akteve për rishqyrtim pranë kësaj gjykate pasi ky vendim është marr në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural.*

Në rekurs kërkuesi, ka parashtruar të njëjtat shkaqe si në ankim, ku ndër të tjera janë:

- *Vendimi i Gjykatës së Apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit. Referuar nenit 27 të ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjetë masave parandaluese kundër pasurisë”, të drejtën e ankimit e kanë secila nga palët pjesëmarrëse në proces. Banka është në këtë proces pasi i cënohen*

interesat për shkak të të drejtave që ka me kontratën e garancisë ndaj pasurive të sekuestruara. Ankuesi Banka Tirana sh.a. pretendon se kjo bankë ka qenë plotësisht në mirëbesim në procedurën e dhënies së kredisë ndaj z. N., si dhe ka hyrë në këtë marrëdhënie bazuar në termat financiarë dhe të drejtën e garancisë reale të hipotekës mbi pasurinë nr.40/85. Subjekti Banka Tirana sha, nëpërmjet Kontratës së Hipotekës nr.xxx., datë 06/04/2020, ka fituar të drejta reale të ligjshme mbi pasurinë e llojit 'truall', në pronësi të Y. N. Të drejtat reale të hipotekës mbi pasurinë 40/85 të Bankës Tirana sh.a. nuk mund të cenohen nga asnjë palë apo proces, deri sa kjo kontratë të jetë në fuqi. Hipoteka si një e drejtë reale, është një e drejtë absolute, e cila ndjek sendin. Në rast tjetërsimi të sendit, hipoteka nuk shuhet por vazhdon ta ndjekë atë, çka do të thotë se nëse debitori nuk ekzekuton detyrimin, do të jetë pasuria e vënë në hipotekë si kolateral që do të shërbejë si mjet për zhdëmtimin e interesave të kreditorit, pavarësisht se pronar i saj do të jetë një subjekt i ndryshëm nga debitori fillestar, të cilit i ka kaluar kjo pasuri me barrë. Në këto kushte sekuestrimi paraprak dhe kalimi në favor të shtetit në bazë të ligjit antimafia, për aq kohë sa pasuria konkrete është e ngarkuar me barrë, merr një karakter tërësisht formal. Kjo sepse në rast mospërmbushje të detyrimit nga debitori fillestar kredimarrës/pronar i pasurisë së vënë si kolateral, subjekti kreditor (Banka) gëzon rivendikimin e saj në çdo kohë, pavarësisht tjetërsimit të pasurisë dhe pa u ndikuar nga fakti se pronari mund të jetë shteti (i cili gëzon të drejtën e pronësisë në të njëjtat kushte me subjekte private). Nga ana tjetër ekzistenca e barrës hipotekore mbi pasurinë 40/85, bën që të humbë funksioni i sekuestros të vendosur me vendimin nr.16 datë 01.08.2020 të Gjykatës së Posaqme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pasi, nuk mund të tjetërsohen nga shtetasi Y N. Në këto kushte, duke qenë se pasuria me nr. 40/85 nuk mund të tjetërsohet nga z. Ndroqi atëherë është e qartë për këtë pasuri nuk plotësohen kriteret e nenit 11 të ligjit Nr.10 192, datë 3/12/2009 për tu vendosur masa e sekuestros.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 00-2021 datë 22.06.2021 shprehet se : “ Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit me vendimin e saj ka cënuar insitutin e ankimit dhe për pasojë ka bërë edhe cënimin e parimit të një procesi të drejt gjyqësor të ngritur nga kërkuesit në rekurs, Kolegji vleron të sjell në vëmendje se Kodi i Procedurës Penale në Titullin VIII, Ankimet, Kreu I, Rregullat e Përgjithshëm, ka përcaktuar në nenin 407 rastet dhe mjetet e ankimit. Pika 1 i nenit 407 përcakton rregullin “Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjete e ankimit”. Në këtë formulim evidentohet se e drejta e ankimit

udhëhiqet nga parimi i taksitivitetit, që e drejta ankimi duhet të njihet nga ligji në mënyrë të shprehur. Për pasojë rregullat e ankimit duhet ti referohen ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (i ndryshuar) Neni 27 pika 1 parashikon se “Kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë, zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit, revokimit apo të shuarjes së masës së sekuestrimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale”. Pra ankimi si mjet dhe e drejtë për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët, në gjykatën më të lartë duhet të jetë parashikuar në ligj. Qëndrimi që mban kërkuesi në rekursin e tij se e drejta e ankimit lejohet pasi ligji nuk është shprehur për ndalimin e ushtrimit të kësaj të drejte nuk qëndron dhe është i pabazuar.⁶⁰⁴

Në lidhje me pretendimin se me moslegjitimimin e personit të tretë T. B. sha me cënimin e insitutit të ankimit dhe të cënimit të parimit të një procesi të drejt gjyqësor të ngritur nga kërkuesit Kodi i Procedurës Penale në Titullin VIII, Ankimet, Kreu I, Rregullat e Përgjithshëm përcakton si subjekte që kanë të drejtë të shtrojnë të drejtën e ankimit prokurorin, viktimën akuzuese, të pandehurin. Referuar neni 212 të K.P.Penale, si dispozitë i posaçëm, pjesë e Seksionit III sekuestrimet, përsëri personi i tretë T. B. nuk përfshihet tek subjektet që ju njihet e drejta e kundërshtimit të vendimit të sekuestros.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ⁶⁰⁵duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Y.N, M. N dhe personi i tretë T. B. sha kundër vendimit nr. 74, datë 11.03.2021, të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, arsyeton se : “ Në lidhje me pretendimin se me moslegjitimimin e personit të tretë T. B. sha me cënimin e insitutit të ankimit dhe të cënimit të parimit të një procesi të drejt gjyqësor të ngritur nga kërkuesit Kodi i Procedurës Penale në Titullin VIII, ankimet, Kreu I, Rregullat e Përgjithshëm përcakton si subjekte që kanë të drejtë të shtrojnë të drejtën e ankimit prokurorin, viktimën akuzuese, të pandehurin. Referuar neni 212 të K.P.Penale, si dispozitë i posaçëm, pjesë e Seksionit III sekuestrimi, përsëri personi

⁶⁰⁴ Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2021 datë 22.06.2021

⁶⁰⁵ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 00-2021 i Vendimit, datë 22.06.2021

i tretë T. B. nuk përfshihet tek subjektet që ju njihet e drejta e kundërshtimit të vendimit të sekuestros. “

Analizimi i këtij rasti praktik dhe interpretimit që i bëjnë gjykata ligjit, sjell domosdoshmërisht nevojën e ndërhyrjes në ligj për të përcaktuar së pari kush hyn në kategorinë e personave të tretë, vetëm ata që kanë titull pronësie apo dhe personat që gëzojnë të drejta reale mbi pronën, si dhe për të parashikuar të drejtën ankimit të personave të tretë dhe disa parime të vlerësimit e mundësive të tjera mbrojtjeje të të tretëve në mirëbesim në marrëdhënie kreditimi apo biznesi me subjekte të ligjit. Në mënyrë të veçantë, në ligjin tonë duhet të gjejmë parashikim për parimet, mbi të cilat duhet të bazohet mbrojtja të tretit në mirëbesim dhe kriteret e dallimit në mes të të vepruarit të të tretit në keqbesim e atij në mirëbesim.

Hipotezat e ngritura në fillim të këtij kreu na japin përgjigjen se:

- ligji shqiptar dhe referimi në rregullat e procedurës penale nuk u jep të gjitha mundësitë procedurale subjekteve, të tretëve për mbrojtje për shkak të devijimit të barrës së provës,
- ligji nuk rregullon në mënyrë të shprehur interesat e të tretëve e sidomos të kreditorëve, të drejtën e aksesit në gjykim , atë të ankimit, të ndërhyrjes në proces, si dhe mundësinë e mbrojtjes së të drejtave reale të pronësisë apo përkatësisë mbi pronën.
- referimi në procedurën penale i instrumenteve të nevojshëm procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror të shtetasve.
- mbrojtjen e së drejtës pasurore e siguron më mirë procedura civile.
- një ligj me elemente të plotë rregullatorë *sui generis* dhe për çështjet e provave e të të provuarit do ishte një zgjidhje më e mirë, duke krijuar një juridiksion të veçantë të masave parandaluese pasurore.
- janë të nevojshme shtesa dhe ndryshime ligjore mbi elementet e barrës së provës për të konfirmuar standardet ndërkombëtare.

KREU VI

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Hyrje 6.2. Konkluzione 6.3 Rekomandime 6.4. Statistika dhe analizë. 6.5. Bibliografi

6.1. Hyrje

Në këtë kre janë përmbledhur konkluzionet përfundimtare të punimit të renditura sipas atyre të nxjerra në çdo kre të tij. Konkluzionet përmbajnë në mënyrë të përmbledhur gjetjet në këtë punim si dhe hipotezat e vërtetuara gjatë trajtimit të tij si ato për juridiksionin e veçantë të masave parandaluese pasurore e konfiskimit në veçanti si standard ndërkombëtar e nevojën e krijimit të një juridiksioni të tillë dhe tek ne, natyrës së ligjit tonë, provave dhe barrës së provës dhe ndërhyrjeve të nevojshme në ligjin aktual për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, korrupsionit e trafikëve nëpërmjet masave parandaluese. Njëqind konkluzione përmbledhin gjetjet si rezultat i punës së gjatë studimore e kërkimore.

Në këtë kre janë dhënë rekomandimet përkatëse të nxjerra nga konkluzionet e punimit e puna kërkimore për punimin në tërësi. Rekomandimet janë dhënë sipas fushave përkatëse ku vendin kryesor e zënë ato për përmirësimin në legjislacionin për masat parandaluese pasurore dhe ligjet e tjera. Janë dhënë rekomandime për domosdoshmërinë e unifikimit të praktikës gjyqsore për disa çështje të zbatimit të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit si dhe për ndryshim të praktikës së unifikuar për një çështje që prek parimet e zbatimit të ligjit, për zbatimin e drejtë të tij, bashkëpunimin e bashkërendimin si dhe politikën penale të tij, për ngritjen e kapaciteteve profesionale të policisë gjyqsore, prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe për analizën e politikës penale në zbatim të ligjit.

Në këtë kre janë përfshirë dhe statistikatat për gjithë periudhën e zbatimit të ligjit nga gjykatat kompetente Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Gjykata e Posacme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për periudhat e ligjeve që kanë vepruar si 2004 -2007, 2007- 2017, 2017 – 2021 dhe periudhën e zbatimit të Aktit Normativ Nr.1/20 ne vitet 2020 – 2021. Në brendësi të statistikave

ka një analizë të tyre me qëllim matjen e efektivitetit të ligjit dhe politikës penale të tij kjo në funksion të trajtimeve e hipotezave të ngritura në këtë punim.

Në fund të kreut është dhënë bibliografia e punimit ku janë përfshirë e gjithë literatura vendase dhe e huaj, raportet studimore, artikujt shkencorë, jurisprudenca e GJEDNJ, ligjet e normat ndërkombëtare si dhe praktika gjyqësore me vendimet e të gjitha shkallëve të gjyqsorit, duke u përfshirë shumica vendimeve të dhëna nga gjykatat për çështje të zbatimit të ligjit.

6.2. KONKLUZIONE

Konkluzione mbi masat parandaluese në përgjithësi

1. Sekuestrimi dhe konfiskimi si masa parandaluese pasurore janë dy instrumente procedurale shumë efikase për parandalimin e goditjen e kriminalitetit në përgjithësi e atij të organizuar, trafikëve e korrupsionit në veçanti. Këto instrumente ndjekin parimin se kriminaliteti prodhon të ardhura e pasuri e kjo pasuri duhet identifikuar e kapur sa më shpejt. Asgjë e krijuar në paligjshmëri e kriminalitet nuk mund të përdoret më tej për të krijuar të ardhura e pasuri të tjera duke dëmtuar parimet e konkurrencës së lirë, ekonomisë së tregut e duke kompromentuar sundimin e ligjit e parimet e shtetit të së drejtës.
2. Krimi i organizuar, korrupsioni dhe trafikët janë veprimtaria kriminale që sjell më shumë të ardhura dhe produkte kriminale, nevoja e të cilave është për ti futur në kanalet e ekonomisë së tregut në formë investimesh, blerjesh e financimesh të aktiviteteve tregtare. Aktivitete të tjera kriminale si ai ekonomik, evazioni fiskal, kontrabanda, fallsifikimi i produkteve të konsumit, korrupsioni, patrimi i parave sjellin të ardhura të konsiderueshme duke sjellë në të njëjtën kohë humbje të financave publike të një shteti. Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie kriminale është sigurimi i përfitimeve materiale, të ardhurave në para, pasurive të luajtshme e të paluajtshme, e produkte të tjera prandaj dhe sekuestrimi e konfiskimi i tyre kanë rëndësi për përmbushjen e qëllimit final të luftës ndaj kriminalitetit.
3. Lufta ndaj kriminalitetit nuk do të kishte kuptim nëse nuk identifikohen e konfiskohen të ardhurat nga veprimtaria kriminale. Kjo sigurohet nëpërmjet procedimeve parandaluese pasurore sekuestrimi e konfiskimi, të cilat nuk përfshihen në fushën e veprimit të dispozitave të tjera të legjislacionit material, lidhur specifikisht me procedimet penale dhe përmbajnë garanci që i tejkalojnë të drejtat e Konventës dhe rregullat e procedurës që janë tipike për pjesën më të madhe të sistemeve ligjore.
4. Sekuestrimi i pasurisë është një masë e përkohshme që ka për synim të parandalojë humbjen, zhdukjen, fshehjen, tjetërsimin e të ardhurave, pasurisë, produkteve të veprave penale që mundësisht më vonë mund të konfiskohen.
5. Konfiskimi është humbja përfundimtare ose e përhershme e pasurisë më anë të një vendimi të gjykatës ndaj pasurisë që ka si qëllim në parandalimin e kryerjes së krimeve të tjera

nëpërmjet shpronësimit të sendeve, të ardhurave nga krimi që në çdo rast të lidhura ngushtë me posedimin e tyre, mbajnë gjallë idenë dhe atraktivitetin e krimit. Në çdo rast si produkt i krimit kuptohet sendi material që buron nga vetë krimi, si përfitim kriminal ose përfitim ekonomik që rrjedh nga vepra penale.

6. Konfiskimi zbatohet për arsye ; së pari është ajo restorative që lidhet me kthimin e asaj që është përfituar pa të drejtë, së dyti parandaluese në kriminalitet pasi duke i hequr pasurinë e përfituar pa të drejtë parandalon mundësinë e përfshirjes më tej në kriminalitete, motivimit për të vijuar më tej në kriminalitet. Arsyeja e tretë që ka të bëjë me parandalimin por është ajo orientuese ndaj pronës, pasi pas konfiskimit prona nuk mund të përdoret më për ndonjë aktivitete kriminale, arsyeja e katërt është ajo kompensuese kompensuese si masë për ata që u është shkaktuar dëm nga vepra penale.
7. Konfiskimi i produkteve të veprave penale është insitut *sui generis*, i cili përdoret në rast të kryerjes së vepërës penale, i cili me një pjesë të tij lidhet me rregullat e së drejtës civile (*sequestrim/ngrijrje e pronës, procedurë përmbarimi/ekzekutim*) prandaj dhe konfiskimi konsiderohet një insitut i përzier penal - civil, qëllimi i të cilit është kthimi i situatës në gjendjen përpara kryerjes së vepërës penale dhe ndalimi i pasurimit të paligjshëm me veprimtari kriminale.
8. Konfiskimi parandalues ka disa karakteristika që e dallojnë nga konfiskimi penal pasi është masë parandaluese dhe jo dënim shtesë ose plotësues si konfiskimi penal që zhvillohet *in rem* ndaj pasurisë së dyshuar si të përfituar nga veprimtaria kriminale, nuk mbështetet në pozitën penale të personit ose në dënimin e tij dhe është autonom nga procedimi penal, shtrihet pa kufizim ndaj gjithë pasurisë së personit, ndaj asaj të familjarëve të tij dhe ndaj personave të tretë që kanë lidhje me personin si subjekt i ligjit, mbështetet në rregullat procedurale penale në rastin e ligjit tonë, ndryshon barra e provës duke ngarkuar personin që duhet të justifikojë pasurinë si të ligjshme, ka fuqi prapaverpuese.
9. Konfiskimi tejkalon logjikën penale; synon të ndajë përgjegjësinë penale individuale, ta lërë atë mënjane, si dhe të neutralizojë një formë të posaçme *in - rem*, synon parandalimin e implikimit kriminal të ekonomisë dhe të institucioneve financiare, duke u krahasuar me të ashtuquajturën *actions in - rem*, konfiskimin civil dhe instrumenteve të tjerë të vendeve anglo-saksone, e duke ndjekur një rregullim të ndryshëm në raport me procesin e të provuarit dhe barrën e provës.

10. Konfiskimi i zakonshëm që bazohet në dënim është njëri prej elementëve më themelorë të konfiskimit së bashku me konfiskimin bazë të vlerës dhe konfiskimin e mjeteve. Konfiskimi i zakonshëm është konfiskimi i produkteve ose i përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga vepra penale për një person i cili është dënuar me vendim të formës së prerë. Konfiskimi pa patur një vendim dënimi është aplikimi i konfiskimit kur ndaj pronarit të pasurisë nuk ka një vendim dënimi pasi nuk gjenden prova për fajësinë, është pushuar çështja, nuk gjendet ose është ndarë nga jeta. Kjo është njohur nga një sërë sistemesh ligjore dhe nga e drejta ndërkombëtare por si standard ndërkombëtar nuk ka një qasje të prerë ndaj këtij lloj konfiskimi pasi është një çështje shumë delikate.
11. Konfiskimi penal "*i zgjeruar*" i aseteve të dyshuara me origjinë të paligjshme është modeli që bazohet në prezumimin e origjinës së paligjshme të aseteve të personave të dënuar për disa lloj veprash penale, tipikisht të lidhura me përfitimin e paligjshëm si për shembull, korrupsioni ose pjesëmarrja në organizata të llojit mafioz. Prezumimi i origjinës së paligjshme sipas këtij rregulli i referohet të gjitha aseteve të personit të dënuar, por mbetet subjekt i plotësimit të barrës së provës, ndonëse të reduktuar, nga ana e prokurorit i cili duhet të provojë mospërputhjen ndërmjet akumulimit të kapitalit të pandehurit dhe të ardhurave të tij të deklaruara për qëllimet e tatimeve ose veprimtarisë së tij të ligjshme ekonomike.
12. Dallimi mes konfiskimit penal e atij parandalues pasuror është së konfiskimi penal kërkon dhënien e një dënimi penal ndërsa ai që nuk bazohet në një dënim, nuk kërkon patjetër të ketë një vendim penal, konfiskimi penal *in personam* shoqëron dënimin penal. Standardet e provës mes të dy llojeve ndryshojnë pasi standardi i provës në konfiskimin pasuror parandalues është më i ulët megjithëse, shumica e juridiksione zbatojnë një standard më të ulët të provës gjatë konfiskimit pa dënim por duke specifikuar rregullat e aplikueshme të provave dhe procedurat mbi të cilat ato merren

Konkluzione mbi standardet ndërkombëtare, jurisprudencën e GJEDNJ dhe modelet ligjore të masave parandaluese pasurore.

13. Një sërë Konventash në nivelin e OKB, KE, Vendimet Kuadër të BE, Direktivat e Komisionit Europian, Rregulloret e Rekomandimet BE kanë trajtuar elementë të këtij

insituti të rëndësishëm duke e ngritur në nivel të një pjesë të së drejtës ndërkombëtare të veçantë. Jurisprudenca e GJEDNJ ka evidentuar kufirin e këtyre masave me respektimin e të drejtave të individit, jurisprudenca kushtetuese të vendeve të BE kanë përshtatur e thelluar konceptet mbrojtëse kushtetuese në referim të standardit të GJEDNJ, një sërë aktesh rregullative në kuadër të BE kanë zbërthyer në imtësi konfiskimin pasuror me synim uniformizimin e zbatimit të tij në hapësirën e përbashkët të së drejtës së zbatuar europiane e më gjerë.

14. Tashmë kemi të bëjmë me një juridiksion të veçantë të masave parandaluese pasurore e të konfiskimit pasuror në veçanti në rang të së drejtës ndërkombëtare që përfshin disa forma të tij me tipare të veçanta nga legjislacioni tradicional.
15. Direktivat e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit si dhe raportet shoqëruese të tyre përbëjnë gjetjet më të arrira e të fundit në çështjet e standartizimit të masave parandaluese pasurore me qëllim harmonizimin e tyre në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, duke qenë një bazë të rëndësishme referuese e gatshme për legjislacionin shqiptar, në mënyrë të veçantë për masat paraprake pasurore si një nga legjislacionet më delikate e për të cilën duhet treguar kujdes i veçantë. Gjyqtarët janë garantuesit e zbatimit të drejtë të ligjeve nëpërmjet interpretimit e kontrollit gjyqësor, prandaj njohja e normave e standardeve ndërkombëtare është detyrë e tyre.
16. Nëse rendisim në analizë jurisprudencën e GJEDNJ tashmë mund të krijojmë një indeks të qëndrimeve të saj të cilat ne duhet ti kemi në vëmendje në praktikën e përditshme në frymën e interpretimit pajtues të ligjit tonë për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar me nenet 1, 6, 7, 8 të KEDNJ. Si të tilla si gjetje të kësaj analize mund të rendisim qëndrimet e GJEDNJ se : e drejta e pronësisë apo e posedimit mbrohet nga neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ, e drejta e pronës gjatë procesit të konfiskimit mbrohet nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, neni 6 i KEDNJ, ndërhyrjen me masat e parandalimit pasuror sekuestrim, konfiskim duhet të jenë në proporcionalitet dhe legjislacioni duhet të përcaktojë një prag vlerësimi të qartë të asaj që konsiderohet pasuri e paligjshme e të mundisë së justifikimit të pasurisë së ligjshme, në zbatimin e masës së konfiskimit legjislacioni duhet të jetë në proporcion të drejtë e të balancuar të interesit të përgjithshëm publik me nevojën për konfiskim dhe asaj të mbrojtjes të së drejtës së pronësisë e asaj për proces të rregullt ligjor, në rastet e krimit të organizuar, mafioz, shtetet duhet të

parashikojnë mekanizma ligjore të balancimit të të drejtave në raport me rëndësinë e kriminalitetit, sekuestrimi i pasurisë së përfituar në mënyrë të padrejtë nga nëpunësit civil i shtetit në kuadër të masave kundër korrupsionit nuk përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit 1, prezumimi se pasuria ishte fituar në mënyrë të paligjshme nuk përbën shkelje të nenit 6 nëse shtetasve u jepen mjete për tu mbrojtur e provuar të kundërtën, kalimi i barrës së povës tek individit nuk përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ nëse parashikohet shprehimisht nga legjislacioni vendas, që të jemi para respektimit të KEDNJ në aplikimin e një masë pasurore ajo duhet të jetë e parashikuar në ligjin e brendshëm e të zbatohet në mënyrë proporcionale, në ekuilibrin e drejtë të masë duhet të jetë në vëmendje : sjellja e pronarit, niveli i fajit, qëllimet dhe objektivat e ligjit, lënia pa pronë e blerësit bona fides, apo mosdhënia e mundësisë së kompensimit, përbën ndërhyrje joproporcionale dhe shkelje, jo çdo masë konfiskimi pasurie ndaj një pasurie në pronësi të një personi që është shfajësuar nga akuzat është në përputhje me Konventën nenin 7, në veçanti për personat juridikë, marrja e masës së konfiskimit të pasurisë shumë kohë pas marrjes së një vendimi shfajësimi nga akuzat penale, jo në çdo rast është në përputhje me nenin 6 të KEDNJ.

17. Jurisprudenca e GJEDNJ na orienton që ligji ynë duhet të ndjekë standardin ndërkombëtar të respektimit të së drejtës së pronësisë duke riparë rregullimet për aksesin në gjykim në të gjitha fazat, kontradiktoritetin, mbrojtjen efikase të palëve të treta si dhe konfiskimin në rast të mospasjes së një dënimi penal.
18. Tashmë kemi të bëjmë me një juridiksion të veçantë të masave parandaluese pasurore, konfiskimit pasuror që përfshin normat konvencionale ndërkombëtare, standardet ndërkombëtare të interpretimit të tyre, dhe jurisprudencën e GJEDNJ, juridiksion që duhet të na orientojë në një sistem ligjor rregullativ sa më të përshtatshëm për masat e konfiskimit pasuror.
19. Vende të ndryshme kanë gjetur zgjidhje të ndryshme legjislative; disa sisteme ligjore europiane e më gjerë i kanë të parashikuar sekuestrimin dhe konfiskimin si insitute penale ose civile në kodet respektive materiale penale. Ligji ynë ka marrë modelin ligjor italian gërshtuar me atë anglez. Modeli italian i Ligjit Antimafia tek i cili është marrë dhe ligji ynë, është modeli më i suksesshëm i përdorimit të masave pasurore i konsideruar më shumë si një masë reale sigurie personale e pasurore me karakter parandalues dhe jo

ndëshkues e cila nuk e lidh fuqinë e këtij insituti me veprimin në kohë të ligjit dhe me procedimin penal.

20. Legjislacioni shqiptar në fushë është i ri e si i tillë është shumë e rëndësishme që ti përmbahet standardeve ndërkombëtare, në veçanti atij të Bashkimit European e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Normat dhe standardet ndërkombëtarë për çështje të luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, në veçanti të konfiskimit të pasurive kriminale e barrës së provës mbi justifikimin e pasursë së ligjshme kanë evoluar. Kryesisht, standardet në nivelin e Bashkimit European me tëresinë rregullative të akteve si Vendimet Kuadër të BE, Direktivat e Komisionit European, Rregulloret, Rekomandimet etj kanë evoluar në mënyrë dinamike duke ju përgjigjur prirjeve dhe formave të pastrimit të parave.
21. Është e nevojshme një interpretim korrekt nën frymën e normave, standardeve ndërkombëtare, jurisprudencës kushtetuese e asaj të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, një praktikë gjyqësore e njëjtë e e qëndrueshme për çështje të zbatimit të tij. Një ligj i plotë me parashikimet e nevojshme e i plotësuar me rregullimet e duhura që të garantojë një procedim pasuror në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor e që ti japë palëve të gjitha mundësitë e mundshme për të referuar në insitutet e duhura procedurale, është i nevojshmëm.
22. Ka shumë rëndësi njohja e standardeve ndërkombëtare dhe zbatimi i tyre në nivelin kombëtar, detyrimi që ka shteti ynë që në përdorimin e këtyre instrumenteve të veçantë të garantohen parimet e procesit gjyqësor të drejtë e garancitë procedurale të të hetuarve, familjarëve të tyre, bashkëpunëtorëve, personave të tretë në mënyrë që si shtet në një përballje të mundshme me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Shqipëria të gjendet në respektim të frymës së KEDNJ, standardet e zbatimit të së cilës i gjejmë pikërisht në këto norma e në këtë jurisprudencë të GJEDNJ.
23. Normat ndërkombëtare, standardet ndërkombëtare e jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut na përcaktojnë kufijnjtë ligjorë të rregullimit të sekuestrimit, konfiskimit, barrës së provës e gjithashtu orientimin tonë në interpretimin gjyqsor të ligjit. Duke parë gjithë kuadrin rregullativ ndërkombëtar, standardet ndërkombëtare tashmë të konfirmuara, jurisprudencën e GJEDNJ, ne duhet të reflektojmë nëse ligji ynë që rregullon masat parandaluese është në përputhje me këto standarde.

24. Duke analizuar jurisprudencën e GJEDNJ dhe aktet komunitare, ne duhet që të bëjmë kujdes me legjislacionin tonë për të përputhur me këto standarde mbrojtjen e interesave pasurore të subjekteve të ligjit, saktësimin e procedurave të konfiskimit, përputhshmërinë me proporcionalitetin e veprës të konfiskimit pa dënim e atij të zgjeruar si dhe mbrojtjen e interesave të palëve të treta, kreditorëve, huadhënësve. Prandaj dhe njohja e saj për juristët, avokatët, gjyqtarët e prokurorët shqiptarë është e rëndësishme.

Konkluzione mbi legjislacionin shqiptar mbi masat parandaluese.

25. Shqipëria ka një ligj tipik *sui generis*, i natyrës penale, por që bazohet në parimet e konfiskimit civil e të zgjeruar e atij pa dënim, e ka të përcaktuar një standard të caktuar të ulët të provës atë të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicie e që i ngarkon barrën e provës subjektit, gjithnjë duke mbrojtur interesat e të të tretëve e duke respektuar kontradiktoritetin në gjykim e parimet e procesit gjyqësor të drejtë.
26. Legjislacioni ynë përvetësoi këtë model ligjor të suksesshëm të zbatuar në vendet e përparuara europiane, duke adaptuar kë të zgjidhje të veçantë për procedimin pasuror parandalues *in rem* i njohur në sistemet ligjore bashkëkohore si konfiskimi civil. Ligji për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë ishte një risi pasi solli ndryshim në një sërë parimesh tradicionale të së drejtës e të procedimit penal si veprimi në kohë i ligjit, rrethi i personave ndaj të cilëve vepronte, barra e provës për subjektin e ligjit, pavarësia nga procedimi penal etj.
27. Natyra e ligjit, zgjerimi i veprimit në kohë të tij, rrethi i gjerë i personave ndaj të cilëve vepronte, devijimi i barrës së provës, rregullat e të provuarit, standardi i provës së kërkuar për të filluar procedimin pasuror e për të vendosur konfiskimin, autonomia nga procedimi penal e nga pozita penale e personit kanë qenë çështjet e diskutueshme në interpretimin e praktikën e përditshme të zbatimit të tij të këtij ligji.
28. Ky ligj duke qenë një instrument i zhdërvjellët e efikas procedural u jep mundësi organeve të procedimit që të sekuestrojnë e të konfiskojnë të ardhura e pasuri duke luftuar kriminalitetin në pikën e tij më të ndjeshme e duke rritur autoritetin e duhur në zbatimin e ligjit. Mbrojtja dhe garantimi i së drejtës së pasurisë së ligjshme, lirisë së veprimit ekonomik si e drejtë kushtetuese, mbrojtja e të drejtave ekonomike të personave të tretë,

familjarëve, bashkëpunëtorëve në veprimtarinë ekonomike, kreditorëve, huadhënësve është po aq e rëndësishme sa qëllimi i ligjit. Studimi i këtij ligji dhe interpretimet teorike e gjyqsore mbi të kanë rëndësi të madhe në kushtet e rëndësisë që ka zbatimi i tij e të mungesës së tyre. Për zbatimin korrekt të tij, duhet gjetur balanca në mes të fuqisë së veprimit të ligjit mbi pronën e mbrojtjes së të drejtave ligjore, ekonomike, pasurore të shtetasve subjekte të ligjit, të afërmëve të tyre, bashkëpunëtorëve, të tretëve.

29. Modeli që ka zgjedhur ligjvënësi shqiptar, ashtu sikurse dhe disa vende të së drejtës kontinentale, krahasuar me procedimet civile për konfiskimin, të cilat janë tipike të sistemeve *common-law*, ka avantazhin e rëndësishëm të mundësisë për të përdorur disa instrumente që janë në dizpozicion të hetimeve në procesin penal. Ky model karakterizohet gjithashtu nga një standard prove i cili kërkon një demostrim rigoroz të origjinës së paligjshme të aseteve (*të cilat rrjedhin prej veprimeve të paligjshme apo të jenë të investuara në ndërrmarrje apo pasuri të paluajtshme*) ose të përputhjes ndërmjet aseteve të akumuluar dhe të ardhurave të ligjshme. Në këto procedime, mbledhja e provave bëhet në mënyrë të thellë, bazohet në përdorimin e teknologjisë së informacionit, në përdorimin ndërthurur të analizës së provave plotësuese dhe hetimeve financiare dhe në një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteve gjyqësore dhe institucioneve të tjera.
30. Justifikimi i prejardhjes së ligjshme të pasurisë është një proces i vështirë e të provuarit përkundrajt mundësisë që ka prokuroria për të përdorur të dhënat, indiciet, provat e procedimit penal. Kjo ndikon në pozitën e zotëruesit të pronës. Hulumtimi i të gjitha mundësive që ligji apo dispozitat e tjera referuese procedurale i japin subjektit të tij, e personave të tretë në mbledhjen e provave e dhënien vlerë të pretendimeve të tyre është me shumë rëndësi për studiuesit, e profesionistët e zbatimit të tij.
31. Çështjet e interpretimit gjyqësor mbi devijimin e barrës së provës për justifikimin e pasurisë së ligjshme tek zotëruesi i pasurisë, niveli më i ulët i kushteve të fillimit të procedimit dhe nevoja e balancimit të një sërë instrumentesh procedurale, mundësitë e mbledhjes e marrjes së provave e paraqitjes së provave, vlera e vlerësimi i tyre, vështirësitë, zbatimi i parimit të proporcionalitetit në kufizimin e së drejtës së pasurisë e detyrimi për të reflektuar frymën e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duhet të jenë çështje në diskutim të gjithanshëm e të vazhdueshëm.

32. Ligji i ri për parandalimin dhe goditjen e krimeve të rënda, korrupsionit e trafikeve nëpërmjet masave parandaluese është një ligj i mirë e efikas i natyrës penale që trajton një insitut konfiskimi *in rem*, bazohet në në parimet e konfiskimit civil, të autonomisë së procesimit pasuror nga ai penal e të devijimit të barërs së provës, duke përcaktuar si standard të provës atë të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për regjistrimin e rremë, i cili duhet të jetë i mbështetur në të dhëna të dobishme të siguruara në rrugë të ligjshme ç'ka nënkupton një garanci për një proces të ligjshëm.
33. Ligji zbatohet edhe për pasuri të vëna para hyrjes në fuqi të ligjit dhe kërkohet vetëm ekzistenca e indiceve për pjesëmarrje në veprimtari kriminale dhe se pasuria të jetë vënë gjatë kësaj veprimtarie, sanksionon autonominë e procesit parandalues ndaj atij penal, kufizon e përcakton një rreth më të ngushtë të veprimit të ligj e konkretisht të pasurisë së dyshuar e të vënë në emër të familjarëve, e bashkëpunëtorëve, verifikimet, hetimet dhe gjykimi sipas këtij ligji do të rregullohet nga dispozitat procedurale të këtij ligji dhe ato të Kodit të Procedurës Penale dhe se të dhënat që rrjedhin nga procedimi penal përdoren edhe në procedimin pasuror, sipas procedurës së këtij ligj, mundësinë e thirrjes gjatë fazës së konfiskimit të personave të tretë e ne veçanti mundësisë së mbrojtjes së pasurisë nga ana e personit të tretë në mirëbesim, si dhe i sanksioneve për të tretët në keqbesim, hetimin për pasuritë të cilat me anë të veprimeve juridike janë transferuar tek të tretët si dhe përcakton kritere të standardit të provës e të kushteve e kriterëve që duhen plotësuar për të vendosur konfiskimin e pasurisë.
34. Çështjet e praktikës gjyqësore dhe interpretimet e ndryshme nga gjykatat në lidhje me institutet e këtij ligji e në mënyrë të veçantë ato që lidhen me rrethin dhe pozitën procedurale të personave ndaj të cilëve zbatohet ligji, veprimet procedurale të cilat duhet të kryente dhe kishte mundësi të zbatonte prokuroria gjatë fazës së hetimit pasuror dhe nëse referimi në rregullat e procedurës civile nënkuptonte disponibilitet të plotë të prokurorisë mbi kërkesën për konfiskim e ngjashme me atë të disponimit të padisë, çështjet e të provuarit, të standardit të provës, kuptimi i indicies që mbështesin dyshimin për përfitimin e pasurisë kriminale etj. kanë qenë çështjet e debatueshme të zbatimit të këtij ligji në kohë.
35. Legjislacioni për masat parandaluese është i ri e si i tillë ai duhet të jetë një legjislacion modern që të reflektojë risitë e fundit në legjislacionin europian. E drejta e vendeve

europiane është një drejtë në zhvillim e sipër çdo ditë, jurisprudenca e GJEDNJ, po ashtu. Konfiskimi pasuror është një masë e cila prek të drejtën e qenësishme të pasurisë e lirisë së veprimit ekonomik e tregtar e si e tillë kufizimi i saj duhet të jetë në përputhje me parimet e KEDNJ e standardet ndërkombëtare. Ky institut ka thyer parimet tradicionale tona të së drejtës e zbatimi i tij nuk është i lehtë.

36. Është e rëndësishme dhënia e të gjitha mundësive subjektivit të ligjit për të provuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë gjatë procesit të vështirë të ngarkimit me barrën e provës së justifikimit të pasurisë së paligjshme.
37. Tashmë mund të themi se kemi një ligj tipik që bazohet në traditën kontinentale të konfiskimit si masë parandaluese pasurore e që ka pranuar standardin më të ulët të provës e devijimin e barrës së provës.
38. Krahësuar me juridiksionin ndërkombëtar të masave parandaluese dhe ligjet homologe të vendeve të BE e më tej, pas kaq viteve zbatimit të këtij legjislacioni ne duhet ta rishikojmë atë duke rirregulluar ligjin në fuqi ose duke përvijëzuar një juridiksion të ri të masave parandaluese brenda sistemit tonë ligjor. Kjo duke patur në vëmendje se sistemet ligjore të cilat nuk e lidhin konfiskimin me dënimin apo pozitën e personit në procedimin penal janë procedime civile, jo domosdoshmërisht penal por administrative në kuptimin e një lloji të veçantë të angazhimit shtetëror, konfiskimi i zgjuar i adaptuar nga ne është karakteristikë për konfiskimin e lidhur me një vendim dënimi apo fajësie për një vepër të rëndë apo krim të organizuar, konfiskimi pa dënim, konfiskimi objektiv apo autonom është i natyrës së konfiskimit civil që rregullohet me rregullat e procedurës civile, barra e provës është karakteristikë për procedimin civil, procedura penale e lidh konfiskimin me pozitën penale të personit subjekt të ligjit detyrimisht.

Konkluzione mbi provat dhe të provuarit në masat parandaluese pasurore.

39. Sekuestrimi dhe konfiskimi si procedura parandaluese pasurore, si insitute që janë rregulluar me një ligj të veçantë *sui generis*, kanë karakteristikat e tyre të veçanta për sa i përket rregullave të të provuarit, standardit të provës, provave që përdoren e mënyrës si merren, barrës së provës, parimet e procesit të drejtë gjyqësor dhe kontradiktoritetit, në prova e teoritë e të provuarit sipas parimeve përkatëse të procedurës që zbatohet

40. Jo të gjitha parimet e provave të procesit penale apo civil vlejnë edhe për procedimin pasuror, pasi në procedimin pasuror, niveli i provave dhe i të provuarit është më i ulët. Megjithatë, të vlerësuarit e provave bëhet sipas disa parimeve të caktuara të cilat gjenden në rregullat e Kodit të Procedurës Penale dhe praktikat ndërkombëtare
41. Procesi i të provuarit ka dallime sipas procedurës në të cilën referon ; procedura penale lejon një hetim pasuror më efikas pasi mund të përdoren rezultatet e procedimit penale dhe mjetete e kërkimit të provës, ndërsa procedura civile ka më shumë mundësi procedurale që palët dhe personat e tretë të jenë aktivë në proces, nisur dhe nga fakti që barra e provës për palët private është tipar i procesit gjyqsor civil ndërsa në procedurën penale rregullat mbi provat janë më të kufizuara e lejohet vetëm paraqitja e provave të njohura sipas parashikimeve të Kodit.
42. Kemi një standard prove të veçantë në procesin e të provuarit në shqyrtimin e masave pasurore, një standard prove të ndryshëm që ka ndryshuar sipas procedurës së zbatimit deri në ndryshimet e fundit, që kërkon interpretim rigoroz në mënyrë që të garantojë procesin në thelb të të cilit është prova, duke e rritur standardin e provës krahasimisht me më përpara por duke ruajtur gjithnjë një standard prove më të ulët se ai penal.
43. Barra e provës për justifikimin e pasurisë së paligjshme i përket personit por kjo nuk shmang detyrimin e prokurorit që në kërkesën për sekuestrim e konfiskim të sjellë prova për të vërtetuar kushtet e kriteret për këto masa. Hetimi pasuror nuk siguron në çdo fazë kontradiktoritetin, ndërsa ai i gjykimit të kërkesës për konfiskim duhet domosdoshmërisht të sigurojë debatin mbi provën, kontradiktoritetin, barazinë e armëve për shtetin dhe subjektin
44. Është e nevojshme që ligji të përcaktojë veprimet hetimore pasurore konkrete dhe provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e vecantë me ligj, si dhe të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen e vlerësimit të tyre, duke bërë përkufizimin e *indicies, elementëve të faktik, provat rrethanore, provës dokumentare*, asaj që merret nga procedimi penal e rregulla të tjera të marrjes së provës në kontradiktoritet.
45. Procedimi pasuror nëpërmet sekuestrimit e në veçanti konfiskimit të pasurisë duke qenë një proces tjetër nga ai penal, e në të njëjtën kohë dhe i natyrës penale, përbën një rregullim të dyfishtë të procesit të të provuarit, objektit të të provuarit, provave dhe barrës së provës prandaj dhe në interpretimin e parimeve të të provuarit e të llojeve të provave, i referohemi

natyrës dhe parimeve mbi të cilat funksionojnë masat parandaluese pasurore si një procedim pasuror *in rem* që ka për qëllim parandalimin nëpërmjet sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë e që kryhet nëpërmjet verifikimit të prejardhjes së ligjshme të saj e kalimit të barrës së provës tek zotëruesi i saj.

46. Nuk ka një juridiksion të veçantë brenda legjislacionit shqiptar të masave parandaluese por vlerësojmë se është e nevojshme krijimi i një juridiksioni të tillë dhe brenda sistemit ligjor shqiptar për vetë natyrën e masave parandaluese pasurore si rregullime ligjore *sui generis*. Kjo mund të arrihet duke identifikuar rregullime të reja mbi provat e të provuarin që parashikon ligji dhe ato të procedurës penale apo civile dhe legjislacionin e veçantë tek i cili duhet të referohemi në hetimin e gjykimin pasuror. Tashmë ligji zbatohet nga gjykata e posacme por edhe nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm sipas fushës së kompetencës së tyre, duke patur parasysh rëndësinë që ka marrë zbatimin e ligjit me zgjerimin e fushës së veprimit edhe për vepra të tjera të krimit të organizuar, korrupsionit e krimit ekonomik patjetër e do të përvijëzojë shpejt edhe në praktikën shqiptare një juridiksion të veçantë të tij të ngjashëm me atë në vendet e tjera të marra si model.
47. Duhet të jetë jurisprudenca nëpërmjet konsolidimit të interpretimit në nivel kushtetues e konvencional dhe praktika gjyqësore për çështjet e interpretimit gjyqësor të ligjit që të trajtojnë e përcaktojnë parimet e zbatimit të së drejtës së provës në procedurën e parandalimit krahas asaj të procesit penal.
48. Procedimi pasuror ka karakteristikat e tij si autonomia me procedimin penal dhe standardi i provës më i ulët se ai i procedimit penal, devijimin e barrës së provës dhe objekti i veçantë i të provuarit që lidhet kryesisht me pasurinë e të ardhurën për rrjedhojë, edhe procesi i të provuarit ka rregullat e veta të veçanta që përcaktohen në këtë ligj në disa përcaktime të veçanta të tij, e aty ku nuk kanë përcaktim të mjaftueshëm të interpretohen në frymën e përparësisë që ka ligji i veçantë.
49. Në zbatimin praktik të ligjit ka rëndësi prova si dhe mundësia që i jepet palës për ta paraqitur atë pasi procesi i konfiskimit të pasurisë është shumë kompleks kur bëhet fjalë për pasuri të mëdha, aktivitetet ekonomike ku janë përfshirë familjarë, të tretë, bashkëpunëtorë, banka, huadhënës, kompani siguracionesh e investimesh, kërkohen ekspertime financiare, kontabile të vlersimit të pasurive etj.

50. Përsa i përket provave, procesit të të provuarit, parimeve mbi të cilat ato bazohen kemi parashikimet e ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit e korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese, rregullimet veçanta të ligjit të cilat bazohen në parimet e procedimit pasuror si standardi i provës e barra e provës. Ndërkohë si norma plotësuese procedurale kemi ato të legjislacionit procedural penal. Këto rregullime nuk mjaftojnë për një procedim ku ndërthuren koncepte të pronësisë, posedimit, e çdo insituti tjetër të së drejtës civile, familjare, trashëgimisë, tregtare, financiare, administrative etj.
51. Ndryshe nga standardet e të provuarit dhe përgjegjësisë në dhënien e një vendimi penal, përfshirë urdhërimin për konfiskimin ose jo të sendeve të sekuestruara, në procedimin parandalues, sipas ligjit shqiptar, vendosja e masës pasurore ka në themel të saj dyshimin e arsyeshëm, të mbështetur në të dhëna të mjaftueshme që rezultojnë nga tërësia e provave të marra dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, gjykimi parandalues mbështetet në prezumime, dyshime të arsyeshme, të dhëna të mjaftueshme, duke iu ngarkuar personit të dyshuar dhe personave të tjerë barra e provës për të vërtetuar ligjshmërinë për justifikimin e origjinës së pasurisë.
52. Standardet e provës që kërkohet janë të ndryshëm për kërkime të veçanta duke dalluar vërtetimi i faktit apo të provuarit për pjesëmarrje në veprimtari kriminale me atë që kërkohet për të vërtetuar ligjshmërinë e pasurisë. Ligji kërkon *dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova* për pjesëmarrjen në veprimtari kriminale që përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit, pjesëmarrja në kriminalitet të organizuar ose veprat penale të tjera në fushën e zbatimit të ligjit duhet të provohet bazuar standardit më të ulët të provës që mbështetet tek dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie, në rastin e rregjistrimit të remë të pasurisë në emër të të afërmëve ligji ka zgjedhur *prezumimin* që është një nivel më i ulët provues, ndërsa e kundërta duhet të provohet, ç'ka kuptohet me prova me nivel provues, *të dhëna të mjaftueshme* se pasuritë ose veprimtaritë e subjekteve të ligjit zotërohen pjesërisht ose plotësisht, kërkohen "*të dhëna të mjaftueshme*", kjo në kuptimin që titulli i pronësisë ose posedimit mund të vërtetohet saktë për shkak të rregjistrimit të pasurisë, *të dhëna të dobishme* të siguruara në mënyrë të ligjshme që krijojnë dyshim të arsyeshëm në rastin e zbatimit të prezumimit të rregjistrimit të remë, *të dhëna të mjaftueshme* që pasuritë zotërohen nga subjektet e ligjit nxirren nga marrëdhënia mes të tyre me të afërmit por dhe nga të dhëna të dobishme të siguruara në mënyrë të ligjshme që krijojnë dyshim të

arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë, *indicie të rëndësishme* për përfshirjen në veprimtari kriminale në rastin e veprimit të ligjit në kohë për pasuritë e vënë përpara hyrjes në fuqi të tij.

53. Të njëjtin nivel prove ligji pranon për rregjistrimin e procedimit penal, sekuestrimin dhe konfiskimin pasi si procedim pasuror për pasuritë që zotërohen plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi të cilët ekziston një dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se janë fituar me kryerjen e veprave penale në fushën e zbatimit të ligjit. Këto standarde prove kërkohen edhe për pasuritë që zotërohen plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi të cilët ekziston *një dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova* se janë fituar me kryerjen e veprave penale në fushën e zbatimit të ligjit.
54. Ka dallime në mes të asaj që kërkohet për sekuestrimin dhe konfiskimin; sekuestrimi vendoset kur ekziston *dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie* që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri, konfiskimi i pasurisë vendoset *kur ka dyshime të bazuara në indicie* për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, por ndërkohë kërkohet në mënyrë kumulative që të rezultojë nga posedimi i pasurisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi dhe nuk provohet prejardhja e ligjshme e pasurisë, ndërsa për përfshirjen në veprimtari kriminale kërkohen *dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie* në lidhje me këtë fakt.
55. Sekuestrimi vendoset kur ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri. Konfiskimi i pasurisë vendoset kur ka dyshime të bazuara në indicie për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, por ndërkohë kërkohet në mënyrë kumulative që të rezultojë nga posedimi i pasurisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi dhe nuk provohet prejardhja e ligjshme e pasurisë.
56. Në kuptimin e provës, duhet ti referohemi provës në të drejtën procedurale penale, teorisë mbi të por gjithashtu natyrës së gjykimit parandalues pasuror, standardi i provës dhe devijimin e barrës së provës i referohet natyrës së konfiskimit të cilën GJEDNJ e konsideron si masë parandaluese dhe jo penale, që ka një funksion të ndryshëm nga procesi *in personam* e që merret me qëllim interesin publik.
57. Procesi parandalues pasuror është një proces që i nënshtrohet parimeve të procesit të rregullt gjyqësor e parimeve themelore të procesit penal dhe të cilësura si të tilla nga ndërhyrja e gjykatës mbi palët, shqyrtimi i një kërkesë të qartë e një objekti të caktuar

gjykimi në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe natyrës së detyrueshme të masës që do merret, kontradiktoritetit në gjykim, sigurimit të mbrojtjes, gjykimit në të gjitha shkallët, mundësia për prova, e drejta e ankimit dhe ajo e rishikimit në rast të një vendimi të padrejtë.

58. Për verifikimin, hetimin dhe gjykimin mbështetet në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohet nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, dhe gjithashtu bazohet në standardin penal të *dysimit të arsyeshëm*. Kjo i jep ligjit natyrën penale të tij, prandaj dhe nuk ka një rregullim të veçantë të provave, teorisë së të provuarit në hetimin e gjykimin parandalues, por për këtë i referohemi tashmë asaj të procedurës penale.
59. Hetimi pasuror ka karakteristikat e veta se është një hetim mbi pronën e pasurisë dhe janë rregullimet e veçanta në ligjin përkatës të mundësisë që ka prokuroria për të mbledhë të dhëna, akte, për të bërë verifikime të nevojshme me qëllim mbledhjen e të dhënave, indicieve apo provave ku ajo mbështet kërkesën për sekuestrim e konfiskim. Rregullat e ligjit prevalojnë mbi ato të procedurës penale që është procedura referuese ç'ka do të thotë që përsa gjejmë parashikime në ligj ne u referohemi atyre, kur nuk ka i referohemi rregullave penale të Kodit të Procedurës Penale.
60. Duke analizuar parashikimet e veçanta të ligjit dhe ato referuese në Kodin e Procedurës Penale për provat dhe vlerësimin e tyre, mund të krijojmë një *indeks* të mënyrës së kryerjes së verifikimeve, hetimeve e marrjes së provave që mund të përdoren në kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë që bazohet në fashikulli i procedimit penal nëse kemi një procedim penal të filluar para ose pas rregjistrimit të procedimit pasuror ose vetëm akte të veçanta të procedimit penal, vendimi gjyqësor i dënimit nëse kemi një proces gjyqësor ndaj subjektit i cili ka përfunduar me një vendim fajësie apo pushimi të çështjes në ngarkim të subjektit, procesverbalet e sekuestrimit, kontrollit, kqyrjes, procesverbalet e sekuestrimit e të marrjes së dokumenteve të pronësisë, kqyrjes së rregjistrave të pasurisë, titujve të pronësisë, akteve të gjendjes civile, aktet e ekspertimit kontabël, financiar e të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, provat materiale, dokumentet dhe rregjistrimet teknike, procesverbale ose thënie të dëshmitarëve.
61. Veprimet hetimore të prokurorisë të kryera vetë ose nëpërmjet policisë gjyqsore bëhen në lidhje me verifikimet e pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, merren të dhëna në rregjistrat e pasurive apo të titujve të pronësisë p.sh. verifikimet e pronave në rregjistrat e pasurive të paluajtshme, mbi mjetet financiare ku futen të gjitha instrumentet me të cilat

një person operon në sistemin finaciari si: *transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* etj, mbi veprimtarinë ekonomike, tregtare dhe profesionale dhe burimi i ardhurave të tyre, ku përfshihen verifikimet mbi llojin e aktivitetit tregtar ose profesional, në emër të subjektit, në ortakëri me të tjerë apo aksioner, kapitali themeltar, burimi, pagesat e tatimeve, bilancet, shpërndarjen e të ardhurave, shpenzimet, llogaritë rrjedhëse e transfertat, investimet.

62. Verifikime të veçanta bëhen për subjektet që janë zotërues të lejeve për transport, shërbime, shfrytëzim mineral, pyjor, peshkim, e në veçanti atyre të ndërtimit, autorizimeve, koncensioneve, licensave e çdo të drejtë tjetër për të ushtruar ushtruar aktivitet ekonomik, verifikohen kontributet nëse janë përfituar, financime, kreditime të çdo lloji, të dhëna të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare, verifikohet e hetohet nëse këto pasuri, veprimtari, të drejta pasurore janë të ligjshme apo jo, informacion administratës, bashkive, gjendjes civile, të regjistrimit të pasurive e të kadastrës, të tatimeveve, licensave, të shërbimeve periodike e të furnizimit me ujë, energji, sigurimeve shoqërore, bankave, shoqërive kursim kredi e atyre të investimeve duke u kërkuar kopje të dokumentacionit të veprimeve të subjektit apo të afërmeve të tij, bëhen hetime për mënyrën e jetesës së personit, shpenzimet e përditshme etj.
63. Titullari i së drejtave reale e atyre të pronësisë subjekti mund të marrë vetë të dhëna, akte, prova shkresore e ti paraqesë në gjykatë si *titujt e pronësisë së pasurive të luajtshme e të paluajtshme* të cilat merren në regjistrat e pasurive apo të titujve të pronësisë të dhëna e akte mbi *transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* etj. të cilat mund të merren nga bankat e institucionet e tjera financiare, si të tilla ata lënë gjithmonë gjurmë, të dhënat e prova për *pagesën e tatimeve* sipas legjislacionit fiskal ku përfshihen të dhëna e akte për zbatimin e procedurave tatimore e pagesën e tatimeve sipas ligjit tatimor, *pagesën e tatimeve mbi të ardhurat si biznes* apo ato që rrjedhin nga vlerësimi i pasurisë së paluajtshme apo transaksioneve mbi të, *pagesën e tatimeve mbi vlerën e shtuar* sipas legjislacionit mbi vlerën e shtuar, *pagesën e taksave kombëtare* sipas legjislacionit për taksat kombëtare , *pagesën e taksave lokale* sipas ligjit

për taksat lokale, *pagesat e detyrimeve doganore* sipas legjislacionit doganor, përmbushjen e detyrimit për deklarimin e pasurisë për subjektet si funksionarë publikë, gjyqtarë e prokurorë që detyrohen të bëjnë *deklarim periodik vjetor për pasurinë dhe konfliktin e interesit e ligjit për deklarimin e pasurisë*.

64. Në procedurën e parandalimit të gjitha dokumentet e përfuara, dhe ndër këto janë dokumente të krijuara në procesin penal si: vendime për caktimin e zbatimit e masave të sigurimit, procesverbale për përgjime, për sekuestre dhe kontrole, deklarata të dëshmitarëve dhe marrje në pyetje, vendime, etj. Në mungesë të një dispozite të shprehur që ta përjashtojë mundësinë e marrjes së këtyre rezultateve, mund të konsiderohet e lejuar. Në këtë përfundim mund të arrihet nga parimi i autonomisë së procedurës penale dhe asaj të parandalimit, që tregon se si mund të ekzistojnë njëkohësisht hetime penale dhe parandalimi pasuror.
65. Rregullimi në legjislacionin shqiptar mbi kompetencat e gjykatës për të vendosur kryesisht për të kryer veprime procedurale të tilla invazive si kontroll banese e përgjim bidedash telefonike është një zgjedhje e veçantë të cilën nuk e kanë legjislacionet e tjera, vështirë të zbatohet në praktikë por dhe nuk përputhet me rolin e gjykatës as në procesin penal. Me interes në fushën teorike dhe praktike është interpretimi i kuptimit të kësaj dispozite, edhe pse është e vështirë që një gjykatës të mund të “përmbushë” këto kompetenca në mënyrë “invazive” (*kontrolle në banesa, përgjime*). Si mjete të kërkimit të provave ato përdoren duke kufizuar privatësinë, kufizime të cilat mund të bëhen vetëm në kuadër të procedimit penal. Referenca për “*kërkesën e palëve*” tregon kompetenca të zgjeruara të gjykatës në procedurë pas sekuestrimit për të verifikuar argumentimet e të interesuarit dhe të Prokurorisë. Të dhënat, informacionet, rezultatet e verifikimeve, provat si: provat materiale, dokumentet, procesverbalet, ekspertimet mbledhen nga prokuroria gjatë fazës së hetimit pasuror përpara ose gjatë periudhës kur është vendosur sekuestro. Në vlerësimin tonë, kjo gjë nuk i përgjigjet pozicionit të Gjykatës, por synon efektivitetin e procedimit pasuror në tërësi si një procedim i veçantë e si e tillë ky rregullim duhet të rishikohet

Konkluzione mbi kërkesën për konfiskim.

66. Kërkesa për konfiskim është finalizimi një sërë veprimesh verifikimi e hetimi pasuror të prokurorisë që përmbledh relacionin e informacionet e policisë gjyqësore, rezultatet e verifikimeve të prokurorit, të gjitha të dhënat e provat e marra si rezultat e këtyre verifikimeve si dhe të gjitha të dhënat e provat që kanë paraqitur subjekti dhe të tretët gjatë fazës së zbatimit të vendimit të sekuestrimit, verifikimi duhet të bëhet duke u bazuar në fakte konkretisht të vërtetuar (*jo mbi dyshime, spekulime apo hamendje*):
67. Për të vërtetuar prejardhjen jo të ligjshme të pasurisë, nuk duhet prova e prejardhjes jo të kundraligjshme të pasurisë, por vetëm mjaftueshmëria e indicieve, që konkludohet kryesisht nga pabarazia ndërmjet vlerës së asetit dhe hyrjeve të deklaruara ose të veprimtarisë që ka kryer personi ndaj të cilit merren masa (*procedohet*)..
68. Kundërshtimet e palëve duhet të verifikohen në lidhje me pronësinë mbi pasurinë qoftë edhe jodirekte të pasurisë, si barrë prove e akuzës e përballë provës së ofruar nga organi propozues dhe që i duket e përshtatshme Gjykatës, në fazën e sekuestrimit. Të tretët që kanë pasurinë të regjistruar në emër të tyre (*pronarë formalë*) të thirrur në gjykim, mund të sjellin elementë që kanë synim të ndikojnë në krijimin e një alibie, duke ushtruar mundësinë për t'u mbrojtur, nëpërmjet futjes në procedurë të elementëve të besueshëm dhe koherentë .
69. Është barrë e personit të kundërshtojë indiciet e përfuara; barrë që duhet shlyer në mënyrë serioze, në atë mënyrë që t'i lejojë gjyqtarit të bëjë verifikimet e duhura në lidhje me ekzistencën e elementëve dyshues mbi prejardhjen e ligjshme të pasurisë. Përcaktimi i sendeve ndaj të cilit merret masa parandaluese duhet të jetë në çdo rast nominal duke ju referuar rëndësisë dhe pasojës që ai ka në interesat pasurore.
70. Prokurori në çdo rast ka detyrë të identifikojë pasuritë të cilat janë rezultat i veprimtarisë kriminale me qëllim që interesi publik i cili determinon në vendosjen e kufizimit të pronës të jetë në proporcion me masën që merret duke u vendosur vetëm mbi ato pasuri të cilat e kanë burimin nga aktiviteti i paligjshëm.
71. Kërkesa për konfiskim pasuror kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të tre kushteve që lidhen sigurisht me të provuarit nga ana prokurorisë në kontradiktoritet të pjesmarrjes së personit në veprimtari kriminale, në veprat penale që përcakton ligji. Kjo duhet provuar në nivelin e dyshimeve të arsyeshme të bazuara në indicie, kur rezultojnë e provuar se pasuria është drejtëpërsëdrejti ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave që

kanë kryer vepra penale në fushën e veprimit të ligjit duke e lidhur këtë me faktin rezultativ çka do të thotë një nivel prove i lartë, nuk është përmbushur barra e provës për të provuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë nga ana e subjektit i cili nukarrin të përligj zotërimin e pasurisë ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjestimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara.

72. Konfiskimi pasurisë mund të bëhet edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit pushohet ose ai deklarohet i pafajshëm me përjashtim të rastit kur fakti nuk ekziston, nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose del që i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale. Në rastin kur rezulton se personi i dyshuar zotëron një numër pasurish, masa parandaluese pasurore nuk vendoset vetvetiu mbi të gjitha pasuritë e tij, por çmohet e vendoset dhe vetëm për ato që, nga gjykimi, rezulton se nuk u justifikohet origjina, prejardhja e ligjshme.
73. Zbatimi i ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, në raport me procesin e rëndësishëm të të provuarit dhe provat ku mbështetet sekuestrimi dhe konfiskimi pasuror kanë nxjerrë në pah disa çështje ligjore dhe praktike me interes për tu trajtuar; në ligjin shqiptar mungojnë përcaktimet për sa i përket të llojit të të dhënës, dyshimit, bazës së mjaftueshëm dhe kritereve nga të cilat gjykatat duhet të nisen për vlerësimin e tyre, ligji duhej të kishte përcaktime të posaçme dhe vetëm në mungesë të tyre të referohej tek dispozitat e tjera procedurale.
74. Në praktikë i referohen rregullimeve procedurale penale të cilat gjithsesi i japin avantazh prokurorisë për të mbështetur një kërkesë për konfiskim mbi të dhëna dhe provat e marra në kuadër të procedimit penal, por jo për një hetim pasuror të specializuar, proaktive e të fokusuar vetëm në hetime pasurore. Nëse ligji do të parashikonte përcaktime përkatëse në lidhje me procedurën se si veprohet gjatë hetimit pasuror, atëherë do të kishte një normativë të posaçme dedikuar hetimit dhe gjykimit pasuror. Përdorimi i të dhënave që vijnë nga procedimit penal si përgjimet në një procedurë tjetër në kuadër të procedimit pasuror duhet të parashikohet me ligj se ndryshe mund të përbëjë shkelje të së drejtës private për personat për të cilët akuza është pushuar apo ka marrë vendim pafajësie.
75. Në praktikën e zbatimit të ligjit tonë konstatohet se elementët e përcaktuar ligjorë të detyrimit për tu provuar në standardin përkatës si ato të pjesmarrjes në veprimtari

kriminale, posedimit të pasurisë apo rregjistrimit të rremë e fiktiv, origjinës jo të ligjshme të pasurisë apo asaj të pajustificuar ligjërisht nivelit të provueshmërisë për secilin fakt, nuk gjejnë argumentim për çdo rast të veçantë por trajtohen të gjitha njësoj.

76. Standardi i provës është i veçantë në procesin e të provuarit në shqyrtimin e masave pasurore, një standard prove të ndryshëm e parime të veçanta prandaj dhe në zbatimin e masave duhet të ndjekim kriteret e përcaktuara në ligj për provat duke i plotësuar më pas ato me parimet e provave në procedurën penale.
77. Një ligj me të gjitha elementët e veçantë rregullator me elementë të plotë rregullativë *sui generis* dhe për çëshjet e provave e të provuarit, që të ketë parashikime të tjera më të gjera për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e provave, të listojë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e veçantë me ligj, duke u dhënë këtë mundësi palëve e duke çliruar gjykatën nga detyrimi për të kryer veprime hetimore kryesisht. Ligji duhet të parashikojë në mënyrë të veçantë të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen e vlerësimit të provave, të përcaktojë disa kriterë vlerësues të indicieve, elementët faktikë, provat rrethore e ato të marra pa kontradiktoritet. Standardi i provës në këtë rast është më i ulët, parimet e vlerësimit të indicieve si provë në procesin penal u nënshtrohen rregullave të të vlerësuarit kushtëzuar nga plotësimi i elementëve kumulativë rëndësi, saktësi, përputhshmëri ndërsa në procedimin parandalues *indicia* marr vlerë dhe si e vetme prandaj një përkufizim i ngjashëm me atë që ka dhënë Akti Normativ nr. 1/20 për elementët e faktit do e bënte më të lehtë punën e gjyqtarëve në vlerësimin e vlerës së tyre gjatë procesit të konfiskimit.

Konkluzione mbi barrën e provës, kontradiktoritetin dhe mbrojtjen e të tretit

78. Devijimi i barrës së provës në lidhje me justifikimin e origjinës së ligjshme të të ardhurës dhe pasurisë nga shteti tek subjekti pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet është një nga tiparet e veçanta të konfiskimit si masë parandaluese pasuror, kjo duke zbatuar një procedurë kontradiktore gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim, në kushtet e barazisë së armëve mes prokurorisë që kërkon konfiskimin dhe subjektit që duhet të justifikojë pasurinë e ligjshme të tij. Barra qëndron mbi personin pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet, që të provojë origjinën e ligjshme të pasurisë në mënyrë rigoroze pa patur

mundësinë që të pretendojë se pasuria vjen nga të ardhurat të cilat janë deklaruar të paverifikueshme.

79. Prokurori ka barrën e provës për të vërtetuar në gjykatë se një person në hetim, ose i dënuar përmbush kushtet për t'u cilësuar si "*person i dyshuar*" për kryerjen e veprave penale të parashikuara në fushën e veprimit të ligjit. Prokurori ka detyrime për të parashtruar kërtime të motivuara dhe prova mbështetëse përpara gjykatës, lidhur me identifikimin e pasurive të personit të dyshuar e të personave të tjerë, të tregojë nga ana e tij se ka bazë për dyshime të arsyeshme dhe të dhëna, prova të mjaftueshme për efekte të gjykimit parandalues.
80. Instrumente procedurale për këtë ndryshojnë sipas procedurës, barra e provës për palën është një element tipik i së drejtës procedurale civile, ndërsa në rastin e procedurës së konfiskimit sipas ligjit shqiptar zbatohet procedura penale. Personi/i afërmi/bashkëpunëtori pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet të ketë mundësinë të përdorë instrumenta ligjorë të ligjit dhe të legjislacionit procedural për të paraqitur prova, kërkuar kqyrjen e ekspertimeve, thirrjen e dëshmitarëve, marrjen e provave, akteve shkresore në institucione bankare e të regjistrimit të pasurisë në mënyrë që të vërtetojë e provojë të ardhurat e ligjshme.
81. Praktika gjyqësore nuk ka qenë uniforme për mënyrën se si do të trajtohen kërkesat për marrjen si provë të ekspertimeve kontabël të kryera nga subjektet jashtë procedimit pasuror, konsulentët teknikë e financiarë, thirrja e personave të tretë, kontratat noteriale mbi huatë ose detyrimet kur ato nuk kanë gjurmë në kanalet bankare e nga cilat kritere duhet të niset gjykata për të vlerësuar vlerën provuese të tyre.
82. Ligji duhet të zgjidhë çështjen e mbrojtjes së interesit pasuror të të tretëve në raport me detyrimin për përmbushjen e barrës së provës, garancitë që ofron ligji për mbrojtjen e kreditorëve, huadhënësve apo familjarëve e të afërmëve që kanë kontribuar në krijimin e pasurisë që kërkohet të konfiskohet. Origjina e ligjshme nuk mund të provohet pa paraqitur dokumente të rëndësishme ose vetëm në prani të elementëve të tjera "*të momentit*" të bazuara në faktin që shumica e ekonomisë shqiptare është informale. Personat e afërm të subjektit të ligjit kanë barrën e provës për të provuar që pasuritë e sekuestruara janë pronë e tyre ekskluzive dhe nuk janë në pronësi të subjektit të ligjit, pra persona e të dënuar apo të dyshuar për kryerje të një veprë penale. Personat fizikë ose juridikë që kanë lidhje biznesi ose bashkëpronësie me subjektet e ligjit kanë barrën e provës për të treguar që elementët

e nxjerrë gjatë procedimit nuk janë të dhëna të mjaftueshme që veprimtaria ose pasuritë e tyre janë poseduar pjesërisht ose tërësisht, në mënyrë indirekte ose janë përdorur në kryerjen e veprimtarive të paligjshme nga subjektet e ligjit.

83. Që të bëhet një konfiskim mjafton të kemi disproporcion midis disponueshmërisë dhe të ardhurave të raportuara nga propozimi ose të dhëna të përshtatshme për të lejuar që në mënyrë të arsyeshme të konkludohet se pasuritë për të cilat kërkohet konfiskimi përbëjnë ripërdorimin e të ardhurave të veprimtarive të paligjshme dhe që propozuesi nuk ishte në gjendje ta provonte origjinën legjitime të parave të përdorura për blerjen e këtyre aseteve.
84. Justifikimi i pasurisë së ligjshme si barrë provuese për subjektet e ligjit/të afërmit/bashkëpunëtorët dhe personat e tretë kërkon që ata të paraqesin fakte/ prova të pakundërshtueshme të cilat sigurohen në mënyra të ndryshme në rrugë zyrtare e në formën e kërkuar nga ligji. Provat mund të kërkojnë në elementët e përcaktuar të ligjit e në institutet e provave që parashikon Kodi i Procedurës Penale. Për përmbushjen e barrës së provës të vendosur për personin e prekur mjafton vetëm pretendimi i fakteve, situatë ose ngjarje, aty ku janë të verifikueshme, janë të mjaftueshme të përshtatshme, në mënyrë të arsyeshme dhe të besueshme për të treguar origjinën e ligjshme të aktivitetit
85. Duke analizuar parashikimet e veçanta të ligjit dhe ato referuese në Kodin e Procedurës Penale për provat dhe vlerësimin e tyre, mund të krijohet një *indeks* të provave që mund të paraqesë subjekti i ligjit në funksion të përmbushjes së barrës së provës e të justifikimit të pasurisë së ligjshme të tij.
86. Titullari i së drejtave reale e atyre të pronësisë, subjekti i ligjit mund të marrë vetë të dhëna, akte, prova shkresore e t'i paraqesë në gjykatë si titujt e pronësisë së pasurive të luajtshme e të paluajtshme që merren në regjistrat e pasurive ose të titujve të pronësisë pranë Agjensia Shtetërore e Kadastrës sipas legjislacionit për tokën e kthimin e pronës për përfitimin e titujve të pasurisë së paluajtshme sipas legjislacionit për tokën bujqësore, pyjet, kullotat dhe kthimin e pronës truall; për automjetet në pronësi a përdorim; të dhëna, akte mbi transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve etj. mund të merren nga bankat e institucionet e tjera financiare, si të tilla ata lënë gjithmonë gjurmë; të dhënat e provat për pagesën e tatimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me legjislacionin fiskal ku përfshihen, përmbushjen e detyrimit për

deklarimin e pasurisë për subjektet si funksionarë publik, gjyqtarë e prokurorë që detyrohen të bëjnë deklarim periodik vjetor për pasurinë dhe konfliktin e interesit sipas legjislacionit në fuqi ; të dhënat mbi veprimtarinë ekonomike, tregtare dhe profesionale dhe burimi i të ardhurave të tyre, ku përfshihen verifikimet mbi llojin e aktivitetit tregtar ose profesional, i regjistruar ose jo në Qendër Kombëtare të Regjistrimit Tregtar, në emër të subjektit, në ortakëri me të tjerë ose aksionerë , kapitali themeltar, burimi, pagesat e tatimeve, bilancet, shpërndarjen e të ardhurave, shpenzimet, llogaritë rrjedhëse e transfertat, investimet, të dhënat që subjektet janë zotërues të lejeve për transport, shërbime, shfrytëzim mineral, pyjor, peshkim, e në veçanti atyre të ndërtimit, autorizimeve, konçensioneve, liçensave e çdo të drejtë tjetër për të ushtruar ushtruar ekonomik, kontributet që subjekti ka përfituar, financime, kreditime të çdo lloji, të dhëna të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare.

87. Ekspertimi kontabël/financiar/auditues dhe ai vlerësimit të pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme është lloji e provës më i përdorshëm për përmbushjen e barrës së provës për subjektet që u jep mundësi subjekteve për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme, në përputhje me legjislacionin e tatim - taksave e përlllogaritur ato sipas metodave të sakta matematikore e ligjore.
88. Të ardhurat e padeklaruara në organet tatimore, si rregull nuk mund të shërbejnë si provë për të justifikuar pasurinë. Huatë, duhet të vlerësohen në raport me dëshmitë. dëshmitë, ekspertimet financiare dhe kontabël dhe rrethanat e kohës në të cilën ato janë dhënë.
89. Ligji mbron interesat e të tretëve të cilët gjenden të lidhur me subjektin, por që janë në mirëbesim, duke parashikuar edhe pasoja por duhet theksuar më shumë mbrojtja e interesave të të tretit më mirëbesim, si një e drejtë e garantuar nga një normë konvencionale, si një parim i cili zbatohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe kriteret mbi bazën e të cilave mund të përcaktohet nëse i treti është në mirëbesim apo të provuarit e të qënurit në keqbesim.
90. Çështje delikate në rastin e zbatimit të ligjit shqiptar është ajo e raportit të kreditorëve me pasurinë e cila është vënë nën sekuestro e kërkohet të konfiskohet në mënyrë të veçantë e bankave që kanë dhënë kredi dhe janë titullare të hipotekës mbi pasurinë e paluajtshme të sekuestrua, kreditori ndaj ndërmarrjes së sekuestruar, etj. Në praktikën gjyqsore ka patur interpretime të ndryshme për pozitën procedurale të personave të tretë, veçanërisht i

kreditorëve dhe bankave, në lidhje me legjitimitimin e tyre para gjykatës në mbrojtje të të drejtave reale të garancisë mbi pronat e vëna kolateral e për të cilat kërkohet konfiskimi.

91. Gjyqtarët duhet që në interpretimin e ligjit të përfshijnë në kategorinë e personave të tretë blerësit në mirëbesim, huadhënësit e bankat në veçanti si kreditorë, pozita e bankave si persona të tretë u duhet grantuar mbrojtja. Gjyqtarët në interpretimin e ligjit duhet të kenë parasysh parimet e së drejtës materiale civile për pronën, huanë, kredinë, garancitë pasurore etj. Është e nevojshme qartësimi i konceptit të pronës në interpretimet e gjyqtarëve në idenë nëse si pronë do të quhen dhe të drejtat reale mbi të si ipoteka, enfiteoza, uzufrukti dhe nëse për koncepti pronë lidhet detyrimisht me titullarin e së drejtës së pronësisë apo me gjendjen faktike të pronësisë.
92. Gjykatat, në vendimarrjen e tyre e kanë kufizuar rrethin e personave të cilët mund të ngrenë pretendime si personat e afërt, por ndërkohë ligji nuk kufizon gjykatën që në bazë të një dyshimi të arsyeshëm të sekuestrojë çdo pronë ku personi i dyshuar që ushtron veprimtari kriminale mund të ketë fshehur apo transferuar pasurinë e tij e gjatë fazës së konfiskimit personave të tretë që kanë të drejta reale mbi pronën e që duhet tu njihet e drejta e ankimit. Koncepti i pronësisë, apo se kujt i përket pasuria është një koncept i së drejtës civile. Ndërkohë që legjislacioni civil nuk njeh të drejtën e përkatësisë mbi një objekt, por të drejtën e pronësisë dhe të drejtën reale mbi të. Ligji duhet të interpretohet në favor të të drejtave të subjekteve personave fizike që kanë të drejta reale mbi pronën në veçanti bankat si subjekte kreditore që parimisht janë në një marrëdhënie mirëbesimi me klientët.
93. Ligji nuk mund të lërë pa mbrojtje kreditorët, bankat, si persona të tretë në mirëbesim që kanë kredituar qytetarët për të blerë a zhvilluar pronat, investimet e që gëzojnë të drejtën e hipotekës mbi pasuritë që kërkohen të konfiskohen. E drejta reale e garancisë i jep bankës të drejtën për të qenë palë në procesin e konfiskimit të pasurive të cilat janë vënë si kolateral pikërisht sepse ky proces mund të sjellë si pasojë kalimin përfundimisht të pasurisë në favor të shtetit prandaj dhe mbrojtja duhet lejuar në këtë fazë. Banka ka të drejtë të mbrohet dhe të paraqitet në gjykatë gjatë fazës së konfiskimit bazuar në të drejtën e saj të hipotekës mbi pasurinë objekt i masës së sekuestros për të cilën është kërkuar konfiskimi. Referimi në rregullat e procedurës penale dhe natyra penale e ligjit nuk pengon gjykatën në interpretimin e ligjit në këtë rast në favor të garantimit të së drejtës së mbrojtjes të së drejtës reale të pronësisë, të drejtave që duhet interpretuar në përputhje me parashikimet e së

drejtës civile, bankare e tregtare. Për atë kohë sa ekziston e drejta reale e garancisë dhe shteti ngarkohet në çdo rast për zhdëmtim atëherë poseduesit të së drejtës reale duhet t'i jepet mundësia që të paraqitet në gjykimin e kërkesës për konfiskim të pasurisë për tu shqyrtuar mundësia nëse mund të vendosë konfiskim ndaj një pasurie e cila është dhënë si garanci për përmbushje të detyrimit të kontraktimit të kredisë. Në këtë rast gjatë fazës së konfiskimit e drejta për të marrë pjesë në proces duhet të garantohet.

94. Është e nevojshme ndërhyrja në ligj për të përcaktuar së pari kush hyn në kategorinë e personave të tretë, vetëm ata që kanë titull pronësie apo dhe personat që gëzojnë të drejta reale mbi pronën si dhe për të parashikuar të drejtën ankimit të personave të tretë, dhe disa parime të vlerësimit e mundësive të tjera mbrojtje të të tretëve në mirëbesim në marrëdhënie kreditimi apo biznesi me subjekte të ligjit. Në mënyrë të veçantë në ligjin tonë duhet të gjejmë parashikim parimet mbi të cilat duhet të bazohet mbrojtja të tretit në mirëbesim dhe kriteret e dallimit në mes të të vepruarit të të tretit në keqbesim e atij në mirëbesim.
95. E drejta procedurale civile ka përparësi përse i përket llojeve të larmishme të provës dhe të barrës së provës për palët në procedurën civile si një traditë e së drejtës procedurale civile, ligji ynë është bazuar në modele ligjore që referojnë tek procedurën civile e në insitutet e saj siç është ai anglez e italian. Ligji ynë dhe referimi në rregullat e procedurës penale nuk u jep të gjitha mundësitë procedurale subjekteve, të tretëve për mbrojtje për shkak të devijimit të barrës së provës. Ligji nuk rregullon në mënyrë të shprehur interesat e të tretëve e sidomos të kreditorëve, të drejtën e aksesit në gjykim, atë të ankimit, të ndërhyrjes në proces, e mundësinë e mbrojtjes së të drejtave reale të pronësisë apo përkatësisë mbi pronën. Referimi në procedurën penale nuk siguron instrumentet e nevojshme procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror të shtetasve, mbrojtjen e së drejtës paurore e siguron më mirë procedura civile. Referimi në procedurën penale e bën ligjin më efektiv e i jep mundësi Prokurorisë të përdorë provat e procedimit penal. Por procedimi penal është i lidhur me pozitën penale të personit e nuk mund të injorohet raporti me përfundimin e procedimit penal.
96. Vlerësimi i provave të paraqitura nga subjekti, të afërmit, persona të tretë në funksion të barrës së provës duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme bazuar në rregullat e ligjit, në përputhje me objektin e të provuarit të përcaktuar në ligj si dhe në përputhje me parimet e

vlerësimit të procedurës penale por rregullimet e ligjit dhe përcaktimet e tij për kriteret kanë përparësi dhe do të zbatohen të parat sipas parimit *lex specialis derogat legi generali*. Rregullimet e përcaktimit të ligjit në këtë rast nuk janë të shumta ndryshe nga ligjet e tjera analoge. Megjithatë, në përmbajtje të ligjit ne gjejmë disa kritere të vlerësimit të barrës së provës nga subjekti dhe personat e tretë të cilat mund të zhvillohen më tej në përmjet interpretimit të zgjeruar e më tej me disa shtesa rregullimesh më përshkruese.

97. Ligji nuk kufizon mundësinë për të paraqitur prova pasi përcakton vetëm se barra e provës për të provuar se veprimtaritë dhe pasuritë e sekuestruara të zotëruara pjesërisht ose plotësisht prej tyre janë fituar në burime të ligshme u përket subjekteve të ligjit. Të afërmeve dhe bashkëpunëtorëve u përket barra për të provuar se pasuritë për të cilat kërkohet konfiskimi zotërohen me titull pronësie vetëm prej tyre e janë fituar në mënyrë të ligshme e nuk janë në pronësi të tërthortë të personave subjekte të ligjit..
98. Kriteri i përbushjes së tre kushteve kumulative është një garanci për konfiksimin pasuror pasi ndërthur detyrimin e prokurorisë për vërtetuar pjesmarrjen e subjektit në veprimtari kriminale dhe zotërimin nga ana e tij të pasurisë me barrën e provës së subjektit për të vërtetuar origjinën e ligjshme të saj, duke ndërthurur me të gjitha mundësitë ligjore të instrumenteve procedurale të të provuarit sipas standardit të kërkuar në ligj.
99. Të provuarit e prejardhjes së ligjshme të pasurisë nga subjekti i ligjit apo përligjia e zotërimit të pasurisë e të ardhurës përpjestimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të deklaruara është një proces rigoroz e empirik i cili i nënshtrohet një vlerësimi të thellë e të gjithanshëm juridik, ekonomik, financiar e logjik. Prejardhja e ligjshmërisë së pronës apo përligjia e zotërimit të pasurisë e të ardhurës në përpjestim me nivelin e të ardhurave duhet bërë në përputhje me parimet e vlerësimit të provës të shjelluara më lart në një proces gjyqsor që i jep mundësinë subjektit të ligjit dhe të tretëve të paraqesin e të marrin, të mbledhin çdo të dhënë e provë në funksion të saj.
100. Një ligj me elementë të plotë rregullativë *sui generis* dhe për çështjet e provave e të të provuarit, mbi elementët e barrës së provës, të legjitimitetit të subjekteve personave të tretë për të konfirmuar standardet ndërkombëtare, duke përcaktuar dhe referimet përkatëse në zbatimin e legjislacionit procedural penal për njoftimet e zhvillimin e procesit civil për ekzekutimin e vendimit, si dhe me referime përkatëse në legjislacionin material

civil e ligjet e tjera të veçanta, do ishte një zgjidhje më e mirë duke krijuar një juridiksion të vecantë të masave parandaluese pasurore.

6.3. REKOMANDIME:

A. Rekomandime për përmirësim të legjislacionit.

A.1. Legjislacioni për masat pasurore parandaluese

1. Rishikimin e çështjeve themelore në legjislacionin tonë tonë për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sistemet e tjera krahasues ligjore duke riformuluar natyrën penale të ligjit në raport me autonominë nga procesi penal, parashikim të gjerë të veçantë të insituteteve në ligj, si dhe referimin vetëm në standardin e procesit penal duke patur parasysh disa nënëparime:
 - Sistemet ligjore të cilat nuk e lidhin konfiskimin me dënimin apo pozitën e personit në procedimin penal janë procedime civile, jo domosdoshmërisht penale por administrative në kuptimin e një lloji të vecantë të angazhimit shtetëror.
 - Procedura penale e lidh konfiskimin me pozitën penale të personit subjekt të ligjit detyrimisht
 - Konfiskimi i zgjeruar i adaptuar nga ne është karakteristikë për konfiskimin e lidhur me një vendim dërimi apo fajësie për një vepër të rëndë apo krim të organizuar.
 - Konfiskimi pa dënim, konfiskimi objektiv apo autonom është i natyrës së konfsikimit civil që rregullohet me rregullat e procedurës civile.
 - Barra e provës është karakteristikë për procedimi civil.
2. Ligji duhej të ketë përcaktime të posaçme dhe vetëm në mungesë të tyre të referohej tek dispozitat e tjera procedurale pasi referimi vetëm në rregullat aktuale procedurale penale të cilat gjithsesi i japin avantazh prokurorisë për të mbështetur një kërkesë për konfiskim mbi të dhëna e prova të marra në kuadër të procedimit penal por jo për një hetim pasuror të specializuar, proaktive e të fokusuar vetëm në hetime pasurore.
3. Rekomandohet ndërhyrje thelbësore në ligj duke shtuar të gjitha elementët e veçantë e të plotë rregullativë *sui generis* dhe për çështjet e provave e të të provuarit, që të ketë rregullime të tjera më të gjera për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e provave, të listojë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e vecantë me ligj, duke u dhënë këtë mundësi palëve e duke çliruar gjykatën nga detyrimi për të kryer veprime hetimore kryesisht.

4. Ligji duhet të parashikojë në mënyrë të veçantë të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen e vlerësimit të provave, të përcaktojë disa kriterë vlerësues të indicieve, elementët faktikë, provat rrethore e ato të marra pa kontradiktoritet, duke dhënë një përkufizim mbi indicien, elementët e faktit, provën rrethore dhe atë jotipike si dhe duke përcaktuar që në kushtet e një standardi më të ulët të kërkuar për provueshmërinë, këto marrin vlerë dhe si të vetme pa u kushtëzuar nga plotësimi i elementëve kumulativë rëndësi, saktësi, përputhshmëri me elementë të tjerë provues sic është karakteristikë e vlerësimit të indicies apo provës indirekte në procesin penal.
5. Të ketë rregullim e përcaktim të veçantë të elementëve të përcaktuar ligjorë të detyrimit për tu provuar në standardin përkatës pjesëmarrjen në veprimtari kriminale, posedimit të pasurisë apo regjistrimit të rremë e fiktiv, origjinën jo të ligjshme të pasurisë apo asaj të pajustificuar ligjërisht, nivelit të provueshmërisë për secilin fakt.
6. Të ndërhyhet në ligj duke parashikuar rregullime përkatëse në lidhje me procedurën se si veprohet gjatë hetimit pasuror nga ana e prokurorisë për të mbledhur të dhënat, provat mbi bazueshmërinë e kërkesës për sekuestrim e asaj për konfiskim duke patur të rregulluar specifikimisht një normativë të posaçme dedikuar hetimit dhe gjykimit pasuror.
7. Ligji duhet të ketë rregullime të tjera më të gjera për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e provave, të listojmë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e veçantë me ligj, duke u dhënë këtë mundësi palëve e duke çliruar gjykatën nga detyrimi për të kryer veprime hetimore kryesisht, të parashikojë në mënyrë të veçantë të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen e vlerësimit të provave, të përcaktojë disa kriterë vlerësues të indicieve, elementët faktikë, provat rrethore e ato të marra pa kontradiktoritet.
8. Ligji duhet të ketë rregullime të tjera më të gjera për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e provave, të listojë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e veçantë me ligj, duke u dhënë këtë mundësi palëve e duke çliruar gjykatën nga detyrimi për të kryer veprime hetimore kryesisht.
9. Një ligj me të gjitha elementët e vecantë rregullator me elementë të plotë rregullativë *sui generis* dhe për çështjet e provave e të të provuarit për shkak se standardi i provës i kërkuar është më i ulët se ai penal për rrjedhojë rregullimi mbi këtë standard provueshmërie duhet

të jetë shprehimisht në ligj e më tej për provat në kuptim të procedurës penale e mjetet e kërkimit të provës të referojë në rregullat procedurale penale.

10. Ligji duhet të ketë në përmbajtje të tij të drejta të përcaktuara në mënyrë të shprehur si atë të mbrojtjes, të drejtën për tu informuar pa vonesë për procedimin, atë për ndihmës ligjore falas, dhe të drejtat për të marrë e mbledhur prova gjatë fazës së hetimit pasuror, për të pyetur dëshmitarë e për tu njohur me to.
11. Ligji ynë duhet të rishohë çështjen e konfiskimit pa dënim.
12. Nëse ligji do kishte përcaktime eksplicite në lidhje me procedurën se si veprohet gjatë hetimit pasuror atëherë do të kishim një rregullim normativ të posaçëm dedikuar hetimit dhe gjykimit pasuror.
13. Ligji duhet të referojë në dispozita të përcaktuara qartë të Procedurës Penale në lidhje me insitutet e Procedurës Penale si mjetet e kërkimit të provës, provat dhe vlersimin e tyre si dhe në insitute të së drejtës civile në lidhje me *përfaqsimin, veprimet juridike, kontratat e konceptet e së drejtës së pronësisë* si dhe në ato konkrete të procedurës civile në lidhje me *ekzekutimin e vendimit dhe kundërshtitë gjatë kësaj faze*.
14. Duhet të ketë një dispozitë të përgjithshme në ligj për natyrën e masave parandaluese, standardin e kërkuar përveç objektit e qëllimit të tij.
15. Ligji duhet të japë përkufizime për *sekuestrimin, konfiskimin si masa pasurore parandaluese, pasurinë dhe të drejtat reale mbi të, të ardhurën, produktin e veprimtarisë ekonomike e tregtare në përgjithësi e në veçanti pasurinë e paligjshme, të ardhurën e paligjshme, produktin e paligjshëm, subjektin e ligjit, personin e tretë, hetimi pasuror, dyshimin e arsyeshëm të bazuar në indicie, indicien, elementët e faktit, provat rrethanore, ekspertimin financiar/kontabël e të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme, konsulencën teknike e aktin e ekspertimit privat, prova jotipike*.
16. Duhet të riformulohet neni 5 i ligjit “Marrëdhëniet me procedimin penal” si dhe neni 24, duke qartësuar konceptin e konfiskimit pa dënim sipas kuptimit që i është dhënë në nenin 24 të tij sipas të cilit konfiskimi i pasurisë mund të vendoset edhe ndaj personit kur akuza apo procedimi penal ndaj tij, pushohet apo deklarohet i pafajshëm me përjashtim të rasteve që neni 24 i ka marrë nga nga neni 388 i KPrP, por që neni 388 i KPrP ka dhe tre raste të tjera kur mund të jepet vendim pafajësie.

17. Një nen i ri duhet shtuar në ligj nën titullin “Standardi i provës”, i cili duhet të ndajë disa formulime që gjenden në nenet 3 (Fusha e zbatimit) një nen më vete që mund të vendoset në kreun e parë, pas nenit 5 të ligjit, duke përcaktuar *nënndarje të standardit të provës* që kërkohet për çdo objekt të të provuarit e duke bërë dallimin në mes *të situatave faktike* sipas propozimit më poshtë : “Standardet e provës që kërkohen në vërtetimin e fakteve janë :

- *dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova* për pjesëmarrjen në veprimtari kriminale që përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit.
- *prezumimin e simulimit të pronësisë së pasurisë* në rastin e rregjistrimit të rremë të pasurisë në emër të të afërmëve
- *të dhëna të mjaftueshme* se pasuritë ose veprimtaritë e subjekteve të ligjit zotërohen pjesërisht ose plotësisht dhe titulli i pronësisë ose posedimit vërtetohet saktë për shkak të rregjistrimit të pasurisë.
- *të dhëna të dobishme* të siguruara në mënyrë të ligjshme që krijojnë dyshim të arsyeshëm në rastin e zbatimit të prezumimit të rregjistrimit të rremë.
- *indicie të rëndësishme* për përfshirjen në veprimtari kriminale në rastin e veprimit të ligjit në kohë për pasuritë e vënë përpara hyrjes në fuqi të tij.
- *të dhëna të mjaftueshme* që pasuritë zotërohen nga subjektet e ligjit nxirren nga marrëdhënia mes të tyre me të afërmit por dhe nga të dhëna të dobishme të siguruara në mënyrë të ligjshme që krijojnë dyshim të arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.
- *dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie* që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri për kërkimin e sekuestrimit
- *dyshime të bazuara në indicie* për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, posedimi i pasurisë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi e kur nuk provohet prejardhja e ligjshme e pasurisë për vendosjen e konfikut.

18. Një nen tjetër duhet shtuar për të parashikuar se “Të dhënat e mjaftueshme nxirren:

- nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat subjekte të veprimit të ligjit, për shkak të marrëdhënies së veçantë me të dyshuarin e veprës, si marrëdhënia familjare, e punës e aktivitetit ekonomik e tregatar, varësia profesionale ose lidhja e gjakut, familjare e miqësore.

- nga fakti që personi fizik ose juridik ka pasuri ose të ardhura që nuk përputhen dukshëm me nivelin e të ardhurave, fitimeve ose veprimtarive të ligjshme të deklaruara dhe nuk justifikohen prej tyre.
 - mungesa e mjeteve financiare të palës së tretë për të blerë pasuritë, që përbën në veçanti një element të rëndësishëm të pronësisë fiktive, i shtohet marrëdhënies së veçantë ndërmjet të dyshuarit dhe personit që zotëron pasuritë e nga rrethana të tjera të dobishme “
19. Ligji duhet të përcaktojë rregulla për lejimin e kufizimit të disa të drejtave që tejkalojnë përmbajtjen e Konventës dhe rregullat e procedurat tipike procedurale p.sh mundësinë për të përdorur deklaratimet e mëparshme të dëshmitarëve (*deklaruesve*), të ashtuquajturat *leximet e lejueshme apo kundërshtimet e dëshmisë* si tejkallim i parimit të marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë.
 20. Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të prganizuar duhet të ketë elementë të tjerë rregullativë si norma procedurale që përbëjnë rregullim të veçantë për mënyrën e veprimit të prokurorisë gjatë verifikimeve e kryerjes së veprimeve hetimore të ngjashme me ato që përcakton ligji italian dhe ai anglez.
 21. Rekomandohet ndërhyrje thelbësore në ligj duke shtuar të gjitha elementët e veçantë rregullator me elementë të plotë *sui generis* dhe për çëshjet e provave e të të provuarit, që të ketë rregullime të tjera më të gjera për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e provave, të listojë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e veçantë me ligj, duke u dhënë këtë mundësi palëve e duke çliruar gjykatën nga detyrimi për të kryer veprime hetimore kryesisht.
 22. Ligji duhet të parashikojë në mënyrë të veçantë të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen e vlerësimit të provave, të përcaktojë disa kriterë vlerësues të indicieve, elementët faktikë, provat rrethore e ato të marra pa kontradiktoritet, duke dhënë një përkufizim mbi indicien, elementët e faktit, provën rrethore dhe atë jotipike si dhe duke përcaktuar që në kushtet e një standardi më të ulët të kërkuar për provueshmërinë, këto marrin vlerë dhe si të vetme pa u kushtëzuar nga plotësimi i elementëve kumulativë rëndësi, saktësi, përputhshmëri me elementë të tjerë provues sic është karakteristikë e vlerësimit të indicies apo provës indirekte në procesin penal.
 23. Të ketë rregullim e përcaktim të veçantë të elementëve ligjorë të detyrimit për tu provuar në standardin përkatës pjesmarrjen në veprimtari kriminale, posedimit të pasurisë apo

rregjistrimit të rremë e fiktiv, origjinën jo të ligjshme të pasurisë apo asaj të pajustificuar ligjërisht, nivelit të provueshmërisë për secilin fakt.

24. Të ndërhyhet në ligj duke parashikuar rregullime përkatëse në lidhje me procedurën se si veprohet gjatë hetimit pasuror nga ana e prokurorisë për të mbledhur të dhënat, provat mbi bazueshmërinë e kërkesë për sekuestrim e asaj për konfiskim duke patur të rregulluar specifikimisht një normativë të posaçme dedikuar hetimit dhe gjykimit pasuror.
25. Është e nevojshme që ligji të përcaktojë veprimet hetimore pasurore konkrete dhe provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese në rregullimin e vecantë me ligj, si dhe të gjitha instrumentete e nevojshme në marrjen e vlerësimit të provave, duke bërë përkufizimin e *indicies, elementëve të faktik, provat rrethanore, provës dokumentare, asaj që merret nga procedimi penal e rregulla të tjera të marrjes së provës në kontradiktoritet*
26. Të ndryshohet tërësisht neni 6 duke u ndarë në tre nene të tjera duke parashikuar në mënyrë të hollësishme veprimet hetimore procedurale që bën policia gjyqsore apo Byroja Kombëtare e Hetimit duke listuar një sërë veprimesh konkrete hetimore si më poshtë :
- “Policia gjyqsore dhe prokuroria gjatë hetimit pasuror dhe në mbështetje të kërkesës për konfiskim pasurie marrin :
- fashikullin e procedimit penal nëse kemi një procedim penal të filluar para ose pas rregjistrimit të procedimit pasuror ose vetëm akte të veçanta të procedimit penal;
 - vendimi gjyqësor i dënimit nëse kemi një proces gjyqësor ndaj subjektit i cili ka përfunduar me një vendim fajësie apo pushimi të çështjes në ngarkim të subjektit;
 - procesverbalet e sekuestrimit, kontrollit, kqyrjes, arrestimit në flagrancë.
 - procesverbalet e sekuestrimit e të marrjes së dokumenteve të pronësisë, kqyrjes së rregjistrave të pasurisë, titujve të pronësisë, akteve të gjendjes civile;
 - aktet e ekspertimit kontabël, financiar e të vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
 - provat materiale;
 - dokumentet dhe rregjistrimet teknike;
 - procesverbale ose thënie të dëshmitarëve.
 - akte e prova të tjera të mbledhurar në mënyrë të ligjshme në funksion të objektit të të provuarit
27. Ligji duhet të ketë rregullime të tjera më të gjera për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e provave, të listojmë provat që përdoren në hetimet e gjykimet parandaluese

në rregullimin e vecantë me ligj, duke u dhënë këtë mundësi palëve e duke çliruar gjykatën nga detyrimi për të kryer veprime hetimore kryesisht.

28. Të riformulohet dhe neni 8 i ligjit (*Veprimet paraprake*) duke përcaktuar tërësinë e veprimeve paraprake hetimore që duhet të bëjë policia gjyqore dhe Byroja Kombëtare e Hetimit sipas modelit të ligjit anglez por e vënë në realitetin ligjor shqiptar si më poshtë :
“Veprimet hetimore të prokurorisë të kryera vetë ose nëpërmjet policisë gjyqore bëhen në lidhje me:

- verifikimet e pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme duke marrë të dhëna në regjistrat e pasurive apo të titujve të pronësisë pranë regjistratit të pasurive të paluajtshme pranë Agjensisë së Kadastrës.
- hetime mbi mjetet financiare ku futen të gjitha instrumentet me të cilat një person operon në sistemin financiar si: *transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* duke marrë të dhënat përkatëse pranë bankave dhe institucioneve bankare.
- hetime mbi veprimtarinë ekonomike, tregtare dhe profesionale dhe burimin e të ardhurave të tyre, ku përfshihen verifikimet mbi llojin e aktivitetit tregtar ose profesional, i regjistruar ose jo në Qendër Kombëtare të Regjistratit Tregtar, në emër të subjektit, në ortakëri me të tjerë apo aksioner, kapitali themeltar, burimi, pagesat e tatimeve, bilancet, shpërndarjen e të ardhurave, shpenzimet, llogaritë rrjedhëse e transfertat, investimet.
- verifikime të veçanta për subjektet që janë zotërues të lejeve për transport, shërbime, shfrytëzim mineral, pyjor, peshkim, e në veçanti atyre të ndërtimit, autorizimeve, koncesioneve, licensave e çdo të drejtë tjetër për të ushtruar ushtruar aktivitet ekonomik.
- verifikohen për kontributet nëse janë përfituar, financime, kreditime të çdo lloji, të dhëna të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare.
- verifikohet e kryhen hetime nëse ekzistojnë në momentin e regjistrimit të procedimit pasuror këto pasuri, veprimtari, të drejta pasurore janë të ligjshme apo jo.
- kërkohet informacion pranë zyrave të administratës, bashkive, gjendjes civile, të regjistrimit të pasurive e të kadastrës, të tatimeveve, licensave, të shërbimeve periodike e të furnizimit me ujë, energji, sigurimeve shoqërore, bankave, shoqërive kursim kredi e atyre të

investimeve duke u kërkuar kopje të dokumentacionit të veprimeve të subjektit apo të afërmëve të tij.

- verifikime për për mënyrën e jetesës së personit, shpenzimet e përditshme etj.
- verifikime për të dhëna jashtë vendit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike të ndërsjellë.

Verifikime dhe informacionet të merren pranë zyrave përkatëse si:

- të dhënat për pasuritë e paluajtshme kërkojnë pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ose Agjensisë Shtetërore të Kadastrës ndërsa për pasuritë e luajtshme si automjetet pranë zyrave të Drejtorive të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- për llogaritë bankare, transfertat, pagesat, hetimet shtrihen në banka, institucionet e kreditimit e të investimeve.
- për pasuritë e shoqërive tregtare në regjistrin e shoqërive tregtare apo pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKB).
- për kuotat dhe aksionet verifikohen dhe hetohen publikimet në regjistrin e shoqërisë tregtare dhe shënimet në regjistrat kontabël të shoqërive.
- për *titujt e pronësisë së pasurive të luajtshme e të paluajtshme* merren në regjistrat e pasurive apo të titujve të pronësisë p.sh. Agjensia e Kadastrës sipas legjislacionit për tokën, kthimin e pronës për përfitimin e titujve të pasurisë së paluajtshme sipas legjislacionit për tokën bujqësore, pyjet, kullotat dhe kthimin e pronës truall.
- pranë institucioneve të regjistrimit të pasurive të luajtshme si automjetet.
- të dhëna e akte mbi *transfertat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* etj. mund të merren nga bankat e institucionet e tjera financiare, si të tilla ata lënë gjithmonë gjurmë
- të dhënat e prova për *pagesën e tatimeve* sipas legjislacionit fiskal ku përfshihen të dhëna e akte për zbatimin e procedurave tatimore e pagesën e tatimeve sipas ligjit tatimor
- për *pagesën e tatimeve mbi të ardhurat si biznes* apo ato që rrjedhin nga vlerësimi i pasurisë së paluajtshme apo transaksioneve mbi të,
- *pagesën e tatimeve mbi vlerën e shtuar* sipas legjislacionit mbi vlerën e shtuar
- *pagesën e taksave kombëtare* sipas legjislacionit për taksat kombëtare

- *pagesën e taksave lokale* sipas ligjit për taksat lokale
 - *pagesat e detyrimeve doganore* sipas legjislacionit doganor
 - përmbushjen e detyrimit për deklarimin e pasurisë për subjektet si funksionarë publikë, gjyqtarë e prokurorë që detyrohen të bëjnë *deklarim periodik vjetor për pasurinë dhe konfliktin e interesit e ligjit për deklarimin e pasurisë*.
29. Të ndryshohet paragrafi 1 nëniti 10 të ligjit në lidhje me kompetencat e gjykatës për të urdhëruar hetime të nevojshme për të zgjidhur çështjen dhe marrë masa të veçanta të përcaktuara me ligj të veçantë si një kompetencë invazive, të panevojshme e që nuk përputhet me rolin e gjykatës, duke e shfuqizuar këtë parashikim e duke e ndryshuar me rregullimin e marrëdhënies së gjyqtarit të procedurës së parandalimit me ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit e administrimin e pasurisë së paluajtshme apo aktivitetit ekonomik gjatë fazës së sekuestrimit të pasurisë duke përvijëzuar figurën procedurale të gjyqtarit të procedurës/masës parandaluese pasurore dhe kompetencat funksionale të tij në kontrollin e mirëadministrimit të pasurisë së sekuestruar.
30. Të shtohet një nen i veçantë që subjektet e ligjit, të afërmit, bashkëpunëtorët dhe personat e tretë mund të marrin informacionet e nevojshme për pasuritë e prezumuara të regjistruar fiktivisht në emër të tyre pranë institucione si më poshtë: “Familjari, i afërmi, bashkëpunëtori në veprimtari ekonomike, personi i tretë titullar i së drejtave reale të pronësisë i cili është në kushtet e mirëbesimit me subjektin mund të marrë vetë të dhëna, akte, prova shkresore e ti paraqesë në gjykatë duke kërkuar të dhëna e dokumente.
- pranë institucione të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të pasurisë e të luajtshme për titujt e pronësisë së pasurive të luajtshme e të paluajtshme
 - të dhëna e akte mbi *transferrat e parave, konvertimet në tregun valutor, kursimet, depozitat, kreditë, kolaterali pasuror, investimet financiare, investimet në bursë, blerja e kuotave në fondet e investimeve* etj. pranë bankave e institucionet e tjera financiare.
 - të dhënat e prova për *pagesën e tatimeve* sipas legjislacionit fiskal ku përfshihen të dhëna e akte për zbatimin e procedurave tatimore e pagesën e tatimeve sipas ligjit tatimor
 - të dhëna për *pagesën e tatimeve mbi të ardhurat si biznes* apo ato që rrjedhin nga vlerësimi i pasurisë së paluajtshme apo transaksioneve mbi të
 - për *pagesën e tatimeve mbi vlerën e shtuar* sipas legjislacionit mbi vlerën e shtuar
 - për *pagesën e taksave kombëtare* sipas legjislacionit për taksat kombëtare

- *për pagesën e taksave lokale* sipas ligjit për taksat lokale
 - *për pagesat e detyrimeve doganore* sipas legjislacionit doganor
 - për përmbushjen e detyrimit për deklarimin e pasurisë për subjektet si funksionarë publikë, gjyqtarë e prokurorë që detyrohen të bëjnë *deklarim periodik vjetor për pasurinë dhe konfliktin e interesit e ligjit për deklarimin e pasurisë*.
31. Ligji duhet të parashikojë në mënyrë të veçantë të gjitha instrumentet e nevojshme në marrjen e vlerësimit e provave, të përcaktojë disa kritere vlerësuese të indicieve, elementët faktikë, provat rrethore e ato të marra pa kontradiktoritet.
 32. Në mënyrë të veçantë në ligjin tonë duhet të gjejnë parashikim parimet mbi të cilat duhet të bazohet mbrojtja të tretit në mirëbesim dhe kriteret e dallimit në mes të të vepruarit të tretit në keqbesim e atij në mirëbesim.
 33. Mbrojtja e interesit pasuror të të tretëve në raport me detyrimin për përmbushjen e barrës së provës, garancitë që ofron ligji për mbrojtjen e kreditorëve, huadhënësve apo familjarëve e të afërmeve që kanë kontribuar në krijimin e pasurisë që kërkohet të konfiskohet
 34. Duhet ndërhyrja në ligj dhe një shtesë në një nen pas nenit 12/a dhe 22 për të përcaktuar kush hyn në kategorinë e personave të tretë, vetëm ata që kanë titull pronësie apo dhe personat që gëzojnë të drejta reale mbi pronën, për të parashikuar të drejtën ankimit të personave të tretë, e disa parime të vlerësimit e mundësive të tjera mbrojtje të të tretëve në mirëbesim në marrëdhënie kreditimi apo biznesi me subjekte të ligjit.
 35. Të riformulohet parashikimi mbi të ardhurat për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore që nuk mund të shërbejnë si provë e vërtetimit të të ardhurës së ligjshme.
 36. Të parashikohet që huatë në para jashtë sistemit bankar nuk mund të vlerësohen si provë nga gjykata për vërtetimin e fakteve mbi prejardhjen e ligjshme të pasurisë.
 37. Në Kreun IV, të referohet në normat përkatëse materiale civile ku mund të gjejnë kuptim koncepti i pronësisë, posedimit faktik si dhe të veprimit juridik, përfaqsimi, trashëgimisë, huasë, kredisë, garancisë, kolateralit, hipotekës, enfiteozës e çdo insitut tjetër të së drejtës civile, familjare, trashëgimisë, tregtare, financiare, administrative etj. duke adaptuar frymën legjislative të legjislacionit normues referues.
 38. Saktësimin në ligj të parimit të autonomisë së procedimit pasuror duke riformuluar nenin 24 të tij “Pranimi i kërkesës për konfiskim” duke shtuar që konfiskimi mund të vendoset edhe ndaj pasurisë së trashëgimtarëve të një pesroni që ka ndërruar jetë ë e që dyshohet

duke rikonfirmuar dhe në fazën e konfiskimit atë që është thënë në nenin 3 “Fusha e Zbatimit” si dhe duke pranuar rastin e pafajësisë së personit juridik dhe rastin kur vendimi i pafajësisë për personin fizik jepet për arsye se konfiskimi pasurisë mund të bëhet edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit pushohet ose ai deklarohet i pafajshëm me përjashtim të rastit kur fakti nuk ekziston, nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose del që i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale.

39. Të parashikohet specifikisht në një nen të veçantë se në rastin kur rezulton se personi i dyshuar zotëron një numër pasurish, dhe justifikohet një pjesë e saj, masa parandaluese pasurore nuk vendoset vetvetiu mbi të gjitha pasuritë e tij, por çmohet e vendoset dhe vetëm për ato që, nga gjykimi, rezulton se nuk u justifikohet origjina, prejardhja e ligjshme ose vetëm për atë pjesë që nuk vërtetohet prejardhje e ligjshme.
40. Ligji të ketë përcaktime përkatëse në lidhje me procedurën se si veprohet gjatë hetimit pasuror, duke krijuar një normativë të posaçme dedikuar hetimit dhe gjykimit pasuror. Përdorimi i të dhënave që vijnë nga procedimi penal si përgjimet në një procedurë tjetër në kuadër të procedimit pasuror duhet të parashikohet me ligj se ndryshe mund të përbëjnë shkelje të së drejtës private për personat për të cilët akuza është pushuar apo kanë marrë vendim pafajësie.
41. Duhet ndërhyrja në ligj për të përcaktuar së pari kush hyn në kategorinë e personave të tretë, vetëm ata që kanë titull pronësie apo dhe personat që gëzojnë të drejta reale mbi pronën si dhe për të parashikuar të drejtën ankimit të personave të tretë, dhe disa parime të vlerësimit e mundësive të tjera mbrojtje të të tretëve në mirëbesim në marrëdhënie kreditimi apo biznesi me subjekte të ligjit. Në mënyrë të veçantë në ligjin tonë duhet të gjejmë parashikim parimet mbi të cilat duhet të bazohet mbrojtja të tretit në mirëbesim dhe kriteret e dallimit në mes të të vepruarit të të tretit në keqbesim e atij në mirëbesim.
42. Nevoja e ndërhyrjes në ligj për të parashikuar të drejtën ankimit të personave të tretë.
43. Një shtesë në ligj duke specifikuar të drejtat e kreditorëve të palëve të treta para sekuestrimit.
44. Të drejtën për të ndërhyrë në procesin e konfiskimit dhe personat fizikë dhe juridike që kanë të drejta reale mbi pronën.
45. Ligji duhet të parashikojë mbrojtje për bankat, si persona të tretë në mirëbesim që kanë kredituar qytetarët për të blerë a zhvilluar pronat, investimet e që gëzojnë të drejtën e

hipotekës mbi pasuritë që kërkohen të konfiskohen dhe mbrojtja duhet lejuar në këtë fazë, duke evidentuar dallimin që në ndryshim nga seanca e vendosjes së masës së sekuestros gjatë konfiskimit personat e tretë thirren, banka të ketë të drejtë të mbrohet dhe të paraqitet në gjykatë gjatë fazës së konfiskimit bazuar në të drejtën e saj të hipotekës mbi pasurinë objekt i masës së sekuestros për të cilën është kërkuar konfiskimi. Referimi në rregullat e procedurës penale dhe natyra penale e ligjit nuk duhet të pengojë gjykatat pe në interpretimin e ligjit në këtë rast në favor të garantimit e mbrojtjes të së drejtës reale të pronësisë, të drejtave që duhet interpretuar në përputhje me parashikimet e së drejtës civile, bankare e tregtare. Për aq kohë sa ekziston e drejta reale e garancisë dhe shteti ngarkohet në çdo rast për zhdëmtim atëherë poseduesit të së drejtës reale duhet t'i jepet mundësia që të paraqitet në gjykimin e kërkesës për konfiskim të pasurisë për tu shqyrtuar mundësia nëse mund të vendosë konfiskim ndaj një pasurie e cila është dhënë si garanaci për përmbushje të detyrimit të kontraktimit të kredisë. Në këtë rast gjatë fazës së konfiskimit e drejta për të marrë pjesë në proces duhet të garantohet.

A.2. Përmirësim i legjislacionit penal material

46. Kodi Penal të parashikojë penalizimin e veprimit të simulimit të blerjes së pronës apo tjetërimit të saj kur ka filluar procedimi parandalues pasuror ose është vendosur sekuestrimi i pasurisë e personi është në dijeni.
47. Të parashikohet një vepër penale për personin, subjektin e posaçë m, zyratrin apo punonjësin e administratës që kryen veprime juridike të kalimit të pronësisë apo tjetërimit në rast se është në dijeni të faktit se ndaj kësaj pasurie janë vendosur masa preventive pasurore.

A.3. Përmirësim i legjislacionit procedural penal

48. Rekomandohet që Kodi i Procedurës Penale të bëjë disa përmirësime duke patur parasysh që është tashmë një korpus ligjor i cili shërben edhe për hetimin e pasuror e që rregullimet procedurale penale të cilat gjithsesi i japin avantazh prokurorisë për të mbështetur një kërkesë për konfiskim mbi të dhëna dhe provat e marra në kuadër të procedimit penal, por jo për një hetim pasuror të specializuar, proaktiv e të fokusuar vetëm në hetime pasurore.

49. Si ndërhyrje të tilla në Kodin e Procedurës Penale duhet të jenë;

- Tek llojet e provave si të tilla provat të shtohen si nënloje të tyre dokumenti privat dhe ai zyrtar.
- Të shtohen rregullime tek ekspertimet duke patur parasysh natyrën e ekspertimeve komplekse në hetimin pasuror si *ekspertimet kontabël financiar e të vlerësimit mbi pasuritë e paluajtshme*.
- Të parashikohet si provë *konsulenti teknik privat*.
- Të shtohen prova të tjera atipike si *rregjistrimet, filmimet private, ekspertimet private*.

A.4. Përmirësime në legjislacionet e tjera.

1. Rekomandoj që të bëhen shtesat përkatëse në ligjet e veçanta me qëllim që të parashikohet detyrimi i veprimit të organeve administrative për të bërë verifikime në çdo rast të kalimit të pronës, tjetërsimit apo përdorimit të saj si barrë hipoteke të marrin informacion nëse ndaj kësaj pasurie ka masa preventive pasurore.
2. Këto ndryshime të bëhen konkretisht në ligjet;
 - Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”
 - Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”
 - Ligji nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme “
 - Ligji 20/20 “Për përfundimin e procesit të rregjistrimit të pasurisë “
 - Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”
 - Ligjit nr. 112/2020 “Për rregjistrin e pronarëve përfitues “
 - Ligji nr. 9662/2007 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 131/2016.
 - Ligji nr. 9723 datë 3.5.2007 “Për qendrën Kombëtare të Rregjistrimit“ i ndryshuar me ligjin nr. 8/2015.
3. Të bëhen shtesat përkatëse në tërësinë e ligjeve mbi tatimet e të ardhurat dhe atyre mbi prokurimet duke parashikuar detyrimin e organeve të administratës fiskale e tatimore dhe atyre të zbatimit të procedurave të prokurimit për të verifikuar çdo përfitim në të ardhura apo rimbursim nëse ndaj subjekteve tregtare e ekonomike veprojnë masat e

parandalimit pasuror e konkretisht duke shtuar një përcaktim të tillë në ligjet si më poshtë si;

- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar si dhe ligjit nr. 112/2020 “Për rregjistrin e pronarëve përfitues
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar,
- Ligji nr. 9723 datë 3.5.2007 “Për rregjistrimin e biznesit” i ndryshuar.
- Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”
- Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar
- Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar
- Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar me ligjin nr. 32 datë 2.04.2015
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 99/20 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “.
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik“.

B. Rekomandime mbi nevojën për njehsim dhe ndryshim të praktikës gjyqsore.

1. Rekomandoj Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në përputhje me nenin 141 të Kushtetutës dhe nenin 438 të KPrP, të njehsojë praktikën gjyqsore në lidhje me raportin në mes të vendimit të fajësisë dhe vijimit të procedimit pasuror me kofiskim
2. Një vendim njësues tjetër mbi praktikën gjyqsore të interpretimit ligjor nga ana e gjykatave të standardit të provave për vërtetimin e fakteve mbi prezumimin fiktik të pasurisë dhe provat që duhet të kenë vlerë për vërtetimin e prejardhjes së ligjshme të pasurisë. *(mund të trajtohen disa nga provat si kontratat e huave, të ardhurat e padeklaruarat etj.)*
3. Një vendim njësues të praktikës gjyqsore në lidhje me zbatimin e nenit 22 të ligjit për thirrjen e personave të tretë, legjitimitetin e pozicionin e tyre procedural e në veçanti të cilësisë e mundësisë procedurale për të ndërhyrë në proces të personave të tretë si kreditorë dhe banka për të mbrojtur të drejtat reale të garancisë mbi pronën që kanë si kolateral për shkak të kreditimit.

4. Një vendim njësoes në lidhje me praktikën e ndryshme të apelit mbi të drejtën e ankimit ndaj vendimit që nuk ka pranuar kërkesën revokimin apo shuarjen e masës së sekustrimit të pasurisë.
5. Nisjen e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqsore të unifikuar nga Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7/ 2011 mbi çështjet për të cilat ligji i ri nuk ka ndërhyrë në ndryshim të interpretimit që është bërë në vendimin unifikues.

C. Rekomandime për një kuptim dhe zbatim sa më të drejtë të ligjit

1. Çështjet e interpretimit gjyqësor mbi devijimin e barrës së provës për justifikimin e pasurisë së ligjshme tek zotëruesi i pasurisë, niveli më i ulët i kushteve të fillimit të procedimit dhe nevoja e balancimit të një sërë instrumentesh procedurale, mundësitë e mbledhjes e marrjes së provave e paraqitjes së provave, vlera e vlerësimi i tyre, vështirësitë, zbatimi i parimit të proporcionalitetit në kufizimin e së drejtës së pasurisë e detyrimi për të reflektuar frymën e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duhet të të vlerësohen me kujdes maksimal nga gjyqtarët.
2. Gjatë zbatimit të ligjit për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese profesionistët e zbatimit të tij duhet të kenë parasysh natyrën e tij dhe faktin se ky ligj është një rregullim i veçantë legjislativ, me parime e rregulla të ndryshme nga normat tradicionale.
3. Profesionistët e zbatimit të tij duhet të kenë parasysh natyrën e tij dhe faktin se ky ligj është një rregullim i veçantë ligjor *sui generis* e për këtë nevojitet studim i thelluar i njohurive juridike, standardit e normave ndërkombëtare e legjislacionit tonë të brendshëm material e procedural, penal e civil por dhe atij ekonomik e financiar.
4. Në interpretimin e koncepteve të pronësisë dhe personave të tretë, gjyqtarët nuk mund të lënë pa mbrojtje kreditorët, bankat, si persona të tretë në mirëbesim që kanë kredituar qytetarët për të blerë a zhvilluar pronat, investimet e që gëzojnë të drejtën e hipotekës mbi pasuritë që kërkohen të konfiskohen. E drejta reale e garancisë i jep bankës të drejtën për të qenë palë në procesin e konfiskimit të pasurive të cilat janë vënë si kolateral pikërisht sepse ky proces mund të sjellë si pasojë kalimin përfundimisht të pasurisë në favor të shtetit

prandaj dhe mbrojtja duhet lejuar në këtë fazë. Banka ka të drejtë të mbrohet dhe të paraqitet në gjykatë gjatë fazës së konfiskimit bazuar në të drejtën e saj të hipotekës mbi pasurinë objekt i masës së sekuestros për të cilën është kërkuar konfiskimi. Referimi në rregullat e procedurës penale dhe natyra penale e ligjit nuk pengon gjykatën në interpretimin e ligjit në këtë rast në favor të garantimit të së drejtës së mbrojtjes të së drejtës reale të pronësisë, të drejtave që duhet interpretuar në përputhje me parashikimet e së drejtës civile, bankare e tregtare. Në këtë rast gjatë fazës së konfiskimit e drejta për të marrë pjesë në proces duhet të interpretohet në favor të garantimit të pjesmarrjes.

D. Rekomandime për bashkëpunim dhe bashkërendim në mes të institucioneve

2. Gjatë zbatimit të ligjit për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese institucionet duhet të bashkëpunojnë ngushtë me qëllim të përbushjes së qëllimit të tij që është identifikimi i pasurive të personave ndaj të cilit vepron ligji, familjarëve të tyre dhe të tretëve për pasurinë e simuluar e të regjistruar në emër të tyre.
3. Ky bashkëpunim ka rëndësi të zhvillohet në mes të organeve të tilla të specilizuara të institucioneve të kontrollit të pasurisë e të konfliktit të interesit, atyre të parandalimit të pastrimit të parave dhe të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
4. Nevojitet që në nivelin e bashkëpunimit gjyqsor ndërkombëtar, vendi ynë të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtar bashkëpunimi me vendet anëtare të Bashkimit Europian dhe atyre të rajonit tonë sipas parashikimeve të Direktivën 2014/42 /BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 3 prill 2014 *“Për bllokimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit në Bashkimin Europian”*.
5. Nevojitet bashkëveprimi polici gjyqsor/hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit me organet e administratës, institucionet e vlerësimi të pasurive, të parandalimit të pastrimit të parave dhe të organeve të rivlerësimit.
6. Duhet bashkëpunim efektiv në mes të administratorit të pasurisë me prokurorinë dhe gjykatën për administrim sa më të mirë të pasurisë së sekuestruar.

E. Rekomandime për ndryshime strukturore të institucioneve dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të policisë gjyqsore, prokurorëve dhe gjyqtarëve

1. Është e nevojshme ngritja e strukturave të specilizuara të policisë gjyqsore dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit (SPAK) për hetimin financiar e pasuror paranadalues në çdo prokurori rrethi gjyqsor menjëherë pas përfundimit të hartës gjyqsore e risstrukturimit të prokurorive në rrethe si dhe krijimi i një seksioni të specializuar pranë Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK) për hetimin financiar e pasuror e zbatimin e masave parandaluese pasurore për veprat penale të krimit të organizuar, korrupsionit, si dhe atyre të kryera në detyrë nga subjektet e veçanta sipas nenit 75/ të KPrP.
2. Në kushtet e reja të zbatimit të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar është e domosdoshme që për oficerët e hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimeve, policisë gjyqsore, ekspertët, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe atyre të rretheve gjyqsore, gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme dhe atyre të gjykatave të rretheve gjyqsore është e nevojshme të hartohet një manual praktik në lidhje me disiplinën normative e didaktike të veprimeve hetimore të nevojshme, verifikimeve, akteve shkresore, mjeteve të kërkimit të provve, provave, indicieve e instrumenteve të tjera procedurale penale e civile në ndihmë të përmbushjes së barrës së provës.
3. Çështjet e interpretimit gjyqësor mbi devijimin e barrës së provës për justifikimin e pasurisë së ligjshme tek zotëruesi i pasurisë, niveli më i ulët i kushteve të fillimit të procedimit dhe nevoja e balancimit të një sërë instrumentesh procedurale, mundësitë e mbledhjes e marrjes së provave e paraqitjes së provave, vlera e vlerësimi i tyre, vështirësitë, zbatimi i parimit të proporcionalitetit në kufizimin e së drejtës së pasurisë e detyrimi për të reflektuar frymën e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duhet të jenë çështje në diskutim të gjithanshëm e të vazhdueshëm në bazë të një programi trajnimi të mirëfilltë vazhdues të oficerëve të policisë gjyqsore, prokurorëve, gjyqtarëve, avokatëve, administratorëve të pasurive të sekuestruara e juristëve në përgjithësi si dhe në programet e studimit të studentëve të së drejtës.

6.4. Bibliografia:

Libra dhe artikuj:

- Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray, Stolen Asset Recovery , Stolen Asset Recovery, A Good practices Guide for Non - Conviction Based asset Forfeiture, (STAR) Initiative 2009 The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank
- Antonio Balsamo, referim në seminarin me teme “Konfiskimi nëpërmjet ligjit antimafia”, organizuar nga PAMECA, 20.11.2017
- Michele-Laure Rassat, Manuel de procedure penale, Press Universitare de France, 2002
- Stefano Finocchiaro La confisca e il sequestro di prevenzioni, di Stefano Finocchiaro, Diritti Penale Contemporaneo.
- Balsamo Antonio (2014) Codice antimafia, Digesto delle discipline penalistiche, Agg. VIII, Torino, UTET
- M. Maugeri, Le moderne sanzioni patrimoniali tra funzionalità e garantismo, Milano, 2001, 122 ss.; AA. VV.,
- F. Mendido La giustizia patrimoniale penale, Torino, 2011, Le confische nella prevenzione e nel contrasto alla criminalità “da profitto” (*mafie, corruzione, evasione fiscale*), in questa Rivista, 2 febbraio 2015.
- Sequestri penali, misure di prevenzione e procedure concorsuali, Alalisi dei rapporti alla luce del nuovo codice antimafa, aggiornato al D.Lgs.n.54/2018 sulle incompatibilita e al D.Lgs.n.72/2018 in material di tutela del lavoro.
- Menditto Francesco (2019) Le misure di prevenzione e la confisca allargata (17 ottobre 2017, nr. 161 (Milano, Giufree) Cfr. Balsamo A, Contraffatto V., Nicastro G,
- Anna Maria Maugeri , Le misure patrimoniali contro la criminalita organizzaata, Giufree, Milano 2010. L'actio in remassurge a modello di “confisca Europea “ nel rispetto delle garanzie CEDU “Emendamenti della Commissione LIBE alla proposta di direttiva in materia di congelamento e confisca dei proventi del reato – Diritto penale contemporaneo
- J.C. Sharman, The Money Laundry, Regulating Criminal Finance in the Global Economy (Cornell Studies in Political Economy) Cornell university Press, I 1st (October 15, 2011)
- Vesel Latifi, Ismet Elezi, Vasilika Hysi, Politikat e luftimit të kriminalitetit, botim i Insitutit European për Studime Juridike dhe Administrim Publik “Juridica“ 2012, Fq. 122
- Sandër Simoni, Leksione të lëndës *Procedurë Penale*, temat “*Provat. Mjetet e provës*”, Shkolla e Magjistraturës, 2005 e në vijim.
- Codice de Procedura Penale, Edizione Simone 2005
- Francis Casorla. redigee avec le concours de Jean Pradel , Professeur a la Faculte de droit et de sciences sociales de Poitiers, Code de Procedure Penale, con loi du 15 juin 2000, 44 edition, edition 2016, Dalloz,
- Corinne Renault - Brahinsky, Code de Procedure Penale, 44 edition, 2004, Procedurë Penale, 6 edition

- Coredro F. Procedura Penale, VIII ed, Giufree, Milano, 2006.
- Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda Procedura Penale, komentar, 2003,.
- Michele- Laure Rassat Manuel de procedure penale, 1 edition 2003
- Micheli, GA, The burden of Proof, rest. Padua, 1966.
- Flutura Tafaj, Asim Vokshi, Procedurë Civile, Pjesa I, Botimi II, Fakulteti i Drejtësisë i UT, 2018
- R. Haig, “Koncepti i të ardhurave–aspektet ekonomike dhe ligjore” në Haig (red.), Bibliografi
- H. Simons, “Tatimi mbi të ardhurat personale”, 1938; Bibliografi:
- K. Holmes, “Koncepti i të ardhurave – një analizë shumëdisiplinore Bibliografi:
- A.Mangione Le misure di prevenzione personali e patrimoniali. La confisca allargata. Aspetti sostanziali e processuali, Milano 2019.
- L Paolo Ferrua, Fabio M. Grifantini, Giulio Illuminati, Renzo Orlandi, G.Giappichelli a prova nel dibattimento penale, quarta edizione, editore, Torino, 2007.
- Vincent Mermoz Les indies en procedurë penale,Universite Paris Saclay , 2019
- A cura di Vincenzo Giglio Codice,Delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione,
- Anna Maria Maugeri , L’actio in rem surge a modello di “confisca Europea “ nel rispetto delle garanzie CEDU “Emendamenti della Commissione LIBE alla proposta di direttiva in materia di congelamento e confisca dei proventi del reato.
- Stefano Finocchiaro Diritto penale contemporaneo“La confisca “civile“ dei proventi da reato misura di prevenzione e civil forfeiture:verso un modello di non conviction based confiscation Criminal justice Network - Progetto Giustizia Penale Lavoro concluso nel mese di luglio 2018, Milano.
- Impact, Study on Civil Forfeiture, project Criminal assets Recovery in Serbia, publisher Council of Europe, 2013
- The G8 Best Practice Principales on Tracing Freezing and Confiscation of assets (2004)

Legjislacion i huaj:

- Proceeds of Crime Act 2002
- Decreto legislative 6 settembre 2011, n.159 Codice delle leggi antimafia e delle misure di prevenzione , nonce nuove disposizione in material di documentazione antimafia, a norma degli articoli 1 e 2 della legge 13 agosto 2010, n. 136(G.U 28 settembre 2011, n. 226, testo aggiornato con la legge 17 ottobre 2017, n. 161)
- Dekreti Legjislativ 6 shtator 2011 n. 159, Kodi antimafia dhe masat parandaluese, (Gazeta Zyrtare e 28 shtator 2011 e Republikës së Italisë.
- Serious Organised Crime and Police Act 2005, the Serious Crime Act 2007 and the Serious Crime Act 2015
- Civil Asset Forfeiture Reform Act, 2000

Legjislacion shqiptar:

- Kodi Penal i RSH
- Kodi Procedurës Penale i RSH
- Kodi i Procedurës Civile RSH
- Ligji “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar” nr. 9284, datë 30.09.2004
- Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
- Ligji 70 / 2017 datë 27.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” është miratuar në Parlament me datën 24.07.2017 dhe ka hyrë në fuqi me datën 22.05.2017.
- Ligji 35/2017 “Për një ndryshim në KPrP të RSH”
- Ligji 70/2017 “Për një ndryshim në ligjin 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
- Akti Normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike
- Ligji “Për Ratifikimin e Konventës të Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit” Nr. 9492, datë 13.3.2006.
- Ligji “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit” Nr. 9641, datë 20.11.2006.
- Ligji “Për Ratifikimin e Konventës për Pastrimin e, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimit të Terrorizmit” Nr. 9646, datë 27.11.2006.
 - Ligji “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale” Nr. 10 193, datë 3.12.2009. Ligji nr. 8438 datë 28.12..2998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar si dhe ligjit nr. 112/2020 “Për rregjistrin e pronarëve përfitues
 - Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligji nr. 9723 datë 3.5.2007 “Për rregjistrimin e biznesit” i ndryshuar dhe ligji nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme “
 - Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”
 - Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar
 - Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar
 - Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar me ligjin nr. 32 datë 2.04.2015
 - Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”
 - Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën” (Fletore zyrtare 5, viti 1991, faqe 246) Ndryshuar me: Ligj, Ndryshuar me ligjin nr.47/2015datë 7.5.2015)

- Ligji nr. 8438 datë 28.12.2000 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar si dhe ligjit nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues:”.

Konventa të OKB, KE/Vendime Kuadër të KE /Rekomandime të BE / Raporte dhe të tjera:

- Konventa e Këshillit të Evropës për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe Protokollet e saj.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope.
- Konventa e vetme Kombeve të Bashkuara mbi Drogat Narkotike.
- Konventa Evropiane për Shtypjen e Terrorizmit.
- Konventa Penale kundër Korrupsionit dhe Protokollet e saj.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Kombëtar dhe dy Protokollet shitesë të saj;
- Raporti i Konferencës së organizuar nga Komisioni Europian , Misioni EURALIUS dhe Gjykata e Krimeve të Rënda “*Praktikat më të mira të drejtësisë penale - Aktiviteti i Gjykatës së Krimeve të Rënda kontribut solid në luftën kundër krimit të organizuar* “, mbajtur nga Sandër Simoni, 13 korrik 2012. www.gjkr.gov.al
- Konventa e Vjenës 1988, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8722 datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “*Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope*”
- Konventa Evropiane mbi ndihmën gjyqësore në fushën penale, e vitit 1959 (neni 3, I C. E.A.G.) përshkruan letërporosinë si të drejtpërdrejtë, përveçse në njoftime, në “kryerjen e akteve përgatitore” dhe në “përcjelljen e provës së krimit
- European Parliament Resolution of 23 October 2013 on organized crime, corruption and money laundering: recommendations on actions and initiatives to be taken (final report) (2013/2107(INI), The European Parliament
- Direktivën “*Për bllokimin dhe konfiskimin e përfitimeve nga veprat penale në Bashkimin Europian*”.
- Directive 2014/42/EU Of The European Parliament and of The Council, of 3 April 2014, on the freezing and confiscation of instrumentalities and proceeds of crime in the European Union, doc. The European Parliament and the Council of the European Union
- The Stockholm Programme and the Justice and Home Affairs Council Conclusions on Confiscation and asset Recovery adopted in June 2010
- Vendimi Kuadër 2001/500/CBD u kërkon shteteve anëtare të lejojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit pas dënimit të formës së prerë dhe të lejojnë konfiskimin e pasurisë vlera e së cilës i korrespondon këtyre instrumenteve dhe produkteve. Report from the Commission to the European Parliament and the Council, Asset recovery and confiscation, European Commission , Brussels, 2.6.2020 COM (2020)217 final.
- Report from the Commission to the European Parliament and the Council, Asset recovery and confiscation, European Commission , Brussels, 2.6.2020 COM (2020)217 final.

- The Use of Non-Conviction Based Seizure and Confiscation, funded by the European Union and the Council of Europe, Council of Europe 2020, www.coe.int/econcrime
- Reversal of the burden of proof in confiscation of the proceeds of crime: a Council of Europe Best Practice Survey, (*Best Practice Survey No. 2*), PC-S-CO (2000) 8 Rev Council of Europe, European Committee of Crime Problems, Strasbourg 25 May 2000.
- Recommendation 4 of the Financial Action Task Forces 2012, FATF Recommendations 2012, www.fatf-gafi.org on 15 October 2020.
- Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Rikuperimi dhe konfiskimi i pasurisë, Bruksel, 2.6.2020, COM (2020)217 finale
- Marrëveshja e ndihmës së ndërsjellë në fushën penale mes Shqipërisë e Italisë në vitin 2002,
- Direktiva e Parlamentit Evropian nr. 2014/42 e BE e miratuar me 25 shkurt 2015

Vendime të GJEDNJ:

- Vendimi i GJEDNJ datës 13 Nëntor 2007 mbi rastin Bocellari dhe Rizza, datë 8 Korrik 2008, mbi rastin Pierre, dhe 5 Janar 2010, mbi rastin Bongiorno.
- GJEDNJ sesioni. II, 5 janar 2010, Bongiorno e të tjerë kundër Italisë
- Çështja Brems, Vendimi i GJEDNJ 2005
- Çështja Denisova § Moiseyeva kundër Rusisë, Vendimi i datës 4 tetor 2012i GJEDNJ.
- GJEDNJ, 15 prill, Marandina vs. Italisë, GJEDNJ, 22 shkurt 1994, Raimondo kundër Italisë, GJEDNJ 15 qershor 1999, Prisco kundër Italisë
- GJEDNJ, 15 prill, Marandina vs. Italisë, GJEDNJ, 22 shkurt 1994, Raimondo kundër Italisë, GJEDNJ 15 qershor 1999, Prisco kundër Italisë.
- GJEDNJ, 22 shkurt 1994, Raimondo kundër Italisë, GJEDNJ 5 korrik 2001, Arcuri kundër Italisë Corte eur. Dir.uomo 4 shtator 2001, Reila kundër Italisë, GJEDNJ, 5 janar 2010, Buongiorno kundër Italisë
- GJEDNJ, 12 maj 2015, Gogidze dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë, Vendimi Cacucci dhe Sabatelli kundër Italisë, 17 qershor 2014
- Çështja Denisova § Moiseyeva kundër Rusisë, Vendimi i datës 4 tetor 2012i GJEDNJ.
- Wiot kundër Francës, vendim i datës 15 mars 2001; APIS a.s. kundër Sllovakisë, vendim i datës 13 janar 2002;
- Libert kundër Belgjikës, vendim i datës 8 korrik 2004).
- Markass Car Hire Ltd kundër Qipros, vendim i datës 23 Tetor 2001,
- Micallef kundër Maltës, vendim i datës 15 tetor 2009
- Raimondo v. Itali App. Nr. 12954/87 (GJEDNJ 22 shkurt 1994) , Reila kundër Italisë App. Nr. 52439/99 (GJEDNJ 4 shtator 2001, Sun kundër Rusisë, Nr. 31004/02 (GJEDNJ 5 shkurt 2009)

Vendime të tjera gjyqësore të huaja:

- Gjykata e Lartë Belge, Vendimi i 18 shkurtit 1998, Proces & Beëijs 1998, dhe Gjykata e Apelit të Benjafield në Angli në Vendimin e 21 dhjetorit 2000,
- Çështja Comonwealth kundër Weber, vendosur nga Gjykata e Lartë e Massachusetts në 1850, ose dënimi i famshëm i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në re Winship, i vitit 1970, Reference Manual on Scientific Evidence, For Une With Federal Practice and Procedure, Federal Judicial Center, Wes Publishing Company

Vendime të tjera gjyqësore në Shqipëri:

- Vendimi nr. 4 datë 23.02.2011, Gjykata Kushtetuese me Kërkesë Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kërkesa me objekt “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ të ligjit nr. 10192 “.
- Vendimi Nr. 45, datë 23.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese. www.gjk.gov.al
- Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 48 datë 06.07.2015
- Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1 datë 25.01.2007 mbi kërkesën e Prokurorisë së Krimve të Rënda për konfiskimin e pasurisë së shtetasit Xh. T.
- Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 25.01.2007
- Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 25.01.2007
- Vendimi nr. 294 datë 4.5.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 1967 datë 23.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Nr.00-2013-1548 i Vendimit (83) i datës 06.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mbi kërkesën e A.Sh, S.Sh për rishikim vendimi të konfiskimit.
- Vendimi nr.00-2021-438, dt.22.06.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 134, datë 15.02.2018 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 179, datë 27.06.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 1967 datë 23.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 25 datë 10.12.2014 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
- Vendimi nr. 10 datë 12.02.2015 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda
- Vendimi nr. 5 datë 16.03.2018 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda
- Vendimi nr. 230 datë 24.12.2020 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Vendimi nr. 25 datë 10.12.2014 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
- Vendimi nr. 10 datë 12.02.2015 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

- Vendimi nr. 112 datë 24.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimet të Kolegjit të Posacme të Apelimit i cili me Vendimin nr. 12 datë 17.12.2018
- Vendimi nr. 132 datë 1.06.2021 i Gjykatës së Posacme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- Vendimi nr. 11 datë 22.01.2014 i Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 230 datë 24.12.2020 i Gjykatës së Posacme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- Vendimi nr. 41 datë 16.03.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 112 datë 24.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 224 datë 09.12.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 61 datë 29.02.2012 Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 134 datë 15.02.2018 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 132 datë 01.06.2021 i Gjykatës së Posacme të Apelit
- Vendimin nr. 00-2021, datë 7.10.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimin nr. 224 datë 09.12.2014 të Gjykatës së Lartë
- Vendimin nr. 1 datë 16.01.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
- Vendimin nr. 8 datë 02.04.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda

Faqe web:

- <https://www.filodiritto.com/codici/codice-delle-leggi-antimafia-e-delle-misure-di-prevenzione>
- <https://www.europarl.europa.eu/neës/en/faq/17/what-are-the-european-parliament-s-poëers-and-legislative-procedures>
- <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/03/05/18/8a16fc95-2582-420f-89e5-76f288b2bcab;q=akti%20normativ%20nr.%201%20date%2031.01.2020>
- <https://www.altalex.com/documents/altalexpedia/2015/09/28/confisca-confische>
- https://www.echr.coe.int/Documents/CP_Italy_ENG.pdf
- <https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=002-1732&filename=002-1732.pdf>
- <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2002/29/contents>
- <https://www.europarl.europa.eu/news/en/headlines/priorities/crime/20131018IPR22665/cracking-doëen-on-organised-crime-corruption-and-money-laundering>
- https://www.criminaljusticenetwork.eu/contenuti_img/Finocchiario_Libro.pdf
- <https://www.filodiritto.com/codici/codice-delle-leggi-antimafia-e-delle-misure-di-prevenzione>
- <https://eur-lex.europa.eu/legal>,
- <https://eur-lex.europa.eu/lex>

6.5. Statistika

Zbatimi i ligjit për parandalimin e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese dhe rezultatet e tij nga Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Zbatimin e këtij ligji dhe të politikës penale të tij, statistikën mbi to, tiparet e shqyrtimit të kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim sipas ligjit antimafia në për efekt të analizës i kemi ndarë në 5 periudha të zbatimit të tij nga gjykatat kompetente: Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

1- Periudha e zbatimit të ligjit ligji 9284 dt. 30.09.2004 “ *Pwr parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar* ” vitet 2004 – 2009

2 - Periudha e zbatimit të ligjit të ri nr. 10 192 datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, nga viti 2010 e në vazhdim.


3 - Periudha e zbatimit të ligjit pas ndryshimeve me ligjin nr. 10 192 datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, nga viti 2010 e në vazhdim.

4 - Ligji 70 / 2017 datë 27.04.2017 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” është miratuar në Parlament me datën 24.07.2017 dhe ka hyrë në fuqi me datën 22.05.2017.

5 - Akti Normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike*

Tërësia e çështjeve të trajtuara sipas ligjit Antimafia në vitet 2004 - 2021

Ne vite	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Sekuestro Konfiskim	0	14	41	27	22	18	22	17	21	13	31	35	35	33	27	20	20	31




Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2021

Nëpërmjet kësaj table paraqesim të dhënat për treguesit e ngarkesës në vite që nga krijimi i gjykatës për të kuptuar dhe mënyrën e evoluimit të natyrës së çështjeve penale në kompetencën e gjykatës sonë, si dhe për të analizuar ngarkesën e gjykatës.

Ne vite	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Çështje Gjyqsore	140	141	123	124	145	136	111	118	130	171	221	234	211	190	183	142	102	149
Masa sigurimi	237	257	266	266	277	181	354	217	312	332	584	535	451	446	198	173	126	106
Kerkesa te tjera	96	294	587	550	577	656	926	661	782	901	1432	1473	1333	1755	1749	1591	1083	1898
Sekuestro Konfiskim		14	41	27	22	18	22	17	21	13	31	35	35	33	27	20	20	31
Seanca paraprake														49	138	134	77	87
Total	473	706	1008	967	1021	991	1413	1013	1245	1417	2268	2277	2030	2473	2295	2060	1408	2271


Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2021



Tërësia e çështjeve të trajtuara sipas Aktit Nomativ – OFL 2020;2021

Ne vite	2020	2021
Sekuestro Konfiskim	137	96

**Sekuestro Konfiskim sipas Aktit Normativ OFL
Viti 2020 - 2021**



Analizë e rezultateve të shqyrtimit të kërkesave sipas ligjit antimafia.

Nga Raportet e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, të vitit 2012, sipas nenit 18 të ligjit nr. 10 192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasuria sekuestruar dhe konfiskuar me vendim përfundimtar të Gjykatës së Krimeve të Rënda që gjendet nën administrimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (ku përfshihen vlera monetare , pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, banesa, njësi tregtare, automjete) pas analizimit të të dhënave nga vendimet e gjykatës e të azhurnuara dhe Raportet tre mujore të

Agjensisë e Tabelën e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara deri më 27.06.2012 shkon në vlerën 1,899,160,479 lekë ose 13 milion 770 Euro.⁶⁰⁶

Me vendime të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda ose Gjykatës së Lartë janë kthyer pasuritë në vlerën 869,631,351 lekë ose 6 milion e 300 EURO. Shuma e përgjithshme e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga gjykata jonë ka qënë rreth 20 milion EURO. Per periudhen 2010 deri me 30.06.2012 jane Sekuestruar nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krimet e Renda ne total Vlerat Monetare sipas shumave te meposhtme prej:

- 3,028,822.72 Euro
- 33,558.74 USD
- 43,491,209.17 Leke
- 60 Paund (gjashtedhjetë).

Jane Sekuestruar gjithashtu Pasuri te Paluajtshme si me poshte:

- 18 apartamente banimi
- 10 njesi tregtare;
- 7 biznese;
- 6 troje si dhe jane sekuestruar 24 automjete.

Nga keto sekuestro jane Konfiskuar (per periudhen e sipercituar) Vlerat Monetare sipas shumave te meposhtme prej:

- 2,885,654.37 Euro
- 1,937.00 USD
- 31,473,483.60 Leke

7.Planit i Veprimit për plotësimin e 12 Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Europian për Shqipërinë i qershorit 2011 –fq. 74, ka referuar se “vlera e përafërt e gjithë aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara me vendime të formës së prerë të Gjykatës për Krime Të Rënda në administrim të Agjesisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është 2.3 miliard lekë (afërsisht 16.8 milion EURO)”

8.Planit i Veprimit për plotësimin e 12 Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Europian për Shqipërinë, 21.03.2012- fq 136 ka referuar vlerat shtesë gjatë vitit 2011 dhe ka theksuar se e krahasuar me vitin 2010 në vitin 2011 janë konfiskuar 200 % më shumë asete kriminale.

Jane Konfiskuar gjithashtu pasuri te paluajtshme si me poshte:

- 3 apartamente banimi;
- 4 njesi tregtare;
- 6 troje si dhe jane Konfiskuar 4 automjete

Me te detajuar sipas viteve, informacionin e mesiperm ne forme tabelore e gjeni:

Sekuestro pasuri te paluajtshme						
Viti	Apartamente	Njesi tregtare	Troje	Biznese	Automjete	Totali
2010	4	7	4	4	11	30
2011	5	2	1	2	5	15
2012	9	1	1	1	8	20

Konfiskime pasurise te paluajtshme						
Viti	Apartamente	Njesi tregtare	Troje	Biznese	Automjete	Totali
2010	1	0	0	0	1	2
2011	2	4	6	0	3	15
2012	0	0	0	0	0	0


Viti		SEKUESTRO		KONFISKIME		
		Sasia	Siperfaqe	Sasia	Siperfaqe	leke
2010	Automjete	11		1		
	Apartamente	4	337.95	3	138.69	

	Njesi tregetare	8	1983.6			
	Aktivite tregetare	3				
	Troje	4	6275			
			8596.55		138.69	0
201						
1	Automjete	5		3		
	Apartamente	5	476.6		205	
	Njesi tregetare	2	650.9		3059.6	
	Aktivite tregetare	2				
	Troje	1	3080		4875	
			4207.5		8139.6	0
201						
2	Automjete	7				
	Apartamente	7	661.7			
	Njesi tregetare	1	452			
	Aktivite tregetare			3		29,000,000
	Troje	1	759.99			
			1873.69	3	0	29000000


Pershkrimet e pasurive te sekuestruara.

Sekuestro Vlera monetare				
Viti	Euro	USD	Pound	Leke
2010	€ 2,854,588.56	\$2,977.00	£60.00	34,616,406.41
2011	€ 15,129.67	\$0.00	£0.00	0.00
2012	€ 95,338.68	\$30,581.74	£0.00	8,938,570.17

Total	€ 2,965,056.91	\$33,558.74	£60.00	43,554,976.58
--------------	-----------------------	--------------------	---------------	----------------------




Konfiskime Vlera monetare			
Viti	Euro	USA	Leke
2010	€ 70,000.00	\$970.00	39184.16
2011	€ 2,815,654.37	\$967.00	31434299.44
2012	€ 0.00	\$0.00	0.00
Total	€ 2,885,654.37	\$1,937.00	31473483.60




Sekuestriime pasuri te paluajtshme

Viti	Apartamente	Njesi tregtare	Troje	Biznese
2010	4	7	4	4
2011	5	2	1	2
2012	9	1	1	1
Totali	18	10	6	7



Konfiskime pasuri te paluajtshme

Viti	Apartamente	Njesi tregtare	Troje	Biznese
2010	1	0	0	0
2011	2	4	6	0
2012	0	0	0	0
Totali	3	4	6	0



Sekuestro Automjete	
Viti	Automjete
2010	11
2011	5
2012	8
Totali	24

Konfiskime Automjete	
Viti	Automjete
2010	1
2011	3
2012	0
Totali	4


Në krahasim me vitin 2010 , në vitin 2011 janë konfiskuar 200 % më shumë asete kriminale në vlerë monetare.

Pasuritë e sekuestruara dhe ato të konfiskuara janë përfutur kryesisht nga kryerja e veprave penale të trafikimit të narkotikëve dhe të trafikimit të femrave për prostitucion, një pjesë e tyre vijnë nga kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo organizatave kriminale. Këto të dhëna rikonfirmojnë dhe një herë se janë pikërisht trafiqet dhe krimi i organizuar që sjellin të ardhura për autorët e këtyre veprave penale.

Gjatë vitit 2011 dhe 2012 ka patur kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim për pasuri të vëna dhe nga persona të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të parave”, neni 287 i KP. Fakti që në fushën e veprimit të ligjit antimafia janë dhe pasuri të krijuara me vepra penale të cilat nuk janë në kompetencën e Gjykatës për Krime të Rënda si “Pastrimi i parave”, neni 287 dhe “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” neni 114/a të KP mund të ndikojë në evidentimin e tyre gjatë fazës hetimore.

Më poshtë po paraqesim ecurinë e gjykimit të kërkesave që lidhen me aplikimin e ligjit “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikeve nëpërmjet Masave Parandaluese”.

Tabela e gjykrimeve parandaluese (kërkesave LPGKO) në tërësi



Kërkesat penale dhe (kërkesa LPGKO) VITI 2014

Të rregjistruara gjithsej	32
Sekuestro	22

Konfiskime	5
Të përfunduara	27
Të mbartuara	5

